

PËRGJEGJËSIA E SHITËSIT PËR DORËZIMIN E MALLIT NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE

Doktoranti: Majlinda Belegu

Dorëzuar:
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(SHKENCA JURIDIKE), me profil (E DREJTA CIVILE), për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.asoc.Dr.sc. Armand Krasniqi

Tiranë, 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Studimi është punë origjinale dhe është kryer duke u respektuar standardet e njohura dhe të pranuara për studime dhe hulumtime.

Autorja e studimit është e ndërgjegjshme dhe e përgjegjshme për detyrimet që ka pasur në kuptim të përdorimit të literaturës, referimeve, referencave, citimeve, etj., gjatë kryerjes së studimit doktorat.

A u t o r j a

Abstrakt

Qëllimi i studimit është të bëhet një përshkrim dhe interpretim i normave vendore dhe atyre ndërkombëtare, krahasueshmëria dhe ngjashmëria e këtyre normave në ves vete lidhur me përgjegjësitë e shitësit të kontratës së shitjes. Analiza e punimit është bërë kryesisht duke u bazuar në normat e LMD-së dhe KCSH duke i krahasuar këto me normat ndërkombëtare posaçërisht me Konventën e Vjenës. Studimi synon të shpjegojë mundësitë e unifikimit të së drejtës vendore me atë ndërkombëtare sepse Shqipëria dhe Kosova janë pretendente për anëtarësim në BE.

Në studim paraqitet edhe pasqyrë e krahasueshmërisë në mes normave vendore dhe ndërkombëtare për vendin, kohën dhe mënyrën e dorëzimit të mallit nga ana e shitësit tek blerësi si përgjegjësi kryesore e tij sipas kontratës së shitjes.

Poashtu në këtë punim paraqiten të gjitha detyrimet e shitësit për mallin që duhet ta dorëzojë konform kontratës së shitjes. Ai është përgjegjës për dorëzimin e mallit pa të meta materiale dhe juridike dhe bëhet krahasueshmëria normative vendore dhe ndërkombëtare kur shitësi nuk përgjigjet për të metat e mallit. Përgjegjësi i shitësit sipas LMD-së dhe KCSH është edhe bartja e pronësisë së mallit, ndërkajë sipas KV bartja e pronësisë nuk është përgjegjësi e tij.

Konventa e Vjenës bazohet në teorinë komerciale (tregtare) si edhe sistemi common law, ndërkajë LMD dhe KCSH janë bazuar në teorinë tradicionale, e cila teori është ku bazohet sistemi kontrinental.

Metodologjia e këtij studimi është paraqitja e teorisë tradicionale dhe teorisë tregtare (komerciale) së dorëzimit të mallit. Si përgjegjësi tjetër e shitësit përveç dorëzimit të mallit në vendin dhe kohën e caktuar konform kontratës është edhe përgjegjësia e tij lidhur me pretendimet e personit të tretë për mallin e shitur. Shitësi është përgjegjës edhe nëse malli nuk dorëzohet konform kontratës së shitjes. Shitësi është përgjegjës, nëse nga ana e tij është dorëzuar mall i kualitetit dhe sasisë konform kontratës së shitjes.

Është e lehtë kur kontrata përmbushet sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese por është shumë e vështirë kur shkelet, nuk përmbushet, ose, kur kontrata përmbushet pjesërisht.

Në këtë rast në punim është analizuar dëmi dhe rastet kur ai shkaktohet si dhe janë sqaruar llojet e dëmit të shkaktuar dhe mënyra e kompensimit të këtij dëmit. Shkaktimi i dëmit sjell edhe te kompensimi i tij me mjete monetare.

Fjalët kyçe: Ligj, Shitësi, Blerësi, Kontrata, Mall

Abstract

Study aims to make a description and the interpretation of national and international norms, comparison and similarity of these norms among themselves related to the responsibility of seller on the contracts of sale. Analysis is done basically based on the norms of LMD (Law on Obligatory Relations) and the Albanian Civil Code (KCSH) comparing these with the international norms especially with the Vienna Convention. Study aims to explain possibilities of unification of the domestic law with the international law since both Albania and Kosova are pretending EU membership.

In the study it is presented a mirror of comparison between national norms and the international norms for the country, time and the way of goods delivery by seller to buyer as the main responsibility according to the contract of sale.

There are also presented all obligations of seller regarding goods that he has to deliver according to the contract. He is responsible to deliver goods with no material and judicial shortcomings and the comparison of national and international normative is done when the seller doesn't respond for the goods shortcomings. It is seller's responsibility according to the LMD and KCSH to transfer the ownership over the goods whereas according to KV the transfer of ownership is not the seller's responsibility.

Vienna Convention is based on the commercial (trade) theory as well the common law system, whereas LMD and KCSH are based on the traditional theory which is the theory where the continental system is based.

Methodology of this study is presentation of the traditional theory and the trade (commercial) theory on delivering goods. As the other responsibility apart from delivering goods on the determined time and place conform the contract is seller's responsibility related to the pretendings of the third person on the sold goods. Seller is responsible also if the goods are not delivered conform the sale contract. Seller is responsible if from his side it is delivered goods of quality and quantity conform the sale contract.

It is easy when the contract is fulfilled according to the agreement between parties but it is very difficult if the contract is violated, if contract is not fulfilled or if the contract is fulfilled partially.

In this case the within the study it is analysed the damage and the cases when the damages are caused as well as the types of damages in goods and the way of compensation. The cause of damage brings to the monetary compensation, as well.

Key words: Law, Seller, Buyer, Contract, Goods.

MIRËNJOHJE

Së pari, falënderoj dhe shpreh mirënjohje për udhëheqësin tim, prof. dr. Armand Krasniqi, i cili me përkushtim dhe me përgjegjësi intelektuale më ka ndjekur gjatë gjithë kohës së studimeve në shkollën doktorale. Udhëzimet e profesor Armandit për hulumtim, për gjetje të burimeve dhe për përdorimin e tyre kanë qenë çelësi për të nxjerrë produktin që e kemi në duar.

Së dyti, e falënderoj edhe sepse më ka shtyrë dhe më ka inkurajuar për punë hulumtuese duke më krijuar një mjedis në të cilin jam ndier tërësisht e barabartë edhe për sa i përket komunikimit intelektual.

Mirënjohjet dhe falënderime edhe për Komisionin dhe profesorët e Shkollës Doktorale që më ka udhëzuar dhe më ka ndjekur gjatë ditëve doktorale, të cilët duke më kritikuar dhe duke qenë njëkohësisht kërkues ndaj meje më kanë shtuar vullnetin për punë dhe për përgjegjësi gjatë periudhës si doktorante.

Falënderoj gjithashtu prof. dr. Ksenofon Krisafin i cili ka qenë gjithnjë i gatshëm t'i përgjigjet kërkesave të mia për një orientim sa më të mirë dhe efikas në literaturë, për interpretim të normave të së drejtës ndërkombëtare dhe për gatishmërinë e tij për të më udhëzuar sidomos në çështjet metodologjike.

I gjithë personeli i shkollës doktorale meriton respekt dhe falënderim për asistencën e dhënë, kolegjalitetin dhe lehtësimet gjatë komunikimit.

Falënderoj familjen time, veçanërisht prindërit dhe fëmijët e mi, që më kanë mbështetur, duruar dhe mirëkuptuar gjatë kohës së shkollës doktorate, kohë kaq e ngarkuar kur jo rrallë herë nuk kam arritur të përmbush obligimet e mia familjare.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORËSISË	ii
Abstrakt	iii
Abstract	v
MIRËNJOHJE	vii
Shkurtesa	xv
KAPITULLI I: Hyrje	1
I. Metodologjia e punës	5
II. Pyetje dhe hipoteza	6
III. Metodatat e hulumtimit	7
IV. Burimet e studimit	8
KAPITULLI II: BURIMET JURIDIKE PËR PËRGJEGJËSINË E SHITËSIT PËR DORËZIMIN E.....	9
II.1. Burimet Ndërkombëtare.....	9
II.1.1. Konventat Ndërkombëtare si burim.....	10
II.1.1.2. Ligjet Uniforme të Hagës.....	11
II.1.1.3. Konventa e Kombeve të Bashkuara për kontratën për shitjen ndërkombëtare të mallit- Konventa e Vjenës	12
II.1.1.3.1. Rëndësia e Konventës së Vjenës	14
II.1.1.3.2. Struktura e Konventës	15
II.1.1.3.3. Interpretimi i Konventës së Vjenës	16
II.1.1.3.4. Mangësitë më të rëndësishme të Konventës së Vjenës	18
II.1.1.4. Konventa të tjera të rëndësishme për shitjen ndërkombëtare të mallit	18
II.1.2. Burimet e veçanta të shitjes ndërkombëtare të mallit	18
II.1.2.1. Llojet e burimeve të veçanta.....	19
II.1.2.2. Parimet e kontratave ndërkombëtare tregtare - UNDROIT	20

II.1.2.3. Parimet e të Drejtës Kontraktore Europiane (PECL).....	21
II.1.2.4. Rregullat ndërkombëtare për interpretimin e nocioneve të tregtisë - INCOTERMS	22
II.2. Burimet kombëtare	24
II.2.1. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve	24
II.2.2. Uzansat.....	25

KAPITULLI III: DETYRIMI I DORËZIMIT TË SENDIT DUKE U BAZUAR NË KONTRATËN E SHITJES

III. 1. Vështrime të përgjithshme	27
III. 2. Përkufizimi teorik i dorëzimit - konceptet tradicionale dhe komerciale	28
III. 3. Përkufizimi i nocionit të dorëzimit sipas legjislacionit pozitiv.....	33
III. 3.1. Dorëzimi te shitja ndërkombëtare e mallit.....	35
III. 3.1.1. Vendi dhe përmbajtja e dorëzimit	36
III. 3.1.1.1 Detyrimi i shitësit që mallin ta dorëzojë në vendin e caktuar	37
III. 3.1.1.2. Përmbytja e detyrimit me dorëzimin e mallit transportuesit.....	39
III. 3.1.1.2.1. Transporti i mallit	40
III. 3.1.1.2.2. Transportuesi	42
III. 3.1.1.2.3. Dorëzimi i mallit	46
III. 3.1.1.2.4. Vendi i dorëzimit	48
III. 3.1.1.3.Dorëzimi i mallit te blerësi.....	49
III. 3.1.1.3.1. Vendosja e mallit në posedim të blerësit.....	50
III. 3.1.1.3.2. Vendi i ndodhjes së mallit si vend i përmbytjes së detyrimit	53
III. 3.1.1.3. Selia e shitësit si vend i përmbytjes së detyrimit	55
III. 3.1.2. Koha e përmbytjes.....	56
III. 3.1.2.1. Caktimi me kontratë i kohës për dorëzimin e mallit.....	57
III. 3.1.2.1.1. Caktimi i datës së përmbytjes së detyrimit	57
III. 3.1.2.1.2. Caktimi i periudhës kohore për përmbytjen e detyrimit	58
III. 3.1.2.2. Përmbytja e detyrimit në afatin e arsyeshëm	61
III. 3.2. Dorëzimi i mallit te shitja vendore e mallit.....	63
III. 3.2.1. Vendi dhe përmbajtja e dorëzimit - rregulla të përgjithshme	63
III. 3.2.1.1. Vendi i ndodhjes së mallit si vend i përmbytjes	65

III. 3.2.1.2. Vendi i dërgimit të mallit si vend i përmbushjes së detyrimit (dorëzimit të mallit)...	66
III. 3.2.2. Koha e dorëzimit të mallit.....	69
III. 3.2.2.1. Rregullimi me kontratë i kohës së dorëzimit të mallit.....	70
III. 3.2.2.1.1. Dorëzimi i mallit në kohën e caktuar (në ditë).....	71
III. 3.2.2.1.2. Dorëzimi në afatin e caktuar.....	72
III. 3.2.2.2. Dorëzimi i mallit në afat sipas marrëveshjes së palëve	75
III. 4. Përfundimi.....	76

K APITULLI IV: PËRGJEGJËSIA E SHITËSIT PËR DORËZIMIN E MALLIT NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE	79
IV. 1. Vështrime të përgjithshme.....	79
IV. 2. Qëllimi i përgjegjësisë kontraktore	80
IV. 3. Kushtet e përgjegjësisë kontraktore	81
IV. 4. Dëmtimi i përgjegjësisë së përmbushjes	82
IV. 5. Llojet e shkeljeve kontraktore dhe rëndësia e tyre për përgjegjësinë e shitësit.....	84
IV. 6. Përmbajtja e normave për përgjegjësinë e shitësit	85
IV. 7. Natyra juridike dhe kuptimi i përgjegjësisë së shitësit për dorëzim të mallit në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore.....	86
IV. 7.1. Kushtet për paraqitjen e përgjegjësisë së shitësit për vonesën e përmbushjes	90
IV. 7.1.1. Kushtet e dukurisë së vonesës së shitësit.....	92
IV. 7.1.1.1 Kushtet pozitive.....	92
IV. 7.1.1.2 Kushtet negative	95
IV. 7.2. Fajësia e shitësit	98
IV. 8. Përgjegjësia e shitësit në rastet e shkeljes së kontratës me dorëzimin e mallit	99
IV. 8.1. Vështrime të përgjithshme	99
IV. 8.2. Kuptimi i konformitetit.....	101
IV. 8.3. Dorëzimi i mallit me të meta fizike.....	106
IV. 8.3.1. Kuptimi subjektiv i defektit (i të metave) së mallit.....	108
IV. 8.3.1.1. Marrëveshja eksplicite	109
IV. 8.3.1.2. Marrëveshja e heshtur.....	110
IV. 8.3.2. Kuptimi objektiv i defektit (mungesës)	111

IV. 8.3.2.1. Përshtatshmëria e mallrave për përdorim të zakonshëm	113
IV. 8.3.2.2. Përshtatshmëria e mallrave me qëllim të veçantë.....	119
IV. 8.3.2.2.1. Njohja e shitësit për qëllimin e caktuar	120
IV. 8.3.2.2.2. Besimi i blerësit në ekspertizën dhe gjykimin e shitësit	122
IV. 8.3.2.3. Ngjashmëria e mallit në mostër ose model (kampion)	122
IV. 8.3.2.4. Paketimi i zakonshëm ose i duhur i mallit	126
IV. 8.4. Dorëzimi i një pjese të sendit të shitur ose dorëzimi i një sasive më të vogël ose më të madhe ndryshe nga kontrata	129
IV. 8.5. Dorëzimi aliud.....	133
IV. 8.6. Paketimi (ambalazhimi) ose mbrojtja e mallit	139
IV. 8.7. Koha për përcaktimin e konformitetit të mallit.....	140
IV. 8.7.1. Kalimi i rrezikut	141
IV. 8.7.2. Jokonformiteti në kohën e kalimit të rrezikut	142
IV. 8.7.3. Jokonformiteti pas kalimit të rrezikut.....	145
IV. 8.7.3.1. Dëmtimi i detyrimit nga ana e shitësit	145
IV. 8.7.3.2. Garancia e shitësit.....	148
IV. 8.8. Të metat e dukshme.....	151
IV. 8.9. Mungesat e fshehura.....	154
IV. 8.9.1. Kohëzgjatja e afatit.....	157
IV. 8.9.1.1. Afati prekluziv.....	159
IV. 8.9.2. Afati i garantuar me kontratë	162
IV. 8.10. Përfshirjet nga detyrimi i lajmërimit	164
IV. 8.10.1. Njohuritë e shitësit për veset, mungesat, dëmet	165
IV. 8.10.2. Njohuria e shitësit.....	166
IV. 8.10.3. Moszbulimi i mungesave shitësit	168
IV. 8.10.4. Koha e zbatueshme për njohuri të shitësit	169
IV. 8.11. Justifikimi i arsyeshëm për mospërbushje të detyrimit të shitësit për lajmërim.....	170
IV. 8.11.1. Mungesa e lajmërimit (njofimit)	172
IV. 8.11.2. Justifikimi i arsyeshëm	172
IV. 8.11.3. Ndikimi i nenit 44 i Konventës së Vjenës për përgjegjësinë e shitësit.....	176
IV. 8.12. Jokonformiteti i mallit për të cilën shitësi nuk përgjigjet.....	177

IV. 8.12.1. Të metat materiale të parëndësishme.....	178
IV. 8.12.2. Njohuritë e blerësit për të metat	179
IV. 8.12.3. Njohuritë e blerësit	180
IV. 8.12.4. Pakujdesia e shitësit	183
IV. 8.12.5. Koha e nevojshme për njohuritë e blerësit.....	184
IV. 8.12.6. Efektet e lirimit.....	185
IV. 9. Përgjegjësia e shitësit për shkak të dëmtimit (shkeljes) të kontratës me dorëzimin e mallit me të meta juridike (përgjegjësia e përgjithshme e shitësit për mungesat juridike)	186
IV. 9.1. Të metat juridike	188
IV. 9.1.1. E Drejta e personit të tretë	189
IV. 9.1.2. Arkëtimi (pretendimet) e personit të tretë.....	191
IV. 9.2. Koha e nevojshme për ekzistimin e të metave juridike	192
IV. 9.3. Njoftimi për të metat juridike.....	194
IV. 9.3.1. Lënda dhe përmbajtja e njoftimit	195
IV. 9.3.2. Afati për njoftim	196
IV. 9.3.2.1. Fillimi i afatit për njoftim	196
IV. 9.3.2.2. Zgjatja e afatit.....	197
IV. 9.3.3. Afati i fundit për njoftim.....	198
IV. 9.3.4. Forma e njoftimit, adresimi dhe rreziku i transfertës	199
IV. 9.4.Përfjashtimet nga detyrimi i njoftimit.....	199
IV. 9.4.1. Njohuria e shitësit për të drejtat ose kërkesat e personit të tretë.....	200
IV. 9.4.2. Arsyetimi i arsyeshëm për mospërmbushje të detyrimit të njoftimit	201
IV. 9.5. Të metat juridike për të cilat shitësi nuk përgjigjet.....	202
IV. 10. Përgjegjësia e shitësit, përgjegjësi kur në mallin e shitur ekziston e drejta ose kërkesa e cila krijohet në pronësinë industriale ose intelektuale	203
IV. 10.1. E drejta e personit të tretë për kërkimin e të drejtave të cilat krijohen në pronësinë intelektuale dhe industriale	205
IV. 10.2. Kufizimi territorial	207
IV. 10.2.1. Shteti i përdorimit të mallit	208
IV. 10.2.2. Shteti i selisë së blerësit	210
IV. 10.3. Koha për ekzekutimin e të drejtave ose kërkesave të personit të tretë të cilat krijohen në pronësinë intelektuale.....	210

IV. 10.4. Njohuritë e shitësit.....	211
IV. 10.5.Njoftimi i shitësit për të drejtat ose kërkimet e personit të tretë të cilat krijohen në pronësinë industriale dhe intelektuale	213
IV. 10.6.Përfshirja e përgjegjësisë së shitësit	214
IV. 10.6.1. Njohuria e blerësit	215
IV. 10.6.2.Trajtimi sipas udhëzimeve teknike të blerësit	216
IV. 11. Bazat për lirimin e shitësit nga përgjegjësia për dorëzimin e mallit	217
IV. 11.1.Bazat për lirimin nga përgjegjësia të shitja ndërkombëtare e mallit	218
IV. 11.1.1.Karakteret e normës për lirimin e përgjegjësisë	219
IV. 11.1.2.Rasti i jashtëzakonshëm (vis major)	220
IV. 11.1.2.1.Kushtet për lirim.....	221
IV. 11.1.2.2.Mospërbushja e detyrimit të dorëzimit	221
IV. 11.1.2.2.1.Shkelja e kontratës, jashtë kontrollit të shitësit	223
IV. 11.1.2.2.2.Fusha e kontrollit të shitësit	225
IV. 11.1.2.2.3. Dorëzimi i mallit jokonform kontratës	228
IV. 11.1.2.2.4. Mosparashikimi i pengesës	229
IV. 11.1.2.2.4. Pathyeshmëria e pengesës dhe pasojat e saj.....	232
IV. 11.1.2.2.5.Shkaku.....	233
IV. 11.1.3. Lirimi për shkak të veprimit ose lëshimit të blerësit	234
IV. 11.1.3.1. Kushtet për lirim nga përgjegjësia.....	235
IV. 11.1.3.1.1. Mospërbushja e detyrimit.....	235
IV. 11.1.3.1.2 Veprimi i shitësit	235
IV. 11.1.3.1.3 Lidhja shkakësore	236
IV. 11.1.3.2. Rregullat për lirimin e shitësit nga përgjegjësia për veprimet ose lëshimet e blerësit	237
IV. 11.2.Baza për lirimin e shitësit nga përgjegjësia për mospërbushje të detyrimit tek e drejta vendore	238
IV. 11.3. Karakteret e normës për lirimin nga përgjegjësia.....	238
IV. 11.4.Kushtet për lirim nga përgjegjësia e shitësit për mospërbushje të kontratës.....	238

KAPITULLI V: KOMPENSIMI I DËMIT SI PËRGJEGJËSI KONTRAKTORE E SHITËSIT PËR SHKAK TË SHKELJES SË DETYRIMIT TË DORËZIMIT	240
V.1. Vështirime të përgjithshme	240
V.2. Kërkesa e blerësit për kompensim dëmi	241
V.3.Kompensimi i dëmit	241
V.3.1.Kompensimi i dëmit sipas zgjedhjes së blerësit.....	242
V.3.2.Kompensimi i dëmit me mjete monetare.....	242
V.4. Mënyrat e kompensimit	243
V.5.Mënyra konkrete e kompensimit të dëmit	244
V.5.1. Dëmi real – dëmi i rëndomtë.....	244
V.5.2. Dëmi i shkaktuar për shkak të mospërbushjes së kontratës.....	245
V.6. Dëmet anësore.....	245
V.7. Pasojat e dëmit	246
V.8. Lucrum cessans apo fitimi i humbur	246
V.9. Mjetet monetare të shpërblimit të dëmit	247
 KAPITULLI VI: PËRFUNDIMET / KONLUZIONET	249
 LISTA E REFERENCAVE / LITERATURA.....	260

Shkurtesa

INCOTERMS - Rregullat ndërkombëtare për interpretimin e nocioneve të tregtisë

CISG - Konventa për Shitjen Ndërkombëtare të Mallit

KSHNM –Kontrata për shitjen ndërkombëtare të mallit

KV - Konventa e Vjenës

KCSH - Kodi Civil Shqiptar

LMD - Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës

RSFJ - Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

UNDROIT - Parimet e kontratave ndërkombëtare tregtare

PECL - Parimet e të Drejtës Kontraktore Evropiane

KKBDNT - Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare

UNICTRAL - Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Tregtinë Ndërkombëtare

OKB - Organizata e Komebeve të Bashkuara

AP – Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Komebeve të Bashkuara

KAPITULLI I: Hyrje

Kontrata e shitjes është kontrata me e shpeshtë dhe kontrata më e rëndësishme në të drejtën e detyrimeve. Në bazë të kontratës, palët kontraktuese duhet të jenë të gatshme të përmbushin të gjitha detyrimet e tyre. Përkundër kësaj shitësi duhet të dorëzojë mallin, të dorëzojë dokumentacionin që janë dokumentacione për sendin që është shitur. Përveç kësaj, ai duhet të dorëzojë pronësinë në mallin e shitur. Blerësi duhet të marrë sendin e blerë dhe të dorëzojë çmimin për sendin, ashtu siç e kanë bërë marrëveshjen, që njëkohësisht paraqiten edhe si dy detyrime kryesore të blerësit. Qëllimi i shuarjes së secilës kontratë për shitjen është përmbushja e detyrimeve që janë krijuar me lidhjen e saj. Detyrimet, të cilat i bart shitësi janë pak më të rënda dhe më me përgjegjësi sesa ato të blerësit. Palët kontraktuese duhet të plotësojnë kushtet për lidhjen e kontratës, sepse nëse ato nuk plotësohen të dy palët kontraktuese do të jenë të sanksionuara si moralisht ashtu edhe ekonomikisht. Në këtë punim të doktoraturës do të bëjmë objekt analize përgjegjësinë e shitësit për dorëzimin e mallit në të drejtën vendore dhe ndërkombëtare. I gjithë punimi i referohet normave vendore dhe ndërkombëtare kryesisht në shumicën e rasteve bëhet krahasim në mes Konventës së Vjenës Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të Kosovës dhe Kodit Civil Shqiptar.

Shitësi duhet të dorëzojë mallin, por njëkohësisht duhet të ketë detyrim në mënyrë që ta bëjë dorëzimin në raport me detyrimet që i ka marrë nga ana e kontratës. Shitësi e shkel marrëveshjen e tij menjëherë në atë moment kur nuk vepron në mënyrë si janë marrë vesh në kontratë. Kur malli i kontraktuar nuk është dorëzuar sipas marrëveshjes në kohën dhe vendin, dhe sipas kushteve të përshkruara në kontratë. Shkelja e kontratës bëhet kur nuk dorëzohet malli, kur malli dorëzohet në sasi më të vogël ose edhe kur malli nuk dorëzohet sipas cilësisë apo edhe sipas vlerave të cilat janë përshkruar në kontratë. Poashtu punimi do të përmbajë detyrimin e dorëzimit të mallit blerësit sipas të gjitha detyrimeve të tij të përcaktuara në kontratë. Përvec mallit fizikisht duhet dorëzuar edhe dokumentacioni përkatës i mallit. Sipas KCSH malli duhet dorëzuar transportuesit, dhe dorëzimi transportuesit përbën përmbushje të detyrimit të shitësit ndaj blerësit. Malli duhet të dërgohet në gjendje ashtu si është kontrolluar nga ana e blerësit. Malli duhet të posedoj të gjitha kualitetet e paraqitura nuk duhet të ketë mungesa fizike, juridike.

Malli poashtu duhet të posedoj paketimin e duhur sipas marrëveshjes në kontratë, ai duhet të jetë i paketuar edhe nëse nuk është paraparë me kontratën e shitjes.

Qëllimi i përzgjedhjes së temës “*Përgjegjësia e shitësit për dorëzimin e mallit në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore*” qëndron si më poshtë:

E para, ekziston nevoja e analizës së normave vendore dhe ndërkombëtare dhe propozimi për vendime të reja të cilat do t’iu përgjigjen rasteve për tregtinë ndërkombëtare. Këtu flitet për vendimet, që do t’iu përgjigjen rasteve konkrete të cilat raste janë të pranishme në të drejtën vendore. E dyta, edhe pse në shqip ekziston literaturë për kontratën e shitjes ajo megjithatë është e pamjaftueshme dhe personalisht kam hasur vështirësi në gjetjen e literaturës. Shumica e literaturës që më është dashur të analizoj është literatura e huaj. Literatura në gjuhën shqipe përfshin vetëm interpretim ligjesh duke i munguar aktualiteti dhe duke përfshirë fare pak, në mos aspak vendime gjyqësore nga praktika gjyqësore. E fundit, ekzistojnë probleme të mëdha edhe në praktikën gjyqësore sidomos kur bëhet fjalë për Kosovën.

Punimi do t’iu shërbej lexuesve në përgjithësi dhe juristëve në veçanti për çështjet e ndryshme në praktikën gjyqësore. Është bërë përpjekje që përgjegjësia e shitësit të shpjegohet në mënyrën më të qartë të mundshme duke analizuar dhe interpretuar normat pozitive vendore dhe ndërkombëtare.

Pikënisja e analizës dhe vendin qëndror në analizë e kanë dispozitat që përmban LMD-ja dhe Konventa e Vjenës për shitjen ndërkombëtare të mallit. Kjo është konsideruar shumë e domosdoshme dhe në këtë mënyrë jemi munduar të japim shpjegime dhe të bëjmë analizë dhe interpretime të burimeve ndërkombëtare dhe vendore.

Në analizë (kur ka qenë e mundur), është vështuar dhe është paraqitur mendimi i teoricienëve të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë. Jemi munduar të përcaktojmë nocionin e dorëzimit si edhe bazën për lirimin e shitësit nga përgjegjësia për mosdorëzimin e mallit. Sipas metodologjisë janë analizuar vendimet që ekzistojnë në praktikën gjyqësore të ne dhe në praktikën ndërkombëtare për dorëzimin e mallit dhe për mosdorëzimin e tij dhe në rast se vjen deri te mosdorëzimi i mallit si do të bëhet shpërblimi i dëmit për mospërmbushje të kontratës ose kur ajo është përmbushur pjesërisht apo është përmbushur duke u zëvendësuar me një mall tjetër jokonform kontratës. Në fund kemi përfshirë analiza përmbyllëse.

Punimi përbëhet nga 6 kapituj: **Kapitulli i parë** paraqet hyrjen e punimit të doktoraturës në të cilën janë parashtruar qëllimet e studimit, objektivat e studimit, metodologjia e punimit si dhe metodat e përdorura për punimin e doktoraturës.

Tema e doktoraturës përvec kapitullit të hyrjes ka 5 kapituj tjerë, Kapitulli i gjashtë është kapitull ku janë paraqitur përfundimet/konkluzionet si dhe e fundit është literatura e shfrytëzuar për hulumtim.

Kapitulli i dytë - përfshin analizën e normave pozitive ndërkombëtare dhe vendore. Ky kapitull përmban përshkrimin e normave të aplikueshme vendore dhe ndërkombëtare. Fillimisht fillohet me historikun e unifikimit të normave ndërkombëtare lidhur me shitjen ndërkombëtare të mallit. Fillon me sqarimin e Ligjeve Uniforme të Hagës, KV, Parimet e kontratave ndërkombëtare tregtare – UNDRIT, Parimet e të Drejtës Kontraktore Europiane (PECL), për të vazhduar më tutje me Rregullat ndërkombëtare për interpretimin e nocioneve të tregtisë – INCOTERMS. Në fund përfshihen burimet vendore për shitjen e mallit.

Kapitulli i tretë - përfshin analizën teorike të nocionit pozitiv të dorëzimit. Në këtë kapitull është analizuar teoria tradicionale dhe teoria komerciale. Analiza është bërë në mes të këtyre teorive dhe duke e sqaruar se cilës teori i përket legjislacioni jonë. Konventa e Vjenës më tepër i çaset teorisë komerciale e cila teori dorëzimin e parasheh si detyrim të shitësit dhe blerësit. Shitësi është i obliguar të dorëzoj mallin sipas marrëveshjes, blerësi të paguaj mallin. Ndërkaq teoria tradicionale përvec dorëzimit të mallit dhe çmimit të sendit parasheh edhe bartjen e pronësisë.

Përvec teorive këtu është analizuar vendi dhe koha e dorëzimit të mallit e përcaktuar me kontratën e shitjes, legjislacionit në fuqi dhe Konventës së Vjenës. Gjithmonë në kapitull janë bërë krahasueshmëri në mes normave vendore dhe ndërkombëtre për problematikën e shtruar.

Kapitulli katër, që njëkohësisht është edhe kapitulli kryesor, përfshin gjithë përgjegjësinë e shitësit për dorëzimin e mallit në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore duke bërë edhe krahasimin mes normave vendore KCSH dhe LMD-së së Kosovës për përgjegjësinë dhe dorëzimin e mallit nga ana e shitësit ashtu si janë marrë vesh në kontratë. Ky kapitull është edhe pjesa kryesore e temës së doktoraturës. Ndahet në disa nënpjesë duke sqaruar probleme bazë të dhe detyrime bazë të shitësit të përcaktuara me kontratë dhe me normat për shitjen e mallit.

Përgjegjësia e shitësit për mospërmblidhjen e kontratës konform kushteve të përcaktuara ligjore dhe kontraktore. Janë numëruar shkeljet e detyrimeve kontraktore nga ana e shitësit për

dorëzimin e mallit jokonform kontratës, dorëzimin e mallit aluid, dorëzimin e mallit me të meta, dorëzimin e mallit me të drejtë të personit të tretë, dorëzimin e mallit të paketuar etj.

Përgjegjësinë e shitësit për të metat e mallit. Përshkrimi dhe analizimi i këtyre mungesave/veseve/të metave/defekteve të mallit dhe përgjegjësia e shitësit nëse blerësi ka ditur për këto të meta dhe në rastet kur ai nuk ka pasur njohuri për to. Analizimi i të metave të dukshme dhe të padukshme sipas legjislacionit tonë dhe analiza e këtyre normave me norma ndërkombëtare. Paketimi i mallit është objekt analize poashtu dhe mospërbushja e këtij detyrimi a e bën përgjegjës shitësin sipas Kodit Civil, LMD-së dhe KV. Kapitulli katër përfshin edhe analizën e nocionit konformitet, jokonformitet dhe përgjegjësinë e shitësit në rast se malli është konform kontratës dhe jokonform kontratës. Në këtë kapitull sqarohen edhe rastet specifike kur shitësi nuk është përgjegjës për mospërbushjen e kontratës konform kontratës. Kapitulli përmban edhe analizën e lajmërimit të shitësit nga ana e blerësit për të metat e mallit, kohën e lajmërimit dhe rastet kur mungon lajmërimi. Afatet për lajmërim të shitësit për të metat nga ana e blerësit.

Kapitulli pesë - përfshin analizën e shpërblimit të dëmit në rast të shkakimit të dëmit dhe në rast se ai shkaktohet si pasojë e shkeljes së kontratës. Në këtë kapitull sqarohet dëmi, llojet e dëmit, pasojat e dëmit dhe mjetet monetare me çka bëhet kompensimi i tij.

Në sythin përfundime (**kapitulli gjashtë**) jepen të gjitha përfundimet relevante që janë edhe konkludime të hulumtimit.

Literatura është bazuar në burimet të ndryshme hulumtimi.

Për vite me radhë është grumbulluar literaturë juridike vendore dhe ndërkombëtare, që i përket fushës, dhe ndërkohë është bërë një seleksionim i kujdesshëm, ku është përzgjedhur literatura së cilës do t'i referohemi dhe e gjithë kjo përzgjedhje është bërë me qëllim që të jemi sa më neutralë në analizën e objektit të studimit. Janë përzgjedhur autorë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë. Për kapitujt e temës është përzgjedhur literaturë si vendore po ashtu edhe ndërkombëtare, në literaturë janë përfshirë edhe konventat ndërkombëtare për shitjen ndërkombëtare të mallit në veçanti, por edhe për kontratën e shitjes në përgjithësi. Ligjet e zbatueshme në vendin tonë janë interpretuar dhe janë shfrytëzuar si bazë apo më mirë të themi si udhëzues për sqarimin e problematikës. Janë përdorur dispozita nga Konventa e Vjenës, rregullat INCOTERMS, janë sqaruar parime lidhur me çështjen e përgjegjësisë së shitësit. Meqë në kapitullin II janë sqaruar edhe burimet vendore për përgjegjësinë e shitësit atëherë janë përdorur

burimet si Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve, Uzansat e Veçanta dhe të Përgjithshme lidhur me përgjegjësinë e shitësit për shitjen ndërkombëtare të mallit. Krahas kësaj është përdorur edhe literaturë akademike. Po ashtu janë intervistuar përfaqësues të biznesit dhe të transportit për shitjen dhe transportimin e mallit si brenda ashtu edhe jashtë shtetit. Të gjitha këto intervista do të përdoren vetëm për nevoja të studimit dhe këto do të mbeten anonime.

Grumbullimi i literaturës ka përfshirë literaturën e autorëve të spikatur të së drejtës ndërkombëtare tradicionale, prej të cilëve është nxjerrë të kuptuarit tradicional të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare. Janë nxjerrë interpretime të burimeve ndërkombëtare e sidomos për Konventën Ndërkombëtare për Shitjen Ndërkombëtare të Mallit. Nga kjo konventë është përshkruar dhe struktura e saj. Është sqaruar ndikimi i saj në normat vendore dhe ngjashmëria e saj me KCSH-në dhe LMD-në. Në këtë kapitull është përfshirë edhe INCOTERMS dhe janë përshkruar po ashtu këto dispozita dhe ndikimi i tyre në legjislacionin vendas. Në të dyja këto burime ndërkombëtare është përshkruar edhe historiku i krijimit të tyre.

Gjatë hulumtimit është përdorur literaturë e autorëve si Marjana Tutulani – Semini, Ardian Nuni, Nerxhivane Dauti, Riza Smaka, Mazllum Baraliu, Vilim Gorenc, si edhe komentare të Konventës së Kombeve të Bashkuara për shitjen ndërkombëtare të mallit, si edhe literaturë nga disa autorë të tjerë që sqarojnë konventat ndërkombëtare dhe dispozitat e normave vendore lidhur me çështjen e analizës.

Është dashur mjaft punë për ta grumbulluar këtë literaturë si edhe analizat e shumë kontratave. Te shitjet vendore ka qenë më e lehtë të gjenden këto kontrata. Por ka pasur vështirësi për të gjetur kontrata të tilla, që trajtohen si ndërkombëtare, madje ka pasur edhe hezitim për të dorëzuar edhe kontratat që lidhen më transportuesit e mallit. Vështirësitë kam ndeshur edhe kur kam intervistuar kompanitë e transportit dhe kompanitë që e kanë selinë në shumë shtete.

I. Metodologjia e punës

Për të studiuar problemin e parashtruar në temën e doktoratës është përdorur ajo metodologji që ka pasur për qëllim:

- Të paraqes interpretimin e normave vendore dhe të atyre ndërkombëtare lidhur me përgjegjësinë e shitësit te kontrata e shitjes. Të paraqesë ngjashmërinë dhe dallimet në

mes normave ndërkombëtare dhe vendore si dhe mundësia e unifikimit të këtyre normave.

- Të paraqesë të gjitha detyrimet e shitësit si për shembull: detyrimin e dorëzimit të sendit, detyrimin e transportit, detyrimin e përgjegjësisë për të metat e mallit, pastaj rastet kur ai përjashtohet nga përgjegjësia dhe gjithmonë duke bërë krahasueshmërinë në mes të këtyre normave. Po ashtu është analizuar koha e dorëzimit të mallit, vendi i dorëzimit të mallit, mosdorëzimi i tij në kohën e duhur dhe dorëzimi i mallit në një afat të arsyeshëm.
- Është analizuar po ashtu shkelja e kontratës me mospërbushje.
- Dorëzimi i mallit me të meta materiale dhe juridike.
- Klasifikimi i këtyre të metave në të meta të dukshme dhe të fshehta.
- Dorëzimi i mallit sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese dhe dorëzimi i mallit jo konform kontratës dhe në rastet kur vjen deri te dorëzimi i mallit të tillë çka ndodhë.
- Kompensimi i dëmit si përgjegjësi kontraktore e shitësit për shkak të shkeljes së detyrimit të dorëzimit.
- Shpërblimi i dëmit në rast të mospërbushjes së kontratës dhe llojet e dëmit të shkaktuar, etj.

II. Pyetje dhe hipoteza

- A janë burimet vendore dhe ndërkombëtare që rregullojnë përgjegjësinë e shitësit për dorëzimin e mallit, unike apo janë të ndryshme nga një tjetra?
- A përmbushet përgjegjësia e shitësit nëse dorëzimi i mallit nuk është bërë konform me kontratën e lidhur dhe a ka raste përjshtimi?
- A është përgjegjës shitësi për bartjen e pronësisë së mallit sipas KV, LMD dhe KCSH?
- Sipas teorisë tradicionale dhe asaj tregtare a bëhet regjistrimi i pronësisë së mallit ?
- A duhet të jetë përgjegjës shitësi nëse malli ka të meta materiale juridike edhe nëse malli është kontrolluar paraprakisht dhe a është i detyruar shitësi të lajmëroj blerësin sipas KV, LMD-së dhe KCSH?
- A është përgjegjës shitësi për dorëzimin e mallit aluid?

- Nëse shitësi ka për detyrim t'ia dorëzojë mallin transportuesit të mallit, atëherë a përmbushet detyrimi i tij vetëm me dorëzim të mallit tek transportuesi apo malli gjithsesi duhet dorëzuar blerësit në mënyrë që të përmbushet detyrimi kontraktor ?
 - Nëse dorëzohet malli me pengesa (të meta, vese) ku ka të drejta edhe personi i tretë, a duhet të informojë blerësin për këtë çështje?
 - Nëse bëhet kompensimi i dëmit për shkak të mospërmbushjes së kontratës ndërkombëtare (shkeljes së saj) për mosdorëzimin e mallit në vendin e caktuar, atëherë si caktohet kompensimi dhe në çfarë valute bëhet kompensimi i dëmit të shkaktuar?
- *Në mes qasjeve tradicionale dhe komerciale lidhur me përgjegjësinë e shitësit për dorëzimin e mallit, ka të ngjarë që qasja tradicionale e pranuar nga LMD dhe KCSH, ofron më shumë siguri juridike për te dyja palët kontraktuese.*

III. Metodat e hulumtimit

Gjatë analizës autorja ka përdorur metoda të ndryshme dhe konkretisht si më poshtë:

- *Metoda historike* me qëllimin për të sqaruar normat juridike gjatë historisë dhe nevojën e inkorporimit të këtyre normave gjatë historisë në ligjet tona për problematikën në fjalë.
- *Metoda e analizës sistematike* është përdorur për të analizuar larminë e burimeve juridike (jurisprudenca, statute, konventa, rezoluta, artikuj shkencorë, libra universitarë, të gjitha për të nxjerrë përfundime të nevojshme.
- *Metoda e analizës logjike* është përdorur për të nxjerrë përfundime duke u bazuar në rregullat e logjikës.
- *Metoda e analizës teleologjike* është përdorur për të interpretuar normat juridike dhe burimet e bazuara në qëllimin e tyre.
- *Metoda e analizës komparative* është përdorur për të krahasuar qëndrimet e autorëve, por dhe për të bërë krahasimin e normave vendore me ato ndërkombëtare.
- *Metoda e analizës filozofike* është përdorur për të interpretuar burimet juridike në frymën e filozofisë të së drejtës.

- *Metoda e analizës teorike* është përdorur për të interpretuar burimet juridike, si për shembull, për të sqaruar dorëzimin e mallit sipas kohës së përcaktuar në kontratë, por edhe në rastet kur kjo kohë nuk është caktuar në kontratë.

IV. Burimet e studimit

Burimet e studimit mund t'i klasifikojmë në tri grupe:

Grupi i parë: aktet juridiko normative: kushtetutat, konventat ndërkombëtare, raporte të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore.

Grupi i dytë: literaturë e veçantë si artikuj shkencor, tekste dhe monografi dhe dokumente të institucioneve ndërkombëtare.

Grupi i tretë: vendime nga institucione, vendime të gjykatave dhe dokumente tjera procedurale relevante, intervista gjysëm të strukturuar, revista gazeta, web faqe, etj.

KAPITULLI II: BURIMET JURIDIKE PËR PËRGJEGJËSINË E SHITËSIT PËR DORËZIMIN E MALLIT

Kontrata e shitblerjes është njëra ndër kontratat kryesore dhe kontrata më e rëndësishme e së drejtës kontraktore. Të gjitha burimet formale të së drejtës ndahen në Burime Ndërkombëtare dhe Burime Nacionale (kombëtare).

II.1. Burimet Ndërkombëtare

Ndërtimi i një Bashkimi European modern është pothuajse i pamundur pa një të drejtë civile të kodifikuar në mënyrë unike për shtetet e Bashkimit European.¹ Kjo mundëson qarkullim të lirë të vlerave pasurore dhe quhet qarkullim i lirë i mallrave dhe shërbimeve. Kodi Civil European është i kushtëzuar nga shumë shkaqe si pasojë e vetë jetës në hapësirën e BE-së.²

Kontrata për shitblerje është kontrata më e shpeshtë e tregtisë së mallrave. Ajo paraqet njëkohësisht kontratën më të rëndësishme në të drejtën detyimore. Në këtë mënyrë mospengesa e tregtisë së mallrave çon në përparimin dhe zhvillimin e tregtisë me mall si në të drejtën vendore, ashtu edhe në drejtën ndërkombëtare. Kështu shitja e mallit bën të mundur zhvillimin e jetës tregtare. Nevoja për krijimin e rregullave të veçanta ka qar deri te forcimi i shteteve në zhvillim duke aluduar se te kontratat ndërkombëtare takohen palët e fuqive të ndryshme shtetërore, pra fuqitë e ndryshme shoqërore dhe ekonomike.

Në botë ekzistojnë rregulla të unifikuara të cilat rregullojnë lëminë e shitjes ndërkombëtare të mallit.

Këto rregulla ndahen në :

- Rregulla ndërkombëtare (konventa ndërkombëtare).
- Rregulla vendore të shitjes së mallrave.

¹ Abdulla Aliu. (2008). *E Drejta Civile I, Pjesa e Përgjithshme*. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 23.

² Po aty, fq. 23.

Burimet ndërkombëtare për këtë lëmi janë të shumta, por ne do të përqendrohemi sa më shumë në temën bazë për të cilën jemi të interesuar, në përgjegjësinë e shitësit për dorëzimin e mallit nga shitësi te blerësi. Ky detyrim është edhe detyrimi bazë dhe detyrimi i parë që shitësi duhet të përmbushë ndaj blerësit.

II.1.1. Konventat Ndërkombëtare si burim

Konventat ndërkombëtare janë burim primar i së drejtës. Në secilin vend demokratik konventat ndërkombëtare janë instrumenti më i rëndësishëm për unifikimin e së drejtës ndërkombëtare. Konventat ndërkombëtare paraqesin një lloj kontrate në mes dy apo më shumë shteteve dhe janë burim i së drejtës civile si edhe ligji pozitiv i vendit tonë.³ Ato nxirren me iniciativën dhe nën patronatin e organizatave ndërkombëtare dhe sipas rregullave; kanë karakter kompromisi.⁴

Në fillim të shekullit XX edhe pse kontrata për shitjen ka sjellë një bum ekonomik, kontrata për shitjen edhe më tej është rregulluar me ligje dhe me kode kombëtare.⁵ Konventat ndërkombëtare janë lidhur në emër të ish- RSFJ dhe si të tilla rregullat e tyre obligojnë edhe Kosovën, sepse meqë ato janë ratifikuar bëhen e drejtë e brendshme e një shteti.⁶

Rregullat nacionale kanë dallim në mes veti. Mungesa e unifikimit të së drejtës ka dërguar deri te probleme të ndryshme dhe të ndërlikuara. Shumë herët është vërejtur se duhen të merren parasysh të gjitha specifikat ndërkombëtare të marrëdhënieve të punës dhe janë të nevojshme rregullat që përshtaten me ato çështje, pra, rregullat që do t'i dedikohen kësaj çështjeje. Rregullat duhet të pranohen nga të gjitha shtetet pa marrë parasysh rregullimin e tyre shtetëror dhe ekonomik. Që këto rregulla të kenë sukses ndërkombëtar, do të nevojitej tubimi (mbledhja) i të gjitha shteteve që marrin pjesë në tregtinë ndërkombëtare.

Të gjitha problemet, të cilat dalin në mes të shteteve, gjatë nxjerrjes së këtyre normave do të duhej të rregullohen sipas parimeve të përbashkëta.⁷ Unifikimi i së drejtës civile në Europë

³ Abdulla Aliu. (2008). *E Drejta Civile I, Pjesa e Përgjithshme*. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq.88.

⁴ Slavko Carić, Šogorov, S, Jelena Vilus, & Durnev, Kan L. (1996). *E Drejta Ndërkombëtare Tregtare*: Novi Sad, fq. 42-44.

⁵ Michael Joachim Bonel. (1987). *Commentary on the International Sales Law– The 1980 Vienna Sales Convention*, Giuffrè, Milan, fq.3.

⁶ Abdulla Aliu. (2008) *E Drejta Civile I, Pjesa e Përgjithshme*. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq.88.

⁷ Fritz Enderlein, & Dietrich Maskow, (1992). *International Sales Law*, Oceana Publications, fq. 1.

është një rrugë që do të ndryshojë edhe karakterin e burimeve të së drejtës civile që ekziston sot. Kjo tendencë e unifikimit të së drejtës civile nuk është e re, por për shkak të Luftës së Dytë Botërore dhe krijimit të sistemeve të ndryshme juridike në Europë, ka ardhur deri te ngecja e unifikimit të legjislacionit të së drejtës civile.⁸ Në të drejtën Europiane ka pasur përpjekje konkretisht në unifikimi e kontratave. Bile legjislatorët kanë bërë përpjekje edhe të kodifikimit të kontratave. Ideja ka qenë që të promovohet një e drejtë e njëjtë materiale e kontratave për të gjitha shtetet anëtare të BE-së.⁹ Unifikimi i të gjitha normave ndërkombëtare për shitjen ka zgjatur rreth 50 dekada, ndërkaq përgatitja shumëvjeçare e tyre ka përfunduar në vitin 1980, me nxjerrjen e Konventës për Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallit (Konventa e Vjenës). As kontinentet e tjera nuk kanë ndërtuar ndonjë kod kontratash të përbashkët dhe është pothuajse e sigurt se nëse nuk do të aprovohej Konventa e Vjenës tregu i brendshëm, do të vuante nga ekzistenca e një numri të madh normash kontraktore. Në bazë të asaj që u tha më lart mund të themi që është arritur një sukses i madh në drejtimin e unifikimit dhe Konventa e Vjenës ka pasur një sukses të madh duke tejkaluar të gjitha parashikimet.

II.1.1.2. Ligjet Uniforme të Hagës

Në kuadër të Lidhjes së Kombeve në vitin 1926 është krijuar një institut për unifikimin e së drejtës private-UNIDROIT. Presidenti i parë, Ernest Rabel, ka sugjeruar që të fillojë me unifikimin e normave të shitjes në të drejtën ndërkombëtare.¹⁰ Ky ka propozuar mundësinë e unifikimit të shitjes ndërkombëtare. Prej fillimit është konstatuar se rregullat ndërkombëtare duhet të përgatiten në formën e instrumentit detyrues. Puna shumëvjeçare është kurorëzuar në vitin 1964 në Konferencën Diplomatike të mbajtur në Hagë me nxjerrjen e dy akteve: Ligjet Uniforme të shuarjes së Kontratave në shitjen ndërkombëtare të sendeve të luajtshme; dhe Ligjet Uniforme të shuarjes së Kontratave në shitjen ndërkombëtare të sendeve të paluajtshme. Pas kësaj janë nxjerrë edhe konventat: Konventa e unifikimit të ligjit për shuarjen e kontratave në shitjen ndërkombëtare të sendeve të luajtshme dhe Konventa e unifikimit të ligjit për shuarjen e kontratave në shitjen ndërkombëtare të sendeve të paluajtshme. Të gjitha shtetet që kanë marrë

⁸ Abdulla Aliu. (2008). *E Drejta Civile I, Pjesa e Përgjithshme*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 89.

⁹ Cyril Nourissat. (2010). *E Drejta e Biznesit e Bashkimit European*, Papirus, fq. 36.

¹⁰ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow. (1992) *International Sales Law*, Oceana Publications, fq. 1.

pjesë në hartimin e këtyre konventave si dhe shtetet anëtare kanë qenë të detyruara që t'i inkorporojnë këto konventa në të drejtën dhe ligjet e veta kombëtare.

Me rastin e krijimit të ligjeve të Hagës janë përcaktuar parime të caktuara. Është përcaktuar se rregullat e ruajtura në to nuk duhet të paraqesin recetën e rregullave kombëtare, por duhet të jenë të tilla që të jetësojë nevojat e tregtisë ndërkombëtare.¹¹ Këto rregulla do të zbatohen vetëm për shitje ndërkombëtare dhe autonomia e vullnetit të mbrohet më së shumti.¹²

Edhe pse është shpenzuar kohë dhe mund shumë i madh, këto konventa ndërkombëtare nuk kanë sjellë sukseset e paramenduara dhe aq të pritura. Në anën tjetër nuk është pritur edhe pranimi i këtyre konventave nga një numër i madh shtetesh, sepse në hartimin e tyre kanë marrë pjesë shumë më pak shtete. Në të vërtetë vetëm 7¹³ shtete nga 9 shtete të Europës Perëndimore i kanë ratifikuar konventat në fjalë. Megjithatë edhe shtetet që i kanë ratifikuar këto konventa ndërkombëtare, i kanë ratifikuar me rezerva¹⁴.

Edhe pse nuk ka arritur suksesin që është dashur të arrijë Konventat e Hagës prapëseprapë kanë kontribuar në rritjen si dhe në unifikimin e së drejtës ndërkombëtare, e sidomos në unifikimin e së drejtës në shitjen ndërkombëtare. Në fillim ata kanë rregulluar ndryshimet në rregullimin e shitjes ndërkombëtare të mallit. Në anën tjetër kanë çuar në unifikimin e praktikës gjyqësore në mes të Italisë, Gjermanisë dhe shteteve të Beneluksit. Me fjalë të tjera kanë ardhur edhe deri te ndihma për nxjerrjen e ligjeve kombëtare e ndër to edhe nxjerrjen e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të aprovuar më 1978. Ajo çka është më e rëndësishme është se këto konventa janë konventat bazë që kanë çuar në nxjerrjen e Konventës së Vjenës.

II.1.1.3.Konventa e Kombeve të Bashkuara për kontratën për shitjen ndërkombëtare të mallit- Konventa e Vjenës

Ligjet e Hagës janë tashmë ligje të miratuara. Ato paraqesin një lloj hyrjeje për Konventën Ndërkombëtare të Vjenës. Puna ka vazhduar në kuadër të organizatës më të madhe

¹¹ Ralph Folsom, Michael Gordon, & John Spanogle, *Medunarodni trgovački poslovi*, Novi Sad, 1997, fq. 37-38.

¹² Po aty. fq.37-38.

¹³ Shtetet e BE-së që kanë ratifikuar Konventat e Hagës janë: Belgjika, Italia, Luksemburgu, Holanda, Gjermania, Britania e Madhe dhe San Marino.

¹⁴ Vetëm Izraeli nuk ka pasur asnjë rezervë nga shtetet anëtare të OKB-së.

botërore. Komisioni i OKB-së për të drejtën ndërkombëtare tregtare UNICITRAL ka filluar punimet për hartimin e një konvente me përmasa botërore.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Kontratën për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (shkurt KSHNM) është traktat shumëpalësh që paraqet një ligj uniform të shitjes i cili deri më tani është ratifikuar nga 77 shtete)¹⁵. Palë të kësaj konvente janë vendet të cilat zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të tregtisë kombëtare, duke e bërë kështu KSHNM-në njërin nga ligjet ndërkombëtare uniforme më të suksesshme. KSHNM-ja ua mundëson palëve të një kontrate t'u shmangen problemeve me zgjedhjen e ligjit për zbatim, sepse KSHNM-ja ofron rregulla përmbajtësore në të cilat palët kontraktuese, gjykatat dhe arbitrazhet mund të mbështeten.

KSHNM-ja është rezultat i një procesi të gjatë, i cili ka filluar në vitet 20-të. Hartimi i një ligji uniform të shitjes fillimisht u fillua nga Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private (INUDP, angl. UNIDROIT) dhe nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare dhe pastaj nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (KKBDNT).

Ky traktat është nënshkruar në Vjenë në vitin 1980, prandaj jo rrallë herë quhet Konventa e Vjenës. KSHNM-ja hyri në fuqi në janar të vitit 1988, për një numër prej 11 shtetesh. Që nga ajo kohë, numri i këtyre shteteve është rritur në vazhdimësi, çka tregon qartë për suksesin e unifikimit të ligjit. Çfarë është më e rëndësishmja, KSHNM-ja ka gjetur zbatim të gjerë në terren, sepse është pranuar nga “çdo rajon gjeografik, çdo fazë e zhvillimit ekonomik dhe çdo sistem kryesor ligjor, shoqëror dhe ekonomik”. Pas aderimit të shtetit, KSHNM-ja bëhet pjesë e ligjit vendor dhe e zëvendëson çdo ligj kombëtar pozitiv në shtetin kontraktues. Nga konventat e së drejtës uniforme, KSHNM-ja është përshkruar të ketë “ndikimin më të madh në të drejtën e tregtisë ndërkufitare mbarëbotërore”.

KSHNM-ja është përshkruar si një arritje e madhe legjislative dhe si “akti ndërkombëtar më i suksesshëm deri më tani” në kuadër të së drejtës së unifikuar të shitjeve ndërkombëtare. Një ndër faktorët kryesorë, që e bëjnë KSHNM-në aq të suksesshme është para së gjithash fleksibiliteti i saj. Ajo i lejon shteteve kontraktuese që të heqin dorë nga disa nene të specifikuar. Është shumë me rëndësi që një konventë të jetë fleksibile për t'i bindur shtetet me tradita ligjore të ndryshueshme që të pajtohen me unifikimin e një pjesë të caktuar të ligjit. Një

¹⁵ (http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/sale_goods/1980CISG_status.html. (qasur me dt.30. mars, 2012.).

numër vendesh, që e kanë nënshkruar KSHNM-në kanë dhënë deklarata dhe i kanë shprehur rezervat e tyre sa i përket fushëveprimit të këtij traktati, ndonëse shumica e tyre kanë aderuar në këtë konventë pa asnjë rezervë.¹⁶ Në këtë konventë Shqipëria aderoi me ligjin 10092, dt. 09.03.2009.

II.1.1.3.1.Rëndësia e Konventës së Vjenës

Kjo konventë i ka tejkaluar të gjitha parashikimet për sukseset e saj. Ajo paraqet burimin më të rëndësishëm të së drejtës në shitjen ndërkombëtare të mallit. Tanimë e kanë ratifikuar rreth 75 shtete, gjegjësisht 2/3 e botës veprojnë sipas kësaj Konvente. Një nga fuqitë e mëdha tregtare që nuk e ka aprovuar këtë Konventë është vetëm Britania e Madhe.¹⁷ Konventa e Vjenës ka arritur suksesin e saj më të madh në Europë, sepse ajo është aprovuar dhe ratifikuar nga të gjitha vendet e Bashkimit Europian përveç dy shteteve europiane.¹⁸ Me plot bindje mund të themi se, në Europë është arritur unifikimi i së drejtës ndërkombëtare, kur kemi të bëjmë me shitjen ndërkombëtare të mallit.

Vlen të theksohet se kjo Konventë nuk merret me rregullimin në fushën ndërkombëtare të kontratave të zakonshme të shitjes, përjashtim ky i parashikuar në nenin 2 të saj.¹⁹

Ndikimi i Konventës së Vjenës është i dyanshëm - direkt dhe indirekt. Ndikimi direkt i kësaj Konvente është se kjo konventë po përdoret për kontratat e shitjes që kanë të bëjnë me elemente ndërkombëtare. Në anën tjetër ndikimi indirekt i saj është se ajo ka shërbyer si model për zhvillimin dhe për reformimin e mëtejshëm të së drejtës së shitjes në nivelin ndërkombëtar, regional dhe atë kombëtar. Lirisht mund të themi që ndikimi i saj është aq i madh, sa që ka ndikuar në perfeksionimin e së drejtës detyrimore si në Europë, ashtu edhe në botë.²⁰

¹⁶ Konventa e Kombeve të Bashkuara për Kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave (KSHNM), shtator 2011. Ky manual është përgatitur falë mbështetjes së popullit amerikan, përmes Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

¹⁷ Sipas nenit 99 të *Konventës së Vjenës* shteti i cili ka aderuar në këtë Konventë me rastin e ratifikimit të *Konventës së Vjenës* është dashur të ndërpresë aplikimin e një ose dy *Konventave të Hagës*. Britania e Madhe nuk ka ratifikuar *Konventën e Vjenës* dhe në Britani janë ende në fuqi ULIS dhe ULFIS.

¹⁸ Britania e Madhe dhe Portugalia nuk e kanë ratifikuar dhe nuk e kanë aprovuar *Konventën e Vjenës*.

¹⁹ Ardian Kalia. (2013). *E Drejta Ndërkombëtare Private*, Botimet FLESH, Tiranë, fq. 260.

²⁰ Shembull i ndikimit të *Konventës së Vjenës* në Europë është i dukshëm në kapitullin 2, Direktiva 1999/44/EZ Parlamenti dhe Këshilli i Ministrave nga 25.05.1999 në disa aspekte të shitjes së mallit ku është marrë nocioni nga *Konventa e Vjenës*. Me implementimin e Direktivës ky koncept ku është marrë definicioni i konformitetit të mallrave nga *Konventa e Vjenës*. Me zbatimin e kësaj Direktive ky nocion është përfshirë edhe në sistemet juridike të shteteve anëtare të UE-së. Në disa shtete si (Suedia, Finlanda, Norvegjia), *Konventa e Vjenës* zbatohet jo vetëm

II.1.1.3.2 Struktura e Konventës

KSHNM-ja përmban rregulla të hollësishme të zbatimit. Kjo Konventë përcakton aplikimin e saj në sistemin e së drejtës private ndërkombëtare dhe përcakton të drejtën materiale që është e zbatueshme. Prandaj, zbatimi i KSHNM-së nuk varet nga kompetenca e ndonjë gjykate. Kjo është ilustruar si në skicën në vijim.

- Zbatimi i KSHNM-së? Përcaktimi sipas rregullave të zbatimit²¹
- Zbatimi i dispozitave materiale të KSHNM-së
- Përcaktimi i gjykatës kompetente.

Bazuar në rregullat e zbatueshmërisë, çfarë është edhe më me rëndësi, KSHNM-ja përmban edhe të drejtën materiale që merret me shitjen e mallrave të luajtshme. Kjo në fakt parandalon ndonjëherë zbatimin e vështirë të së drejtës materiale të huaj. Megjithatë, dispozitat në KSHNM nuk janë të plota edhe pse ngërthejnë në vetvete dispozita më të rëndësishme, që i rregullojnë kontratat e shitjes, në këto dispozita ende ekzistojnë zbrazëtira që duhet të plotësohen me ligjin kombëtar. Nëse zbatohet në mënyrë korrekte, KSHNM-ja mund të jetë thjeshtëzim i pamasë i biznesit ndërkombëtar. KSHNM-ja ndahet në katër pjesë dhe ka gjithsej 101 kapituj.

Pjesa e parë (nenet 1-13 të KSHNM-së) përmban rregullat për sferën e zbatimit të saj (kapitulli I, nenet 1-6 të KSHNM-së) si edhe një numër dispozitash të përgjithshme të tjera (kapitulli II, nenet 7-13 të KSHNM-së). Pjesa e dytë (nenet 14-24 të KSHNM-së) merret me formimin (përpilimin) e kontratës. Pjesa e tretë (nenet 25-88 të KSHNM-së) është pjesa më gjithëpërfshirëse e kësaj konvente. Ajo titullohet “shitja e mallrave” dhe siguron “ligjin aktual të shitjes” brenda kësaj konvente. Pastaj ajo nëndahet në pesë kapituj, për të cilët do të flasim më poshtë.

Kapitulli I (nenet 25-29 të KSHNM-së) përmban disa dispozita të përgjithshme, që mund të jenë të rëndësishme për tërë ligjin e shitjes, e posaçërisht përkufizimin e nocionit të “shkeljes themelore”, i cili do të jetë i rëndësishëm e në veçanti si parakusht për dispozicionin e disa

në marrëveshjet ndërkombëtare për shitjen e mallit, por edhe në kontratat për shitje brenda shtetit. Ndikimi i *Konventës së Vjenës* ka qenë shumë i madh në ish -vendet socialiste të cilat janë vende në tranzicion që tashmë kanë nxjerrë ligje të reja. Për të gjitha këto më gjerësisht tek: Peter Schlechtriem, *Basic Structure and General Concepts of the CISG as Models for a Harmonisation of the Law of Obligations*, Juridica International, X/2005, fq. 30-31

²¹ Konventa e Vjenës, neni 1-6

mjeteve juridike, përfshirë edhe të drejtën për t'iu shmangur kontratës (krahaso nenet 49, 64, 72 dhe të tjerët me radhë të KSHNM-së).

Kapitulli II (nenet 30-52 të KSHNM-së) merret me detyrimet e shitësit. Pas rregullës së përgjithshme në nenin 30 të KSHNM-së, i cili i përcakton detyrimet e shitësit në kuptim të gjerë, pjesa I (nenet 31-34 të KSHNM-së) merret me përputhjen e mallrave dhe pretendimet e palës së tretë, dhe përfundimisht, pjesa III (nenet 31-34 të KSHNM-së) përmban elementet thelbësore të çdo ligji të shitjes – mjetet juridike të blerësit në rast të shkeljes së kontratës nga shitësi.

Kapitulli III (nenet 53-65 të KSHNM-së) ka një strukturë të ngjashme: me nenin 53 të KSHNM-së parashihen detyrimet e blerësit në një mënyrë të përgjithshme. Pjesa I (nenet 54-59 të KSHNM-së) merret me detyrimin për ta paguar çmimin. Pjesa II (neni 60 i KSHNM-së) merret shkurtimisht me detyrimin për ta bërë pranimin e mallit. Pjesa III (nenet 61-64 të KSHNM-së) qeverisë, mjetet juridike të shitësit në rast të shkeljes së kontratës nga blerësi.

Pjesa e tretë përshkohet nga një hulumtim i rëndësishëm që rregullon përmbajtjen e kontratës për shitjen, gjegjësisht kapitulli II, i cili i dedikohet përgjegjësisë së shitësit dhe kapitulli V, që përmban rregulla të përbashkëta për të dyja palët kontraktuese, ku, në mes të tjerash janë rregulluar dy pajisjet më të rëndësishme të së drejtës, e cila qëndron në dispozicion të palëve kontraktuese në rast të cenimit të kontratës - shkelje të kontratës dhe shpërblimin e dëmit si vështrim i përgjegjësisë kontraktore.

II.1.1.3.3. Interpretimi i Konventës së Vjenës

Vëmendje duhet t'i kushtohet karakterit ndërkombëtar të kësaj konvente kur bëhen përpjekje për t'i interpretuar dispozitat e saj. Neni 7, paragrafi 1 i KSHNM-së ofron disa udhëzime për standardin e interpretimit. Në këtë Konventë parimet e përgjithshme të interpretimit kanë karakter ndërkombëtar, prandaj del nevoja që të promovohet unifikimi në zbatim. Nga kjo deklaratë mund të nxirren tri udhëzimet kryesore:

Karakter i ndërkombëtar – Kupton se kjo Konventë duhet të interpretohet në mënyrë pavarur, që do të thotë se nuk duhet të bëhet asnjë analogji me ligjet vendore, ndërsa nocioneve duhet t'u jepet kuptim sipas KSHNM-së, e cila po ashtu bazohet në politikat kryesore, në strukturën dhe në historinë e negociatave për këtë konventë.

Njëjtësia/Uniformiteti - Qëllimi është që çdo gjykatë apo arbitër ta zbatojë KSHNM-në në mënyrë identike. Natyrisht ky është qëllim paksa utopist, por gjykatat prapëseprapë mund ta marrin parasysh të drejtën e huaj si precedent dhe së paku të përpiqen të distancohen në çështjet e KSHNM-së për t'u dhënë përparësi praktikave vendore dhe për t'i konsultuar opinionet akademike për këto çështje.

Respektimi i mirëbesimit -Vështirësia e parë në të cilën gjendet një standard i përshtatshëm i mirëbesimit. Sërish, konceptet vendore të mirëbesimit nuk duhet të barten në këtë Konventë. Mirëbesimi mund të burojë vetëm nga praktika ndërkombëtare dhe nga punimet shkencore.

Të rejtat e muajve të fundit - Me datën 23 prill të vitit 2015 në Asamblenë e Përgjithshme është vendosur që në Vjenë të festohet 35 vjetori i aprovimit të kësaj konvente. Në sesionin e 48 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, kryesisht është diskutuar për celebrimin e 35 vjetorit, Mbledhja e AP është mbajtur nga data 29-16 korrik të vitit 2015 në Vjenë. Kryesisht në këtë sesion është diskutuar lidhur me ecurinë e KV për këto 35 vjet. Pastaj aprovimi i kësaj Konvente nga ana e Brazilit ka qenë një ndër të arriturat më të mëdha. Poashtu është diskutuar që kjo konventë të duhet të ketë prioritet në raport me ligjet vendore sidomos në vendet në tranzicion. Kryesisht vëhet në spikamë kontributi i akademikëve dhe profesorëve në implementimin e kësaj konvente në legjislacionin vendas të vendeve në transicion e sidomos në Brazil. Në sesion është vendosur axhenda e disa aktiviteteve shkencore të cilat do të mbahen lidhur me këtë konventë. Do të mbahen aktivitete shkencore gjatë tërë vitit 2015, të cilat aktiitete do të mbahen në Danimarkë, Austri, Zvicër, Amerikë, Brazil, Hungari, Spanjë, Singapur, Kore, Kolumbi dhe e fundit në muajin Dhjetor në Kroaci²². Poashtu në mbledhjen e AP me 5.05.2015 është aprovuar axhenda e përkohshme e sesionit të 48 në të cilën sesion do marrin pjesë vendet anëtare por edhe vendet që nuk janë anëtare të cilat mund të janë monitoruese në këtë sesion. Poashtu, në këtë sesion mund të marrin pjesë organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare. Këto të dytat mund të jenë si monitoruese të sesionit.²³

²² Shih më gjërësisht: <http://www.uncitral.org/uncitral/en/index.html,A/CN.9/849>, Distr.General 23.Pril 2015, qasur me: 2.06.2015.

²³ Shih më gjërësisht: <http://www.uncitral.org/uncitral/en/index.html,A/CN.9/824>, Distr.General 5. Maj. 2015, qasur me: 2.06.2015.

II.1.1.3.4. Mangësitë më të rëndësishme të Konventës së Vjenës

Edhe pse Konventa e Vjenës ka arritur sukses të madh, megjithatë ka edhe disa mangësi. Rregullat e së drejtës, që janë të vendosura aty, janë arritur përmes kompromisit që ka ndikuar shumë në kualitetin e këtyre rregullave. Në një masë të madhe në Konventën e Vjenës janë përdorur koncepte të paqarta. Në anën tjetër nocioni i dorëzimit është tejkaluar për shkak të pamundësisë së arritjes së kompromisit për këtë çështje.²⁴ Disa çështje nuk janë përfshirë në këtë Konventë; dalin jashtë kornizave të kësaj Konvente²⁵ dhe në këto lëmi duhet vepruar me norma kolizive. Mungesat e përmendura paraqesin ”çmimin” për pranimin e gjerë të kësaj konvente.

II.1.1.4. Konventa të tjera të rëndësishme për shitjen ndërkombëtare të mallit

Përveç ligjeve të unifikuara të Hagës dhe Konventës së Vjenës në lëmin e shitjes ndërkombëtare të mallrave janë nxjerrë edhe konventa tjera.²⁶ Nuk mund t’i analizojmë të gjitha për të mos dalë jashtë temës që kemi bërë objekt studimi dhe hulumtimi.

II.1.2. Burimet e veçanta të shitjes ndërkombëtare të mallit

Meqenëse dita - ditës e drejta po shndërrohet në të drejtën globale, prapëseprapë përveç normave të përgjithshme ekzistojnë edhe norma të veçanta të cilat janë dedikuar vetëm për një problematikë të caktuar. Burimet e veçanta kanë përdorim më të shpeshtë, prandaj ato paraqesin rol vendimtar në detyrimore. Me Konventën e Vjenës, që është arritja më e madhe deri me sot që ka të bëjë me të drejtën detyrimore, është arritur unifikimi më i madh i së drejtës në tregtinë e mallrave ndërkombëtare. Mirëpo e kemi theksuar edhe më herët se, edhe kjo Konventë ka

²⁴ Shih më gjerësisht te: Peter Schlechtriem & Ingeborg Shwenzwer. (2005). *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, fq. 3.

²⁵ Shih më gjerësisht Kapitullin 4 të *Konventës së Vjenës*.

²⁶ Për mospërmendjen e mëtejshme të këtyre konventave brenda tekstit, si konventa për një problematikë të tillë njihen këto Konventa: Konventa e OKB-së për shpërndarje dhe qasje në materien e shitjes ndërkombëtare të mallit nga viti 1983. Dhe Konventa për të drejtën autoritare të shitja ndërkombëtare e mallrave nga viti 1974, Konventa për qasje në materie të shitja ndërkombëtare e mallrave nga viti 1983, Konventa për të drejtën ndërkombëtare autoritare të shitja ndërkombëtare e mallrave e vitit 1985.

mangësitë e veta, dhe konkretisht njërin prej këtyre mangësive e kemi cekur. Konventa është e rregulluar në bazë të kompromisit dhe me që kjo Konventë është krijuar në këtë mënyrë, ka qenë tepër e vështirë për secilin vend që të rregullojë pjesën e përgjithshme të së drejtës së detyrimeve. Por burimet e veçanta nuk janë obligative për të gjithë. Andaj ato duhet të jenë mjete bindëse sepse pasqyrojnë situatën reale për çështjen në fjalë.

Gjatë analizës së burimeve të veçanta duhet pasur kujdes edhe për Konventën e Vjenës, për arsye se këto burime nuk përputhen shumë me këtë Konventë. Konventa e Vjenës në radhë të parë vendos autonominë e vullnetit të palëve kontraktuese, sepse ajo u mundëson palëve kontraktuese të bëjnë marrëveshje në paqe lidhur me marrëveshjen e tyre.²⁷

Te Konventa e Vjenës përparësi i jepet praktikës gjyqësore dhe të drejtës zakonore²⁸, ndërkajë te burimet vendore këto janë burime të tërthorta ose dytësore. Ne e cekëm edhe më herët që Konventa e Vjenës ka mangësi dhe si rrjedhojë e këtyre mangësive Konventa paraqet edhe zbrazëtira të shumta, të cilat mund të plotësohen duke inkorporuar pjesë të së drejtës vendore.

II.1.2.1. Llojet e burimeve të veçanta

Tash në kohën e re, mund të flasim për unifikim e së drejtës. E drejta ndërkombëtare është e drejtë e cila dita - ditës është duke përfshirë mbarë botën duke anashkaluar edhe të drejtën vendore. Kemi thënë qysh herët se e drejta nacionale është e drejtë e cila aprovohet dhe vepron vetëm në nivel vendi. Burimet e veçanta ndahen në dy grupe. Grupi i parë përfshin rregullat që krijohen duke u përsëritur brez pas brezi. Në grupin e dytë bëjnë pjesë rregullat që nxirren nga organizatat ndërkombëtare.

Burimet më të rëndësishme janë kontratat formulare, gjegjësisht kontratat tipe dhe të adezionit. Këto kontrata të kohëve të fundit janë ato të cilat çdo ditë po krijojnë problemet më të mëdha duke përfshirë edhe rregulla që palët mund edhe t'i keqpërdorin.

Me që gjatë krijimit dhe pas krijimit të së drejtës ndërkombëtare këto kontrata kanë sjellë deri edhe te disa keqkuptime dhe zbrazëtira, dhe në bazë të kësaj janë krijuar edhe burimet autonome në kuadër të organizatave ndërkombëtare. Organizatat ndërkombëtare kanë nxjerrë një numër shumë të madh të burimeve autonome dhe është e pamundur të analizohen të gjitha. Andaj do të

²⁷ Konventa e Vjenës, neni 6.

²⁸ Po aty, neni 9.

trajtojmë vetëm disa prej tyre dhe konkretisht ato që janë më të rëndësishme lidhur me problemin që do ta trajtojmë.

II.1.2.2. Parimet e kontratave ndërkombëtare tregtare - UNIDROIT

Në Romë në vitin 1994 është themeluar Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private, i ashtuquajtur UNIDROIT, me emër të përbashkët është quajtur *Parimet e Kontratave Ndërkombëtare Tregtare*.

Këto parime përmbajnë rregullat themelore për kontratën e shitjes së mallit. Këto parime përmbajnë edhe rregullore të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me kontratat e tjera. Parimet kanë arritur sukses të madh dhe po ashtu kanë ndikuar shumë edhe te vendimet e arbitrazhit të cilat çojnë në aplikimin e parimeve UNIDROIT. Për shkak të disa mungesave dhe nevojës së ripërtëritjes së këtyre parimeve këto shpeshherë janë publikuar, siç është rasti në vitin 2004, e po ashtu edhe ndryshimi i fundit i vitit 2010.²⁹ UNIDROIT i vitit 2010 e ka preambulën, ka 11 kapituj, dhe sipas kësaj i bie që ka 4 kapituj më shumë se UNIDROIT i vitit 2004 i cili kishte 7 kapituj dhe 119 nene.

Sipas preambulës së UNIDROIT 2010 këto parime përcaktojnë rregullat e përgjithshme për kontratat ndërkombëtare komerciale. Ato do të zbatohen kur palët bien dakord që kontratat e tyre të rregullohen nga ana e tyre. Parimet mund të zbatohen kur palët kanë rënë dakord që kontrata e tyre të rregullohet nga parimet e përgjithshme të së drejtës, *mercatoria lex*. Ato mund të zbatohen kur palët nuk kanë zgjedhur asnjë ligj për të qeverisur kontratën. Këto parime mund të përdoren për të interpretuar apo për të plotësuar instrumentet ndërkombëtare dhe uniforme të ligjit. Përdoren për të interpretuar apo për të plotësuar ligjin vendor. Ato mund të shërbejnë si një model për ligjvënësit kombëtarë dhe ndërkombëtarë³⁰.

²⁹ Shih më shumë: Bianca-Bonell, *The UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts and the Principles of European Contract Law: Similar Rules for the Same Purposes?*. Vilus, UNIDROIT Kapitujt e marrëveshjeve tregtare ndërkombëtare, 2004. – Botim i plotësuar, *Jeta Juridike*, 11/2005, fq. 459- 460.

³⁰ www.UNIDROIT.com, dt.25.09. 2012, Preambula e UNIDROIT, fq . 1, 2010.

II.1.2.3. Parimet e të Drejtës Kontraktore Europiane (PECL)

Në vendet e BE-së ekzistojnë rregulla dhe terminologji të ndryshme të së drejtës kontraktore. Ekzistojnë dallime të mëdha po ashtu në sistemin kontinental dhe në atë anglosakson. Dallimet që ekzistojnë në sistemet e së drejtës nxjerrin probleme në tregtinë ndërkombëtare dhe paraqesin barrierë për liritë themelore, gjegjësisht për lëvizjen e lirë të mallit, shërbimet e njerëzve dhe kapitalit. Për këtë arsye është parë shumë herët se është e nevojshme përpilimi dhe aprovimi i një Kodi Civil European të përbashkët. Kështu në vitin 1989³¹ dhe 1994³² u mbledh Këshilli i Ministrave dhe Komisioni European për të marrë iniciativën për fillimin e punimeve në Kodin Civil European.³³ Edhe pse ende nuk është përpiluar Kodi Civil European në këtë drejtim është punuar shumë. Hapi i parë është arritur në vitin 1980 kur për herë të parë është formuar Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare Detyrimore, ku janë mbledhur një numër i madh shkencëtarësh me në krye profesorin Ole Land. Pas një periudhe të gjatë pune u hartuan Parimet e së Drejtës Detyrimore Europiane.

Këto parime edhe sot e kësaj dite janë si pikënisje për krijimin dhe aprovimin e Kodit Civil European. Puna kryesore e Komisionit ka qenë unifikimi i së drejtës civile në përgjithësi, por është aritur unifikimi rajonal i së Drejtës Detyrimore në veçanti, e cila paraqet një ndër bazat kryesore të së drejtës civile; gjegjësisht paraqet një hap para drejt formimit të Kodit Civil European. Po ashtu këto parime nuk përmbajnë rregulla dhe nuk rregullojnë kontratat të veçanta, por përmbajnë rregulla të përgjithshme. Këto parime rregullojnë të gjitha kontratat e jo vetëm kontratat e shitjes pra edhe kontratat e së drejtës tregtare. Këto parime përbëhen nga tri pjesë. Pjesa e parë është hartuar në vitin 1995 dhe ka të bëjë me shkaktimin e dëmit kontraktues. Pjesa e dytë e hartuar në vitin 1999, përfshin përfundimin e kontratës, autorizimin e agentëve, vlefshmërinë dhe interpretimin e kontratës. Pjesa e fundit është publikuar në 2002-in dhe përmban pjesën e përgjithshme të së drejtës së detyrimeve.³⁴

³¹ Resolution of 26 May 1989, OJEC No. C 158/401 of 26 June 1989.

³² Resolution of 6 May 1994, OJEC No. C 205 (519) of 25 July 1994.

³³ Shih më shumë: Ole Lando, *The Rules of the European contract law - Study of the systems of private law in the EU with regard to the discrimination and the creation of a European Civil Code*, European Parliament, Directorate General for Research, Working Paper, Legal Affairs Series, JURI 103 EN, June 1999, Kapitulli III, fq 127.

³⁴ Shih më shumë: Ole Lando, *The Rules of the European contract law*, fq. 129-130. http://www.jus.uio.no/pace/en/html/the_rules_of_european_contract_law.ole_lando/toc.htm

Qëllimi i komisionit nuk ka qenë sjellja e revolucionit në të drejtën detyrimore në Europë, por krijimi i parimeve moderne europiane në raport me kushtet ekonomike të Europës, që do ta çojë tregtinë në përgjithësi drejt lulëzimit dhe përparimit. Këto parime nuk janë krijuar vetëm për juristët, por janë krijuar për këdo që dëshiron të dijë dhe t'i përdorë ato, pra të jetë në gjendje t'i kuptojë. Si burim i këtyre parimeve kanë shërbyer burimet kombëtare, po ashtu edhe ato ndërkombëtare e posaçërisht Konventa e Vjenës.

Këto parime kanë natyrë dispozitive dhe deri te aplikimi i tyre arrihet vetëm nëse palët janë marrë vesh mes veti.³⁵ PECL mund të jetë lex CONTRACTUS dhe mund të përdoret për të interpretuar rregullat ndërkombëtare dhe kombëtare dhe për të mbushur zbrazëtirat juridike. Gjithashtu, PECL mund të shërbejë si bazë për harmonizimin e ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve mes shteteve anëtare të BE-së.

II.1.2.4. Rregullat ndërkombëtare për interpretimin e nocioneve të tregtisë - INCOTERMS

Në të drejtën ndërkombëtare përdoren nocione të ndryshme. Kontratat në vende të ndryshme lidhen, interpretohen dhe në fund edhe shuhen. Mirëpo interpretimi i tyre nuk bëhet në mënyrë të njëjtë. Jo shumë rrallë, për shkak të interpretimit të ndryshëm lindin edhe mosmarrëveshje ose konflikte të ndryshme që sjellin humbje të mëdha monetare. Për të evituar këto keqkuptime janë bërë përpjekje të shumta për unifikimin e normave tregtare. Këto norma tregtare përfshihen brenda ombrellës së Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë dhe këto norma quhen *Termet Ndërkombëtare Tregtare - INCOTERMS*.

INCOTREMS-at për herë të parë janë hartuar në vitin 1936, por disa herë kanë kaluar nëpër revizione të ndryshme.

INCOTERMS-at kryesisht u referohen transaksioneve nga kontratat për shitblerje ndërkombëtare të mallrave. INCOTERMS-at nuk i përcaktojnë të gjitha mënyrat e transaksioneve ndërkombëtare, por, vetëm ato të punëve tregtare ndërkombëtare që konsiderohen më të rëndësishme dhe më të shpeshta³⁶. Incoterms-at si të tillë aplikohen në kombinime me termat tregtarë të tjerë të inkorporuar në një kontratë, për shembull te kontrata e shitblerjes, si

³⁵ PECL, Neni 101, paragrafi (2).

³⁶ Riza Smaka, *E Drejta Biznesore*, Universiteti Mbretëror ILIRIA, Prishtinë, 2008.

kontratë themelore, si dhe te kontrata të tjera të inkorporuara në një kontratë, le të themi, në kontratën për shitblerje është e përfshirë edhe kontrata për transportin, për sigurim, kontrata për financim etj.

INCOTERMS-at janë rregulla të një standardi ndërkombëtar dhe janë përdorur në mbarë botën në kontratat vendore dhe ndërkombëtare për shitjen e mallrave. ICOTERMS-at e vitit 1936 ofrojnë përkufizime të pranura ndërkombëtarisht si edhe rregullat e interpretimit për shumicën e kushteve të zakonshme tregtare. Rregullat janë nxjerrë dhe mirëmbahen nga ekspertë ndërkombëtarë. Sipas modifikimit të INCOTERMS-ave nga viti 2000, aktualisht ekzistojnë 13 forma strukturore të tyre. Ato janë: Franko-fabrika, punishte, depo, franko-transportuesi, në vendin e kontraktuar, franko pranë anijes apo buzë saj, franko anije, në limanin e kontraktuar për liferim me mjet transportues ujor, çmimi për transportim, çmimi për sigurim dhe transportim, transportimi i paguar deri në limanin e kontraktuar, transportimi dhe sigurimi i mallit të paguar deri në limanin e kontraktuar, malli i shit-blerë nga shitësi i liferohet blerësit në kufirin shtetëror të kontraktuar, malli i liferauar franko në anije *Delivered duty paid* dhe *delivered duty unpaid delivered ex quay*).³⁷ Versioni i fundit i ICOTERMS-ave siç e thamë është versioni i 2010-ës që ka hyrë në fuqi me 1 janar 2011. Ata i ndihmojnë tregtarët për të shmangur keqkuptimet duke qartësuar detyrat, kostot dhe rreziqet e përfshira në ofrimin e mallrave nga shitësit për blerësit. INCOTERMS-at janë rregulla që njihen nga UNICATRAL si standard ndërkombëtar për interpretimin e termave më të zakonshëm në tregtinë e jashtme.

Të gjitha kontratat e lidhura sipas INCOTERMS 2000 mbeten të vlefshme edhe pas vitit 2011. Palët kontraktuese mund të lidhin kontratë edhe me versionin e INCOTERMS 2000, edhe pse tanimë janë të aprovuara INCOTERMS 2010. Ato mund të lidhin kontratë me çfarëdo versionin të INCOTERMS-ave.³⁸ INCOTERMS-at janë rregulla që rregullojnë raportet në mes shitësit dhe blerësit nga kontratat e shitjes në rast të transportit të mallit, doganimit të mallit, ambalazhimit të mallit, si dhe përgjegjësinë për dorëzimin e mallit. INCOTERMS-at janë rregullore të natyrës dispozitive, që të jenë të aplikueshëm duhet gjithsesi që palët të jenë marrë vesh paraprakisht në mes veti për këtë. Në bazë të kësaj palët kontraktuese janë të lira që me marrëveshjen e tyre paraprake të ndërrojnë apo të përshtatin për veten afatin e kontraktuar me marrëveshje.

³⁷ Po aty, fq 350, 351 dhe 352.

³⁸ www.icco.org, *International Chamber of Commerce, The new Incoterms*, dt. 28.09.2012.

INCOTERMS-at nuk mund të ndërrojnë klauzolat, që ka secila marrëveshje për shitjen. Këto marrëveshje na shërbejnë që të lehtësohet shitja e mallrave jashtë kufijve shtetërorë. Janë rregulla aq të pranuar sa mund të themi lirisht se në arenën ndërkombëtare janë bërë traditë.

II.2. Burimet kombëtare

Në të drejtën e Kosovës si burim nacional konsiderohet Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, por në aspektin ndërkombëtar numërohen edhe disa uzansa, që po ashtu janë trashëguar nga ish -Jugosllavia dhe që quhen Uzansa për tregtinë e mallrave, aprovuar në vitin 1954.

II.2.1. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve

Kosova ka qenë pjesë përbërëse e ish-Jugosllavisë. Si pjesë e ish RSFJ-së ka trashëguar të gjithë legjislacionin nga sikundër edhe të gjitha pjesët përbëse të federatës. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (ligji aktual-pozitiv), është pasardhës i LMD-së së vitit 1978. Në këtë ligj ka pasur ndikim Kodi Civil Austriak, për të mos thënë kopje e tij. Ndikimi i LMD-së së vitit 1978 është shumë evident dhe në LMD-në aktuale ka ndikim shumë të madh. Ndikimi i Kodit Civil Shqiptar i vitit 1994 nuk është shumë i madh në ligjin aktual. Kjo nisur nga fakti se Kodi Civil Shqiptar i vitit 1994 është Kodi Civil që kryesisht mbështet në Kodin Civil Italian. Prandaj edhe gjatë analizës së problematikës janë analizuar edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i Kosovës dhe Kodi Civil Shqiptar. Nxjerrja edhe e një kodi civil më modern në Kosovë nuk krijon kushte për përjashtimin e burimeve tjera të së drejtës civile.³⁹

Në të gjitha shtetet evropiane ku ekziston e drejta e shkruar, pra edhe në Kosovë si shtet që pretendon të jetë pjesë e familjes evropiane, ligji paraqet burimin kryesor të së drejtës në përgjithësi, pra edhe të drejtës civile në veçanti.⁴⁰ Në Kosovë, nxjerrja e Kodit Civil është e rëndësishme dhe ajo duhet të bëhet duke u mbështetur në rregullativën e shteteve me sisteme juridike të zhvilluara.

³⁹ Avdulla Aliu. (2013). E Drejta Civile, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, fq. 204.

⁴⁰ Avdulla Aliu. (2013). E Drejta Civile, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, fq. 203.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve paraqet të drejtën e detyrimeve në aspekt material. Për formulimin e këtij ligji nga ana e ekspertëve ligjor kosovar dhe ndërkombëtar është dashur një kohë e gjatë sidomos në fillim të shek. XXI. Për përpilimin e LMD-së janë bërë përpjekje të shumta, ky ligji gjithmonë ishte më voluminoz. Pas përpjekjeve të shumta dhe analizave nga ekspertët kanë ardhur deri te përpilimi i ligjit pothuajse më voluminoz në legjislacionit kosovar. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr 04/L-077 është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë si pjesë e përgjithshme e ligjit. Kjo pjesë quhet Libri i Parë dhe ka gjithsej VI pjesë. Pjesa e posaçme është libri 2. Libri 2 përbëhet nga XXX pjesë. LMD-ja siç theksuam më lartë është një ndër ligjet më voluminoze në Kosovë dhe në vete ngërthen 1059 nene. Parlamenti i Republikës së Kosovës LMD-në e ka aprovuar me dt. 10 maj 2012. Ligji është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës gjashtë muaj më vonë kur edhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor të po atij viti.

Kosova, sot mund të modifikojë dhe përshtatë të drejtën civile me vendet e BE-së, sepse e ka një kohë të mjaftueshme të ndërtimit të së drejtës me anë të ligjeve të veçanta.

II.2.2. Uzansat

Uzansat janë doke zakonore të kodifikuara, të mbledhura e të sistemuara dhe të publikuara, përgjithësisht të lejuara nga organet kompetente. Uzansat janë zakone të kodifikuara afariste, kurse kodifikimin e përpilojnë dhe e shpallin organet e autorizuar.⁴¹ Uzansat i nxjerrin shoqatat afariste, odat, bursat etj.⁴² Në Republikën e Kosovës për grumbullimin, sistemimin dhe kodifikimin e uzansave është e autorizuar Oda Ekonomike e Kosovës. Uzansat, që janë të aplikueshme në shtetin tonë, janë uzansat e trashëguara nga ish-Jugosllavia. Me që ato janë uzansa të aprovuara para vitit 1989 dhe nuk janë diskriminuese për shqiptarët vazhdojnë të jenë ende uzansa të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Uzansat kanë karakter dispozitiv mirëpo, disa uzansa përkundër këtyre që kanë karakter dispozitiv, kanë edhe karakter imperativ.⁴³ Uzansat ndahen në uzansa të përgjithshme dhe uzansa të veçanta. Disa autorë uzansat i

⁴¹ Vilim Gorenc. (2010) *Bazat e së Drejtës Tregtare Statusore dhe Kontraktore*, Kolegji Victory, Prishtinë, fq 29.

⁴² Po aty. fq. 29.

⁴³ Mazllum Baraliu. (2010). *E Drejta Biznesore* Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2010, fq. 45.

klasifikojnë si të detyrueshme. Uzansat e përgjithshme kanë karakter imperativ, ndërsa ato të veçanta më shpesh janë të karakterit dispozitiv.⁴⁴

Ndërkaq një grup tjetër i autorëve uzansat i klasifikon si “IUS Dispozitivum” ndaj aplikohen vetëm atëherë kur palët kontaktuese shprehimisht apelojnë për to.⁴⁵ Sipas mendimit tonë Uzansat janë burime të tërthorta të cilat aplikohen vetëm në rastet kur ligji nuk e zgjidh çështjen në fjalë. Në disa vende ekzistojnë uzansa të njëjta, dhe palët me kontratë vendosin se cilat do t’i aplikojnë. (...) Palët merren vesh dhe pajtohen për zbatimin konkret të tyre (...)⁴⁶

Në rastin e përcaktimit të uzansave bazohemi te praktika, kështu që organi i autorizuar nuk mund të shpallë me uzansë diçka që nuk ka bazë në praktikën afariste.

⁴⁴ Po aty. fq.45.

⁴⁵ Riza Smaka. (2008). *E Drejta Biznesore*, Universiteti Iliria, Prishtinë , fq 119.

⁴⁶ Po aty. fq. 119.

KAPITULLI III: DETYRIMI I DORËZIMIT TË SENDIT DUKE U BAZUAR NË KONTRATËN E SHITJES

III. 1. Vështrime të përgjithshme

Një prej qëllimeve kryesore të kontratës për shitblerje është përmbushja e saj. Qëllimin e kontratës së shitjes dhe detyrimet e të dyja palëve kontraktuese e përshkruan edhe KCSH-ja në të cilën shënohet si më poshtë. Kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi.⁴⁷ Përmbushja e saj bëhet duke e dorëzuar sendin, dhe për sendin e dhënë duhet dhënë si kompensim çmimi i sendit, që njëkohësisht paraqet edhe një prej detyrimeve kryesore të blerësit. Blerësi është i detyruar për të paguar çmimin në kohën dhe në vendin e caktuar në kontratë. Në mungesë të dispozitës kontraktuese apo të dokës përkatëse, pagesa duhet të bëhet në momentin dhe në vendin në të cilin bëhet dorëzimi i sendit.⁴⁸ Mbi blerësin rëndon detyrimi për pagimin e çmimit i cili mund të jetë përcaktuar nga palët në kontratë ose palët në kontratë mund t'ia kenë besuar caktimin e çmimit.⁴⁹ Nga kjo dalin detyrime për të dyja palët kontraktuese të cilat duhet gjithsesi të përmbushen.

Shitësi është i detyruar që të dorëzojë mallin, përveç kësaj ai duhet të dorëzojë, po ashtu, edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të cilat paraqesin edhe bartjen e pronësisë nga shitësi te blerësi. Shitësi është i detyruar të dorëzojë të gjitha dokumentacionet përkatëse për fitimin e pronësisë së tyre, sipas kushteve të parashikuara nga kontrata apo ligji.⁵⁰ Detyrimet e mësipërme janë detyrime kryesore të palëve kontraktuese që paraqesin edhe detyrimet thelbësore të kontratës për shitblerje. Detyrimet e zakonshme mund të dalin nga ligji. Të dyja palët kontraktuese e kanë të njohur se, duhet të përmbushin detyrimet e tyre kryesore, pa marrë parasysh se për çka është fjala për detyrime thelbësore ose detyrime të zakonshme. Ato janë detyrime për palët dhe palët duhet t'i zbatojnë ato me përpikëmeri. Dallimi kryesor në mes të detyrimeve thelbësore dhe atyre të zakonshme është se sanksioni te detyrimet thelbësore është më i rëndë sesa te detyrimet e zakonshme.

⁴⁷ KCSH, neni 705, paragrafi 1.

⁴⁸ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq.373.

⁴⁹ Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi, *vepër e cituar*, fq.10.

⁵⁰ KCSH neni 710, paragrafi 2.

Qëllimi kryesor i studimit tonë është përgjegjësia e shitësit për dorëzimin e mallit. Mirëpo së pari, për të analizuar këtë dukuri duhet kuptuar fjala *dorëzim* sepse për të njohur efektet për mospërbushjen e një kontrate, pyetja e parë është përmbajtja dhe interpretimi i përmbajtjes së saj. Përcaktimi i dorëzimit është shumë i ndërlikuar sepse nga kjo lindin pasoja të rëndësishme.

E para, shitësi obligohet që sendin, të cilin e shet, që është kontraktuar me kontratën e shitjes t’ia dorëzojë blerësit, kështu blerësi fiton të drejtën për zotërim, pra përkatësisht të drejtën e pronës mbi sendin e blerë,⁵¹ blerësi ka detyrimin t’i paguajë çmimin shitësit.

E dyta, blerësi ka të drejtë të kërkojë dorëzimin e sendit, poashtu ai ka detyrim për dorëzimin e çmimit për sendin e blerë.⁵² E treta, në përmbushjen e detyrimit mund të ndodhë që sendi të humbasë cilësitë/vetitë e veta duke pësuar të meta fizike, dhe të gjitha këto gjatë transportit barten nga shitësi te blerësi. E katërta, nëse shitësi nuk vepron me mirëbesim atëherë shitësi hyn në borxh ndaj blerësit. E pesta, nëse shitësi nuk përmbush detyrimin në afatin e caktuar, shitësi mund të shtojë një afat shtesë për përmbushjen e tij. Në një rast të tillë domethënia e dorëzimit numëron ato masa të cilat duhet të ndërmarrë shitësi që të ndalojë veprimin e mëtejshëm negativ (p.sh. shuarja e detyrimit).⁵³ E gjashta, nëse shitësi nuk bën dorëzimin e mallit atëherë blerësi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit.⁵⁴

III. 2. Përkufizimi teorik i dorëzimit - konceptet tradicionale dhe komerciale

Kontrata e shitjes është një ndër kontratat më të rëndësishme të parashikuara nga Kodi Civil dhe LMD-ja me anë të së cilës realizohet qarkullimi i pasurisë nga një person tek tjetri.⁵⁵ Kjo kontratë ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi. Kontrata e shitjes e detyron shitësin që sendin, të cilin e shet, t’ia dorëzojë blerësit dhe t’ia kalojë të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t’ia paguajë çmimin dhe ta pranojë sendin.⁵⁶

⁵¹ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq. 370.

⁵² Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, 2nd (English) edition, New York, 2005, fq. 344.

⁵³ Po aty, fq. 34.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi, *Vepër e cituar*, fq. 9.

⁵⁶ LMD, neni 438, paragrafi 1.

Kontrata e shitblerjes është kontratë e dyanshme me anë të së cilës shitësi është i detyruar që t'ia dorëzojë sendin e blerë nga ai, blerësit. Ndërkaq blerësi është i detyruar që shitësit t'ia dorëzojë çmimin dhe të marrë sendin e blerë nga vetë ai. Në bazë të kësaj shohim se kontrata e shitblerjes ka të drejtë të fitimit të pronësisë në bazë të së cilës pronësia kalon nga një titullar tek titullari tjetër. Kjo kontratë (*iustus titullus*) ndërkaq, me kalimin e pronësisë dhe me regjistrimin e sendeve të paluajtshme, duhet regjistruar në libra publikë (*modus aquirendi*). Çështja është ndryshe në rastet kur sendi është lëndë e kontratës, send i luajtshëm, që vetëm dorëzohet, por, nuk regjistrohet në librat publikë.

Te kontrata e shitjes, shitësi është i detyruar që t'ia dorëzojë sendin blerësit. Shitësi mund t'ia dorëzojë sendin direkt ose indirekt, por në secilin rast qëndron detyrimi i tij për dorëzimin e sendit. Megjithatë efekti i këtij detyrimi do të jetë i ndryshëm varësisht nga efektet e kontratave.

Nëse kontrata nënkupton edhe fitimin e pronësisë, atëherë shitja paraqet një harmonizim të së drejtës dhe gjendjes faktike, sepse blerësi, që në momentin e shuarjes së kontratës, ka fituar të drejtën e pronësisë. Që do të thotë se, me lidhjen e kontratës nuk është bartur e drejta e pronësisë, por janë krijuar të drejta dhe detyrime për të dyja palët kontraktuese; kjo dëshmon se kontrata e shitblerjes është kontratë e dyanshme detyruese. Është kontratë oneroze sepse është kontratë me shpërblim, është kontratë konsensuale dhe komutative, në shumë raste e sidomos në rastet kur lëndë e kontratës është sendi i paluajtshëm dhe kur kontrata është kontratë reale. Në anën tjetër nëse kontrata ka efekt detyrues atëherë kjo paraqet një bazë të fortë dhe për fitimin e pronësisë mbi sendin nevojitet edhe mënyra ligjore e fitimit të pronësisë (*modus aquirendi*) që me sendet e luajtshme fitohet me dorëzim të thjeshtë (*traditio*). Shitësi çdo herë ka detyrim të dorëzojë sendin që është lëndë e kontratës.

Dorëzim është veprimi kur sendi vendoset në duart e blerësit ose kur këtij të fundit i jepet mundësia ta marrë atë në mënyrë që të kryhet dorëzimi (neni 1604) sipas kësaj dispozite, e cila përdor një shprehje, që sot nuk është shumë e përshtatshme, bëhet fjalë për marrje në pronësi).⁵⁷ Me dorëzim do të kuptojmë dhënien faktikisht dhe materialisht të sendit në duart e blerësit.⁵⁸

Ne teori ekzistojnë dy kuptime të dorëzimit të sendit, respektivisht forma tradicionale dhe forma komerciale e konceptit të dorëzimit. Qëllimi i konceptit tradicional është kalimi i pronësisë për lëndën e kontratës nga shitësi te blerësi, kështu që shitësi mund të përdorë sendin

⁵⁷ Georges Vermelle. (2008). "Kontratat -Pjesa e Posaqme", Papirus, Tiranë, fq 45.

⁵⁸ Mariana Tutullani-Semini. (2006). "E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave-Pjesa e Posaqme", Tiranë, fq.11.

dhe nga sendi të nxjerrë dobi. Në këtë mënyrë e trajton edhe LMD-ja, në bazë të së cilës shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar me kontratë.⁵⁹ Dorëzimi i mallit, në kuptimin e fitimit të pronësisë, ndodh vetëm atëherë kur blerësi merr sendin, respektivisht kur sendi është dorëzuar nga ana e shitësit. Shitësi e ka kryer parimisht detyrimin e dorëzimit ndaj blerësit, kur ai (shitësi) ia dorëzon blerësit sendin apo ia dorëzon dokumentin me të cilin mund të merret sendi.⁶⁰

Kuptimi tradicional i dorëzimit është kritikuar, sepse kjo shkon më shumë në favor të tregtisë bashkëkohore të mallrave. Duhet bërë dallimin në mes të shitjes civile dhe asaj tregtare dhe duhen pasur parasysh specifikat e tyre. Rrjedhimisht sipas kësaj detyrimi për dorëzimin e sendit i përgjigjet tregtisë së mallrave si detyrim për dorëzimin e mallit (kuptimi komercial i porosisë).

Dorëzimin e kryejnë të gjitha veprimet, të cilat shitësi është i detyruar t'i kryejë, në mënyrë që, blerësi të mund ta pranojë mallin i cili është porositur.⁶¹ Kjo do të thotë se shitësi duhet të bëjë çdo gjë, që është e mundur, për t'ia dorëzuar të drejtën e pronësisë blerësit, por se cilat veprime duhet të kryejë ai në rastin konkret kjo varet nga kontrata dhe nga natyra e punës. Në bazë të asaj se a varet dorëzimi nga dy apo më shumë veprime, mund ta dallojmë dorëzimin në kuptimin e ngushtë dhe dorëzimin në kuptimin e gjerë.

Sipas teorisë sonë dhe qëndrimit të pranuar si dhe ofrimit në një kuptim të ngushtë, duket se ata i ruajnë mallrat në dispozicion të blerësit në një vend të caktuar ose në një automjet të caktuar dhe malli i dorëzohet blerësit, transportuesit ose shpëdicionit.⁶²

Sipas kësaj dorëzimi nuk ka për qëllim që blerësi të fitojë pronësinë e mallit, por fuqinë e vërtetë të shitjes. Në atë moment, kur shitësi ia dorëzon mallin blerësit ose transportuesit, ai ka përmbushur detyrimin e tij kontraktor. Shitësi e kryen detyrimin e dorëzimit edhe atëherë kur blerësi ia jep sendin apo shkresën që për të ka karakter të dokumentit me vlerë, dhe në bazë të të cilit blerësi mund të marrë sendin.⁶³ A do ta marrë blerësi mallin nga shitësi, si dhe a do të transportohet malli deri te blerësi për përmbushjen e detyrimit të shitësit kjo nuk ka rëndësi.

⁵⁹ LMD, neni 450.

⁶⁰ Po aty, neni 450, paragrafi 1.

⁶¹ *Uzansa e Përgjithshme*, *Uzansa*, nr. 70.

⁶² Vladimir Kapor. (1961). "*Kontrata e Shitblerjes—Përkthim i Uzansave të Përgjithshme për Tregti me Mallra*", Botimi 4, Beograd, fq.95.

⁶³ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq 371.

Për porosinë në kuptimin e ngushtë lidhet kalimi i rrezikut. Te shitjet në distancë, kur shitësi duhet t'ia dërgojë mallin blerësit, ai ka detyrim që të ndërmarrë edhe veprime të tjera (juridike dhe faktike) p.sh përgatitja e mallit për dërgim, shuarja e detyrimit me transportuesin, sigurimin e mallit dhe ngarkimin e mallit në mjetin transportues. Të gjitha veprimet nënkuptojnë dorëzimin në kuptimin e gjerë. Nëse dorëzimi nuk përkufizohet në këtë mënyrë, atëherë mund të paraqiten probleme dhe shqetësime në praktikë. Në të vërtetë nuk është e qartë se me cilat veprime dhe në cilin moment shitësi e ka kryer dorëzimin.

Për shkak të rrezikut, përkufizimi i nocionit të dorëzimit bart rregulloret, që rregullisht përcaktojnë rregulloret e ofrimit të tillë në kuptimin e ngushtë. Në teorinë tonë janë përgatitur qëndrime, që ndarja e nocionit shitje-blerje në kuptimin tradicional dhe tregtar është e panevojshme dhe është ligjërisht e pabazuar. Në këtë teori kemi paraqitur pikëpamje se ndarja e konceptit mësohet në metoda tradicionale, komerciale dhe të panevojshme dhe që të gjitha këto ligjërisht janë të pabazuara. Së pari, u vu në dukje se "ndarja" e dorëzimit të mallit në metodën komerciale dhe atë civile, ka sjellë në shumë raste, mosmarrëveshje në praktikë. Sidomos në rastet kur diskutohet se - a është bërë dorëzimi i mallit sipas marrëveshjes. Pastaj, në sistemet ku tradita e dorëzimit të mallit është kusht për fitimin e pronësisë, do të ishte e domosdoshme që përkundër përmbushjes së detyrimit të bëhet edhe dorëzimi i sendit.⁶⁴ Kjo teori nuk është e pranueshme për shumë arsye. Pikënisja e analizës duhet të jetë nocioni i dorëzimit, që do të thotë se dorëzimi përfshin të gjitha veprimet që duhet t'i bëjë shitësi në mënyrë që sendi të kalojë te blerësi, respektivisht që pronësia të kalojë nga shitësi të blerësi. Blerësi pas këtij veprimi ka të drejtë të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij. Veprimet të cilat shitësi i ndërmerr janë lëndë e së drejtës detyrimore, detyrimet e shitësit nga kontrata e shitjes janë norma imperative të përcaktuara me KCSH dhe me LMD. Këto veprime janë ato të cilat janë të rregulluara sipas parimeve të së drejtës sendore dhe janë të nevojshme për fitimin e posedimit dhe pronësisë. Sipas kësaj normat imperative janë të detyrueshme për të gjitha palët kontraktuese.

Qëllimi i dorëzimit është që shitësi duhet të fitojë një mundësi reale për të disponuar mallrat. Kjo domethënë që shitësi është i detyruar të ndërmarrë të gjitha ato veprime çka është e mundur dhe që me këto veprime duhet t'ia mundësojë këtë gjë (disponimin me mallra) blerësit. Transferimi i posedimit nuk është me rëndësi. Sipas mendimit tonë nocioni i dorëzimit dhe

⁶⁴ Shih më shumë: Vrleta Krulj, *vepër e cituar*, fq. 77; Vesna Klajn-Tatić, "*Vonesa e Shitësit në Dorëzimin e Mallit*", Beograd, 1983, fq. 38- 39.

nocioni i përmbushjes janë të ndryshëm dhe janë teori të pavarura, edhe pse në raste të caktuara mund të kenë kuptim të njëjtë. Nëse shitësi është i detyruar që mallin ta dorëzojë në selinë e shitësit, ai pastaj e ka detyrë që të përmbushë këtë detyrim dhe në atë moment dorëzimi dhe përmbushja kanë të njëjtin kuptim dhe domethënie.

Megjithatë kur flasim për shitjen në distancë, kur shitësi dhe blerësi nuk gjenden në të njëjtin shtet, malli nuk i dorëzohet blerësit, por i dorëzohet personit të tretë (transportuesit, shpëdicionit), ndërsa shitësi e plotëson detyrimin e dorëzimit në momentin e dorëzimit të sendit. Në këtë rast, detyrimi do jetë i përmbushur vetëm atëherë kur transportuesi i dorëzon sendin blerësit edhe në këtë rast ende nuk do të thotë se është përmbushur detyrimi. Në rastin kur sipas kontratës nevojitet që të bëhet transportimi i sendeve, ndërsa në kontratë nuk është caktuar vendi i përmbushjes, dorëzimi quhet i kryer me dorëzimin e sendit transportuesit ose personit i cili e organizon transportin.⁶⁵ Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend të caktuar, ai shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve.⁶⁶

Në shitjen me dokumente, shitësi shkarkohet nga detyrimi i dorëzimit të sendeve të shitura, duke i dhënë blerësit dokumentin e shitjes dhe dokumentet e tjera të cekura në kontratë ose në ligj.⁶⁷

Dorëzimin në këto rrethana e bëjnë veprimet të cilat shitësi është i detyruar që t'i ndërmarrë në parim të shuarjes së kontratës së shitjes. Nga kjo mund të bëhet përmbushja e dorëzimit në të drejtën detyimore dhe në të njëjtën kohë nuk mund të bëhet dorëzimi me anë të së cilës arrihet posedimi i mallit.⁶⁸

E dyta, dorëzimi kuptohet si punë materiale me ndikim detyrimor dhe mundëson trajtim të ndarë të çështjes në mes të bartjes së posedimit dhe kalimit të rrezikut.⁶⁹

Kjo është shumë e rëndësishme për shitjen ndërkombëtare të mallrave për shkak të fitimit dhe bartjes së pronësisë tek të drejtat kombëtare, që e rregullojnë këtë në mënyra të ndryshme me norma kogente, dhe me krijimin e këtyre normave dhe rregullave uniforme nuk ka qenë e mundur rregullimi i kësaj çështjeje. Në bazë të kësaj, në tregtinë ndërkombëtare për palët

⁶⁵ LMD, neni 455, paragrafi 1

⁶⁶ KCSH, neni 711, paragrafi 2.

⁶⁷ KCSH, neni 714.

⁶⁸ Vrleta Krulj, vepër e cituar, fq. 74.

⁶⁹ Vladimir Kapor, "Kontrata për Shitblerjen e Mallit", fq. 96.

kontraktuese, detyrim bazë është dorëzimi i mallit dhe kalimi i rrezikut, e jo më kalimi i pronësisë.⁷⁰

Rreziku është mundësia e ndodhjes së ngjarjeve negative. Te malli i shitur rreziku ekziston edhe në rastet e prishjes së paparashikuar të tij, gjegjësisht të humbjes së tij ose shkatërrimit të tij. Çështja e rrezikut është e lidhur me mënyrën e posedimit me mallin, gjegjësisht pala që mund të ketë mallin në dispozicion mban përgjegjësinë e prishjes eventuale të humbjes dhe shkatërrimit të mallit. Me dorëzim nga shitësi, blerësi e bart fuqinë e posedimit, në këtë moment te blerësi bartet rreziku i prishjes apo i humbjes së mallit.

Në fund, në mes të dorëzimit tradicional dhe atij tregtar ekziston edhe një dallim esencial. Dorëzimi konsiderohet si akt i njëanshëm, derisa dorëzimi i mallit sipas aktit tradicional është veprim i dyanshëm. Dorëzimi nënkupton detyrimin e shitësit, shitësi është i detyruar të ndërmarrë të gjitha veprimet që blerësi të mund të fitojë pronësinë. Nëse dorëzimi do të konsiderohet si akt i dyfishtë, nëse për realizimin e dorëzimit do të duheshin veprimet e shitësit dhe blerësit, dhe për përmbushjen e kontratës është e lidhur edhe bartja e rrezikut, kjo gjithmonë do të varet edhe nga dëshira e blerësit.⁷¹ Në këtë rast shitësi do të vihej në pozitë të vështirë.

III. 3. Përkufizimi i nocionit të dorëzimit sipas legjislacionit pozitiv

Shtjellimet dhe këto analiza, që do bëhen më poshtë, do të jenë të karakterit të përgjithshëm. Ato do të paraqesin në hyrje për një analizë në detaje të hollësishme të nocionit dorëzim sipas së drejtës pozitive në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore.

Përcaktimin për dorëzimin e sendit e gjejmë në Ligjin Uniformë për shitjen e mallit nga viti 1905-1907⁷². Zakoni i përmendur nuk përcakton dorëzimin, por nga ai shihet se dorëzimi varet nga veprimet që duhet t'i kryejë shitësi në mënyrë që blerësi të fitojë tërësisht posedimin e mallit.⁷³

Përcaktimi i dorëzimit të mallit gjendet në ULIS. Sipas nenit 19 të ULIS-it dorëzimi është dhënia e porosisë (dorëzimit të mallit) të kontraktuar në kontratë. Në këtë përcaktim janë të përfshira dy detyrime të shitësit – a) detyrimi i dorëzimit të mallit dhe b) detyrimi i posedimit të

⁷⁰ Aleksandar Goldštajn, “*E Drejta Biznesore Kontraktuese*”, fq. 212.

⁷¹ Shih më shumë: Vesna Klajn-Tatić, vepër e cituar, fq. 40.

⁷² Bianca - Bonell, vepër e cituar, fq. 249.

⁷³ Po aty. fq.249.

mallit, shitësi duhet t'ia mundësojë blerësit posedimin e mallit dhe fitimin e pronësisë së mallit të dorëzuar. Qëllimi i këtij përcaktimi është përkushtimi preciz se në cilën mënyrë është përmbushur detyrimi. Sa është e suksesshme kjo? Kjo do të sjellë një kontribut edhe për gjykatën edhe për praktikën gjyqësore. Në vend të kësaj, është arritur një efekt që është tërësisht i kundërt sepse shitësi është vendosur në një pozitë të vështirë dhe të padrejtë dhe mund të durojë një numër të madh të dëmeve të shkaktuara nga këto veprime.

Neni 19 i ULIS-it ka sjellë një numër të madh vështirësish dhe prandaj për këtë nen ka disa ankesa. E para, dorëzimi i mallit, i cili nuk është paraparë në kontratë, nuk është llogaritur si dorëzim edhe në rastet kur blerësi e ka marrë mallin, e ka përdorur ose e ka shitur atë.

E dyta, bartja e rrezikut ka qenë e lidhur me dorëzimin. Nga kjo dorëzimi i mallit, i cili nuk është paraparë në kontratë, nuk parasheh dorëzimin ose përmbushjen e detyrimit dhe nuk ka arritur deri te kalimi i rrezikut te blerësi për prishje, humbje ose shkatërrim të mallit. Një rezultat i tillë ka qenë i paqëndrueshëm në disa situata si, për shembull, neni 19 i ULIS-it nuk ka mundur të aplikohet dhe ka qenë e pamundur që dorëzimi të përmbushet, dhe në rastet kur blerësi ka pranuar mallin me të meta (vese), ose, kur është detyruar ta pranojë, sepse këto të meta nuk kanë paraqitur diçka serioze, dhe ai nuk e ka shkelur detyrimin e marrëveshjes, ose, kur shitësi në marrëveshje me blerësin ka mënjeluar defektet (të metat), ose kur blerësi nuk ka mundur ta refuzojë mallin sepse me kohë nuk ka bërë marrëveshje për mangësitë.⁷⁴

Që në fillim, me krijimin e Konventës së Vjenës, ka ekzistuar ideja që dorëzimi të përcaktohet, por për shkak të mosgjatësisë së formulës adekuate nga kjo ide është hequr dorë. Në vend të kësaj, Konventa e Vjenës përcakton vendin dhe kohën e dorëzimit në rastet konkrete dhe parasheh se cilat veprime duhet të ndërmarrë shitësi që të përmbushë detyrimin.

LMD-ja nuk e parasheh përmbushjen, por e parasheh përgjegjësinë e shitësit për dorëzimin e mallit. Shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar me kontratë.⁷⁵ Ky detyrim ka për objekt një send, që i takon tashmë blerësit, i cili është bërë pronar si pasojë e efektit real të menjëhershëm të kontratës së shitjes, gjithmonë kur flitet për sendet individualisht të përcaktuara.⁷⁶ Ndërkaq KCSH-ja e parasheh se shitësi është i

⁷⁴ Po aty, fq.245-246.

⁷⁵ LMD, neni 450, paragrafi 1.

⁷⁶ Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi, *vepër e cituar*, fq 13.

detyruar t'i dorëzojë blerësit sendin⁷⁷ sendet dorëzohen në gjendjen në të cilën ndodhen në momentin e përfundimit të kontratës.⁷⁸

Për dallim nga LMD-ja, Uzansat e Përgjithshme për Tregtinë me Mallra parashohin përmbushjen dhe këtë duke bërë përcaktimin, por dhe duke mos bërë një dallim të ndryshëm në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë në mes të këtyre dy shprehjeve.

Me qëllim që të nxirret përfundimi në të drejtën pozitive duhet të nisemi nga përmbajtja e saj, gjegjësisht nga ajo se cilat veprime dhe cilën mënyrë shitësi duhet të ndërmarrë që detyrimi (dorëzimi) të përmbushet. Për shkak të marrëveshjes së plotë si detyrim kryesor i shitësit ndaras do të vështrojmë rregullimin e saj në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore, e më pastaj do të nxjerrim përfundime.

III. 3.1. Dorëzimi te shitja ndërkombëtare e mallit

Dorëzim është veprimi kur sendi vendoset në duart e blerësit. Kur këtij të fundit i jepet mundësia ta marrë sendin në mënyrë që të kryhet dorëzimi (neni 1604) sipas kësaj dispozite, e cila përdor një shprehje që sot nuk është shumë e përshtatshme, bëhet fjalë për marrje në pronësi.⁷⁹

Dorëzimi (përmbushja) nënkupton veprime që shitësi është i detyruar që t'i ndërmarrë, me qëllim që blerësi të bëhet posedues i mallit. Qëllimi i fundit i veprimeve të tilla duhet të jetë fitimi i pronësisë në mall nga ana e blerësit. Rregullat ndërkombëtare përcaktojnë se cilat veprime duhet të ndërmarrë shitësi, në mënyrë që blerësi të ketë pronësi të plotë mbi mallin. Megjithatë, bartja dhe vendosja e pronësisë sipas veprimeve të ndërmarra janë të rregulluara me norma kombëtare (nacionale).⁸⁰

Detyrimi i dorëzimit të mallit është i rregulluar me nenet 31-33 të Konventës së Vjenës. Në nenin 31 të Konventës së Vjenës është përcaktuar vendi dhe përmbajtja e dorëzimit (detyrimit), cilat veprime dhe në cilin vend shitësi duhet të ndërmarrë këto veprime që të përmbushë këtë detyrim të tij. Çështja e vendit dhe përmbajtja e detyrimit të dorëzimit janë të

⁷⁷ KCSH, Neni 710, paragrafi 1.

⁷⁸ KCSH, Neni 711, paragrafi 1.

⁷⁹ Georges Vermelle. (2008). “Kontratat- Pjesa e Posaçme”. Papirus, Tiranë. fq. 45.

⁸⁰ Sipas nenit 4, paragrafi b, *Konventa e Vjenës* nuk varet nga ndikimi të cilin mund ta ketë në përfitimin e mallit të shitur.

lidhura ngushtë prandaj dhe për këtë arsye janë të rregulluara me një normë. Në bazë të kësaj, vendi i dorëzimit menjëherë ndikon në përmbajtjen e detyrimit të shitësit. Nëse në kontratën e shitjes është përfshirë edhe transporti i mallit, shitësi e përmbush detyrimin me dorëzimin e mallit tek transportuesi i parë.⁸¹ Kjo normë është e njëjtë edhe me LMD-në, neni 455 edhe me KCSH-në, neni 711.

Nëse kontrata e shitjes nuk parasheh transportin e mallrave, shitësi e përmbush detyrimin me vendosjen e mallit në dispozicion të blerësit në vendin e caktuar.⁸² KCSH-ja këtë çështje e rregullon duke përfshirë si jepet më poshtë. Në rast se kontrata nuk përfshin transportin e sendeve dhe u referohet sendeve të përcaktuara individualisht, ose një lloji që do të duhet të tërhiqet nga një sasi e caktuar, ose që duhet të fabrikohet, të prodhohet, në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës, palët e dinin që sendet ndodheshin dhe se duhet të fabrikoheshin apo të prodhoheshin në një vend të caktuar, shitësi detyrohet t'i vërë sendet në dispozicion të blerësit në atë vend.⁸³ Veprimet e dorëzimit duhet të përmbushen me kohë, në mënyrë që shitësi të përmbushë detyrimin,⁸⁴ në këtë mënyrë do të bëhet edhe përmbushja e kontratës, duke mos shkaktuar shkelje apo cenim të kontratës.

III. 3.1.1. Vendi dhe përmbajtja e dorëzimit

Vendi i dorëzimit të mallit në shumicën e rasteve përcaktohet nga pala kontraktuese me anë të kontratës që palët e lidhin në mes tyre. Çështja është shumë e lehtë në raste të tilla. Ka raste kur vendi i dorëzimit të mallit nuk është përcaktuar me kontratë, e në rastet e tilla veprohet sipas disa teorive të ndryshme. Fillimisht bazohemi në ligjin pozitiv, në rastet kur kjo nuk përcaktohet atëherë konventat ndërkombëtare përcaktojnë çështjen në fjalë. Për sa i përket vendit të dorëzimit sendet mund t'i dorëzohen transportuesit ose personit të caktuar në kontratë.⁸⁵

Neni 31 i Konventës së Vjenës rregullon disa situata. Shitësi në bazë të kontratës së shitjes, ka detyrim që mallin ta dorëzojë në vendin e caktuar, që në praktikë kjo më së shpeshti ndodh. Kontrata në shumicën e rasteve përcakton se në cilin vend do të bëhet dorëzimi i sendit. Nëse detyrimi i tillë i shitësit nuk ekziston Konventa e Vjenës e bënë dallimin, kur kontrata e

⁸¹ Konventa e Vjenës, neni 31, paragrafi (a).

⁸² Konventa e Vjenës, neni 31, paragrafi (b).

⁸³ KCSH 711, paragrafi 3.

⁸⁴ Konventa e Vjenës, neni 33.

⁸⁵ Marjana Tutulani- Semini. (2006). “E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave”, Tiranë, fq 12.

shitjes parasheh transportin e mallit (neni 31.a) dhe kur transporti nuk është përfshirë në kontratën e shitjes (neni 31.b dhe 31.c). Këtë e përfshin edhe KCSH-ja dhe LMD-ja. Konventa e Vjenës nuk e parasheh kur shitësi është i detyruar që blerësit t'ia dorëzojë mallin në selinë e tij. Kjo është i ashtuquajturi detyrim dhe gjithmonë do të supozohet.⁸⁶

Natyrisht me ekzistimin e detyrimit të shitësit është e mundur, por, kjo çështje duhet shprehimisht të jetë e kontraktuar edhe nga palët kontraktuese.

III. 3.1.1.1 Detyrimi i shitësit që mallin ta dorëzojë në vendin e caktuar

Detyra themelore e shitësit është dorëzimi i sendit të blerë nga ana e blerësit. Dorëzimi i sendit do të thotë të vihet blerësi në lidhje materiale me sendin.⁸⁷ Dallimi duhet të bëhet edhe te dorëzimi i mallit, nëse është malli send i luajtshëm apo send i paluajtshëm. Sendi i luajtshëm dorëzohet aty për aty, ndërkaq sendet e paluajtshme dorëzohen duke bërë dorëzimin simbolik si dhe duke bërë regjistrimin në librat publikë.

Edhe tek e drejta ndërkombëtare dorëzimi është obligim kryesor i shitësit. Me dorëzimin e mallit përmbushet detyrimi kryesor i shitësit.

Autonomia e vullnetit të palëve përfaqëson njërin nga instrumentet juridike për caktimin e së drejtës kompetente dhe organit kompetent lidhur me të drejtat dhe detyrimet e palëve që dalin nga kontrata me element të huaj, e që palët kontraktuese mund ta shfrytëzojnë me dëshirën të tyre, por që nuk janë të detyruar me ligj.⁸⁸

Dispozitiviteti i normave të përfshira në Konventën e Vjenës dhe parimet e autonomisë së vullnetit si një prej kushteve kryesore për lidhjen e kontratës janë të shprehura shprehimisht në nenin 6 të Konventës së Vjenës. Këto dy parime kryesore janë të vërtetuara edhe në normat e tjera në Konventën e Vjenës, si dhe në burimet e tjera vendore dhe ndërkombëtare. Sipas kësaj palët janë të lira të shuajnë kontratën dhe me marrëveshje të përcaktojnë përmbajtjen e saj. Vërtetimin e kësaj e gjejmë në hyrje të nenit 31 të Konventës së Vjenës e cila parasheh se

⁸⁶ Një qëndrim të tillë e ka vërtetuar edhe praktika gjyqësore. Shih më shumë: Chengwei Liu, Place of Performance: Comparative analysis of Articles 31 and 57 of the CISG and counterpart provisions in Article 7:101 of the PECL, November, 2004, www.cisg.law.pace.edu, dt. 20.11.2012.

⁸⁷ Nerxhivane Dauti. (2001). *“E Drejta e Detyrimeve (pjesa e përgjithshme dhe e veçantë)”*. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 310.

⁸⁸ Asllan Bilalli & Hajredin Kuçi. (2009). *E Drejta Ndërkombëtare Private*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 287.

rregullat e përfshira në këtë normë do të zbatohen nëse shitësi nuk është i obliguar që mallin ta dorëzojë në një vend tjetër. Siç shihet edhe këtu i jepet përparësi vullnetit të lirë të palëve kontraktuese. Shitësi duhet të dorëzojë sendet në datën e caktuar në kontratë ose kur është e përcaktueshme në bazë të kontratës.⁸⁹ Shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar me kontratë.⁹⁰ Nga kjo shihet, se ajo për çka janë marrë vesh palët paraqet detyrim kryesor për dorëzimin e mallit.

Dorëzimin si përgjegjësi kryesore të shitësit të dyja palët rregullisht e rregullojnë në kontratën e tyre. Vendi i dorëzimit mund të jetë i caktuar ekskluzivisht në kontratë ose mund të përcaktohet jashtë kontratës. Vendi i ekzekutimit të detyrimit përcaktohet ose me marrëveshjen e palëve ose në ligj.⁹¹ E kjo do të thotë që nëse kontrata nuk përcakton vendin e dorëzimit të mallit (elementi konsensual), atëherë vendin e përmbushjes së këtij detyrimi e përcakton norma juridike (elementi imperativ). Palët mund të përcaktojnë ekskluzivisht vendin me kontratë. Ato e përcaktojnë vendin e saktë të përmbushjes së detyrimit ose me përdorimin e ndonjëres nga nocionet ndërkombëtare si: (CIF, FOB etj) sidomos INCOTERMS. Në praktikë është vërejtur se në kontratën në të cilën ekskluzivisht është paraparë përdorja e INCOTERMS-ave nuk na paraqiten si problem.⁹² Shkaku qëndron te detajet e rregullave që përmban kjo klauzolë.

Është e mundur që vendi i dorëzimit të mos jetë caktuar në kontratë, por, ajo ndodh për shkak të praktikës që ka ndodhur më herët në mes të palëve kontraktuese.⁹³ Palët kontraktuese kanë lidhur një kontratë të tillë edhe më herët, dhe kjo kontratë është përmbushur me përpikëmeri. Në këtë rast palët kontraktuese kanë krijuar besim te njëri -tjetri. Kur vendi i dorëzimit nuk është caktuar me kontratë, dorëzimi i sendit bëhet në vendin ku shitësi në momentin e lidhjes së kontratës e ka pasur vendbanimin apo vendqëndrimin e vet. Nëse mungon vendbanimi, dhe në qoftë se shitësi e ka lidhur kontratën në kuadër të veprimtarisë së vet ekonomike të rregullt, atëherë vendi i dorëzimit është selia e tij.⁹⁴

Nëse palët do të vinin deri te ndonjë mosmarrëveshje rreth krijimit të ndonjë praktike ose tradite, atëherë pala që thirret në traditë ka si obligim moral të saj të dëshmojë dhe të tregojë.

⁸⁹ KCSH, neni 712, paragrafi 1.

⁹⁰ LMD, neni 450 paragrafi 1.

⁹¹ Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). *E Drejta e Detyrimeve*, Tiranë.

⁹² Shih më shumë: Chengwei Liu, *Place of Performance: Comparative analysis of Articles 31 and 57 of the CISG and counterpart provisions in Article 7:101 of the PECL*, November, 2004, www.cisg.law.pace.edu.

⁹³ *Konventa e Vjenës*, neni 9, paragrafi 1.

⁹⁴ LMD, neni 454, paragrafi 1.

Në fund, në mungesë të marrëveshjes vendi i dorëzimit mund të jetë vendi në bazë të zakonit, nëse përmbushen tri kushte kumulative si dhe duhet të punohet në zakonet që palët e kanë njohur ose kanë mundur ta njohin, pra thënë më thjesht zakonet që cili është gjerësisht i njohur. Zakoni i cili është i njohur në tregtinë ndërkombëtare dhe që zakonisht palët e respektojnë në raste të njëjta.⁹⁵

Palët janë të lira të shuajnë detyrimin dhe që me marrëveshje të përcaktojnë përmbajtjen e saj, si dhe nga normat që përmbajnë konventat ndërkombëtare që të përfshijnë apo të ndërronë përmbajtjen e tyre. Të gjitha këto janë të pranishme nëse shitësi nuk është i detyruar që mallin ta dorëzojë në ndonjë vend tjetër. Siç shihet, këtu i jepet përparësi vullnetit të palëve kontraktuese. Nëse në kontratë nuk parashihet vendi i dorëzim-pranimi, vendi i dorëzim-pranimi të sendit të shitblerë, atëherë vendi i pranimi ose i dorëzimit trajtohet vendi i cili në momentin e kontraktimit është vendbanimi ose vendqëndrimi i shitësit.⁹⁶

Nëse vendi i dorëzimit nuk është përcaktuar sipas asnjërës nga të cekurat e mësipërme atëherë neni 31 i Konventës së Vjenës sqaron se normat e tilla kanë karakter plotësues, sepse do të aplikohet vetëm në rastet kur nuk ekziston marrëveshja e palëve, praktika e përdorur në mes palëve ose e drejta zakonore. Në praktikë vlera e tij është shumë e vogël dhe nevojitet vetëm në rastet kur ekzistojnë zbrazëtira në marrëveshjen e lidhur në mes të palëve kontraktuese.

III. 3.1.1.2. Përmbushja e detyrimit me dorëzimin e mallit transportuesit

Konventa e Vjenës, e cila ka për bazë dorëzimin e mallit, varet nga ajo se në kontratën e shitjes a është përfshirë ose jo transporti i mallit. Megjithatë bëhet fjalë për shitje ndërkombëtare, e cila më së shpeshti parasheh transportin e mallit dhe neni 31 i Konventës së Vjenës fillimisht parasheh rregulla të cilat rregullojnë kontratën e shitjes, tek të cilat kontrata dhe malli duhet të transportohet dhe atëherë detyrimi i shitësit përmbushet me dorëzimin e mallit te transportuesi i parë me qëllim që malli të dërgohet te blerësit. Kjo dukuri është e pranishme edhe në Kodin Civil Shqiptar dhe në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve.⁹⁷ Në tekstin e mëposhtëm do të

⁹⁵ Konventa e Vjenës, neni 9, paragrafi 2.

⁹⁶ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq.371.

⁹⁷ Kodi Civil Shqiptar, çështjen në fjalë e parasheh në nenin 711, paragrafi 2, ndërkaj LMD-ja e parasheh këtë në nenin 456.

analizojmë nocionet e transportimit të mallrave, transportuesin, dorëzimin e mallit, dhe vendin e dorëzimit të mallit.

III. 3.1.1.2.1. Transporti i mallit

Shitësi është i detyruar të dorëzojë sendin te blerësi. Kjo paraqet detyrimin kryesor të shitësit, dhe në bazë të kësaj ai është i detyruar t'i dorëzojë blerësit sendin e kontraktuar, i cili paraqitet si lëndë e kontratës mbi shitjen.⁹⁸

Që të mund të flasim për transportin e mallit në pajtueshmëri me nenin 31 të Konventës së Vjenës duhet të plotësohen këto kushte. Fillimisht, duhet të punohet për transportin të cilin e organizon shitësi. Pas kësaj është e nevojshme që transporti të organizohet me qëllim të caktuar. Në fund është e nevojshme që shitësi duhet të organizojë transportin që t'i mundësojë blerësit që ta marrin mallin.⁹⁹ Përgjegjësia e dorëzimit të shitësit në këtë rast është përgjegjësia e dërgesës, ndërsa ajo në mungesë të marrëveshjes së palëve për dorëzim ndodh në rastet kur marrëveshja është lidhur nga distanca.¹⁰⁰

Nëse kontrata është lidhur me atë që malli duhet dorëzuar, shitësi nuk është i detyruar që të gjejë transport, por, gjithsesi është i obliguar që të bëjë transportin e mallit, gjegjësisht ai në këtë rast gjithsesi duhet të gjejë transportuesin dhe të shuajë të gjitha kontratat të cilat janë urgjente për transportin të cilit i përgjigjet.¹⁰¹ Sipas së drejtës vendore ai gjithsesi duhet të lidhë kontratën për transportin e mallit. Sipas nenit 32, paragrafi 2 i Konventës së Vjenës, shitësi është i detyruar që të organizojë transport me mjete të caktuara dhe sipas kushteve që nevojiten për transportin e mallit të tillë. Kjo do të thotë se ai është përgjegjës që të zgjedhë transportin dhe mënyrën e bartjes, por nëse nuk ekziston një mënyra e tillë e bartjes atëherë zgjedh rrugën e drejtë të transportit.¹⁰² Nëse palët kanë bërë marrëveshje për llojin e transportit, atëherë shitësi është i detyruar që mallin ta dorëzojnë te vozitësi ose transportuesi i llojit që nevojitet për

⁹⁸ Nerxhivane Dauti, *vepër e cituar*, fq. 310.

⁹⁹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Shwarzer, *vepër e cituar*, fq. 345.

¹⁰⁰ Jochem Schmidt. (2004). *Münchener Kommentar zum Handelsgesetzbuch*, München, fq. 495.

¹⁰¹ Shih neni 32, paragrafi 2, i *Konventës së Vjenës* Përgjegjësia e shitësit, që të organizojë transportin e mallit, nuk tejkalon dispozitat e *Konventës së Vjenës*. Megjithatë kur palët janë marrë vesh apo kanë lidhur kontratë këtë përgjegjësi të shitësit sipas nenit 32, paragrafi 2, të *Konventës së Vjenës* është përgjegjësi e caktuar. Ndërsa palët e zbatojnë nenin 32, paragrafin 2, të *Konventës së Vjenës*, i cili është më gjerësisht se neni 31 pika a e *Konventës së Vjenës* sepse mund të ndodhë që me kontratën e shitjes të jetë paraparë transporti i mallit, por që blerësi është i detyruar ta organizojë transportin.

¹⁰² Shih më shumë: Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 259.

transportin e atij lloj mallit. Transportuesi në këtë rast detyrohet (...) sendin e caktuar ta transportojë në vendin e kontraktuar, ndërkaj dërguesi i sendit, detyrohet që atij për atë shërbim t'ia paguajë çmimin e kontraktuar.¹⁰³ Nëse nuk ka një marrëveshje të tillë, atëherë shitësi është i detyruar që të ketë parasysh interesat e blerësit, llojin e mallit, urgjencën e punës, sigurinë e transportuesit dhe shpenzimet e transportit të cilat duhet t'i përgjigjen mënyrës së transportit. Gjithashtu, shitësi nuk guxon të pranojë klauzola jo të rregullta që mund ta lironin transportuesin nga përgjegjësia.

Nuk duhet ngatërruar situata kur shitësi është përgjegjës që të organizojë transportin që ai ta sjellë mallin te destinacioni i fundit pasi e ka marrë mallin nga shitësi.¹⁰⁴

Për zbatimin e nenit 31, pika (e), të Konventës së Vjenës nuk është me rëndësi se cila palë kontraktuese i bart shpenzimet e transportit.

Sipas një mendimi, nga rregulla e shënuar, që shitësi duhet të organizojë transport ekziston një përjashtim. Është e mundur që blerësi të organizojë transportin e mallit, por vendi i dorëzimit të mallit nuk është selia e shitësit (neni 31, pika c, Konventa e Vjenës), por as vendi ku gjendet malli (neni 31, pika b, Konventa e Vjenës), por një vend tjetër si, për shembull, Selia e transportuesit.¹⁰⁵ Atëherë do të vinte deri tek aplikimi i nenit 31, pika a e Konventës së Vjenës dhe pranë kësaj që shitësi nuk ka organizuar transportin e mallit. Si vërtetim i kësaj shtohet fjalia e dytë, neni 67, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës e cila parasheh se nëse shitësi është i detyruar që mallin t'ia bartë transportuesit në vendin e caktuar, rreziku për shitësin kalon në momentin që ai ia dorëzon mallin transportuesit po në atë vend. Sipas mendimit tonë, kjo është e gabuar. Domethënë, nëse palët janë marrë vesh, që si vend të dorëzimit të mallit kanë paraparë një vend tjetër ose nëse ai vend kalon nga tradita e praktikës së punës, kjo do të thotë se dorëzimi duhet të kryhet në vendin e caktuar, që dorëzimi të kryhet te vendi i caktuar i dorëzimit sipas kontratës së shitjes dhe nuk do vij fare deri te aplikimi i nenit 31 i Konventës së Vjenës.

Qëllimi i transportit pa ekuivoke është shprehur në nenin 31 pika (a) e Konventës së Vjenës sepse është e nevojshme që ai të merret parasysh për hir të dorëzimit të mallit te blerësit. Prandaj, të gjitha llojet e tjera të transportit, që nuk kanë për qëllim dorëzimin e mallit te blerësit, por të kthyerat për destinime të tjera nuk janë të pranuar me këtë rregull. Kështu, për shembull, transporti i mallit nga furnizuesi i shitësit deri te blerësi nuk paraqet transport në kuptimin e nenit

¹⁰³ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq. 415.

¹⁰⁴ Kjo situatë është e rregulluar me nenin 3, pika b dhe c të *Konventës së Vjenës*.

¹⁰⁵ Shih më shumë: Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 495.

31 pika (a) e Konventës së Vjenës. Nga ana tjetër mund të flasim për transportin e mallit nëse porositeti i mallit, me urdhër të shitësit, mallin do ta drejtojë nga blerësi. Puna tranzitore duhet të ndryshojë nga shitja e mallit që ndodhet në transport. Nëse kontrata e shitjes, e cila ndodhet në transport, shuhet kjo nuk është kontratë sipas neni 31 pika (a) e Konventës së Vjenës.

E fundit, transporti i mallit mund të jetë pasojë e kontratës së shitjes. Vetë Konventa e Vjenës nuk konstituon përgjegjësinë e shitësit për organizimin e transportit të mallit, por ajo duhet të dalë si pasojë e palëve. Sipas mendimit tonë duhet të konsiderohet që me kontratën për shitjen e mallit duhet që përfshihet edhe transporti dhe jo vetëm në rastet kur palët në mënyrë eksplicite në kontratë kanë rënë dakord për transport të mallit, por edhe atëherë kur transporti i mallit del nga tradita¹⁰⁶ ose nga praktika e themeluar në mes të palëve.¹⁰⁷ Përgjegjësia e transportit të mallit më së shpeshti do të dalë nga kontrata, por ka mundësi që ajo ekziston në bazë të zakonit ose të praktikës së zbatuar në mes të palëve kontraktuese. Prandaj, mendojmë se në këtë rast nevojitet vullneti i dyja palëve kontraktuese që malli të transportohet, dhe kjo mund të lindë jo vetëm nga një kusht i shprehur, por nga zakoni dhe praktika e krijuar në mes të palëve kontraktuese. Nëse nga kontrata nuk del se malli duhet të transportohet, atëherë duhet të zbatohet neni 31 pika (b) ose neni 31 pika (c) e Konventës së Vjenës.¹⁰⁸

III. 3.1.1.2.2. Transportuesi

Transportues është subjekti që si veprimtari të rregullt të tij merret me transportime për subjektin tjetër që, me kontratë obligohet të bëj transportime për pagesa.¹⁰⁹

Nëse kontrata e shitjes e parasheh transportin e mallit, shitësi duhet që mallin ta dorëzojë tek transportuesit e parë. Që të sqarojmë se kur shitësi ka përmbushur detyrimin, është e nevojshme që të njohim afatin kur transportuesi e merr, si dhe cili është transportuesi i parë.

¹⁰⁶ *Konventa e Vjenës*, neni 9, paragrafi 2.

¹⁰⁷ Po aty, neni 9, paragrafi 1.

¹⁰⁸ Shih më gjërësisht neni 31 pikat, b dhe c Konventa e Vjenës: (b) në venien e mallrave në dispozicion të blerësit në atë vend, në qoftë se, në rastet e papërfshira në nënparagrafin e mësipërm, kontrata ka të bëjë me mallra specifike, ose mallra të paidentifikuara për t'u marrë nga një magazinë e veçantë apo për t'u fabrikuar ose prodhuar, dhe në kohën e lidhjes së kontratës palët e dinin që mallrat ishin apo ishin për t'u fabrikuar ose prodhuar në një vend të posaçëm; c) në raste të tjera-në venien e mallrave në dispozicion të blerësit në vendin ku shitësi kishte vendin e tij të biznesit në kohën e lidhjes së kontratës.

¹⁰⁹ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq. 415.

Transportuesi, të cilit shitësi duhet t'i dorëzojë mallin, duhet kuptuar secila ndërmarrje e pavarur e cila duhet të kryejë transportin e mallit, qoftë në tërësi, qoftë pjesë - pjesë për dorëzimin e mallit.¹¹⁰

Nga nocioni i sipërm shohim se transportuesi duhet të jetë personi i tretë i cili është i ndryshëm dhe i pavarur nga shitësi. Njëkohësisht nga kjo mund të nxjerrim se me transportin kuptojmë lidhje të një kontrate tjetër shtesë, kontratë e cila lidhet në mes të shitësit dhe personit të tretë (transportuesit). Kontratë e cila lidhet për shkak të përmbushjes së kontratës së lidhur në mes shitësit dhe blerësit. Transportuesi është subjekt i pavarur, mund të jetë edhe person fizik edhe juridik dhe duhet të ketë zotësi veprimi. Transportuesi detyrohet që subjektin e caktuar ta transportojë në vendin e kërkuar, apo, sendin e caktuar ta transportojë në vendin e kontraktuar, ndërsa, udhëtari përkatësisht dërguesi i sendit, detyrohet që atij, për atë shërbim, t'ia paguajë çmimin e kontraktuar.¹¹¹ Për transportuesin e pavarur mund të flasim nëse flitet për subjektin juridik, që ka zotësi juridike dhe zotësi veprimi, i cili mund të përmbushë me shitësin kontratën e plotfuqishme për transport.¹¹² A contrario, nuk llogaritet si transportues pala e cila është punësuar te shitësi dhe që sipas urdhrit të tij e transporton mallin.

Transportuesi është i detyruar që, sendin të cilin e merr për transportim, dërguesit të tij t'ia dorëzojë në vendin dhe në kohën e caktuar në kontratë.¹¹³ Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend tjetër të caktuar, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve.¹¹⁴

Shumë shpesh palët merren vesh që shitësi është i obliguar që mallin ta transportojë te blerësit. Në këtë rast nuk mund të aplikohet neni 31 pika (a) e Konventës së Vjenës sepse për përmbushjen e dorëzimit nevojitet që shitësi të zbatojë dorëzimin të transportuesit, gjegjësisht nevojitet që shitësi t'i dorëzojë transportuesit posedimin e mallit. Çka nënkupton dhe ka njëllojshmëri në mes të legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar. Edhe KCSH-ja edhe LMD-ja e kanë të rregulluar këtë dispozitë. Nëse shitësi transporton mallin te blerësi, atëherë nuk ka dorëzim të posedimit dhe dorëzimi përmbushet vetëm me dorëzimin e mallit te blerësi.

¹¹⁰ Peter Schlechtriem. (2000). *Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht*, 3. völlig neubearbeitete Auflage, München, 2000, fq. 321.

¹¹¹ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq. 415.

¹¹² Shih më shumë: Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 349.

¹¹³ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq. 415.

¹¹⁴ KCSH, neni 711, paragrafi 2.

Gjithashtu, nëse shitësi zbaton pjesën e transportit detyrimi përmbushet me dorëzimin e mallit transportuesit të parë dhe të pavarur.¹¹⁵ Në rastin kur sipas kontratës nevojitet që të bëhet transportimi i sendeve, ndërsa në kontratë nuk është caktuar vendi i përmbushjes, dorëzimi quhet i kryer me dorëzimin e sendit transportuesit ose personit i cili e organizon transportin.¹¹⁶

Në këtë mënyrë përcaktimi i nocionit të transportit vjen deri te ndarja e përgjegjësisë dhe rrezikut, sipas së cilës shitësi ka përgjegjësi vetëm për rrezikun të cilin e bart vetëm deri te blerësi. Në këtë rast, shitësi përgjigjet për të gjitha gabimet, dëmet dhe mungesat që ndodhin gjatë transportit për dorëzimin e mallit, të cilat i kryejnë të punësuarit e tij dhe ai është përgjegjës për veprimet e tyre. Nëse shikojmë nga ana tjetër, me dorëzimin e mallit, shitësi humb posedimin faktik mbi mallin dhe nuk përgjigjet më për dëmtimet, që krijohen me shuarjen e kontratës për transportin. Shitësi është i detyruar që me kujdes dhe respekt ndaj blerësit të përzgjedhë transportuesin, me të cilin shuhet kontrata për transportin dhe të kujdeset për interesin e blerësit.¹¹⁷ Sipas kësaj, shitësi përgjigjet për përzgjedhjen e transportuesit, por jo për punën e tij. Përgjigjet për përzgjedhjen e transportuesit sepse shitësi e përzgjedh atë sipas dëshirës së tij. Shitësi lidh kontratë me transportuesin në mënyrë që malli të dorëzohet te blerësi. Ai e lidh kontratën me personin e tretë në mënyrë që të përmbushë detyrimin e tij nga kontrata e tij e parë.

Shitësi, sipas nenit 31 pika (a) e Konventës së Vjenës si dhe sipas nocionit të përgjithshëm për transportin, transportuesi përfshinë të gjitha llojet e transportit si atë ajror, detar, lumor, tokësor dhe hekurudhor. Për atë që në teorinë e shitjes ndërkombëtare të mallit ka qenë lëndë e mosmarrëveshjeve, lind pyetja se: a mund të konsiderohet shpedicioni si transportues në bazë të nenit 31 pika (a) e Konventës së Vjenës? Gjegjësisht, a mund të përmbushet detyrimi me dorëzimin e mallit te shpedicionit? Sipas ligjeve kombëtare kjo çështje rregullohet në mënyra të ndryshme. Me vetë faktin përgjigjja në pyetjen se a mund të llogaritet shpedicioni si transportues varet nga të drejtat në selinë e tij.¹¹⁸ Sipas mendimit tonë, pa marrë parasysh zgjidhjet e ndryshme sipas asaj sesi e rregullojnë legjislacionet vendore, përgjigje në pyetje mund të sjellë pozita e shpedicionit. Shpedicionerin mund ta llogarisim si person të tretë, i cili është përgjegjës për organizimin e transportit të mallit. Nëse shpedicioni e organizon transportin e mallit, por jo duke mos e dorëzuar mallin, ai nuk mund të llogaritet si transportues

¹¹⁵ Shih më shumë: Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, fq. 348; gjithashtu, Bamberger, Roth, Kommentar zum Bürgerlichen Gesetzbuch, Band 3, München, 2003, fq. 2810.

¹¹⁶ LMD, neni 455.

¹¹⁷ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2810; po ashtu, Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 496.

¹¹⁸ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 253.

në bazë të nenit 31 pika (a) e Konventës së Vjenës, se shitësi e përmbush detyrimin me dorëzimin e mallit tek transportuesit të cilin e ka udhëzuar shpediteri. Përkundër kësaj, te pjesëmarrja e pavarur e shpediterit, kur ai vetë përmbush të gjitha apo një pjesë të transportit të mallit, pozita e tyre është e njëjtë me transportuesin e pavarur dhe me dorëzimin e mallit shpediterit, shitësi përmbush detyrimin e tij. Megjithatë, parashtrohet pyetja, a e ka dorëzuar shitësi mallin, nëse ia ka dorëzuar shpedicionit? Shpedicioni më pastaj duhet të organizojë transportin e tij. Kjo do të thotë që malli për një kohë të shkurtër ndodhet te shpedicioni dhe që ai më vonë e bën dorëzimin e mallit tek transportuesit. Dy përgjigje janë të sakta. E para, mund të llogaritet që shitësi me dorëzimin e mallit te shpediteri ka përmbushur detyrën e tij kryesore. E dyta, me dorëzim mund të llogaritet dorëzimi i mallit tek transportuesit e parë nga ana e shpediterit dhe derisa malli të ndodhet në posedim të shpediterit, atë duhet ta konsiderojmë si magazinier i shitësit.¹¹⁹ Sipas kësaj teorie¹²⁰ dhe sipas mendimit tonë, që mendojmë se është i drejtë, duhet të llogaritet se shitësi ka përmbushur detyrimin kur mallin ia dorëzon shpediterit. Këtë qëndrim e përkrahin së paku dy arsye. E para, shpediteri është i pavarur dhe e dyta, shitësi me dorëzimin e mallit bart te shpediteri posedimin faktik dhe juridik të mallit për shkak të përmbushjes së detyrimit ndaj blerësit. Dorëzimi i mallit blerësit ose përmbushja e detyrimit të shitësit të përcatuar me kontratë nuk do të ishte i mundur duke bërë dallimin në mes dorëzimit të mallit subjektit i cili merr transportin dhe bën bartjen e mëtutjeshme të mallit te një transportues tjetër, dhe në këtë mënyrë shitësi bartë posedimin faktik e jo atë juridik të mallit te pala tjetër me qëllim që malli të dorëzohet nga ky subjekt te blerësi. Shpediteri obligohet që për transportimin e sendit të caktuar, në emrin e vet dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, të kontraktojë për transportim si dhe të kryejë detyrime kontraktuese të tjera të nevojshme për realizimin e transportimit, ndërsa urdhërdhënësi është i detyruar, që atij për atë punë, t’ia paguajë kompensimin e kontraktuar.¹²¹

LMD-ja e rregullon çështjen e shpedicionit në kuadër të kontratës së shpedicionit, e cila është kontratë me emër dhe kontratë e dyanshme detyruese. Edhe kjo kontratë lidhet nga ana e shitësit me personin e tretë sikurse kontrata e transportit. LMD-ja e përkufizon si më poshtë. Me kontratën për shpeditimin detyrohet shpedituesi që me qëllim transporti të sendit të caktuar, të

¹¹⁹ Tako & Heinz Georg Bamberger & Herbert Roth, *vepër e cituar*, fq. 2810.

¹²⁰ Tako & Heinz Bamberger & Herbert Roth, *vepër e cituar*, 2003, fq. 2810; Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 496. Shih më shumë: Peter Schlechtriem & Ingerborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 349; Wilhelm Albrecht Achilles, (2000). *Kommentar zum UN-Kaufrechtsübereinkommen (CISG)*, Luchterhand, fq. 79.

¹²¹ Riza Smaka, *vepër e cituar*, fq. 417.

lidhë në emër të vet dhe për llogari të urdhërdhënësit kontratën e transportit dhe kontrata të tjera të nevojshme për kryerjen e transportit, si dhe të kryejë punë dhe veprime të tjera të rëndomta, ndërsa urdhërdhënësi detyrohet t'i paguajë shpërblim të caktuar.

Në qoftë se në kontratë është paraparë, shpedituesi mund të lidhë kontratën e transportit dhe të ndërmarrë veprime të tjera juridike në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit.¹²²

Nëse me transport të mallit nga shitësi te blerësi marrin pjesë më shumë transportues shitësi përmbush detyrimin e tij me dorëzimin e mallit tek transportuesit e parë.

III. 3.1.1.2.3. Dorëzimi i mallit

Nëse sipas kontratës për shitjen e mallit duhet të bëhet transporti, detyrimi i shitësit për dorëzimin e mallit qëndron te dorëzimi i mallit transportuesit të parë. Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend tjetër të caktuar, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve.¹²³ Që të mund të flasim për dorëzimin nevojitet që shitësi të plotësojë veprime të ndryshme dhe me qëllime të caktuara.

Dorëzimi i sendit do të thotë të vihet blerësi në lidhje materiale me sendin.¹²⁴ Legjislacioni pozitiv kombëtar rregullon dorëzimin me Kodin Civil dhe me LMD-në. Shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar në kontratë.¹²⁵ Të dyja palët kontraktuese në shumicën e rasteve e përcaktojnë vendin dhe kohën e dorëzimit të mallit.

Në rastin kur sipas kontratës nevojitet që të bëhet transportimi i sendeve, ndërsa në kontratë nuk është caktuar vendi i përmbushjes, dorëzimi quhet i kryer me dorëzimin e sendit transportuesit ose personit i cili e organizon transportin.¹²⁶

Dorëzim domethënë kalim i posedimit juridik të mallit “kalim i detyrimit të ruajtjes së mallit tek transportuesit”¹²⁷ Përmbajtja e qëllimit të dorëzimit të mallit, gjegjësisht cilat veprime duhet të ndërmarë shitësi, varet nga ajo se për çka janë marrë vesh palët kontraktuese. Në

¹²² LMD, neni 848, paragrafi 1 dhe 2.

¹²³ KCSH, neni 711 paragrafi 2.

¹²⁴ Nerxhivane Dauti, *vepër e cituar*, fq.310.

¹²⁵ LMD, neni 450.

¹²⁶ LMD, neni 455.

¹²⁷ Wilhelm Albrecht Achilles, *vepër e cituar*, fq. 80.

secilin rast vendosja e mallit në posedim të transportuesit, si dhe përgatitja e mallit për dërgim nuk mund të llogariten si dorëzim. Më së shpeshti janë veprime të cilat shitësi është i detyruar t'i ndërrmarë dhe këto veprime janë të caktuara me klauzola dhe me lloje të veçanta të transportit. Shitësi mund të ketë detyrim që mallin ta përgatis deri te mjeti transportues, e në rastet tjera, edhe t'i ngarkojë në mjetin e transportit dhe të vendosin mjetet që janë të përshtatshme për atë lloj malli. Tek transporti detar, për shembull, shitësi ka përmbushur detyrimin e tij me dorëzimin e mallit në port FAS ose do të jetë i detyruar që mallin ta dorëzojë brenda në anije. Është e mundur që transportuesi të vijë në delinën e shitësit dhe të marrë mallin nga tubat të cilat shitësi i ka caktuar më herët.¹²⁸

Në rastet e të ashtuquajturës punë transitore, kur malli dorëzohet direkt nga furnizuesi i shitësit deri te blerësi, detyrimi është përmbushur kur furnizuesi e dorëzon mallin tek transportuesit. Furnizuesi konsiderohet si ndihmës i shitësit dhe për këtë shitësi përgjigjet për punën e tij sikur të ishte i veti.¹²⁹ Dorëzimi është realizuar kur shitësi ka marrë në posedim fizik sendin me qëllim të transportit të tij.¹³⁰ Transportuesi duhet të pranojë mallin, gjegjësisht duhet të jetë fizikisht i pranishëm me rastin e ngarkimit. Nëse shitësi e ngarkon transportin në mungesë të transportuesit, detyrimi është përmbushur vetëm atëherë kur transportuesi e merr kontrollin e veturës.¹³¹ Nuk ekziston dorëzimi, kur transportuesi e merr posedimin indirekt ose kur dorëzohen dokumentet në bazë të së cilës ai mund të posedojë edhe mallin.¹³² Për porosinë e duhur është e nevojshme që transportuesit duhet t'i dorëzohet malli, por, jo dokumentacioni. Në rastet kur shitësi asnjëherë nuk i dorëzon dokumentacionin blerësit, ai e ka përmbushur detyrimin me dorëzimin e mallit transportuesit të parë. Në vështirim të parë, dokumentacioni i cili nuk është dorëzuar, blerësi do ketë në posedim të tij mjetet juridike të parapara me marrëveshjen dhe me Konventën e Vjenës.¹³³

Detyrimi duhet të përmbushet për shkak të transportit të mallit dhe dorëzimin e tij te blerësit. Për këtë qëllim, shitësi është i detyruar që transportuesit t'i japë adresën e saktë ku duhet të dorëzohet malli. Nëse shikojmë nga ajo që është potencuar më lart, rrjedh se dorëzimi i

¹²⁸ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 253.

¹²⁹ Shih më shumë: Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 497.

¹³⁰ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 350.

¹³¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 351.

¹³² Wilhelm Albrecht Achilles, *vepër e cituar*, fq. 80.

¹³³ Shih më shumë: Albert H. Kritzer. (1989) *Guide to Practical Application of the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, Deventer, fq. 232.

mallit pa qëllim konkret, ose me qëllim që ky mall të magazinohet, nuk paraqet përmbushje, e cila përkon me nenin 31 pika (a) e Konventës së Vjenës.

III. 3.1.1.2.4. Vendi i dorëzimit

Kur duhet të dorëzohet malli, atëherë palët kontraktuese vendin e dorëzimit mund ta caktojnë, por edhe mund të mos e caktojnë. Vendi i dorëzimit caktohet me marrëveshjen e shitësit dhe blerësit. Në rast se vendi i dorëzimit nuk është caktuar në kontratë, dorëzimi i sendit bëhet në vendin të cilin shitësi, në çastin e lidhjes së kontratës, e ka pasur vendbanim, ose në mungesë të këtij merret vendqëndrimi.¹³⁴

Në rastet kur shitësi është i detyruar ta dërgojë mallin në një vend tjetër nga vendi i dërgimit, dërgimi konsiderohet të jetë kryer kur malli i është dorëzuar transportuesit.¹³⁵ Në rastet kur malli dorëzohet në ndonjë vend tjetër, atëherë vendi i përmbushjes për shitësin nuk është caktuar, dorëzimi konsiderohet se është bërë me dorëzimin e sendit transportuesit.

Në nenin 31 pika (a) në Konventën e Vjenës, vendi i dorëzimit të mallit nuk është i përcaktuar shprehimisht. Shpesh vendi i dorëzimit të mallit tejkalon kontratën, zakonet ose praktikën e krijuar në mes të palëve kontraktuese. Në praktikë shumë shpesh do të jetë e kontraktuar ndonjëra nga klauzolat që përmban INCOTERMS, dhe me të do të caktohet vendi i dorëzimit të mallit. Nëse vendi i dorëzimit është i caktuar, atëherë përmbushja mund të kryhej vetëm me dorëzimin e mallit në atë vend të caktuar.

Nëse vendi i dorëzimit të mallit nuk është i përcaktuar atëherë shitësi është i lirë që mallin t'ia dorëzojë transportuesit të parë në cilindo vend që është i përshtatshëm për përmbushjen e detyrimit. Më e shpeshta do ishte selia e tyre. Natyrisht, në momentin e përmbushjes së detyrimit, shitësi për përmbushjen e detyrimit duhet të veprojë me mirëbesim dhe në harmoni me nenin 7, paragrafin 1, të Konventës së Vjenës.

Kjo do të thotë që ai nuk mund të urdhërojë vendin e përmbushjes së detyrimit, sepse kjo do të çonte deri te rritja e shpenzimeve për blerësin dhe në rritjen e rrezikut.¹³⁶ Ose kjo do të

¹³⁴ Nerxhivane Dauti, *vepër e cituar*, fq. 312.

¹³⁵ Po aty, fq. 312.

¹³⁶ Shih më shumë: Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 497.

çonte në shtyrjen e kohës së transportit dhe në rritje të dukshme të shpenzimeve të transportit.¹³⁷ Si dhe mospërbushje në kohë të detyrimit të shitësit, me ç'rast edhe kontrata nuk do të shuhej ashtu siç është planifikuar.

III. 3.1.1.3. Dorëzimi i mallit te blerësi

Detyrimi kryesor i shitësit është dorëzimi i mallit te blerësit. Këtë detyrim shitësi e zbaton në bazë të kontratës së lidhur në mes të palëve kontraktuese. Palët kontraktuese sipas dëshirës së tyre përcaktojnë vendin dhe kohën e dorëzimit të mallit sipas dëshirës së tyre. Dorëzimi i mallit ndryshon varësisht nga objekti i cili duhet të dorëzohet. Varësisht nga ajo se malli a duhet të jetë i luajtshëm apo i paluajtshëm ndryshon edhe vendi i dorëzimit të tyre. Për sa u përket sendeve të paluajtshme, dorëzimi bëhet nëpërmjet dhënies së titullit të pronësisë, që do të thotë të aktit që vërteton kalimet e mëparshme, nëse paraqitet nevoja deri brenda kufirit të parashkrimit tridhjetëvjeçar.¹³⁸ Kjo njëkohësisht paraqet fitim derivativ i të drejtës subjektive. Fitim derivativ kemi, kur personiu të drejtën e fiton nga person i ciliu, këtë të drejtë e bartë në fituesin e ri.¹³⁹ Ndërsa te sendet e luajtshme çështja është ndryshe sepse dorëzimi bëhet nëpërmjet dorëzimit konkret të sendit (traditë reale).¹⁴⁰ Nëse kontrata e shitjes nuk parasheh transportin e mallit dhe nëse përbushja nuk duhet të përbushet në ndonjë vend tjetër, shitësi e përbush detyrimin me dorëzimin e mallit në posedim të blerësit. Prandaj, përmbajtja e përbushjes së detyrimit ka të bëjë me ndërmarrjen e veprimeve të cilat paraqesin vendosjen e mallit në posedim të blerësit. Çështja është shumë e lehtë në rastet kur malli është send i luajtshëm. Çështja është më e ndërlikuar kur sendi është send i paluajtshëm.

Konventa e Vjenës bën dallim në mes vendit të përbushjes së detyrimit kur është i caktuar lloji i mallit me rastet e tjera. Nëse si detyrim i kontratës është sendi individualisht i përcaktuar, ose sendi sipas gjinisë të cilat duhen ndarë nga një masë e gjerë ose duhet të prodhohen ose të ndërtohen, dhe në kohën e shuarjes së detyrimit (kontratës) palët kanë qenë në njohuri që malli është në një vend të caktuar ose do të duhej të krijohej ose të prodhohet në një vend të caktuar, atëherë, shitësi është i detyruar që mallin t'ia lërë në posedim blerësit në atë

¹³⁷ Wilhelm Albrecht Achilles, vepër e cituar, fq. 80. Poashtu : Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, vepër e cituar, fq. 351.

¹³⁸ Georges Vermelle. (2006). “E Drejta Civile, Kontratat –Pjesa e Posaçme”, Tiranë, fq.47.

¹³⁹ Abdulla Aliu. (2013). “E Drejta Civile”. Universiteti i Prishtinës, “Hasan Prishtina”, Prishtinë, fq.437.

¹⁴⁰ Georges Vermelle. (2006). “E Drejta Civile, Kontratat –Pjesa e Posaçme”, Tiranë, fq. 47.

vend.¹⁴¹ Kjo është e pranishme në rastet kur duhet të ndërtohen sende të cilat janë të paluajtshme dhe janë të ngulitura për tokën. Në këto raste vendi i dorëzimit duhet të jetë vendi ku është ndërtuar malli i planifikuar. Në të gjitha rastet e tjera, shitësi është i detyruar që blerësit t’ia dërgojë mallin në posedim në vendin që në kohën e përmbushjes së detyrimit e ka pasur selinë e tij.¹⁴² Neni 31 pika (c) e Konventës së Vjenës paraqet rregullore të përgjithshme se detyrimet që nuk ishin në para duhet të përmbusheshin në selinë e debitorit.¹⁴³

Dorëzimi i sendit bëhet në vendin ku palët janë marrë vesh për dorëzimin e sendit dhe vetëm nëse palët kontraktuese bien dakord mund të ndodhë ndryshe.

Sipas kësaj rregulle në mungesë të marrëveshjes tjetër të palëve kontraktuese, debitori do të duhej ta përmbushte detyrimin në mënyrën që e ka më të lehtë për përmbushje të detyrimit.¹⁴⁴ Në të dyja rastet blerësi është i detyruar që ta marrë mallin nga vendi ku malli ndodhet, gjegjësisht ku atij i është lënë. Sipas kësaj, paragrafet b dhe c, parashohin detyrimin, detyrim i cili përmbushet në vendin e debitorit.

Në bazë të asaj që në rastet e cekura përmbajtja e detyrimit është e njëjtë fillimisht duhet përcaktuar se çka nënkuptohet me vendosjen e mallit në posedim blerësit. Pas kësaj më tej do analizojmë vendin e përmbushjes, gjegjësisht vendin nga i cili ose në të cilin blerësi duhet të marrë mallin. Shpenzimet e dorëzimit bien mbi shitësin. Por shpenzimet e transportit përballohen nga blerësi. Gjithsesi kjo varet përsëri nga marrëveshja e palëve kontraktuese.

III. 3.1.1.3.1. Vendosja e mallit në posedim të blerësit

Shitja është një kontratë e dyanshme. Te disa legjislacione bartja e pronësisë bëhet me kontratë, ndërsa te disa të tjera përveçse lidhet kontrata për shitjen nevojitet të lidhet edhe kontrata për bartjen e pronësisë. Ka raste kur si pronar blerësi mund të jetë vetëm nëse plotësohen disa kushte të cilat KCSH-ja i numëron në mënyrë taksative në nenin 166. Si pronar i sendit mund të bëhen personat të cilët kanë blerë mall nga një person tjetër nëse së pari është lidhur një kontratë me shpërblim, e dyta kur objekt i kontratës është send i luajtshëm, dhe e treta

¹⁴¹ Konventa e Vjenës, neni 31 pika b.

¹⁴² Shih më shumë: Konventa e Vjenës nenin 31, pika c.

¹⁴³ Neni 7, paragrafi 1, pika b, PECL, Neni. 6.1.6 paragrafi 1, pika b.

¹⁴⁴ Shih më shumë: Ole Lando & Hugh Beale. (2000) “*Principles of European Contract Law – Parts I and II*”, Combined and Revised, The Hague, Boston, London, fq. 330.

të ekzistojë mirëbesimi. LMD-ja nuk e parasheh një mundësi të tillë, sepse ai përcakton se blerësi nuk mund të jetë pronar i mallit nëse shitësi nuk ka pasur pronësi në sendin e shitur. Për fitimin e pronësisë në një send të luajtshëm është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit të pronësisë si dhe dorëzimi i sendit të fituesit të pronësisë.¹⁴⁵ Në raste të tilla kjo kontratë shpallet e pavlefshme. Sepse askush nuk mund të bartë të drejtat e të tjerëve nëse vetë nuk i posedon ato të drejta. Shitja e sendeve të paluajtshme, në çdo rast, jo vetëm duhet të bëhet në formën e kërkuar shprehimisht me ligj, por, mbi të gjitha, të drejtën për të shitur një send të paluajtshëm e ka vetëm personi, i cili është pronar i sendit të paluajtshëm, personi fizik vendës ose i huaj, personi juridik privat vendës ose i huaj, personi juridik publik kompetent, pra, vetëm organi shtetëror apo ndërmarrja shtetërore së cilës ligji i ka njohur shprehimisht kompetencën për të shitur sende të paluajtshme).¹⁴⁶

Malli është lënë në dispozicion, kur shitësi ka bërë çdo gjë që ka qenë e nevojshme që blerësit t'i mundësohet që ta fitojë posedimin mbi mallin¹⁴⁷. Prandaj shitësi duhet t'ia mundësojë blerësit mundësinë, kështu që ky, nuk mund të bëjë asgjë vetëm të posedojë. Nga ana tjetër për përmbushjen e detyrimit nuk është me rëndësi a ka ndërmarrë blerësi të gjitha veprimet e duhura për marrjen e detyrimit. Nga kjo mund të themi që përmbushja e detyrimit është veprim i njëanshëm (unilateral) i shitësit, dhe që shitësi duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e mallit ashtu siç ata janë marrë vesh në kontratë. Në krahasim me këtë zgjedhje të Konventës së Vjenës, ULIS ka e parë të nevojshme dorëzimin e mallit. Përmbushja nënkupton veprimet e dyanshme apo bilaterale të shitësit dhe blerësit.¹⁴⁸ Çka edhe e karakterizon kontratën e shitjes si kontratë të dyanshme detyruese. Nëse shitësi e dorëzon mallin të blerësi, blerësi është i detyruar që mallin ta marrë nga shitësi. Shitësi duhet të dorëzojë sendet në gjendjen që ato ishin në çastin e lidhjes së kontratës.¹⁴⁹

Veprimet, që duhet t'i ndërmarrë shitësi, duhet më së shpeshti të përfshijnë identifikimin e mallit i cili duhet të jetë i dorëzuar, ashtu si është paketimi dhe dhënia e paralajmërimit të blerësit i cili do t'ju mundësonte posedimin dhe fitimin e pronësisë.¹⁵⁰

¹⁴⁵ *Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore*, neni 21, paragrafi 1, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr 03/L-154.

¹⁴⁶ Besnik Maho. (2009). *Fitimi i pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme*, Universiteti European i Tiranës, Tiranë.

¹⁴⁷ Shih më shumë: *UN DOC. A/CONF. 97/5 (Komentari i UNCITRAL-it)*, Official Records, fq. 30.

¹⁴⁸ Shih më shumë: Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 255.

¹⁴⁹ *KCSH*, neni 711.

¹⁵⁰ Sipas *UN DOC. A/CONF. 97/5 (Komentari i UNCITRAL-it)*, Official Records, fq. 30.

Identifikimi i mallit nënkupton çështjen e saj në masë të caktuar ose vendosjen e shenjave në të. Shitësi nuk është i detyruar të identifikojë mallin, nëse identifikimi i tij është i mundur me ardhjen e blerësit.¹⁵¹ Malli në dispozicion, do të llogaritet vetëm malli i cili është i përshtatshëm për transport. Nëse malli mund të transportohet vetëm i ambalazhuar, atëherë shitësi ka detyrim të sigurojë ambalazhin e përshtatshëm. Nëse shitësi mallin nuk e ambalazhon, dhe për këtë shkak nuk mund të jetë e përshtatshme që malli të transportohet, ai nuk e ka përmbushur detyrimin e tij kontraktor.

Kur malli është i gatshëm për përmbushje të detyrimit (dorëzim), nëse shitësi ka marrë përsipër të kryejë për të gjitha ato që ka qenë i detyruar dhe nuk është caktuar koha e saktë e dorëzimit të mallit, shitësi është i detyruar që ta lajmërojë blerësin për mallin. Nëse shitësi dërgon lajmërimin në mënyrën e caktuar rreziku i vonesës, humbjes ose dëmeve dhe i mungesave të transportimit i bart blerësi.¹⁵² Megjithatë, pasi rreziku të blerësi kalon vetëm atëherë kur mallin e ka në dispozicion, gjegjësisht me përmbushjen e detyrimit.¹⁵³ Shitësi në rast se vjen deri te paraqitja e problemit me dorëzimin e lajmërimit, ka interes që ta dërgojë përsëri lajmërimin që detyrimi i pagesës së çmimit krijohet vetëm atëherë kur blerësit malli i vendoset në posedim.¹⁵⁴

Vendosja e mallit në posedim nuk nënkupton detyrimin e shitësit që mallin ta ngarkojë në mjetin e transportit. Shitësi është i detyruar që mallin ta ngarkojë vetëm në rastet e dorëzimit të mallit, por, jo në rastet e dhënies në posedim.¹⁵⁵ Kur shitësi e përmbush detyrimin me vendosjen e mallit në posedim, atëherë detyrimi i ngarkimit bie në veprimin e marrjes së mallit, detyrim të cilin e ka detyrim ta kryejë blerësi.¹⁵⁶ Shpenzimet bien mbi shitësin për dorëzimin e mallit, shpenzimet e transportit përballohen nga blerësi.¹⁵⁷

Natyrisht palët mund të merren vesh që detyrimi i shitësit është që ta ngarkojë mallin. Nuk bie në detyrimin e përmbushjes, por ka të bëjë me detyrimin shtesë të shitësit.¹⁵⁸ Ndarja është shumë e rëndësishme sepse mospërmbushja e ngarkesës në këtë rast nuk ngarkon me përgjegjësi shitësin për mospërmbushje të detyrimit.

¹⁵¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 358.

¹⁵² *Konventa e Vjenës*, neni 27.

¹⁵³ *Konventa e Vjenës*, neni 67, paragrafi 2.

¹⁵⁴ *Konventa e Vjenës*, neni 58, paragrafi 1.

¹⁵⁵ Shih më shumë: Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 359.

¹⁵⁶ *Konventa e Vjenës*, neni 60.

¹⁵⁷ Georges Vermelle, *vepër e cituar*, fq. 48.

¹⁵⁸ Shih më shumë: Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 498.

Malli nuk është i vendosur në posedimin e blerësit, nëse shitësi për dorëzimin e tij kërkon nga blerësi përmbushjen e kushteve të caktuara. Për përmbushje nuk është e mjaftueshme që malli të jetë fizikisht në posedim të blerësit, por nevojitet që shitësi të jetë i pajtimit për marrjen e mallit në dispozicion nga ana e blerësit¹⁵⁹. Situata do të jetë ndryshe nëse në të njëjtën kohë me marrjen e mallit duhet të kryhet edhe pagesa e çmimit.¹⁶⁰

Nëse malli gjendet te personi i tretë, për shembull nëse ajo është e vendosur në një magazinë të pavarur, malli duhet t'i vendoset në posedim blerësit në atë vend. Në këtë rast shitësi do të përmbushë detyrimin dhe kështu blerësit do t'ia mundësojë marrjen e mallit nga magazina. Shitësi do të urdhërojë magazinierin që blerësit t'i dorëzohet malli ose blerësit t'i dorëzohet në magazinë ose në kontroll me anë të së cilës ai mund edhe ta tërheq atë. Nëse gjendet te personi i tretë, ai duhet të jetë i gatshëm që t'i dorëzohet blerësit. Në të kundërt të kësaj, nëse personi i tretë refuzon që blerësit t'ia dorëzojë mallin ose në rast se vendos kushte të tjera, të kundërta me kontratën që ka pasur me shitësin. Malli nuk është vendosur në posedim dhe shitësi nuk ka përmbushur detyrimin.¹⁶¹

Nëse është fjala për mallin, i cili shumë lehtë mund të përdoret, ajo është vendosur në posedim të blerësit, nëse ekziston marrëveshje e pakushtëzuar e shitësit për marrjen e tij.¹⁶² Nëse fituesi e ka në posedim sendin e luajtshëm, atëherë puna juridike e vlefshme është e mjaftueshme për kalimin e pronësisë.¹⁶³

III. 3.1.1.3.2. Vendi i ndodhjes së mallit si vend i përmbushjes së detyrimit

Nëse palët nuk janë marrë vesh për vendin e dorëzimit të mallit dhe nëse kontrata për shitjen nuk parasheh transportin e mallit, dhe lëndë e kontratës janë sendet individualisht të përcaktuara, ose sendet që sipas gjinisë duhen ndarë nga masa e caktuar ose nga sendet që duhet prodhuar ose përpunuar, dhe që në kohën e përmbushjes së kontratës palët kanë qenë të informuara se malli gjendet në vendin e caktuar ose duhet prodhuar apo krijuar në vendin e

¹⁵⁹ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 498.

¹⁶⁰ *Konventa e Vjenës*, neni 58, paragrafi 1.

¹⁶¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 361.

¹⁶² Wilhelm Albrecht Achilles, *vepër e cituar*, fq. 81. Po ashtu: Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 360.

¹⁶³ *Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore*, i Kosovës, neni 21, paragrafi 2.

caktuar, shitësi është i detyruar që mallin ta vendosë në posedim të blerësit në atë vend.¹⁶⁴ Për fitimin e pronësisë për një send të luajtshëm është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit të pronësisë si dhe dorëzimi i sendit të fituesit të pronësisë.¹⁶⁵ Për sendet e paluajtshme vlen rregulli që dorëzimi faktik bëhet në vendin ku ndodhen ato, kurse dorëzimi juridik bëhet në vendin ku gjendet gjykata dhe librat e tokës.¹⁶⁶

Në rastet e caktuara vendi i dorëzimit nuk është selia e shitësit, por ndonjë vend tjetër, neni 31 pika (b) e Konventës së Vjenës niset nga ajo që ai vend i përgjigjet vullnetit të lirë të palëve kontraktuese¹⁶⁷ dhe në bazë të kësaj shitësi është i detyruar t'i dorëzojë blerësit mallin e caktuar dhe mallin e njëjtë ta vendosë në dispozicion në vendin ku ndodhet malli.

Për aplikimin e normës së cekur është e nevojshme që palët të njihen, në kohën e shuarjes së kontratës, se ku ndodhet malli, ose ku do të gjendet në kohën e përmbushjes së kontratës. Edhe pse është e nevojshme njohuria e palëve, sipas mendimit tonë, këtu mendohet para së gjithash, për njohurinë e blerësit për atë se ku ndodhet sendi dhe kjo për dy arsye.

Së pari, shitësi rregullisht duhet të ketë njohuri për mallin dhe e dyta, blerësi duhet ta marrë mallin, gjegjësisht ka detyrimin e përmbushjes (marrjes së sendit), neni 60, Konventa e Vjenës, dhe është e nevojshme të di se ku ndodhet malli (sendi). Njohuria e blerësit për vendndodhjen e sendit duhet të jetë e vërtetë dhe duhet të ekzistojë në kohën e shuarjes së kontratës. Mungesa e njohurisë së palëve kontraktuese, në kohën e shuarjes së kontratës, si pasojë ka ndërrimin e rregullave nga neni 31 pika (c) e Konventës së Vjenës. Po ashtu vlen nëse blerësi më vonë rastësisht kupton, për shembull, se ku sendi do të prodhohet. Në këtë rast vendi i përmbushjes llogaritet të jetë selia e shitësit në kohën e shuarjes së kontratës, e jo vendi i prodhimit të mallit.

Gjithashtu, fakti që shitësi nuk ka mundur ta dijë¹⁶⁸ ose është dashur ta dijë¹⁶⁹ ku ndodhet malli nuk është e mjaftueshme. Neni 31 pika (b) e Konventës së Vjenës përdoret në shumë situata. Së pari nëse lëndë e kontratës është sendi individualisht i përcaktuar, shitësi e përmbush detyrimin kur i vë mallin në posedim blerësit në vendin ku malli ndodhet.

¹⁶⁴ Konventa e Vjenës, neni 31 pika b.

¹⁶⁵ Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, i Kosovës, neni 21, paragrafi 1.

¹⁶⁶ Nerxhivane Dauti, *vepër e cituar*, fq. 2001.

¹⁶⁷ Shih më shumë: Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 498.

¹⁶⁸ Peter Schlechtriem & Ingeborg Shwenzer, *vepër e cituar*, fq. 357.

¹⁶⁹ Herbert M. Kritzer, *vepër e cituar*, fq. 233.

Situata e dytë ekziston kur lëndë e kontratës është sendi gjenerik i cili duhet të ndahet nga masa e caktuar (p.sh. nafta 5 t, grurë të klasës së parë i cili ndodhet në mulli). Në këtë rast vendi i përmbushjes konsiderohet vendi ku ndodhet masa, e cila është e përcaktuar në gjini, dhe që duhet të ndahet. E treta, nëse lëndë e kontratës është malli i cili duhet të prodhohet më vonë, shitësi ose nga personi i tretë (p.sh. ndonjë makinë), vendi i përmbushjes do të jetë vendi ku ndodhet fabrika në të cilën do të prodhohet sendi. Në fund, kur lëndë e kontratës është malli që duhet prodhohet (si kafeja që duhet të prodhohet në plantacionin e kafesë), atëherë vendi i përshtatshëm është vendi i prodhimit të lëndës së kontratës.

Nëse do të flisnim sipas kontratës së shitjes, që ku duhet të transportohet malli dhe kur duhet të zbatohen normat e nenit 31 pika (a), e Konventës së Vjenës, shitësi asnjëherë nuk mund të përmbushë detyrimin. Nuk ka dorëzim të mallit te transportuesi, te blerësi ose përmbushje të detyrimit ndaj blerësit. Ky qëndrim nuk është gjithmonë i pranuar, por domosdo edhe në këtë rast palët, në kohën e shuarjes së kontratës së shitjes, e dinë ku ndodhet malli ose në cilin vend është malli që do të mbërrijë në posedim të blerësit.

III. 3.1.1.3. Selia e shitësit si vend i përmbushjes së detyrimit

Nëse nuk është e mundur aplikimi i nenit 31 pika (a) dhe neni 31 pika (b) e Konventës së Vjenës, atëherë shitësi duhet të porosisë mallin në vendin në të cilin ka pasur selinë në kohën e përmbushjes së detyrimit. Nëse shitësi në kohën e shuarjes së kontratës ka pasur më shumë se një seli, me mirëbesim do të jetë selia e cila ka lidhjen më të afërt me kontratën dhe përmbushjen e saj. Pastaj, nëse shitësi nuk ka pasur seli, vendi i dorëzimit është vendqëndrimi i tij aktual në kohën e shuarjes së kontratës.¹⁷⁰ Kur shitësi ndërron selinë, ai ka detyrimin që malli të dorëzohet në selinë e origjinës.

Por, që të funksionojë mirë dhe me mirëbesim dorëzimi i mallit duhet të bëhet malli, por edhe blerësi duhet të pranojë që përmbushja e detyrimit të bëhet në selinë e re, dhe nëse shitësi nuk e sjell mallin është e kuptueshme se ka shpenzime të pakuptimta dhe të mëdha. Në anën tjetër edhe shitësi duhet të veprojë me këtë normë dhe duhet të jetë i gatshëm që blerësit t'ia

¹⁷⁰ Konventa e Vjenës, neni 10 pika a dhe b.

kompensojë shpenzimet,¹⁷¹ të cilat blerësi i bën për shkak të marrjes së mallit në ndonjë vend tjetër. Shpenzimet e dorëzimit si dhe ato që i paraprijnë dorëzimit i bart shitësi, ndërsa shpenzimet e dërgimit të sendit dhe të gjitha shpenzimet e tjera pas dorëzimit i bart blerësi, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.¹⁷²

III. 3.1.2. Koha e përmbushjes

Të plotësosh ose të zbatosh kontratën do të thotë të ndërmarrësh krejt çka është e nevojshme që bërja e kontraktuar të realizohet. Të realizosh kontratën do të thotë të paguash obligimin.¹⁷³

Shitësi duhet të dorëzojë mallin në kohën e caktuar ose në kohën e paraparë në kontratën e shitjes. Koha e dorëzimit është intervali kohor brenda të cilit shitësi duhet t'ia dorëzojë sendin blerësit.¹⁷⁴ Koha e dorëzimit të mallit si dhe vendi i dorëzimit janë shumë të rëndësishëm, por sidomos kur palët këtë e rregullojnë me kontratë. Kohën e përmbushjes së detyrimit e rregullon edhe LMD-ja, por edhe KCSH-ja me dispozitat e tyre si më poshtë. Shitësi është i detyruar të dorëzojë sendet në çdo moment të periudhës së kohës, që është caktuar ose është e caktueshme sipas kontratës, përveç kur del nga rrethanat sesi i është lënë blerësit të zgjedhë datën.¹⁷⁵ Shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar në kontratë.¹⁷⁶ Kjo është e vlefshme në rastet kur është kontraktuar dorëzimi brenda një periudhë të caktuar. Kur është kontraktuar që dorëzimi i sendit të bëhet brenda një periudhe të caktuar, ndërsa nuk është caktuar se cila palë do të ketë të drejtë ta caktojë datën e dorëzimit brenda asaj periudhe, kjo e drejtë i takon shitësit, përveç kur nga rrethanat e rastit rrjedh se caktimi i datës së dorëzimit i është lënë blerësit.¹⁷⁷ LMD-ja e përcakton edhe rastin kur data e dorëzimit nuk është caktuar. Kur data e dorëzimit të sendit të blerësi nuk është caktuar, shitësi ka për detyrë ta bëjë dorëzimin

¹⁷¹ Shih më shumë: Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 498. Po ashtu, Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 358.

¹⁷² LMD, neni 457.

¹⁷³ Andrija Gams. (1986). *Hyrje në të Drejtën Civile*, Universiteti i Kosovës, Prishtinë, fq.259.

¹⁷⁴ Nerxhivane Dauti, *vepër e cituar*, fq. 311.

¹⁷⁵ KCSH, neni 712, paragrafi 2.

¹⁷⁶ LMD, neni 450.

¹⁷⁷ LMD, neni 452.

brenda afatit të arsyeshëm pas lidhjes së kontratës duke marrë parasysh natyrën e sendit dhe rrethanat e tjera.¹⁷⁸

Te legjislacioni ndërkombëtar dhe sipas rastit që ne studiojmë, sipas Konventës së Vjenës, koha e përmbushjes dhe arritja e kohës së përmbushjes së detyrimit nga ana e shitësit është e rregulluara në nenin 33 të Konventës së Vjenës, gjegjësisht është e përcaktuar se në cilin moment shitësi duhet të përmbushë veprimet, të cilat përbëjnë dorëzimin nga neni 31 i Konventës së Vjenës. Konventa e Vjenës i jep përparësi marrëveshjes së nënshkruar në kontratë, e cila është në harmoni me parimin e autonomisë së vullnetit të të dyja palëve kontraktuese. Së pari, nga kjo del se gjithnjë duhet të shihet me mirëbesim se për çka janë marrë vesh palët në kontratë. Nëse palët në këtë kontratë nuk janë marrë vesh për kohën e përmbushjes së detyrimit, atëherë aplikohet rregulli i përcaktuar që bazohet në nenin 33 në pikën (c) të Konventës së Vjenës, ku shitësi është i detyruar që mallin t'ia dorëzojë blerësit në kohën e caktuar.

Neni 33, i Konventës së Vjenës, përcakton kohën kur shitësi është i detyruar të përmbushë detyrimin.¹⁷⁹

III. 3.1.2.1. Caktimi me kontratë i kohës për dorëzimin e mallit

Caktimi i kohës së dorëzimit të mallit me kontratë mund të jetë dyanësor. Palët mund të merren vesh për kohën që kur duhet të përmbushet detyrimi.

III. 3.1.2.1.1. Caktimi i datës së përmbushjes së detyrimit

Datën e përmbushjes së detyrimit e përcaktojnë palët kontraktuese me rastin e lidhjes së kontratës. Ata përcaktojnë datën më të përshtatshme dhe sipas dëshirës së tyre. Nga kjo shihet se caktimi i kohës së përmbushjes së detyrimit është i natyrës dispozitive. Afatin e dorëzimit e caktojnë shitësi dhe blerësi me marrëveshjen e tyre.¹⁸⁰ Nëse shitësi nuk e dorëzon sendin me kohë atëherë ai ka rënë në vonesë.¹⁸¹ Këtë dukuri e përcakton edhe KCSH-ja, por edhe LMD-ja.

¹⁷⁸ Po aty, neni 453.

¹⁷⁹ Në të njëjtën mënyrë e rregullon edhe neni 7:102 i PECL- së dhe neni 6.1.1 UPC, koha e caktuar e përmbushjes së detyrimit kontraktor.

¹⁸⁰ Nerxhivane Dauti. (2012). “Kontratat”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 137.

¹⁸¹ Po aty, fq 137.

Edhe Konventa e Vjenës e thekson se data caktohet me anë të kontratës nga të dyja palët kontraktuese.

Sipas nenit 33, pika a, e Konventës së Vjenës, shitësi është i detyruar që të dorëzojë mallin, nëse data është e caktuar ose mund të rregullohet në bazë të kontratës. Nëse palët kanë vendosur kohën e dorëzimit të mallit, rregulli kryesor është që shitësi duhet ta ekzekutojë po në atë kohë. Vetëm dorëzimi i mallit, i bërë në datën e caktuar, do të konsiderohet si kontratë e përmbushur. Në rast se shitësi e dorëzon mallin më herët blerësi mund ta pranojë, por edhe mund ta refuzojë.¹⁸² Nëse, në të kundërtën e saj, përmbushja e detyrimit vonohet, shitësi e sjell me vonesë, blerësi mund të përdorë mjete të ndryshme juridike duke kërkuar përmbushjen e detyrimit.

Dita kur duhet të mbërrijë malli caktohet në kontratë. Afatin e dorëzimit e caktojnë shitësi dhe blerësi me marrëveshjen e tyre.¹⁸³ Koha e përmbushjes mund të jetë e caktuar, ose mund të urdhërohet jo vetëm në bazë të të dhënave që përmban kontrata, por edhe në bazë të zakoneve që palët i kanë bazuar në kontratat e tyre, gjegjësisht në bazë të praktikës së krijuar në mes tyre. Momenti i përmbushjes është i caktuar nëse në kontratë është përcaktuar koha e saktë në mes tyre (p.sh. detyrimi duhet përmbushet me dt. 7 shtator). Dita e përmbushjes është e caktuar, nëse në kontratë është e përcaktuar koha e cila tregon një rast të sigurt, p.sh. 20 ditë pas lidhjes së kontratës, e Premte pas festës së Bajramit, ditën e parë të punës, muajin tjetër), ose sjelljen në lidhje me ngjarjet e ndryshme kalendarike për shembull me anijen e parë.¹⁸⁴ Kur është koha e caktuar shprehimisht me ndonjë ngjarje është me rëndësi të thuhet se flitet për një ngjarje e cila sigurisht se do të ndodhë. Në të kundër, nëse afati i përmbushjes përcaktohet në bazë të ngjarjeve, që dihen se kur do të ndodhin, këtu nuk ka vend për nenin 33, të Konventës së Vjenës.

III. 3.1.2.1.2. Caktimi i periudhës kohore për përmbushjen e detyrimit

Nëse koha është e caktuar ose mund të caktohet në bazë të kontratës, shitësi është i detyruar që mallin ta dorëzojë në cilëndo kohë që ekziston brenda kësaj periudhe, përveç nëse

¹⁸² *Konventa e Vjenës*, neni 52, paragrafi 1.

¹⁸³ Nerxhivane Dauti. (2012). “*Kontratat*”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 137.

¹⁸⁴ Peter Schlechtriem, *Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht*, fq. 360.

rastet tregojnë për atë se, blerësi ka qenë përgjegjës që të caktojë datën e dorëzimit.¹⁸⁵ Koha e dorëzimit është intervali kohor brenda të cilit shitësi duhet të dorëzojë sendin te blerësi.¹⁸⁶

Periodha kohore paraqet intervalin kohor që përfshin më shumë ditë, fillimi dhe fundi janë të evidentuara në kontratë ose në bazë të kësaj është edhe i përcaktuar.

Te rasti i caktimi të periudhës kohore vlejnë të njëjtat rregulla si edhe te përmbushja e detyrimit të përcaktuara në ditë. Afati i përmbushjes mund të jetë i caktuar edhe me shenja kalendarike me caktimin e periudhës kohore ose i përcaktuar për ngjarje të caktuara. Nëse flitet për përmbushjen në afat të caktuar, fillimi dhe fundi i saj duhet të caktohen ose të urdhërohen nga kontrata. Në secilin rast është e detyrueshme që afati i fundit për përmbushje të detyrimit duhet të jetë i caktuar ose i urdhëruar.¹⁸⁷ Përkundër kësaj, me këtë nen nuk janë rregulluara rastet kur është i përcaktuar vetëm fillimi i afatit të përmbushjes. Atëherë do të vinte deri te aplikimi i nenit 33 pika (c), e Konventës së Vjenës, sikur të mos ishte e kontraktuar përmbushja e detyrimit në kohën e caktuar.

Kur detyrimi arrin në ditën e fundit të afatit dhe nëse edhe në atë ditë nuk përmbushet detyrimi, shitësi bije në vonesë. Megjithatë, detyrimi është i përmbushur në kohën brenda këtij afati, gjegjësisht shitësi mund të përmbushë në cilëndo ditë gjatë këtij afati.

Përmbushja do të jetë me mirëbesim nëse shitësi merr të gjitha veprimet deri te kalimi i afatit. Fitimi i pronësisë në mall, nga ana e blerësit, brenda afatit nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit.¹⁸⁸ Sipas kësaj, nëse shitësi duhet të organizojë ngarkimin e mallit, përmbushja do të jetë me mirëbesim dhe nëse ai në kohë përmbush dorëzimin e mallit te transportuesit me qëllim të vetëm dorëzimin te blerësi.

Shitësi nuk është i detyruar që mallin ta dërgojë më herët, por është i detyruar ta dorëzojë mallin te blerësi deri në momentin e fundit para kalimit të afatit..¹⁸⁹ Për dorëzimin e mallit në vendin e caktuar, shitësi është i detyruar që të bëhet gati për dorëzim deri në kalimin e afatit. Përmbushja e detyrimit do të jetë me mirëbesim edhe nëse malli është vendosur te blerësi në pronësi ditën e fundit të afatit. Në këtë rast shitësi është i detyruar që blerësit, në të jetën kohë dhe në mënyrën e caktuar, t'i dërgojë lajmërimin për vendosjen e mallit në pronësi. Dërgimi i

¹⁸⁵ *Konventa e Vjenës*, neni 33, pika b.

¹⁸⁶ Nerxhivane Dauti. (2012). “*Kontratat*”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq 137.

¹⁸⁷ Jens Krüger & Rüdiger Westermann. (2004). “*Münchener Kommentar zum Bürgerlichen Gesetzbuch*”, Band 3, 4. Auflage, München, fq. 2338.

¹⁸⁸ Peter Schlechtriem, “*Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht*”, fq. 362.

¹⁸⁹ Shih më shumë: Peter Schlechtriem, *Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht*, fq. 363.

paralajmërimit është detyrim sepse sikurse e kemi thënë edhe parë, vetëm në këtë mënyrë shitësi përmbush detyrimin e tij.

Sipas parimit të vetëdijësimit dhe respektit, nga ana e shitësit pretendohet që kur ta konsiderojë mallin se do ta kalojë në pronësi të blerësit në minutën e fundit me mirëbesim, ai duhet të lajmërojë blerësin, që ky i fundit të marrë mallin. Nëse shitësi e anashkalon këtë, konsiderohet që malli nuk i është dorëzuar në pronësi me mirëbesim.¹⁹⁰

Nëse kontrata, zakonet ndërkombëtare ose rrethanat nuk tregojnë të kundërtën, shitësi është i autorizuar që të zgjedhë një minutë në kornizën e afatit në të cilin do të përmbushet detyrimi. Në parim, shitësit i jepet mundësia e zgjedhjes se në cilin moment ai do të përmbushë detyrimin sepse është e nevojshme që t'i ofrojë fleksibilitet në përmbushjen e detyrimit. Sipas mendimit tonë, pasqyron kompleksitet të përmbushjes së detyrimit nga ana e shitësit.

Marrëveshja e palëve mund të tejkalojë të drejtën e blerësit që në kohë dhe brenda afatit të caktuar për dorëzimin e mallit t'i bën thirrjen shitësit dhe me këtë të caktojë minutën e saktë të përmbushjes.¹⁹¹ Palët këtë mundësi mund ta kontraktojnë në kontratë dhe pastaj do të bëhet fjalë për dorëzim me kërkesë apo thirrje të blerësit, kjo mund të burojë varësisht nga rrethanat e punës. Dorëzimi me kërkesë të blerësit, do të jetë i kontraktuar ose do të tejkalojë nga rrethanat e punës kur blerësi ka interes të posaçëm për përcaktimin e momentit të saktë të dorëzimit. Mund të jetë e mundur që blerësi ka vendosur kushte të caktuara, dhe nuk i përgjigjet dorëzimi i mallit sepse kjo pason para afatit të caktuar dhe fizikisht nuk mund të caktohet në mënyrën që është vendosur. Gjithashtu, kjo vlen nëse blerësi duhet të organizojë transportin e mallit dhe të përmbushë detyrimin me transportuesin e vet.

Nëse është e kontraktuar ose nga këto rrethana tejkalohet detyrimi i së drejtës së blerësit që të përcaktojë çastin e përmbushjes së detyrimit, atëherë blerësi këtë zgjidhje duhet ta kryej brenda afatit të paraparë dhe për dorëzimin e caktuar shitësi e paralajmëron blerësin.

Paralajmërimi i shitësit është i domosdoshëm, ai do të mund të përgatitet për përmbushjen e detyrimit në mënyrë që të përmbushë detyrimin në kohën e caktuar. Në këtë rast, shitësi nuk guxon që të përmbush detyrimin deri kur blerësi nuk e thërret që këtë ta bëjë ai.¹⁹² Përkundër kësaj shitësi do të jetë i autorizuar që të përmbush detyrimin, kur nga palët e

¹⁹⁰ Shih më shumë: Peter Schlechtriem, "Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht", fq. 363. Gjithashtu: Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 508.

¹⁹¹ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 508.

¹⁹² Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2338.

kontraktuara del se shitësi duhet që ta dorëzojë mallin deri te kalimi i afatit, e drejta e blerësit që të caktojë afatin e përmbushjes shërben që të bëhet lëvizja e detyrimit të përmbushjes përpara.¹⁹³ Nëse blerësi nuk përzgjedh afatin e përmbushjes, ai me këtë dëmton detyrimin e marrjes së mallit nga neni 60 i Konventës së Vjenës.¹⁹⁴

III. 3.1.2.2. Përmbushja e detyrimit në afatin e arsyeshëm

Përmbushja e detyrimit përcaktohet në kontratë në shumicën e rasteve. Shitësi duhet t'i dorëzojë mallrat dhe çdo dokument në lidhje me to dhe të transferojë pronësinë e mallrave, siç kërkohet nga kontrata dhe nga kjo Konventë.¹⁹⁵ Problemi më i madh është në rastet kur ajo nuk është caktuar në dispozitat e kontratës. Nëse koha e dorëzimit nuk është caktuar shprehimisht nga kontrata, shitësi është i detyruar që mallin ta dërgojë në afatin pas shuarjes së kontratës.¹⁹⁶ Shitësi gjithsesi është i detyruar të dorëzojë mallin edhe nëse kontrata nuk e parasheh kohën e përmbushjes së detyrimit. Nëse blerësit nuk i është caktuar data e dorëzimit të sendit, atëherë shitësi është i detyruar ta dorëzojë sendin në afatin e arsyeshëm pas lidhjes së kontratës, duke pasur parasysh natyrën e sendit si edhe rrethanat e tjera.¹⁹⁷ Nëse me kontratë nuk është parashikuar data e dorëzimit, shitësi ka për detyrë ta dorëzojë sendin brenda afatit të arsyeshëm nga dita e lidhjes së kontratës, duke pasur parasysh natyrën e sendit ose rrethanat e tjera.¹⁹⁸ LMD-ja e parasheh afatin e arsyeshëm. Kur data e dorëzimit të sendit të blerësi nuk është caktuar, shitësi ka për detyrë ta bëjë dorëzimin brenda afatit të arsyeshëm pas lidhjes së kontratës duke marrë parasysh natyrën e sendit dhe rrethanat e tjera.¹⁹⁹

Kodi Civil Shqiptar dorëzimin e sendit në kohën dhe në afatin e caktuar e përfshin në nenin 712, brenda një afati të arsyeshëm pas përfundimit të kontratës, kur palët nuk kanë parashikuar një afat për dorëzimin e sendit.²⁰⁰

Fillimi i afatit të arsyeshëm fillon qysh nga momenti i shuarjes së kontratës. Në anën tjetër sado të jetë jetëgjatësia e saj, gjegjësisht afati, do të konsiderohet i arsyeshëm dhe do të

¹⁹³ Po aty.

¹⁹⁴ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2816.

¹⁹⁵ *Konventa e Vjenës*, neni 30.

¹⁹⁶ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2816.

¹⁹⁷ Nerxhivane Dauti, *vepër e cituar*, fq. 312.

¹⁹⁸ Vilim Gorenc. (2010). *Bazat e së Drejtës Tregtare Statusore dhe Kontraktore*, Kolegji Victory, Prishtinë, fq.201.

¹⁹⁹ *LMD*, neni 453.

²⁰⁰ *KCSH*, neni 712, paragrafi 3.

varet nga të gjitha rrethanat e rastit konkret. Nëse palët nuk janë marrë vesh për kohën e dorëzimit të mallit, atëherë malli duhet të dorëzohet në kohën kur të dyja palët e shohin më të përshtatshme, gjegjësisht në kohën kur të dyja palët kanë interes. Sipas kësaj për vlerësimin e afatit nuk janë parësore vetëm interesat e shitësit. Me rastin e caktimit të afatit të arsyeshëm duhet të kemi parasysh të gjitha rrethanat, domethënë çka krijon një sjellje të pranueshme tregtare.²⁰¹

Kohëzgjatja e afatit të arsyeshëm është e rëndësishme dhe lidhet me faktin se: a ndodhet malli në magazinë te shitësi, ose shitësi duhet të furnizohet me mall, dhe a duhet që malli të prodhohet në po atë këtë kohë. Nëse malli gjendet te shitësi, atëherë ai duhet vetëm ta përgatisë për përmbushje kontratën dhe sipas rregullit afati i përmbushjes duhet të jetë i shkurtër. Nëse lënda e kontratës është malli, i cili duhet tani të prodhohet, atëherë llogaritet një kohë e arsyeshme e cila nevojitet për prodhimin e mallit. Në fund nëse shitësi mallin duhet ta marrë nga personi i tretë, atëherë në afat të arsyeshëm llogaritet edhe koha që i nevojitet shitësit për furnizim.²⁰²

Nëse, për shembull, blerësi nga shitësi blen pjesën rezervë për ndonjë makinë, sipas rregullit, kjo nënkupton porosinë e shpejtë, dhe në këto raste dorëzimi i “shpejtë” mund të ishte i arsyeshëm. Afati i arsyeshëm, si afat i përmbushjes së detyrimit, merret parasysh edhe te detyrimet të cilat krijohen pas lidhjes së kontratës, sikur dorëzimi i sendeve që është pjesë përbërëse, si dhe pjesët rezervë.²⁰³

Nëse në kontratë është shënuar “sa më shpejtë të jetë e mundur” ose kur përmbushja është e lidhur për një kontratë të pacaktuar aplikohet rregulli për dorëzimin në afatin e arsyeshëm.²⁰⁴

Kur shitësi është i detyruar që mallin ta dorëzojë në kohën e arsyeshme, kjo domethënë se ka në dispozicion interval të caktuar kohor për përmbushjen e detyrimit. Sipas kësaj këtu bëhet fjalë për dorëzimin e mallit në kohën e caktuar, por vetëm në dallim nga rasti i lartshënuar, nuk e kanë caktuar palët në kontratën e tyre, por ky afat caktohet sipas rrethanave të rastit konkret. Kjo do të thotë se, nëse në rastet e caktuara nuk del diçka tjetër, shitësi është kompetent të zgjedhë kohën (çastin) e dorëzimit që mund të jetë në çfarëdo ditë që përmbahet brenda kornizës të atij afati. Në bazë të parimit të mirëbesimit, shitësi duhet që blerësin ta paralajmërojë për

²⁰¹ Herbert M. Kritzer, *vepër e cituar*, fq. 242.

²⁰² Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 401.

²⁰³ Wilhelm Albrecht Achilles, *vepër e cituar*, fq. 88.

²⁰⁴ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 137.

dorëzimin e paraparë, e sidomos kur blerësi duhet të ndërmarrë përgatitjet për pranimin e mallit.²⁰⁵

III. 3.2. Dorëzimi i mallit te shitja vendore e mallit

Sipas së drejtës sonë detyrimi kryesor i shitësit, të cilin ia përcakton kontrata e shitjes është detyrimi i dorëzimit të sendit. Përmbushja e kontratës kryhet kur shitësi ia dorëzon mallin blerësit ose ia dorëzon blerësit sendin apo edhe i dorëzon dokumentin me të cilin mund të merret sendi.²⁰⁶ Shitësi e ka përmbushur detyrimin e dorëzimit të sendit ndaj blerësit në çastin kur ia ka dorëzuar sendin ose dokumentin me të cilin sendi vihet në dispozicion të blerësit.²⁰⁷ Shitësi duhet t'i dorëzojë mallrat dhe çdo dokument në lidhje me to dhe të transferojë pronësinë e mallrave, siç kërkohet nga kontrata dhe nga Konventa e Vjenës.²⁰⁸

Sipas nesh, kur bëhet fjalë për kontratën e shitjes në tregti më mirë është të përdoret nocioni dorëzimi i mallit. Për dallim nga LMD-ja, uzansat e përgjithshme për tregti me mallin flasin për detyrimin e shitësit për dorëzimin e mallit.

III. 3.2.1. Vendi dhe përmbajtja e dorëzimit - rregulla të përgjithshme

Vendi i detyrimit sikurse edhe koha e dorëzimit të sendit përcaktohet nga palët kontraktuese. Në shumicën e rasteve vendi caktohet me kontratë, rrallëherë ndodhë që vendi të caktohet jashtë kontratës. Për sa i përket vendit të dorëzimit sendet mund t'i dorëzohen transportuesit ose personit të caktuar në kontratë.²⁰⁹ Nëse sendet do të prodhohen në të ardhmen ose në një vend të caktuar të prodhimit, dorëzimi do të bëhet në vendin e prodhimit.²¹⁰ Në vënien e mallrave në dispozicion të blerësit në atë vend, në qoftë se, në rastet e papërfshira në nënparagrafin e mësipërm, kontrata ka të bëjë me mallra specifike, ose me mallra të paidentifikuara për t'u marrë nga një magazinë e veçantë apo për t'u fabrikuar ose prodhuar, dhe

²⁰⁵ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2339.

²⁰⁶ LMD, neni 450, paragrafi 2.

²⁰⁷ Vilim Gorenc, *vepër e cituar*, fq 201.

²⁰⁸ Konventa e Vjenës, neni 30.

²⁰⁹ Marjana Tutlani- Semini, *vepër e cituar*, fq 12.

²¹⁰ Po aty, fq 12.

në kohën e lidhjes së kontratës palët e dinin që mallrat ishin apo ishin për t'u fabrikuar ose për t'u prodhuar në një vend të posaçëm;²¹¹

Vendi i dorëzimit është ai vend ku shitësi duhet të përmbushë detyrimin. Ky vend duhet të dallohet nga vendi i dorëzimit të mallit nga blerësi dhe duhet të jetë vend i përcaktuar nga të dyja palët kontraktuese. Vendi i dorëzimit të mallit të blerësit është vendi ku malli i cili i është dorëzuar fizikisht blerësit, në mënyrë që ai të ketë mundësi që ta shohë atë. Vendi i përcaktuar është ai vend ku sipas marrëveshjes malli duhet të jetë i drejtuar.²¹² Për sendet e luajtshme është rregull që malli të dorëzohet aty ku është lidhur kontrata. Doëzimi i sendit të luajtshëm varet nga lloji i sendit, marrëveshjes së palëve dhe natyrës së punëve.²¹³ Pronësia mbi sendin e luajtshëm fitohet me dorëzimin e sendit në posedim fituesit.²¹⁴ Për sendet e paluajtshme vlen rregulli i dorëzimit faktik dhe bëhet në vendin ku ndodhen ato, kurse dorëzimi juridik në vendin kugjendet gjykata dhe librat e tokës.²¹⁵ E drejta e pronësisë mbi paluejtshmërisë që barten me punë juridike (kontratë) fitohet vetëm atëherë kur e drejta të regjistrohet në librat publik.²¹⁶

Dorëzimi është detyrim i shitësit, por detyrim jo në para. Detyrimi i shitësit për dorëzimin e mallit, është borxh i cili kërkohet, domethënë që blerësi është i detyruar të vijë në vendin e caktuar dhe të marrë mallin nga shitësi. Sipas rregullës së përgjithshme, detyrimin jo në para, borxhliu është i detyruar ta përmbushë në vendin në të cilin, në kohën e lindjes së detyrimit, ai ka pasur, pra në selinë e tij. Shitësi duhet ta dorëzojë në selinë ose në vendqëndrimin që ka pasur në momentin e shuarjes së kontratës. Nëse shitësi në kohën e shuarjes së kontratës ka më shumë se një seli, dorëzimin duhet ta bëjë në atë vend dhe nga ajo seli e cila ka dërguar ofertën ose në vendin ku ai ka pranuar ofertën.

Në vështrim të përmbajtjes së dorëzimit, LMD-ja e përfshin nocionin tradicional të dorëzimit të mallit, për përmbushjen e detyrimit nuk është e mjaftueshme që shitësi t'ia vendos mallin në posedim blerësit dhe për këtë ta paralajmërojë atë. Shitësi e përmbush detyrimin vetëm atëherë kur blerësi ia dorëzon sendin ose ia dorëzon të drejtën me anë të së cilës mund të marrë sendin. Shitësi duhet t'ia kalojë blerësit të drejtën e pronësisë. Pronësia mund të jetë e

²¹¹ *Konventa e Vjenës*, neni 31, pika b.

²¹² Lidhur me vendin e orientimit, shih më shumë Uzansën nr .74 (3) dhe Kapor, “Kontrata për Shitblerje të Mallit Përkthim i Uzansave të Përgjithshme dhe për Tregti me Mallra”, fq. 100 .

²¹³ Armand Krasniqi. (2014). “E Drejta Biznesore”. Kolegji European Dukagjini, Pejë, fq.111.

²¹⁴ Po aty.

²¹⁵ Nerxhivane Dauti, *vepër e cituar*, fq 312.

²¹⁶ Avdulla Aliu .(2006). “E Drejta Sendore (Pronësia)”. Universiteti I Prishtinës, Prishtinë, fq.109-110.

drejtpërdrejtë, kur sendi i dorëzohet blerësit, ose jo e drejtpërdrejtë, nëse sendi dorëzohet duke i dorëzuar dokumentacionin. Me dorëzimin e sendit shitësi duhet të dorëzojë edhe dokumentet që lidhen me të.²¹⁷ Nëse flitet për të ashtuquajturin dorëzim të dokumentacionit, atëherë përmbushja e detyrimit me dorëzimin e dokumentacionit nuk është e mjaftueshme. Dorëzimi fizik i tyre te blerësit, për përmbushjen e detyrimit, domethënë ndërmarrja e veprimeve të ndryshme juridike. Shitësi e ka kryer parimisht detyrimin e dorëzimit ndaj blerësit, kur ai (shitësi) ia dorëzon blerësit sendin ose ia dorëzon dokumentin me të cilin mund të merret sendi.²¹⁸ Shitësi duhet t'i dorëzojë mallrat dhe çdo dokument në lidhje me to dhe të transferojë pronësinë e mallrave, siç kërkohet nga kontrata dhe nga kjo Konventë.²¹⁹

Nëse dorëzimi ndodh në selinë e shitësit, ai nuk është i detyruar që të njoftojë, gjegjësisht të thërrasë blerësin që t'i dorëzohet sendi.²²⁰ Kjo është tërësisht në përputhje me nocionin tradicional për dorëzimin e mallit, sepse dorëzimi i mallit përmbushet me dorëzimin e mallit te blerësit, e jo me vendosjen e sendit në posedim, gjegjësisht ndërmarrjes së të gjitha veprimeve që blerësi mund të fitojë pronësinë në mall.

Në bazë të rregullit të përgjithshme për vendin e përmbushjes ekzistojnë dy përjashtime. Përjashtimi i parë varet në vendin e dorëzimit të mallit të caktuar, i dyti, në vendin e dorëzimit të mallit i cili duhet të transportohet.

III. 3.2.1.1. Vendi i ndodhjes së mallit si vend i përmbushjes

Kjo problematikë vlen për rastet kur sendi do të prodhohet ose kur sendi është i paluajjtshëm. Në këto raste sendi nuk bartet në posedim te blerësi, por bëhet bartja simbolike te blerësi.

Nëse në kohën e shuarjes së kontratës për shitjen për palët kontraktuese ka qenë e njohur se ku ndodhet sendi, ku duhet të jetë prodhuar, dorëzimi bëhet në atë vend. Sendi më vonë mund të bartet në një vend tjetër, por vendi i përmbushjes së detyrimit konsiderohet vendi i ndodhjes së sendit, me kusht që palët kontraktuese, në momentin e shuarjes së kontratës, kanë qenë të njoftuara se ku ndodhet sendi. Rregulli i përmendur ka të bëjë me të gjitha sendet.

²¹⁷ *KCSH*, neni 710, paragrafi 2.

²¹⁸ *LMD*, neni 450, paragrafi 2.

²¹⁹ *Konventa e Vjenës*, neni 30.

²²⁰ *Komentar i LMD-së*, Libri II, redaktor Perović & Stojanović, Kragujevac, Gornji Milanovac, 1980, fq. 50.

Rregulli i ndodhjes së sendit si vend i përmbushjes së detyrimit është paraparë si më ekonomik duke mos shkaktuar shpenzime të panevojshme për të dyja palët kontraktuese. Nëse sendi ndodhet në vend tjetër nga selia e shitësit, më ekonomike është që detyrimi të kryhet pikërisht në atë vend. Në fillim rregulli i ndodhjes së sendit si vend i përmbushjes së detyrimit kishte të bënte vetëm për sendet individualisht të përcaktuara dhe sendet gjenerike, të cilat duhet të ndahen nga masa.

III. 3.2.1.2. Vendi i dërgimit të mallit si vend i përmbushjes së detyrimit (dorëzimit të mallit)

Në rast të shitjes distancionale të mallit kur malli duhet të dorëzohet diku tjetër. Si shitësi ashtu edhe blerësi e kanë selinë në shtete të ndryshme, ndërkaq, malli duhet të transportohet nga një shtet në shtetin tjetër. Vendi i përmbushjes së kontratës, përkatësisht zbatimi i së drejtës së vendit të përmbushjes së kontratës si fakt vendimtar (pikë e lidhjes paraqitet më vonë se *lex loci contractus*).²²¹ Kur është fjala tek transporti i mallit duhet të bëhet dallimi në mes dorëzimit të destinuar dhe shpërndarjes së mallit. Te kontrata e shpërndarjes, shitësi detyrimin e tij kryesor e përmbush me dorëzimin e mallit te transportuesit ose te shpedicioni, vendi i përmbushjes së detyrimit është vendi i dorëzimit të mallit te transportuesit. Në këto raste lidhet kontratë e dytë vetëm e vetëm që kjo kontratë, domethënë kontrata e parë, të përmbushet. Te kontrata e destinuar shitësi është i detyruar që blerësit t’ia dorëzojë mallin në vendin e caktuar në kontratë. Në rastet kur nuk është caktuar me kontratë të bëhet transporti sipas marrëveshjes jashtëkontraktore të të dyja palëve kontraktuese, domethënë vendi i dorëzimit është vendi i përcaktuar në kontratë. Është e mundur që palët të merren vesh në kontratën e shitjes dhe që malli duhet të transportohet, por duke mos caktuar saktësisht vendin e dorëzimit të mallit, respektivisht të përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast lind pyetja se: për çfarë kontrate bëhet fjalë? Për kontratën e shpërndarjes apo kontratë me vend të caktuar të dorëzimit të mallit. Përgjigjja është shumë e rëndësishme për shitësin sepse detyrimi i tij dhe përgjegjësia është shumë më e madhe te kontrata me vend të caktuar për dorëzim të mallit. Në teori dhe në praktikë ekziston prezumimi se në dobi të kontratës së shpërndarjes, domethënë se vendi i dorëzimit të mallit,

²²¹ Asllan Bilalli & Hajredin Kuçi. (2009). *E Drejta Ndërkombëtare Private*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq.310.

llogaritet të jetë vendi i shpërndarjes.²²² Në LMD kjo problematikë është zgjidhur dhe është shpjeguar në mënyrë të saktë duke mos lënë hapësirë për paqartë, sepse në rastet ku sipas kontratës është i nevojshëm transporti i mallit, ndërkaq në kontratë nuk është paraparë vendi i përmbushjes, detyrimi përmbushet me dorëzimin e sendit tek transportuesit ose te subjekti i cili organizon shpërndarjen.²²³ Në rastet kur kontrata përcakton transportin e mallit, këtë e parasheh edhe LMD-ja, por edhe KCSH-ja në dispozitat e veta. LMD-ja e përcakton në këtë mënyrë: në rastin kur sipas kontratës nevojitet që të bëhet transportimi i sendeve, ndërsa në kontratë nuk është caktuar vendi i përmbushjes, dorëzimi quhet i kryer me dorëzimin e sendit tek transportuesit ose te personi i cili e organizon transportin.²²⁴ KCSH-ja, në nenin 711, përcakton se në rastet kur shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet tek transportuesit, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve.²²⁵

Sipas uzansave të përgjithshme për tregti me mallra, vendi i dorëzimit të kontratës së shpërndarjes është stacioni i trenit (transporti hekurudhor), porti detar (transporti detar), apo porti i shitësit (transporti lumor).²²⁶ Nëse këto vende janë larg dhe së paku 10 kilometra nga magazina e shitësit, dorëzimi i mallit ose përmbushja e detyrimit do të bëhet në magazinën e tij²²⁷ me shpërndarjen e mallit në një kamion ose në ndonjë mjet tjetër transporti.²²⁸

Shitësi nuk është i detyruar vetëm të dorëzojë mallin tek transportuesit dhe shpediteri, por edhe të organizojë shpërndarjen e tij. Për këtë qëllim ai duhet të përmbyllë në mënyrën e zakonshme dhe me kushte të zakonshme dhe të merren vesh për nevojat e transportit deri në vendin e caktuar.²²⁹

Në qoftë se shitësi dhe blerësi janë marrë vesh për llojin e transportit, atëherë shitësi është i detyruar të veprojë në mënyrën e zakonshme edhe sipas kushteve të zakonshme. Shuarja e kontratës në mënyrën e zakonshme dhe sipas kushteve të zakonshme nënkupton faktin se shitësi është i detyruar të shuajë kontratën me transportuesin i cili kryen transport publik. Nëse ka më shumë transportues, transporti duhet besuar te më të përshtatshmit për transportim. A është shuar

²²² Vrleta Krulj, *vepër e cituar*, fq. 92.

²²³ LMD, neni 472.

²²⁴ LMD, neni 455.

²²⁵ KCSH, neni 711, paragrafi 2.

²²⁶ *Uzansa e Përgjithshme*, Uzansa nr. 71, paragrafi 3.

²²⁷ KCSH, neni 711, paragrafi 5.

²²⁸ *Uzansa e Përgjithshme*, Uzansa nr. 76, paragrafi 3.

²²⁹ LMD, neni 473.

kontrata në mënyrë të rregullt dhe sipas kushteve të rregullta kjo do të vlerësohet sipas vendit të shitësit, gjegjësisht sipas vendit nga i cili dërgohet malli.²³⁰

Me rastin e organizimit të shpërndarjes së mallit, shitësi duhet të veprojë në marrëveshje dhe mirëbesim dhe duhet të ketë kujdes për çmimin e transportit, zgjatjen e transportit, sigurinë e rrugës, etj. Edhe pse ligji flet vetëm për përgjegjësinë e shitësit që të përmbushë marrëveshje të caktuara, sipas mendimit tonë, shitësi ka obligim që të organizojë shpërndarjen e mallit dhe ajo nënkupton jo vetëm shuarjen e kontratës për transport ose shpërndarjen e mallit, por ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera që do ta sjellin sendin në gjendje të rregullt dhe deri te vendi i destinacionit.²³¹ Duke u bazuar në atë se shitësi nuk është ekspert për organizimin e shpërndarjes, ai është i detyruar të veprojë me kujdes si një tregtar i mirë. Te mënyra e kryerjes së transportit të mallit është e rëndësishme zgjedhja e transportuesit ose i shpediterit. Paraprakisht me mirëbesim do të merret në konsideratë zgjedhja e blerësit. Megjithatë, nëse shitësi nuk ka zgjedhur transportuesin apo shpediterin, atëherë shitësi e destinon mallin dhe në këtë rast përgjigjet për zgjedhjen e tij.²³²

Shitësi ka dorëzuar mallin nëse ia dorëzon transportuesit ose subjektit i cili organizon shpërndarjen. Për dallim nga shitja ndërkombëtare e mallit, ku është e dyshimtë se dorëzimi i mallit shpediterit do të konsiderohet dorëzim i mallit, në të drejtën tonë, transportuesi dhe shitësi janë të barabartë. Zgjidhja e së drejtës sonë është e mirë sepse e ngre pozicionin e shpediterit dhe faktin se me dorëzimin e mallit shitësi bart të drejtën e pronësisë në mall gjatë transportimit të mallit.²³³ Shpediteri mund të bëjë shpërndarjen e mallit, ose, në rast të veprimit të vetëm, mundet që personalisht të kryejë transportin e mallit. Është rregull që shpediteri nuk përgjigjet për veprimet e subjekteve të tjera, të cilat nevojiten për përmbushjen e detyrimit, por, vetëm për zgjedhjen e rregullt të tyre.

Qëllimi kryesor është dorëzimi i mallit nga ana e shitësit te blerësit, me dorëzimin e mallit transportuesit për qëllime të tjera nuk mund të konsiderohet përmbushje e detyrimit. Nëse nuk janë marrë vesh ndryshe, shpenzimet për përgatitjen e mallit për dorëzimin e mallit si dhe

²³⁰ *Komentar Zakona o obligacionim odnosima*, knjiga II, redaktor Perović, Stojanović, fq. 58.

²³¹ Boris Vizner & Ivan Bukljaš. (1979). "*Komentar Zakona o obveznim (obligacionim) odnosima*", knjiga 3, Zagreb, fq. 1566 1567.

²³² *Uzansat e Përgjithshme*, uzansa. nr. 76 paragrafi 2.

²³³ Shih më shumë në analizën e pozitës së shpediterit në pjesën e punimit i cili mbron faktin e transportuesit të shitja ndërkombëtare e mallit.

për përmbushjen e detyrimit i bart shitësi, ndërkaq shpenzimet e bartjes së mallit dhe të gjitha shpenzimet e tjera pas dorëzimit i bart blerësi nëse nuk është kontraktuar ndryshe.²³⁴

III. 3.2.2. Koha e dorëzimit të mallit

Koha e përmbushjes është kuptimi në bazë të së cilës përcaktohet se në cilin moment shitësi është i detyruar ta përmbushë detyrimin e dorëzimit të mallit. Edhe pse sipas rregullores, nuk është i rëndësishëm elementi i kontratës së shitjes, këtë pyetje palët rregullisht e rregullojnë në marrëveshjen e tyre.

Para shqyrtimit të vendimeve, të cilat ekzistojnë në të drejtën tonë pozitive, është e nevojshme të konkludohet saktësisht rëndësia e kuptimeve të caktuara. Në literaturë dhe në rregullat e së drejtës kemi hasur në disa mospajtime terminologjike që mund të na çojnë në gabime materiale. Duhet bërë dallimi në mes të mendimeve *koha e dorëzimit*, dita (momenti) i dorëzimit dhe data e dorëzimit. Koha e dorëzimit është kuptim i përgjithshëm me anë të së cilës përcaktohet çasti i caktuar ose intervali i caktuar kohor në të cilin shitësi është i detyruar të ndërmarrë veprime të cilat kryejnë dorëzimin. Dita (afati) i dorëzimit është minuti (çasti i saktë kur duhet të përmbushet detyrimi. Afati i përmbushjes është i caktuar dhe është interval i urdhëruar kohor, i cili përfshin më shumë ditë dhe brenda këtij afati shitësi duhet ta dorëzojë mallin. Prandaj koha e përmbushjes është kuptimi i përgjithshëm që në vetvete përmban edhe ditën, edhe datën e përmbushjes së detyrimit. Afati i dorëzimit nuk mund të përfshihet si momenti i kohës kur blerësi mund të pretendojë përmbushjen e detyrimit²³⁵ Afati fillon të rrjedhë nga momenti i caktuar, por afati nuk mund të përcaktohet si moment, sepse afati është interval kohor. Nga fillimi i afatit, detyrimi është përmbushur, dhe ka ardhur deri në ditën e fundit të përmbushjes. Sipas mendimit tonë, kjo e kalon atë sepse vendimi, që përmbajnë uzansat e përgjithshme në vend të kohës së dorëzimit flet për afatin e dorëzimit.²³⁶ Në bazë të kësaj që flitet në literaturë vijmë në përfundim “kur palët bien vet në ujdi për afatin e dorëzimit, ato këtë mund ta caktojnë vetë ose me afat të fiksuar për një datë të caktuar, që është rasti më i shpeshtë, të vendoset një kohë e caktuar-periudhë e caktuar kohore (duke caktuar me ditë)- që brenda

²³⁴ LMD, neni 457.

²³⁵ Shih më shumë: Vesna Klajn-Tatić, *vepër e cituar*, fq. 45.

²³⁶ Shih më shumë: *Uzansat e Përgjithshme*. Uzansa. nr. 80-95.

këtyre ditëve të bëhet dorëzimi”.²³⁷ Në këtë përcaktim kemi dy gabime, të cilat janë pasojë dhe në bazë të së cilës afati i dorëzimit përdoret si teori që shënon kohën e dorëzimit, dhe me të mund të shënohet edhe dita (data e caktuar) dhe afati i dorëzimit (periudha për disa ditë). Disa teoricienë nocionet afat dhe datë e dorëzimit i konsiderojnë si të njëjtën gjë.²³⁸

Teoritë e përdorura në uzansat e përgjithshme janë të pacaktuara për arsye se data e dorëzimit përcakton ditën e dorëzimit, e kur flitet për afatin e dorëzimit sipas uzansave të përgjithshme përdoret nocioni afat i marrëveshjes. Përkundër kësaj, disa rregullore përmbajnë uzansat e përgjithshme që çojnë në ditën brenda afatit të marrëveshjes. Zgjidhja e domethënies është e një rëndësie të veçantë, sepse në shumë raste vjen deri te aplikimi i zgjidhjeve të marra nga uzansat e përgjithshme.

Në dallim nga uzansat e përgjithshme LMD-ja flet për kohën e dorëzimit, datën e dorëzimit, dorëzimin brenda periudhës së caktuar kohore, kur data e dorëzimit nuk është caktuar²³⁹, gjegjësisht bëhet dallim i qartë në mes të kohës së dorëzimit, ditës dhe afatit të përmbushjes. Duke pasur parasysh të gjitha këto mund të bëjmë dallimin e dy mënyrave për përcaktimin e kohës së dorëzimit të mallit. E para, koha e dorëzimit mund të kontraktohet me marrëveshje. E dyta, nëse koha, në të cilën shitësi do të dorëzojë mallin, nuk është e rregulluar me kontratë atëherë zbatohen norma të caktuara ligjore.

III. 3.2.2.1. Rregullimi me kontratë i kohës së dorëzimit të mallit

Palët, në shumicën e rasteve, në kontratën e tyre merren vesh rreth kohës së dorëzimit të mallit. Koha e përmbushjes mund të caktohet në dy mënyra - me caktimin e ditës (kohës) ose me caktimin e afatit në të cilin duhet të përmbushet detyrimi.

²³⁷ Vladimir Kapor: “*Ugovor o kupovini i prodaji robe – Tumač opštih uzansi za promet robom*”, fq. 111.

²³⁸ Shih më shumë: Vrleta Krulj, *vepër e cituar*, fq. 84-86.

²³⁹ Shih më shumë: *LMD*, neni, 450, 452 dhe 453.

III. 3.2.2.1.1. Dorëzimi i mallit në kohën e caktuar (në ditë)

Ekzekutimi i detyrimit duhet të bëhet në afatin e caktuar në kontratë.²⁴⁰ Nëse palët kanë paraparë në kontratë afatin e dorëzimit të mallit me kontratë, shitësi është i detyruar që dorëzimin e mallit ta kryejë në atë kohë. Kjo është rregull i cili del nga parimi *pacta sunt servanda*, por edhe nga LMD-ja e Kosovës dhe prej Kodit Civil Shqiptar të vitit 1994. Dorëzimi bëhet menjëherë pas firmosjes së kontratës ose brenda një afati të arsyeshëm pas firmosjes.²⁴¹

Megjithatë palët mund të bien në ujdë të veprojnë ndryshe. Në këtë rast palët mund të bien dakord për një afat pezullues për dorëzimin e plotë ose për dorëzim pjesë-pjesë.²⁴²

Koha e dorëzimit mund të jetë përcaktuar në kontratë ose është nxjerrë nga ajo. Momenti i dorëzimit të mallit është përcaktuar në kontratë nëse palët janë marrë vesh që dorëzimi i mallit duhet të bëhet në ditën e caktuar (p.sh. me 25 Maj). Dita e dorëzimit është e përcaktuar nëse në kontratë është caktuar dhe lidhur me ndonjë ndodhi (p.sh. 20 ditë nga lidhja e kontratës) ose nëse përdoren afate të zakonshme. Sipas LMD-së, thënia fillim i muajit përcakton ditën e parë të muajit, gjysma është i pesëmbëdhjeti, ndërkaj fundi i muajit konsiderohet dita e fundit e muajit.²⁴³ Sipas LMD – së nëse nga qëllimi i palëve ose nga natyra e marrëdhënieve kontraktore nuk përcaktohet diçka tjetër atëherë do të zbatohet e drejta e nxjerrë nga ligji. Kjo do të thotë se ka të bëjë me normë të shtuar, e cila do të gjejë përdorimin e saj kur të marrëveshja e palëve kontraktuese ekzistojnë zbrazëtira. Te përdorimi i këtyre nocioneve duhet të jemi shumë të kujdesshëm sepse uzansat e përgjithshme u japin një domethënie tjetër. Me fillim e muajit uzansat përcaktojnë kohën ose periudhën kohore nga data 1 e muajit deri në ditën e dhjetë të muajit, mesi i muajit fillon nga dita e njëmbëdhjetë deri më datën 20 të muajit, ndërkaj fundi i muajit përfaqëson kohën nga data 21 e deri në ditën e fundit të muajit.²⁴⁴ Kjo do të thotë se sipas uzansave të përgjithshme dorëzimi i mallit bëhet në datën e caktuar e jo në ditën e caktuar të muajit. Rregulli i përfshirë në uzansa është më fleksibël dhe shumë më shumë u përgjigjet nevojave të tregtisë me mallra, prandaj në praktikë do të përdoren shumë më shpesh. Te kontratat

²⁴⁰ KCSH, neni 463, paragrafi 1.

²⁴¹ Georges Vermelle. (2008). *vepër e cituar*, Papirus, Tiranë, fq. 47.

²⁴² Po aty.

²⁴³ Shih më shumë: LMD, neni 65, paragrafi 2. Është me rëndësi të kemi parasysh që LMD-ja dhe *Uzansat Përgjithshme* në mënyra të ndryshme përcaktojnë vlerën e afateve të zakonshme.

²⁴⁴ Shih më shumë: *Uzansat e Përgjithshme*, Uzansa nr. 82.

tregtare nocioni me fillimin e muajit për tregtarët rregullisht do të thotë afat i caktuar, e jo saktësisht afat i caktuar në ditën e parë të muajit.

Afatet për përmbushje të detyrimit KCSH i rregullon me nenin 91. Kur afati është caktuar me ditë, nuk llogaritet dita në të cilën fillon ngjarja ose koha nga e cila ai duhet të fillojë. Afati që është caktuar në javë, në muaj ose vite, mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër dhe atë të ditës që ai ka filluar.²⁴⁵

Situata në rastet kur është përcaktuar afati me kontratë nuk është e njëjtë me dorëzimin në afat të caktuar. Edhe nëse dita e dorëzimit të mallit nuk është përcaktuar sipas ditës kalendarike, por, është determinuar me kalimin e kohës duke e lidhur me ndonjë ndodhi të caktuar, shitësi nuk ka mundësi të zgjedhë kur do të dorëzojë mallin, por është përgjegjës që ta dorëzojë mallin po atë ditë.

III. 3.2.2.1.2. Dorëzimi në afatin e caktuar

Tregtarët shumë shpesh në praktikë për dorëzimin pajtohen në mes veti që detyrimi duhet të përmbushet në ditën e caktuar. Shumë më shpesh shitësit i përcaktohet afati i caktuar brenda të cilit ai duhet të bëjë dorëzimin e mallit. Një afat i tillë quhet afatkornizë dhe mund të përcaktohet me marrëveshjen e palëve kontraktuese ose duke e përcaktuar vetvetiu këtë afat nga marrëveshja.

LMD-ja përcakton vetëm një rregull që rregullon dorëzimin me kontratë i cili është përcaktuar në periudhën kohore. KCSH-ja në nenin 712 parasheh dorëzimin me kontratë në dy paragrafë. Shitësi është i detyruar të dorëzojë sendet në datën e caktuar në kontratë ose që është e përcaktuar në bazë të kontratës.²⁴⁶ Në çdo moment të periudhës së kohës, që është caktuar ose që është e caktueshme sipas kontratës (...).²⁴⁷ Përkundër kësaj uzansat e përgjithshme përmbajnë rregulla më të detajuara. Me qenë se uzansat janë më të detajuara ato çdo ditë do të përdoren dhe në raste të caktuara do të bëhen detyrimitisht të zbatueshme.

Afati kornizë në të cilin do të duhej të përmbushej detyrimi është i përcaktuar kur palët në kontratë përcaktojnë në mënyrë kalendarike periudhën kohore (p.sh. nga janari deri në maj). Përkundër kësaj, afati i përmbushjes është i përcaktuar kur është i lidhur me ndodhjen e rastit të

²⁴⁵ KCSH, neni 91, paragrafët 1 dhe 2.

²⁴⁶ KCSH, neni 712, paragrafi 1.

²⁴⁷ Po aty, neni 712, paragrafi 2.

caktuar. Në bazë të kësaj është e mundur që palët shprehimisht të përcaktojnë ndodhinë e caktuar (p.sh. në afat prej 10 ditësh para përmbylljes së kontratës), ose me përdorimin e nocioneve të caktuara çojnë në krijimin e rastit të caktuar (me ardhjen e shiut, me lulëzimin e dardhës etj). Nëse afati i dorëzimit është përcaktuar në kontratë me shprehjen urgjent, shpejt, dhe me shprehje të tilla do të thotë që dorëzimi duhet të kryhet në afat prej 8 ditësh nga shuarja e kontratës.²⁴⁸ Shprehjet në kontratë si me hapjen e lundrimit, me kalimin e ngricave, me ardhjen e ujit, dhe shprehje të ngjashme që dorëzimi i mallit duhet të kryhet në afat prej 15 ditësh sipas shërbimit zyrtar, në të gjithë rrugën detare që do të bëhet në lundrim të hapur ose ka përfunduar pengesa për lundrim, pa marrë parasysh se a është rruga e lundrueshme edhe para shpalljes publike.²⁴⁹

Nëse flitet për dorëzimin e mallit në afat të caktuar, fillimi i saj dhe përfundimi mund të jenë të caktuar me kontratë. Nëse me kontratë nuk është caktuar afati i fundit për përmbushjen e detyrimit nuk mund të flasim për ekzistimin e afatit kornizë (p.sh. dorëzimi i mallit jo para dhjetorit).

Kur është e paraparë që përmbushja e detyrimit duhet të bëhet në afatin kornizë, është me rëndësi çështja, që pala kontraktuese është e autorizuar të respektojë afatin e dorëzimit. Palët mund që me marrëveshje të tejkalojnë ditën e dorëzimit duke mos e potencuar atë me dëshirën e njërit prej palëve kontraktuese. Këtë mund ta bëjnë edhe duke u bazuar në klauzolën “ me zgjedhjen e blerësit”²⁵⁰. Kur është kontraktuar, se malli duhet të dorëzohet brenda një periudhe të caktuar kohore, por edhe nuk është përcaktuar se cila palë ka të drejtë që ta caktojë afatin dhe dorëzimin në kufi sipas të gjitha teorive dhe legjislacionit, kjo e drejtë i takon shitësit. Uzansat e parashohin që, nëse nuk është rregulluar afati i dorëzimit të mallit, që në këtë rast është cekur më lart, atëherë kjo e drejtë i takon shitësit.²⁵¹ Edhe LMD-ja edhe uzansat përcaktojnë se caktimi i afatit të dorëzimit të mallit i takon shitësit sepse kjo është më e dobishme dhe se atij duhet t’i jepet mundësia e zgjedhjes së momentit të dorëzimit. Kjo zgjedhje buron nga e drejta natyrore e detyrimit të dorëzimit të mallit, gjegjësisht shitësi është pala e cila duhet të ndërmarrë veprime të ndryshme derisa vijmë te përmbushja e detyrimit. Ekzistojnë raste të caktuara kur shitësi është i autorizuar që të caktojë afatin e dorëzimit të mallit. Kjo mund të arrihet kur shitësi ka obligim ta bëjë transportin e mallit. Për dallim nga LMD-ja uzansat nuk e parashohin mundësinë që shitësi

²⁴⁸ Shih më shumë: *Uzansa e Përgjithshme*, Uzansa nr. 81.

²⁴⁹ Shih më shumë: *Uzansa e Përgjithshme*, Uzansa, nr. 85.

²⁵⁰ Shih më shumë: Vladimir Kapor & Slavko Carić, *vepër e cituar*, fq.100.

²⁵¹ Shih më shumë: *Uzansa e Përgjithshme*, Uzansa nr. 88, paragrafi 1.

të caktojë ditën e dorëzimit të mallit. Sipas mendimit tonë, këtë mundësi që ia krijon ligji shitësit, është më e mirë sepse nuk e favorizon shitësin, por, i jep më shumë mundësi shitësit që të ketë parasysh të gjitha rrethanat dhe të gjejnë mundësinë më të mirë në raport me rastin konkret. Gjithashtu kjo zgjidhje është edhe në harmoni me rregullat e shitjes ndërkombëtare.

Pala e cila ka qenë e autorizuar që të caktojë ditën brenda afatit të kontraktuar në kontratë se kur do të bëhet dorëzimi i sendit dhe mund të caktojë secilën ditë, që është ditë pune, brenda këtij afati.²⁵² Nëse pala e autorizuar kontraktuese nuk ka caktuar ditën e dorëzimit, si ditë e dorëzimit llogaritet të jetë dita e fundit për dorëzimin e mallit, e përcaktuar në kontratë, në mes palëve kontraktuese që me lidhjen e kontratës. Sipas një teorie tjetër, teori të cilën e përkrah edhe LMD-ja, është se nëse pala e autorizuar nuk ka caktuar afat për dorëzimin e mallit, dhe, nëse nuk është caktuar me kontratë se kur duhet të bëhet dorëzimi i mallit, pala kontraktuese e autorizuar për caktimin e afatit për dorëzimin e mallit, mund të kërkojë nga gjykata që ky afat të caktohet nga ana e gjykatës me vendim gjyqësor për dorëzimin e mallit.²⁵³ Mendimi ynë është se kjo nuk mund të zbatohet për disa arsye. E para, neni i cekur rregullon këtë çështje kur afati i dorëzimit nuk është caktuar fare, ndërkaq subjekti i cili është i autorizuar të caktojë afatin e dorëzimit, nuk e cakton atë, por bën shtyrje apo ngecje në caktimin e këtij afati. Pala tjetër nuk është e detyruar të durojë këtë ngecje apo shtyrje, dhe detyrohet që palës tjetër, që është e autorizuar t'ia përkujtojë palën e autorizuar (për caktimin e afatit) që ta bëjë caktimin e afatit për dorëzimin e mallit. Nëse është kontraktuar afati kornizë për dorëzimin e mallit, kjo do të thotë që koha e caktuar kur duhet të dorëzohet sendi, por nuk është e mundur që të bëhet aplikimi i këtij rregulli ligjor, që si normë rregullon situatën kur vendi i përmbushjes nuk është i përcaktuar. E dyta, duhet bërë dallimi mes dorëzimit dhe arritjes së afatit për përmbushje të detyrimit.²⁵⁴ Detyrimi llogaritet si detyrim, brenda afatit që është kontraktuar dhe detyrim ku duhet të bëhet dorëzimi i mallit, gjegjësisht shitësi *mund* ta përmbushë këtë detyrim. Megjithatë, detyrimi përmbushet nëse arrin në ditën e fundit dhe blerësi në këtë ditë të fundit, me mirëbesim mund të kërkojë

²⁵² Shih më shumë: Uzansa . nr. 87, paragrafi 2, Po ashtu: Perović & Stojanović, *Komentar Zakona o obligacionim odnosima*, libri II, fq. 53.

²⁵³ Shih më shumë: Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, *Komentar Zakona o obligacionim odnosima*, libri II., fq. 53; Borislav T. Blagojević & Vrleta Krulj, *Komentar Zakona o obligacionim odnosima*, libri I, fq. 962.

²⁵⁴ *Koha e përmbushjes së detyrimit të kontraktuar dallon dy momente: kohën në të cilën me mirëbesim pala kërkon përmbushje nga pala tjetër - arritja dhe koha në të cilën pala e detyruar mund ta kryejë detyrimin – të përmbush detyrimin. Përkundër kësaj arritja e përmbushjes duhet të ekzistojë bile në të njëjtën kohë me arritjen e përmbushjes. Kjo do të thotë se arritja e përmbushjes dhe përmbushja e detyrimit nuk duhet të jenë të pranishme në të njëjtën kohë.* Shih më shumë: Reiner Schulze, *Bürgerliches Gesetzbuch – Handkommentar*, 2. Auflage, Baden-Baden, 2002, fq. 255.

përmbushjen, ndërkaq shitësi si i detyruar duhet ta kryejë dorëzimin. Mosdorëzimi i mallit e çon shitësin në vonesë për përmbushje të detyrimit.

Nëse flitet për sasi të madhe të mallit, e cila, nuk mund të dorëzohet brenda një dite, pala e autorizuar, duhet të bëjë llogaritje që dorëzimi i mallit të bëhet në atë periudhë të caktuar kohore ku i gjithë malli do të dorëzohet (të përmbushet detyrimi) brenda afatit të caktuar në kontratë.²⁵⁵ Sipas kësaj, kur duhet të dorëzohet një sasi e madhe e mallit, nuk është e mjaftueshme që detyrimi të fillojë të përmbushet, por, detyrimi duhet të përmbushet brenda afatit të caktuar në kontratë.

Pala e cila ka të drejtë të përcaktojë kur përmbushet detyrimi brenda afatit të kontraktuar, duhet, që për ditën e përmbushjes të njoftojë edhe palën tjetër me kohë. Njoftimi duhet të bëhet i qartë për punën për të cilën flitet, si dhe për ditën kur duhet të përmbushet detyrimi. Ky njoftim quhet *preavizo* e përmbushjes. Uzansat te rasti i përmbushjes së detyrimit pranojnë teorinë e pranimit, njoftimi konsiderohet i kryer kur e pranon pala e cila e ka porositur.²⁵⁶ LMD-ja nuk parasheh detyrimin e njoftimit të palës, por që kjo gjithsesi është e kuptueshme.

III. 3.2.2.2. Dorëzimi i mallit në afat sipas marrëveshjes së palëve

Kontrata e shitblerjes është e plotfuqishme edhe nëse palët nuk janë marrë vesh për kohën e dorëzimit të mallit. Kur palët nuk kanë kontraktuar kohën e dorëzimit të mallit, ekzistojnë tri mënyra për caktimin e kohës në të cilën duhet të arrijë malli. Në shumë vende të botës, nëse asgjë tjetër nuk është kontraktuar, dorëzimi duhet të kryhet menjëherë.²⁵⁷ Sipas vendimit tjetër përshkruhet afati fiks i caktuar, brenda të cilit malli duhet të dorëzohet. Këto i përmbajnë edhe uzansat e përgjithshme, të cilat parashohin që, nëse afati i dorëzimit nuk është caktuar me kontratë, konsiderohet se dorëzimi duhet të bëhet brenda afatit 8 ditor nga shuarja e kontratës.²⁵⁸ Shumë teori dhe sidomos ato të sistemit anglosakson, parashohin se në mungesë të marrëveshjes në mes të palëve kontraktuese dorëzimi duhet të bëhet në afat të përcaktuar sipas marrëveshjes pas përmbylljes së kontratës. Këtë çështje e parasheh edhe LMD-ja, që parasheh nëse shitësi është i obliguar të bëjë dorëzimin e mallit sipas marrëveshjes së palëve për afatin e dorëzimit, pa

²⁵⁵ *Uzansa e Përgjithshme, Uzansa nr. 88, paragrafi 3.*

²⁵⁶ Shih më shumë: *Uzansa e Përgjithshme, Uzansa nr. 89, neni 3.*

²⁵⁷ *Kodi Civil Gjerman, neni 271, paragrafi 1.*

²⁵⁸ *Uzansa e Përgjithshme, Uzansa . nr. 80, neni 2, dhe neni 81.*

marrë parasysh rrethanat dhe pavarësisht se çfarë natyre ka sendi.²⁵⁹ Afati i dorëzimit të mallit brenda 8 ditëve nuk është e mundur të ndodhë gjithmonë sepse ka raste kur malli i cili duhet dorëzuar është malli që nuk është i gatshëm. Ai duhet të prodhohet, në këtë rast afati prej 8 ditësh nuk vlen. Rregullimi i dorëzimit të mallit në bazë të marrëveshjes së palëve kontraktuese, është një prej dukurive më interesante sepse forcon marrëveshjen në mes të palëve kontraktuese, mundëson lehtësime për palët kontraktuese dhe i shërben tregtisë së lirë të mallrave. Afati me marrëveshje vlerësohet në raport me karakterin dhe me natyrën e sendit si edhe rrethanat e tjera. Kështu, për shembull, dorëzimi i sendit gjenerik në sasi më të vogël mund të bëhet brenda 3 ditësh. Duke u fokusuar në pushimin e afatit apo ndërrimin e afatit sipas marrëveshjes duhen pasur parasysh të gjitha rrethanat, si dhe interesat e dyja palëve kontraktuese.

Uzansat e përgjithshme parashohin një rregull të veçantë për rastin kur palët nuk kanë përfshirë në kontratë afatin e dorëzimit, por kanë paraparë që blerësi është i obliguar që shitësin ta obligojë për ambalazhim. Atëherë shitësi është i obliguar që ta dorëzojë mallin menjëherë me kalimin e kohës së nevojshme për paketimin e mallit.²⁶⁰ Shitësi është i obliguar që të caktojë afat të saktë të dorëzimit të mallit dhe është i obliguar që për këtë të njoftojë palën tjetër kontraktuese.

III. 4. Përfundimi

Me rastin e krijimit të normave për dorëzimin, hartuesit e Konventës së Vjenës janë ballafaquar me disa vështirësi. Janë tërhequr nga përcaktimi i dorëzimit sepse nocioni i dorëzimit, që është përfshirë në ULIS, ka krijuar një numër pasojash negative dhe për këtë arsye nuk është e mundur të vihet deri te ndonjë konsensus. Në Konventën e Vjenës janë përfshirë vetëm veprimet që kryejnë palët për të përmbushur detyrimin. Megjithatë, në bazë të të gjithave atyre që kemi diskutuar më lart mund të nxjerrim disa përfundime. E para, në Konventën e Vjenës janë qartësisht të parapara ndikimet nga të drejtat e detyrimeve dhe ndikimet e së drejtës pronësore të kontratës së shitjes. Edhe pse për blerësin qëllimi kryesor është përmbushja e detyrimit dhe shuarja e kontratës për shitje si dhe fitimi i pronësisë mbi mallin, kjo e drejtë i është lënë të drejtave interne. Kontrata e Vjenës dorëzimin e parasheh që ka kuptimin e

²⁵⁹ Shih më shumë: Boris Vizner & Ivan Bukljaš. *vepër e cituar*, vëllimi 3, fq. 1560.

²⁶⁰ *Uzansat e përgjithshme*, Uzansa nr. 94.

përgjegjësisë kryesore të shitësit, përgjegjësi e shitësit e cila për shitësin tejkalon kontratën e shitjes që cila është tërësisht e pavarur nga fitimi i pronësisë dhe posedimit ndaj mallit. Dorëzimi llogaritet si akt i thjeshtë i shitësit, që gjegjësisht përfshin ato veprime të cilat shitësi duhet t'i kryejë që t'ia mundësojë blerësit fitimin e pronësisë dhe posedimin mbi sendin. Veprimi i dorëzimit është veprim i përmbushjes (*die Leistungshandlung*), derisa suksesi i përmbushjes (*der Leistungserfolg*), i cili shikohet në aspekt të fitimit të pronësisë nga ana e blerësit, nuk është pjesë përbërëse e dorëzimit.²⁶¹ Prandaj, dorëzimin shitësi mund ta përmbushë vetëm nga njëra anë, pa bashkëpunim dhe ndërmarrje të veprimeve të tjera nga ana e blerësit. E dyta, me këtë klasifikim të dorëzimit janë të qarta dy përgjegjësi të ndara, që shitësi mallin ta dorëzojë dhe detyrimi i blerësit që mallin ta marrë nga ana e shitësit. Legjislacioni ynë (LMD) rregullon në mënyrë të përkryer marrëdhëniet detyimore, por nuk bën dallimin në mes të dorëzimit dhe bartjes së sendit. Nga kjo mund të konkludojmë se malli i dorëzuar nga ana e blerësit nënkupton edhe bartjen e pronësisë nga shitësi te blerësi. Dorëzimi sipas legjislacionit tonë kuptohet si veprim me anë të së cilës shitësi e bën bartjen e pronësisë së sendit te blerësi, me çka, i mundëson blerësit që sendin ta përdorë, ta shfrytëzojë dhe ta ketë në zotërim. Prandaj, sipas LMD-së, dorëzimi domethënë edhe bartje sepse dorëzimi do të thotë mënyrë e fitimit të pronësisë. Sipas LMD-së, përgjegjësia për dorëzim është veprim i dyanshëm sepse nevojitet veprim bilateral (i dyanshëm), sepse për realizimin e saj kërkohet edhe bashkëpunimi i blerësit. Në rastet kur dorëzimi i sendit nuk ka ndodhur për shkak të mosbashkëpunimit të blerësit (vonesa e blerësit), risku kalon te blerësi në momentin kur ky ka ardhur me vonesë. Nga kjo që është shënuar më lart shihet se për dorëzim nevojitet veprim i dyanshëm (bilateral), dhe nevojitet gjithsesi bashkëpunimi i blerësit. Kjo dukuri nuk është e përshtatshme sepse realizimi i detyrimit kryesor të shitësit varet tërësisht nga blerësi.

LMD-ja me nocionin blerje nënkupton dy dukuri. E para, shitësi është i obliguar që sendin e shitur t'ia dorëzojë blerësit në vendin dhe kohën e caktuar me kontratë. Kjo është dukuri kur në rastet që sendin (mallin) e dorëzon vetë shitësi te blerësi. Ndërkaq, kur është fjala për dorëzimin e mallit nga një vend në një vend tjetër, malli i cili duhet dorëzuar tek transportuesi, shitësi detyrimin e tij e kryen në momentin kur dorëzon sendin tek transportuesit ose te shpediteri. Në këtë rast ky paraqet veprim unilateral (të njëanshëm) sepse malli nuk i është dorëzuar blerësit, por as përfaqësuesit të tij, sepse dorëzimi i mallit tek transportuesit është “akti i

²⁶¹ Shih më shumë: Peter Schlechtriem, “Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht, fq. 317.

fundit”, për detyrimin e tij kryesor, DORËZIMIN, të cilin e kryen vetë shitësi.²⁶² Sipas disa teorive dorëzimi i mallit tek transportuesit nuk është dorëzim dhe nuk përbën kryerjen e detyrimit kryesor të shitësit, por është dorëzim juridik. Dorëzimi ndodh dhe në rastet simbolike, me dorëzimin simbolik të gjërave të sendit kryesor (nëse dorëzohen çelësat e shtëpisë, të veturës etj).

Dorëzimi duhet të jetë si obligim i pastër i shitësit, përmbajtja e së cilit varet nga kontrata dhe varet prej situatës faktike. Detyrimi i dorëzimit edhe ashtu të çon te fitimi i pronësisë, dhe detyrimi i bartjes së pronësisë nuk është pjesë përbërëse e përgjegjësisë së shitësit për dorëzim, por këto janë dy përgjegjësi të ndara të shitësit. E derisa fitimi i pronësisë është i rregulluar me norma të së drejtës sendore, ndërkaj për bartjen apo dorëzimin e mallit janë të mirëseardhura normat e së drejtës obligative. Po ashtu, edhe detyrimi i dorëzimit është i pavarur nga bartja e pronësisë. Siç kemi parë në shqyrtimet e mëhershme, është e mundur që në të njëjtën kohë të kryhet dorëzimi dhe bartja e posedimit, por, ato nuk janë të varura nga njëra - tjetra.

Nocioni i dhënë në uzansa të përgjithshme nuk është nocion që nuk shpjegohet në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë, por nocioni i dorëzimit në uzansa më shumë i përgjigjet nevojave tregtare.

Mendojmë që është e domosdoshme që dorëzimi të përcaktohet si veprim i njëanshëm i shitësit. Kjo domethënë se vetëm nga shitësi duhet të varet kryerja e tij dhe duhet të konsiderohet që malli është dorëzuar në momentin kur shitësi ka ndërmarrë veprimet e fundit në atë drejtim. Ky orientim çon edhe në rregullimin më preciz të përgjegjësisë së shitësit për dorëzim të mallit (përmbushje të detyrimit). Si në të drejtën ndërkombëtare po ashtu edhe në uzansat e përgjithshme duhen vështuar ndaras veprimet e përmbushjes dhe rezultatet e përmbushjes.

²⁶² Shih më shumë: Malden Draškić. (1966). *Obaveze prodavca prema unifikovanim propisima o medunarodnoj Kupoprodaji*, Beograd, fq. 33.

KAPITULLI IV: PËRGJEGJËSIA E SHITËSIT PËR DORËZIMIN E MALLIT NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE

IV. 1. Vështrime të përgjithshme

Marrëdhënia e detyrimeve është marrëveshje juridike në të cilën njëra palë i besueshmi, dhe i autorizuari nga pala tjetër, të detyruarit i kërkon veprim të caktuar, dhe borxhliu është i detyruar që ta kryejë këtë. Secila marrëdhënie detyrimore pa marrë parasysh se për çka është krijuar, prodhon një veprim të caktuar juridik - i besueshmi në marrëdhëniet e detyrimeve krijon ndaj borxhliut të drejtën subjektive në kërkesë, të drejtën subjektive që të kërkojë përmbushjen e detyrimit të tij. Detyra kryesore e borxhliut është pra pagesa e borxhit, ose më mirë të themi përgjigjja për kërkesën e të autorizuarit.

Lëndë e interesimit tonë në këtë punim nuk janë të gjitha marrëdhëniet detyrimore, por vetëm ato të cilat burimi i tyre paraqitet në kontratë. Qëllimi i shuarjes së çdo kontrate është përmbushja e saj, plotësimi i obligimeve të palëve kontraktuese. Edhe kontrata si marrëdhënie detyrimore, ka ndikim në krijimin e së drejtës subjektive të të besuarit dhe kërkesës, që është i drejtuar drejt krijimit të kësaj të drejte subjektive. E drejta detyrimore gjithmonë është drejtuar kah përmbushja e detyrimit nga ana e borxhliut dhe për këtë arsye quhet *kërkesa parësore*. Po ashtu, detyrimi prej nga është drejtuar kërkesa mund ta quajmë *detyrim parësor*. Është e mundur që debitori të mos përmbushë detyrimin e tij parësor sipas kontratës, ose nuk e përmbush atë aspak, ose vonohet deri te përmbushja e tij. Nëse vjen deri te cenimi i marrëveshjes kontraktore nga ana e borxhliut, në anën e kreditorit krijohet edhe një kërkesë, kërkesa për shpërblimin e dëmit. Kërkesës së tillë i përgjigjet detyrimi i borxhliut për shpërblimin e dëmit, që krijohet si pasojë juridike për shkak të mospërmbushjes së kërkesës parësore. Për dallim prej kërkesës parësore e cila i është drejtuar për përmbushjen e detyrimit kontraktor, kërkesa për shpërblim të dëmit është e karakterit dytësor, sepse ajo krijohet vetëm atëherë kur njëra nga palët kontraktuese, debitori, nuk përmbush detyrimin kontraktor. Sipas kësaj, kërkesa dytësore e kreditorit i është drejtuar për përmbushjen e detyrimit dytësor borxhliut.

Në rastet kur borxhliu e shkel detyrimin e tij, kreditori krijon të drejtën subjektive që nga ai të kërkojë veprim të caktuar ose kërkesën për shpërblim të dëmit. Kërkesa e borxhliut

ndryshon, sepse ai krahas detyrimit kryesor ka për detyrim të kryejë edhe disa veprime, pra, të shpërblejë dëmin. Nga lloji i dëmit varet se cili do jetë fati i kërkesës parësore të kreditorit, si dhe, çfarë kërkesë shtesë do të kërkojë kreditori nga ana e debitorit. Në rastet e caktuara kërkesa parësore e kreditorit për përmbushje mund të shuhet, derisa në situata të tjera ai mund të vazhdojë të ekzistojë.

IV. 2. Qëllimi i përgjegjësisë kontraktore

Palët kontraktuese janë të obliguara që të përmbushin detyrimet e tyre të cilat i kanë kontraktuar në kontratë. Mirëpo nuk vijnë gjithmonë deri te përmbushja e detyrimit. Në këto situata mund të flasim për mospërmbushje të kontratës.

Lëndë e analizës në punimin tonë nuk do të jenë të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve, por vetëm kontrata. Nëse debitori nuk e përmbush detyrimin e tij, kreditori i duron të gjitha dëmet e krijuara. Kreditori nuk mund të krijojë më si qëllim në bazë të së cilit është shuar kontrata. Në këto raste është e udhës që pala e cila ka shkaktuar dëmin, të bartë të gjitha sanksionet juridike, më mirë të themi që të përgjigjet për veprimet e veta.

Mendimi i zhvillimit të tregtisë së mallrave është një disiplinë kontraktore. Dëmtimi i kësaj marrëveshjeje dhe shkelja e detyrimit kontraktor sjell te pasoja të caktuara për palën e cila shkakton shkeljen e obligimit kontraktor. Nëse ndonjëra palë kontraktuese nuk përmbushë detyrimin, përparësi i jepet përgjegjësisë kontraktore.

Përgjegjësia kontraktore²⁶³ është sanksioni i cili e atakon palën e cila nuk e ka respektuar marrëveshjen kontraktore. Ai sanksion është i karakterit sendor, sepse atakon pronësinë e debitorit, ka të bëjë me kompensimin e dëmit të cilën pala tjetër kontraktuese e ka duruar.

Përgjegjësia mund të krijohet jo vetëm me dëmtimet e marrëveshjes kontraktore, por, me dëmtimit e secilit obligim kontraktor. Sipas kësaj, kuptimi “përgjegjësia kontraktore”, ka kuptim më të gjerë nga përgjegjësia për shkeljen e detyrimit kontraktor. Me qenë se dëmtimi në tregtinë më mallra më së shpeshti ndodh me shkeljen e detyrimit kontraktor sot është nocion i pranuar tërësisht “përgjegjësia kontraktore”. Lëndë e hulumtimit tonë nuk është përgjegjësia kontraktore në përgjithësi, por, përgjegjësia e shitësit, për shkelje të detyrimit kontraktor për mosdorëzim të

²⁶³ Sipas Ivica Jankovec «përgjegjësia kontraktore është pamje e përgjegjësisë sendore e cila merr pjesë në bazë të kushteve të caktuara, nëse njëra palë nuk vepron sipas detyrimit të saj nga ndonjë detyrimi kontraktor”. Shih më shumë: Ivica Jankovec. (1993). “Ugovorna odgovornost”, Beograd, fq. 8.

mallit në bazë të kontratës së shitjes të lidhur në mes shitësit dhe blerësit. Megjithatë, te këto shtjellime hyrëse është me rëndësi të shtjellohen edhe çasjet e përgjithshme të përgjegjësisë kontraktore.

IV. 3. Kushtet e përgjegjësisë kontraktore

Që të ndodh përgjegjësia kontraktore nevojitet që të plotësohen këto kushte: duhet të shkelet përgjegjësia kontraktore nga detyrimi kontraktor dhe duhet të shkaktohet dëmi. Këtu flitet për kushtet kontraktore të nevojshme si rrethana të qasjes në përgjegjësi kontraktore. Në fund, është e nevojshme që të ekzistojnë rrethana-kushte që paraqesin përgjegjësinë për palën e cila e ka shkelur detyrimin kontraktor. Këto janë paramendime negative të përgjegjësisë kontraktore. Nëse ekziston ndonjë rrethanë e cila përfshinë përgjegjësinë e palës, e cila, e ka shkelur detyrimin kontraktor, pastaj përmbushja e të gjitha kushteve pozitive nuk mund të sjell deri te përgjegjësia kontraktore.

Përgjegjësia kontraktore do e vë në pah vetëm me shkeljen e detyrimit kontraktor nga “detyrimi i plotfuqishëm detyrimor”,²⁶⁴ Është shumë e rëndësishme të ekzistojë kontrata e plotfuqishme, sepse vetëm atëherë mund të flasim për përgjegjësi kontraktore, sepse baza kryesore e saj është *iustus titulus*, dëmtimi i përgjegjësisë kontraktore ekzistuese. Sipas kësaj, kontrata e plotfuqishme është kusht për përgjegjësi kontraktore.

Nga ana tjetër, nëse nuk ekziston detyrimi në mes dy subjekteve, nëse veprimi i kontratës ka ndaluar ose kontrata nuk është e vlefshme, ndërkaq njëra palë, palës tjetër i shkaktën dëm, atëherë ekziston detyrimi i kompensimit të dëmit por sipas bazës tjetër. Atëherë flasim për përgjegjësi jashtëkontraktore. Me shkaktimin e dëmit në mes dy palëve kontraktuese krijohet një veprim juridik, përmbajtjen e të cilit e përbën detyrimi i shpërblimit të dëmit. Sipas kësaj përgjegjësia jashtëkontraktore e shpërblimit të dëmit paraqet përmbajtjen primare të marrëdhënies kontraktore.

Ekzistimi i kontratës së plotfuqishme është e përshtatshme për dallimin në mes detyrimit kontraktor dhe atij jashtëkontraktor. Derisa baza e përgjegjësisë jashtëkontraktore të kompensimit të dëmit nuk e krijon dëmi i bazës së përgjegjësisë kontraktore, deri këtu kushtin e

²⁶⁴ Ivica Jankovec. (1993). “*Ugovorna odgovornost*”, Beograd, fq. 9.

përgjegjësisë jashtëkontraktore nuk e krijon dëmi i një detyrimi të mëhershëm ekzistues, por, shkaktimi i dëmit.

Nga kjo që u tha më lartë është e rëndësishme të ekzistojë marrëdhënia e plotfuqishme kontraktore, sepse pa ekzistimin e kontratës së plotfuqishme nuk ka përgjegjësi kontraktore.

Ratio e ekzistimit të përgjegjësisë kontraktore është shpërblimi i dëmit. Nëse palës tjetër kontraktuese nuk i është shkaktuar dëm me rast të shkeljes së detyrimit kontraktor atëherë nuk ka vend për përgjegjësi kontraktore.

Shkaktimi i dëmit është fakt i zvogëlimit të pasurisë së dikujt dhe dëmtimit të pasurisë së tij. Nëse është fjala për shkaktimin e dëmit ose të zvogëlimit apo pengimit të pasurisë së dikujt ka ardhur si pasojë e mospërbushjes së detyrimit kontraktor, atëherë vet fakti i shkaktimit të dëmit, dhe *ipso iure* krijohet kushti juridik që quhet përgjegjësia për dëmin.

Veprimi kryesor i këtij veprimi juridik detyrimor ka të bëjë me detyrimin e debitorit gjegjësisht shkaktuesit të dëmit që ta kompensojë dëmin. Shkaktimi i dëmit mund të sjell deri te ndërrimi i detyrimit primar të kontratës ose në rastet e caktuara, deri te shuarja e kontratës.

IV. 4. Dëmtimi i përgjegjësisë së përbushjes

Problemi i mëparshëm i analizës së përgjegjësisë kontraktore të shitësit për dorëzimin e mallit, në rast të mospërbushjes së detyrimit të tij (shitësit), dhe detyrime tjera shtesë është problematika se në cilat situata konsiderohet se ka ardhur deri te shkelja e kontratës nga ana e shitësit²⁶⁵ si dhe çka domethënë nocioni “shkelje e kontratës”.

Në Konventën e Vjenës flitet për *mospërbushje të kontratës*. Afër nocionit mospërbushje, Konventa e Vjenës përdor nocionin shkelje të kontratës (*die Vertragsverletzung, breach of contract*). Për shkelje të kontratës flitet në nenin 25 të Konventës së Vjenës, e cila e definon si të rëndësishme shkeljen e kontratës. Përkundër kësaj titulli i pjesës III të kapitulli II është: “Mjetet të cilat i posedon blerësi në rast të shkeljes së kontratës nga ana e shitësit”. Në neni 49 paragrafi 1, pika (a) e Konventës së Vjenës, në të njëjtën normë përdoren dy nocione dhe parashihet e drejta e blerësit që të shuaj kontratën nëse mospërbushja e çfarëdo marrëveshjeje nënkupton shkelje të kontratës.

²⁶⁵ Shih më shumë: Ivica Jankovec. (1993). “Ugovorna odgovornost”, Beograd, fq. 25.

Dallimi në mes të nocioneve të cekura nuk është vetëm çështje e natyrës së gjuhës por rrënja e saj ka dallimet që ekzistojnë në mes sistemeve të së drejtës. Në të drejtën kontinentale kontratën e krijojnë të drejtat dhe detyrimet e ndryshme, dhe kështu është e mundur të shkelet me mospërbushjen e një apo më shumë prej këtyre detyrimeve. Përkundër kësaj në të drejtën anglosaksone, shkelja e kontratës aplikohet në tërësi²⁶⁶. Prandaj, nocioni shkelje e kontratës është karakteristikë e sistemit common law dhe nënkupton shkeljen e kontratës në tërësi, nga ana tjetër, mospërbushja varet nga shkelja e një ose më shumë detyrimeve individuale dhe terminologjinë e rrënjësore për të drejtën kontinentale.

Sipas mendimit tonë, kuptimet mospërbushje dhe shkelje e kontratës në Konventën e Vjenës kanë kuptim të njëjtë.²⁶⁷ Shkelja e kontratës (mospërbushja) kuptohet në aspektin më të gjerë, nuk bëhet dallimi në mes çështjes kur shitësi nuk e ka përmbushur fare detyrimin, ose nuk e ka përmbushur në tërësi kontratën. Nga kjo kuptojmë se ekzistojnë dy kuptime mospërbushja dhe gjysmëpërbushja.

Në burimet autonome pa dallim përdoret nocioni mospërbushja e detyrimit kontraktor. Sipas 8:101 PECL “Kur pala nuk e përmbush detyrimin të cilin e ka sipas kontratës... pala e dëmtuar mund të aplikojë disa mjete juridike që parashihen në nenin 9”. Si në Konventën e Vjenës edhe këtu me një kuptim mospërbushje përfshihen të gjitha mënyrat e shkeljes së kontratës. “Mospërbushja mund të përmbajë gjysmëpërbushjen ose përmbushjen e parakohshme, nëse përmbushja ka ardhur më herët, shumë më vonë ose nuk ka ardhur kurrë.”²⁶⁸

UPC-të adaptojnë një kuptim të mospërbushjes. Sipas neni 7 UPC mospërbushja ekziston atëherë kur pala nuk përmbush cilëndo nga detyrimet e veta të cilat i ka të përcaktuara në kontratë, duke përfshirë edhe gjysëmpermbushjen (përmbushjen jo të plotë) ose përmbushjen e vonuar. Nga kjo shohim se neni 7 i cili quhet definicioni i mospërbushjes, sqaron se çka do të konsiderohet mospërbushje. Për dallim nga Konventa e Vjenës dhe PECL, me këtë normë shprehimisht është paraparë që mospërbushja duhet kuptuar në kuptimin e gjerë. Sipas mendimit tonë kjo mënyrë e trajtimit të nocionit mospërbushje është e dobishme sepse nuk lë vend për paqartësi të cilat mund të krijohen gjatë krijimit të thelbit të këtij kuptimi.

Sipas LMD-së debitori duhet të përmbushë detyrimin e tij, ashtu si ajo është e nënshkruar me kontratë. LMD-ja nuk zgjerohet më tej, por përgjigje në këtë pyetje mund të japim duke

²⁶⁶ Barry Nicholas. (1979). Force Majeure and Frustration, 27 American Journal of Comparative Law, fq.245.

²⁶⁷ Peter Schlechtriem. Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht, fq. 460.

²⁶⁸ Ole Lando & Hugh Beale, vepër e cituar, fq. 359.

trajtuar në hollësi normat në përgjithësi dhe parimet. Gjithsesi, debitori me rastin e përmbushjes së detyrimit të tij duhet të veprojë në raport me parimet e së drejtës së detyrimeve, e para së gjithash me parimin e respektimit dhe besimit, si dhe me parimin *pacta sunt servanda*. Debitori është i detyruar që gjatë përmbushjes së detyrimit të tij të jetë i kujdesshëm e cila në drejtësi synon në llojin përkatës të marrëdhënieve detyrimore.

Kuptimi shkelje e kontratës përdoret si kuptim i përgjithshëm ku përfshihet edhe kompensim i dëmit. Debitori është i obliguar të kryej detyrimin e tij, por, detyrimi duhet të përmbushet tërësisht. Është e mundur që debitori të përmbushë detyrimin, por ta përmbushë pjesërisht. Përmbushja e detyrimit, pjesërisht është e rregulluar me norma, me të cilat është e rregulluar kontrata e shitblerjes. Prandaj, sipas kësaj, shkelja e kontratës është kuptim i përgjithshëm, e cila përfshinë rastet kur detyrimi kontraktor nuk është përmbushur, ose është përmbushur me vonesë, ose është përmbushur pjesërisht.²⁶⁹

IV. 5. Llojet e shkeljeve kontraktore dhe rëndësia e tyre për përgjegjësinë e shitësit

Në shitjen ndërkombëtare të mallrave me një parim të vetëm janë përfshirë të gjitha dëmet për të gjitha detyrimet të cilat burojnë nga kontratat ose nga Konventa e Vjenës. Kjo Konventë i ndan dëmet në dëme të rëndësishme dhe dëme jo të rëndësishme. Nëse flitet për dëmin e rëndësishëm të kontratës, pala e cila i ka qëndruar besnike kontratës mund të zgjedh se, a do të kërkojë që të shuhet kontrata, apo ajo të përmbushet nga pala e cila e ka shkelur kontratën. Në të dy rastet pala ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit. Te dëmi jo i rëndësishëm, pala që ka respektuar kontratën, duhet t’ia mundësojë palës tjetër (e cila nuk ka respektuar kontratën) edhe një afat shtesë për përmbushje të kontratës. Atëherë, nëse edhe pas këtij afati, debitori nuk përmbushë detyrimin, ose kur deklarohet që nuk do e përmbushë detyrimin, pala që ka respektuar kontratën mund ta shuaj atë. Ai në çdo rast ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit. E drejta jonë dhe të gjitha të drejtat tjera të cilat i takojnë sistemit civil law nuk e njohin këtë ndarje.

²⁶⁹ Ivica Jankovec, (1993).“Ugovorna odgovornost”Beograd, fq. 25; Gjithashtu: Jelena Perović. Komentar Zakona o obligacionim odnosima, Beograd, 1995, fq. 586.

Pasojat e dëmeve të rëndësishme, janë shumë më të mëdha. Dallimet e dëmit të rëndë dhe atij të thjeshtë përcaktojnë se cilat norma duhet zbatuar që të shpërblehet pala e dëmtuar. Pala e dëmtuar në këtë rast blerësi ka të drejtë të kërkojë kompensimin dhe shpërblimin e dëmit.

Shkeljet e kontratës mund të ndahen në dy grupe. Grupin e parë, e përbëjnë shkeljet të cilat shkaktojnë automatikisht shuarje të kontratës, kur ndodh anulimi i saj. Nëse afati i përmbushjes së kontratës është element esencial i kontratës, atëherë, nëse ai nuk respektohet nga ana e debitorit, vjen automatikisht te shuarja e kontratës. Në të gjitha rastet tjera kreditori nëse dëshiron ta shuaj kontratën, i duhet debitorit që t'ia mundësojë edhe një afat shtesë për përmbushjen e kontratës.

Grupin e dytë të shkeljeve e përbëjnë ato shkelje që nuk çojnë deri te shuarja e kontratës. Kjo ndarje ka rëndësi praktike. Në rast se vjen deri te shuarja e kontratës shpërblimi i dëmit vendoset në vend të përmbushjes së detyrimit nga kontrata e shuar. Nga ana tjetër nëse shuarja e kontratës nuk është pasojë e mospërmbushjes, kreditori nga debitori mund të kërkojë edhe përmbushjen e detyrimit edhe shpërblimin e dëmit.²⁷⁰

IV. 6. Përmbajtja e normave për përgjegjësinë e shitësit

Kur përmbushen detyrimet sipas marrëveshjes, atëherë kontrata shuhet. Në shumicën e rasteve, kontratat përmbushen dhe nuk vjen deri te aplikimi i normave që rregullojnë cenimin e saj. Normat e përgjegjësisë kontraktore krijojnë bërthamën e së drejtës kontraktore.

Kontratat e shitjes rregullisht përmbajnë rregulla përfundimtare të cilat i qasen përmbushjes së tyre. Qëllimi i saj është se palët në momentin e shuarjes së kontratës besojnë se secila nga palët duhet të përmbushë detyrimet e tyre të përcaktuara me kontratë. Nëse njëra palë cenon marrëveshjen, pala tjetër mund të shfrytëzojë mjete të caktuara juridike. Për secilin cenim të kontratës së plotfuqishme, duhet të ekzistojë një mjet i caktuar juridik, sepse nuk mund të flitet për një marrëveshje të detyrueshme (detyrim).²⁷¹

²⁷⁰ Shih më shumë: Ivica Jankovec, (1993). "Ugovorna odgovornost", fq. 26.

²⁷¹ Herbert Bernstein & Josef Lookofsky. (1997). Understanding the CISG in Europe – A Compact Guide to the 1980 United Nations Convention on the Contracts for the International Sale of Goods, Dordrecht, fq. 81.

Kushtet materiale të përgjegjësisë së shitësit për përmbushje për shitjen ndërkombëtare të mallit janë të parapara me neni 45 paragrafi 1, pika (b), Konventa e Vjenës, ndërkaq me nenin 74-77 të Konventës së Vjenës është i rregulluar shpërblimi i dëmit dhe rregullat e llogaritjes.

Normat për përgjegjësinë e shitësit që i përmban Konventa e Vjenës kanë karakter plotësues. Me rastin e analizës të përgjegjësia e shitësit duhet të ketë parasysh natyrën dispozitive të normave që përmban Konventa e Vjenës, gjegjësisht palët kanë të drejtë të ndërrojnë apo përbyllin ndikimin e urdhëresave të saj (neni 6, Konventa e Vjenës). Palët janë të lidhura jo vetëm me marrëveshje të lidhur shprehimisht, por edhe me zakone dhe praktikë të krijuar në mes tyre (neni 9, Konventa e Vjenës). Për këtë arsye, kur shqyrtohet çështja e përgjegjësitë kontraktore të shitësit fillimisht duhet analizuar kontrata e shuar, zakonet dhe praktikën e krijuar në mes palëve, e në fund vet Konventën e Vjenës.

E drejta jonë pozitive përgjegjësinë e shitësit për mungesa materiale dhe juridike i konsideron gjithashtu dispozitive. Autonomia e vullnetit të palëve kontraktuese në këto raste i nënshtrohet kufizimeve të caktuara. E para, përgjegjësia për qëllimin dhe moskujdesin nuk mund të shuhet paraprakisht me kontratë. Përgjegjësia mund të shuhet vetëm për pakujdesi të thjeshtë, nëse marrëveshja e tillë ka lindur nga pozita monopoliste e shitësit ose nga pabarazia e palëve kontraktuese.

IV. 7. Natyra juridike dhe kuptimi i përgjegjësisë së shitësit për dorëzim të mallit në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore

Rregullat për përgjegjësinë kontraktore paraqesin bërthamën e së drejtës kontraktore. Nëse kontrata është dhunuar, për palën e dëmtuar është e një rëndësie të madhe çështja se cilat mjete juridike janë në dispozicion. Në bazë të asaj që u cek më lartë me rastin e formulimit të normave për përgjegjësinë në Konventën e Vjenës janë udhëhequr diskutime të shumta. Edhe rregullat për përgjegjësinë janë si normat tjera që përmban kjo konventë e karakterit dispozitiv. Dallimet që ekzistojnë në mes common law dhe civil law kanë ardhur edhe një herë në shprehje. Domethënë pasqyra është që përgjegjësia e bazuar në faj (përgjegjësi subjektive) është e drejta bazë në të drejtën bashkëkohore e që e drejta e tij objektive mund të jetë vetëm përjashtim. Përkundër kësaj pjesëmarrësit e shkollës tradicionale anglosaksone do të jenë tërësisht kundër

kësaj çështjeje. Në sistemin common law e civil law shkelja e kontratës kuptohet ndryshe, e si pasojë e kësaj edhe e drejta e shpërblimit të dëmit.

Në vendet që i takojnë sistemit kontinental e edhe në të drejtën tonë, përgjegjësia lidhet me dëmin e dëmtuesit, gjegjësisht nëse shkaktuesi i dëmit fsheh cenimin e kontratës atë e atakon përgjegjësia kontraktore. Në të drejtën anglosaksone fajësia ka rol tjetër, sepse nuk është e nevojshme dëshmia për ekzistimin e përgjegjësisë kontraktore. Te gjitha detyrimet kontraktore konsiderohen detyrime të garancisë, të ashtuquajtura garancia e rezultatit të caktuar, i cili, nëse mungon, ekziston cenimi i kontratës dhe përgjegjësia kontraktore.²⁷²

Nëse shitësi nuk përmbush detyrimet e veta të parapara sipas kontratës, Konventës së Vjenës apo zakoneve, blerësi mund të kërkojë shpërblimin e dëmit. Këto rregulla i parasheh neni 45 paragrafi 1 pika (b), e Konventës së Vjenës. Norma e përmendur paraqet bazën e parë të përgjegjësisë së shitësit, ose më mirë të themi baza e kërkesës së blerësit për kompensimin e dëmit. Edhe në praktikën gjyqësore dhe praktikën e arbitrazhit është vërtetuar që neni 45 paragrafi 1, pika (b), e Konventës së Vjenës është bazë e së drejtës sekondare të shitësit të cenimi i kontratës.²⁷³

Vet fakti që shitësi ka bërë shkeljen e kontratës dërgon deri te përgjegjësia e tij. Analoge me këtë, është edhe cenimi i detyrimit që si pasojë ka ecurinë e përgjegjësisë së shitësit. Për përgjegjësinë e shitësit është e nevojshme edhe *shkelja e mjaftueshme* e kontratës si fakt objektiv. Me fjalë të tjera, baza e përgjegjësisë së shitësit është vet cenimi i kontratës. Kjo do të thotë se shitësi për dorëzimin përgjigjet sipas parimeve të përgjegjësisë objektive. Përgjegjësia e shitësit për përmbushje në të drejtën ndërkombëtare është përgjegjësi e garantuar,²⁷⁴ e cila është e pavarur nga fajësia dhe ekziston çdo herë kur nuk ekziston rrethana që e çon në lirimin nga përgjegjësia nga neni 79 dhe 80 i Konventës së Vjenës.

Parimi i përgjegjësisë së garantuar është marrë nga e drejta anglosaksone. Mirëpo qëndrimi civil ka mbizotëruar në vështrim të rregullave të cilat varen nga lirimi i përgjegjësisë.²⁷⁵ Duke pasur parasysh mund të vërtetojmë se rregullat e përgjegjësisë kanë karakter

²⁷² Ugo Draetta, Ralph .B. Lake & Ved B. Nanda, Breach and Adaptation of International Contracts – An Introduction to Lex Mercatoria, fq. 34 i 35.

²⁷³ Germany 29 March 2001 District Court (Landgericht) Trier www.cisg.law.pace.edu; Switzerland 28 October 1998 Supreme Court www.cisg.law.pace.edu; Germany 21 March 1996 Hamburg Arbitration proceeding www.cisg.law.pace.edu

²⁷⁴ Bamberger, Roth, vepër e cituar, fq. 2840; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, vepër e cituar, fq. 2428; Peter Schlechtriem, Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht, fq. 458.

²⁷⁵ Herbert Bernstein & Josef Lookofsky, vepër e cituar, fq. 98

kompromisi.²⁷⁶ Që të mund të pretendojë kompensimin e dëmit blerësi nuk duhet të dëshmojë fajësinë ose mungesën e kujdesit dhe besimit e cila kërkohet në tregti. Me fjalë të tjera, përgjegjësia e shitësit nuk është e lidhur me cilëndo dëshmi ose supozim që ai e ka fshehur cenimin e përmbushjes së përgjegjësisë kontraktore.

Esenca e përgjegjësisë objektive bazohet në atë së shkaktuesi i dëmit, përgjigjet pavarësisht fajësisë. Mirëpo kjo nuk do të thotë që domosdo ekziston përgjegjësia pa fajësi, por, do të thotë që është kusht i përgjegjësisë. Më së shpeshti shkaktari i dëmit do të jetë edhe fajtor për dëmin, por, i dëmtuari ka të drejtë në kompensim në bazë të detyrimit të kryerësit që të bartë mbi vete riskun e dëmit.²⁷⁷

Parimi i përgjegjësisë objektive është më strikt nga parimi i përgjegjësisë subjektive. Megjithatë, këtë pretendim në një masë të madhe e zbut fakti se as sistemi i përgjegjësisë objektive, as sistemi i përgjegjësisë subjektive, nuk janë absolut. Gjithashtu dallimet më evidente që ekzistojnë në mes tyre, janë më shumë në teori se në praktikë. Në praktikë shumica e rasteve në të cilën bëhet shkelja e kontratës është pakujdesia, e ai i cili është sjellë me pakujdesi, ai nuk mund të thirret në fuqi madhore (vis major).²⁷⁸ Duke u bazuar në këtë, në marrëdhëniet ndërkombëtare përgjegjësia objektive shpejton shuarjen e marrëdhënieve ndërkombëtare të cilët janë problematike.²⁷⁹ Dhe në fund ndikimi i rregullave për përgjegjësinë e garantuar është lehtësuar me ndikimin e lirimit nga përgjegjësia që është e rregulluar me nenin 79 dhe 80 të Konventës së Vjenës.

Në të drejtën tonë natyra e përgjegjësisë së shitësit ka dallim në varësi të llojit të dëmit të detyrimit të përmbushjes. Shitësi për mospërmbushje dhe vonesë me dorëzimin e mallit përgjigjet në bazë të rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë kontraktore. Në rastet e caktuara përgjegjësia e tij fillon me fajësinë, ai përgjigjet sipas parimeve të përgjegjësisë subjektive me fajësi të supozuar. Në bazë të kësaj ekzistimi i pakujdesisë së thjeshtë (culpa levis), derisa mënyrat më të rënda të fajësisë pakujdesia e rëndë dhe dashja) nuk përcaktojnë, por këto i dëmtuari duhet të dëshmojë. Në teorinë dhe praktikën tonë fajësia nga neglizhenca kuptohet

²⁷⁶ “...our English colleagues suspecting that the fault principle had entered through the back door of the excuses under Art. 79(1) of the CISG, while (German) scholars suspected seeing the devil’s cloven hoof of strict contractual liability.” Peter Schlechtriem, Basic Structures and General Concepts of the CISG as Models for a Harmonisation of the Law of Obligations, *Juridica International*, X/2005, fq. 33.

²⁷⁷ Jakov Radišić, vepër e cituar, fq. 193.

²⁷⁸ Shih më shumë: Ivica Jankovec, “vepra e cituar”, fq. 99.

²⁷⁹ Bianca -Bonell, vepër e cituar, fq. 332.

objektivisht, ndërsa sjellja e shitësit krahasohet me standardet e njeriut të kujdesshëm. Shitësi gjatë përmbushjes së detyrimit është i detyruar të ketë kujdes i cili kërkohet në tregti. Përkundër kësaj, secili kujdes nuk është kujdes i tregtarit të mirë, gjegjësisht nuk është e mjaftueshme për ekspert (specialist), kjo paraqet kujdes të pamjaftueshëm. Sipas kësaj, sjellja e shitësit llogaritet si abstrakt ndaj modelit abstrakt të tregtarit apo ekspertit të mirë, e jo konkretisht sipas mundësive individuale. Ne konsiderojmë që kujdesi është kuptim objektiv të cilin shitësi duhet ta dëshmojë gjatë dorëzimit dhe prezanton garancinë e heshtur për përmbushje të detyrimit.

Nga ana tjetër, është e një rëndësie tjetër fajësia, si pasojë e kësaj, natyra e përgjegjësisë së shitësit për të metat materiale dhe juridike. Shitësi përgjigjet për të metat materiale dhe juridike të cilat i ka pasur malli në momentin e bartjes së rrezikut në blerësin, pa marrë parasysh se a ka qenë në dijeni. Të metat i ndajmë në dy lloje: Të meta të dukshme dhe të padukshme. Do të konsiderohen të dukshme ato të meta të cilat duhet të konstatohen me një vëmendje dhe një vështrim të zakonshëm nga ana e blerësit, aty për aty në çastin e marrjes së dorëzimit të sendit.²⁸⁰ Të dytat janë ato të meta të cilat duhet të konstatohen me një vëmendje dhe një vështrim të zakonshëm nga ana e blerësit, aty për aty në çastin e marrjes së sendit.²⁸¹ Të meta konsiderohen të gjitha ato vese të fshehta të sendit edhe ato të cilat megjithëse nuk e pengojnë përdorimin e tij, e zvogëlojnë në mënyrë të ndjeshme vlerën e sendit duke e bërë të vështirë ose të papërshtatshëm përdorimin e tij.²⁸²

Sipas kësaj, blerësi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit në momentin e pranimit të mallit me të meta materiale, pa marrë parasysh se a e ka ditur shitësi për ekzistimin e këtyre mangësive (të metave). Në këtë rast shitësi përgjigjet, sikur edhe në shitjen ndërkombëtare të mallit, sipas parimeve të përgjegjësisë objektive (garantuese) pa marrë parasysh fajësinë.

Në këtë rast shitësi ka pranuar çmimin kontraktor duke llogaritur që malli ka tipare kontraktore. Po të dinte që malli ka të meta, ai ose nuk do ta blinte, ose do ta blinte me çmim më të lirë. Në bazë të kësaj, nënkuptohet se shitësi mund të zbulojë mungesat (të metat) po të kishte investuar me një kujdes më të shtuar. Nëse lejohet të dëshmohet e kundërta do të çojë deri te mosmarrëveshje të shumta.²⁸³ Dhe në fund, duhet pasur parasysh që përgjegjësia kontraktore paraqet instrument për ndarjen e rrezikut nga një punë. Shitësi, i cili nuk e ka ditur dhe as ka

²⁸⁰ Mariana Tutulani - Semini (2006). *vepër e cituar*, pjesa e posaçme, Skanderbag books, Tiranë, fq. 16.

²⁸¹ Po aty, fq 16.

²⁸² Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). *E Drejta e Detyrimeve II*, Tiranë, fq 17.

²⁸³ Shih më shumë: Ivica Jankovec, *vepër e cituar*, fq. 152.

mundur ta dijë që malli ka të meta nuk është fajtor, por megjithatë bart përgjegjësi për këtë. Shkaku qëndron në atë se blerësi bart dëmin, sepse dëmi nuk mund të ketë lidhje me të.²⁸⁴ Sipas kësaj, sikur edhe tek të metat materiale të mallit të dorëzuar, shitësi për të metat juridike të mallit të dorëzuar përgjigjet sipas parimeve të përgjegjësisë së garantuar. Argumentet që shërbejnë për justifikim të vendimit të përmendur janë të njëjta edhe te përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të mallit të dorëzuar.

IV. 7.1. Kushtet për paraqitjen e përgjegjësisë së shitësit për vonesën e përmbushjes

Te kontratat e shitjes koha luan një rol shumë të rëndësishëm. Vonesa në përmbushjen e detyrimeve kontraktore është shkelja më e rëndë e kontratës së shitjes. Nëse shitësi nuk e përmbush detyrimin me mirëbesim, besimi në marrëdhëniet kontraktore dobësohet, dhe blerësi fillon të frikësohet se: a do të përmbushet detyrimi, apo jo. Te kontrata e shitjes në tregti situata është më komplekse për shkak të lidhjes së kontratës që shuan një subjekt juridik, për shembull, blerësi në shumicën e rasteve blenë mall që ta shesë menjëherë, ndërsa vonesa e përmbushjes së një detyrimi sjell me vete edhe vonesa të tjera.

Duke u bazuar në kontratën e shitjes shitësi i ka borxh mallin blerësit, malli i cili është lëndë e kontratës dhe vonesa e shitësit me dorëzimin e mallit është rast tipik i vonesës së debitorit. Në shitjen ndërkombëtare të mallit me rastin e krijimit dhe unifikimit të rregullave kjo ka ardhur në shprehje. Në mes vendeve që i takojnë sistemit common law dhe civil law, por në mes të atyre vendeve që i takojnë sistemit kontinental ekzistojnë dallime të mëdha dhe në vetë dallimin e konceptit vonesë e shitësit, me domethënien që i qasen vonesës, si dhe në shprehjen e kushteve për praninë e përgjegjësisë për vonesën. E drejta kontinentale vonesën e shitësit rregullisht e përcakton si mospërmbushje e rregullt në kohën e caktuar.²⁸⁵

²⁸⁴ Po aty, fq. 152.

²⁸⁵ Dallimet kryesore në mes të sistemit kontinental ndahen në dy çështje. E para, a është e nevojshme të dukuria e vonesës prania e fajësisë së debitorit, gjegjësisht shitësit dhe e dyta, a është supozimi për praninë e vonesës që ekzistimi të jetë i mundshëm, ose vonesa e përfshin edhe mundësinë objektive dhe atë subjektive. Shih më shumë, Malden Draškić, (1966). Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o medunarodnoj kupoprodaji, fq. 45.

Përkundër kësaj, e drejta anglosaksone nuk e njeh vonesën si një shkelje (dhunim) të kontratës. Common Law nisat nga ideja e përgjithshme e shkeljes së kontratës (breach of contract) e cila çon në përgjegjësinë për dëmin pa marrë parasysh fajësinë.

Koha e përcaktuar e përmbushjes së detyrimit është urdhër kontraktor ashtu si edhe secila pjesë e kontratës. Dëmet e vonesës së përmbushjes së detyrimit kontraktor, varen nga parimi kryesor, nga ajo se, a është koha e përmbushjes në rastin e caktuar për kontratë “e rëndësishme” ose jo (engl. *whether time is of the essence of the contract or not*).²⁸⁶ A është përgjegjësia kontraktore e rëndësishme ose jo, gjegjësisht a është *condition* ose *warranty* që varet nga natyra e kontratës dhe nga qëllimet e palëve kontraktuese. Pa marrë parasysh, a është shkelja e detyrimit e rëndësishme shitësi do të jetë i detyruar, që blerësit t’ia kompensojë dëmin. Dallimi lind në mjetet juridike e cila në këto dy raste, posedimin që e ka blerësi në pikëpamje të përgjegjësisë kontraktore nuk është e rëndësishme.

Konventa e Vjenës, si dhe ULIS, nga këndvështrimi i sistemit anglosakson fillon nga shkelja e kontratës. Shitësi ka shkaktuar shkelje për përmbushje në kohë të caktuar vetëm atëherë nëse nuk ka dorëzuar asgjë në kohën e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar me kontratë. Nëse shitësi dorëzon çka do, blerësi mund të shfrytëzojë mjete juridike nga përgjegjësia për mungesë vullneti. Në këtë mënyrë vonesa është e barazuar me mungesën e përmbushjes në përgjithësi.²⁸⁷ E konsiderojmë se sistemi i pranuar në Konventën e Vjenës është i mirë dhe u përgjigjet nevojave tregtare. Në Konventën e Vjenës nuk ekzistojnë rregulla të posaçme të cilat rregullojnë përgjegjësinë e shitësit për vonesën, por, vonesa konsiderohet në një mënyrë shkelje e detyrimit të përmbushjes, dhe shkaqet e saj janë të rregulluara me nenin 45 të Konventës së Vjenës. Në të drejtën tonë vonesa llogaritet si vonesë e debitorit në përgjithësi si dhe normat që rregullojnë kohën e dorëzimit të mallit. Po ashtu edhe uzansat e kanë të rregulluar me norma të përgjithshme vonesën e debitorit, për të gjitha kontratat për tregti të mallrave, por dhe kanë rregulla të posaçme për kontratën e shitjes.

²⁸⁶ Ernst Rabel, *Das Recht des Warenkaufs* – eine rechtsvergleichende Darstellung, fq. 265.

²⁸⁷ Malden Draškić, (1966). *Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o međunarodnoj kupoprodaji*, fq. 47.

IV. 7.1.1. Kushtet e dukurisë së vonesës së shitësit

Kur afati për përmbushje të detyrimit nuk është element esencial i kontratës, për përgjegjësinë e shitësit, për vonesën, duhet të krijohen kushte të caktuara, të cilat ndahen në dy lloje: pozitive dhe negative. Kushtet janë pozitive atëherë kur duhet të plotësohen për paraqitjen e vonesës, derisa ekzistimi i kushteve negative ndalon vonesën e shitësit.

IV. 7.1.1.1 Kushtet pozitive

Shitësi bie në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin e tij në kohën e përcaktuar në kontratë. Ardhja e afatit, domethënë koha, kur duhen ndërmarrë veprimet të cilat përmbajnë detyrimin e dorëzimit dhe kur blerësi mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Është e nevojshme të dihet se cilat veprime duhet të ndërmarrë shitësi që ta kryejë detyrimin. Detyrimi i dorëzimit arrin në mënyra të ndryshme, varësisht prej asaj se a e parasheh kontrata e shitjes transportin e mallit dhe se shitësi duhet të vendosë mallin në dispozicionin e blerësit. Në rastin e parë shitësi është i detyruar që mallin t'ia dorëzojë transportuesit të parë, derisa në rastin e dytë është i detyruar që me mirëbesim t'ia dorëzojë mallin blerësit në vendin e përcaktuar me kontratë, domethënë malli duhet të jetë i gatshëm që blerësi ta marrë.

Arritja e afatit duhet të ketë ndryshim kur afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në kontratë ose është përcaktuar me ligj si dhe kur afati nuk është i përcaktuar. Kur afati i përmbushjes është caktuar me kontratë ose në ndonjë mënyrë tjetër (me ligj, me uzansa ose zakon) është përcaktuar ose i urdhëruar, pastaj vazhdon parimi *dies interpellat pro homine* (afati është paralajmërim për debitorin). Në këtë rast arritja është kusht i vetëm për rënien e shitësit në vonesë. Kur afati i përmbushjes ka arritur, shitësi bie në vonesë ditën tjetër pas kalimit të afatit.

Data e arritjes mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme. E para, në kontratë mund të parashihet afati i saktë i dorëzimit. E dyta, arritja mund të caktohet në mënyrë kalendarike. E treta, nëse është përcaktuar periudha në të cilën duhet dorëzuar malli sipas rregullit, arritja është e caktuar në momentin kur shitësi përcakton ditën e fundit të afatit të caktuar. Nëse afati është përcaktuar në favor të interesit të blerësit, atëherë blerësi është i autorizuar të caktojë datën kur duhet të caktohet dorëzimi.

Te detyrimet e prapambetura, sipas rregullit, kur blerësi drejton kërkesën e shitësit. Në shitjen ndërkombëtare të mallrave dërgimi i kërkesës për arritje të afatit për përmbushje të detyrimit nuk kërkohet. Kur afati i përmbushjes nuk është përcaktuar as me kontratë e as me ligj, shitësi është i detyruar të dorëzojë mallin në afatin e përcaktuar pas shuarjes së kontratës.²⁸⁸ Mospërmbushja në afatin e caktuar e sjell shitësin në vonesë. Sipas kësaj, në shitjen ndërkombëtare të mallrave nuk kërkohet dërgimi i kërkesës, dhe vonesa lidhet për arritjen pa marrë parasysh a është afati i dorëzimit i përcaktuar.

Vonesa e debitorit është një institut i së drejtës së detyrimeve, e cila gjen rregullimin juridik në dispozitat e përgjithshme mbi detyrimet.²⁸⁹

LMD-ja e rregullon vonesën e debitorit dhe parasheh nëse afati për dorëzimin e mallit nuk është përcaktuar. Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtëgjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes të detyrimit. Sipas kësaj, arritja e përmbushjes së detyrimit paraqitet në afatin e caktuar nga momenti i shuarjes së kontratës.²⁹⁰

Edhe uzansat e përgjithshme nuk përfshijnë kërkesën për arritjen e pagesës së detyrimit. Nëse afati i dorëzimit nuk është përcaktuar me kontratë konsiderohet se nxitet dorëzimi çka domethënë dorëzimi duhet të bëhet në afat prej 8 ditësh nga shuarja e kontratës.²⁹¹ Kjo do të thotë se nëse nuk dorëzohet malli brenda afatit të caktuar (në afat prej 8 ditësh), ditën tjetër pra ditën e nëntë, shitësi bie në vonesë. Vendimi që përmbajnë uzansat dhe LMD-ja dallon nga afati nga i cili shitësi është i detyruar të bëjë dorëzimin e mallit. Konsiderojmë se vendimi i marrë në Uzansat e Përgjithshme është më i mirë sepse në tregti sjell siguri dhe besim. Sipas disa autorëve, në rastet kur shitësi bie në vonesë me dorëzimin, aplikohen vendimet që përmbajnë uzansat.²⁹² Edhe pse mendojmë, që rregullat të cilat i përfshijnë uzansat, janë të mira, ato nuk mund të kenë përparësi në raport me LMD-në, vetëm nëse palët me kontratë janë marrë vesh në aplikimin e tyre.

Të përfundojmë, sipas ligjit tonë dhe sipas së drejtës ndërkombëtare për shitjen e mallit, arritja e detyrimit është kusht i vetëm për rënien e shitësit në vonesë pa marrë parasysh a është

²⁸⁸ Konventa e Vjenës, neni 33, paragrafi 1, pika c.

²⁸⁹ Marjana Tutulani - Semini, vepër e cituar, pjesa e përgjithshme, Skadnerbagbooks, Tiranë, 2006, fq. 172.

²⁹⁰ LMD, neni 302, paragrafi 2.

²⁹¹ Uzansa e Përgjithshme, Uzansa nr. 80 paragrafi 2, dhe Uzansa nr. 81.

²⁹² Vitomir Popović. (2000). Docnja prodavca sa isporukom robe, Banja Luka, fq. 75.

afati i përcaktuar. Kreditori është në vonesë, në qoftë se, pa ndonjë shkak të arsyeshëm refuzon të pranojë përmbushjen, ose me sjelljet e veta e parandalon atë. Kreditori është në vonesë edhe kur është i gatshëm të pranojë përmbushjen e detyrimit të njëkohshëm të debitorit, por nuk ofron përmbushjen e detyrimit të vet të arritur për pagesën.²⁹³ Vonesa e kreditorit i jep të drejtën debitorit që të kërkojë t'i shpërblehen dëmet që i janë shkaktuar.²⁹⁴ Debitori çlirohet nga përgjegjësia në qoftë se detyrimi i tij bëhet i pamundur më vonë dhe kur pamundësia vjen për faj të tij.²⁹⁵ Rregulli që shitësi duhet të dorëzojë mallin në afatin e përcaktuar, kur nuk është përcaktuar afati i dorëzimit, është marrë nga e drejta anglosaksone. Megjithatë, në praktikën gjyqësore common law këshillon edhe lajmërimin (njoftimin) e shitësit.²⁹⁶ Edhe në sistemin civil law mund të ballafaqohet tendenca e adoptimit të lajmërimit kur debitori është në dilemë rreth afatit të dorëzimit.²⁹⁷ Kuptimet në teoritë e brendshme dhe në ato ndërkombëtare, flasin për kontributin, që do të ishte më i mirë sesa në rastet e përmendura dhe përmbushja të ndodhë vetëm pasi blerësi të kërkojë nga shitësi përmbushjen e detyrimit. Afati i arritur me marrëveshje nuk është i përcaktuar, blerësi me kërkesë mund t'ia përkujtojë shitësit, kur ai e konsideron se ka ardhur koha e përmbushjes, ose, kur koha e përmbushjes është edhe gati në mbarim.²⁹⁸ Përkrah kësaj kërkesa e debitorit është paraparë edhe në praktikë. Duke u bazuar në atë se rregullat e Konventës së Vjenës kanë karakter dispozitiv, më e udhës do të ishte që palët të merren vesh, që të ekzistojë vonesa, dhe blerësi duhet paraprakisht të njoftojë shitësin.

Sipas mendimit tonë, kërkesa është zgjidhje e mirë, sepse pasiguria, që ekziston në mes shitësit dhe blerësit, në vështirësi të arritjes së përmbushjes së detyrimit, kur afati nuk është përcaktuar, reduktohet në masë më të vogël. Për këtë arsye do të kthehemi në atë se, çka është kërkesa, në cilën formë duhet të bëhet, çfarë natyre juridike ka, dhe në cilat raste nuk nevojitet dërgimi i kërkesës për përmbushje të kontratës.

Kërkesa (INTERPELLATIO) është thirrje apo apel për shitësit që të përmbushin detyrimin e tyre, gjegjësisht të dorëzojnë mallin. Nuk konsiderohet kërkesë çdo apel i drejtuar shitësit. Në kërkesë mund të kërkohet veprimi, i cili, është borxh dhe duhet të jetë e qartë që nga ai moment shitësi ka rënë në vonesë. Kërkesa duhet t'i drejtohet sendit i cili ka qenë lëndë e

²⁹³ LMD, neni 306, paragrafët 1 dhe 2.

²⁹⁴ Marjana Semini, vepër e cituar, pjesa e përgjithshme, fq. 178.

²⁹⁵ KCSH, neni 492.

²⁹⁶ Malden Draškić, (1966) "Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o menunarodnoj kupoprodaji", fq. 51.

²⁹⁷ Po aty. fq. 51.

²⁹⁸ Vesna Klajn-Tatić, vepër e cituar, fq. 104.

përmbushjes. Nëse blerësi në kërkesë kërkon që detyrimi duhet të kryhet në ndonjë mënyrë tjetër nga kontrata, ose të dorëzojë atë çka nuk e ka detyrim ose borxh, ajo nuk ka efekt. Kërkesën mund ta drejtojë vetëm blerësi ose përfaqësuesi i tij, ajo duhet t'i drejtohet shitësit ose përfaqësuesit të tij.

LMD-ja për kërkesën nuk parasheh asnjë formalitet. Ajo mund të bëhet shprehimisht me gojë ose me shkrim, me vërejtje gjyqësore dhe me ndërmarrjen e ndonjë veprimi, i cili aludon në përmbushjen e detyrimit. LMD-ja parasheh që kërkesën e sinjalizojnë edhe ato veprime me anë të të cilave fillon përmbushja e detyrimit.

Në teori ekzistojnë kuptime të ndryshme për natyrën juridike të kërkesës. Sipas një kuptimi, ajo është punë juridike. Qëndrimi i dytë është se kërkesa është një veprim i njëanshëm i vullnetit me anë të së cilës kërkohet përmbushja e detyrimit nga kontrata ekzistuese²⁹⁹. Me të drejtë mendojmë se me kërkesën nuk synohet krijimi, ndryshimi dhe shuarja e detyrimit.

Në rastet e tjera dërgimi i kërkesës te shitësi nuk ka kuptim. E para, kur afati i përmbushjes është i caktuar ose është i urdhëruar me ligj. E dyta, kur shitësi me arritjen e afatit të përmbushjes shprehimisht deklaron që nuk do të bëjë dorëzimin e mallit. E treta, kur shitësi mund të dijë kur duhet të dorëzojë mallin (p.sh. kur shitësi në të njëjtën kohë është edhe prodhues). Katër, kur shitësi më herët ka hequr dorë nga e drejta e kërkesës. Pesë, kërkesa nuk është e nevojshme kur, vetë shitësi deklaron që do të dorëzojë mallin në ditën e caktuar. Në fund kur shitësi e pamundëson arritjen e kërkesës ose ia pamundëson blerësit që ta dërgojë atë.

IV. 7.1.1.2 Kushtet negative

Shitësi bie në vonesë kur nuk e dorëzon me kohë mallin pa ndonjë justifikim, nëse nuk ekziston asnjë nga kushtet negative të vonesës. Në të dyja rastet nuk ka vonesë edhe afër asaj që shitësi nuk e ka përmbushur me mirëbesim detyrimin. E para, nëse shitësi kundër kërkesës së blerësit mund të parashtrojë ankesë për mospërmbushjen e kontratës (*exceptio non adimpleti contractus*). Ankesa e mospërmbushjes është mjet juridik i shitësit kundër blerësit neglizhent, i cili kërkon përmbushje, ndërkaq vetë nuk është i gatshëm që ta përmbushë detyrimin e tij.

²⁹⁹ Jakov Radišić, vepër e cituar, fq. 329; Vesna Klajn -Tatić, vepër e cituar, fq. 106; Aleksandar Goldštajn, Privredno ugovorno pravo, fq. 353.

Ankesa e mospërbushjes së kontratës nuk të çon deri te arritja e përmbushjes së detyrimit, por të çon deri te paraqitja e vonesës dhe e pasojave të saj.³⁰⁰

E dyta, vonesën e shitësit e ndalon vonesa e blerësit me pranimin e mallit. Nëse blerësi pa të drejtë refuzon që të bëjë pranimin e mallit, shitësi nuk është në vonesë. Sipas kësaj, vonesa e blerësit dhe vonesa e shitësit reciprokisht përjashtohen.

Në Konventën e Vjenës pranimi i mallit konsiderohet detyrim individual i blerësit.³⁰¹

Vonesa e blerësit me marrjen e mallit është vonesë e debitorit dhe është e përcaktuar objektivisht, kështu që për ekzistencën e saj është e mjaftueshme që blerësi të mos përmbushë detyrimin e tij në afatin e përcaktuar.

Kodi Civil Shqiptar, e rregullon detyrimin e blerësit që të marrë sendin me nenin 730 deri në nenin 737. Kodi e rregullon si detyrim të dytë të blerësit dhe e parasheh në dispozitat e tij pranimin e sendit. Blerësi është i detyruar që të marrë në dorëzim sendin ose sendet që ai i ka blerë.³⁰² Detyrimi i blerësit, për marrjen në dorëzim të sendeve të blera nga ana e tij, nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve që mund të priten prej tij në mënyrë të arsyeshme, për t'i lejuar shitësit të bëjë dorëzimin dhe blerësi të tërheqë sendet.³⁰³ Nëse blerësi nuk e pranon sendin në afatin e caktuar, ai konsiderohet me vonesë dhe mban përgjegjësi civile.³⁰⁴

Në të drejtën tonë, është zhvilluar debat për çështjen, se natyra e vonesës së blerësit me pranimin e mallit, nuk ekziston dhe në këtë rast, a bëhet fjalë për vonesën me mirëbesim të debitorit? Pa marrë parasysh si është e rregulluar vonesa e blerësit me pranimin e mallit, vonesa e blerësit përfshin edhe vonesën e shitësit. Megjithatë, kjo çështje është e rëndësishme sepse pasojat juridike të debitorit dhe të vonesës së kreditorit janë të ndryshme. Shitjen e kanë pasur të rregulluar edhe KCSH-ja e vitit 1981 që parashihte se: Me kontratën e shitjes njëra palë (shitësi) detyrohet t'i kalojë në pronësi palës tjetër (blerësit) një send dhe blerësi detyrohet ta marrë sendin dhe të paguajë çmimin e tij.³⁰⁵

Vendimet që përmban LMD-ja dhe KCSH-ja nuk janë të rregulluara mjaftueshëm. Nga kjo nuk mund të japim ndonjë përgjigje, a është pranimi i mallit detyrim apo e drejtë e blerësit? Në anën tjetër, LMD-ja me përcaktimin e kuptimit të kontratës së shitjes parasheh: Me kontratën

³⁰⁰ Vesna Klajn -Tatić, vepër e cituar, fq. 107.

³⁰¹ Konventa e Vjenës, neni 53 dhe neni 60.

³⁰² Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi, vepër e cituar - II, fq.11.

³⁰³ Po aty.

³⁰⁴ Marjana Tutulani-Semini, vepër e cituar, fq 18.

³⁰⁵ Kodi Civil Shqiptar i vitit 1981, neni 182, paragrafi 1.

e shitjes detyrohet shitësi që sendin, të cilin e shet, t'ia dorëzojë blerësit dhe t'ia kalojë të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t'ia paguajë çmimin dhe ta pranojnë sendin.³⁰⁶ Ndërkaq në KCSH-në pozitive thuhet: Kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi.³⁰⁷

Në teori nuk ekziston një qëndrim unik për përcaktimin e natyrës së vonesës së blerësit për shkarkim të përmbushjes. Sipas një mendimi, blerësi është i detyruar për dorëzimin e çmimit, ndërkaq kreditori për pranimin e mallit. Sipas kësaj vonesa e blerësit me pranimin e mallit është vonesa e kreditorit.³⁰⁸ Nocioni që është përmendur më lart është pranuar edhe nga Uzansat e Përgjithshme edhe në praktikën gjyqësore. Edhe pse uzansa nr. 70, paragrafi 3, pranimin e mallit e përcakton si detyrim të blerësit, komentaret janë unikë në qëndrim, kështu që pranimi i çmimit të blerjes paraqet të drejtën e shitësit.³⁰⁹ LMD-ja parasheh pranimin e mallit si detyrim të blerësit sepse dorëzimi është si veprim i dyanshëm, e cila nuk mund të realizohet pa dëshirën e blerësit. Nga ajo që u tha më lart nënkuptojmë se vonesa e blerësit me pranimin e mallit duhet të trajtohet si vonesë e debitorit.

Sipas mendimit tonë LMD-ja pranimin e mallit e përcakton si detyrim të blerësit dhe kjo varet edhe nga ajo pse blerësi është i detyruar të bashkëpunojë me shitësin që ky të mund të përmbushë detyrimin. Megjithatë mendojmë se përkundër detyrimit të bashkëpunimit, blerësi është debitori, kontrolli i mallit është pasuar nga vonesa e shitësit me pranimin e mallit dhe nga vonesa e kreditorit. Shitësi mund të zgjidhë kontratën në ato raste kur blerësi është në vonesë me pranimin e mallit dhe nëse krijohen kushtet dhe dyshon se blerësi nuk do të paguajë çmimin. Sipas kësaj, kur shitësi dyshon që blerësi nuk do ta paguajë çmimin me kohë dhe do të bjerë në vonesë, ai mund të zgjidhë kontratën. Që vonesa e blerësit të konsiderohet si vonesa e debitorit, atëherë shitësi, duke u bazuar në vonesën, edhe mund të ketë të drejtë të bëjë zgjidhjen e kontratës dhe rrethana që shitësi ka dyshuar që blerësi nuk do të paguajë çmimin nuk do të ketë rëndësi juridike. Në praktikë blerësi, i cili ndodhet në vonesë me pranimin e mallit, rregullisht do të ndodhet në vonesë me pagesën e çmimit, blerësi do të bjerë në vonesën e kreditorit dhe në vonesën e debitorit.

³⁰⁶ LMD, Neni 438, paragrafi 1.

³⁰⁷ KCSH i vitit 1994, neni 705, paragrafi 1.

³⁰⁸ Boris Vizner & Ivan Bukljaš, vepër e cituar, fq. 1754.

³⁰⁹ Borislav Blagojević & Vrleta Krulj, "Komentar Zakona o obligacionim odnosima", libri I, fq. 1018.

IV. 7.2. Fajësia e shitësit

Rregullat e unifikuara e rregullojnë vonesën në mënyrë objektive. Nga kjo e kuptojmë se, për ekzistimin e saj nuk është e rëndësishme pasoja e mospërbushjes së detyrimit në kohë të caktuar. Konventa e Vjenës dhe pasojat e pranisë së vonesës me dorëzimin e mallit, gjegjësisht përgjegjësia e shitësit përcaktohet objektivisht. Me shuarjen e kontratës shitësi garanton që do t'i përmbushë detyrimet e veta. Prandaj, blerësi ka të drejtë për kompensimin e dëmit sapo shitësi dorëzon mallin në kohën e caktuar dhe vendin e caktuar.³¹⁰ Për përgjegjësinë e shitësit me rëndësi është vetëm shkelja e kontratës, derisa shkaku i vonesës nuk ka rëndësi. Shitësi mund të lirohet nga përgjegjësia për vonesën vetëm nëse vonesa e tij është shkak i rrethanave që sipas nenit 79 dhe 80 përmbyllin përgjegjësinë e tij.

Në tregtinë vendore gjithashtu është pranuar qëllimi objektiv i vonesës, dhe nuk është me rëndësi se a mund të vendoset prania e vonesës si ngarkesë e shitësit. Për përgjegjësinë e shitësit për vonesën, fajësia është juridikisht e qartë, ndërkaj, ai përgjigjet sipas rregullave të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.³¹¹ Për vonesën shitësi përgjigjet sipas parimeve të përgjegjësisë subjektive me fajësinë e supozuar. Shitësi mund të lirohet nga përgjegjësia për vonesën me dorëzimin e mallit nëse janë përmbushur kushtet nga neni 158 i LMD-së, për të cilën do të flasim pak më vonë. Një prej rregullave kryesore është që shitësi nuk përgjigjet për ndodhitë, që nuk ka qenë e mundur të parashihen për rastin. Megjithatë, përgjegjësia e shitësit, që ka rënë në vonesë, është manipuluar. Ai përgjigjet edhe për mosfshehjen e pjesshme apo të tërësishme të pamundësisë së përmbushjes, nëse është paraqitur pas kalimit të tij në vonesë, për të cilën edhe përgjigjet.³¹² Sipas kësaj shitësi përgjigjet edhe nga i ashtuquajti rast i përzier (casus mixtus). Përgjegjësia strikte e shitësit tejkalon nga rregullat e përgjithshme për lidhjen shkaksore (kauzale). Rasti është i paparashikuar, por është shkak indirekt i vonesës, sepse nuk do të ndikonte që shitësi të jetë në vonesë.³¹³ Sipas kësaj, shitësi mund të lirohet nga përgjegjësia

³¹⁰ Konventa e Vjenës, neni 45, paragrafi 1.

³¹¹ Shih LMD-në, neni 154, paragrafi 1. Vonesa e debitorit konsiderohet si delikt civil, dëmet e së cilit nuk trajtohen si veprime juridike të vonesës së debitorit, por si pasojë e përgjegjësisë kontraktore për dëmin e shkaktuar, të cilat, si të tilla, nuk përmbushin disa rregulla të posaçme për ndikimet e vonesës, por nën rregullat e përgjithshme për kompensimin e dëmit për shkak të shkeljes së detyrimit ekzistues, cituar nga Boris Vizner, "Komentar Zakona o obaveznim (obligacionim) odnosima", libri 2, Zagreb, 1978, fq. 1209.

³¹² LMD, neni 262, paragrafi 4.

³¹³ Jakov Radišić, vepër e cituar, fq. 332.

vetëm nëse dëshmon që, sendi i cili është lëndë e detyrimit, rastësisht i ka skaduar afati dhe që ai detyrimin e tij e ka përmbushur me kohë.³¹⁴

IV. 8. Përgjegjësia e shitësit në rastet e shkeljes së kontratës me dorëzimin e mallit

Shitësi është i detyruar të dorëzojë mallin në gjendje të rregullt. Madje sendi duhet të dorëzohet në gjendjen në të cilin ka qenë në rastin e lidhjes së kontratës. Të dyja palët kontraktuese kanë të drejta dhe detyrime, malli duhet të dorëzohet ashtu si ka qenë në momentin e verifikimit. Shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar në kontratë.³¹⁵ Si detyrë e dytë e shitësit është dorëzimi i sendit pa të meta. Nëse malli dorëzohet në mënyrë jo të rregullt, gjithsesi shitësi do të jetë ai që do të përgjigjet për mallin i cili nuk është dorëzuar në gjendje të rregullt. Malli nuk duhet të ketë mungesa materiale, por as mungesa juridike. Të metat juridike ndahen në dy kategori dhe ato ndahen në të meta të dukshme dhe të fshehura. Konsiderohen të dukshme ato të meta, të cilat duhet të konstatohen me një vëmendje dhe me një shikim të zakonshëm nga ana e blerësit, aty për aty në çastin e marrjes në dorëzim të sendit.³¹⁶ Nuk ekzistojnë rrethana të cilat çojnë në lirimin e shitësit nga përgjegjësia.

IV. 8.1. Vështrime të përgjithshme

Në studimet krahasuese të së drejtës³¹⁷ Rabeli ka dëshmuar dallimet në mes të drejtave nacionale në rregullimin e përgjegjësisë së shitësit për mungesat që kanë sendet gjatë dorëzimit të mallit. Së pari ka analizuar dallimet në mes conditions dhe warranties të së drejtës kontinentale, e pastaj dallimet e normave juridike të shteteve që i takojnë sistemit civil law dhe ka propozuar gjetjen e definicionit të përgjithshëm për të metat e sendeve (të mallit).³¹⁸

³¹⁴ Shih më shumë: LMD, neni 262, paragrafi 5.

³¹⁵ LMD, neni 450, paragrafi 1.

³¹⁶ Marjana Tutulani - Semini, vepër e cituar, pjesa e posaçme, fq.16.

³¹⁷ Ernst Rabel, Das Recht des Warenkaufs – eine rechtsvergleichende Darstellung, Band 1 dhe 2.

³¹⁸ Ernst Rabel, vepër e cituar, Band 2, pjesa VI, fq. 101-291.

Për herë të parë³¹⁹ kuptimi i korrespondencës është paraparë në nenin 19 të ULIS me rastin e përkufizimit të nocionit përmbushje. Kjo mënyrë e përcaktimit të kuptimit me të drejtë është kritikuar,³²⁰ e më vonë me hartimin e Konventës së Vjenës është anashkaluar. Konventa e Vjenës në përgjithësi ndan përgjegjësinë e përmbushjes së mallit dhe detyrimin e shitësit që të dorëzojë mallin jo konform kontratës. Derisa sipas ULIS-it jokonformiteti i mallit do të thoshte mospërmbushje e detyrimit, sipas Konventës së Vjenës mospërputhshmëria me kontratën nuk ka ndikim në dorëzim, gjegjësisht në përmbushje.

Pasojat e kësaj ndarjeje janë se shitësi mund të kryejë detyrimin e dorëzimit, por në rast të jokonformitetit të mallit, blerësi mund të shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike që janë përmendur në nenin 45 të Konventës së Vjenës. Si përfundim, në rast të dorëzimit të mallit nga ana e shitësit, por të një mallit që nuk është mall i cilësisë dhe vlerës së njëjtë, sipas marrëveshjes që kishin palët kontraktuese në kontratë, atëherë bëhet fjalë për përmbushjen e detyrimit, por që nuk është në raport me marrëveshjen që është lidhur nga palët kontraktuese.

Koncepti i jokonformitetit ka dashur të heqë të gjitha vështirësitë, të cilat kanë qenë të pranishme dhe janë krijuar gjatë detyrimit të veçantë të shitësit, i cili garanton për dëmet e mallit me sanksione të veçanta. Krijimi i një koncepti të përbashkët, të paraqitjes jokonforme të mallit, dhe mënyrat e rregullimit të përgjegjësisë së shitësit, i cili i përgjigjet nevojave të tregtisë ndërkombëtare dhe që në të njëjtën kohë dallon nga shumica e të drejtave nacionale. Kjo çasje është produkt i kompromisit, e ka qenë i nevojshëm për të tejkaluar dhe kapërcyer dallimet në mes të drejtave nacionale. Megjithatë, duhet të potencohet që dallimet në mes të vendimeve të Konventës së Vjenës dhe Konventës së të drejtave nacionale nuk janë dramatike për dy arsye. E para, për krijimin e nenit 35 të Konventës së Vjenës, i cili rregullon jokonformitetin. Janë marrë si model normat nacionale që shërbejnë si rregulla në shumë vende. E dyta, dallimi kryesor është në shkallën e përgjithshme. Megjithatë, e drejta nacionale përmban norma më të detajuara dhe që kanë të bëjnë me dallimin më delikat që e bën Konventa e Vjenës.

Si gjithmonë edhe vendosja e kuptimit të ri ka sjellë me vete vështirësitë e caktuara. Nga kuptimi i qytetarëve, jokonformiteti i mallit dhe si e rregullon Konventa e Vjenës. Nuk ka rëndësi dallimet, të cilat, ekzistojnë në disa sisteme të së drejtës së dorëzimit peius dhe aluid kur

³¹⁹ Kuptimi i konformitetit (conformity) ekziston në Ligjin e veçantë tregtar Amerikan, por ka kuptim më të gjerë, që në të ardhmen përfshin secilën shkelje të detyrimeve kontraktore. Prandaj sipas kësaj, jokonformiteti i kontratës mund të jetë sjellja e shitësit, si dhe dorëzimi në një numër më të vogël të mallit. Shih më shumë: Malden Draškić, (1966). “Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o menunarodnoj kupoprodaji”, fq. 69.

³²⁰ Shih më shumë: Jelena Vilus, e të tjerë, vepër e cituar, fq. 202, 203.

blerësi si shtesë, mund të përkrahë edhe aluidin, i cili nuk mund të mbështet si shtesë. Gjithashtu, nuk bëhet dallimi i përmbajtjes së mallit dhe i garancisë së posaçme në rastet kur malli posedon karakteristika të caktuara.

Fakti se flitet për kuptimin e përgjithshëm mund të merret parasysh në rastin e aplikimit të saj sepse në të kundërtën ekziston një rrezik i madh që secila gjykatë do të aplikojë nenin 35 të Konventës së Vjenës sipas klasifikimit personal, që do të ishte ndikim negativ i dyfishtë. E para, vetë Konventa e Vjenës do të largohet nga teksti bazik i saj, dhe e dyta, dallimet në qasje do të ndalonin në aplikimin e njëanshëm dhe në unifikimin e së drejtës. Gjithashtu, me rastin aplikimit të Konventës së Vjenës, në vështirimin e jokonformitetit të mallit, nuk mund të aplikohet nga ligji vendor, sepse rregullat që përmban e drejta nacionale janë të ndryshme. Nga kjo mund të nisemi se në secilin rast konkret duhet t'i përmbahemi asaj sesi palët janë dakorduar në kontratë, por edhe me rregullat e nenit 7, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës për aplikimin e saj. Kjo domethënë që jokonformiteti duhet të interpretohet duke pasur parasysh karakterin ndërkombëtar të Konventës së Vjenës si dhe nevojën që të përparojë uniformiteti i aplikimit të saj në të gjitha shtetet.

IV. 8.2. Kuptimi i konformitetit

Këtë çështje e kanë diskutuar shumë teoricienë. Normat juridike ndërkombëtare, të cilat së pari e kanë rregulluar këtë çështje, janë dispozitat e ULIS-it. ULIS-i e ka rregulluar këtë çështje me nenin 19, paragrafi 1, neni 33, paragrafi 1 dhe neni 36. Janë këto norma, që kanë prezantuar shembullin dhe modelin më të mirë, me rastin e krijimit të këtij vendimi i cili edhe sot është pjesë brenda Konventës së Vjenës. Konventa e Vjenës, neni 35, rregullon çështjen e konformitetit dhe nuk prezanton ndërrimin thelbësor të normave të përmendura, por para së gjithash është më i lehtë, më interpretues, me tekst më të kuptueshëm. Shitësi duhet të dorëzojë mallra të cilat janë në sasinë, cilësinë dhe përshkrimin e kërkuar në kontratë dhe që mbyllen ose paketohen në mënyrën e kërkuar nga kontrata.³²¹

Në Konventën e Vjenës nuk është shprehur kuptim i caktuar i konformitetit, por nga paraqitja e të gjithë pjesës së dytë, konformiteti i mallrave, të drejtat dhe kërkesat e personave të tretë, si dhe nga të gjitha nenet, duke filluar nga neni 35 deri në nenin 44 të Konventës së Vjenës

³²¹ Konventa e Vjenës, neni 35, paragrafi 1.

mund të nxirren vetëm dy përfundime. E para, si në të drejtat ndërkombëtare edhe në Konventë bëhet dallimi në mes përgjegjësisë për konformitetin e mallit në njërin anë, dhe përgjegjësinë për mungesat juridike, nga ana tjetër. Prandaj, jokonformiteti i mallit paraqet të gjitha të metat e mallit që nuk mund të mbulohen. E dyta, Konventa Europiane aplikon kuptimin e veçantë të konformitetit të mallit e cila përfshin të gjitha performancat fizike të mallit, jo vetëm shmangia nga kualiteti, por edhe dallimet në sasi, dorëzimi aluid dhe të metat në paketimin e mallit. Me nenin 35 të Konventës së Vjenës është paraparë detyrimi i shitësit, që të dorëzojë mallin konform kontratës. Shitësi duhet të dorëzojë mallra të cilat janë në sasinë, cilësinë dhe përshkrimin e kërkuar në kontratë dhe që mbyllen ose paketohen në mënyrën e kërkuar nga kontrata.³²²

Konformiteti ka bazën e tij që lidhet me bazën e garancisë për të metat fizike si detyrime të posaçme të shitësit. Edhe LMD-ja e rregullon konformitetin e mallit duke potencuar te kontrata me shpërblim, ku secili kontraktues përgjigjet për të metat materiale të mospërmbushjes së vet.³²³ Meqë shitësi është ai që ka i bërë ofertë blerësit atëherë është ai që duhet t'ia paraqesë të gjitha cilësitë për sendin e shitur blerësit. Në këtë rast ai gjithsesi duhet ta mbrojë blerësin nga të metat apo mungesat e sendit të shitur.³²⁴

Megjithatë jokonformiteti prezanton kuptimin e gjerë për sa i takon kuptimit të mungesave fizike të mallit, që është baza e përgjegjësisë së shitësit sipas së drejtave nacionale.³²⁵ Lidhur me çështjen ose më mirë le të themi me detyrimin e caktuar flet edhe LMD-ja dhe KCSH-ja që në dispozitat e tyre përfshijnë përgjegjësinë për të metat juridike dhe materiale në mënyrë taksative.

Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit, të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut te blerësi, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit.³²⁶

Edhe legjislacioni civil shqiptar detyrimin e dorëzimit për të metat (mangësitë, mungesat) e përkufizon në këtë mënyrë: Shitësi është përgjegjës për çdo mangësi ose mospërputhje që ekzistonte në momentin e kalimit të rrezikut te blerësi, edhe kur e meta shfaqet pas këtij momenti.³²⁷

³²² Konventa e Vjenës, neni 3, paragrafi 1.

³²³ LMD, neni 103, paragrafi 1.

³²⁴ Majlinda Belegu, Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese si bazë për funksionimin e ligjit në shtetin e së drejtës, punim në konferencën e organizuar nga Universiteti i Tetovës, 12 mars, 2014.

³²⁵ Georges Vermelle. (2006) E Drejta Civile, Kontratat-Pjesa e Posaçme, Papirus, fq. 53.

³²⁶ Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 461, paragrafi 1.

³²⁷ Kodi Civil Shqiptar, neni 716, paragrafi 1.

Jokonformiteti përfshin rastet e përmbushjes në sasi më të vogël, gjegjësisht kur malli i dorëzuar ka të meta fizike. Gjithashtu, jokonformiteti paraqitet në rastet kur në të drejtat nacionale janë të ndara nga përgjegjësia e të metave fizike, gjegjësisht për jokonformitetin mund të flitet edhe në rastet e dorëzimit të pjesshëm, dorëzimi i një sasi më të vogël ose më të madhe të mallit. Jo sipas kontratës kur palët janë marrë vesh për dorëzimin e mallit dhe përmbushjes aluid.

Konformiteti i mallit përfshin detyrimin e shitësit që të dorëzojë mallin në sasi, në cilësi dhe lloj siç është paraparë me kontratë; malli duhet të jetë i mbështjellë dhe i ruajtur në mënyrën e paraparë në kontratë.³²⁸ Rregulli i parë është që, për konformitetin e mallit është e zbatueshme ajo për çka janë marrë vesh palët kontraktuese. Megjithatë, nëse marrëveshja në mes të palëve kontraktuese, për çështjet që mungojnë, konformiteti vlerësohet sipas kriterëve objektive që janë paraparë në Konventën e Vjenës.³²⁹

Për krijimin e secilës kontratë, por edhe për krijimin e kontratës ndërkombëtare për shitjen e mallit është e nevojshme që palët kontraktuese të arrijnë marrëveshje për elementet e rëndësishme të kontratës. Sipas Konventës për lidhjen e kontratës së plotfuqishme, për shitjen e mallit, palët duhet të arrijnë marrëveshje për llojin dhe sasinë e mallit. Në Konventën e Vjenës neni 14, paragrafi 1, parashihet që oferta për shuarje të kontratës duhet të jetë e mjaftueshme dhe duhet të tregojë për tendencën e ofertuesit, që të detyrohet në rast të pranimi të saj. Oferta është e përcaktuar nëse në të është përcaktuar malli shprehimisht ose në heshtje dhe është vërtetuar sasia e mallit. Në këtë rast, ekzistojnë elemente për përcaktimin e saj. Etiketimi i mallit nënkupton që palët janë përcaktuar për çfarë lloji të mallit që flitet. Nga kjo e shohim, që lloji i mallit, duhet të jetë i përcaktuar dhe kjo mund të kryhet shprehimisht ose në heshtje. Nga ana tjetër, sasia mund të jetë e përcaktuar, nëse përcakton elementet e ofertës.

Duke pasur parasysh këtë, mund të themi se ekzistimi i secilës kontratë të shitjes *conditio sine qua non*, përcakton vërtetimin e llojit dhe sasisë së mallit. Sipas kësaj, është e mundshme që palët nuk e përcaktojnë cilësinë e mallit, i cili është lëndë kontraktore, atëherë zbatohen kriteret e përmendura objektive në Konventën e Vjenës, në nenin 35, paragrafi 2 .

Dhe në fund, duhet pasur në konsideratë lista nga Konventa e Vjenës, neni 35, paragrafi 1, që detyrimi i shitësit përmban dorëzimin e mallit të cilësisë së përcaktuar me kontratë, sasisë, llojit

³²⁸ Konventa e Vjenës, neni 35, paragrafi 1.

³²⁹ Konventa e Vjenës, neni 35, paragrafi 2.

dhe paketimit ose të mbrojtur nga mënyra e përcaktuar me kontratë, e cila nuk është e përmbyllur.³³⁰ Nga kjo mund të themi që palët mund të merren vesh se malli duhet të përmbushë edhe kërkesa të tjera, për shembull, normat zakonore në vendin e përdorimit të mallit. Nëse ekziston një marrëveshje e tillë atëherë kuptimi i konformitetit, përfshi edhe performancën e kontraktuar të mallit, shitësi përgjigjet për të gjitha performancat për të cilat blerësi, falë kontratës do të presë shumë nga malli.

E drejta jonë nuk e njeh shprehjen konformitet. LMD-ja flet për përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit. Sikurse edhe në Konventën e Vjenës edhe LMD-ja, kuptimi i të metave materiale nuk është qartësisht i përcaktuar. Në nenin 462 është përcaktuar se ekzistojnë të metat materiale. Pranë kësaj, ligji bën dallim në mes të të metave të dukshme dhe atyre të fshehura,³³¹ por i njeh edhe mungesat materiale të pjesshme dhe ato minore. Blerësi ka për detyrë që sendin e pranuar ta shikojë ose ta japë në kontroll sapo kjo të jetë e mundur sipas rrjedhës së rregullt të gjërave dhe për të metat e dukshme të lajmërojë shitësin në një afat kohor prej tetë (8) ditësh, ndërsa ndryshe ndodh te kontratat midis ndërmarrësve pa shtyrje, ku e humb të drejtën që i takon mbi këtë bazë.³³² Ndërkaq të metat e fshehta, parashihen në LMD si më poshtë. Kur pas marrjes së sendit nga blerësi shihet se sendi ka ndonjë të metë, e cila nuk ka qenë e mundur të zbulohet me kontroll të rëndomtë me rastin e marrjes së sendit (e meta e fshehtë), blerësi është i detyruar me kërcënim të humbjes së të drejtës, që për atë të metë të lajmërojë shitësin në një afat prej tetë (8) ditësh, duke u llogaritur prej ditës kur e ka zbuluar të metën, ndërsa te kontrata midis ndërmarrësve menjëherë.³³³ KCSH-ja i qaset të metave ose veseve nga neni 716-723.

Nga kjo është e nevojshme që të kryejmë analizën kur konsiderohet se ekzistojnë të meta materiale dhe të rregullohet në bazë të marrëdhënies së nocionit për të metat materiale dhe nocionit jokonformitet. Përgjegjësia për të metat materiale dhe të përmbushjes, paraqet ndikimin juridik të të gjitha kontratave të dyanshme. Përgjegjësia e shitësit për të metat materiale paraqet detyrimin e shitësit që të garantojë blerësin dhe të përgjigjet për të metat materiale të mallit. Shitësi në çdo kohë duhet t'i garantojë blerësit se sendi është në gjendje për një përdorim normal.³³⁴ Disa grupe teoricienësh të metat i ndajnë në të meta të dukshme dhe në të meta të padukshme për efekte të analizës. Të metat ose vese e fshehta të sendit të blerë duhet të jenë të

³³⁰ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, Wiener UN-Kaufrecht (CISG), Berlin, 2005, fq. 355.

³³¹ Shih më shumë: LMD, neni 464 dhe 465.

³³² LMD, neni 464, paragrafi 1.

³³³ Po aty, neni 465.

³³⁴ Georges Vermelle. (2008). "E Drejta Civile-Kontratat-Pjesa e Posaçme", Papirus, Tiranë, fq. 53

tilla që ta bëjnë të paaftë sendin për përdorim, pra për atë që sendi është i destinuar ose përndryshe duhet të ulin në një masë të konsiderueshme vlerën e tij.³³⁵

Me nocionin të meta materiale janë përfshirë fillimisht mungesat fizike. Mungesat fizike janë të rregulluara edhe me uzansa, që edhe ato sipas uzansave quhen defekte³³⁶, derisa në teori janë të pranishme defektet fizike³³⁷ dhe dëmet e mallit.³³⁸ Dëmtimet fizike paraqesin secilën qasje të sendit të shitur nga performanca të tilla të cilat ajo duhet t'i ketë sipas kontratës me zakonet e punës.³³⁹ Kjo do të thotë që defekti i mallit prezanton devijimin nga cilësia e mallit për të cilat shitësi garanton, gjegjësisht përgjigjet. E dyta, kuptimi i veseve materiale përfshin edhe dorëzimin e mallit në sasi më të vogël. Në vështrim të parë mund të duket që defektet në sasi të mallit të dorëzuar nuk janë përfshirë në kuptimin e defekteve materiale, edhe pse si defekte materiale LMD-ja nuk përcakton mungesat kuantitative. Megjithatë LMD-ja rregullon të drejtat e blerësit në rast të ekzistimit të të metave të pjesshme, që ne i shohim se, defektet e pjesshme ekzistojnë vetëm kur në një pjesë të sendit ka defekte, ose kur i është dorëzuar vetëm një pjesë e sendit dhe sasi më e vogël se ajo e kontraktuar. Sipas kësaj edhe dorëzimi i një sasi më të vogël të mallit nënkupton defekt material.

Prandaj, një qëndrimi i tillë ka bastion (mbështetje) edhe në teori.³⁴⁰ E treta, edhe pse LMD-ja shprehimisht nuk e pranon në teori³⁴¹, por në praktikën gjyqësore ekziston bashkëmendimi që edhe mungesa e paketimit mund të konsiderohet si defekt material. Siç e shohim kuptimi i defekteve materiale është më i gjerë se mungesat fizike. E fundit, edhe pse ligji ynë këtë nuk e parasheh shprehimisht, ne i konsiderojmë si qëndrime të sakta, sipas të cilave dorëzimin fluid, në raste të caktuara, duhet ta trajtojmë si defekt material. Posaçërisht për këtë, në një pjesë të teorisë sonë, ekziston qëndrimi se përdorimi i nocionit defekt material nuk është i përshtatshëm dhe përdorimi i nocionit konformitet do t'i përshtatej më shumë. E konsiderojmë që udhëheqja e këtij kuptimi konformitet, do të ishte më e përgjithshme dhe në raport me zhvillimin e së drejtës së shitblerjes. Gjithashtu me kuptimin (jo) konformitet do të përfshiheshin

³³⁵ Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). E drejta e Detyrimeve II, Tiranë, fq.17

³³⁶ Uzansat e Përgjithshme, Uzansa nr. 135.

³³⁷ Aleksadar Goldštajn, "Privredno ugovorno pravo", fq. 263. Po ashtu: Malden Draškić, (1966). "Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o menunarodnoj kupoprodaji", fq. 69.

³³⁸ Vladimir Kapor, "Ugovor o kupovini i prodaji robe – Tumač opštih uzansi za promet robom", fq. 149.

³³⁹ Aleksadar Goldštajn, Privredno ugovorno pravo, fq. 263.

³⁴⁰ Po aty.

³⁴¹ Shih më shumë: Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, Komentar Zakona o obligacionim odnosima, libri II, , fq. 73.

të gjitha rastet e përmendura më lart dhe në këtë mënyrë do të eliminoheshin problemet e kualifikimit të rregullt, që mund të krijohen në rastet e kufirit, e për çka do të flasim më shumë në shqyrtimet e mëvonshme.

IV. 8.3. Dorëzimi i mallit me të meta fizike

Shitësi është i detyruar që t'ia dorëzojë blerësit sendin në gjendje siç ka qenë në rastin kur është lidhur kontrata.³⁴² Sendet dorëzohen në gjendjen në të cilën ndodhen në momentin e përfundimit të kontratës.³⁴³ Nëse shitësi nuk e dorëzon mallin ashtu si e parasheh ligji, atëherë ai përgjigjet për këto veprime. Këtë e parasheh edhe KCSH-ja dhe LMD-ja. Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit, të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut te blerësi, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit.³⁴⁴ Gjithmonë sipas nenit 461, por në paragrafin pasues përfshihet ajo që: Shitësi përgjigjet edhe për ato të meta materiale të cilat shfaqen pas kalimit të rrezikut te blerësi, në qoftë se janë pasojë e shkakut që ka ekzistuar më parë. E meta materiale e parëndësishme nuk merret parasysh.³⁴⁵ Shitësi duhet të dorëzojë sendet në cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e caktuar në kontratë.³⁴⁶

Bazën e tyre kuptimi i konformitetit dhe mungesave materiale e kanë te garanci institucionale për defektet si detyrime të veçanta të shitësit. Defekti paraqet mungesën natyrore ose normale të përsosmërisë së sendit, e cila ndryshon për secilin send, për të cilën blerësi ka të drejtë të presë.³⁴⁷ Defekti mund të kuptohet si çdo joprefeksionalitet i sendit (kuptimi konceptual i defektit) ose si joprefeksionalitet që mundëson ose pengon përdorimin e saj (kuptimin funksional të defektit). Përshkrimet pozitive, ato ndërkombëtare dhe ato vendore adaptojnë kuptimin funksional të defektit. Nëse në rastin e vlerësimit ekziston me mirëbesim defekti për atë që palët shprehimisht e kanë kontraktuar heshturazi, në pyetje është kuptimi subjektiv i defektit. Nga ana tjetër, nëse joprefeksionaliteti i mallit vlerësohet sipas përdorimit të rregullt atëherë

³⁴² Nerxhivane Dauti. (2012). "Kontratat", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2012, fq.137.

³⁴³ KCSH, neni 711, paragrafi 1.

³⁴⁴ LMD, neni 461, paragrafi 1.

³⁴⁵ LMD, neni 461, paragrafi 1 dhe 2.

³⁴⁶ KCSH, neni 715, paragrafi 1.

³⁴⁷ Malden Draškić, (1966). "Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o menunarodnoj kupoprodaji", fq. 75.

është fjala për kuptimin objektiv të defektit.³⁴⁸ Sendet thuhet që nuk janë në përputhje me kontratën po qe se nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm, të caktuara nga kontrata, përveçse kur ka marrëveshje të kundërt.

Në Konventën e Vjenës dhe në LMD është përfshirë kuptimi objektiv-subjektiv i të metave. Te shitja ndërkombëtare cilësia e mallit mund të jetë caktuar në dy mënyra. E para, performancat të cilat duhet të posedojë malli konform kontratës mund të vlerësohen subjektivisht, me vullnetin e palëve kontraktuese. E kur në marrëveshjen e palëve ekziston zbrazëti, atëherë zbatohen kriteret objektive të konfirmuara me Konventën e Vjenës. Kriteret e Konventës kanë rol plotësues dhe rol të kufizuar, sepse ato zbatohen vetëm në mungesë të rregullave kontraktore të lidhura shprehimisht ose heshturazi për cilësinë e mallit.

Në anën tjetër LMD-ja nuk përcakton se çka janë defektet materiale, por përmend rastet në të cilat konsiderohet që defekti ekziston. Të metat numërohen në mënyrë taksative në LMD në këtë mënyrë: E meta ekziston në qoftë se sendi nuk ka veçoritë e duhura për përdorimin e tij të rregullt ose për qarkullim; në qoftë se sendi nuk ka veçoritë e duhura për përdorim special për të cilën e blen blerësi, e që e ka pasur të njohur shitësi, ose është dashur ta kishte të njohur; në qoftë se sendi nuk ka veçori dhe karakteristika të cilat janë kontraktuar shprehimisht ose në heshtje, përkatësisht që janë caktuar; kur shitësi e ka dorëzuar sendin, që nuk i është përshtatur mostrës ose modelit, përveçse nëse mostra ose modeli janë treguar vetëm për qëllime njoftimi.³⁴⁹

Ndërsa ligji në vend të parë vendos përshtatshmërinë e mallit për përdorim dhe për tregti të rregullt, e më vonë citon që malli duhet të posedojë performanca të kontraktuara. Konsiderojmë se e drejta jonë përparësi i jep kuptimit objektiv të të metave. A është porositur malli me të meta fizike, përcaktohet përparësia sipas përmbajtjes së kontratës, gjegjësisht malli duhet të ketë performanca të kontraktuara. Përkundër kësaj, kuptimi abstrakt i përdorimit të mallit për nevoja të zakonshme ka kuptim dytësor dhe zbatohet vetëm atëherë nëse kontrata ose rrethanat nuk tregojnë diçka tjetër. Në fund, nëse palët nuk e kanë përcaktuar me kontratë se çfarë cilësie duhet të ketë malli, që është lëndë e kontratës, aplikohen kriteret objektive shtesë nga neni 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës.

³⁴⁸ Po aty.

³⁴⁹ LMD, neni 402, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4.

IV. 8.3.1. Kuptimi subjektiv i defektit (i të metave) së mallit

Shitësi duhet të dorëzojë sendet në cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe të ambalazhuara në mënyrën e caktuar në kontratë.³⁵⁰ Shitësi është i detyruar të dorëzojë mallin në sasi, në cilësi dhe në lloj siç është paraparë në kontratë, por dhe të paketuar ose të mbrojtur në mënyrën e paraparë në kontratë.³⁵¹ Sipas neni 462 të LMD-së të metat materiale ekzistojnë atëherë nëse sendi nuk ka performanca dhe forma të cilat palët kontraktuese i kanë përcaktuar në kontratë. Gjithashtu sipas neni 33, paragrafi 1, pika (f) e ULIS-it, shitësi nuk e ka përmbushur detyrimin e dorëzimit kur ka dorëzuar sendin i cili nuk ka karakteristikat e parapara me kontratë. Rregullat e përfshira në LMD janë të njëjta me rregullat ndërkombëtare. Nga kjo shohim se shitësi e ka për detyrim t'ia dorëzojë mallin me cilësinë e caktuar në kontratë blerësit. Kur bëhet fjalë për cilësinë e rregulluar me kontratë kjo është e vetmja që zbatohet, bile edhe nëse malli, për shembull, nuk i ka performancat e zakonshme. Të gjitha këto norma të përmendura më sipër konfirmojnë parimin e autonomisë së vullnetit të palëve kontraktuese, si një prej kushteve bazë të së drejtës kontraktore dhe dispozitivitetin e rregullave të cilat i përmban edhe LMD-ja, Konventa e Vjenës dhe ULIS-i. Megjithatë duhet vërejtur në Konventën e Vjenës që parimi i autonomisë së vullnetit është parim bazë, ndërsa sipas LMD-së dhe ULIS-it pëlqimi për dorëzimin e mallit është kusht thelbësor. Konsiderojmë se rregullat që përfshin Konventa e Vjenës janë të mira për dy arsye. E para, sepse deklarojnë se me rastin e vlerësimit të konformitetit të mallit përparësi ka ajo palë e cila ka qenë qëllimi i palëve, gjegjësisht atë çka palët janë marrë vesh. Prandaj sipas kësaj, te vlerësimi i konformitetit së pari duhet trajtuar atë çka palët kanë konfirmuar në kontratë me firmat (nënshkrimet) e tyre. E dyta, nga neni 35, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës shihet qartë se çka përfshin kuptimi konformitet.

Cilësia e paraqitjes është kuptimi material më i rëndësishëm i mallit. Me cilësinë e mallit nënkuptohet aftësia fizike e mallit (p.sh. vjetërsia) si dhe të gjitha të drejtat faktike dhe rrethanat të cilat varen në raport me mallin dhe rrethinën e tij.³⁵² Sipas kësaj cilësia përfshin pamjen fizike të mallit në kuptimin e ngushtë, por edhe veti të tjera të cilat varen nga malli dhe nga nevojat e tregtisë si edhe nga kërkesat e blerësit. Blerësi çdo herë blen mallin duke pasur një qëllim të caktuar, dhe është i interesuar që t'i dorëzohet malli i cilësisë së caktuar. Prandaj edhe nëse

³⁵⁰ KCSH, neni 715, paragrafi 1.

³⁵¹ Konventa e Vjenës, neni 35, paragrafi 1.

³⁵² Peter Schlechtriem, "Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)", fq. 277.

malli ka vese ai duhet të jetë i njoftuar me kohë nga ana e shitësit. Mungesa e konformitetit në vështrim të cilësisë do të ekzistojë nëse shitësi dorëzon mallin e cilësisë më të dobët apo më të mirë nga ajo e kontraktuar. Me rastin e vlerësimit, se a ekzistojnë mungesat fizike të paraqitjes së sendit, merren raportet sendore dhe juridike të cilat sipas kuptimit të tregut ndikojnë në vlerën e sendit.³⁵³ Ndërsa në pikëpamje të mungesës së konformitetit, nuk është e rëndësishme që, mungesat (dëmet) të cilat i ka malli të atakojnë mundësinë e përdorimit dhe të vlerës së mallit, është e parëndësishme se nga mungesa e cilësisë, e përcaktuar me kontratë, nuk do të mund të përdoren sipas mënyrës së planifikuar ose vlera e tij është më e vogël se ajo që është supozuar. Ky dallim mund të jetë me vlerë me rastin e humbjes, të cilën blerësi e ka duruar për shkak të jokonformitetit me rastin e matjes për kompensimin e dëmit. Sipas Konventës së Vjenës, por edhe sipas uzansave dhe LMD-së cilësia ka rëndësi juridike sepse me të janë të përfshira të gjitha karakteristikat fizike që duhet t'i posedojë malli sipas kontratës.

Neni 35, i Konventës së Vjenës, udhëzon që, shitësi është i detyruar të veprojë në mënyrën e paraparë me kontratë. Ajo çka nuk ekziston me Konventën e Vjenës dhe tek ULIS-i është se malli i dorëzuar duhet të ketë karakteristikat dhe format e caktuara, ndërkaq këtë e parasheh edhe LMD-ja. Karakteristikat e mallit në kontratë mund të jenë të përcaktuara shprehimisht ose në heshtje apo edhe në mënyrë të tërthortë.

IV. 8.3.1.1. Marrëveshja eksplicite

Një prej kushteve të përgjithshme për lidhjen e kontratës është vullneti i palëve kontraktuese. Palët vullnetin e tyre mund ta shprehin shprehimisht ose në heshtje. Pëlqimi i vullnetit duhet të jetë i dyanshëm, sepse që të lidhet kontrata, vullneti i dyja palëve kontraktuese duhet të jetë i përputhur.³⁵⁴ Marrëveshja eksplicite e palëve në sasi, cilësi dhe në lloj të mallit nënkupton që në kontratë qartësisht dhe detajisht, në rrugë të përshkrimeve kuantitative dhe cilësore, janë përcaktuar karakteristika të caktuara të cilat duhet t'i posedojë secili mall që është lëndë kontraktuese. Mënyra e përmendur e mallit është më e mira sepse lë më pak hapësirë për pakënaqësi, por palët shumë rrallë në shumë raste, me rastin e marrëveshjes, veprojnë në këtë mënyrë. E para, ato çdo ditë shuajnë një numër të madh kontratash dhe zakonisht dorëzimi i

³⁵³ Aleksadar Goldštajn, "Privredno ugovorno pravo", fq. 263.

³⁵⁴ Nerxhivane Dauti. (2001). "E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Veçantë", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.

mallit është çështje rutinore dhe kërkon përmbushje të shpejtë, dhe kështu rregullimi në detaje i të gjitha çështjeve çon në vështirësimin e tregtisë vendore, dhe posaçërisht atë ndërkombëtare. E dyta, shpeshherë nuk merren vesh për karakteristikat e mallit, të cilat janë të ditura, për shembull, makina e blerë duhet të jetë në rregull dhe duhet të punojë.

Theksimi i hollësishëm i karakteristikave (vetive), të cilat duhet të posedojë malli, mund të jetë e ofruar ose e përcaktuar vetëm për sende të caktuara. Atëherë pranimi i ofertës do të thotë pranim që malli do të përdoret vetëm për raste të caktuara dhe se do të ketë veti të caktuara.³⁵⁵

Afër marrëveshjes për vetitë individuale që malli duhet të ketë, është e mundur që palët të kontraktojnë cilësitë e mallit dhe thirren shprehimisht në kushte të përgjithshme të punës së shitësit ose blerësit. Konformiteti i mallit mund të jetë i përcaktuar shprehimisht edhe nëse palët merren vesh për përdorimin e zakonit të caktuar.³⁵⁶

IV. 8.3.1.2. Marrëveshja e heshtur

Për marrëveshjen e heshtur mund të flasim atëherë kur nuk ka marrëveshje eksplicite, por që vullneti i palëve kontraktuese është qartësisht i shprehur. Kjo përfshin rastin, nëse palët në kontratën e tyre kanë përmbushur dërgimin sipas standardeve të caktuara industriale.³⁵⁷ Gjithashtu marrëveshja e heshtur paraqitet nëse shitësi i ka treguar blerësit, dhe ky e ka dorëzuar sendin pa përcaktime të posedimit.

Pastaj marrëveshja e heshtur e palëve kontraktuese edhe pse janë plotësuar të gjitha kushtet për aplikim të heshtur të kushteve të përgjithshme të punës së shitësit ose blerësit. Ky është rasti kur bëhet fjalë për kushtet e përgjithshme të punës, të cilat palët i kanë përdorur më herët, në kontratat e mëhershme të shitjes së mallit të caktuar dhe se aplikimi i saj ka ardhur deri tek ajo masë, në tregtinë e zakonshme të mallit që, palës tjetër i është dashur të bazohet në aplikimin e tyre. Për zbatimin e heshtur të zakonit, sipas Konventës së Vjenës është e nevojshme përmbushja kumulative e tri kushteve: e para, që palët të dinë zakonin ose ka qenë dashur të jetë i njohur: e dyta, që të flitet për zakonin i cili gjerësisht është i njohur në tregtinë ndërkombëtare;

³⁵⁵ Shih më shumë: Wilhelm Albrecht Achilles, vepër e cituar, fq. 94.

³⁵⁶ Konventa e Vjenës, neni 9, paragrafi 1.

³⁵⁷ Peter Schlechtriem, "Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)", fq 276 - 277.

e treta, që rregullisht të respektohen palët kontraktuese, në kontrata të llojit të njëjtë në profesionin përkatës.³⁵⁸

Ekzistimi i marrëveshjes së heshtur nuk supozohet në rast të përcaktimit të vetive të mallit, të cilat janë të nevojshme, që ajo të jetë e pranueshme për tregtinë në shtetin importues.³⁵⁹

IV. 8.3.2. Kuptimi objektiv i defektit (mungesës)

Kur palët në kontratën për shitjen ndërkombëtare nuk kanë përcaktuar pronësinë e sendit atëherë konformiteti i saj të çon, duke u bazuar në kriteret objektive të parapara, në Konventën e Vjenës. Neni 35, paragrafi 2, parasheh, 4 kushtet që aplikohen kur palët nuk kanë kontraktuar diçka tjetër. Ekzistimi i kësaj norme në tregtinë ndërkombëtare ka qenë i domosdoshëm sepse shitjen e zakonshme, pa vërtetimin e synimeve të tjera, blerësi i sotëm është i autorizuar të presë që malli të ketë cilësitë e caktuara bazike, edhe nëse kontrata shprehimisht këtë nuk e thotë. Sipas normës së përmendur konsiderohet se malli është konform kontratës:

- Nëse malli nuk është i përshtatshëm për qëllimet për të cilat malli i llojit të njëjtë përdoret zakonisht;
- Nuk është i përshtatshëm për qëllim të veçantë, në rastet kur malli i shitësit shprehimisht ose heshturazi i është bërë me dije blerësit, në kohën e shuarjes së kontratës, në përjashtim kur rrethanat tregojnë se blerësi e mbështeste këtë ose nuk ka qenë e ditur se blerësi mbështetet në profesionalizmin dhe gjykimin e shitësit;
- Nuk posedon mall cilësor të cilin shitësi ia ka paraqitur blerësit në vështrim të mostrës ose modelit;
- Nuk është paketuar ose mbrojtur në mënyrën e zakonshme për mall të tillë ose, një mënyrë e tillë nuk ekziston në mënyrat e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallit.³⁶⁰

³⁵⁸ Konventa e Vjenës, neni 9, paragrafi 2.

³⁵⁹ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2819.

³⁶⁰ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 269.

Duhet të vërejmë që neni 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës dallon nga neni 33, paragrafi 2, i ULIS-it. Domethënë, neni 33, paragrafi 1, i ULIS-it parasheh se në rastet e caktuara shitësi nuk e ka përmbushur detyrimin e tij, derisa neni 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, rregullon situatën kur konsiderohet se malli nuk është konform kontratës. Sipas kësaj neni 35, i Konventës së Vjenës, përcakton detyrimin e dorëzimit në mënyrën pozitive.³⁶¹

Shohim se për konformitetin nevojitet që malli të jetë i përshtatshëm për qëllime të caktuara, ose të ketë cilësi të dëshmuara nga pamja e mostrave ose modeleve, ose që është pakeluar, ose mbrojtur në mënyrë të përshtatshme. Kriteret për caktimin e konformitetit të mallit janë taksativisht të numëruara, sipas kësaj, në bazë të urdhrat që këto të aplikohen, dallon nga mënyra sesi janë ekspozuar. Domethënë, kur konformiteti vlerësohet në raport me qëllimin, për çka përdoret malli, a është demonstruar qëllimi i shitësit, për çka do ta përdorë mallin blerësi, a i është bërë me dije shitësit qëllimi i përdorimit të mallit? Nëse po, atëherë malli duhet të ketë cilësi të cilat i përgjigjen këtij qëllimi. Nëse jo, atëherë malli duhet t'i përgjigjet qëllimit për të cilin malli i llojit të njëjtë zakonisht përdoret. Edhe LMD-ja parasheh kriteret të njëjta si edhe Konventa e Vjenës.

Neni 35 paragrafi 2, rregullon konformitetin në mënyrën negative, sepse rastet e caktuara kur konsiderohet që malli është dorëzuar dhe që malli nuk është konform kontratës së lidhur. Me konventë i është larguar shprehimisht përcaktimi i kuptimit konformitet. Në të njëjtën mënyrë vepron edhe ligji ynë, neni 461, i LMD-së, i cili parasheh se, kur ekzistojnë të metat materiale, por nuk caktohet çka mund të konsiderohet e metë materiale. Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut të blerësi, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit.³⁶²

Kriteret që janë paraqitur janë objektive, sepse këto i parasheh edhe Konventa edhe Kodi Civil, por edhe LMD-ja. Për kriteret vlen përcaktimi që i përshtatet vullnetit të heshtur të shitësit, ose të blerësit. Kriteret e përmendura do të përdoren në rastet kur ekziston vullneti i shprehur, ose i heshtur i palëve kontraktuese për pronësinë, të cilat duhet t'i posedojë malli, gjegjësisht kur ekziston marrëveshja e palëve, por nuk përmban detaje të hollësishme, për kërkesat të cilat malli duhet t'i ketë. Kriteret e përmendura nga neni 35, paragrafi 2, i qasen vetëm cilësisë së mallit, sepse pa përcaktimin e sasisë dhe llojit të mallit që është lëndë e kontratës, sipas Konventës së

³⁶¹Po aty.

³⁶² LMD, neni 461, paragrafi 1.

Vjenës nuk është e mundur të krijohet kontrata e shitjes.³⁶³ Dhe kushtet e fundit nga neni 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, janë alternative. Do të thotë se përmbushja konsiderohet më e vogël nëse nuk është përmbushur cilado nga kushtet e parapara.

IV. 8.3.2.1. Përshtatshmëria e mallrave për përdorim të zakonshëm

Sipas nenit 35, paragrafi 2, pika a, e Konventës së Vjenës malli nuk është i përshtatshëm për kontratën, nëse malli nuk është i përshtatshëm, për qëllimin për të cilin ai është shitur, nuk është i llojit të njëjtë, për përdorim të zakonshëm. Kjo rregull ekziston edhe në ligjin tonë kombëtar, por edhe në ligjet e vendeve të tjera. Kjo shihet në nenin 462, të LMD-së, në qoftë se sendi nuk i ka veçoritë e duhura për përdorimin e tij të rregullt ose për qarkullim. Në qoftë se sendi nuk i ka veçoritë e duhura për përdorim special, për të cilën e blen blerësi, dhe që e ka pasur të njohur shitësi, ose është dashur ta kishte të njohur. Në qoftë se sendi nuk ka veçori dhe karakteristika, të cilat janë kontraktuar shprehimisht ose heshtazi, përkatësisht që janë caktuar.³⁶⁴

Normat e përmendura përmbajnë kuptimin funksional dhe objektiv të mungesave të mallit. Kuptimi funksional i defektit kuptohet; me mungesë konsiderohet mosperfeksionimi që pamundëson ose pengon përdorimin. Pranë kësaj, defekti (mungesa) e mallit konsiderohet objektivisht sipas përdorimit të tij të rregullt.³⁶⁵ Shitësi meqë është pronar i mallit është i detyruar të mbrojë blerësin edhe për mungesat fizike ose të metat materiale të sendit të shitur.³⁶⁶

Në praktikë shumë shpesh malli nënkupton mënyrën e përgjithshme sesi është paraqitur te shitësi për qëllimin për të cilin ai do të përdoret. Atëherë, kur të dyja palët nuk janë marrë vesh për asgjë në kuptimin e paraqitjes (dukjes) së mallit, shitësi është i detyruar që të dorëzojë mallin i cili është i përshtatshëm për qëllime të cilat malli i llojit të njëjtë rregullisht përdoret. Kjo domethënë që malli për nga cilësia duhet t'i përgjigjet pritjeve të zakonshme të subjektit që i ka blerë.³⁶⁷ Malli duhet të ketë vetitë të cilat janë urgjente për përdorimin normal të tij.

³⁶³ Konventa e Vjenës, neni 14, paragrafi 1, si dhe pjesa e këtij punimi i cili mbron kuptimin për konformitetin e mallit.

³⁶⁴ LMD, neni 461, paragrafi 1, 2 dhe 3.

³⁶⁵ Malden Draškić, (1966). "Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o menunarodnoj kupoprodaji", fq. 75.

³⁶⁶ Nerxhivane Dauti. (2012). "Kontratat", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 139.

³⁶⁷ UN DOC. A/CONF. 97/5 (Komentar UNCITRAL-a), Official Records, fq. 32, pika 5.

Nisur nga kjo malli nuk është i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm kur atij i mungojnë karakteristikat specifike dhe të zakonshme ose kur ka mungesa të cilat çojnë në përdorim dhe shfrytëzim material edhe më të vështirë.³⁶⁸ Përveç kësaj, malli nuk është i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm, edhe nëse është i mundur përdorimi material i tij, por mungesat e tij zvogëlojnë vlerën e tij tregtare. Në këtë kuptim edhe mungesat fizike të jashtme (të dukshme) edhe afër ruajtjes së funksionimit të mallit mund të sjellin deri te jokonformiteti. Të metat e dukshme konsiderohen ato të meta të cilat duhet të konstatohen me një vëmendje dhe me kontroll të zakonshëm.³⁶⁹ Kështu që malli me ngjyrë jokonforme, e cila nuk ndikon në përdorimin e tij, por ndikon në shitjen e mëtejshme të tij, çon në zvogëlimin e çmimit dhe paraqet jokonformitet. Në fund malli nuk është i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm nëse përdorimi i tij është i lidhur me çmim jo të zakonshëm.³⁷⁰ Ta përkujtojmë se: Çmimi paraqet detyrimin e parë të blerësit, që mund të jetë përcaktuar nga palët në kontratë ose palët në kontratë mund t'ia kenë besuar caktimin e çmimit një personi të tretë, të emëruar në kontratë ose që mund të emërtohet më vonë.³⁷¹

Që të mund të përcaktojmë se, a është malli me mungesa dhe nëse i përgjigjet pyetjes se çka nënkupton me shprehjen për përdorim të zakonshëm. Për dallim nga Konventa e Vjenës, e cila rregullon në mënyrë qartë kuptimin e përdorimit të zakonshëm, ligji ynë në vështrim të parë bazohet në ULIS, paragrafi 1, pika d, që është shumë më i qartë për këtë. Kështu, në të drejtën tonë është e paraparë që malli duhet të ketë përbërësit e nevojshëm për përdorim të rregullt ose për tregti të rregullt, derisa ULIS-i e parasheh që malli duhet të ketë përdorim cilësor për përdorim të zakonshëm ose për tregti.³⁷² Një vendim i tillë paraqet kombinimin e rregullave që përmban civil law dhe common law. Sipas sistemit kontinental, shitësi gjithmonë përgjigjet për përdorimin e rregullt të mallit, bile edhe kur kjo shprehimisht nuk është e thënë. Shitësi nuk mund të thirret në atë, që nuk e ka ditur se cilat veti duhet të ketë malli, që të jetë i përshtatshëm për përdorim të rregullt ose për tregti të rregullt, sepse ai që shet mallin duhet të dijë edhe vetitë

³⁶⁸ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, "International Sales Law", fq. 144.

³⁶⁹ Marjana Semini, *vepër e cituar*, pjesa e posaçme, Tiranë 2006, fq. 16.

³⁷⁰ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 274.

³⁷¹ Ardian Nuni, Ilir Nuni, Asim Vokshi, *vepër e cituar II*, Tiranë 2008, fq. 10.

³⁷² Në tekstin anglez përdoret nocioni - commercial use i cila po të përkthehet, do të thotë përdorim komercial. Pikërisht ky nocion është shumë më i detajuar dhe tregon përmbajtjen e këtij kuptimi.

tij. Në anën tjetër, në sistemin anglosakson është përfshirë kërkesa që, malli duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim në tregti.³⁷³

Secili blerës furnizohet për një qëllim të caktuar, dhe është i autorizuar që të presë nga një mall i tillë që do të ketë përdorim të caktuar. Siç e pamë përmbajtja e kuptimit përdorim i zakonshëm është përcaktuar objektivisht, dhe varet nga ajo se a do ta përdorë vetë blerësi mallin, ose do ta shesë një përdorues adekuat.

Në rastin e parë, kur shitësi blen mallin që ta përdorë për veten e tij, përshtatshmëria e mallit për qëllimet për të cilat malli zakonisht përdoret, gjegjësisht për përdorim të rregullt të tij konsiderohet në raport me një degë të caktuar të së drejtës. Nëse malli mund të përdoret në shumë mënyra, atëherë ai duhet të jetë i pranueshëm për të gjitha qëllimet.³⁷⁴ Kur malli nuk mund të përdoret për të gjitha mënyrat e zakonshme, por vetëm në disa, atëherë shitësi për këtë rrethanë duhet të lajmërojë blerësin.³⁷⁵ Në rastin tjetër, kur blerësi blen mallin për shkak të shitblerjes atëherë duhet të jetë i përshtatshëm që të përdoret në tregti, gjegjësisht është e mundur edhe shitja e mëtutjeshme e tij. Sipas kësaj, edhe shitblerja e mallit bie në përdorim të zakonshëm të tij.

Varësisht nga lloji i mallit (p.sh. makina për shtyp) dikur për përdorimin e saj të rregullt ka qenë e domosdoshme që të sigurohet teknikë dhe udhëzime për montim, përdorim dhe menaxhim. Udhëzimet duhet të jenë të atilla që nuk duhet të çojnë drejt mungesave dhe pengesave kur veprohet sipas tyre.³⁷⁶ Sipas mendimit tonë, nëse kontrata bazohet në mallin, i cili është i vendosur ose i magazinuar në Kosovë dhe që nuk është prodhuar për eksport, mjafton që udhëzimi për përdorim të jetë në gjuhën shqipe (ose në ndonjërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë). Në anën tjetër, nëse malli është i dedikuar për eksport, atëherë përkrah kësaj duhet të vendoset udhëzimi për përdorim në gjuhën në të cilën flitet, gjegjësisht gjuha e vendit për ku ka

³⁷³ Malden Draškić, (1966). "Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o menunarodnoj kupoprodaji", fq. 79; *Komentar Zakona o obligacionim odnosima, libri I*, recensentë: Borislav Blagojević & Vrleta Krulj, fq. 971.

³⁷⁴ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2348, 2349.

³⁷⁵ Peter Schlechtriem, "Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)", fq. 279.

³⁷⁶ Sipas vendimit gjyqësor neni 35, paragrafi 2, pika a *Konventa e Vjenës* se shitësi nuk i ka dhënë me mirëbesim blerësit të gjitha këshillat për montim. Në bazë të kësaj makina është prishur pas 3 viteve të përdorimit dhe me këtë ka tradhtuar pritjet e blerësit që do ta përdorte për një kohën më të gjatë pa u prishur apo dëmtuar. SWEDEN, 5 June 1998 Arbitration Institute of the Stockholm Chamber of Commerce (4.000 ton rail press case), www.cisg.law.pace.edu

vendmbërritjen malli. Nëse shitësi ka detyrim që të montojë mallin, atëherë montimi i gabuar e bën të papërshtatshëm mallin për përdorim të zakonshëm.³⁷⁷

Përdorimi i zakonshëm përfshin edhe përshtatshmërinë e mallit për përdorim në afatin e caktuar. Nëse lëndë e kontratës është malli që priset shpejt (malli ushqimor ose prodhimet farmaceutike), atëherë ajo duhet të ruhet në gjendje të mirë, sipas rregullave të zakonshme, kohës së caktuar pas dorëzimit.³⁷⁸ Çka nënkuptojmë me afat të kuptueshëm varet edhe nga rrethanat e rastit. Megjithatë, meqë nuk ekzistojnë standarde të përgjithshme në kuptimin e periudhës së afatshmërisë së mallit, i cili shumë lehtë shkatërrohet, më e rëndësishmja është që palët kontraktuese për këtë të merren vesh. Gjithashtu malli me qëndrueshmëri më të gjatë duhet të qëndrojë në mënyrë të përshtatshme për përdorim të zakonshëm, në një periudhë të caktuar.³⁷⁹ Përshtatshmëria që malli të përdoret në bazë të kontratës, mund të kuptohet edhe nëse për atë nuk është dhënë një garanci e caktuar.³⁸⁰ Nëse lëndë e kontratës për shitjen është malli i përdorur, blerësi mund të presë përshtatshmërinë e tij dhe durimin e tij.³⁸¹

Malli, të cilin blerësit ia dorëzon shitësi, mund të jetë pak ose shumë i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm. Është e rëndësishme që duhet të dorëzohet me përshtatshmëri mesatare.³⁸² Megjithatë kjo nuk duhet të përzihet me cilësinë e mallit, gjegjësisht kjo nuk do të thotë që shitësi duhet të dorëzojë mallin e cilësisë mesatare.

Me rastin e përcaktimit se i çfarë cilësie duhet të jetë malli që të jetë i përshtatshëm për të gjitha rastet, për të cilat malli i llojit të njëjtë, zakonisht përdoret. Në mes të teoricienëve ekziston një mosmarrëveshje rreth dy çështjeve. E para, varet nga cilësia e mallit gjenerik të dorëzuar. Megjithatë në teori ekziston mosmarrëveshja rreth asaj se çka konsiderohet përdorim i zakonshëm kur është në pyetje, si lëndë, malli me përbërje gjenerike, gjegjësisht a paraqet përdorimi i zakonshëm përmblotjen e detyrimit që malli të jetë i cilësisë mesatare. Në disa të drejta kombëtare, sidomos në ato të sistemit kontinental (Gjermania, Franca, Zvicra), ekziston

³⁷⁷ Kështu e parasheh neni 434, paragrafi 2, BGB. Shih më shumë: Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 357.

³⁷⁸ Peter Schlechtriem, *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, fq. 279.

³⁷⁹ Në një lëndë është konstatuar që neni 35, paragrafi 2, pika a, e *Konventës së Vjenës* sepse mjeti për ftohje është prishur në afat të shkurtër pas dorëzimit FRANCE, 15 May 1996 Cour d'appel Grenoble (Refrigeration equipment for transportation of produce, etc. case), www.cisg.law.pace.edu

³⁸⁰ Shih më shumë: Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, "International Sales Law", fq. 145.

³⁸¹ Shih më shumë: Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 35.

³⁸² Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, "International Sales Law", fq. 144. Shih më shumë, Bianca- Bonell, *vepër e cituar*, fq. 274.

rregull i veçantë që malli gjenerik i dorëzuar në bazë të kësaj, duhet të jetë i kualitetit mesatar. Ky rregull ekziston edhe në të drejtën tonë. Në një ligj të mëhershëm anglez për shitjen e mallit (Sale of Goods Act) nga 1979 është përfshirë parimi (merchantability” që do të thotë që malli mund të kishte edhe cilësinë nën mesatare derisa është e mundshme shitja e mëtejshme e tij. Megjithatë sipas ligjit të ri për shitjen e mallrave të vitit 1994 është pranuar parimi që malli është konform kontratës dhe nëse është e mundur që të bëhet përdorimi tregtar i tij, por është paraparë që edhe malli duhet të jetë i cilësisë së kënaqshme.³⁸³ Sipas kësaj, kuptimi merchantability do të thotë më shumë nga mënyra e thjeshtë e shitjes së mëtejshme të mallit. *Merchantable quality* domethënë përshtatshmëria për shitjen, në kuptimin e përshtatjes për nga malli i tillë shërben.³⁸⁴ Në bazë të asaj që e kemi përmendur më lart, mund të thesojmë se nevojat që kanë sjellë deri te mospengesa e zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare si konkurrencë, kanë sjellë deri tek afrimi i qëndrimeve të ndryshme. Gjithashtu në të ardhmen, që të mos ekzistojnë rregulla të përbashkëta në këtë çështje, e konsiderojmë gjithmonë vendimin në mënyrë të përshtatshme që palët të merren vesh deklarativisht. Sipas mendimit tonë edhe në mungesë të marrëveshjes blerësi gjithmonë mund të pretendojë kualitetin minimal të mallit të caktuar.

Mosmarrëveshja e dytë krijohet sepse kuptimi i përdorimeve të zakonshme nuk është ndërkombëtarisht uniform. Kjo do të thotë që mënyra e njëjtë në një shtet mund të trajtohet si mall pa të meta, dhe në anën tjetër si i papërshtatshëm. Në bazë të kësaj krijohet mosmarrëveshja e cila brenda kornizës së cilësisë, që pretendohet në vendin e eksportit ose në vendin e përdorimit. Problemi ka kuptim teorik dhe rëndësi praktike sepse përgjigjja varet nga ajo sesi do të trajtohet mënyra e përdorimit dhe e shitjes së mëtejshme të mallit. Sipas mendimit tonë shitësi është gjithmonë i detyruar të dorëzojë mallin, që do të përmbushë të gjitha përshkrimet e vlefshme dhe me standarde në vendin e tij, gjegjësisht përshtatshmërinë e mallit për përdorim që vlerësohet sipas standardit në selinë e shitësit. Një qëndrim i tillë ekziston edhe në të drejtën tonë. Shitësi nuk është i detyruar që të bëjë përshkrimet të cilat janë bërë për mallin dhe, të cilat përshkrime vlejnë për vendet e tjera, dhe po të njëjtat të vlejnë edhe për vendin e blerësit. Përkundër kësaj shitësi nuk duhet ta dijë vendin e blerësit dhe vendqëndrimin e mallit, gjegjësisht vendin ku malli duhet të përdoret. Në analogji me këtë, nëse shitësi e eksporton mallin në disa shtete, nuk mund të nënkuptohet se ai duhet t’i dijë të gjitha normat që zbatohen

³⁸³ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2820.

³⁸⁴ Aleksadar Goldštajn, *vepër e cituar*, fq. 265.

në vendet e eksportit. Gjithashtu nuk është e mjaftueshme që shitësi të paralajmërojë blerësin vetëm për shtetin në të cilin malli do të përdoret dhe në këtë mënyrë shitësi të jetë i lidhur me të drejtën e atij vendi.³⁸⁵ Veçanërisht shitësi duhet të respektojë standardet e shtetit ku do të eksportohet malli, kur ai i ka ditur ose është dashur ta ketë ditur, në bazë të qëndrimit të zakonshëm të marrëdhënieve të punës me blerësin, ose në bazë të udhëzimeve të blerësit.³⁸⁶ Gjithashtu shitësi duhet t'i përmbahet, para së gjithash çka i ka ofruar blerësi me rastin e përmbushjes apo shuarjes së kontratës. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe në praktikën gjyqësore. Gjykata gjermane ka përkrahur qëndrimin që kërkesat e cilësisë, të cilat janë paraparë me të drejtën ndërkombëtare në vendin e blerësit, nuk janë të përshtatshme në kuptimin e nenit 35, paragrafi 2, pika a, e Konventës së Vjenës, bile kur shitësi nuk ka pasur shkak të dijë për këto.³⁸⁷ Sipas mendimit tjetër, malli është i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm, vetëm nëse është në harmoni me normat publike, për sigurinë e prodhimit, mbron konsumatorin dhe mjedisin në vendin importues, përdorimi i zakonshëm duhet të përcaktohet sipas standardeve të shtetit ose regjionit në të cilin blerësi mendon (parasheh) ta përdorë mallin. Ne mendojmë që qëndrimi jonë kalon nga ajo që blerësi e blen mallin me qëllim të caktuar, dhe është e rëndësishme për çka e përdor mallin e blerë. Nëse analiza kryhet nga ana e blerësit atëherë me të drejtë mund të merren në konsideratë kriteret e vendit ku malli do të përdoret, por shitësi nuk duhet të di për to, dhe blerësi duhet t'ia përkujtojë. Sipas mendimit tonë, në secilin rast blerësi është ai i cili më herët është në pozitë të dijë të gjitha kushtet që malli duhet të përmbushë në shtetin përkatës dhe është e drejtë e tij që të pritët që ai t'ia propozojë shitësit. Pikërisht për këtë blerësi duhet të bartë rrezikun e përdorimit të mallit në vendin importues. Në të kundërtën, pranimi i qëndrimit tjetër shitësin e sjell në pozitë të vështirë në mënyrë të padrejtë.

³⁸⁵ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 144.

³⁸⁶ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2820.

³⁸⁷ *Shitësi nga Zvicra blerësit nga Gjermania i ka dorëzuar molusqe, që kanë pasur më shumë kalcium sesa norma që ka porositur Ministria e Shëndetësisë së Republikës Federale të Gjermanisë. Gjykata ka marrë vendim që kërkesat për cilësi, të cilat janë paraparë me të drejtën publike dhe shitësit në mënyrë totale nuk janë përshtatur dhe nuk janë në përputhje me nenin 35, paragrafi 2, pika (a)(e), e Konventës së Vjenës, bile shitësi nuk ka pasur arsye që ato t'i njohë. Kodi Civil Gjerman, 8 mars 1995 IP Rax 1996, 26 . www.unilex.info*

IV. 8.3.2.2. Përshtatshmëria e mallrave me qëllim të veçantë

Blerësit në tregtinë ndërkombëtare shumë shpesh kuptojnë se, është e nevojshme që malli të përmbushë një qëllim të veçantë, por nuk dinë shumë për mallin, duke mos dhënë specifika të veçanta. Atëherë blerësi duhet, që për mallin e dëshiruar, t'ia përshkruaj shitësit qëllimet për të cilat dëshiron ta përdorë mallin. Këto raste i rregullon edhe neni 35, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës dhe neni parasheh që, nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, konsiderohet ajo që shitësit, shprehimisht ose heshturazi, i është bërë me dije në kohën e përmbylljes së kontratës. Duke pasur parasysh normën e përmendur, mund ta përmbyllim që me mungesën e marrëveshjes, në mes të palëve kontraktuese, për cilësinë e mallit të porositur, blerësi mund të presë që malli duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm, mall i cili tejkalon përdorimin e tij të zakonshëm vetëm me përmbushjen e kushteve të caktuara. E para, është e nevojshme që përdorimi i zakonshëm, të cilin ai e parasheh për ta përdorur mallin ka qenë e njohur për shitësin. E dyta, përdorimi i posaçëm duhet që shitësit t'i paraqitet në momentin e caktuar, në kohën e përmbylljes ose të shuarjes së kontratës. E treta, është e nevojshme që shitësi është mbështetur në mjeshtërinë e gjykimit të shitësit.

Nga përshtatja e mallit për qëllim të caktuar mund të flasim, për shembull, kur blerësi planifikon përdorimin në kushte ekstreme klimatike. Gjithashtu nëse malli duhet të përmbushë kushte (rregulla) të posaçme si, për shembull, normat publike për ruajtjen e konsumatorit në vendin e përdorimit, atëherë edhe kjo konsiderohet për qëllim të caktuar.

Neni 35, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës nuk përfshin rastet kur vetë shitësi dekreton që malli është i përshtatshëm për përdorim të veçantë ose kur blerësi porosit mallin që të jetë i përshtatshëm për qëllim të caktuar.³⁸⁸

Normë të njëjtë përmban edhe neni 33, paragrafi 1, pika e, e ULIS-it, e cila parasheh se mungesa e konformitetit ekziston kur shitësi ka dorëzuar sendin, i cili nuk ka kushte të nevojshme për përdorimin e zakonshëm të paraparë shprehimisht ose heshturazi me kontratë. Në mes të tekstit të Konventës së Vjenës dhe ULIS-it ekziston një dallim i rëndësishëm që bazohet në atë, se ULIS-i aludon që kuptimi i veçantë i shitësit, në momentin e caktuar, është bërë me dijeni. Nëse merret në konsideratë, që malli gjithmonë duhet të posedojë të gjitha përmbajtjet e kontraktuara, vendoset pyetja e kushtit të nenit 33, paragrafi 1, pika f, e ULIS-it.

³⁸⁸ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 275.

Sipas të drejtës sonë mungesat materiale ekzistojnë atëherë kur sendi nuk ka përbërjet e nevojshme për përdorim të veçantë për të cilin blerësi e fiton dhe që ka qenë e njohur ose është dashur të jetë e njohur për shitësin.³⁸⁹

Uzansa nr. 146, paragrafi 1, i Uzansave të Përgjithshme për tregti me mallra, përcakton që cilësia e mallit nuk është e përcaktuar me kontratë, dhe nëse shitësi me shuarjen e kontratës ka pasur për qëllim, por dhe ka qenë e njohur ose është dashur të jetë e njohur për çka ka qenë i dedikuar malli, shitësi duhet të porosisë mallin e një cilësie të tillë, cilësi që i përgjigjet qëllimit të caktuar.

IV. 8.3.2.2.1. Njohja e shitësit për qëllimin e caktuar

Qëllimi i veçantë për cilin malli duhet të jetë i përshtatshëm duhet të jetë i njohur për shitësin. Nëse në kohën e shuarjes së kontratës blerësi mund të deklarojë qëllimin për çka e përdor mallin, ndërsa shitësi nuk pajtohet me të, atëherë shitësi duhet të dorëzojë mallin të cilin do të jetë i përshtatshëm për përdorim të veçantë. Megjithatë, në këto raste nuk përdoret neni 35, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës, por neni 35, pika 1, e Konventës së Vjenës, sepse shitësi është çdo herë përgjegjës për dorëzimin e mallit në sasi, cilësi dhe lloj, ashtu si janë marrë vesh. Neni 35, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës, përdoret kur marrëveshja e palëve për cilësinë nuk ekziston, por shitësi në një mënyrë të caktuar, pikërisht në momentin e shuarjes së kontratës, ia ka bërë me dije shitësit që malli duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim të veçantë, dhe që më vonë ai duhet të bazohet në cilësinë e tij. Sipas kësaj, pritjet e blerësit edhe po të mos ekzistonte marrëveshja formale janë të mbrojtura si të drejta. Në bazë të kësaj shohim se sipas Konventës së Vjenës nuk është e nevojshme që palët kontraktuese të arrijnë marrëveshje për një qëllim të veçantë, por është e mjaftueshme, që ajo të jetë e njohur për shitësin në kohën e shuarjes së kontratës.

Me thënien, vëre në dijeni, duhet të kuptojmë prezantimin e qëllimit të mallit, në mënyrë që shitësi sipas kujdesit të veçantë, nga rrethanat e caktuara ka mundur të kuptojë.³⁹⁰ Shitësit në mënyrë të qartë duhet t'i bëhet me dije qëllimi i veçantë. Pastaj nga lënda e punës ose nga selia e blerësit mund të kuptohet që malli duhet të shërbejë për një qëllim të caktuar. Kështu, për

³⁸⁹ LMD neni 462.

³⁹⁰ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 145. Gjithashtu, Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2347.

shembull, është e mjaftueshme që të supozohet vendi i përdorimit të mallit. Në këtë rast shitësi është përgjegjës që të marrë në konsideratë vendin e përdorimit dhe kushtet klimatike të cilat mbizotërojnë atje, pastaj të dorëzojë mallin që blerësi ka mundësi ta përdorë. Qëllimi i prezantimit të mallit të shitësi, duhet të jetë paraqitur me qëllim që ai të mund ta pranojë mallin si të njohur dhe të kontrolluar më parë, dhe nëse ai e ka pranuar mallin si të njohur, kjo çështje nuk është e rëndësishme.³⁹¹ Sipas kësaj neni 35, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës nuk kërkon njohjen pozitive të shitësit, por është e mjaftueshme që të ekzistojë mundësia e njohjes së qëllimit të caktuar. Një zgjedhje e tillë është e mirë sepse në rast të mosmarrëveshjes shpjegon se me paraqitjen e njohjes së vërtetë të shitësit mund të sjell edhe deri te krijimi i vështirësive të ndryshme. Gjuha e nenit 35, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës është e tillë që nuk pretendon që vetë blerësi t'ia bëjë me dije shitësit qëllimin për çka përdoret malli. Gjithashtu paralajmërimi nuk është kauzë për të njoftuar shitësin. Kjo domethënë që shitësi mund të arrijë aftësi për qëllimin e caktuar edhe nga 3 subjektet ose nga burimet e veta.³⁹²

Sipas konventës blerësi, shitësit, mund t'ia bëjë të njohur qëllimin e caktuar në dy mënyra - shprehimisht dhe në mënyrë të heshtur. Kur qëllimi i mallit është i veçantë duhet të bëhet i njohur shprehimisht dhe konkretisht shitësit i prezantohet qëllimi dhe atëherë ai, me qëllimin e tërheqjes nga përgjegjësia për jokonformitetet duhet të vendoset me ankim. Megjithatë problemi mund të krijohet te njoftimi në mënyrë të heshtur, në një mënyrë të veçantë, por gjithsesi ai për këtë është dashur gjithsesi të dijë.³⁹³ Me rastin e vlerësimit se a është qëllimi i caktuar i shitësit, që heshturazi të bëjë me dije “duhet të ketë parasysh mundësinë objektive të shitësit që për përdorim të tillë të dijë të zbulojë dhe të justifikojë pritjet e blerësit, të cilat nuk tejkalojnë nga kushtet e kontratës”.³⁹⁴

Ligji ynë pretendon përdorimin e zakonshëm, për të cilën mallin blerësi e blen nga shitësi dhe shitësi këtë e ka pasur të ditur/njohur ose është dashur të jetë e ditur/njohur nga ana e tij. Përdorimi i veçantë, për të cilin blerësi siguron që shitësit i është dashur të jetë e ditur për përdorimin e mallit edhe nëse nuk është treguar, sqaruar, ose i është bërë me dije nga vetë

³⁹¹ Julius Von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 361.

³⁹² Julius Von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 361. Gjithashtu, Krüger, Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2348.

³⁹³ Peter Schlechtriem. “*Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods*”, (CISG), fq. 281.

³⁹⁴ Malden Draškić, (1966). “*Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o menunarodnoj kupoprodaji*”, fq. 75.

blerësi.³⁹⁵ Sipas një mendimi, përdorimi i zakonshëm është kur blerësi ka pasur njohuri për përdorimin e mallit dhe kur çështja është kontraktuar.³⁹⁶ Megjithatë në këto raste sipas mendimit tonë aplikohet neni i LMD-së, sipas të cilit, malli duhet të posedojë të gjitha veçoritë e heshtura dhe të shprehura shprehimisht. Në anën tjetër, për përdorimin e zakonshëm të mallit, shitësit i është dashur të jetë e ditur, nëse ai dhe blerësi gjenden në lidhje pune, ose nëse shitësi në një mënyrë e di se me çka merret blerësi dhe se çfarë malli i nevojitet.³⁹⁷ Siç e shohim te shitja vendore e mallit është e nevojshme që të ekzistojë njohja pozitive e shitësit për qëllimet për të cilat blerësi do ta përdorë mallin.

Përgjegjësia e shitësit për konformitetin mund të jetë e pranishme vetëm nëse qëllimi i përdorimit i është prezantuar në rastin e shuarjes së kontratës. Një dukuri e tillë ekziston edhe në Konventën e Vjenës dhe në Uzansat e Përgjithshme.

IV. 8.3.2.2.2. Besimi i blerësit në ekspertizën dhe gjykimin e shitësit

Kushti i fundit të cilin duhet ta plotësojë sipas nenit 35, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës është se blerësi është mbështetur në ekspertizë dhe në gjykimin e shitësit. Blerësi ka të drejtë që të presë përmbushjen apo dorëzimin e mallit të përshtatshëm për RASTE TË CAKTUARA DHE TË SHIJOJË mbrojtjen ligjore kur nga rrethanat e tejkalon atë që blerësi ka besuar ose është dashur të besojë në kualifikimet dhe vlerësimet e shitësit. Në parim ky përkushtim do të ekzistojë kur shitësi është ekspert ose specialist në prodhimin ose furnizimin e mallit dhe kur përkushtimi i nevojiten blerësit për një qëllim të caktuar. Ky kusht është marrë nga e drejta anglosaksone, ndërsaq e drejta jonë pozitive këtë çështje nuk e njeh.

IV. 8.3.2.3. Ngjashmëria e mallit në mostër ose model (kampion)

Te shitja sipas mostrës ose modelit malli i porositur përputhet vetëm kur i përket mostrës ose modelit. Në këtë rast matja e cilësisë së mallit është mostër ose model, dhe jo përdorim i rregullt ose i veçantë. Sipas nenit 35, paragrafi 2, pika c, e Konventës së Vjenës, malli nuk është

³⁹⁵ Vladimir Kapor. “*Ugovor o kupovini i prodaji robe – Tumač opštih uzansi za promet robom*”, fq. 159.

³⁹⁶ Verljeta Krulj, “*Komentar Zakona o obligacionim odnosima*”, libri I, redaktor Blagojević, fq. 971.

³⁹⁷ Vladimir Kapor, vepër e cituar, fq.159.

i veçantë në kontratë nëse nuk posedon cilësi të mallit, të cilat shitësi ia ka paraqitur blerësit në shikim të mostrës ose modelit. Gjithashtu neni 462 i LMD-së dëshmon për ekzistimin e së metës në rast se: shitësi e ka dorëzuar sendin, që nuk i është përshtatur mostrës ose modelit, nëse mostra ose modeli janë treguar vetëm për qëllime njoftimi dhe neni 33, paragrafi 1, pika c, ULIS përcakton që sendet e dorëzuara duhet të jenë të veçanta në bazë të mostrës dhe modelit, pos nëse janë shkaqe ose modele të treguara vetëm për shkak të informimit.³⁹⁸ Në qoftë se shitja është bërë mbi bazën e një modeli ose kampioni shitësi duhet të dorëzojë sende që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose të kampionit.³⁹⁹

Nëse nga mostra nënkuptohet për sasi të vogël të mallit, e marrë nga malli që është i përgatitur për shitje. Në anën tjetër modeli paraqet një kopje të mallit, i cili i tregon blerësit kur vetë malli nuk është i pranishëm si, për shembull, ende nuk është prodhuar ose ndodhet shumë larg nga blerësi. Dallimi në mes të përcaktimit të cilësisë së mallit, në bazë të mostrës dhe modelit konsiston si në vijim. Te shitja në bazë të mostrës shitësi garanton që malli ka të gjitha cilësitë e kësaj mostre. Kur cilësia e mallit përcaktohet në bazë të modelit, është e mundur që malli i porositur duhet të posedojë të gjitha, ose vetëm disa karakteristika të modelit. Në bazë të kësaj, në rastet e modelit, kontrata duhet të përfaqësojë të gjitha cilësitë që të dëshmohet se cilësitë e mallit janë modele të ilustruara.⁴⁰⁰

Vlerësimi i korrespondencës së mallit kryhet në raport me shkakun autentik. Autentik konsiderohet ai model i cili është i vulosur dhe në të cilin është etiketa e nënshkruar nga palët, ose është shkak se njëra palë me vulën e vet e ka vulosur atë. Nëse ka më shumë shkaqe, me mirëbesim është ai të cilat palët e konsiderojnë të tillë.⁴⁰¹ Parashtrohet pyetja; se në ç'masë duhet t'i përgjigjet mostrës? Uzansat e përgjithshme pretendojnë një ujdi të plotë të mallit.⁴⁰² dhe lejojnë shkëputjen vetëm në rastet e caktuara. Shkëputja është e lejuar kur kjo është e kontraktuar, e paraparë me uzansa të veçanta ose me zakonet (dokat) tregtare.⁴⁰³ Edhe sipas LMD-së malli duhet të përgjigjet për të gjitha qëllimet për të cilin është blerë. Një përfundim i tillë i tejkalon kërkesat që sendi duhet të korrespondojë me mostrën ose me modelin. Devijimet nga mostra janë të mundshme në dy raste, nëse palët janë marrë vesh ashtu, ose nëse mostra

³⁹⁸ LMD, neni 462, paragrafi 2.

³⁹⁹ KCSH, neni 715, paragrafi 3.

⁴⁰⁰ Peter Schlechtriem, *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, fq. 282.

⁴⁰¹ Uzansat e Përgjithshme, Uzansa. nr. 141 paragrafi 3, pika 4.

⁴⁰² Uzansat e Përgjithshme, Uzansa. nr. 141, paragrafi 1 i.

⁴⁰³ Uzansat e Përgjithshme, Uzansa. nr. 141, pika 2.

është treguar në kohën e njoftimeve. Kërkesa e korrespondencës së plotë të mallit me model është e fortë dhe në praktikë nuk do të respektohet gjithmonë. Për këtë arsye në teori është marrë qëndrimi për mungesat e mundshme, kur sipas parimit flitet për posedime që nuk janë të vlefshme, të cilat nuk ndikojnë në vlefshmërinë e përmbushjes.⁴⁰⁴ Sikurse te shumë të drejta tjera nacionale edhe në Konventën e Vjenës shitësi garanton që malli ka cilësi që i ka treguar në formën e mostrës ose të modelit. Mbi shitësin rëndon detyrimi që t'i garantojë blerësit pronësinë e sendit apo të të drejtës që ai shet dhe në qoftë se blerësi zhvishet nga pronësia mbi sendin e blerë⁴⁰⁵. Megjithatë, mund të ndodhë që palët në kontratë të përcaktojnë cilësitë, të cilat malli duhet të posedojë kumulativisht edhe kushtet e kontraktuara si dhe në kushtet që janë caktuar sipas modelit. Nëse përkundër kësaj, ekziston mospërputhje në mes mostrës/modelit të kontraktuar, kontrata, nga njëra anë, duhet të përfaqësojë vërtetësinë sipas cilësive dhe qëllimit të palëve, por duhet t'i jepet edhe përparësi.⁴⁰⁶ Qëndrimi tjetër është që përparësia duhet t'i jepet mostrës. Gjithashtu sipas mendimit të disa autorëve ULIS i jep përparësi shkakut. Një vendim i tillë është nxjerrë duke u bazuar në vendin të cilin neni 33, paragrafi 1, i ULIS-it përfshin shitjen sipas mostrës ose modelit. Ajo është e rregulluar pas dorëzimit aliud para miratimit të mallit me kushtet, apo e rregulltat kontraktuara.⁴⁰⁷ Sipas mendimit tonë, në këtë rast duhet mbajtur qëndrim tjetër. Në prezantimet e mëparshme është ekspozuar në detaje korrespondenca e çmimeve. Nëse ekziston pajtim i palëve për cilësinë e mallit atëherë gjithmonë në mënyrë parësore përdoren rregullat e nenit 35, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, gjegjësisht shitësi duhet të dorëzojë mallin, në bazë të të gjithë asaj siç janë marrë vesh palët kontraktuese. Nëse mungon marrëveshja në mes të palëve në çështjet e caktuara, korrespondenca vlerësohet sipas kriterëve objektive të parapara me nenin 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, gjegjësisht shitësi duhet të porosisë mallin sipas të gjitha kushteve dhe cilësive ashtu si janë marrë vesh. Vetëm nëse marrëveshja në mes të palëve për çështjet e caktuara mbetet pas Konventës së Vjenës, gjegjësisht në këtë rast veprohet sipas modelit dhe mostrës nga neni 35, paragrafi 2, pika c, e Konventës së Vjenës. Në të drejtën tonë nuk i është dhënë shprehimisht përparësi marrëveshjes së palëve, por e konsiderojmë që, me rastin e vlerësimit, në rast se ekziston

⁴⁰⁴ Vladimir Kapor. *Kontrata për Shitblerjen e Mallit – Përkthime të Uzansave të Përgjithshme për Tregti me Mallra*, fq.157; *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, libri I*, redaktorët: Borislav Blagojević & Vrljeta Krulj, fq.972.

⁴⁰⁵ Ardian Nuni & Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). *E Drejta e Detyrimeve*, Tiranë, fq. 15.

⁴⁰⁶ Peter Schlechtriem, *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, fq.283.

⁴⁰⁷ Malden Draškić, (1966). *Obaveze prodavca prema unifikovanim pravilima o menunarodnoj kupoprodaji*, fq. 84.

mungesa materiale para së gjithash duhet marrë në konsideratë marrëveshja e palëve në mostër ose në model nëse i ka treguar blerësit me qëllim që të caktojë vetëm disa cilësi të tij. Shitësi është i detyruar të dorëzojë dhe të gjithë aksesoret e tij, frutet dhe të ardhurat që sendi ka krijuar që nga çasti i lidhjes së kontratës deri në çastin e dorëzimit të tij.⁴⁰⁸ Megjithatë në të ardhmen malli më së shpeshti ka karakteristikat dhe ka raste që është vështirë të vlerësohen nga ata; shitësi kërkon që të tregojë me dëshmi mostrën ose modelin dhe në këtë rast qëllimi i tyre duhet të jetë caktuar qartë.⁴⁰⁹

Neni 33, paragrafi 1, pika c, në ULIS ka paraparë që shitësi nuk do të përgjigjet për jokonformitetin e mallit nëse blerësi ka shkaku ose modelin e treguar “pa obligime”.

Në këtë rast nuk flitet për shitjen nga shkaku ose modeli. Edhe pse në Konventën e Vjenës kjo shprehimisht nuk është paraparë qartësisht në nenin 35, paragrafi 2, pika c, nuk është përfshirë rasti, kur shitësi i tregon blerësit mostrën ose modelin pa qëllimin e detyrueshmërisë. Shitësi përgjigjet për jokonformitetin e mallit, për mostrën ose modelin, kur kjo është në një mënyrë e caktuar, dhe kur shprehimisht ose heshturazi e ka marrë këtë mbi vete. Në bazë të kësaj nëse blerësi i prezanton mostrën ose modelin shitësit, kjo shitësin nuk e obligon sipas nenit 35, paragrafi 2, pika c, e Konventës së Vjenës, po vetëm në rastet nëse me këtë nuk është pajtuar më herët.⁴¹⁰

Në teori është e vështirë të tregohet se në cilën mënyrë duhet të kryhet kufiri në mes të nenit 35, paragrafi 2, pika c, dhe nenit 35, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës dhe në bazë të këtij neni mund të vlerësohet jokonformiteti, nëse malli i përgjigjet mostrës ose modelit, dhe malli nuk është i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm. Sipas njërit qëndrim, shitësi i tregon mostrën/modelin blerësit dhe ai ka mundësi që atë ta kontrollojë. Kështu konsiderohet që blerësi nuk bazohet në specializimin dhe vlerësimin e shitësit. Përparësi në këtë rast i duhet dhënë nenit 35, paragrafi 2, pika c, e Konventës Vjenës.⁴¹¹ Nëse përkundër kësaj, shitësi vlerëson që malli është i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm, dhe blerësi në bazë të kësaj apo në bazë të mostrës/modelit të treguar, këtë nuk ka mundur ta vërtetojë, fillimisht aplikohet neni 35,

⁴⁰⁸ Mariana Tutulani-Semini, *E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Posaçme*, Skenderbegbooks, Tiranë 2006, fq. 11.

⁴⁰⁹ Bianca- Bonell, *vepër e cituar*, fq. 276.

⁴¹⁰ Në një vendim të gjykatës është marrë vendim dhe është vërtetuar që neni 35 paragrafi 2 pika c e Konventës së Vjenës aplikohet edhe kur blerësi siguron modelin nëse palët janë marrë vesh që malli duhet të jetë konform modelit AUSTRIA, 9 November 1995 Oberlandesgericht Graz (Marble slabs case), www.cisg.law.pace.edu

⁴¹¹ Peter Schlechtriem, *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, fq. 283.

paragrafi 2, pika b.⁴¹² Sipas mendimit tjetër, të cilin ne e konsiderojmë të vlefshëm, shitja në bazë të mostrës ose në bazë të modelit, blerësit i mundësohet që të kryejë kontrollin e përshtatshmërisë së mallit për qëllimin e tij. Përparësi gjithmonë ka neni 35, paragrafi 2, pika c, e Konventës së Vjenës, gjegjësisht drejtimi kah mostra ose modeli përfshin aplikimin dhe qëndrimin a dhe b.⁴¹³

IV. 8.3.2.4. Paketimi i zakonshëm ose i duhur i mallit

Nëse asgjë nuk është kontraktuar diçka më ndryshe, shitësi është i detyruar që të përmbushë detyrimin me mall të paketuar. Shitësi duhet të dorëzojë sendet në cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar në kontratë, të vendosura dhe të ambalazhuara në mënyrën e caktuar në kontratë.⁴¹⁴ LMD-ja në nenin 672 në mënyrë të qartë në 5 paragrafë përshkruan çështjen e paketimit. Dërguesi ka për detyrë t'i paketojë sendet sipas mënyrës së parashikuar ose të praktikuar, për arsyen që të mos shkaktohet ndonjë dëm ose të mos rrezikohet siguria e njerëzve ose e të mirave.⁴¹⁵ Malli nuk është konform me kontratën nëse nuk është paketuar dhe nuk është mbrojtur në mënyrën e zakonshme për atë lloj malli, ose kur një mënyra e tillë nuk ekziston, në mënyrën të cilën është e përshtatshme që ta ruajë mallin⁴¹⁶. Nga ato çka kemi thënë më sipër pason që detyrimi i përmbushjes përfshin dhe një obligim shtesë të shitësit, që të krijojë atë çka është e zakonshme që blerësi të pranojë mallin në gjendje të kënaqshme.

Shumica e shteteve, që i takojnë sistemit kontinental, në mesin e të cilave është edhe Kosova dhe Shqipëria, nuk përfshihen mungesat (të metat) në paketim në përgjegjësinë e shitësit për dorëzimin e mallit, ndërkajë drejta Amerikane parasheh që paketimi është pjesë e domosdoshme e garancisë së shitësit që malli mund të shitet edhe më tutje (merchantability).⁴¹⁷

Shitësi është përgjegjës për paketim e mallit pavarësisht nga ajo çka është si detyrim i tij i përmbushjes, pavarësisht se a duhet malli të përgatitet ose që blerësit t'i lihet në posedim.

Staudinger, Magnus, *vepër e cituar*, fq. 363.

⁴¹³ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2821; Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 146; Bianca - Bonell, *vepra e cituar*, fq. 276; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2352.

⁴¹⁴ Kodi Civil i Shqipërisë 1994, neni 715, paragrafi 1.

⁴¹⁵ LMD, neni 672, paragrafi 1.

⁴¹⁶ Konventa e Vjenës, neni 35, paragrafi 2, pika d,

⁴¹⁷ Peter Schlechtriem, *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, fq. 283.

Shitësi duhet të dorëzojë sendet në cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar në kontratë, si dhe të ambalazhuara në mënyrën e caktuar në kontratë.⁴¹⁸

Sipas Konventës së Vjenës malli duhet të pakëtohet në mënyrën që është e përshtatshme për mallin. Përshtatshmëria e paketimit vlerësohet sipas traditave dhe standardeve në një degë të caktuar të tregtisë, sipas së cilës merret në konsideratë shkaku i paketimit, pra me fjalë të tjera mbrojtja e mallit gjatë kohës që malli është në transport.⁴¹⁹ Nëse malli është dërguar në mënyrën e zakonshme atëherë paketimi i tij është i zakonshëm dhe i përshtatet kushteve të zakonshme të transportit.⁴²⁰ Paketimi i zakonshëm është i varur direkt nga lloji i mallit. Kështu që te shitja e drithërave, paketimi i zakonshëm nënkupton ngarkimin e tij në vagonë të trenit ose në kontejnerë, ndërsa për një lloj tjetër malli (p.sh. malli i një firme të veçantë) zakonisht përfshihet paketimi origjinal i mallit. Pastaj tek transporti i kafshëve përfshihet paketimi i detyrueshëm që paraqet transport të sigurt.⁴²¹ Gjithashtu neni 35, paragrafi 2, pika d, e Konventës së Vjenës nuk e përfshin përshkrimin e të gjitha udhëzimeve të nvojshe.

Kur nuk ekzistojnë zakonet në bazë të së cilave mund të rregullohej paketim i zakonshëm, atëherë malli duhet të jetë i pakëtuar në mënyrën në të cilën është më e përshtatshme që malli të ruhet. Kjo varet para së gjithash në rastet kur malli është prodhuar posaçërisht për blerësin ose kur flitet për prodhimin i cili është i ri në treg. A është paketimi i përshtatshëm? Kjo është pyetja faktike, e me rastin e vlerësimit duhet marrë në konsideratë lloji i mallit, gjatësia,, afati i qëndrueshmërisë dhe mjeti i transportit, kushtet klimatike gjatë kohës së transportit, por edhe kushtet në vendin e përcaktuar apo në ndonjë vend tjetër. Në secilin rast malli duhet të jetë i pakëtuar në mënyrë që të jetë i përshtatshëm, që ai të ruhet dhe të mbrohet, derisa shitësi t'ia dorëzojë transportuesit ose blerësit.⁴²² Detyrimi i dorëzimit mbaron kur shitësi ia dorëzon mallin transportuesit, atëherë paketimi duhet të jetë i atillë që t'i rezistojë transportit dhe të vazhdojë deri te dorëzimi i mallit te blerësi në vendin e dedikuar për dorëzim. Nëse shitësi e ka ditur ose është dashur të dijë për mundësinë e devijimit ose për rishitje të mallit atëherë malli duhet të jetë i pakëtuar në mënyrë që të përballojë transportin dhe të vazhdojë të qëndrojë deri në

⁴¹⁸ KCSH, neni 715, paragrafi 1.

⁴¹⁹ Peter Schlechtriem, *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, fq. 283.

⁴²⁰ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2353.

⁴²¹ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 364.

⁴²² Sipas një vendimi të arbitrazhit, shitësi i pemëve të konservuara nuk ka përmbushur detyrimin e tij nga neni 35, paragrafi 2, pika d e Konventës së Vjenës sepse malli nuk është i pakëtuar në mënyrën e duhur. Gjithashtu paketimi në kontejnerë, në kohën e duhur, ka sjellë deri te shkatërrimi i tij MEXICO, 29. April 1996 Compromes Arbitration (Canned fruit case), www.cisg.law.pace.edu

destinacionin e fundit.⁴²³ Nëse paketimi nuk është i përshtatshëm atëherë LMD-ja e përcakton në këtë mënyrë: Transportuesi ka për detyrë të paralajmërojë dërguesin për të metat e paketimit, që mund të vihen re, përndryshe përgjigjet për dëmtimin e dërgesës që do të shkaktohej për shkak të këtyre të metave.⁴²⁴

Kjo që u tha më lart vlen vetëm nëse shitësi për mundësitë e përgatitjes së mëtejme di ose është dashur të dijë me rastin e shuarjes së kontratës.⁴²⁵

Paketimi i mallit mund të ketë dy funksione të ndryshme. Në njërin anë ai mund të jetë pjesë përbërëse e mallit (p.sh. paketimi i një parfumi, paketimi origjinal i mallit të caktuar të një marke të njohur), e në anën tjetër kjo mund të përdoret vetëm si mbrojtje për paketimin e mallit. Varësisht prej funksionit të paketimit janë të ndryshme pasojat e dëmtimit të tij në transport. Nëse për kohën e transportit dëmtohet paketimi, i cili ka rol mbrojtës, dhe malli mbetet i paprekur atëherë për dëmtimin do të përgjigjet shitësi. Gjithashtu blerësi nuk thirret në përgjegjësi nëse malli nuk ka qenë mirë i pakeluar, por që ka arritur i padëmtuar. Përkundër kësaj, kur paketimi është pjesë përbërëse, dëmtimi i tij sjell deri te pakujdesia dhe te përgjegjësia e shitësit.

Në fund paketimi duhet t'i shërbejë qëllimit për kohën e transportit, në mënyrë që malli të mbrohet nga dëmet. Nëse gjatë transportimit të mallit, për shkak të mungesave që ndodhen në paketimin e tij, malli dëmtohet, atëherë, shitësi është përgjegjës, bile edhe nëse dëmi është shkaktuar pas kalimit të rrezikut.⁴²⁶ Për dëmin, që për shkak të së metës në paketim e pësojnë personat e tretë derisa sendi ndodhet tek transportuesi, i përgjigjet transportuesi, ndërsa ky ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga dërguesi.⁴²⁷

Nga lidhja në mes të paketimit dhe korrespondencës së mallit mund të themi që shitësi bart shpenzimet për paketimin e duhur.

⁴²³ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 278.

⁴²⁴ LMD- neni 672, paragrafi 2.

⁴²⁵ *Konventa e Vjenës*, neni 38, paragrafi 3.

⁴²⁶ Peter Schlechtriem, *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)*, fq. 284.

⁴²⁷ Gjithashtu Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2353.

⁴²⁷ LMD, neni 672, paragrafi 2.

IV. 8.4. Dorëzimi i një pjese të sendit të shitur ose dorëzimi i një sasi më të vogël ose më të madhe ndryshe nga kontrata

Palët kontraktuese kur lidhin kontratën, e lidhin duke përcaktuar sasinë dhe llojin e mallit i cili duhet të dorëzohet nga shitësi te blerësi. Shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar me kontratë.⁴²⁸ Sasia e dorëzuar e mallit duhet t'i përgjigjet asaj që palët kanë kontraktuar në mes tyre. Kur vetëm një pjesë e sendit të dorëzuar ka të meta ose kur është dorëzuar vetëm një pjesë e sendit ose një sasi më e vogël sesa ajo që është kontraktuar, blerësi mund ta zgjidhë kontratën në kuptim të neneve të mësipërme vetëm në lidhje me pjesën e cila ka të meta ose vetëm në lidhje me pjesët ose sasi të që mungojnë.⁴²⁹ Shitësi duhet të dorëzojë sendet në cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar në kontratë, si dhe të ambalazhuara në mënyrën e caktuar në kontratë.⁴³⁰

Sipas Konventës së Vjenës me jokonformitet mund të konsiderohet secili dallim në sasi, gjegjësisht dhe dorëzimi i një sasi më të vogël ose më të madhe nga ajo e cila është përcaktuar në kontratë. I njëjti vendim është i përfshirë edhe në nenin 33, paragrafi 1, pika a, e ULIS. Në të drejtën tonë, me kuptimin e mungesës materiale, është përfshirë dorëzimi vetëm i një pjese të sendit ose sasi më e vogël e mallit sesa ajo e kontraktuar.

Në të drejtat nacionale, sipas rregullës, dallojnë pjesëmarrja e blerësit në rastet e mungesave kuantitative dhe mungesave fizike të mallit. Kjo nuk është e dobishme, sepse nuk është gjithmonë e lehtë të bëhet në të ardhmen kufizimi i mungesave kuantitative dhe kualitative; ndodh që mungesat në vështirësi të sasisë, krijojnë ndonjëherë mungesa në vështirësi të kualitetit. Pikërisht për shkak se mungesat në mall ndodhin ato largojnë sigurinë në tregtinë ndërkombëtare, kuptimi i jokonformitetit i përfshin edhe mungesat, edhe cilësinë në sasi. Në këtë mënyrë është e barabartë pjesëmarrja e blerësit tek të dyja llojet e mungesave.

Sipas Konventës së Vjenës, nëse shitësi porositi sasi më të vogël, gjegjësisht vetëm një pjesë e mallit, në kontrolle të pjesës së mallit të cilat i mungojnë blerësit në posedim qëndrojnë të gjitha mundësitë e së drejtës nga neni 46 deri te neni 50 i Konventës së Vjenës⁴³¹, gjegjësisht ai mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kërkon zvogëlimin e mallit dhe shkëputjen e kontratës. Sipas

⁴²⁸ LMD, neni 450.

⁴²⁹ LMD, neni 475, paragrafi 1.

⁴³⁰ KCSH, neni 715, paragrafi 1.

⁴³¹ Konventa e Vjenës, neni 51, paragrafi 1.

Konventës së Vjenës përmbushja e një sasi të mallit konsiderohet mungesë e konformitetit, por jo një pjesë e mospërmbushjes së detyrimit me vonesë në dorëzim, në kontroll të mallit të humbur. Dallimi është i rëndësishëm për kushtet e ndryshme, për dukjen e përgjegjësisë së shitësit, si dhe për shkak të mjeteve juridike e cila blerësit i qëndron në dispozicion. Kjo çështje, e cila është paraqitur tregon ilustrim të qartë të një fakti që dorëzimi korrespondon me mallin dhe me detyrimin e dorëzimit sipas Konventës së Vjenës që është plotësisht detyrim i shkëputur, kështu që pasojat e së drejtës paraqesin dëmtimet e tyre të ndryshme. Nëse dorëzimi i një sasi më të vogël të mallit, nga malli i kontraktuar, do të trajtohet si dorëzim i pjesërisht me vonesë në vështrim të përmbushjes, atëherë blerësi mundet që sipas nenit 45, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës të përdorë mjete juridike nga neni 46 deri në nenin 52 të Konventës së Vjenës dhe do të ketë të drejtë që të kërkojë kompensimin e dëmit. Baza për përdorim të cilitdo nga mjetet juridike të përmendura do të ishte përmbushje e detyrimit,⁴³² si një prej detyrimeve të shitësit. Përkundër kësaj, blerësi fiton të drejtën që të thirret në jokonformitetin e mallit vetëm në bazë të kushteve të përcaktuara. Ai është i detyruar që mallin e pranuar ta kontrollojë⁴³³ dhe në afatin e caktuar të paralajmërojë shitësin për të metat.⁴³⁴

Disa autorë për dorëzimin e një sasi më të vogël të mallit, ndryshe nga ajo e kontraktuar, e shohin si ofertë për ndryshimin e kontratës, me të cilën blerësi dështon që të pranojë përfundimisht ankesat.⁴³⁵ Në këtë rast, blerësi është përgjegjës që të paguajë çmimin vetëm për mallin e porositur. Mungesat në sasi konsiderohen jo vetëm dorëzimi i një sasi më të vogël të mallit gjenerik, por gjithashtu edhe dorëzimi i një sendi individualisht të përcaktuar, të cilit i mungon ndonjë pjesë, sepse jokonformiteti ekziston nëse mungon pjesa e veçantë nga tërësia e mallit të porositur.⁴³⁶ Qëndrimi i pranuar gjerësisht është që mungesa e konformitetit do të ekzistojë edhe nëse ekziston dallimi në sasi nga dokumenti⁴³⁷, sipas mendimit të dytë, nëse mungesa e mallit është e dukshme nga dokumenti, atëherë bëhet fjalë për dorëzim të pjesërisht e jo për jokonformitetin. Ne konsiderojmë që në këtë rast flitet për jokonformitetin e mallit, me këtë rast blerësi në pajtim me nenin 40 të Konventës së Vjenës nuk është përgjegjës që shitësin ta paralajmërojë për të metat.

⁴³² Sipas nenit 45, të *Konventës së Vjenës*, nëse shitësi nuk përmbush cilëndo nga detyrimet e veta, të cilat i ka në bazë të kontratës ose Konventës, blerësi mund të parashtrojë mjete të parapara juridike.

⁴³³ *Konventa e Vjenës*, neni 38.

⁴³⁴ *Konventa e Vjenës*, neni 39.

⁴³⁵ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2347.

⁴³⁶ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2347, 2348.

⁴³⁷ Gjithashtu, Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2347- 2348.

Sipas së drejtës sonë, dorëzimi e një sasi më të vogël të mallit konsiderohet mungesë e pjesëshme. Sepse nisur nga ky dorëzim edhe mund të quhet dorëzim simbolik, madje prof. Dauti zgjerohet duke potencuar: Dorëzimi simbolik është kur nuk dorëzohen sendet në tërësi, por vetëm një pjesë, për shembull drithi ose kur dorëzohet dokumenti me shkrim mbi sendin.⁴³⁸ Mungesa e pjesëshme ekziston nëse pjesa e sendit të dorëzuar ka të meta, nëse është dorëzuar një pjesë e sendit ose nëse është dorëzuar sasi më e vogël nga ajo e kontraktuar. Megjithatë ligji nuk precizon në cilën fushë duhet të ekzistojë mungesa e pjesëshme, domethënë sa përmban sasia më e vogël e mallit dhe sa sasia e kontraktuar në kontratë, në sa pjesë sendi ka mungesa ose cila është pjesa e sendit që është dorëzuar.⁴³⁹ E konsiderojmë që ekzistimi i një mungese të pjesëshme duhet të vlerësohet sipas rrethanave të rastit. Në bazë të kësaj duhet pasur kujdes që sasia e kontraktuar ose sendi i dorëzuar krijon tërësinë, gjegjësisht se a është blerësi ai që ka interes të arsyeshëm që të pranojë sendin e kontraktuar ose sasisë në tërësi. Sipas qëndrimeve të praktikës vendore mungesa e sasisë së mallit konsiderohet mungesë materiale.⁴⁴⁰

Te shitja ndërkombëtare e mallit, nëse shitësi dorëzon sasinë më të madhe nga ajo e kontraktuar, blerësi mund të pranojë ose të refuzojë dorëzimin që tejkalon sasinë e kontraktuar. Nëse blerësi pranon të gjithë mallin, plotësisht ose njërën pjesë mbi sasinë e kontraktuar, është i obliguar sipas çmimit të kontraktuar⁴⁴¹. Përkundër kësaj, nëse blerësi dëshiron të refuzojë sasinë ose pjesën më të madhe, që e tejkalon atë të kontraktuarën, ai duhet si edhe në rastet e tjera të jokonformitetit të mallit të paralajmërojë shitësin.⁴⁴²

Dorëzimi i një pjese më të madhe nga ajo e kontraktuar është lëndë e mosmarrëveshjes e cila ka ndodhur në Francë. Blerësi nga Franca nga shitësi prej Gjermanisë ka porositur mjete komponente elektronike. Blerësi ka sfiduar sasinë e mallit të porositur duke deklaruar që malli që është dorëzuar është i sasisë më të madhe edhe nga shitësi ka kërkuar që sasia e plotësuar e mallit të merret prapa. Gjykata e instancës më të ultë ka marrë vendim që blerësi ka qenë i detyruar që të paguajë çmimin e mallit të dorëzuar dhe që pjesa e tepërt të kthehet te shitësi, në vend që nga shitësi të kthehet tek ai. Më vonë edhe Gjykata e Apelit të Francës e ka vërtetuar

⁴³⁸ Nerxhivane Dauti (2001). “E drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Veçantë”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 310.

⁴³⁹ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, libri II*, redaktorët Perović, Stojanović, fq.105.

⁴⁴⁰ Dragoslav Veljković, *E Drejta e Detyrimeve–Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me Regjistrin e Termeve – për aplikimin praktik me rastet e kontratave , ankesave dhe praktikës gjyqësore*, Beograd, 2005, fq. 463.

⁴⁴¹ *Konventa e Vjenës*, neni 52 paragrafi 2.

⁴⁴² Gjermania 25.09.2002 Oberlandesgericht Rostock, www.unilex.info.

vendimin e gjykatës më të ultë.⁴⁴³ Komentatorët me arsye kanë kritikuar këtë vendim, sepse blerësi është përgjegjës që mallin ta kontrollojë dhe ta paralajmërojë shitësin për mungesat eventuale të mallit. Megjithatë ai kurrë nuk ka detyrimin e kthimit të mallit shitësit.

Në të drejtën tonë dorëzimi i një sasive më të madhe të mallit nga ajo e kontraktuar nuk paraqet mungesë materiale. Blerësi nuk është i obliguar që të pranojë mallin, i cili e tejkalon sasinë e përcaktuar me kontratë. Posaçërisht blerësi mund të refuzojë edhe pranimin e të gjithë sasisë nëse pjesa e tepërt nuk mund të ndahet pa shpenzime të rëndësishme dhe pa vështirësi të mëdha.⁴⁴⁴

Te kontratat tregtare blerësit shpesh blejnë mallin për shkak të shitjes së mëtejshme, dhe sasia më e madhe eventuale nuk paraqet pengesa. Pikërisht për arsye të kësaj ligji përmban supozimin që blerësi ka pranuar tepricën, nëse në afatin e arsyeshëm nuk deklaron që e refuzon tepricën e mallit. Sipas kësaj blerësi mund të refuzojë tepricën e mallit të porositur nga momenti kur kontrata vendoset në afatin e arsyeshëm. Afati i arsyeshëm fillon të rrjedhë nga momenti kur blerësi me kontroll ka konstatuar që sasia më e madhe e mallit të dorëzuar ndryshon nga ajo e kontraktuar ose nga momenti kur ai atë e ka marrë vesh. Natyrisht, blerësi i cili nuk refuzon tepricën është i detyruar që atë mall ta paguajë me të njëjtin çmim, sikurse edhe sasinë të cilën e ka pranuar, me supozimin që teprica në të gjitha normat i përgjigjet asaj që është kontraktuar. Dorëzimi i një sasive më të madhe të mallit konsiderohet ofertë për shuarje të kontratës së re për shitjen, në kontrollim të sasisë më të madhe⁴⁴⁵ dhe vazhdimi i marrëveshjes nga ana e blerësit me pranimin e tij.

Në disa degë të tregtisë janë të lejuara disa devijime të sasisë së kontraktuar, gjegjësisht ekziston një tolerancë e caktuar. Arsyeja për pranim për devijimeve të tilla qëndron në atë sesa më shumë mall të porositet dhe në sasi sa më të madhe, sidomos nëse malli duhet të transportohet nga një vend në një vend tjetër, do të ketë humbje të sasisë së mallit madje rrezikon të ketë raste edhe deri te zhdukja e tij. Ndonjëherë është natyra e mallit e tillë që nuk lejohet dorëzimi i sasisë së njëjtë me atë të kontraktuar. Ky është rasti kur porositet, për shembull, malli në pjesën më të madhe të rasteve. Konventa e Vjenës shprehimisht nuk e rregullon rastin kur ekzistojnë devijime më të vogla. Nëse janë të zakonshme ose sipas praktikës devijime të tilla

⁴⁴³ Teija Poikela, *vepër e cituar*, fq. 34.

⁴⁴⁴ Vladimir Kapor, “Kontrata për Shitjen dhe Blerjen e Mallit” “Përkthim i Uzansave të Përgjithshme për Tregti me Mallra” fq. 147; “Kommentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve”, libri I, redaktori Borislav Blagojević & Vrleta Krulj, fq. 994.

⁴⁴⁵ Boris Vizner & Ivan Bukljaš, *vepër e cituar*, libri 3, fq. 1645.

janë të lejuara, dhe dorëzimi konkret nis në kufijtë e tolerancës, atëherë nuk ka mungesë konformiteti. Nëse arsyeja e palëve është që devijimet nuk tolerojnë, kjo mund të precizohet në kontratë. Këtu flitet për një situatë shumë të rëndësishme duke u nisur nga ajo se, blerësi atëherë mund të përdorë saktësisht po atë mall, por jo me të gjitha mjetet juridike. Ai mund t'i përdorë këto mjete për shkak të devijimeve më të vogla, por dhe të kërkojë shuarjen e kontratës ose dorëzimit e një malli tjetër, por gjithsesi në dispozicion qëndron kërkesa për kompensimin e dëmit dhe kërkesa e zvogëlimit të çmimit.

Në tregtinë e mallit devijimet e vogla në sasi të pranueshme janë evidente. Sipas zakoneve të punës, të cilat ekzistojnë në të drejtën tonë, shkëputja nga sasia e kontraktuar mund të rregullohet në dy mënyra. Nëse palët në kontratë përdorin nocione tregtare, të cilat janë të zakonshme për shprehjen e tolerancës, atëherë është lënë largimi nga 5% ose nën sasinë e kontraktuar.⁴⁴⁶ Kur sasia e mallit nuk është e përcaktuar në këtë mënyrë, atëherë, është lënë më së shumti devijim 2% nën sasinë e kontraktuar. Sipas kësaj nëse është dorëzuar sasia e mallit brenda kornizave të kontraktuara, porosia në shikim të sasisë konsiderohet në rregull. Natyrisht, palët kontraktuese gjithmonë mund të bartin klauzolën “pa tolerancë” dhe njëkohësisht urdhërojnë se tolerancat nuk janë gjithmonë të lejuara, pra nuk ka kurrfarë devijimi në sasinë e mallit të porositur.

IV. 8.5. Dorëzimi aliud

Shitësi duhet t'i dorëzojë blerësit mallin e kontraktuar, të llojit dhe cilësisë së njëjtë për çka janë marrë vesh palët kontraktuese, në mënyrë që përmbushja të jetë konform kontratës. Shitësi duhet të dorëzojë mallra të cilat janë në sasinë, cilësinë dhe përshkrimin e kërkuar në kontratë dhe që mbyllen ose paketohen në mënyrën e kërkuar nga kontrata.⁴⁴⁷ Lloji i mallit të cilin shitësi ia ka borxh blerësit mund të jetë përcaktuar në mënyra të ndryshme. E para, shitësi mundet që llojin e mallit ta përcaktojë dhe ta ofrojë, atëherë shitësi është i detyruar që ta përshkruajë mallin. Edhe nëse oferta varet nga shpalljet, të cilat ilustrojnë mallin dhe cilësinë, ky ilustrim krijon pjesën e ofertës, dhe kështu për shitësin krijohet detyrimi në rastin kur e pranon

⁴⁴⁶ *Uzansat e Përgjithshme*, Uzansa . nr. 121, paragrafi 1.

⁴⁴⁷ *Konventa e Vjenës*, neni 35, paragrafi 1.

ofertën.⁴⁴⁸ E dyta, lloji i mallit mund të jetë i përcaktuar në ofertë, të cilën blerësi ia ka bërë shitësit. Natyrisht pranimi i ofertës nga ana e shitësit do të thotë që përshkrimi i mallit e detyron.

Sipas nenit 35, paragrafi 1, Konventa e Vjenës, shitësi është përgjegjës që ta dorëzojë mallin në llojin si është përcaktuar në kontratë. Ky detyrim ka për objekt një send, që i takon tashmë blerësit, i cili është bërë pronar si pasojë e efektit real e të menjëhershëm të kontratës së shitjes, gjithmonë kur flitet për sendet individualisht të përcaktuara, ku blerësi bëhet pronar që në momentin e nënshkrimit të kontratës ndërmjet tij dhe shitësit.⁴⁴⁹ Në të kundërt, dorëzimi i një lloji tjetër nga ajo e kontraktuar konsiderohet jokonform kontratës. Shitësi është i detyruar t'ia dorëzojë blerësit sendin e kontraktuar, i cili paraqitet si lëndë e kontratës mbi shitjen.⁴⁵⁰ Zgjidhje e njëjtë ekziston edhe në nenin 33 paragrafi 1, pika b e ULIS-it, nga të cilat mungesa e konformitetit ekziston kur shitësi ka dorëzuar një send tjetër, e jo atë për të cilën janë marrë vesh, ose ndonjë send të ndonjë lloji tjetër. Siç e shohim te ULIS dorëzimi i mallit të ndryshëm nga malli që është kontraktuar, dhe dorëzimi i mallit të llojit tjetër, shprehimisht është trajtuar si jokonformitet. Konventa e Vjenës, këtë nuk e thotë në mënyrë të qartë, por sipas mendimit tonë situata e së drejtës është e njëjtë. Sipas kësaj me porosinë aluid⁴⁵¹ kuptohet dorëzimi i një sendi tjetër ose i një sendi të një lloji tjetër.

Vendimi i pranuar në burimet ndërkombëtare ka qenë lënda e shumë marrëveshjeve, sepse të drejtat kombëtare trajtojnë ndryshe dorëzimin e aluid-it. Mund të themi që as sot sipas kësaj çështjeje nuk ekziston qëndrim i njëjtë. Sipas një mendimi, dorëzimi i një lloji tjetër të mallit nga ajo e kontraktuar, paraqet dorëzim jokonform, ndërsa sipas një pjese tjetër të teoricienëve, në këtë rast flitet për mospërbushje të detyrimit.⁴⁵² Ekziston dallim i madh në mes adresimit të dorëzimit aluid, si jokonformitet i mallit në një anë, dhe si mospërbushje e detyrimit në anën tjetër, sepse sipas Konventës së Vjenës jokonformiteti i dorëzimit dhe mospërbushja e detyrimit të dorëzimit të mallit është diçka tjetër. Edhe pse krijuesit e Konventës së Vjenës kanë tentuar që të unifikojnë mjetet juridike të blerësit në rast të dëmtimit të kontratës nga ana e shitësit. Analiza e normave të Konventës së Vjenës, na tregon për dallim

⁴⁴⁸Fritz Enderlein & Dietrich Maskow. *International Sales Law*, fq. 142

⁴⁴⁹ Ardian Nuni & Ilir Mustafaj & Asim Vokshi, *E Drejta e Detyrimeve II*, Tiranë 2008, fq. 13.

⁴⁵⁰ Nerxhivane Dauti, *E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Veçantë*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2001 fq.310

⁴⁵¹ Fjala aluid do të thotë diçka tjetër. Me një fjalë dorëzimi i një malli tjetër dhe jo mallit të kontraktuar në mes palëve kontraktuese në kontratë.

⁴⁵² Të Drejtat Kombëtare si ajo në Shqipëri po ashtu edhe ajo në Kosovë, dorëzimin e aluid-it e trajtojnë si mospërbushje të detyrimit.

nga ajo se çfarë dallimi ekziston në mes të jokonformitetit dhe mospërbushjes së detyrimit. Për këtë shkak, duhet të kuptohen diskutimet me rastin e përpilimit të Konventës së Vjenës, se dorëzimi aliud nuk ka qenë vetëm analizë teorike, por ka pasur kuptim praktik, sepse kualifikimi i rregullt i dorëzimit aliud ka ndikuar jashtëzakonisht në atë se cilat mjete juridike dhe cilat kushte do të ketë blerësi dhe gjegjësisht, a do të ketë mundësi që të përdorë mjetet juridike të parapara në Konventën e Vjenës. Blerësi humb të drejtën që të thirret në dorëzimin jokonform nëse me mirëbesim nuk lajmëron shitësin për jokonformitetin. Kjo do të thotë se nëse shitësi dorëzon orizin në vend të misrit dhe blerësi me mirëbesim nuk e kundërshton këtë dorëzim sepse e konsideron këtë se deri te përmbushja nuk ka ardhur, ai humbet mundësinë e thirrjes në jokonformitet. Ky problem është tejkaluar me rastin e përmbushjes si detyrime unilaterale të shitësit, me dërgimin e propozimit që dorëzimi është kryer, gjithmonë, kur shitësi i dorëzon mallin blerësit ose transportuesit me qëllim të përmbushjes së kontratës për shitjen.

Në bazë të kësaj mosmarrëveshjeje, të shprehur më lart, rreth përmbushjes të aliud-it ekzistojnë mendime sipas të cilave duhet të krahasohen pasojat juridike të dorëzimit të varshmërisë nga ajo nëse është lënda e kontratës, e përcaktuar si send individualisht i përcaktuar ose send gjenerik.⁴⁵³ Shkaku për këtë qëllim qëndron më tutje. Te sendet individualisht të përcaktuara shumë lehtë mund të konstatohet se a flitet për dorëzimin e një sendi tjetër. Përkundër kësaj, te sendet e përcaktuara sipas garës shumë shpesh nuk është e mundur të urdhërohet me siguri se a flitet për dorëzimin e mallit me mungesa ose aliud. ULIS-i dhe Konventa e Vjenës dorëzimin e mallit tjetër, në raport me dorëzimin e kontraktuar të llojit tjetër të mallit e përcaktojnë si dorëzim jokonform. Për shembull jokonformiteti konsiderohet dorëzimi i patateve të klasit të tretë në vend të klasit të parë, por gjithashtu edhe dorëzimi i orizit në vend të patateve. Kjo do të thotë që, edhe në rastet e devijimeve të ashpra, kur është dorëzuar lloji tjetër i mallit, në raport me atë të kontraktuar, flitet për dorëzim më të vogël. Për kontributin e vlerësimit tonë flet teksti i nenit 35, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, në të cilin bëhet dallimi në mes të asaj që a është dorëzuar malli i cilësisë më të dobët ose malli i një lloji tjetër. Gjithashtu, ky qëndrim përkrahet edhe nga fakti se mungesa në llojin e mallit të paraparë në kontratë mund të “shërojë” moslejimin e ankesave të jokonformitetit.⁴⁵⁴

⁴⁵³ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 514.

⁴⁵⁴ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow., *International Sales Law*, fq. 142.

Për dallim nga kjo, që u potencua sot, qëndrimi gjithëpërfshirës në Komentarin e Sekretariatit të UNCITRAL-it⁴⁵⁵ bën dallimin në mes të dorëzimit aliud dhe mallit të cilësisë së dobët, kështu që në rastet e dorëzimit të mallit të një lloji tjetër, në raport me atë të kontraktuar (nëse shitësi në vend të misrit dorëzon patate) konsiderohet se dorëzimi ose përmbushja e detyrimit nuk është kryer. Qëndrimi i artikulluar nga Komentari i Sekretariatit nuk na çudit nëse duhet të kemi parasush dy dukuri. E para, koha e nxjerrjes së tij. Ky komentar daton para kohës së nxjerrjes së Konventës së Vjenës, kohë kur konceptet janë pranuar në këtë mënyrë edhe kur këto norma ende nuk janë aplikuar. E dyta, në formimin e këtij mendimi, në një masë të madhe, kanë ndikuar rregullat e së drejtës nga të drejtat nacionale, sipas të cilit dorëzimi i mallit, që nuk ka asgjë të përbashkët me mallin të cilin ka dashur blerësi, nuk paraqet dorëzimin (përmbushjen).⁴⁵⁶ Së pari blerësi mund të thirret në jokonformitetet vetëm nëse shitësi i ka dërguar lajmërim për këtë. Kjo do të thotë që shitësi duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin që dorëzimi është jokonform kontratës. Këtu duhet bërë dallimin e dy rasteve: kur shitësi është i vetëdijshëm dhe kur ai nuk është i vetëdijshëm. Ndonjëherë mund të ndodhë që mallrat të përzihen dhe që këto janë dedikuar për dy dorëzime të ndryshme dhe që shitësi vërtet nuk e di që blerësi në vend të kripës ka dorëzuar miell. Në këtë rast edhe shitësi mund të ketë interes, që menjëherë me pranimin e njoftimit nga blerësi, ta rregullojë gabimin e bërë, dhe, në këtë situatë shitësi duhej të jetë i mbrojtur. Përkundër kësaj shitësi nuk mund të nxjerrë dobi nga jokonformiteti i tij. Ai nuk ka të drejtë që të përdorë nenin 38 dhe 39 të Konventës së Vjenës kur mungesa e konformitetit varet nga fakti se cilat do të jenë të njohura dhe cilat të panjohura, dhe këtë ai nuk ia ka zbuluar blerësit⁴⁵⁷

E dyta, dorëzimin e mallit jokonform kontratës, blerësi mund të forcojë me paraqitjen e ankesës. Në këtë rast, është tërësisht e njohur që dorëzimi është kryer me rregull dhe që blerësi është i detyruar të paguajë çmimin. E treta, nëse do të rregullohej dallimi në mes të aliud-it dhe mallit të cilësisë më të dobët, edhe teorikisht dhe në praktikë problemi do të pasqyroste kufij në mes të këtyre të dyjave, gjegjësisht kur malli është dorëzuar aliud e kur jo. Problemi zakonisht

⁴⁵⁵ Komentari nr. 31 - UN DOC. A/CONF. 97/5 (Komentari UNCITRAL-a), Official Records, fq. 29. Komentari i UNCITRAL-it prezanton komentari të Konventës së Vjenës të vitit 1978. Komentari zyrtar i vetë Konventës në korniza të UNCITRAL-it nuk ekziston, ky tekst nuk konsiderohet si versioni më i afërt i Komentarit të Konventës së Vjenës dhe në masë të madhe edhe sot e kësaj dite përdoret.

⁴⁵⁶ *Sipas të drejtës më të hershme gjermane dorëzimi aliud është konsideruar dorëzim i mallit, i cili nuk është porositur, konsiderohet se në këto raste dorëzimi i mallit nuk është përmbushur, shih më shumë: Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, International Sales Law, fq. 143.*

⁴⁵⁷ *Konventa e Vjenës, neni 40.*

vjen deri te shprehja kur lënda e kontratës është sendi gjenerik, sepse shumë shpesh nuk mund të konstatohet në mënyrë precize se a flitet për mungesë të mallit ose për sendin e llojit tjetër. (dorëzimi i verës së kuqe në vend të verës së bardhë). Edhe pse në këtë lëmi ekziston një numër i madh i vendimeve ende nuk janë konstatuar dhe kufizuar kriteret e sakta. Në praktikë, për këtë mund të konstatohej edhe një rast tjetër problematik sepse në rastin konkret blerësi dhe gjyqtari në të njëjtën mënyrë kanë kuptuar dorëzimin aliud. Kjo do të çonte deri te shprehja nëse blerësi dhe gjyqtari rrjedhin nga sisteme të ndryshme të së drejtës. E katërta, sipas teorisë gjermane bëhet dallimi në mes të aliud-it” të ashpër” dhe aliudit “të rëndomtë”. I pari do të krijohej në rast të dorëzimit të llojit tjetër (p.sh. kripë në vend të sheqerit), derisa për të dytën mund të flitet kur është dorëzuar sheqeri i bardhë në vend të sheqerit të errët. Sipas këtij qëndrimi “të ashpër” aliud-i prezanton jodorëzimin, ndërsa aliud “i rëndomtë” është mungesa e konformitetit.⁴⁵⁸ Mund të shohim se në mes të teoricienëve nuk ekziston njëzëri bashkimi i mendimeve të tyre. Vendorsja e kuptimit aliud “i ashpër” dhe aliud “i thjeshtë” në praktikë mund të ketë shumë vështirësi, sepse nuk është gjithmonë e mundur kufizimi i tillë. Konsiderojmë që dallimi në mes tyre, në disa të drejta kombëtare, nuk është i pranueshëm. Edhe vetë neni 35, i Konventës dhe po ashtu neni 33, paragrafi 1, pika b e ULIS-it për këtë nuk lejojnë asnjë bazë. Në fund trajtimi i ndryshëm i përgjegjësisë për mungesa dhe aliud do të sjellë deri te paradoksi, se është shumë më e lehtë, nëse shitësi do të kalonte, dhe në këtë mënyrë do të dorëzojë tërësisht mall tjetër nga ai mall që është kontraktuar. Rregullat për rastin e mospërmbushjes janë më të favorshme për shitësin (p.sh. te vonesa ekziston detyrimi i dhënies së argatit shtesë te punët jofikse, derisa te mungesat e mallit, blerësi mundet që menjëherë të dorëzohet (shkëputet) nga kontrata).

Kur shitësi dorëzon mallin e një lloji tjetër (p.sh. drithë i llojit tjetër) të cilin mall blerësi mundet që pa dëm ta përdorë dhe atë për qëllim të caktuar, shtrohet pyetja, se cilat kritere duhet të zbatohen për vlerësimin e jokonformitetit. Në praktikë, në tregtinë e mallrave, vlerësimi kryhet sipas asaj që, blerësi, mallin mund ta përdorë, ta shfrytëzojë sipas kritereve subjektive. Përkundër kësaj, jokonformiteti në Konventën e Vjenës dhe sipas ULIS-it përcaktohet sipas kritereve objektive dhe kështu që në të ardhmen secili dorëzim aliud prezanton jokonformitet.⁴⁵⁹

Sipas të drejtës sonë ekzistojnë zbrazëtira në vështirim të dorëzimit të mallit aliud, edhe pse kjo çështje nuk rregullohet nga LMD-ja, por as edhe nga Uzansat e Përgjithshme. Gjithashtu

⁴⁵⁸ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2346.

⁴⁵⁹ Malden Draškić, (1966). *Përgjegjësia e shitësit sipas rregullave të unifikuara për shitjen ndërkombëtare*, fq. 72.

edhe në doktrinë qëndrimet janë të ndara rreth asaj se, në rast të dorëzimit të mallit aliud ekziston mungesa materiale ose konsiderohet se dorëzimi i mallit (përbushja e detyrimit të dorëzimit) nuk është kryer sipas kontratës. Sipas një mendimi, dorëzimi i një sendi tjetër ose i ndonjë lloji tjetër të mallit, në raport me atë të kontraktuar, nuk paraqet dorëzimin e mallit me mungesa materiale. Me dorëzimin e mallit aliud, shitësi nuk e ka përbushur detyrimin e kontraktuar, dhe me kalimin e afatit për dorëzim bie në vonesë dhe përgjigjet për pasojat e vonesës.⁴⁶⁰ Teoria tjetër është se dorëzimi i mallit aliud mund të trajtohet si përbushje e detyrimit me mungesa materiale. Në disa raste, kur sendi i dorëzuar është i llojit të njëjtë, por ka cilësi të ndryshme nga ai i kontraktuar duhet të konsiderohet që flitet për mungesa materiale.⁴⁶¹ Gjithashtu ekzistojnë autorë që e kanë përkrahur, që dorëzimi i mallit aliud gjithmonë konsiderohet dorëzim më i vogël.⁴⁶² E katërta, një grup i autorëve e konsideron që kualifikimi i dorëzimit të mallit aliud është i ngadalshëm edhe pa dhënien e supozimit për zgjidhje të problemit.⁴⁶³ Dhe në fund sipas një grupi mendimtarësh, përgjegjësia e shitësit dhe mënyra në të cilën duhet të urdhërohet dorëzimi i aliud-it nuk është i rëndësishëm. Nëse dorëzimi aliud kuptohet si jokonform, kjo domethënë që shitësi e ka kryer përgjegjësinë e dorëzimit, por përbushja nuk është e plotë. E nëse përgjegjësia për dorëzimin e llojit tjetër të mallit trajtohet si mospërbushje e detyrimit, atëherë do të jetë përgjegjës vetëm shitësi. Baza e përgjegjësisë së shitësit është, shkelja e kontratës, e cila shkelje ekziston edhe kur përbushja e detyrimit do të jetë më e vogël⁴⁶⁴, por edhe atëherë kur dorëzimi nuk është përbushur fare.⁴⁶⁵

E konsiderojmë se një mendim i tillë nuk mund të pranohet dhe se kushtet e pjesëmarrjes së përgjegjësisë janë të ndryshme në rast të mospërbushjes së detyrimit dhe për gjysmë-përbushje.

Konsiderojmë që është e domosdoshme, që edhe në të drejtën kombëtare dorëzimi i mallit aliud duhet të rregullohet juridikisht edhe me KCSH-në dhe me LMD-në. Më tutje, si të rregullt, e konsiderojmë qëndrimin sipas të cilit dorëzimi i aliud-it konsiderohet dorëzim

⁴⁶⁰ Boris Vizner & Ivan Bukljaš, *vepër e cituar*, libri 3, fq. 1596. Gjithashtu ky qëndrim është përkrahur edhe në praktikën gjyqësore. Sipas qëndrimit të praktikës gjyqësore shitësi nuk ka përbushur dorëzimin nëse blerësit i dorëzon një send tjetër, e jo atë që ka qenë i kontraktuar, shih më shumë, Ivica Jankovec, (1993). *Përgjegjësia kontraktore*, Beograd, fq. 144.

⁴⁶¹ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, Libri II, redaktorët Perović & Stojanović, fq. 73.

⁴⁶² Vladimir Kapor, *Kontrata për Shitblerjen e Mallit – Përkthim i Uzansavave për Tregti me Mallra*, fq. 171.

⁴⁶³ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, libri I, redaktorët Blagojević & Krulj, fq. 973.

⁴⁶⁴ Dorëzim më i vogël - dorëzim i sasisë më të vogël të mallit nga ajo e kontraktuar.

⁴⁶⁵ Ivica Jankovec, (1993). *Përgjegjësia Kontraktore*, Beograd, fq. 144.

jokonform dhe që është pranuar në Konventën e Vjenës dhe në ULIS, sepse ka kuptimin e përparësisë. Radhitja e aliud-it nën kuptimin e konformiteti çon deri tek evitimi drejt vështirësive të përmendura.

Megjithatë përparësia më e madhe e vendimit të përmendur është shumë e rëndësishme dhe kontribon në sigurinë juridike. Blerësi e di, që në secilin rast duhet të kontrollojë mallin dhe të vendosë për ankesën. Në anën tjetër, edhe shitësi është i sigurt që ka përmbushur detyrimin nëse në afatin e përcaktuar nuk e ndjek marrëveshjen.

IV. 8.6. Paketimi (ambalazhimi) ose mbrojtja e mallit

Në fund shitësi është përgjegjës që blerësit t'ia dorëzojë mallin e paketuar ose të mbrojtur në mënyrën e paraparë në kontratë. Nëse palët që kanë lidhur kontratë janë marrë vesh për mënyrën e mbrojtjes ose të paketimit të mallit, atëherë malli nuk është konform kontratës nëse në këtë mënyrë paraqiten devijimet. Në tregtinë ndërkombëtare detyrimi i paketimit të mallit është përgjegjësia kryesore e shitësit dhe përbën pjesën përbërëse të kuptimit të konformitetit. Pasoja praktike e këtij vendimi të Konventës përbën atë se, blerësi në prag të mungesave në paketim ose mbrojtje të mallit, mund të thirret vetëm me kushtin që me mirëbesim ka lajmëruar shitësin. Për dallim nga vendimi i pranuar nga Konventa e Vjenës, detyrimi i shitësit në lidhje me paketimet e mallit në të drejtat ndërkombëtare më së shpeshti trajtohen si detyrim shtesë i shitësit. Në të drejtën tonë shitësi gjithashtu ka detyrim për paketimin e mallit. Edhe pse LMD-ja shprehimisht nuk e parasheh këtë në teori⁴⁶⁶ dhe në praktikën gjyqësore⁴⁶⁷ ekziston pajtimi se mungesa e paketimit (ambalazhimit) mund të konsiderohet si mungesë materiale. Dërguesi ka për detyrë t'i paketojë sendet sipas mënyrës së parashikuar ose të praktikuar, me qëllim që të mos shkaktohet ndonjë dëm ose të mos rrezikohet siguria e njerëzve ose e të mirave.⁴⁶⁸ Këtë e trajton edhe KCSH-ja, e cila i lë hapësirë kontratës për ambalazhimin duke e vazhduar më tej quhet se këto sende nuk janë në përputhje me kontratën në rast se nuk janë të vendosura ose të ambalazuara sipas mënyrës së zakonshme në analogji me sende të të njëjtit lloj, ose në mungesë të një mënyre

⁴⁶⁶ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, libri II, redaktorët Perović & Stojanović, fq. 73.

⁴⁶⁷ Shitësi i përgjigjet blerësit për kompensimin e dëmit për shkak të paketimit të mallit të shitur, pa marrë parasysh se çka ka ndodhur me rastin e transportit dhe nëse nuk është marrë vesh për paketimin e dërgesave dhe ngarkesave. Koleksioni II/1-286. E përmendur sipas: Aleksandar Goldštajn, *E Drejta Kontraktore Tregtare*, fq. 268.

⁴⁶⁸ LMD, neni 672, paragrafi 1.

të tillë të zakonshme, në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për të ruajtur dhe për të mbrojtur sendet.⁴⁶⁹

IV. 8.7. Koha për përcaktimin e konformitetit të mallit

Malli i dorëzuar duhet të jetë konform kontratës. Në të drejtën ndërkombëtare dhe në atë kombëtare si rregull është pranuar që shitësi të përgjigjet për të gjitha çka përmban kontrata, e ndër të gjitha edhe për jokonformitetin e mallit, gjegjësisht për mungesat materiale të cilat ekzistojnë në kohën e kalimit të rrezikut te blerësi. Gjithashtu, shitësi përgjigjet edhe për ato të meta materiale të cilat shfaqen pas kalimit të rrezikut te në blerësi, në qoftë se janë pasojë e shkakut i cili ka ekzistuar më parë.⁴⁷⁰ Ndërkaq Konventa e Vjenës këtë e rregullon duke e quajtur shitësin përgjegjës dhe kjo në përputhje me kontratën dhe me këtë Konventë për çdo mospërputhje që ekziston në kohën kur rreziku kalon te blerësi, megjithëse mospërputhja bëhet e qartë vetëm pas kësaj kohe.⁴⁷¹

KCSH-ja këtë çështje e rregullon me nenin përkatës dhe në mënyrë të hollësishme. Shitësi është përgjegjës për çdo mangësi ose mospërmbushje që ekzistonte në momentin e kalimit të rrezikut te blerësi, edhe kur e meta shfaqet pas këtij momenti.⁴⁷²

Ratio e këtij vendimi është nevoja e ndarjes së rrezikut në mes të shitësit dhe blerësit. Deri te dorëzimi i mallit shitësi sjell përgjegjësinë për rënien e rastësishme ose dëmtimin e mallit. Në momentin e dorëzimit shitësi përmbush detyrimin e tij kryesor dhe malli kalon nga përkujdesja e tij.⁴⁷³ Pas këtij momenti, blerësi bart rrezikun për prishjen ose dëmtimin e mallit. Një vendim i këtillë është logjik sepse deri te përmbushja e detyrimit shitësi mund të eliminojë mungesën, e pas kësaj mungesa mund t'iu përshkruhet të tjerëve. Siç mund të shohim, përgjegjësia e shitësit është e lidhur me kalimin e rrezikut, e jo vetëm për bartje të pronësisë në mall.

Në rastet e caktuara te shitja ndërkombëtare ekziston përgjegjësia e shitësit për mallin jokonform, që merr pjesë pas kalimit të rrezikut, nëse jokonformiteti ka ndikuar te vetë shitësi me dëmtimin e një detyrimi të tij, ose nëse ka dhënë garanci që, në kohën e përcaktuar, nuk do të

⁴⁶⁹ KCSH, neni 715, paragrafi 4.

⁴⁷⁰ LMD, neni 461 paragrafi 2.

⁴⁷¹ Konventa e Vjenës, neni 36, paragrafi 1.

⁴⁷² KCSH, neni 716, paragrafi 1.

⁴⁷³ Komentari i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, libri I, redaktorët Blagojević & Krulj, fq. 969.

ketë jokonformitet të mallit. Vendim të njëjtë ka paraparë edhe ULIS-i, me anë të kësaj që shitësi është përgjegjës edhe për mungesat e konformitetit, të cilat janë krijuar me pjesëmarrjen e palës për të cilën ai përgjigjet.⁴⁷⁴

IV. 8.7.1. Kalimi i rrezikut

Momenti i kalimit të rrezikut është çështje e rëndësishme, sepse nga kjo mosndërprerje varet edhe përgjegjësia e palëve kontraktuese për dështimin ose dëmtimin e mallit. Kalimin e rrezikut palët më së shpeshti e rregullojnë me kontratë. Palët këtë mund ta bëjnë me lidhjen e kontratës duke vendosur klauzolën për kalimin e rrezikut, qoftë me thirrjen në INCOTERMS ose nëse ka përcaktimin e kontraktuar, ndërkaj të shitja ndërkombëtare e mallit parashtrohet pyetja - se a ekzistojnë zakonet tregtare? A janë përmbushur kushtet për aplikimin e tyre në kohën e kalimit të rrezikut? A është vendosur më herët në mes palëve praktika e vendosur më herët? Në fund, për mungesën, më herët është përmendur, që në mënyrë subsidiare përdoren nenet 67-69 i Konventës së Vjenës. Në të drejtën tonë, në mungesë të rregullave të kontraktuara, kalimi i rrezikut është rregulluar me nenin 439 dhe 440 i LMD-së.

Konventa e Vjenës dhe e drejta jonë përfshijnë vendimet e mëposhtme. Nëse sipas kontratës për shitjen është e nevojshme transporti i mallit, dhe shitësi nuk është i detyruar që ta dorëzojë atë në vendin e caktuar, pra transportuesit ose palëve, që të organizojë pajisjet dhe që të bëjë transportin për blerësit në raport me kontratën për shitje.⁴⁷⁵ Nëse shitësi është i obliguar që mallin t'ia dorëzojë transportuesit në vendin e caktuar, rreziku kalon te blerësi vetëm atëherë kur malli i është dorëzuar transportuesit në atë vend.⁴⁷⁶ Neni 738, paragrafët 1 dhe 2 e përcaktojnë shumë mirë këtë çështje.⁴⁷⁷ E drejta jonë e rregullon në mënyrë taksative dorëzimin e mallit te transportuesit në anën e nenit 455. Në rastin kur sipas kontratës nevojitet që të bëhet transportimi i sendeve, ndërsa në kontratë nuk është caktuar vendi i përmbushjes, dorëzimi quhet i kryer me dorëzimin e sendit te transportuesi ose te personi që organizon transportin.⁴⁷⁸

⁴⁷⁴ ULIS, neni 35 paragrafi 2.

⁴⁷⁵ Konventa e Vjenës, neni 67, paragrafi 1, dhe Uzansat e Përgjithshme, Uzansa. nr. 97.

⁴⁷⁶ Konventa e Vjenës, neni 67, paragrafi 1.

⁴⁷⁷ Shih më shumë KCSH, neni 738, paragrafët 1 dhe 2.

⁴⁷⁸ LMD, neni 455.

Te shitja ndërkombëtare e mallit rreziku për mallin që është shitur në kohën e transportit kalon te blerësi në kohën e shuarjes së kontratës. Megjithatë, nëse rrethanat për këtë tregojnëse rreziku kalon te blerësi në kohën kur malli është dorëzuar te transportuesi i cili ka dhënë dokumentet, të cilat konstatohen te kontrata për transport.⁴⁷⁹ Sipas kësaj kontrate transportuesi detyrohet që të transportojë në vendin e caktuar ndonjë person ose send, ndërsa udhëtari, respektivisht dërguesi, detyrohet që për këtë t'i paguajë shpërblimin e caktuar.⁴⁸⁰ Me kontratën e transportit të sendeve transportuesi merr përsipër të transportojë mallin nga një vend në një vend tjetër.⁴⁸¹

Në fund, në rastet e tjera rreziku kalon te blerësi nga koha kur ai merr mallin, ose nëse këtë nuk e bën me mirëbesim, në orën kur malli i është vendosur në dispozicion, dhe ai e shkel kontratën dhe me këtë nuk bie në vonesë me pranimin e dorëzimit. Vonesa e blerësit ekziston kur ai nuk ndërmerr të gjitha veprimet për pranimin e mallit, kur pa arsye refuzon që ta pranojë mallin ose kur është përgatitur që të pranojë mallin, por nuk ofron përmbushje të detyrimit, detyrim që ka arritur për përmbushje. Kur lëndë e kontratës janë sendet e përcaktuara sipas llojit, sipas nenit të LMD-së, rreziku kalon te blerësi, i cili është në vonesë, nëse shitësi ka ndarë sendet në mënyrë të vërejtshme dhe të përcaktuara për përmbushje të dorëzimit, si dhe ai duhet të dërgojë paralajmërimin te blerësi. Sendet e përcaktuara sipas gjinisë në rastet kur shitësi nuk mund të ndajë njërin pjesë, është e mjaftueshme që shitësi t'i ketë kryer të gjitha veprimet që kanë qenë të nevojshme dhe që shitësi do të mund t'i marrë sendet si dhe për këtë nuk i ka dërguar asnjë lajmërim blerësit. Përgjegjësia e shitësit për konformitetin e përmbushjes ekziston vetëm nëse dorëzimi është përmbushur. Sipas kësaj, nëse shitësi është në vonesë me marrjen e mallit, përgjegjësia kalon tek ai kur kalon rreziku, por jo edhe përgjegjësia për mungesat materiale.⁴⁸²

IV. 8.7.2. Jokonformiteti në kohën e kalimit të rrezikut

Shitësi përgjigjet për kontratën dhe Konventën Ndërkombëtare, shitësi është përgjegjës edhe me përputhjen e kontratës me këtë Konventë si dhe për çdo mospërputhje e cila ekziston në

⁴⁷⁹ *Konventa e Vjenës*, neni 68.

⁴⁸⁰ *LMD*, neni 662.

⁴⁸¹ *KCSH* neni 880.

⁴⁸² *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri II*, redaktorët, Perović & Stojanović, fq. 68.

kohën kur rreziku kalon te blerësi, megjithëse mospërputhja bëhet e qartë vetëm pas kësaj kohe⁴⁸³ shitësi është përgjegjës për çdo mungesë në cilësinë e llojit, sasisë dhe paketimin e mallit i cili ka ekzistuar në momentin e kalimit të rrezikut te blerësi. Nëse malli është konform me kontratën, në kohën e kalimit të rrezikut te blerësi, në parim ai nuk ka të drejtë, nëse ajo dështon përmes ndikimeve nga jashtë dhe më vonë nuk i përgjigjet kontratës.⁴⁸⁴

Sipas të drejtës sonë shitësi përgjigjet për mungesat materiale të sendit të cilat ai i ka pasur në kohën e kalimit të rrezikut te blerësi, pa marrë parasysh a ka qenë e njohur kjo për të. Për të metat e dukshme shitësi nuk mban përgjegjësi sepse prezumohet që blerësi duhet t'i shihte ose duhet t'i dinte, përveç rastit kur këto të meta bëjnë që cilësia e sendit të ulet nga ajo që është parashikuar në kontratë aq sa të mos përdoret dot sipas destinacionit.⁴⁸⁵ Gjithashtu, shitësi përgjigjet edhe për mungesat materiale, të cilat paraqiten pas kalimit të rrezikut te blerësi nëse pasojat e shkakut të cilat kanë ekzistuar më parë.⁴⁸⁶ Ligji në rastin tjetër flet për mungesat materiale të cilat janë paraqitur pas kalimit të rrezikut. Mungesat e tilla materiale duhet të jenë pasojë e shkakut të cilat janë krijuar para kalimit të rrezikut. Kjo do të thotë që mungesa ka ekzistuar në kohën e kalimit të rrezikut, vetëm pse atëherë ka qenë në fillim (p.sh. bagëtia e infektuar por, për shkak se kanë qenë në inkubacion, sëmundja nuk është treguar me rastin e pranimit të mallit). Për këtë arsye edhe në rastin tonë e konsiderojmë se flitet për mungesën e cila ka ekzistuar në kohën e kalimit të rrezikut.

Në të drejtën ndërkombëtare dhe kombëtare, për përgjegjësinë e shitësit është e nevojshme që mungesa të ekzistojë në kohën e kalimit të rrezikut. Megjithatë lidhja e përgjegjësisë së shitësit për kalimin e rrezikut nuk do të thotë që blerësi është dashur të kuptojë për mungesat. Shumë rrallë jokonformiteti bëhet i dukshëm në kohën e kalimit të rrezikut dhe mund të konstatohet në bazë të përkujtimit të transportuesit që i është dhënë në lejen e transportit. Blerësi shumë shpesh mundet që me kushtet e mallit të njoftohet vetëm atëherë kur malli mbërrin në vendin e përcaktuar dhe kur do të kryejë kontrollin ose në rastet kur malli fillon që të përdoret, gjegjësisht në momentin e fundit, në raport me kohën e kalimit të rrezikut. Kështu jokonformiteti të kalimi i rrezikut ekziston edhe kur malli në atë moment ka mungesa të fshehura ose nëse malli në

⁴⁸³ *Konventa e Vjenës*, neni 36, paragrafi 1.

⁴⁸⁴ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 435; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2358.

⁴⁸⁵ Mariana Tutulani-Semini, *E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave, Pjesa e Posaçme*, Skanderbegbooks, Tiranë 2006, fq.16.

⁴⁸⁶ *LMD*, neni 461, paragrafi 2.

brendinë e tij është jokonform kontratës,⁴⁸⁷ gjegjësisht nëse jokonformiteti është në fillim.⁴⁸⁸ Të metat e fshehura janë pra të metat e sendit që nuk janë dalluar gjatë ekzaminimit të tij dhe që e bëjnë atë të papërshtatshëm për t'u përdorur sipas qëllimit të caktuar ose që e zvogëlojnë aq shumë cilësinë e tij të përdorimit saqë blerësi, sikur ta dinte, nuk do të kishte blerë ose nuk do të kishte ofruar një çmim më të ulët.⁴⁸⁹ Kjo ndodh në rastin e prodhimeve ushqimore, të cilat në kohën e kalimit të rrezikut ndodhen në procesin e prishjes, dukuri të cilat janë të dukshme nga jashtë, por që do të sjellin deri te prishja e tij. Situata është e njëjtë te dorëzimi i mallit material i cili me rastin e larjes së parë është zvogëluar ose i është fshirë ngjyra.⁴⁹⁰ Rast tjetër është dëmtimi i mallit gjatë transportit për mungesa në paketim. Dërguesi ka për detyrë t'i paketojë sendet sipas mënyrës së parashikuar ose të praktikuar, me qëllim që të mos shkaktohet ndonjë dëm ose të rrezikohet siguria e njerëzve ose e të mirave. Transportuesi ka për detyrë të paralajmërojë dërguesin për të metat e paketimit, që mund të vihen re, përndryshe transportuesi përgjigjet për dëmtimin e dërgesës si pasojë e këtyre të metave.⁴⁹¹ Shitësi do të përgjigjet edhe për mungesat materiale, të cilat paraqiten pas dorëzimit të sendit dhe që kanë ndodhur, për shembull, për shkak se së bashku me sendin duhej të dorëzohej edhe udhëzimi teknik, që është i domosdoshëm, dhe që faktikisht në këtë rast mungon, që për nga rëndësia dhe nga shkakut i përdorimit ndikon në shtyrjen e përdorimit të sendit; po kështu ndodh edhe nëse ky udhëzim do të jetë jo i përshtatshëm ose jo i kuptueshëm.⁴⁹²

Në fund duhet të kuptohet që ligji ynë parasheh që shitësi përgjigjet për mungesat materiale, të krijuara nga kalimi i rrezikut te blerësi, pa marrë parasysh nëse shitësi i ka ditur ose jo mungesat. Megjithatë, fakti që shitësi ka i ditur për mungesat çon në përgjegjësi të dyfishuar sepse sipas nenit 461 të LMD –së, nuk mund të thirret në rrethana që blerësi nuk ka dërguar lajmërim për mungesat. Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut te blerësi, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit.

Shitësi përgjigjet edhe për ato të meta materiale të cilat shfaqen pas kalimit të rrezikut te blerësi, në qoftë se janë pasojë e shkakut i cili ka ekzistuar më parë.⁴⁹³

⁴⁸⁷ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 435; Jens Krüger & Rüdiger Westermann *vepër e cituar*, fq. 2358.

⁴⁸⁸ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 371.

⁴⁸⁹ Georges Vermelle, *E Drejta Civile, Kontratat-Pjesa e Posaçme*, Papirus, Tiranë 2008, fq. 53.

⁴⁹⁰ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 435.

⁴⁹¹ LMD, neni 672, paragrafi 1 dhe 2.

⁴⁹² Ivica Jankovec, (1993). "Përgjegjësia Kontraktore", Beograd, fq. 145.

⁴⁹³ LMD neni 461, paragrafi 1 dhe 2.

IV. 8.7.3. Jokonformiteti pas kalimit të rrezikut

Me qenë se rreziku ka kaluar te blerësi, ky është përgjegjësi që duhet të paguaëj çmimin pa marrë parasysh humbjet dhe dëmtimin, përveç kur humbja ose dëmtimi i mallrave pas kalimit të rrezikut te blerësi nuk e çliron atë nga detyrimi i tij për të paguar çmimin, përveç kur humbja ose dëmtimi ndodh për shkak të një veprimi ose mosveprimi të shitësit.⁴⁹⁴ Rregulli është se pas kalimit të rrezikut ndodhitë atakojnë mallin në sferën e kontrollit të blerësit. Megjithatë, rregullat e rrezikut nuk mund të lirojnë shitësin nga përgjegjësia për shkak të dëmtimit të disa prej detyrimeve të tij. Sipas nenit 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, shitësi përgjigjet për çdo mungesë të jokonformitetit, që janë paraqitur pas momentit që ka kaluar rreziku, dhe jokonformiteti mund të përshkruajë dëmin pa marrë parasysh se çfarë detyrimi kishte, duke përfshirë edhe garancinë që malli duhet të ketë për një periudhë dhe duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm, ose për qëllime të zakonshme, apo që do të përmbajë performanca ose karakteristika të caktuara.⁴⁹⁵ Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit, të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut te blerësi, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni ose jo për të metat e sendit.⁴⁹⁶

IV. 8.7.3.1. Dëmtimi i detyrimit nga ana e shitësit

Kur kalon rreziku dhe paraqitet jokonformiteti i mallit, shitësi do të përgjigjet nëse ai ka ndikuar me dëmtimin e ndonjë detyrimi që ka qenë i detyruar ta kryejë. Sipas një qëndrimi, nëse është dorëzuar malli jokonform, kjo tregon për dëmtim (shkelje) të kontratës, gjegjësisht bëhet vlerësimi, që malli nuk është konform, dhe kjo në një mënyrë tregon dëmtim të detyrimit.⁴⁹⁷ Sipas mendimit tonë, neni 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, rregullon rastin tjetër, e kundërta e kësaj, kur dorëzimi i mallit jokonform paraqet dëmtimin e mallit. Megjithatë në këtë rast shitësi ka porositur mallin pa mungesa (të meta), por është në mes të dëmtimit të ndonjë detyrimi tjetër, atëherë jokonformiteti ka qenë pranishëm pas kalimit të rrezikut te blerësi. Në

⁴⁹⁴ *Konventa e Vjenës*, neni 66.

⁴⁹⁵ *Konventa e Vjenës* neni 36 paragrafi 2.

⁴⁹⁶ *LMD*, neni 461, paragrafi 1.

⁴⁹⁷ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 150.

anën e vlerësimit tonë flet edhe teksti i nenit 36, pika 2, e Konventës së Vjenës që aplikohet kur mungesa e konformitetit është paraqitur pas kalimit të rrezikut.

Është e nevojshme që mungesa e konformitetit mund të përshkruhet dhe të dëmtojë cilindo detyrim të shitësit, gjegjësisht dëmtimi i detyrimit mund të jetë pasojë e jokonformitetit të mallit. Lidhja shkakësore ekziston vetëm nëse jokonformiteti vërtet nuk do jetë i pranishëm dhe që shitësi ka marrë pjesë në raport me detyrimet.⁴⁹⁸

Mospërmbushja e detyrimit mund të përbëhet me veprim, si dhe me mosveprim. Gjithashtu, me kuptimin shkelje e detyrimeve, janë të përfshira dhe shkeljet e detyrimeve kryesore dhe dytësore të shitësit.

Shitësi mund të kryejë shkeljen e detyrimit me zgjedhjen e transportuesit më të keq të mjetit transportues ose të rrugës së transportit.⁴⁹⁹ Shkelja ekziston në rast të dhënies së informacionit të gabuar për montimin, për vendosjen ose përdorimin e mallit. Dëmtimi mund të kryhet edhe me mosdhënien e mjeteve udhëzuese.⁵⁰⁰ Kur shitësi detyrohet që të kryejë montimin me mungesa që paraqet dëmtimin e detyrimit.⁵⁰¹ Sipas mendimit tonë të sotëm si dhe mendimit mbizotërues⁵⁰² rasti i paketimit jo të përshtatshëm të mallit është i rregulluar me nenin 36, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, sepse paketimi sipas nenit 35, të Konventës së Vjenës, është kusht i konformitetit të mallit. Prandaj mungesat e paketimit paraqesin jokonformitetin i cili ka ekzistuar qysh në kohën e kalimit të rrezikut dhe këtu aplikohet neni 36, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Për dëmin, që për shkak të të metës në paketim e pësojnë personat e tretë derisa sendi ndodhet tek transportuesi, përgjigjet transportuesi, ndërsa ky ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga dërguesi,⁵⁰³ sepse sipas legjislacionit tonë, dërguesi ka për detyrë t'i paketojë sendet sipas mënyrës së parashikuar ose të praktikuar, me qëllim që të mos shkaktohet ndonjë dëm ose të rrezikohet siguria e njerëzve ose e të mirave.⁵⁰⁴ Në analizën e dhënë flitet edhe për qëndrimin e praktikës gjyqësore.⁵⁰⁵ Megjithatë, dallimi ka implikime në përgjegjësinë e shitësit. Sipas nenit

⁴⁹⁸ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2359.

⁴⁹⁹ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2822.

⁵⁰⁰ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2358.

⁵⁰¹ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 150; Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 286.

⁵⁰² Fritz Krüger & Dietrich Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2358; Schlechtriem & Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 436.

⁵⁰³ LMD neni 672, paragrafi 5.

⁵⁰⁴ Po aty, neni 672, paragrafi 1.

⁵⁰⁵ Oberlandesgericht Koblenz, 14.12.2006., www.unilex.info. Gjykata ka marrë vendim që shitësi ka shkelur kontratën duke paketuar mallin në një mënyrë tjetër. Sipas nenit 35 paragrafi 2, pika d e Konventës së Vjenës,

36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, mund të bëhet lirimi nga përgjegjësia sipas nenit 79, të Konventës së Vjenës.

Për ekzistimin e dëmtimit të detyrimit nuk është e nevojshme fajësia e shitësit,⁵⁰⁶ por edhe këtu është i përfshirë parimi i përgjegjësisë objektive. Shitësi mund të lirohet nga përgjegjësia për kompensimin e shfaqjes së jokonformitetit sipas rregullave për lirimin nga përgjegjësia, gjegjësisht nën kushtet e parapara në nenin 79, të Konventës së Vjenës.

Neni 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës mund të aplikohet gjithmonë kur është në pyetje shkelja e detyrimit të kryer para kalimit të rrezikut të blerësi. Parashtrohet pyetja - se a është përfshirë situata në nenin 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, kur shkelja është kryer pas kalimit të rrezikut? Në praktikë ky rast mund të jetë i pranishëm te kontrata e shitjes që me montimin dhe me rastin e montimit mund të dëmtohen pjesët tek të cilat rreziku i vetëm ka kaluar te blerësi⁵⁰⁷. Sipas kuptimeve përgjithësisht të pranuara⁵⁰⁸ neni 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës aplikohet edhe te shkelja e kontratës së përmbushur me kalimin e rrezikut në blerësin. E para, vetë neni 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës nuk bën dallimin në kohë, që do të thotë kur është kryer dëmtimi i detyrimit.

E dyta, qëllimi kryesor dhe kuptimi i nenit 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës – në të cilin është peshuar ndarja e rrezikut në mes të shitësit dhe blerësit - flitet për kontribut të trajtimit të njëjtë të shkeljes së detyrimit, pa marrë parasysh kohën kur ato janë krijuar. Në fund, nëse me aplikimin e nenit 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, është kufizuar vetëm te shkeljet e kryera para kalimit të rrezikut, atëherë në rastet e shkeljes së kontratës, raste që kanë qenë të kryera pas kalimit të rrezikut mund të aplikohen norma heterogjene që përmbajnë të drejtat vendore. Kjo do të ishte e paarsyeshme dhe e kundërt me nenin 7, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, i cili parasheh që me rastin e aplikimit të Konventës së Vjenës duhet të kujdesemi për përdorimin e mallit.

edhe pse rreziku ka kaluar te blerësi me dorëzimin e mallit transportuesit, shitësi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar sepse jokonformiteti ka ekzistuar që në kohën e kalimit të rrezikut.

⁵⁰⁶ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2822; Krüger & Westermann, *vepër e cituar*, fq. 235.

⁵⁰⁷ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2359.

⁵⁰⁸ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 372; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 436; Krüger, Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2359.

IV. 8.7.3.2. Garancia e shitësit

Shitësi është përgjegjës për kompensimin e dëmit atëherë kur ai (malli) është i kundërt me garancinë, të cilën shitësi ka dhënë. Malli për një kohë do të jetë i përshtatshëm për qëllim të zakonshëm ose do të ketë përmbajtje ose karakteristika të caktuara.⁵⁰⁹

Kur shitësi i ndonjë makine, motori, apo i ndonjë aparati, ose sendeve të tjera të ashtuquajtura “malli teknik” ia ka dorëzuar blerësit fletëgarancinë me të cilën prodhuesi garanton funksionim të rregullt të sendit për një kohe të caktuar duke e llogaritur qysh në momentin e dorëzimit të tij, blerësi mundet që në rastet kur sendi nuk funksionon në rregull, të kërkojë si nga shitësi, ashtu edhe nga prodhuesi, që sendi të riparohet në afatin e arsyeshëm, ose, nëse nuk e bënjnë këtë, duhet t’i dorëzojë blerësit sendin që funksionon në rregull.⁵¹⁰ Lista e garancisë për funksionim të mirë të sendeve jepet bashkë me sendin teknik, kur ai lëshohet në qarkullim.⁵¹¹ Për përgjegjësinë e shitësit në këtë rast është e nevojshme që jokonformiteti i mallit dërgon deri te shkëlja e garancisë. Neni 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, është i pranuar me të ashtuquajturën garanci e qëndrueshme me anë të së cilës, shitësi garanton që malli do të mbetet funksional në një periudhë të caktuar kohore. Përkundër kësaj, jashtë kësaj norme është garantuar që malli deri te kalimi i rrezikut posedon performancën të caktuar.⁵¹² Lista e garancisë përmban të dhëna për prodhimin (mallin), llojin e prodhimit, kohëzgjatjen e afatit të garancisë, deklaratën mbi evitimin e mungesave funksionale, deklaratën e zëvendësimit të sendit me mungesa funksionale me sendin pa mungesa, datën e prodhimit të sendit, vendbanimin e garantit, nënshkrimin e shitësit kushtet e garancisë dhe ditën e shitjes.⁵¹³

Sipas përmbajtjes garancia sipas rregullit varet nga rreziku, në të cilin gjendet, në sferën e kontrollit të shitësit. Përkundër kësaj, ajo rregullisht nuk përmban mungesa që janë pasojë e vis major, ose trajtim të papërshtatshëm nga ana e blerësit ose personit të tretë. Trajtimi i papërshtatshëm ekziston kur malli përdoret ose mbahet në gjendje jonormale, ose kur posaçërisht kërkohet vëmendje e kërkuar, aftësi, ose kur nuk është respektuar paralajmërimi, dhe udhëzimet të cilat i ka dhënë shitësi.⁵¹⁴

⁵⁰⁹ *Konventa e Vjenës*, neni 36 paragrafi 2.

⁵¹⁰ *LMD*, neni 484, paragrafi 1.

⁵¹¹ Nerxhivane Dauti. (2012). “*Kontratat*”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 110.

⁵¹² Ky ndryshim ekziston edhe në të drejtën gjermane. Krüger, Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2360

⁵¹³ Nerxhivane Dauti. (2012). *Kontratat*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 110.

⁵¹⁴ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 287.

Në mënyrë të veçantë shitësi mund të garantojë qëndrueshmërinë e mallit edhe në rastet e përdorimit jo të zakonshëm të mallit. Megjithatë, rastet e tilla nuk janë të zakonshme, dhe kur ato ekzistojnë është e nevojshme që shitësi të shprehë shqetësimin e tij.

Nuk është e mundur që në mënyrë shumë precize të përcaktohet caku i këtij rregulli. Shitësi është i obliguar që të dorëzojë mallin, i cili do të jetë i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm, në bazë të nenit 35, paragrafi 2, pika a dhe b e Konventës së Vjenës. Për funksionimin e mirë të sendeve teknike, përgjigjet shitësi i sendit teknik dhe prodhuesi.⁵¹⁵ Përshtatshmëria e mallit për përdorim të zakonshëm nënkupton që malli duhet të mbetet i përshtatshëm për përdorim në një afat të caktuar. Nëse pas kalimit të rrezikut do të vërehet që malli nuk është i përshtatshëm për qëllimin e rregullt dhe të zakonshëm, kjo do të thotë se flitet për mungesë të konformitetit i cili ka ekzistuar në kohën e kalimit të rrezikut. Nga kjo aplikohet neni 36, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës.⁵¹⁶ Që të mund të thirret në aplikimin e nenit 36, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës dhe të përdoren edhe mjete juridike për shkak të jokonformitetit të mallit është e mjaftueshme që blerësi në afatin e garantuar të dëshmojë mungesën. Në bazë të kësaj ai duhet të dëshmojë se mungesa ka ekzistuar që nga kalimi i rrezikut.

Me dhënien e garancisë shitësi merr obligime shtesë. Pikërisht për atë arsye garancia nuk është dhënë në rregull, për ekzistimin dhe vazhdimin e saj është e nevojshme marrëveshja në mes palëve ose edhe deklarimi i njëanshëm i vullnetit të shitësit. Ai mund të jetë dhënë në secilën kohë, që do të thotë në të njëjtën kohë me përmbylljen ose pas shuarjes së kontratës, por edhe pas kalimit të rrezikut. Blerësi mundet për shkak të funksionimit jo të rregullt të sendit, të kërkojë nga shitësi, respektivisht nga prodhuesi riparimin ose zëvendësimin e sendit gjatë afatit të garancisë, pavarësisht se kur është shfaqur e meta në funksionimin e sendit.⁵¹⁷

Garancia mund të jetë e dyanshme - shprehimisht dhe heshturazi. Garancitë e shprehura janë garanci të prodhuesit, në të cilat prodhuesi garanton që malli do të funksionojë në periudhë të caktuar kohore (p.sh. 2 vjet 100.000 kilometra të kaluara, 5000 orë pune). Këto garanci në praktikë do të përdoren më së shpeshti dhe në të njëjtën kohë do të lajmërohet për këtë çështje edhe shitësi që është prodhues i mallit. Për garancinë është e nevojshme që të jetë e drejtë dhe sa më precize për shkak të cilësisë së caktuar, si edhe karakteristikave për të cilat shitësi pretendon

⁵¹⁵ Nerxhivane Dauti. (2012). “Kontratat”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq 111.

⁵¹⁶ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 437.

⁵¹⁷ LMD, neni 485, paragrafi 1.

që të marrë përgjegjësinë. Garancia jepet edhe në heshtje. Në heshtje është dhënë garancia vetëm atëherë kur në të pa mëdyshje tregohen rrethanat e rastit. Nisur nga kjo çështje, nuk mundet që në përgjithësi të përcaktohet ekzistimi i garancisë së heshtur për përmbajtje të zakonshme të mallit.⁵¹⁸ Gjithashtu, garancia nuk mundet që në mënyrë konkludente të jepet me reklamim.⁵¹⁹

Edhe te garancia e shprehur dhe tek ajo e heshtur shitësi merr përgjegjësinë për funksionimin e mallit në një periudhë të caktuar kohore. Sipas kësaj, shprehja e garancisë, është periudhë kohore e cila gjithmonë duhet të përcaktohet. Përkundër kësaj mund të krijohet problemi me rastin e përcaktimit të zgjatjes kohore heshturazi të garancisë së dhënë. Sipas versionit të Konventës së Vjenës është paraparë që malli duhet të qëndrojë i përshtatshëm për një kohë (peng. Për një periudhë kohore). Sipas kësaj, flitet për periudhën kohore të papërcaktuar.⁵²⁰ Shumica e autorëve konsiderojnë që formulimi “për një kohë” përcakton periudhën e qëndrueshmërisë së mallit, i cili është i qartë sipas rrethanave të rastit konkret.⁵²¹ Kundër një nocioni të tillë flet fakti që në konferencën diplomatike nuk është pranuar formula “në afat të arsyeshëm sipas rrethanave të rastit”. Konsiderojmë që është e nevojshme të pranohet qëndrimi i përmendur sepse vendimi tjetër do të duhej të kërkohej në të drejtat vendore, që nuk është i dëshirueshëm nëse duhet pasur parasysh karakteri ndërkombëtar i Konventës së Vjenës dhe nevoja që të përparojë njëanshmëria e aplikimit të saj.

Në fund mbetet edhe të përcaktojmë se çka paraqet periudhën kohore të qëndrueshmërisë së mallit sipas rrethanave të rastit? Nuk është e mundur të vendoset si rregull i përgjithshëm, por përgjigjja duhet të kërkohej *in casu*. Megjithatë mund të bëhet dallimi në mes mallit, që priset lehtë nga njëra anë dhe mallit tjetër nga ana tjetër. Malli që priset duhet të përdoret menjëherë pas mbërritjes deri te përdoruesi i fundit në vendin e përcaktuar. Malli tjetër duhet të mbetet i përshtatshëm për përdorimin e tij për të gjithë sipas rrethanave për qëndrueshmëri të pritshme,⁵²² gjegjësisht për qëndrueshmëri të zakonshme.⁵²³ Blerësi kërkon nga shitësi që të bëhet edhe riparimi i sendit që ka garancia. Legjislacioni ynë në mënyrë të qartë e rregullon këtë çështje. Madje ai zgjerohet dhe i jep të drejtë blerësit që të kërkojë edhe shuarjen e kontratës. Në qoftë se shitësi nuk e kryen këtë brenda afatit të arsyeshëm për riparimin ose zëvendësimin e

⁵¹⁸ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 519.

⁵¹⁹ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2360.

⁵²⁰ Konventat e Vjenës janë në gjuhën angleze, spanjolle, franceze, kineze dhe arabe.

⁵²¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 438; Krüger, Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2361.

⁵²² Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 438; Krüger, Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2361.

⁵²³ Jochen Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 519.

sendit, blerësi mund ta zgjidhë kontratën ose të bëjë zbritjen e çmimit si dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.⁵²⁴

IV. 8.8. Të metat e dukshme

Do të konsiderohen të dukshme ato të meta të cilat duhet të konstatohen me një vëmendje dhe një shikim të zakonshëm nga ana e blerësit; aty për aty në çastin e marrjes në dorëzim të sendit.⁵²⁵ Shitësi nuk është përgjegjës për të metat e sendeve të cilat në momentin e përfundimit të kontratës blerësi i dinte ose për të cilat nuk ka marrë dijeni për fajin e vet, përveçse kur të metat kanë të bëjnë me cilësinë, të cilën sendet duhet ta kishin pasur sipas kontratës ose sipas njoftimit të shitësit.⁵²⁶

Shitësi nuk përgjigjet për të metat e specifikuar në LMD, në nenin 462, paragrafët 1 dhe 3 duke potencuar se: në qoftë se blerësi në momentin e lidhjes së kontratës ishte në dijeni për këto të meta, ose ato nuk kanë mundur të jenë të panjohura për atë.⁵²⁷

Neni 39, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës flet për përcaktimin e fillimit të afatit të arsyeshëm, afatit që është me mirëbesim ose në kohën e konstatimit të mungesave dhe në momentin kur mungesa është dashur të zbulohet. E para, te mungesat e dukshme afati fillon të rrjedhë kur blerësi me të vërtetë e zbulon mungesën. Ndërsa është e parëndësishme mënyra e zbulimit të mungesave. Për fillimin e afatit me mirëbesim, që blerësi ka konstatuar jokonformitetin, nuk është e rëndësishme se a e ka zbuluar vetë blerësi mungesën gjatë kontrollit të mallit ose rastësisht mungesën e ka zbuluar dikush tjetër, në bazë të reklamacionit të klientëve të tij. Zbulimi i jokonformitetit ekziston, kur blerësi rreth jokonformitetit mund të jetë i sigurt, si një blerës i kuptueshëm dhe të ndërmarrë hapat që të lëvizë diçka.⁵²⁸ Momenti në të cilin vërtet do të duhej të zbulohej jokonformiteti i dukshëm i mallit, varet nga rrethanat e rastit konkret. Është e mundur që blerësi të konstatojë mungesat e mallit në tërësi edhe para se shitësi të ketë kryer detyrimin e dorëzimit. Ndërsa, është e kuptueshme kur te dorëzimi i makinës mungesa e

⁵²⁴ LMD, neni 487.

⁵²⁵ Mariana Tutulani-Semini, *E drejta e Detyrimeve dhe Kontraktore, Pjesa e Veçantë*, Skanderbagbooks, Tiranë 2006, fq. 17.

⁵²⁶ KCSH, neni 715, paragrafi 5.

⁵²⁷ LMD neni 463 paragrafi 1.

⁵²⁸ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 413, 414; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2390.

dukshme të krijohet edhe para përfundimit të montimit nga ana e shitësit.⁵²⁹ Pastaj, jokonformiteti (p.sh., dallimi i ndryshëm në sasi ose dëmtimi i paketimit të qelqit për ujin mineral) mund të jetë përcaktuar në rastin e dorëzimit të mallit, po kështu mungesat mund të zbulohen edhe gjatë kontrollit.

Afati i arsyeshëm alternativ fillon të rrjedhë nga momenti kur blerësi është dashur ta zbulojë mungesën. Blerësi është dashur të vërejë mungesat më së voni me kalimin e afatit të paraparë për kontroll të mallit, në raport me nenin 38, të Konventës Vjenës, gjegjësisht fillimi i afatit të arsyeshëm, paraqet fundin e afatit për kontroll të mallit nga neni 38, i Konventës së Vjenës. Fillimi i afatit të arsyeshëm paraqet fundin për kontroll të mallit.⁵³⁰ Kur blerësi nuk e ka kontrolluar mallin, afati për lajmërim (njoftim) fillon hipotetikisht nga koha e nevojshme për kontroll.⁵³¹ Sipas kësaj, momenti kur blerësi është dashur t'i zbulojë të metat, paraqet momentin e fundit për fillimin e afatit të arsyeshëm tek të metat e dukshme.

Te dorëzimi i mëhershëm i mallit, afati për dërgimin e lajmërimit nuk fillon të rrjedhë nga koha e kontraktuar e dorëzimit, bile edhe nëse blerësi ka krijuar të metën para kësaj date.⁵³²

Fillimi i afatit nuk anulohet nëse blerësi ka kryer kontrollin e nevojshëm nga neni 38, i Konventës së Vjenës dhe zbulon këto të meta, e pastaj anulon dërgimin e lajmërimit për shkak të vendimit me qëllim që të nxjerrë edhe kontrollin e specializuar për shkak të konstatimit të shkaqeve të jokonformitetit. Blerësi mundet në këtë rast të humbasë të drejtën që të thirret në jokonformitet për shkak të njoftimit jo të duhur. Gjithashtu, nxjerrja e kontrolleve shtesë për lajmërim të shitësit sipas nenit 39, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës nuk është e nevojshme.

Ligjet tona, të metat e dukshme i rregullojnë me KCSH-në, neni 715, paragrafi 5 dhe LMD, neni 463, paragrafi 2, përcakton të metat, të cilat është dashur të zbulohen me kontroll të zakonshëm, në rastin e marrjes së sendit. Edhe pse LMD-ja, në nenin 463, paragrafi 3, lidh zbulimin e mungesës me kryerjen e kontrollit të mallit, e konsiderojmë se nuk është e rëndësishë për të cilin shitësi ka zbuluar mungesën. Gjithashtu, kjo domethënë që kontrollin blerësi duhet ta kryejë, por që mungesa është e atillë që nuk mund të zbulohet me rastin e kontrollit të zakonshëm. A ka mundur blerësi të zbulojë mungesën e dukshme dhe ta vlerësojë si objektive,

⁵²⁹ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2390.

⁵³⁰ *Konventa e Vjenës*, neni 38

⁵³¹ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2390.

⁵³² Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 470.

domethënë sipas palës më të afërt me njohje të pjesshme dhe me përvojën e të njëjtit profesion dhe me specializim të njëjtë si blerësi.

Afati për parashtrim të ankesës në mungesa të dukshme fillon të rrjedhë ndryshe varësisht nga ajo se, a janë të dyja palët të pranishme gjatë kontrollit ose jo. Nëse është kryer kontrolli në praninë e të dyja palëve, blerësi është i detyruar që t'ia paraqesë shitësit menjëherë mendimet e tij për shkak të të metave të dukshme. "Menjëherë" domethënë koha e cila llogaritet derisa të kryhet kontrolli i sendit dhe "koha menjëherë" pas kryerjes së kontrollit të sendit derisa palët ende nuk janë në kontakt në mes veti."⁵³³ Ankesa është e plotfuqishme dhe do të prodhojë efekte juridike, vetëm nëse i drejtohet palës e cila edhe është e pranishme gjatë në kontrollit, dhe konsiderohet që në kontroll të mallit kanë qenë të pranishme të dyja palët kontraktuese nëse kanë qenë aty personalisht, ose nëse është kontrolluar në praninë e përfaqësuesve ose palëve që kanë përfaqësuar emrat e tyre.⁵³⁴

Përfaqësuesi duhet të përmbajë autorizimin që të ndërmarrë veprimet juridike të cilat nuk varen nga dorëzimi dhe marrja e mallit. Në mes palëve që mungojnë, koha për lajmërim fillon të rrjedh nga momenti kur blerësi me kontroll të mallit, ka gjetur, që malli nuk është kontrolluar, afati për parashtrimin e ankesës fillon nga momenti kur blerësi me kontroll ka konstatuar që malli ka mungesa të dukshme. Ne e konsiderojmë se në rastin kur nuk është kontrolluar malli, afati për parashtrimin e ankesës fillon nga momenti kur ka kaluar koha e nevojshme për kontrollin e mallit.

Në fund, me rrethana të caktuara fillimi i afatit për parashtrimin e ankesës mund të shtyhet. Domethënë, nëse blerësi ka vazhduar me prodhimin e sendit edhe më tutje, pa hamendësime, e shitësit me shuarjen e kontratës, ka pasur të njohur ose është dashur të jetë e njohur më tutje mundësia e kësaj përgatitjeje dhe kontrolli i sendit mund të jetë shtyrë deri te arritja e tij në një vend tjetër të përcaktuar, dhe në këtë rast, blerësi është i detyruar që shitësin ta lajmërojë për të metat, dhe mundet që për këtë të informohet nga klientët e tyre. Sipas kësaj, vonesa e fillimit të afatit për parashtrimin e ankesës është e mundur në rrethana të caktuara. Fillimisht, është e nevojshme që blerësi sendin më tutje e ka formuar pa ringarkim. E dyta, është e nevojshme që për shitësin, me rastin e shuarjes së kontratës, ka qenë e njohur ose është dashur të jetë e njohur mënyra e ringarkimit të mëtejshëm. Si moment i përshtatshëm merret momenti i

⁵³³ Boris Vizner & Ivan Bukljaš, *vepër e cituar*, libri 3, fq. 1610, 1611.

⁵³⁴ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, libri II, redaktorët Perović, Stojanović, fq. 84.

shuarjes së kontratës, sepse shitësi atëherë mund të vlerësojë se a është i përgatitur që të bartë këtë rrezik. Mungesat, në këtë rast, konstatohen, se edhe blerësi i dërgon lajmërim shitësit, dhe pastaj blerësi duhet që shitësin ta lajmërojë, sapo e merr vesh. Megjithatë, shitësi te shuarja e kontratës e ka pasur të njohur mundësinë e njoftimit të mëtejshëm për mallin dhe sipas mendimit tonë, blerësi i blerësit ankesën mund t'ia drejtojë edhe direkt shitësit. Në këtë rast do të vërehej ajo që është përmendur më lart, rregullat e konfirmimit të të metave në mes të palëve; blerësi i blerësit do të ishte i detyruar që ta lajmërojë shitësin pa vonesë. Këto situata janë shumë të shpeshta te kontrata e tregtisë, e deri te nxjerrja e LMD-së dhe për shkak të mosekzistimit të rregullave të tillë kjo ka qenë lëndë e konflikteve të ndryshme. Vendimi i përmendur është marrë nga neni 38, paragrafi 2, i ULIS-it, dhe e ka njohur edhe Konventa e Vjenës, neni 38, paragrafi 3, i kësaj konvente. Qëllimi i kësaj norme është lehtësimi i tregtisë.

IV. 8.9. Mungesat e fshehura

Përveç mungesave të dukshme, sendi mund të përmbajë edhe mungesa të fshehura të cilat nuk vërehen lehtë nga palët kontraktuese.

Një prej detyrimeve kryesore të shitësit është se: ai duhet të garantojë blerësin nga zhveshja, nga veset dhe nga mospërputhja e cilësive të sendit me kontratën.⁵³⁵

Të metat ose veset e sendit të blerë duhet të jenë të atilla që e bëjnë të paafte sendin në përdorimin për të cilin ai është destinuar ose që e ulin në një masë të çmueshme vlerën e tij.⁵³⁶ Këto të meta, mungesa ose vese të fshehta, duhet të jenë të atilla të cilat blerësi nuk i njihje në momentin e nënshkrimit të kontratës ose që nuk mund të dalloheshin lehtësisht.⁵³⁷

Kur pas marrjes së sendit nga blerësi shihet se sendi ka ndonjë të metë, e cila nuk ka mundur të zbulohet me kontroll të rëndomtë me rastin e marrjes së sendit (e meta e fshehtë), blerësi është i detyruar me kërcënim të humbjes së të drejtës, që për atë të metë të lajmërojë shitësin brenda një afati kohor tetëditor, filluar prej ditës kur e ka zbuluar, ndërsa te kontrata midis ndërmarrësve menjëherë.⁵³⁸

⁵³⁵ Kodi Civil Shqiptar 1994, neni 710, paragrafi 3.

⁵³⁶ Ardian Nuni, & Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). “E Drejta e Detyrimeve IP”, Tiranë, fq.17

⁵³⁷ Po aty.

⁵³⁸ LMD, neni 465, paragrafi 1.

Jokonformiteti i fshehur ekziston kur blerësi mungesat nuk ka mundur t'i dijë ose është dashur t'i dijë me kontroll të rregullt nga nenin 38, i Konventës së Vjenës. Afati për lajmërim në këtë rast fillon të rrjedhë nga momenti i zbulimit të mungesës sendore. Ky vendim është i kuptueshëm sepse për jokonformitetin e fshehur mund të ankoresh vetëm atëherë kur ajo shihet apo vërehet. Dyshimi i ekzistimit të mungesës nuk është i mjaftueshëm, por është e nevojshme që ekzistimi i mungesës nuk është i mjaftueshëm sigurisht. Nëse, për shembull, makina gjatë përdorimit nga blerësi, i cili nuk mund të përcaktojë nëse ka të meta ose e meta është prezente në kuadër të gabimit në përdorim, dhe nuk ekziston vendimi i jokonformitetit dhe si rrjedhojë nuk e kanë kuptimin e nenit 39, të Konventës së Vjenës.⁵³⁹ Mënyra në të cilën jokonformiteti vlerësohet apo konfirmohet nuk ka kuptim, gjithsesi e meta është zbuluar nga blerësi me rastin e përdorimit ose për të metën shitësi ka kuptuar në bazë të reklamacionit të klientit të tij.

Shpeshherë parashtrohet pyetja se: a mund të vërehet rregulli edhe te mungesat e fshehura? Pyetja qëndron në atë se: a është blerësi përgjegjës me kalimin e afatit për kontroll të mallit, nëse dyshon për ekzistimin e jokonformitetit. Në teorinë juridike, ekzistojnë dy teori. Sipas mendimit të parë, afati i arsyeshëm do të fillojë të rrjedhë nga momenti i vërtetimit real të jokonformitetit. Sipas mendimit të dytë blerësi është i detyruar që të merret edhe me krijimet shtesë “momentin e dyshimit”⁵⁴⁰ Nëse ai këtë nuk do ta bënte, do të duhej të trajtonte se me të vërtetë ka konstatuar jokonformitetin, qysh nga ai moment e deri edhe te rishikimi që do të mund ta vërtetonte këtë të metë të fshehur. Nëse paraqiten simptomat e jokonformitetit jetësohet detyrimi i kontrollit.⁵⁴¹

E konsiderojmë që, do të duhej të pranohej qëndrimi i dytë, se shitësi, në rast të dyshimit dhe të ekzistimit të mungesës, duhet të ballafaqohet, dhe për këtë do të bëhet kontrolli shtesë i mallit. Në të ardhmen po qe se për këtë nuk ekziston norma e shprehur, blerësi është i obliguar që të veprojë sipas parimit të ndërgjegjësimit. Në linjën e fundit, zbulimi i mungesave të mallit është edhe në interesin e tyre. Megjithatë, një vendim i tillë nëse do të realizohej do të ishte një guxim, që mendojmë se nuk ia vlente, sepse në një rast të tillë blerësi është i detyruar që rregullisht të kontrollojë mallin dhe të verifikojë mungesat eventuale të tij.

⁵³⁹ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2391.

⁵⁴⁰ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 414; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2391.

⁵⁴¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 470.

Edhe në të drejtën tonë është pranuar një rregull i njëjtë si në Konventën e Vjenës; në fillim të afatit kur janë zbuluar mungesat e fshehura. Tek të metat e fshehura, afati i parashtrimit të ankesës fillon të rrjedhë nga dita kur blerësi e ka zbuluar të metën.

Mungesa e fshehur është e meta që nuk ka mundur të zbulohet me kontrollin e veçantë me rastin e pranimit të sendit. Kur pas marrjes së sendit nga blerësi shihet se sendi ka ndonjë të metë, e cila nuk ka mundur të zbulohet me kontroll të rëndomtë me rastin e marrjes së sendit (e meta e fshehtë), blerësi është i detyruar me kërcënim të humbjes së të drejtës, që për atë të metë të lajmërojë shitësin në afat prej tetë (8) ditësh, duke e llogaritur prej ditës kur e ka zbuluar të metën, ndërsa te kontrata midis ndërmarrësve menjëherë.⁵⁴² Konsiderojmë se fjalët “me rastin e pranimit të sendit” sasia edhe nëse nuk është në raport me nenin 465 të LMD-së. Mungesë e fshehur është secila mungesë që nuk ka mundur të zbulohet me rastin e cilitdo kontroll të zakonshëm të mallit, e jo vetëm me rastin e kontrollit të mallit, por edhe me rastin e marrjes së tij. Gjithashtu, kur është kontraktuar mënyra e kontrollit të mallit të shitur, e meta ka qenë e fshehur, mungesa është ajo e cila nuk ka mundur që të zbulohet me rastin e tillë, e jo më me kontrollin e zakonshëm.⁵⁴³ Do të konsiderohen të fshehta ato të meta të cilat nuk mund të vërehen me një kontroll të lirë nga pamja e jashtme pas kalimit të një kohe të caktuar apo gjatë përdorimit të sendit.⁵⁴⁴ Të metat ose veset duhet të jenë të meta ose vese të fshehta, ose ato duhet të jenë të tilla të cilat blerësi nuk i njihte në momentin e nënshkrimit të kontratës ose që nuk mund të dalloheshin lehtësisht.⁵⁴⁵

Mungesat e fshehta janë mungesat e mallit të cilat mund të konstatohen vetëm me përdorimin e tyre. Mungesa të tilla më së shpeshti paraqiten te makinat e lehta, ku ato paraqiten vetëm me vendosjen e tyre në shtytje dhe punë në periudhën e caktuar kohore. Gjithashtu, me mungesa konsiderohen edhe mungesat të cilat paraqiten ngadalë.⁵⁴⁶ Veset e fshehura janë pra, të metat e sendit, që nuk janë dalluar gjatë ekzaminimit të tij dhe që e bëjnë sendin të papërshtatshëm për t’u përdorur sipas qëllimit të caktuar ose që e zvogëlojnë aq shumë cilësinë e këtij përdorimi sa që blerësi, sikur ta dinte, nuk do ta kishte blerë ose do të kishte ofruar një çmim

⁵⁴² LMD, neni 465, paragrafi 1.

⁵⁴³ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, libri II*, redaktorët Perović, Stojanović, fq. 86.

⁵⁴⁴ Marjana Semini, *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave-Pjesa e Posaçme*, Skaderbegbooks, Tiranë 2006, fq.17

⁵⁴⁵ Ardian Nuni & Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). *E Drejta e Detyrimeve II*, Tiranë , fq.17.

⁵⁴⁶ Aleksadar Goldštajn, *E Drejta Kontraktore Tregtare*, fq. 296.

më të ulët.⁵⁴⁷ E fundit, malli me paketimin origjinal pas kontrollit të zakonshëm, kufizohet në ekzaminimin e paketimit. Nëse më vonë konstatohet që është dorëzuar mall, që ka pasur mungesa, shitësi për këto të meta të fshehura gjithsesi përgjigjet.⁵⁴⁸

IV. 8.9.1. Kohëzgjatja e afatit

Tek tregtia ndërkombëtare, blerësi lajmëron ose më mirë të themi dërgon lajmërimin në afat të arsyeshëm. Ekziston marrëveshja që afati i arsyeshëm nuk është afat i gjatë. Megjithatë, nga kjo nuk mund të përfundohet se flitet për afat të shkurtër.⁵⁴⁹ Ekziston dallim i madh në vendimet gjyqësore, para së gjithash ato tejkalojnë të drejtat vendore. Sot për shkak të nevojës, njëtrajtshmëria e aplikimit të Konventës së Vjenës është arritur me kompromis dhe praktika gjyqësore është aplikuar sipas kësaj ngjashmërie.

Në teori është pranuar që afati i arsyeshëm, paraqet periudhën në mes dy javëve deri në një muaj.⁵⁵⁰ Megjithatë ky nuk është afat i vetëm, por ai nuk përcaktohet sipas rrethanave të rasteve të veçanta. Nga kjo arsye janë të mundshme devijimet në qëndrueshmërinë e tyre, ato (afatet) mund të jenë edhe më të shkurtra, por dhe më të gjata. Me rastin e mostrës për afatin e arsyeshëm duhet të vazhdohet me zakonet tregtare që në praktikë janë të vendosura në mes palëve, si fakte të përcaktuara. Grupin e parë e bëjnë rrethanat të cilat varen nga malli. Fillimisht është i rëndësishëm lloji i mallit. Afati për dërgimin e lajmërimit nuk është i njëjtë. Te malli, i cili prishet lehtë (p.sh. pemët dhe perimet), është e nevojshme që blerësi për mungesën të tregojë menjëherë, sepse tejzgjatja në këtë rast mund të sjellë deri te humbja e një pjese më të madhe ose të gjithë sasisë së mallit. Gjithashtu sa më shumë që kalon koha është shumë më vështirë të konstatohet shkak i dëmtimit, edhe më shpejt rritet besueshmëria që shkak i mungesës rrjedh

⁵⁴⁷ *Kodi Civil Francez*, neni 1641, cituar nga , Georges Vermelle, *E Drejta Civile, Kontratat, Pjesa e Posaçme*, Papyrus, 2008, fq. 53.

⁵⁴⁸ *Uzansat e Përgjithshme*, Uzansa nr. 148.

⁵⁴⁹ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 415. Cituar nga Enderlein, Maskow, *vepër e cituar*, fq. 159.

⁵⁵⁰ Në mes autorëve gjermanë nuk ekziston pajtim i përbashkët rreth vazhdimin të afatit të arsyeshëm të malli i qëndrueshëm. Disa nga ata pajtohen që afati nga dita e 14-të, p.sh. Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 530; Jens Staudinger & Rudiger Magnus, *vepër e cituar*, fq. 417, 418; derisa të tjerët e konsiderojnë që afati i arsyeshëm duhet të jetë i matur në gjatësi prej një muaji p.sh. cituar nga: Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 468; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2392; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2828.

nga sfera e rrezikut të shitësit.⁵⁵¹ Më së shpeshti, te malli që priset shpejt, si afat i arsyeshëm llogaritet afati prej disa orësh deri në 3 ditë. Sipas rregullit, afati për dërgimin e lajmërimit është i shkurtër nëse lënda e kontratës është malli sezonal, ose nëse është i nevojshëm kontrolli i shpejtë i mallit nga ana e ekspertëve.⁵⁵² Në fund, lajmërimi i shpejtë mund të kërkohet edhe në rastin kur blerësi duhet që të përpunojë mallin shpejt.

E dyta, me rastin e përcaktimit të afatit të arsyeshëm duhet pasur kujdes edhe te lloji i mungesës. Nëse malli është konstatuar me mungesa, të meta të cilat është lehtë të vërehen, për shembull është dëmtuar paketimi origjinal, atëherë shkurtohet afati i arsyeshëm për dërgim të lajmërimit.

Grupin tjetër e paraqesin rrethanat, të cilat nuk janë nga sfera e blerësit, dhe që mund të merren në konsideratë nëse për shitësin, me rastin e shuarjes së kontratës, kanë qenë të njohura.⁵⁵³ Në radhë të parë është i dukshëm specializimi i blerësit. Nëse blerësi është ekspert i asaj fushe, atij do t'i duhej një kohë më e shkurtër për të dhënë vlerësimin, sesa një person që nuk është ekspert. Blerësit, që nuk është ekspert për të kontrolluar një makinë të ndërlikuar, do t'i duhej të angazhonte një person të tretë, dhe kjo duhet vlerësuar sipas standardit objektiv, gjegjësisht, se a është në afatin e arsyeshëm dhe a është në përbërje të njëjtë me rrethana të njëjta dhe nëse atij i është nevojitur ndihma.⁵⁵⁴

Pastaj nga vështrimi për zgjatjen e afatit të arsyeshëm janë të dukshme edhe rrethanat e jashtme. Sipas nenit 20, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, në afat nuk llogariten festat zyrtare dhe ditët që nuk janë ditë pune (p.sh. Viti i Ri). Sigurisht nëse blerësi punon në kohën e festave atëherë edhe ato ditë llogariten në afat.⁵⁵⁵

Në kohën e afatit të arsyeshëm ndikohet edhe afati në mjetin juridik të cilin blerësi planifikon të përdorë. Kur blerësi planifikon që të kërkojë ndërrimin ose përmirësimin e mallit, shuarjen e kontratës, ai po ashtu do të duhej të reagojë më shpejt kur dëshiron të mbajë mallin, si dhe të kërkojë zvogëlim të çmimit ose kompensim të dëmit. Në rastin e parë, afati duhet të jetë sa më i shkurtër për dy arsye. E para, shitësi nuk mund të ndërmarrë asgjë që ta mënjanojë mungesën derisa për këtë bëhet me dije. E dyta, shitësit duhet t'i mundësohet reagim i shpejtë,

⁵⁵¹ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, vepër e cituar, fq. 417; po ashtu: Jens Krüger & Rüdiger Westermann, vepër e cituar, fq. 2394.

⁵⁵³ Në mënyrë analoge aplikohet neni 38, paragrafi 3, *Konventa e Vjenës*, si dhe tek afati për kontrollin e mallit.

⁵⁵⁴ *Konventa e Vjenës*, neni 8, paragrafi 2.

⁵⁵⁵ Julius Staudinger & Ulrich Magnus, vepër e cituar, fq. 417; Schmidt, vepër e cituar, fq. 530.

gjegjësisht ai duhet të organizojë transportkthyes të mallit dhe në mënyra tjera të mundohet që të zvogëlojë humbjet.

Në fund, në rastin kur malli është sipas mostrës, në afatin e arsyeshëm duhet të merren në konsideratë rrethanat e punës së blerësit. Sipas rregullës afati i arsyeshëm do të jetë më i gjatë sesa për ndonjë ndërmarrje të organizuar mirë.

IV. 8.9.1.1.Afati prekluziv

Afatet objektive, me të cilat blerësi mund të ankohet për mungesat e mallit, ndryshojnë në të drejtën ndërkombëtare dhe në të drejtën vendore. Në të drejtën ndërkombëtare blerësi përfundimisht humbet të drejtën që të thirret në jokonformitet në afat prej dy vjetësh nga dorëzimi real.⁵⁵⁶ Të drejtat e blerësit, i cili e ka njoftuar me kohë shitësin mbi ekzistimin e të metave, shuhet pasi të ketë kaluar një vit duke e llogaritur nga dita e dërgimit të njoftimit shitësit, përveç nëse blerësi për shkak të mashtrimit nga ana e shitësit ka qenë penguar t'i realizojë ato të drejta.⁵⁵⁷ Blerësi humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit, në qoftë se nuk denoncon te shitësi, duke specifikuar natyrën e të metave, brenda dhjetë ditëve nga zbulimi, përveç kur palët ose ligji kanë caktuar një afat tjetër.⁵⁵⁸

Në çdo rast blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit në qoftë se nuk e ushtron këtë të drejtë brenda 2 vjetëve nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk është në kundërshtim me kohëzgjatjen e një garancie kontraktore.⁵⁵⁹ Sipas kësaj shohim se Kodi Civil Shqiptar e ka normën e rregulluar në mënyrë analoge me Konventën e Vjenës. Kurse LMD-ja këtë afat e ka më të shkurtër, çka sipas mendimit tonë është afat i mjaftueshëm për çështjen në fjalë.

Nëse i analizojmë vendimet në të drejtën tonë dhe në të drejtat e tjera nacionale në afat prej dy viteve, me nenin 39 të Konventës së Vjenës, atëherë ky afat është relativisht shumë i gjatë. Me rastin e nxjerrjes së Konventës së Vjenës ka debate të mëdha,⁵⁶⁰ ankesa e përmendur për afatet është e paarsyeshme, dhe afati është tepër i gjatë dhe arbitrar. Përkundër kësaj, është

⁵⁵⁶ *Konventa e Vjenës*, neni 39, paragrafi 2., ULIS, neni 39, paragrafi 1, *Uzansa e Përgjithshme*, Uzansa nr. 151, paragrafi 2. .

⁵⁵⁷ *LMD*, neni 483, paragrafi 1.

⁵⁵⁸ *Kodi Civil 1994*, neni 717, paragrafi 1

⁵⁵⁹ Po aty, neni 717, paragrafi 2.

⁵⁶⁰ Jelena Vilus, *Komentar i Konventës UN –it për shitjen ndërkombëtare të mallit*, Zagreb, 1981, fq. 119 dhe 120.

më e vështirë të përcaktohet shkaku i të metës (veseve) kur kalon më shumë kohë nga dorëzimi i mallit te blerësi. Megjithatë, vendimi i tanishëm është rezultat i kompromisit, dhe ka qenë e nevojshme nga arsyet e caktuara. E para, ka qenë e domosdoshme që të merren në konsideratë kushtet me anë të të cilave zhvillohet tregtia ndërkombëtare. E dyta, është e nevojshme që të vazhdojnë me interesin e shitësit, që ai në momentin e caktuar të jetë i sigurt që puna është e kryer dhe e përcaktuar. E treta, përcaktimi i afatit më të gjatë do të bartë me vete vështirësitë rreth dëshmisë për gjendjen e mallit në kohën e dorëzimit.

Sipas Konventës së Vjenës, afati i fundit në të cilin blerësi mund të parashtrojë ankesë për jokonformitetin e mallit, është afati prej 2 vjetësh. Ky afat vlen tek të metat e dukshme dhe te veset e fshehura, por nga kuptimi real jo për konformitetin e fshehur të mallit. Veset e fshehura, të cilat nuk kanë mundur as të zbulohen në rastin e kontrollit të mallit, mund të bëhen të dukshme me rastin e përdorimit të tyre. Në të drejtën tonë afati prej 1 viti, për parashtrimin e ankesës, kryesisht lidhet për veset e mallit. Duhet pasur parasysh se këtu flitet për afatin e fundit në të cilin mund të bëhet ankesa, dhe blerësi është i detyruar t’ia reklamojë veset shitësit menjëherë sapo i zbulon.

Afati 2 vjeçar aplikohet edhe në rastet kur blerësi ka arsye të arsyeshme për mosdhënien e lajmërimit.⁵⁶¹ Përkundër kësaj, afati prej dy vjetëve, gjegjësisht prej 1 viti nuk do të vlejë kur është i ndryshëm me afatin e garantuar të kontratës dhe në rast të jokonformitetit të shitësit nëse shitësi ka ditur për ekzistimin e dëmit, vesit, mungesave për të cilin më vonë do të flitet më shumë.

Afati prej dy vjetëve është prekluziv, kështu që me kalimin e këtij afati blerësi humbet të drejtën që të thirret në jokonformitet. Ky nuk është afati i qëndrueshmërisë. Kështu rrjedha e këtij afati nuk mund të ndërpritet ose të ndalet. Gjithashtu, gjykatat për këtë kanë detyrim të kujdesit *ex officio*. Konsiderojmë që afati prej 1 viti nga natyra e tij është prekluziv.⁵⁶² Qysh me lëshimin e tij ai çon në humbjen e së drejtës. E kundërta e asaj që është përmendur, praktika gjyqësore nuk është unike me atë pyetje. Nga njëra anë vendimet gjyqësore konstatojnë që afati prej 1 viti është afat prekluziv dhe në anën tjetër ekzistojnë vendime gjyqësore për të cilat flitet,

⁵⁶¹ *Konventa e Vjenës*, neni 44.

⁵⁶² Vladimir Kapor, *Kontrata për Shitblerjen e Mallit*–Përkthyes i Uzansave të Përgjithshme për Tregti me Mallra, fq. 165; Ivica Jankovec, (1993). “*Përgjegjësia Kontraktore*”, Beograd, fq. 146; *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, libri I, redaktorët, Blagojević & Vrleta Krulj, fq. 980.

që gjykata mund të kujdeset sipas detyrës zyrtare për respektimin e këtij afati, por gjithmonë vetëm me kërkesën e shitësit.⁵⁶³

Sipas nenit 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës është e nevojshme që blerësi shitësin ta lajmërojë për mungesë të konformitetit. Lajmërimi më i fundit duhet të dërgohet jo më vonë se dita e fundit, që përmbahet në afatin prej dy viteve në kontratë, sepse kjo është e pranueshme nga shitësi.⁵⁶⁴ Përkundër kësaj, në të drejtën tonë, shitësi përgjigjet për mungesat të cilat tregohen nga kalimi i afatit prej një viti. Sipas kësaj, është me rëndësi që veset të jenë të zbuluara para kalimit të afatit, dhe lajmërimi për mungesat të shitësi mund të arrijë edhe me kalimin e afatit.

Në të drejtën ndërkombëtare afati për shitjen e mallit është dy vite dhe fillon të rrjedhë nga momenti i shitjes reale të mallit, të blerësi. Shitja reale e mallit paraqet dorëzimin fizik të mallit nga shitësi të blerësi apo dorëzimin e mallit fizikisht nga ana e personit të autorizuar të blerësi. Për dorëzimin real nuk është e rëndësishme koha e kalimit të rrezikut, as dorëzimi i dokumentacionit i cili e prezanton mallin. Në një rast të tillë, duhet të kemi parasysh që kuptimi i dorëzimit real të mallit nuk është identik me domethënien e dorëzimit të mallit. Sipas kontratës dorëzimi i mallit lidhet me atë se, malli duhet të transportohet, dorëzimi është kryer me dorëzimin e mallit transportuesit të parë. Sipas kontratës duhet të bëhet dorëzimi i sendeve sipas marrëveshjes, ndërsa në kontratë nuk është caktuar vendi i përmbushjes, dhe dorëzimi quhet i kryer me dorëzimin tek transportuesi ose të personi i cili e organizon transportin.⁵⁶⁵ Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend të caktuar, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve.⁵⁶⁶

Në shitjen ndërkombëtare të mallit, ku malli mund të jetë për një kohë të gjatë në transport, dallimi në mes të këtyre dy momenteve mund të jetë i kuptimtë. Nëse dorëzimi kryhet me vendosjen e mallit të blerësi në posedim, ajo kryhet me përgatitjen e mallit në vendin e dorëzimit dhe kur i dorëzohet lajmërimi blerësit. Sipas kësaj, edhe në këtë rast nuk ekziston ujdia në mes kohës së dorëzimit dhe dorëzimit real të mallit. Në fund, kur blerësi padrejtësisht

⁵⁶³ Ivica Jankovec, (1993). *Përgjegjësia Kontraktore*, Beograd, fq. 147.

⁵⁶⁴ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 470.

⁵⁶⁵ *LMD*, neni 455, paragrafi 1.

⁵⁶⁶ *Kodi Civil Shqiptar*, neni 711, paragrafi 2.

refuzon që të pranojë mallin, atëherë momenti i dorëzimit real konsiderohet momenti në të cilin dorëzimi real do të duhej të kryhej.⁵⁶⁷

Për dallim nga vendimi i pranuar në shitjen ndërkombëtare, sipas LMD-së afati prej 1 viti fillon të rrjedhë nga dorëzimi i sendit, fillimi i afatit lidhet me përmbushjen e detyrimit. Sipas së drejtës sonë është pranuar edhe kuptimi tradicional sipas të cilit përmbushja e detyrimit lidhet me dorëzimin e mallit te blerësi sipas së cilës për t'u kryer përmbushja e detyrimit është e nevojshme që të lidhet momenti kur malli realisht i është dorëzuar blerësit.

Te kontrata e shitjes me transport, afati do të rrjedhë nga momenti i dorëzimit të mallit tek transportuesi ose te personi i autorizuar që organizon transportin.

IV. 8.9.2. Afati i garantuar me kontratë

Afati dyvjeçar për dërgimin e lajmërimit nuk do të zbatohet kur nuk është në harmoni me afatin e garantuar me kontratë. Sipas kësaj, palët me marrëveshjen e tyre mund të ndryshojnë ndikimin e nenit 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, gjegjësisht mund të zgjasin ose të shkurtojnë afatin e fundit për dërgimin e lajmërimit.

Afati i garantuar me kontratë mund të ketë qëllim të ndryshëm. Ai mund të paraqesë përmbushjen e mjeteve juridike nga konventa ose kërkon ndërrimin e saj. Në secilin rast konkret pjesëmarrja e kontratës do të duhej të përcaktohej varësisht se në çfarë raporti është me afatin e garantuar dhe me afatin e përcaktuar me nenin 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës.

Pa dyshim kur garancia paraqet shtimin e mjeteve të tjera juridike, por edhe kur afati i garantuar është më i shkurtër se dy vjet, ai nuk ndikon në të drejtën e blerësit që të lajmërojë shitësin në afat prej 2 vjetësh për mungesat (veset) e fshehura. Nëse shitësi i garanton blerësit që makina nuk do prishet në afat prej një viti kjo nuk ka ndikim në afatin 2 vjeçar nga neni 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës. Blerësi mund të ankohet për mungesat të cilat paraqiten me kalimin e afatit garantues në afatin kohor prej dy vjetësh.

Nëse palët merren vesh që garancia duhet të ndërrojë mjetet juridike, sipas një qëndrimi afati dyvjeçar nga neni 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, mund të jetë i zgjatur ose i

⁵⁶⁷ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2395.

shkurtuar.⁵⁶⁸ Shkurtimi i afatit do të ekzistojë nëse palët merren vesh që shitësi do të përgjigjet për jokonformitetet vetëm me kushtin që blerësi do ta lajmërojë atë për mungesat në afat prej 90 ditësh.⁵⁶⁹ Gjithashtu shumë shpesh për mallin që nuk reziston gjatë, por prishet shpejt, shitësi jep garancinë e shkurtër, në mënyrë që blerësi në rast të mungesave ta lajmëronte atë brenda një afati prej 30 ditëve pas pranimit të mallit.⁵⁷⁰ Zgjatja e afatit do të ekzistojë kur afati i garantuar me kontratë është më i gjatë se dy vjet. Në praktikë afatet më të gjata, të garantuara me kontratë, ekzistojnë para së gjithash te mjetet teknike (makina e ndërlikuar, vetura). Sipas kësaj është i mundur vetëm afati dyvjeçar.⁵⁷¹ Sipas mendimit tonë, qëndrimi tjetër nuk është i pranueshëm sepse neni 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, humbet ndërrimin e afatit për dërgimin e lajmërimit gjithmonë kur ai afat është jokonform afatit të garantuar, gjegjësisht kur është lëshuar dhe kur është bërë shkurtimi dhe zgjatja e tij.

Problematika e dytë e rëndësishme është edhe te garancia e kontraktuar, ku aplikohet neni 39, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Me këtë vërtetohet se: a është dërguar lajmërimi në afat të arsyeshëm, pasi blerësi ka zbuluar, ose është dashur të zbulojë, jokonformitetin ose kur i është dashur të presë deri në fund të afatit garantues.

Në fund, nëse mungesa është zbuluar para kalimit të afatit të garantuar, mund të jetë konflikt që blerësi duhej të dërgonte lajmërimin, me qëllim që lajmërimi t'i arrijë para kalimit të afatit të garantuar ose lajmërimin mund t'ia dërgojë në kohën e arsyeshme, bile edhe nëse në këtë mënyrë afati garantues mund të jetë zgjatur. Sipas një mendimi, nëse shitësi ka garantuar veçoritë e caktuara të mallit ose përshtatshmërinë e tij për përdorim të zakonshëm ose përdorim të veçantë në afat të caktuar, dhe dërgimi i lajmërimit nuk është detajisht i rregulluar, do të duhej që blerësit t'i pranohet afati i arsyeshëm për dërgimin e lajmërimit.⁵⁷² Sipas mendimit tonë më e mira është që palët personalisht në kontratën e tyre ta rregullojnë shprehimisht këtë problem. Nëse kjo mbetet, problemi duhet të zgjidhet në mënyrë analoge me aplikimin e nenit 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës dhe në afatin e garantuar me kontratë. Afati i garantuar nuk është ndonjë afat shtesë, por paraqet zgjatje ose shkurtim të afatit dyvjeçar. Nga kjo duhet që, në afatin e garantuar, në mungesë të ndonjë marrëveshjeje tjetër të palëve, do të aplikohen rregullat,

⁵⁶⁸ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2829; Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 162; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 471; Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 423.

⁵⁶⁹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 471.

⁵⁷⁰ Bianca, Bonell, *vepër e cituar*, fq. 311.

⁵⁷¹ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 162.

⁵⁷² Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 472.

të cilat vlejnë për afatin dyvjeçar. E konsiderojmë që blerësi humbet të drejtën që të thirret në mungesën e konformitetit nëse nuk e ka lajmëruar shitësin në afatin e fundit, pra pa kaluar afatin e garantuar, me qëllim që edhe lajmërimi i shitësit të arrijë para kalimit të afatit të garantuar.

Po ashtu e konsiderojmë se një vendim i tillë paraqet garanci të sigurisë juridike dhe ndalon keqpërdorimet e jokonformitetit eventual. Gjithashtu ky vendim është në raport edhe me interesat e të dyja palëve kontraktuese. Shitësi pa dyshim e di kur vlen garancia e dhënë. Nga ana tjetër, mund të shihej që blerësi në këtë mënyrë është vendosur në pozitë të pavoritshme. Megjithatë, nëse nuk kemi parasysh mënyrat bashkëkohore të komunikimit (p.sh. e-mail) atëherë është e qartë që edhe ai kënaq mbrojtjen për të gjithë kohën e zgjatjes së afatit të garantuar.

Për dallim nga rregulli, e cili ekziston në tregtinë ndërkombëtare, e drejta jonë e lejon mundësinë që palët me kontratë të përcaktojnë afat më të gjatë, gjegjësisht që shitësi të përgjigjet për mungesat për një periudhë më të gjatë se 1 vit.

IV. 8.10. Përgjashtimet nga detyrimi i lajmërimit

Në të drejtën ndërkombëtare si edhe në atë vendore shitja e mallit në rrethana kur ka vese ose mungesa malli, përgjegjësia e shitësit ekziston gjithmonë, por përgjegjësia ekziston edhe kur blerësi e bën dërgimin e lajmërimit për veset, dëmet dhe mungesat. Mirëpo përgjegjësia ekziston edhe në rastet e tjera, kur shitësi nuk e ka bërë kontrollin ose njoftimin me mirëbesim dhe kur ky njoftim ose kontroll i sendit nuk është bërë në rregull. E para, shitësi nga blerësi nuk mund të kërkojë dërgimin e lajmërimit për mungesat, nëse vetë personalisht e kanë ditur ose nuk ka qenë e mundur të jetë e panjohur për ta, dhe në rastet kur nga kjo varen edhe mungesat.⁵⁷³ Rasti tjetër i ekzistimit të detyrimit të lajmërimit ekziston vetëm në të drejtën ndërkombëtare për shitjen e mallit. Shitësi nuk mund të bazohet në nenin 39, të Konventës së Vjenës, por as në rastet kur blerësi ka arsyetim të arsyeshëm që nuk e ka dërguar lajmërimin e kërkuar.⁵⁷⁴

⁵⁷³ *Konventa e Vjenës*, neni 40.

⁵⁷⁴ Po aty, neni 44.

IV. 8.10.1. Njohuritë e shitësit për veset, mungesat, dëmet

Në të drejtën ndërkombëtare, por edhe në atë vendore ekziston rregulli sipas të cilit shitësi nuk mund të kërkojë nga blerësi reklamimin e dëmit ose të vesit, nëse ato kanë qenë të njohura ose i është dashur të jenë të njohura dhe nëse nuk ia ka treguar këtë blerësit.

Neni 40, i Konventës së Vjenës, parasheh që shitësi nuk ka të drejtë që të përdorë më rregullat e nenit 39, kur mungesa e konformitetit varet nga fakti se cilat të meta kanë qenë të njohura ose nuk kanë mundur të jenë të panjohura, dhe ai këtë nuk ia ka zbuluar blerësit.⁵⁷⁵ Shitësi nuk mund të thirret në rregullat e nenit 39, të Konventës së Vjenës në tërësi. Kjo domethënë se në rast të përmbushjes së kushteve nga neni 40, i Konventës së Vjenës, nuk aplikohet as afati prekluziv dyvjeçar nga neni 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës.

Edhe sipas LMD-së, blerësi nuk e humb të drejtën që të thirret në ndonjë të metë edhe kur nuk e kryen detyrimin e vet, që sendin ta kontrollojë pa shtyrje të afatit, ose brenda afatit të caktuar të njoftojë shitësin mbi ekzistimin e të metës, si dhe kur e meta është shfaqur vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga dorëzimi i sendit, po qe se për këtë të metë shitësi ka qenë në dijeni ose nuk ka mundur të mos jetë në dijeni. Ligji ynë shprehimisht parasheh se në rastet kur njohuria e shitësit, për mungesa nuk aplikon, afat prekluziv prej 1 viti⁵⁷⁶.

Sipas të drejtës sonë, shitësi përgjigjet për mungesat materiale pa marrë parasysh se a kanë qenë të njohura ato. Shitësi për të metat materiale të sendit, të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut të blerësi, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit.⁵⁷⁷ Shitësi është përgjegjës për çdo mangësi ose mospërmbushje që ekzistonte në momentin e kalimit të rrezikut të blerësi, edhe kur e meta shfaqet pas këtij momenti me kalimin e rrezikut të blerësi.⁵⁷⁸ Shitësi përgjigjet për mungesat edhe kur për to nuk ka pasur dijeni. Megjithatë, shohim që njohuria e shitësit për të metat ose veset ka gjithmonë rëndësi juridike.

Konventa e Vjenës dhe LMD-ja, parashohin që blerësi humbet të drejtën që të thirret në të meta ose vese të mallit nëse me mirëbesim nuk e ka parashtruar ankesën. Flitet për rregulla shumë strikte. Megjithatë, nëse për shitësin ka qenë e njohur ose është dashur të jetë e njohur, që malli të cilin duhet të dorëzojë ka mungesa, dhe ai këtë mall megjithatë ia dorëzon blerësit,

⁵⁷⁵ *ULIS*, neni 40.

⁵⁷⁶ *LMD*, neni 468.

⁵⁷⁷ *LMD*, neni 461, paragrafi 1.

⁵⁷⁸ *Kodi Civil Shqiptar, 1994*, neni 716.

pastaj ai merr pjesë si mala fidei (me keqbesim). Në këtë rast shitësi sillet kundër parimit të ndërgjegjësimit dhe ndershmërisë, dhe po në këtë rast shitësi nuk mund të thirret në ato rrethana që blerësi nuk është ankuar me mirëbesim për mungesat e mallit të shitur nga ana e shitësit.

IV. 8.10.2. Njohuria e shitësit

Shitësi nuk mund të thirret për mosnjohuri dhe kjo për shkak të moslajmërimit për jokonformitetin nëse mungesa e konformitetit varet nga faktet, të cilat kanë qenë të njohura, ose nuk ka qenë e mundur të jenë të panjohura. Në rastin e parë kërkohet njohja pozitive e shitësit për jokonformitetin. Në anën tjetër, në teori është e debatueshme çka nënkupton formulimi nuk kanë mundur të jenë të panjohura. Qëndrimi që mbizotëron është se mungesa e shitësit nuk ka mundur të jetë e panjohur kur mosnjohuria e tij, dërgon te pakujdesia e rëndë.⁵⁷⁹ Në bazë të kësaj, pakujdesia e rëndë ekziston me rastin e kontrollit të mallit, dhe shitësi nuk i zbulon mungesat të cilat me një kujdes të thjeshtë⁵⁸⁰ është dashur të dihen.⁵⁸¹ Sipas qëndrimit tjetër, me pakujdesi të rëndë është e nevojshme të mësohet se bëhet fjalë për jokonformitetin që “bie në sy” dhe që është gjegjësisht e dukshme.⁵⁸² Sipas mendimit tonë, formulimi *nuk ka qenë e mundur të jetë e panjohur* duhet të kuptohet si mosnjohje dhe si pakujdesi e rëndë. Megjithatë, duhet të përcaktohet që dallimi në mes të qëndrimeve të përmendura nuk është zbatuar në praktikë, sepse janë të dukshme mungesat (veset, të metat), të cilat po të kishte kujdes të veçantë mund edhe të zbulohen. Kuptimi praktik i kësaj formule shihet në atë se çka çon në dëshminë e lehtësuar. Blerësi nuk duhet të dëshmojë ekzistimin e njohurisë reale të shitësit, njohuri që mund të jetë shumë vështirësisht e njohur, por është e mjaftueshme që të dëshmojë se flitet për mungesat (të metat, vset) të cilat për shitësin nuk kanë mundur në asnjë mënyrë të mbesin të panjohura.

A është shitësi pjesëmarrës me pakujdesinë e rëndë - kjo është pyetja faktike e cila varet nga rrethanat e rasteve konkrete. Për aplikimin e nenit 40, të Konventës së Vjenës, në këtë rast, nuk është e mjaftueshme pakujdesia e thjeshtë. Kjo nuk është e mjaftueshme, sepse shitësi është

⁵⁷⁹ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2400; Wilhelm Albrecht Achilles, *vepër e cituar*, fq. 120; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2830; Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 425.

⁵⁸⁰ *Konventa e Vjenës* për pakujdesinë përdor formulimin ka ditur ose është dashur të dijë.

⁵⁸¹ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2830; Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 532.

⁵⁸² Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 478. Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 164.

dashur të zbulojë jokonformitetin me kontrollin e mallit.⁵⁸³ Gjithmonë kur shitësi e dorëzon mallin, i cili është i papërdorshëm (p.sh. kanatjerja e femrave e cila ka kohë të shkurtër përdorimi) ose që nuk mund të shitet më tutje, konsiderohet se kjo nuk ka mundur të jetë e panjohur. Nëse ekziston një zakon i përshtatshëm i punës, që malli duhet të ketë cilësi të caktuara dhe shitësi këtë e di, aplikohet neni 40, i Konventës së Vjenës. Njohuria pozitive e shitësit supozohet gjithmonë, kur shitësi mungesat e mallit i fsheh me qëllim.⁵⁸⁴ Përkundër kësaj, nuk veprohet me pakujdesinë e rëndë, kur shitësi i cili nuk ka kontrolluar mallin me të meta brenda paketimit edhe më vonë e dorëzon këtë mall në paketimin origjinal. Në këtë rast pakujdesia e rëndë e shitësit, ka ekzistuar vetëm nëse mungesa do të mund të njihej edhe pa kontroll paraprak të mallit.

Me rastin e vlerësimit se a ka vepruar shitësi me pakujdesi të rëndë duhet marrë në konsideratë sesa ka qenë shitësi i lidhur me mallin, në një anë, dhe llojin e jokonformitetit. E para, duhet të bëhet dallimi i situatës kur shitësi është prodhues i mallit edhe kur ai vetëm dorëzon mallin. Gjithashtu nga prodhuesi do të pritet njohje tjetër e mallit, por nga pala e cila mallin e rishet. Sipas rregullit, prodhuesi duhet të di mungesat sepse ka obligim të kontrollojë prodhimet e veta.

Nga ana tjetër, më në detaje në kontratë janë rregulluar kërkesat në shikim të cilësive të mallit, kështu shitësi duhet që më herët të kuptojë për ekzistimin e mungesës (të metave, veseve) nga gjendja reale dhe ajo e kontraktuar.⁵⁸⁵ Në bazë të kësaj dorëzimi aliud i mallit dhe devijimet e mallit në sasi nuk munden që të ballafaqohen dhe të kuptohen lehtë, por vërehet mungesa e cilësisë. Rregullisht te aliud-i dhe te devijimet në sasi konsiderohen që janë edhe devijimet në cilësi. Rregullisht edhe tek aliud-i dhe te devijimet në sasi të mallit konsiderohen që jokonformiteti i mallit në raport me shitësin nuk ka mundur të mbetet i panjohur. Më së shpeshti në praktikë dhe dorëzimi i mallit të cilësisë më të mirë nga ajo e kontraktuar konsiderohet se flitet për faktin, i cili është fakt për shitësin, dhe që nuk ka qenë e mundur të mbetet i panjohur.

Njohja apo mosnjohja e shitësit nga pakujdesia e rëndë mund të varet edhe nga faktet në të cilat fillon jokonformiteti. Shitësi nuk duhet të ketë njohuri për mungesën e të drejtave të tij, por është e mjaftueshme që i kanë humbur për faktin se cila është natyra e vesit që rregullisht çon

⁵⁸³ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 426.

⁵⁸⁴ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 426.

⁵⁸⁵ Wilhelm Albrecht Achilles, *vepër e cituar*, fq. 120.

në jokonformitet të mallit konkret.⁵⁸⁶ Konsiderojmë që e gjithë kjo, që është përmendur më lart, *mutatis mutandis* mund të aplikohet edhe në të drejtën vendore.

IV. 8.10.3. Moszbulimi i mungesave shitësit

Nëse blerësi e paralajmëron shitësin, që malli ka të meta, atëherë ai edhe më tutje mund të thirret në ato rrethana që lajmërimi është i vonshëm ose është lajmërim jo i rregullt, dhe në linjën e fundit në këtë mënyrë do të lirohet nga përgjegjësia. Megjithatë neni 40, i Konventës së Vjenës, nuk e tejkalon që shitësi ka detyrim të zbulojë mungesat e blerësit.⁵⁸⁷ Caku i këtij rregulli është relativisht i vogël.

Çështja e rëndësishme, kur shitësi duhet që blerësit t’ia zbulojë mungesën, do të mund të vlerësohet me normat e nenit 39, të Konventës së Vjenës. Nëse shitësi para shuarjes së kontratës i ka theksuar blerësit që malli ka mungesa, e pas kësaj kontrata duhet të shuhet, atëherë në përgjithësi nuk ekziston jokonformiteti aspak në nenin 35, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Në këtë rast nuk vendoset çështja e përgjegjësisë së shitësit. Me rastin e shuarjes së kontratës, blerësi e kupton mungesën e konformitetit, atëherë përgjegjësia e shitësit do të përmbillet në bazë të nenit 35, paragrafi 3, i Konventës së Vjenës. Nëse për kohën e kryerjes së detyrimit shitësi i zbulon blerësit mungesat, blerësi do të refuzojë që të pranojë mallin ose do ta pranojë mallin me vese, dëme ose të meta. Në bazë të të gjithë kësaj, që është përmendur, shtrohet pyetja se në cilin rast shitësi mund të ketë interes të arsyeshëm që të jetë i informuar për mungesat (të metat, veset) të cilat ai vetë ia ka zbuluar blerësit. Sipas qëndrimit, i cili është pranuar nga të gjithë, kjo normë ka kuptim vetëm nëse shitësi i zbulon blerësit rrezikun nga krijimi i mungesës. Ai këtë mund ta krijojë më së voni me rastin e dorëzimit të mallit.⁵⁸⁸ Nëse më vonë, me të vërtetë vërtetohet jokonformiteti, atëherë është detyrim i blerësit që të parashtrojë ankesën për jokonformitet.

⁵⁸⁶ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 426. Gjithashtu, Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 318 dhe 319.

⁵⁸⁷ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 427; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2830. Vendim i kundërt, Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 163.

⁵⁸⁸ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 427; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2830.

IV. 8.10.4. Koha e zbatueshme për njohuri të shitësit

Momenti në të cilin duhet të ekzistojë njohuria e shitësit, nuk është shprehimisht i rregulluar në Konventën e Vjenës, ndërkaq në teori kjo është e diskutueshme. Sipas një mendimi teorik, është me autoritet momenti i dorëzimit të mallit të blerësi.⁵⁸⁹ Teoria tjetër është që blerësit edhe më vonë i është bërë e ditur kjo çështje, dhe se autoriteti që e konsideron momentin e kalimit të afatit për kontrollin dhe lajmërimin për jokonformitet.⁵⁹⁰ Sipas teorive të fundit, me rastin e vlerësimit të momentit në të cilin duhet të ekzistojë njoftimi (lajmërimi), gjegjësisht mosnjohja e shitësit nga pakujdesia e rëndë, duhet të nisët nga qëllimi dhe nga caku i detyrimit të lajmërimit. Ajo shërben, para së gjithash me këtë, që shitësi me mirëbesim të jetë i informuar për mungesat e mallit dhe mundet që në mënyrë të arsyeshme të reagojë (të mënjanojë të metat, të sigurojë dëshmitë, të ngrerë ankesa kundër furnizuesit të tij). Nëse shitësi në momentin e mbarimit të afatit për lajmërim, di për të metat, atëherë lajmërimi i blerësit nuk është i nevojshëm.⁵⁹¹ Këtu merret parasysh situata kur shitësi në një mënyrë, por jo nga blerësi të kuptojë jokonformitetin. Rastet e këtilla janë shumë të rralla në praktikë, dhe për shembull: kur blerësi i blerësit për shkak të jokonformitetit i drejtohet direkt shitësit. E konsiderojmë se qëndrimi i fundit vështirë se mund të mbrohet. Nga pikëpamja e nenit 39, Konventa e Vjenës, lajmërimi nuk ka kuptim edhe kur shitësi në kohën e mëhershme kupton për të metat e sendit.

Sipas mendimit tonë, neni 40, i Konventës së Vjenës, rregullon njohurinë e shitësit për momentin e mëhershëm. Me rastin e kërkit të përgjigjes në gjejmë që, është e nevojshme analizimi i rregullave në tërësi, i rëndësishëm është edhe fakti që shitësi duhet t'ia zbulojë blerësit faktet nga të cilat varet jokonformiteti. Në shqyrtimet e mëhershme kemi parë që shitësi këto fakte duhet t'ia zbulojë blerësit më së voni, me rastin e dorëzimit të mallit. Në bazë të kësaj, qëndrimi ynë dhe njoftimi i shitësit duhet të ekzistojë në momentin e dorëzimit të mallit, sipas nenit 40, në Konventën e Vjenës, e gjithë kjo varet nga njohuritë e shitësit për atë moment të dorëzimit të mallit. Nëse shitësi pas dorëzimit të mallit shtesë, kupton për jokonformitetin e tij (jo nga blerësi, por nëpërmes lajmërimit nga personi i tretë), ai nuk do të mund të thirret sipas

⁵⁸⁹ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, Stargardt, *vepër e cituar*, fq. 92; Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 164; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2830; Staudinger, Magnus, *vepër e cituar*, fq. 426. Jes Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2401.

⁵⁹⁰ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2401; Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 532; Peter Schlechtriem, & Rüdiger Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 479.

⁵⁹¹ Po aty, fq. 2402, 479 dhe 480.

nenit 39, të Konventës së Vjenës, nëse nuk di për këtë fakt se duhet të bazohet në nenin 40, të Konventës së Vjenës, por kjo dukuri nuk do të jetë në harmoni me parimin e ndërgjegjësimit nga neni 7, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. As ligji i ynë nuk e rregullon në cilin moment duhet të ekzistojë njoftimi i shitësit për ekzistimin e të metave. Gjithashtu, kjo çështje nuk është sqaruar as në teori. Në këtë rast e konsiderojmë të volitshëm sepse edhe në të drejtën tonë aplikohet drejt vendimi i përmendur më lart. Në bazë të kësaj, njohuria e shitësit duhet të ekzistojë më së voni në momentin e dorëzimit të mallit blerësit.

IV. 8.11. Justifikimi i arsyeshëm për mospërbushje të detyrimit të shitësit për lajmërim

Pa marrë parasysh rregullat e nenit 39, paragrafi 1, Konventa e Vjenës, mund të zbritet çmimi i sendit në raport me nenin 50, të Konventës së Vjenës, ose, blerësi do të kërkojë kompensimin e dëmit, në raport me humbjet e fitimeve. Nëse sipas nenit 44, të Konventës së Vjenës, blerësi, me kusht të ekzistimit të arsytimit të arsyeshëm për moslajmërimin, përmban rregulla të caktuara për shkak të jokonformitetit të mallit, edhe kur shitësi nuk ka dërguar fare lajmërimin e kërkuar. Blerësi mund të përdorë mjete juridike monetare, gjegjësisht të arrijë të ulë çmimin ose të kërkojë kompensimin e dëmit, vetëm për humbjen e fitimit. Përkundër kësaj, është përmbysur e drejta që kërkohej; duhet të bëhet ndërrimi ose përmirësimi i mallit, edhe si e drejtë në përgjithësi, edhe si drejtë për shuarje të kontratës në veçanti.

Nëse analizohet neni 44, i Konventës së Vjenës, duhet të vërehet që kjo varet vetëm nga neni 39, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Kjo domethënë që me kalimin e afatit dyvjeçar nga neni 39, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, blerësi humbet të gjitha kërkesat sipas shitësit për shkak të jokonformitetit të mallit, edhe nëse ka marrë arsyetim të arsyeshëm për mospërbushje të detyrimit të lajmërimit.

Neni 44, i Konventës së Vjenës, paraqet vendimin me kompromis dhe nuk e ka burimin as në ULIS, as në ndonjë burim kombëtar.⁵⁹² Me këtë rregull në një masë është lehtësuar rregulli i ashpër i përfshirë në nenin 39, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, sipas së cilës blerësi humbet të drejtën që të thirret në jokonformitet, nëse shitësi humbet të drejtën që të thirret në

⁵⁹² Konventa e Vjenës, neni 44.

jokonformitet. Nëse shitësi me mirëbesim dhe në mënyrën më të përshtatshme nuk e lajmëron blerësin për ekzistimin e tyre. Shkaqet e aplikimit të nenit 44, të Konventës së Vjenës, në konventë janë si vijon: E para, në disa shtete, të cilat i takojnë sistemit anglosakson, fare nuk ekziston detyrimi i blerësit që mallin ta kontrollojë edhe për mungesat e mundshme të lajmërojë shitësin.⁵⁹³ E dyta, blerësi nga vendet në zhvillim, shumë shpesh nuk do të kenë mundësi, që me mirëbesim të parashtrojnë ankesën, sepse në kuadër të ekspertizës, e cila ka qenë jo e mjaftueshme, nuk do të kenë mundësi që të zbulojnë ose të urdhërojnë natyrën e tyre (natyrën e të metave). Kjo varet nga konfirmimi i mungesave të makinat e ndërlikuara për import në vendet në zhvillim.⁵⁹⁴

Për shkak të kësaj, që është përmendur më lart, ekziston një numër i madh vendesh në zhvillim, ku, ekzistimi i nenit 44, i Konventës së Vjenës, ka qenë kusht absolut për pranimin e Konventës së Vjenës.

Neni 44, i Konventës së Vjenës, është në harmoni me parimet e privatësisë. Dorëzimi i mallit jokonform, paraqet shkelje të kontratës nga ana e shitësit. Për këtë arsye nuk është rregull që blerësi të humbasë të gjitha mjetet juridike, nëse ka pasur arsyetim të arsyeshëm, që nuk ka dërguar lajmërimin e kërkuar. Megjithatë, neni 44, i Konventës së Vjenës, paraqet cenim të interesave të shitësit dhe një impenjim të madh për të e veçanërisht për pjesëmarrje në dobi të blerësit. Gjithashtu shumë shpesh shitësi duron pasojat e dëmit për të cilat blerësi nuk ka dërguar lajmërimin e duhur. Në fund, ekziston rreziku që, blerësi do të konfirmojë jokonformitetin dy vjet, e pastaj në bazë të nenit 44, të Konventës së Vjenës, t'ia shkurtojë shitësit pagesat e mbetura.

Në cak të dhënies së përgjigjeve të plota për të gjitha pyetjet që tejkalojnë nga neni 44, i Konventës së Vjenës, është e nevojshme që sa më shpejt të përcaktojë fushën e aplikimit të tij, në rastet kur ekziston arsyetim i arsyeshëm, dhe mënyrën si ndikon kjo në përgjegjësinë e shitësit për dorëzimin e mallit.

⁵⁹³ Neni 44, i *Konventës së Vjenës*, në konferencën diplomatike ka qenë një prej normave më të debatuar dhe një prej normave për të cilat është diskutuar më shumë. Neni 44, i *Konventës së Vjenës* në mënyrën që ekziston aktualisht nuk ka ekzistuar në draftin e *Konventës së Vjenës*, por është shtuar në konferencën diplomatike me iniciativën e Finlandës, Ganës, Suedisë, Nigerisë dhe Pakistanit. Është kërkuar nga të dërguarit e shteteve në zhvillim, të cilët janë deklaruar për frikën e tyre, që neni 39, i *Konventës së Vjenës*, është shumë i ashpër dhe mund t'i sjellë në një pozitë shumë të vështirë blerësit e këtyre vendeve. Si kompromis është përkrahur detyrimi me aprovimin e marrëveshjes, por ai krahas nenit 44, të *Konventës së Vjenës*, është zbutur. Shih më shumë për këtë çështje në: Bianca, Bonell, *vepër e cituar*, fq. 324-325.

⁵⁹⁴ John O Honnold, *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, 3rd edition, The Hague, 1999, fq. 283.

IV. 8.11.1. Mungesa e lajmërimit (njoftimit)

Në njoftimin mbi ekzistimin e të metës së sendit, blerësi ka për detyrë ta përshkruajë të metën hollësisht dhe ta ftojë shitësin ta kontrollojë sendin.⁵⁹⁵ Ka raste kur nuk bëhet lajmërimi si në të drejtën vendore, ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Neni 44, i Konventës së Vjenës, zbatohet nëse blerësi ka arsytim të arsyeshëm pse nuk ka dërguar lajmërimin (njoftimin) e kërkuar. Sipas formulës së përmendur pa dyshim që në rastet e përfshira si blerës, të cilat për jokonformitetin ka ditur ose është dashur të dijë, në afat të arsyeshëm nuk ka dërguar fare lajmërimin shitësit, kur ai nuk e ka lajmëruar. Në bazë të kësaj, në nenin 44, Konventa e Vjenës gjithsesi vërejmë edhe rastet kur blerësi me mirëbesim ka dërguar lajmërimin, ose kur për lajmërimin nuk është përcaktuar në mënyrë precize natyra e vesit, mungesës. Sipas mendimit të sotëm gjithëpërfshirës,⁵⁹⁶ neni 44, i Konventës së Vjenës, përfshin edhe rastin kur blerësi nuk ka kontrolluar me kohë mallin ose nuk e ka kontrolluar fare atë, dhe për këtë ka dërguar lajmërimin me vonesë. E quajmë që qëndrimi i përmendur është i padiskutueshëm, por në të njëjtën kohë është edhe e nevojshme të tregojmë më tutje. Neni 44, i Konventës së Vjenës, shprehimisht drejton vetëm në detyrim të lajmërimit nga neni 39, paragrafi 1, të Konventës së Vjenës. Në të ardhmen në mënyrë që kontrolli të shërbejë për përgatitjen e reklamacionit, ai është përfshirë në sanksione të parapara për vonesën e tij. Sipas mendimit tonë, vonesa ose moskryerja e kontrollit të mallit paraqet shkak të shkeljes së përgjegjësisë së lajmërimit të shitësit. Neni 44, i Konventës së Vjenës nuk e bën dot dallimin në mes të shkaqeve të moslajmërimit, dhe e konsiderojmë që nuk ka qenë e nevojshme për të ndarë këtë çështje në raport nga shkaqet e tjera.

IV. 8.11.2. Justifikimi i arsyeshëm

Vetë fakti që blerësi nuk ka parashtruar ankesë për jokonformitetin, jokonformiteti nuk është i mjaftueshëm për të sjellë deri të aplikimi i nenit 44, të Konventës së Vjenës. Duke u nisur nga kjo është e nevojshme që, edhe blerësi të ketë arsytim të arsyeshëm që nuk ka dërguar

⁵⁹⁵ LMD, neni 467, paragrafi 1.

⁵⁹⁶ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 455; Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 545; Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 172; Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2420.

njoftimin. Në konventën ndërkombëtare nuk janë dhënë rastet e nevojshme, të cilat do të mund të konsideroheshin të arsyeshme për justifikim, përgjigje në këtë pyetje kanë dhënë edhe teoria juridike edhe praktika gjyqësore.

Në teorinë juridike ekzistojnë qëndrime të ndryshme për sa i përket kësaj problematike kur ekziston arsyetim i arsyeshëm. Tek arsyetimi i arsyeshëm sipas një teorie të përhapur, nuk flitet për fajësinë, sepse rrethanat të cilat përfshijnë fajësinë e blerësit janë përfshirë në nenin 38 dhe 39, të Konventës së Vjenës.⁵⁹⁷ Sipas kësaj teorie, me rastin e vlerësimit, se a ka blerësi arsyetim të arsyeshëm, duhet të vazhdojë parimi i kapitalit. Edhe pse ai nuk e ka përmbushur detyrimin, që të lajmërojë shitësin për mungesat (të metat), por edhe nëse nuk është sjellë në raport me rregullat dhe rrethanat e rastit konkret, kapitali mund të diktojë shkallë të caktuar të marrëveshjes dhe të butësisë.

Sipas qëndrimit tjetër në kornizat e nenit 44, të Konventës së Vjenës, fillimisht është e nevojshme të pyetet se a ekziston fajësia? Domethënë qëllimi ose edhe pakujdesia e blerësit.⁵⁹⁸ Nëse blerësi nuk është fajtor për shkeljen e detyrimit të lajmërimit, atëherë neni 44, i Konventës së Vjenës, aplikohet menjëherë. Në këtë rast nuk ka nevojë për vlerësim interesi. Teoricienët, të cilët marrin pjesë në këtë mendim, e konsiderojnë që, neni 44 i Konventës së Vjenës mjaftueshëm merr për bazë interesat e shitësit, ndërsa blerësit i mundësojnë vetëm mjete juridike të kufizuara. Fajësia nuk ekziston *te vis majori*, si dhe te grevat dhe shqetësimet politike. Gjithashtu, nëse në kompani blerësi nuk ka pasur mundësi që të lëshojë në punë makinën e dorëzuar për shkak të goditjes së rrymës.⁵⁹⁹ Neglizhenca do të ekzistonte nëse blerësi në tregti dhe në punë nuk i kushton objektivisht kujdesin e kërkuar duke e lëshuar nga kontrolli mallin.⁶⁰⁰

Sipas mendimit tonë, do të duhej të pranohej qëndrimi i parë. Megjithatë duhet të vërehet, që rezultatet të cilat të dërgojnë në këtë, pra, edhe për njërin edhe për tjetrën janë identike, por është e ndryshme rruga deri te këto rezultate. Konsiderojmë se, pyetja më e rëndësishme që buron nga këto dy qëndrime është se; a do të mund blerësi të veprojë me arsyetim të arsyeshëm dhe nga neglizhenca, dhe a do të veprohet ndaj blerësit, i cili nuk ka vepruar me kujdes të shtuar, si dhe, a do të kërkohet nga rasti i tillë arsyetimi. Rasti i tillë do të ekzistojë kur blerësi nuk njih

⁵⁹⁷ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2838; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 512 i 513. Fritz Krüger, & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2420.

⁵⁹⁸ Po aty. *vepër e cituar*, fq. 2420.

⁵⁹⁹ Po aty. fq. 2421.

⁶⁰⁰ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 513. Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2420; Jochen Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 545.

norma juridike ose kur juridikisht është vërtetuar gjendja e mallit. Justifikimi nuk mund të kuptohet si mungesë e neglizhencës, dhe në të kundërtën neni 44, i Konventës së Vjenës nuk do të aplikohet fare.⁶⁰¹ Konsiderojmë që rasti i veprimit me pakujdesi në rrethanat e caktuara, dhe humbja e të gjitha të drejtave për blerësin ka qenë jo i drejtë. Sipas kësaj, arsyetimi i arsyeshëm mund të ekzistojë edhe kur blerësi nuk ka treguar shkallën e kujdesit që rregullisht kërkohet në tregti.

Vlerësimi i ekzistimit të arsyeshëm të arsyetimit është çështje faktike, që duhet të zgjidhet sipas rrethanave të rastit konkret. Në rastin e vlerësimit të arsyetimit të arsyeshëm duhet të shpiem në llogari të interesit të palëve, por dhe që të arrihet drejtpeshimi i interesit të palëve kontraktuese. Shitësi ka tre interesa kryesore. E para, është e nevojshme që pas kohës së caktuar duhet të jetë i sigurt, që me, dorëzim të mallit të kryhet detyrimi i tij kontraktor. E dyta, shitësi ka interes që të sigurojë dëshmitë për rastin e konfliktit eventual. Interesi i sigurimit të dëshmisë ekziston pavarësisht nga ajo se cila nga palët në konflikt do të ketë barrën e dëshmisë. Interesi i tretë, është interesi i shitësit, i cili shpejt duhet të jetë i informuar për të metat e mallit. Nga ana tjetër, shitësi ka interes që mbikëqyrja nuk e çon kah humbja e të drejtave të tij.

Me përcaktimin se a ekziston arsyetimi i arsyeshëm duhet të merren në konsideratë vështirësitë e shkeljes së detyrimit të njoftimit, si dhe përkushtimin që ka investuar në njoftim blerësi, pasojat e humbjes së plotë të mjeteve juridike për blerësin, dëmin të cilin e ka bartur shitësi dhe llojin e të metave të mallit. Për dallim nga afati i arsyeshëm, i përcaktuar nga neni 39, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës i cili merr për bazë, para së gjithash rrethanat objektive, kushtet për arsyetim të arsyeshëm janë subjektivo-objektive. E para, duhet të analizohet arsyeja e shkeljes së detyrimit të njoftimit. Nëse shkelja e blerësit është e një rëndësie më të vogël do të duhej të pranohej ekzistimi i arsyetimit të arsyeshëm. Rast të tillë do të ketë nëse të metat normalisht nuk kanë mundur të presin, që blerësi për shkak të kësaj të mos ketë kontrolluar mallin, kur blerësi ka dërguar njoftim preciz, por jo të mjaftueshëm për jokonformitetin, si dhe kur blerësi ka shkelur pak afatin e marrëveshjes.⁶⁰² E dyta, për nga rëndësia është lloji i mallit. Kjo zakonisht vjen nga shprehja që malli mund të prishet, dhe kontrolli shtesë i mallit nuk është më i mundur. Në këtë rast arsyetimi i blerësit do të përmbylej. Përkundër kësaj, mungesat të cilat ekzistojnë te malli i qëndrueshëm (p.sh. të metat te konstruksioni i makinave) të cilat mund

⁶⁰¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 513. Po ashtu, Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2420; Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 545.

⁶⁰² Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 514.

të kompensohen si shtesë dhe të konfirmohen se interesi i shitësit nuk është shumë i madh dhe se është i mundur fuqizimi i arsyeshëm i blerësit, kryesisht kjo vlen të lëshimet e vogla.⁶⁰³ E treta, sipas mendimit të përhapur⁶⁰⁴ mosnjohja e normave ligjore nga ana e blerësit mund të prezantojë bazën për arsyeshmëri të arsyeshme. Blerësi ka arsyetim të arsyeshëm, nëse e drejta kombëtare e vendit të tij nuk njeh detyrimin e kontrollit të mallit dhe të njoftimit të shitësit me jokonformitetin e mallit. E katërta, për nga rëndësia është edhe ekspertiza dhe përvoja e blerësit. Për shkak të këtij qëllimi, neni 44, i Konventës së Vjenës, është arsyetim edhe kur blerësi nuk është mjaftueshëm i specializuar, gjegjësisht, kur ai nuk posedon aftësi të mjaftueshme teknike. Kjo është ekskluzive në rastet kur flitet që blerësi është nga vendet në zhvillim, kështu që për ta, është më e vështirë prania e njohjeve të specializuara. Gjithashtu, shumë shpesh blerësit nuk kanë në pronësi mjete të mjaftueshme teknike për kryerjen e kontrollit të përshtatshëm të mallit dhe konstatimit të të metave të tij. Po ashtu shumë shpesh blerësit nuk disponojnë mjaft me mundësitë teknike për kryerjen e kontrollit të përshtatshëm, të kontrollit të mallit dhe konstatimit të të metave. E pesta, rrethanat si, për shembull, sëmundja ose vështirësitë e organizuara në kompaninë e blerësit, gjithashtu mund të prezantojnë arsyetim të arsyeshëm. Dhe e fundit, arsyetimi i arsyeshëm mund të ekzistojë edhe te parashtrimi i ankesës në mënyrë të gabuar (p.sh. më herët) përfaqësuesit të shitësit.⁶⁰⁵

Praktika gjyqësore, mbështetjen e blerësit në nenin 44, të Konventës së Vjenës, sipas rregullit e ka hedhur, edhe pse palët në konflikt shumë shpesh thirren në nenin 44, të Konventës së Vjenës. Sipas qëndrimeve të gjykatës nuk ekziston arsyetim i arsyeshëm kur blerësi vërteton që në afat për ankesë nuk ka mundur të refuzojë shitësin me telefon. Gjithashtu edhe blerësi nuk ka arsyetim kur ka lëshuar kontrollin e ofruar dhe veç me kalimin e afatit është ankuar për mungesat.⁶⁰⁶ Nga ana tjetër, gjyqet e arbitrazhit kanë lëshuar aplikimin e nenit 44, të Konventës së Vjenës.⁶⁰⁷

⁶⁰³ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 457. Poashtu, Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 546.

⁶⁰⁴ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2838; Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 546; Julius von Staudinger, & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 458.

⁶⁰⁵ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 457.

⁶⁰⁶ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 457.

⁶⁰⁷ Në dy vendime të arbitrazhit shitësi në mënyrë të suksesshme është thirrur në nenin 44, të Konventës së Vjenës. Në rastin e parë mallin e ka kontrolluar specialisti i pavarur. Specialistin bashkërisht e kanë emëruar palët kontraktuese dhe me kontrollimin e kryer e ka lëshuar konstatimin (certifikatën) e analizës së kryer. Kur malli ka arritur në vendin e përcaktuar blerësi ka zbuluar që ai edhe në sasi, edhe në cilësi dallon nga të dhënat që përmban certifikata dhe blerësi ka lajmëruar shitësin dhe inspektorin që e kanë propozuar së bashku për problemin në fjalë.

IV. 8.11.3. Ndikimi i nenit 44 i Konventës së Vjenës për përgjegjësinë e shitësit

Sipas nenit 44 të Konventës së Vjenës përgjegjësia e shitësit për jokonformitetet të mallit të dorëzuar është e kufizuar. Shitësi i cili ka dorëzuar një sasi më të vogël të mallit, që sipas nenit 44, të Konventës së Vjenës, të përgjigjet për dëmin në raport me nenin 74, të Konventës së Vjenës. Megjithatë blerësi mund të kërkojë kompensim vetëm për dëmin real të pësuar, por jo në humbjen e fitimeve.

Dëmi i vërtetë ekziston nëse malli është dorëzuar me vlerë më të vogël sesa vlera që është kontraktuar, atëherë, dëmi i pësuar paraqet dallimin në mes të çmimit të shitur dhe vlerës së vërtetë të mallit të dorëzuar jokonform kontratës. Çasti për vlerësimin e vlerës së mallit jokonform kontratës, është çasti që duhet të ndiqet pas njoftimit.⁶⁰⁸ Nëse malli i dorëzuar është tërësisht i padobishëm, atëherë blerësi mund të kërkojë kompensimin e dëmit sa shuma e çmimit të shitjes.⁶⁰⁹ Blerësi, gjithashtu mund të krijojë kompensimin e dëmit për humbjet, të cilat janë krijuar me përdorimin e mallit jokonform kontratës si, për shembull, me përdorimin e mallit me të meta që do të shkaktojë dëm edhe në mallin tjetër të blerësit. Në fund, këtu do të bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet e transportit dhe riparimit të mallit.

Nëse shitësi mund të largojë jokonformitetin dhe me këtë të evitojë dëmin, për të cilin blerësi ka lajmëruar për afatin e arsyeshëm nga neni 39, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, paraqitet edhe çështja se; a do të thirret ai në këto rrethana në nenin 77, Konventa e Vjenës dhe të kërkojë zvogëlim të kompensimit në lartësi të bartjes së humbjeve të cilat ai ka mundur t'i evitojë. Sipas kuptimit të rregullt, që është mbizotërues, shitësi, në këtë rast, mund të përdorë nenin 77, të Konventës së Vjenës dhe të krijojë zvogëlimin e kërkesës për kompensimin e

Gjykata e arbitrazhit ka shpallur vendimin, që lajmërimi nuk është bërë me mirëbesim sipas nenit 39, por ka paraqitur certifikatën me arsyetim të arsyeshëm për vonesën. Sepse certifikata është paraqitur nga institucioni i pavarur, të cilin e kanë zgjedhur të dyja palët kontraktuese me vullnetin e tyre dhe blerësi nuk ka qenë përgjegjës për gabimet e tij dhe për këtë arsye mund të thirren në nenin 44, të Konventës së Vjenës. Gjykata e Arbitrazhit, rasti No.9187 Qershor 1999, www.cisg.law.pace.edu. Në rastin e dytë është e përcaktuar me kontratë, që kërkesat për shkak të jokonformitetit të iniciohen në afat prej 50 ditësh nga dita e përcaktuar në ngarkesë. Kontrolli i mallit në port ka ekzistuar i pandërprerë nga blerësi dhe blerësi nuk ka kontrolluar mallin derisa nuk ka arritur në vendin e përcaktuar. Në bazë të kësaj blerësi nuk ka dërguar lajmërim për jokonformitetin në afat prej 50 ditësh. Megjithatë, gjykata ka vendosur që blerësi ka pasur arsyetim të arsyeshëm për vonesën dhe ka pranuar nenin 44, të Konventës së Vjenës. RUSSIA Arbitration Award case No. 054/1999 of 24 January 2000, www.cisg.law.pace.edu.

⁶⁰⁸ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2422.

⁶⁰⁹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 515.

dëmit.⁶¹⁰ Qëndrimi tjetër është se neni 44 ka përparësi në raport me nenin 77 të Konventës së Vjenës kur blerësi ka arsyetim të arsyeshëm për njoftimin që nuk e ka bërë. Përmendet se kundër fjalës në një anë moslajmërimi të konsiderohet si i arsyeshëm, e në anën tjetër të konsiderohet me bazë të zvogëlimit të kërkesës. Gjithashtu, fakti që neni 44, i Konventës së Vjenës, lejon kompensimin, vetëm të dëmit real dhe paraqet kufizim të kërkesës së blerësit, pra sipas këtij qëndrimi, shitësi mundet që me sjelljen e tij të kontribuojë në zvogëlimin e kompensimit të dëmit vetëm për dëmet reale dhe paraqet kufizim të mjaftueshëm të kërkesës së blerësit. Sipas këtij qëndrimi, shitësi mund të kërkojë zvogëlimin e kompensimit të shumës së çmimit për kompensimin e dëmit vetëm atëherë kur blerësi me sjelljen e tij ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të rritet. Ky do të ishte rasti kur blerësi mallin do ta shiste prapë ashtu si edhe para njoftimit për të metat e tij. Megjithatë, në këtë rast nuk është dëmtuar vetëm detyrimi i njohjes, por dëmtimi varet nga shitja e mëtejshme e mallit.⁶¹¹

IV. 8.12. Jokonformiteti i mallit për të cilën shitësi nuk përgjigjet

Në rastet e caktuara, para rrethanave të jashtëzakonshme kur malli ka mungesa, shitësi për të metat nuk do të përgjigjet. E para, shitësi nuk është përgjegjës nëse malli ka të meta materiale të panjohura. Shitësi nuk përgjigjet për të metat e specifikuar në paragrafët 1 dhe 3 nga neni 462 në qoftë se blerësi në momentin e lidhjes së kontratës ishte në dijeni për këto të meta, ose ato nuk kanë mundur të jenë të panjohura për atë.⁶¹² E dyta, shitësi nuk do të përgjigjet për të metat nëse me rastin e shuarjes së kontratës blerësi ka pasur njohuri për këto të meta ose nuk kanë qenë të panjohura për të. E treta, shitësi nuk përgjigjet për të metat e mallit të shitur, për mallin e ofruar për shkak të realizimit të së drejtës së zënë peng ose falimentimit. Sipas Kodit Civil Shqiptar shitësi nuk është përgjegjës për të metat të cilat në momentin e përfundimit të kontratës, blerësi i dinte ose për të cilat nuk ka marrë në dijeni për fajin e vet, përveç kur të metat kanë të bëjnë me cilësinë që sendet duhet t'i kishin pasur sipas kontratës apo sipas njoftimit të shitësit.⁶¹³

⁶¹⁰ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2839; Bianca, Bonell, *vepër e cituar*, fq. 327. Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2423.

⁶¹¹ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2423.

⁶¹² LMD, neni 463

⁶¹³ KCSH, neni 715, paragrafi 5.

IV. 8.12.1. Të metat materiale të parëndësishme

Me mospërbushje të parëndësishme do të kuptojmë dorëzimin e një sendi me të meta, por që nuk shkakton mosrealizimin e plotë të të drejtave të blerësit dhe mosrealizimin e vullnetit kontraktor të palëve.⁶¹⁴ Edhe legjislacioni pozitiv të metat materiale i rregullon me dispozitat e veta. Sipas nenit 463, paragrafi 1, 2, 3 të LMD-së dhe Kodi Civil, neni 715, paragrafi 5, shitësi nuk do të përgjigjet për të metat e parëndësishme materiale. Të njëjtën rregull e përmban edhe ULIS-i, i cili në nenin 33, paragrafi 2, parasheh që dallimet në sasi, mungesat e ndonjë pjese, ose një dallim nuk marren në konsideratë kur janë të parëndësishme. E meta materiale e parëndësishme nuk merret parasysh.⁶¹⁵ Sipas Uzansave të Përgjithshme, uzansa nr. 155 blerësi nuk mund të refuzojë pranimin e mallit nëse dallimi në cilësi nuk e kalon kufirin për devijimet normale, me përjashtim kur kontrata përmban normën “pa tolerancë” ose një normë të tillë. Normat e përmendura në raport me parimin *de minimis non curat lex*. Konventa e Vjenës nuk parasheh shprehimisht që blerësi nuk është përgjegjës për të metat e parëndësishme konform kontratës.

Të metat e parëndësishme janë ato te meta që paraqesin atë mungesë e cila sipas zakoneve të punës dhe rrethanave të punëve konkrete nuk pengon përdorimin e rregullt të sendit, gjegjësisht përdorimin për të cilin blerësi e ka blerë mallin.⁶¹⁶ A ekzistojnë të metat është pyetje faktike e cila duhet të zgjidhet sipas rrethanave të rastit konkret. Kryesisht në konsideratë duhet të merret dëshira e palëve kontraktuese, sepse vetë kontraktuesit mund që në marrëveshjen e tyre të përcaktohen që nuk është lejuar asnjë devijim në cilësi ose sasi. Atëherë shitësi përgjigjet edhe për mungesat e parëndësishme. E dyta, duhet të ketë kujdes për natyrën e sendit. Nëse është lëndë e kontratës së shitjes, për shembull pajisje të sakta matëse, atëherë nuk janë të pranueshme devijimet e përcaktuara.

⁶¹⁴ Mariana Tutulani-Semini, *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave*, Skenderbegbooks, Tiranë, 2006, fq 17.

⁶¹⁵ LMD, neni 461, paragrafi 1.

⁶¹⁶ Boris Vizner & Ivan Bukljaš, *vepër e cituar*, libri 3, fq. 1593.

IV. 8.12.2. Njohuritë e blerësit për të metat

Edhe në të drejtën ndërkombëtare, por edhe në atë vendore është pranuar vendimi që shitësi nuk do të përgjigjet për të metat e mallit nëse blerësi në kohën e shuarjes së kontratës për të e ka ditur ose nuk ka qenë e mundur që për të të jenë të panjohura.⁶¹⁷ Edhe e drejta jonë e rregullon në të njëjtën mënyrë çështjen e mospërgjegjësisë. Shitësi nuk përgjigjet për të metat e specifikuar në paragrafët 1 dhe 3 nga neni 465 në qoftë se blerësi në momentin e lidhjes së kontratës ishte në dijeni për këto të meta, ose ato nuk kanë mundur të jenë të panjohura për atë.⁶¹⁸ Sipas Kodit Civil Shqiptar shitësi nuk është përgjegjës për të metat të cilat në momentin e përfundimit të kontratës, blerësi i dinte ose për të cilat nuk ka marrë në dijeni për fajin e vet, përveç kur të metat kanë të bëjnë me cilësinë që sendet duhet t'i kishin pasur sipas kontratës apo sipas njoftimit të shitësit.⁶¹⁹

Lirimi i shitësit nga përgjegjësia në këtë rast është arsyetuar nga dy arsye. E para, në bazë të kontratës së shuar për shitjen, blerësi pret që me paratë e tij të marrë mallin si pronë e caktuar. Megjithatë, pritjet e blerësit për kontroll të cilësisë së mallit nuk mund të jenë të fshehta nëse ai me rastin e shuarjes së kontratës ka ditur që po e ble mallin me të meta. E dyta, në tregtinë ndërkombëtare, neni 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës paraqet supozimin e vullnetit të heshtur të palëve kontraktuese, që në rast të njohurisë së blerësit për mungesat nuk është i arsyeshëm. Në këtë rast, blerësi nuk mund të pritët nga shitësi që heshturazi të garantojnë cilësinë e veçantë dhe të zakonshme të mallit.

Shuarja e përgjegjësisë së shitësit për dorëzimin e mallit me mungesa është e mundshme nëse përmbushen kushtet e përcaktuara. E para, është e nevojshme që blerësi ka pasur dijeni për të metat në mall ose që ato nuk kanë qenë të panjohura për të. Megjithatë, shitësi përgjigjet edhe për të metat të cilat blerësi ka mundur t'i vërente lehtë, në qoftë se shitësi ka deklaruar se sendi nuk ka kurrfarë të metash apo se sendi ka cilësi dhe karakteristika të caktuara.⁶²⁰ E dyta, njohuria e blerësit duhet të ekzistojë në kohën e shuarjes së kontratës. E treta, përmbushja e përgjegjësisë së shitësit është e mundur vetëm me konventën dhe në ligjin për çështjen në fjalë. Në të drejtën tonë, shitësi nuk do të përgjigjet nëse sendi nuk ka karakteristikat e nevojshme dhe cilësitë e

⁶¹⁷ *Konventa e Vjenës*, neni. 35, paragrafi 3, *ULIS*, neni. 36, *Uzansat e Përgjithshme*, Uzansa nr. 136.

⁶¹⁸ *LMD*, neni 467, paragrafi 2.

⁶¹⁹ *KCSH*, neni 715, paragrafi 5.

⁶²⁰ *LMD*, neni 463, paragrafi 3.

nevojshme si dhe format të cilat shprehimisht ose heshturazi janë kontraktuar, gjegjësisht të shkruara. Dhe e fundit, lirimi i shitësit nga përgjegjësia nuk është absolut sepse ai do të përgjigjet në rast të pandershmërisë së tij, gjegjësisht nëse blerësit i ka premtuar përmbajtjet dhe format të cilat malli nuk i ka ose nëse blerësi me qëllim të keq ka heshtur për të metat. Dallimi në mes së drejtës sonë dhe shitjes ndërkombëtare të mallit është në atë se ligji ynë shprehimisht parasheh çështjet në fjalë në nenin 463 LMD-së derisa në Konventën e Vjenës ajo vjen nga normat e tjera.

IV. 8.12.3. Njohuritë e blerësit

Shitësi bart përgjegjësinë për jokonformitetin nëse blerësi ka dijeni për mungesat e mallit ose ato nuk kanë mundur të jenë të panjohura. Sipas LMD-së shitësi përgjigjet edhe për të metat të cilat blerësi ka mundur t'i vërente lehtë, në qoftë se shitësi ka deklaruar se sendi nuk ka kurrfarë të metash apo se sendi ka cilësi apo karakteristika të caktuara.⁶²¹

Fjala “di” nënkupton njohurinë pozitive të blerësit për mungesat e mallit, gjegjësisht që blerësi realisht e ka ditur për jokonformitetin. Për blerësin mund të thuhet njohja e të metave nëse dihen në tërësi.⁶²² Njohja reale e blerësit ekziston nëse blerësi ka zbuluar të metat. Shitësi blerësin mund ta lajmërojë edhe për të metat e dukshme edhe për ato të padukshme. Më pas, blerësi di për të metat nëse vetë ballafaqohet me të.⁶²³ Gjithashtu, duke u bazuar në kontratë klauzolat, për shembull e blerë në gjendje të kontrolluar, krijon supozim që blerësi ka qenë i njoftuar me gjendjen e mallit dhe me të metat eventuale, dhe shitësi lirohet nga përgjegjësia për të metat e dukshme.

Nëse blerësi di se çfarë malli do t'i dorëzojë shitësi, ai nuk mund të kërkojë mallin me cilësi të tjera ose në gjendje më të mirë. Përkundër kësaj, konsiderohet se blerësi që blen mallin, pa marrë parasysh të metat e dukshme, apo nëse blerësi është pajtuar me ofertën e shitësit e cila është përcaktuar kur malli ka qenë në gjendjen reale⁶²⁴ dhe që heshturazi ka evituar përdorimin e

⁶²¹ LMD, neni 463, paragrafi 3.

⁶²² Aleksadar Goldštajn, *E Drejta Tregtare Kontraktuese*, fq. 277.

⁶²³ LMD, neni 464, paragrafi 1

⁶²⁴ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 278.

mjeteve juridike.⁶²⁵ Vendimi i përmendur është në harmoni me parimin e përgjithshëm *venire contra factum proprium*.⁶²⁶

Pjesa e dytë e formulimit është jokonformiteti i blerësit që nuk ka qenë e mundur të mbetet i panjohur. Kjo në tori është bazuar te shitja ndërkombëtare e mallit dhe është tërhequr kujdesi i shtuar. Vetë Konventa nuk jep informatë në bazë të së cilës vlerësohet që, për blerësin mungesat nuk kanë mundur të mbeten të panjohura. Me rastin e trajtimit të kësaj faze duhet të kemi në mendje se në Konventën e Vjenës përdoret një shprehje tjetër. Këtë çështjeje e ka pasur të njohur dhe e ka zbuluar, se e meta ekziston dhe nuk ka qenë e mundur që për të e meta të jetë e panjohur⁶²⁷ e ka ditur dhe është dashur ta dijë.⁶²⁸ Është e nevojshme të krijohet dallimi në shkallën e kujdesit nga varësia dhe nga formulimi që përdoret. Në këtë mënyrë, rrethanat të cilat dikush është dashur të dijë për shuarjen e kësaj rrethane, të cilat rrethana kanë qenë të zbuluara me kontroll të mallit, kontrollin që, secila palë është dashur ta kryejë.⁶²⁹ Fjalët ka ditur dhe është dashur të dijë përcaktojnë pakujdesinë e thjeshtë⁶³⁰. Nga ana tjetër, fakti në bazë të të cilit për dikë nuk kanë qenë të panjohura janë “faktet të cilat para syve të atij i cili mund të shohë.”⁶³¹ Sipas një mendimi⁶³² për blerësin të metat është e pamundur të mbeten të panjohura, nëse mosnjohja e tyre fillon me keqbesim. Blerësi vepron me pakujdesinë e rëndë nëse me rastin e kontrollit të mallit nuk zbulon të metat të cilat ka mundur t’i zbulojë me kujdes të veçantë. Sipas grupit tjetër të teoricienëve veprimi i blerësit me pakujdesinë e rëndë nuk është i mjaftueshëm, por është e nevojshme që mungesa të jetë objektive, edhe pse e meta është shumë e dukshme dhe është e dukshme shumë mirë.⁶³³ Sipas mendimit tonë, formulimi që të metat për blerësin nuk kanë mundur të mbeten të panjohura, shënon gjithsesi shkallën më të lartë të fajësisë nga pakujdesia e rëndë, për blerësin të metat nuk kanë mundur të mbeten të panjohura nëse ato do të ishin të dukshme. Konsiderohet se nuk kanë mundur të jenë të panjohura për blerësin ato të meta

⁶²⁵ Në teori është pranuar që blerja me njohurinë që malli ka të meta paraqet tërheqje nga mjetet juridike. Shih më shumë: Peter Schlechtriem, *The Seller's Obligations Under the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, fq. 6-23. www.cisg.law.pace.edu

⁶²⁶ Jochen Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 517; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2821.

⁶²⁷ *Konventa e Vjenës*, neni 35, paragrafi 3, neni 40, 42 paragrafi 1 dhe 2.

⁶²⁸ Po aty, neni 38, paragrafi 3, neni 39, paragrafi 1, neni 49, paragrafi 2,, pika b dhe neni 79 paragrafi 4.

⁶²⁹ John Honnold, *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, fq. 260.

⁶³⁰ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 425.

⁶³¹ John Honnold, *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, fq. 260.

⁶³² Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 425, fq. 2354; Gjithashtu: Julian von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 365.

⁶³³ Teija Poikela, *vepër e cituar*, fq. 52. Gjithashtu: Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 148; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 426.

të cilat një person i kujdesshëm, me njohuri dhe përvojë mesatare të personit specialist dhe të profesionistit të njëjtë sikur të blerësit do të mund t'i vërente lehtë gjatë kontrollit të rëndomtë të sendit.⁶³⁴ Nëse blerësi ka pasur mundësinë e arsyeshme që mallin ta kontrollojë edhe pas kontrollit ka vendosur që ta blejë, kjo do të thotë që ka pranuar ofertën e shitësit dhe që për këtë është i kënaqur, se të metat nuk janë zbuluar në mënyrë të arsyeshme me rastin e kontrollit të mallit.

Edhe pse konventa këtë nuk e përmend shprehimisht, për mundësinë e zbulimit të gjendjes në të cilin ndodhet malli është e nevojshme që blerësi ka pasur në mendje mundësinë e arsyeshme që ta kontrollojë mallin. Blerësi është përgjegjës që të kryejë kontrollin i cili duhet të jetë kontroll normal në ekspertizën e tij. Shpesh është e mjaftueshme që ai të kontrollojë një pjesë të vogël të mallit, pa kontroll të të gjithë sasisë të cilën e parasheh ta blejë. Në këtë rast, nëse nuk hasen të metat, blerësi në mënyrë të kuptueshme mund të presë që malli i mbetur, i cili nuk është kontrolluar është mall konform kontratës.⁶³⁵ Kontrolli nga ana e blerësit nuk përfshin aplikimin e metodave komplekse në detaje dhe profesionale. Blerësi ka për detyrë që sendin e pranuar ta kontrollojë ose ta japë në kontroll sapo kjo të jetë e mundur sipas rrjedhës së rregullt të gjërave.⁶³⁶

A ka mundur jokonformiteti i mallit të mbetet i panjohur për blerësin, është një pyetje faktike. Megjithatë, ekzistimi i rrethanave tregon që të metat e mallit për blerësin nuk kanë mundur të mbeten të panjohura. Për shembull, nëse shitësi blerësit më herët i ka shitur mallin e një cilësie më të dobët dhe blerësi ka vërejtje ose nëse çmimi i përgjigjet çmimit i cili paguhet për mallin e kualitetit më të dobët,⁶³⁷ si dhe në rastet kur blihet për shembull, malli i përdorur.

Nga të gjitha gjërat e përmendura mund të konkludojmë që për lirimin e shitësit nga përgjegjësia mjafton që blerësi të ketë mundësinë e kuptimit të mungesave. Rrethana që nuk ka qenë e nevojshme ka qenë ekzistimi i njohurisë së blerësit, njohuri që paraqet lehtësim për shitësin, sepse në rast të mosmarrëveshjes do të jetë e mjaftueshme që të dëshmojë se të metat për blerësin nuk kanë mundur të jenë të panjohura. Në këtë mënyrë shitësi është vendosur në pozitë të kënaqshme sepse në praktikë dëshmia e njohjes pozitive shpesh do të jetë e pamundur.

⁶³⁴ LMD, neni 463, paragrafi 2.

⁶³⁵ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 279.

⁶³⁶ LMD, neni 464, paragrafi 1.

⁶³⁷ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 279.

Përgjegjësia e shitësit nuk është absolutisht e përjashtuar. Nëse me rastin e shuarjes së kontratës blerësi insiston që malli t'i dorëzohet pa të meta, atëherë shitësi do të jetë përgjegjës dhe i detyruar që të evitojë të metat eventuale. Gjithashtu, përgjegjësia e shitësit ekziston, edhe nëse ai, blerësit shprehimisht i ka garantuar që malli do të ketë cilësi të caktuara. Duhet pasur në mendje që këtu garancia e shitësit tregon edhe për ekzistimin e marrëveshjes së palëve në bazë të nenit 35, paragrafi 1, të Konventës së Vjenës, dhe është përjashtuar aplikimi i nenit 35, paragrafi 3, i Konventës së Vjenës.

IV. 8.12.4. Pakujdesia e shitësit

Lirimi i shitësit nga përgjegjësia nuk është absolut. Shitësi nuk mund të lirohet nga përgjegjësia nëse ai vetë ka qenë i paskrupullt (*fraus omnia corrumpit*). Megjithatë, shitësi përgjigjet edhe për të metat të cilat blerësi ka mundur t'i vërente lehtë, në qoftë se shitësi ka deklaruar se sendi nuk ka kurrfarë të metash apo se sendi ka cilësi apo karakteristika të caktuara.⁶³⁸

Konventa e Vjenës nuk rregullon shprehimisht rastin kur shitësi vepron me mashtrim, gjegjësisht kur ai di për mungesat në mall, por për këtë hesht. Blerësi nuk e humb të drejtën që të thirret në ndonjë të metë edhe kur nuk e kryen detyrimin e vet, që sendin ta shikojë pa shtyrje ose pa detyrimin që brenda afatit të caktuar ta njoftojë shitësin mbi ekzistimin e së metës, si dhe kur e meta të jetë shfaqur vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga dorëzimi i sendit, po që se për këtë të metë shitësi ka qenë në dijeni apo nuk ka mundur të mos jetë në dijeni.⁶³⁹ Nëse mungesa për blerësin nuk ka mundur të jetë e panjohur, atëherë shitësi nuk do të bartë përgjegjësinë. Megjithatë, pakujdesia e rëndë e blerësit në këtë situatë nuk dërgon në shuarjen e përgjegjësisë së shitësit. Ky vendim tejkalon nga neni 40 i Konventës së Vjenës dhe parimet e ndërgjegjësimi dhe të ndershmërisë nga neni 7, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Shitësi nuk mund të thirret në sjelljen e blerësit nëse ai vetë ka vepruar jo me vetëdije,⁶⁴⁰ gjegjësisht shitësi i cili vepron në qëllim të keq dhe nuk mund të bazohet në qëllimshmërinë e blerësit dhe që nuk

⁶³⁸ *LMD*, neni 463, paragrafi 3.

⁶³⁹ *LMD*, neni 468, paragrafi 1.

⁶⁴⁰ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 427.

mund të përjashtohet nga kjo⁶⁴¹ sipas kësaj, në rast të ndikimit të keq të shitësit, përparësi ka blerësi.

Për dallim nga e drejta ndërkombëtare në të drejtën tonë ekziston rregulli që nuk varet për veprimin e paarsyeshëm të shitësit. Shitësi përgjigjet për mungesat të cilat blerësi ka mundur t'i vërejtë lehtë (neni 463, paragrafi 3, i LMD-së), nëse ka thënë që sendi nuk ka kurrfarë të metash (as të dukshme, as të fshehura) ose që sendi ka cilësi ose forma të caktuara. Ligji nuk rregullon çështjen kurrë dhe në çfarë mënyre shitësi duhet të japë këtë deklaratë për të metën. Konsiderojmë që deklarimi sipas ligjit vendas bëhet edhe nga LMD-ja e cila e përcakton shprehimisht se: Kur kontrollimi të jetë bërë në prani të të dyja palëve, blerësi është i detyruar që vërejtjet e veta, për të metat e dukshme, t'ia komunikojë shitësit menjëherë, përndryshe e humb të drejtën e cila i takon mbi këtë bazë.⁶⁴² Deklarimi mund të jetë i dhënë edhe me gojë, edhe me shkrim, në kontratë ose edhe jashtë kontratës. Në qoftë se njoftimi për ekzistimin e të metës, të cilin blerësi ia ka dërguar me kohë shitësit me letër rekomande, me telegram ose me ndonjë mënyrë tjetër të sigurt, vonohet ose nuk arrin fare deri te shitësi, do të konsiderohet se blerësi e ka kryer detyrimin e vet për ta njoftuar shitësin.⁶⁴³ Por sipas një qëndrimi që është marrë nga një teori deklarimi, mund të jetë dhënë në momentin e përmbylljes së kontratës, por edhe më vonë deri te dorëzimi i sendit.⁶⁴⁴ Sipas uzansës nr. 136, Uzansat e Përgjithshme, shitësi është përgjegjës edhe nëse blerësi me keqbesim hesht për të metat e mallit.

IV. 8.12.5. Koha e nevojshme për njohuritë e blerësit

Secila njohuri e blerësit për mungesa, nuk çon kah shuarja e përgjegjësisë së shitësit. Është e nevojshme që ajo të ekzistojë në çastin e caktuar. Edhe në shitjen ndërkombëtare të mallit dhe në atë vendore është konsideruar me mirëbesim njohja në kohë e shuarjes së kontratës. Nga një vendim i tillë del si më poshtë. E para, është e qartë që në kufi të shuarjes, kjo nuk mund të vërehet në dorëzimin e mallit të llojit tjetër (aliud-it), si dhe në rast të mungesës së sasisë së mallit. Të dyja dëmet e përmendura krijohen që me përmbushjen e detyrimit, dhe kjo është gati e pamundur që blerësi ta kuptojë këtë në kohën e shuarjes së kontratës.

⁶⁴¹ Qëndrimi i përmendur është përmendur në praktikën gjyqësore, cituar nga: *Bridge, The International Sale of Goods – Law and Practice*, New York, 1999, fq. 82.

⁶⁴² LMD, neni 464, paragrafi 2.

⁶⁴³ LMD, neni 467, paragrafi 2.

⁶⁴⁴ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, fq. 75.

Pasoja e dytë varet nga përgjegjësia e blerësit që të kontrollojë mallin, ta kontrollojë rregullisht në kohën e shuarjes së kontratës dhe më këtë rast blerësi nuk ka detyrim për kontrollin e mallit. Nga kjo arsye mund të jetë e paqartë, se a është blerësi ai, i cili, edhe përkundër thirrjes së shitësit që të kontrollojë mallin, të ketë të drejtë që më vonë të thirret në të meta. Përgjigjja varet nga rrethanat e rastit konkret, domethënë nga natyra e mallit, prej njohurisë për të meta dhe nga një ekspertizë të palëve kontraktuese, nga kushtueshmëria e kontrollit të mallit nga ana e blerësit dhe e të tjerëve.⁶⁴⁵

Konventa dhe LMD-ja nuk japin përgjigje nëse thërrasin blerësin që ta kontrollojë mallin nga të metat e caktuara. Sipas mendimit tonë, në këtë rast blerësi humbet të drejtën që të thirret për të metat, të cilat me rastin e kontrollit të rregullt, janë të dukshme.⁶⁴⁶

IV. 8.12.6. Efektet e lirimit

Legjislacioni pozitiv shqiptar e rregullon përgjegjësinë e shitësit për të metat e sendit me dispozitat e tij, por edhe përshkruan lirimin e shitësit nga përgjegjësia.

Shitësi nuk është përgjegjës për të metat e sendeve të cilat, në momentin e përfundimit të kontratës, blerësi i dinte ose për të cilat nuk ka marrë dijeni për fajin e vet, kur të metat kanë të bëjnë me cilësinë që sendet duhet të kishin pasur sipas kontratës ose sipas njoftimit të shitësit.⁶⁴⁷

Te shitja ndërkombëtare e mallit, është ndikim i lirimit të shitësit nga përgjegjësia kur jokonformiteti është i kufizuar, kështu që kjo përfshihet vetëm në nenin 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës. Normat pozitive të Kosovës në LMD e rregullojnë lirimin e përgjegjësisë në këtë mënyrë: Shitësi nuk përgjigjet për të metat e specifikuara në paragrafët 1 dhe 3 nga neni 462, në qoftë se blerësi në momentin e lidhjes së kontratës ishte në dijeni për këto të meta, ose nëse ato nuk kanë mundur të jenë të panjohura për atë.⁶⁴⁸ Kjo është e qartë vetëm nga formulimi i nenit 35, paragrafi 3, i Konventës së Vjenës, ku në mënyrë të qartë përfshihet që lirimi varet nga pika a dhe d e nenit 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës. Në kontrollin e këtij konkludimi flet historia e krijimit të normës.⁶⁴⁹ Edhe përkundër kësaj që kemi theksuar, disa autorë e

⁶⁴⁵ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 427.

⁶⁴⁶ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 427.

⁶⁴⁷ *KCSH*, neni 715, paragrafi 5.

⁶⁴⁸ *LMD*, neni 463, paragrafi 1.

⁶⁴⁹ Me rastin e nxjerrjes së *Konventës së Vjenës*, në konferencën diplomatike delegacioni i Norvegjisë nuk arriti sukses që të propozojë që ndikimi i tërheqjes të zgjerohet edhe në nenin 35, paragrafi 1, i *Konventës së Vjenës*.

konsiderojnë se është e mundur dhe e nevojshme që të bëhet aplikimi analog i lirit nga përgjegjësia edhe në rastet nga neni 35, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës.⁶⁵⁰ Njëri nga argumentet për këtë qëndrim është se, me dallimin në mes nenit 35, paragrafi 1, dhe nenit 35 paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, përfshihen rregulla të ndryshme, të krijuara, në mënyra të ndryshme të konformitetit. Grupi i tretë i autorëve ka konstatuar se aplikimi i shpeshtë i nenit 35 paragrafi 3 i Konventës së Vjenës në rastet e garancisë së shprehur të shitësit.⁶⁵¹ Sipas mendimit tonë, aplikimi analog i nenit 35, paragrafi 3, dhe neni 35 paragrafi 1, i Konventës së Vjenës nuk është i mundshëm. Është e domosdoshme që të mbahet dallimi në mes detyrimeve të kontraktuara nga njëri detyrim, të cilin e parasheh konventa ose zakoni, nga ana tjetër.⁶⁵² Më herët kemi parë që konformiteti i caktuar i mallit paraqet kritere objektive dhe aplikohet vetëm kur mbetet marrëveshja në mes të palëve. Kur palët janë marrë vesh se cilat cilësi të mallit duhet t'i posedojnë, atëherë është përmbysur aplikimi i kritereve nga neni 35, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës që paraqesin vullnetin e supozuar të palëve kontraktuese. Fakti që neni 35, paragrafi 3, nuk drejton në nenin 35, paragrafin 1, të Konventës së Vjenës, i jep blerësit siguri të caktuar. Nëse nuk ekziston marrëveshja e palëve, në të cilën është dorëzuar përmbajtja e kontraktuar, shitësin nuk mund ta lirojë nga premtimi i tij.⁶⁵³ Kjo tejkalon njërin nga parimet kryesore të së drejtës së palëve kontraktuese *pacta sunt servanda*.

Edhe neni 36, i ULIS-it përmban rregull të njëjtë, por caku i tij është i gjerë, sepse lirimi nga përgjegjësia nuk është përfshirë te dorëzimi i mallit i cili nuk është konform mostrës ose modelit

IV. 9. Përgjegjësia e shitësit për shkak të dëmtimit (shkeljes) të kontratës me dorëzimin e mallit me të meta juridike (përgjegjësia e përgjithshme e shitësit për mungesat juridike)

Shitësi përgjigjet për të metat e sendit që duhet të dorëzohet dhe ai është i detyruar që të mbrojë blerësin nga e drejta dhe kërkesat e personave të tretë. Sipas kësaj, shitësi duhet t'ia

⁶⁵⁰ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 147, 148.

⁶⁵¹ Rutgers Hyland, *Conformity of Goods to the Contract Under the United Nations Sales Convention and the Uniform Commercial Code*, Schlechtriem, *Einheitliches Kaufrecht und nationals Obligationenrecht*, Baden-Baden, 1987, fq. 326.

⁶⁵² Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 280.

⁶⁵³ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 280.

dorëzojë blerësit mallin të lirë nga e drejta e përfshirjes të personave të tretë. Në të kundërtën, nënkuptohet se as vetë shitësi nuk guxon të kufizojë të drejtat në mall. Në qoftë se shitësi nuk e përmbush detyrën ndaj blerësit, që në afatin e arsyeshëm ta lirojë sendin nga e drejta ose nga pretendimi i personit të tretë, blerësi mund ta zgjidhë kontratën në qoftë se për atë shkak qëllimi i saj nuk mund të realizohet.⁶⁵⁴ Mbi shitësin rëndon detyrimi që t'i garantojë blerësit pronësinë e sendit apo të së drejtës që ai shet dhe në qoftë se blerësi zhvishet nga pronësia mbi sendin e blerë... atëherë shitësi detyrohet që t'i kthejë blerësit çmimin e shitjes si dhe dëmin e pësuar me kushtin që blerësi t'ia ketë bërë të ditur shitësit pretendimet e të tretëve mbi sendin duke specifikuar natyrën e tyre. Brenda një afati të arsyeshëm nga momenti kur ka marrë në dijeni ose duhej të merrte në dijeni për to, ndryshe humb të drejtën për të kërkuar çmimin e paguar si dhe dëmin e shkaktuar.⁶⁵⁵

Përgjegjësia e shitësit për të metat juridike tejkalohet nga parimi i vlerës së barabartë të dhënies, bazuar në kontratat e dyanshme. Shitësi është përgjegjës që të sigurojë blerësin jo vetëm për posedimin e dobishëm dhe të qetë dhe për pronësinë e sendit në të cilin blerësi nuk do të jetë i shqetësuar juridikisht në bazë të një të drejte të të tretit, për të cilin ai nuk ka qenë i njoftuar, as edhe që ka pranuar të marrë sendin e ngarkuar me këtë të drejtë.⁶⁵⁶

Në tregti vlerë më të madhe kanë të metat reale sesa ato juridike. Shkaku qëndron në atë që rastet e eviksionit në fushën e mallit si dhe të lëndës së tregtisë ndërkombëtare dhe vendore janë shumë të rralla. Detyrimi i shitësit për të garantuar blerësin nga zhveshja e pronësisë mbi sendin njihet ndryshe edhe si detyrimi për të garantuar blerësin nga eviksioni, ku me eviksion kuptohet rasti kur pas shitjes, një i tretë rivendikon me sukses pronësinë e sendit dhe për këtë arsye blerësi humbet pronësinë mbi pronën e blerë.⁶⁵⁷ Me eviksion do të kuptojmë humbjen ose cenimin e pronësisë së blerësit gjatë ushtrimit të së drejtës së tij si pronar.⁶⁵⁸ Pikërisht për këtë është zhvilluar analiza e të metave juridike në doktrinën e vendeve në zhvillim.

Sipas nenit 41, Konventa e Vjenës, shitësi është i detyruar që të dorëzojë mallin e lirë nga të drejtat e kërkimit të personit të tretë, përveç nëse blerësi kërkon që të pranojë mallin me kushte të tilla. Në tregtinë ndërkombëtare bëhet dallimi në mes të përgjegjësisë për të metat juridike dhe

⁶⁵⁴ LMD neni 493, paragrafi 2.

⁶⁵⁵ Ardian Nuni & Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). *E Drejta e Detyrimeve II*, Tiranë, fq. 15-16.

⁶⁵⁶ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, libri II, redaktorët Perović, Stojanović, fq. 131.

⁶⁵⁷ Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). *E Drejta e Detyrimeve II*, Tiranë, fq. 15.

⁶⁵⁸ Mariana Tutulani –Semini. (2006). *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Posaçme*, Skanderbegbooks, Tiranë, fq.13

përgjegjësisë kur për mallin e shitur ekziston e drejta ose kërkesa që krijohet në pronësinë intelektuale ose industriale, e cila është krijuar me nenin 42 të Konventës së Vjenës, me përfshirjen e kushteve dhe të përgjegjësisë të veçanta të shitësit për të drejtën ose kërkesat të cilat krijohen në pronësinë industriale ose në pronësinë intelektuale, përgjegjësia e shitësit për të metat juridike. Përkundër kësaj, e drejta vendore rregullisht nuk e përmban një dallim të tillë.

Sipas nenit 491, të LMD-së, shitësi përgjigjet në qoftë se në sendin e shitur ekziston ndonjë e drejtë e të tretit e cila e përjashton, e zvogëlon ose e kufizon të drejtën e blerësit, dhe për ekzistimin e saj blerësi nuk është njoftuar, e as që ka dhënë pëlqimin që ta marrë sendin e ngarkuar me këtë të drejtë.⁶⁵⁹ Për përgjegjësinë për të metat juridike (përgjegjësia për eviksion) është e nevojshme që kumulativisht të përmbushen kushtet e mëtutjeshme. E para, në mall duhet të ekzistojë e drejta ose kërkitimi i personit të tretë, do të thotë ngacmimi i blerësit duhet të jetë i drejtë. Përkundër kësaj, ngacmimi nuk është i mjaftueshëm për përgjegjësinë e shitësit. E dyta, të metat juridike duhet të ekzistojnë në kohën e përmbushjes së detyrimit. E treta, është e nevojshme që blerësi, në afatin e caktuar, të lajmërojë shitësin për ekzistimin e së drejtës ose kërkitimin e personit të tretë. E fundit, është e nevojshme që të ekzistojnë rrethanat të cilat çojnë në përgjegjësinë e shitësit për të metat juridike.

IV. 9.1. Të metat juridike

E drejta pozitive i rregullon të metat në të meta materiale dhe ato juridike. Të metat juridike rregullohen me neni 491. Shitësi përgjigjet në qoftë se në sendin e shitur ekziston ndonjë e drejtë e të tretit e cila e përjashton, e zvogëlon ose e kufizon të drejtën e blerësit, dhe për ekzistimin e saj blerësi nuk është njoftuar, e as që ka dhënë pëlqimin që ta marrë sendin e ngarkuar me këtë të drejtë.⁶⁶⁰

Sipas Konventës së Vjenës malli i dorëzuar duhet të lirohet nga të drejtat ose kërkitimet e personit të tretë. Me të drejtën e personit të tretë duhet të kuptohet pozita juridike ekzistuese reale. Përkundër kësaj nocioni kërkitim përfshin rastet kur ekziston vetëm konstatimi i personit të tretë për ekzistimin e së drejtës. Me këtë vendim Konventa e Vjenës mundëson që blerësi duhet të mbrohet edhe nga ngarkesa e cila do të krijohej në mes të konfliktit me ato që janë cekur më

⁶⁵⁹ LMD, neni 491, paragrafi 1.

⁶⁶⁰ LMD, neni 491, paragrafi 1.

lart, me poseduesin e së drejtës. Ky vendim, është vendim në vështirësi të nenit 52 të ULIS-it, dhe këtë e përfshin edhe e drejta jonë, eviksionin për eviksion. Sipas nenit 491, të LMD-së mungesat juridike që ekzistojnë nëse në mallin e shitur ekziston një e drejtë e personit të tretë, i cili përmbyll, zvogëlon ose kufizon të drejtën e blerësit. Për përgjegjësinë e shitësit nuk është e domosdoshme që personi i tretë të nisë konfliktin kundër blerësit, por është e mjaftueshme që ai të jetë jashtëgjyqësor dhe potencon, pra që ka të drejtë ose që në një mënyrë ngarkon blerësin me posedim të lirë me mallin. Bile çka është më e rëndësishme, dhe çka është e mjaftueshme që blerësi me të drejtë frikësohet dhe shqetësohet me kërkesën e personit të tretë.⁶⁶¹ Në bazë të LMD-së kontrata mund të shuhet nëse shitësi në afatin e arsyeshëm nuk lirohet nga veprimi juridik ose nga pretendimet e të tretit.

IV. 9.1.1. E Drejta e personit të tretë

Me kuptimin e drejta e personit të tretë janë të përfshira të gjitha detyrimet reale të cilat ekzistojnë në mall, e në bazë të të cilave personi i tretë mund të ndikojë te malli ose blerësit mund t'ia kufizojë përdorimin e tij, shfrytëzimin ose posedimin⁶⁶². Këto janë, para së gjithash, të drejtat reale. Fillimisht, në të drejta personit të tretë i takon e drejta e posedimit të mallit. Shitësi do të përgjigjet nëse blerësit i dorëzon mall për të cilin është pronar personi tjetër (personi i tretë). Në qoftë se një person i tretë ngre pretendime ndaj blerësit se sendi është pronë e tij, atëherë blerësi është i detyruar të thërrasë në gjykim shitësin.⁶⁶³

Prandaj Konventa e Vjenës nuk rregullon veprimin e fitimit të posedimit, si mundësi e fitimit të pronësisë me vullnet. Kjo sipas nenit 4 pika b e Konventa e Vjenës. Afër posedimit, me kuptimin e drejtë janë përfshirë edhe pozita të tjera (pronësia, pengu). Kuptimi më i madh praktik në tregti ka mjete të sigurimit të besueshmërisë dhe të dorëzuesit të mallit, si dhe barra statusore e transportuesit, magazinierit, shpeditërit dhe komisionarit. E treta, mungesat juridike ekzistojnë gjithmonë kur e drejta e personit të tretë mund të përfshijë të drejtën e posedimit të blerësit, dhe përkundër kësaj afër të drejtave sendore, këtu bëjnë pjesë edhe të gjitha kërkimet

⁶⁶¹ Ivica Jankovec, (1993). *“Përgjegjësia Kontraktore”*, fq. 154.

⁶⁶² Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2831.

⁶⁶³ Mariana Tutulani –Semini. (2006). *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Posaçme*, Skanderbegbooks, Tiranë, fq. 13.

obligative të cilat e furnizojnë personin e tretë me posedimin në mall (kërkimi të cilin e tejkalon nga kontrata e huasë, lizingut, blerjes... etj).

Në teorinë e shitjes ndërkombëtare të mallit është debatuar se a i kufizuar në të drejtën publike posedimi në mall i cili mall posedon mungesën juridike ose të metat në cilësinë e mallit. Për përgjegjësinë e shitësit kjo pyetje ka domethënie sepse janë të ndryshme supozimet e përgjegjësisë së tij. E para, shuarja e përgjegjësisë bën pjesë me rrethanat e ndryshme. Përgjegjësia për të metat juridike sipas nenit 41, të Konventës së Vjenës, mund të shuhet vetëm nëse blerësi pranon mallin e ngarkuar me të drejtën ose kërkesat e personit të tretë, derisa për shuarjen e përgjegjësisë për të metat në cilësi sipas nenit 35, paragrafi 3, është e mjaftueshme që te blerësi të jetë e pranishme pakujdesia e rëndë. E dyta, tek të metat juridike nuk ekziston afati i fundit për lajmërimin e shitësit për të metat, domethënë nuk aplikon në afatin prekluziv, pra në afatin dyvjeçar.

Historia e krijimit të nenit 41, të Konventës së Vjenës, nuk jep mjaftueshëm informata për atë se, si i klasifikon kufizimet e së drejtës publike.⁶⁶⁴ Me interpretimin gjyqësor të formulës *right of a third party*, mund të përfundojmë se neni 41, i Konventës së Vjenës, varet nga e drejta dhe nga kërkimet e personit privat, gjegjësisht që neni 41, i Konventës së Vjenës nuk i ka përfshirë kufizimet e së drejtës publike me posedimin e mallit.

Në secilin rast të metat juridike nuk ekzistojnë kur veçoritë e mallit çojnë në shkeljen e normave publike për mbrojtjen e shpenzimeve ose mjedisit. Me kushte të caktuara këto veçori mund të sjellin deri te përgjegjësia e shitësit për konformitetin sipas nenit 35, të Konventës së Vjenës. Dhe e fundit, sipas një qëndrimi, në bazë të të cilit shitësi është dashur të paguajë brenda kufijve mallin, dhe ta ngarkojë mallin, i cili mall, mund të prezantojë të metat juridike si masa juridike penale (p.sh. konfiskimi i mallit) nga e cila ai krijohet.⁶⁶⁵ Me dorëzimin e sendit shitësi duhet të dorëzojë edhe dokumentet që lidhen me të (mallin).⁶⁶⁶

⁶⁶⁴ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 485

⁶⁶⁵ Po aty; Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 534; Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 432.

⁶⁶⁶ KCSH, neni 715, paragrafi 2, cituar nga: Mariana Tutulani –Semini. (2006). *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, pjesa e posaçme*, Skanderbegbooks, Tiranë, fq 12.

IV. 9.1.2. Arkëtimi (pretendimet) e personit të tretë

Shitësi do të përgjigjet për eviksionin edhe nëse në mall ekziston anketimi, gjegjësisht pretendimi i personit të tretë. Në përkthim të neni 41 i Konventës së Vjenës përdoret nocioni “anketim” derisa në nenin 52, të ULIS-it përdoret fjala pretendim. Shitësi është i obliguar që të dorëzojë mallin e lirë nga pretendimet e personit të tretë. Shitësi është i obliguar të garantojë blerësin për gëzimin e qetë të sendit të lirë nga çdo e drejtë tjetër pronësie e personave të tjerë mbi të. Shitësi duhet të dorëzojë sende të shkarkuara nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve, përveçse kur në kontratë është parashikuar ndryshe.⁶⁶⁷

Shitësi është përgjegjës që të dorëzojë mallin të liruar nga pretendimet e personit të tretë, gjegjësisht nga të drejtat për të cilat personi i tretë i konsideron se ekzistojnë. Shitësi do të përgjigjet pa marrë parasysh se a është krijuar pretendimi i të tretit.⁶⁶⁸ Përgjegjësia e shitësit do të ekzistojë pa marrë parasysh se a ekziston e drejta reale e të tretit. Në këtë mënyrë është zgjeruar përgjegjësia e shitësit, dhe blerësi është i mbrojtur edhe nga debatet eventuale dhe të gjata me bartësit e së drejtës rreth mallit. Kjo është shumë e rëndësishme meqë debatet të tilla mund të paraqesin ngarkesë të rëndësishme për blerësin, sepse mund të jenë pasojë për shpenzime të rëndësishme, dhe mund të pamundësojnë që malli të përdoret në mënyrën e planifikuar.

Në teorinë e shitjes ndërkombëtare të mallit është e debatueshme se, a ekziston përgjegjësia e shitësit në rastet e pretendimeve joserioze të personit të tretë, gjegjësisht për pretendimet për të cilat është e kuptueshme që, në mënyrë shprehimore nuk janë krijuar. Sipas një qëndrimi të neni 41, të Konventës së Vjenës, nuk janë përfshirë kërkesat që nuk janë krijuar ndaj personit të tretë.⁶⁶⁹ E konsiderojmë se mendimi i përmendur nuk mund të pranohet dhe që shitësi duhet të përgjigjet edhe në këtë rast.⁶⁷⁰

Pranimi i qëndrimit të parë do të sjellë deri te problemi në praktikë, sepse do të jetë e vështirë të përcaktohet kriteri i kufirit kur është krijuar ndonjëra nga kërkesat. Gjithashtu, a është kërkesa e të tretit e rrejshme, sipas rregullit, këtë nuk mund ta konstatojë vetë shitësi. Vetë rrethana, që

⁶⁶⁷ Mariana Tutulani –Semini. (2006). *E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Posaçme*, Skanderbegbooks, Tiranë, fq 13.

⁶⁶⁸ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 433

⁶⁶⁹ Po aty. UN DOC. A/CONF. 97/5 (Komentari i UNCITRAL-it), Official Records fq. 36, pika 4.

⁶⁷⁰ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 433; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 486; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2404; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2832.

personi i tretë të konstatojë, që me shitjen e mallit është shkelur ndonjë e drejtë, bie në sferën e përgjegjësisë dhe rrezikut të shitësit. Në këtë rast ai është përgjegjës dhe duhet të diskutojë me personin e tretë. Gjithashtu nëse flitet për kërkesën e rrejshme të shitësit ai pa shpenzime do të dëshmojë që kërkesa nuk është krijuar dhe kështu duhet ta tejkalojë kërkesën e blerësit për kompensimin e dëmit. Në këtë rast blerësi për shkak të kërkesës së të tretit ka qenë i ekspozuar karshi shpenzimeve që shitësi do të duhej t'i kompensonte.⁶⁷¹ Ne e konsiderojmë që kjo, e cila është shënuar edhe më lart, vlen edhe te shitja ndërkombëtare e mallit.

IV. 9.2. Koha e nevojshme për ekzistimin e të metave juridike

Për përgjegjësinë e shitësit është e nevojshme që të metat juridike të ekzistojnë edhe në çastin e caktuar. Sipas, qëndrimit të përgjithshëm te shitja ndërkombëtare është e nevojshme që të metat juridike të ekzistojnë në çastin e dorëzimit të mallit.⁶⁷² Të metat, për të cilat shitësi i ka përgjegjësi, duhet të ekzistojnë në çastin e shitjes ose edhe të kenë ardhur pas këtij momenti.⁶⁷³ Kjo që është përmendur për detyrimin e shitësit është që të dorëzojë mallin e lirë dhe të jetë i pavarur nga e drejta ose nga kërkimet e personit të tretë.

Koha e shuarjes së kontratës nuk është dhe nuk mund të jetë e vendosur për përgjegjësinë e shitësit për evikcion për dy arsye. E para, shitësi përgjigjet edhe për të drejtat e personit të tretë të cilat krijohen pas përmbushjes së kontratës.

E dyta, sepse që nga dorëzimi shitësi mund të largojë të metat juridike të cilat kanë ekzistuar në kohën e shuarjes së kontratës.

Në situata të caktuara, megjithatë ekzistimi i të metave juridike nuk mund të vlerësohen sipas momentit të dorëzimit, sepse do të sjellë rezultate jo të kënaqshme. E para, sipas kontratës për shitjen kur malli duhet të transportohet, dorëzimi është përmbushur me dorëzimin e mallit tek transportuesit e parë dhe të drejtat në mall mund të krijohen më vonë. Këtë çështje e rregullon edhe LMD-ja. Në rastin kur sipas kontratës nevojitet që të bëhet transportimi i sendeve, ndërsa në kontratë nuk është caktuar vendi i përmbushjes, dorëzimi quhet i kryer me dorëzimin e sendit

⁶⁷¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 487.

⁶⁷² Fritz Enderlain & Dietrich Maskow. *vepër e cituar*, fq. 165; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2406; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2832; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 488;

⁶⁷³ Mariana Tutulani –Semini, *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Posaçme*, Skanderbegbooks, Tiranë 2006, fq.16.

tek transportuesit ose te personi që organizon transportin.⁶⁷⁴ Në këtë rast shitësi do të jetë përgjegjës edhe për premtimin e të drejtave, të cilat janë krijuar pas dorëzimit, nëse në të kundërtën e kontratës nuk ka paguar shpenzimet e transportit. Konventa e Vjenës dorëzimin e mallit tek transportuesi e rregullon në mënyrë të përshtatshme. Në qoftë se shitësi është i detyruar që të organizojë transportimin e mallrave, ai duhet të lidhë kontrata të nevojshme për transportimin në vendin e përcaktuar me mjete transporti të përshtatshme për rrethanat dhe sipas kushteve të zakonshme për një transportim të tillë.⁶⁷⁵ E dyta, përgjegjësia e shitësit do të ekzistojë, edhe kur, personi i tretë pas dorëzimit e konsideron që është shkelur e drejta e tij, e cila ka ekzistuar deri në momentin e dorëzimit të mallit. Kjo në mënyrë indirekte do të thotë që, do të pranohet vetëm me kërkesat ekzistuese të personave të tretë dhe që blerësi ka mbetur jo i mbrojtur në vështrim të prezantimit të personave të tretë.⁶⁷⁶

Nga kjo që është përmendur më lart dhe që është bërë për vlerësimin e ekzistimit të të metave të dukshme në çastin e dorëzimit. Shitësi duhet t'i dorëzojë mallrat dhe çdo dokument në lidhje me to dhe të transferojë pronësinë e mallrave, siç kërkohet nga kontrata dhe nga kjo Konventë.⁶⁷⁷ Nëse shikojmë gjerësisht dorëzimi paraqet kufirin në mes të sferave të përgjegjësisë së shitësit dhe blerësit. Për këtë arsye do të duhej të vlerësohet se a janë rrethanat në të cilat e drejta ose pretendimi i personi të tretë krijon rrethana në mënyrë që e drejta ose pretendimi i personit të tretë përfshin ekzistimin para ose pas momentit të dorëzimit.⁶⁷⁸ Edhe ashtu, do të duhej të konstatohej se e drejta e përmendur ose kërkimi i personit të tretë mund të çojë pas deri te rrethanat të cilat kanë ndodhur para dorëzimit.

Rregullat e LMD-së me të cilat është rregulluar përgjegjësia e shitësit për eviksion shprehimisht nuk parashohin se në këtë çast do të ekzistojnë të metat juridike. Megjithatë në teorinë vendore është pranuar qëndrimi, që të metat juridike duhet të ekzistojnë para se blerësi të ketë marrë mallin.⁶⁷⁹

⁶⁷⁴ LMD, neni 455.

⁶⁷⁵ Konventa e Vjenës, neni 33, paragrafi 2.

⁶⁷⁶ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 489.

⁶⁷⁷ Konventa e Vjenës, neni 30.

⁶⁷⁸ Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2405.

⁶⁷⁹ *Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve*, libri II, redaktori Perović, Stojanović, fq. 133.

IV. 9.3. Njoftimi për të metat juridike

Shitësi është i detyruar të mbrojë blerësin edhe për mungesat fizike ose materiale të sendit të shitur.⁶⁸⁰ Nëse ato të meta ekzistojnë blerësi duhet të lajmërohet ose të njoftohet.

Shitësi është përgjegjës që të dorëzojë mallin lirshëm nga e drejta ose pretendimi i personit të tretë. Në të kundërt blerësi në posedim qëndron te mjetet e caktuara juridike, të cilat i shërbejnë për mbrojtjen e interesave të tij. Megjithatë, që të mund të krijojë të drejtat, të cilat i ka në posedim të dorëzimit të mallit me të metat juridike, blerësi duhet ta lajmërojë shitësin për të metat, gjegjësisht që të vendos ankim. Në njoftimin mbi ekzistimin e të metës së sendit, blerësi ka për detyrë ta përshkruajë të metën hollësisht dhe ta ftojë shitësin ta kontrollojë sendin.⁶⁸¹ Megjithatë blerësi humbet të drejtën që të thirret në ekzistimin e të metave juridike nëse për të drejtat ose kërkimin e personit të tretë nuk i dërgon shitësit njoftimin për të metat juridike për të cilat ka përmendur natyrën e tyre në afatin e arsyeshëm meqë ai ka kuptuar ose është dashur të kuptojë për ekzistimin e asaj të drejte ose kërkimi.⁶⁸² Sikur edhe te dorëzimi i mallit jokonform, parashtrimi i ankesës është supozim për thirrje në të metat juridike. Dërgimi i njoftimit për të metat është detyrim, e jo përgjegjësi e blerësit.

Natyrën e detyrimit në lajmërim e kemi analizuar në detaje në njërin nga kapitujt e mëparshëm, dhe kjo nuk do të jetë lëndë e analizave të mëtejshme.⁶⁸³

Detyrimi i blerësit që të lajmërojë shitësin për të metat juridike ekziston edhe në të drejtën ndërkombëtare edhe në atë vendore, por ka dallime në mes veti. Sipas rregullit të Konventës së Vjenës blerësi humbet të drejtën që të thirret në të metat juridike sipas rregullit kur me mirëbesim e njofton shitësin. Përkundër kësaj është neni 493, i LMD- së. Në qoftë se shitësi nuk e përmbush detyrën ndaj blerësit, që në afatin e arsyeshëm ta lirojë sendin nga e drejta ose nga pretendimi i personit të tretë, blerësi mund ta zgjidhë kontratën në qoftë se për atë shkak qëllimi i saj nuk mund të realizohet.⁶⁸⁴ Blerësi, i cili duke mos njoftuar shitësin është lëshuar në kontest me personin e tretë dhe e ka humbur kontestin, megjithatë mund të thirret në përgjegjësinë e

⁶⁸⁰ Nerxhivane Dauti. (2012). *Kontratrat*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq. 139.

⁶⁸¹ *LMD*, neni 467, paragrafi 1.

⁶⁸² *Konventa e Vjenës*, neni 43, paragrafi 2.

⁶⁸³ Shih më shumë pjesën e punimit që ka të bëjë me detyrimin në përgjegjësi të lajmërimit te dorëzimi i mallit jokonform kontratës.

⁶⁸⁴ *LMD*, neni 493, paragrafi 2.

shitësit për të metat juridike, përveç nëse shitësi provon se ka disponuar mjete që të refuzohet kërkesa e personave të tretë.⁶⁸⁵

Në rast të detyrimit të parashtrimit të ankesës është e nevojshme që në detaje të trajtohet përmbajtja e njoftimit, se në cilin afat dhe në cilën formë duhet të jetë krijuar. Si dhe në çfarë raste blerësi edhe përkundër kësaj kur nuk e ka përmbushur detyrimin e njoftimit ka të drejtë që të thirret në të metat juridike.

IV. 9.3.1. Lënda dhe përmbajtja e njoftimit

Në njoftimin sipas nenit 43, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, blerësi duhet të citojë që në mall ekziston e drejta ose anketimi i personit të tretë, si dhe për natyrën e kësaj të drejte. Caku kryesor i njoftimit është që t'ia mundësojë shitësit me qëllim që të reagojë shpejt dhe të kërkohej nga ana e personit të tretë që të mbrohet.

Njoftimi i përgjithshëm që në mall ekziston e drejta e të tretit nuk është e mjaftueshme. Në ankesë natyra e së drejtës ose kërkesa e personit të tretë duhet të jetë shumë precize e përcaktuar në mënyrë që shitësi të vendoset në pozitë që të mbrohet nga të njëjtit.⁶⁸⁶ Nisur nga kjo, lajmërimi duhet të përmbajë të dhënat për personin e tretë (emri, mbiemri, adresa...) natyrën e së drejtës të cilën personi i tretë e kërkon edhe në hapat të cilat personi i tretë veçse i ka marrë. Sigurisht, nëse është e nevojshme për një reagim të shpejtë të shitësit, atij duhet t'i bëhet e qartë kjo nga njoftimi. Nëse e drejta e personit të tretë, si dhe tek ankesa për jokonformitetin, shitësi duhet në këtë rast të njoftojë për secilin rast njëloj.

Ankesa e cila përmban të dhëna jo të sakta (p.sh. vlerësimi i gabuar i situatës juridike) konsiderohet e mjaftueshme me përcaktim. Dhe në këtë mënyrë ekziston mundësia e shitësit që të mbrohet nga kërkesa që nuk është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme.⁶⁸⁷ Nëse shitësi mund të reagojë konkretisht atëherë atij i është përmbushur caku i njoftimit para blerësit dhe nuk guxon të vendosë për ankesat e ashpra. Në të kundërt, blerësi mund të humbasë mjetet juridike nga neni 45, i Konventës së Vjenës, derisa përgjegjësia e shitësit ka qenë e ngushtuar në mënyrë të konsiderueshme.

⁶⁸⁵ LMD, neni 494.

⁶⁸⁶ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2837.

⁶⁸⁷ Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2416; Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 449.

Neni 52, paragrafi 1 i ULIS-it, parasheh që blerësi në ankesë duhet të kërkojë nga shitësi që të evitojë të metat ose te sendet gjenerike, dorëzimi i mallit tjetër të jetë pa të meta. Ankesa e ngritur sipas Konventës së Vjenës nuk duhet të përmbajë kërkesat e blerësit. Megjithatë, blerësi kërkesat e veta duhet t'i theksojë në afat të arsyeshëm.

IV. 9.3.2. Afati për njoftim

Ankesa e blerësit duhet të jetë me mirëbesim. Në qoftë se njoftimi për ekzistimin e të metës, të cilin blerësi ia ka dërguar me kohë shitësit, me letër rekomande, me telegram ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurt vonohet ose nuk arrin fare deri te shitësi, do të konsiderohet se blerësi e ka kryer detyrimin e vet për ta njoftuar shitësin.⁶⁸⁸ Tek kontrata për shitjen ndërkombëtare të mallit, blerësi është i obliguar që të njoftojë shitësin në afatin e arsyeshëm për të metat e mallit, meqë ai e ka kuptuar ose është dashur ta kuptojë ekzistimin e këtyre të metave juridike. Përkundër kësaj në të drejtën tonë shprehimisht është paraparë afati për ankesë, prej nga rrjedh domosdoshmëria e pjesëmarrjes së rregullave juridike ekzistuese që vjen edhe deri te përgjigja.

IV. 9.3.2.1. Fillimi i afatit për njoftim

Te kontrata për shitjen ndërkombëtare të mallit afati për parashtrimin e ankesës fillon të rrjedhë kur blerësi kupton, ose në mënyrë alternative, është dashur të dijë për të drejtën e tij ose kërkesën e personit të tretë. Njohja reale e blerësit për të metat juridike ekziston kur personi i tretë njofton me kërkesën vet të vërtetë për të drejtat ose kërkesat, gjegjësisht kur personi i tretë thekson kërkesën e vet, si dhe kur blerësi me siguri, në një mënyrë të dytë, kupton për të drejtën e të tretit. Me këtë rast për njohurinë e blerësit nuk ka rëndësi, nëse e drejta ose anketimi i vërtetë ekzistojnë.

Nga ana tjetër, blerësi është dashur të kuptojë për të metat kur ekziston ndikimi i mjaftueshëm në bazë të të cilit blerësi është mesatarisht i kujdesshëm nëse ekziston e drejta e personit të tretë.⁶⁸⁹ Sipas kësaj është me rëndësi që blerësi informatat dhe shenjat, të cilat i

⁶⁸⁸ LMD, neni 467, paragrafi 2

⁶⁸⁹ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 449; Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2416.

posedon ose i vëren i injoron (p.sh. nëse nga reklama kupton që malli është i mbrojtur me markë tregtare). Megjithatë blerësi nuk është përgjegjës që pa arsye konkrete të hulumtojë se a ekziston e drejta e personit të tretë. Në teori ekziston pajtueshmëria që formulën e përmendur duhet ta kuptojë si mosdije në mes të pakujdesisë.⁶⁹⁰ Afati për ankesë, sipas rregullit fillon e rrjedh më herët me momentin e dorëzimit. Në rastet e veçanta, kur blerësi kupton, ose, kur ka dashur të kuptojë për të drejtën e të tretit para dorëzimit, afati fillon e rrjedh më herët (p.sh. rreziku që malli të jetë i kthyer me rastin e transportit).⁶⁹¹

Sipas nenit 465 të LMD-së afati për njoftim fillon e rrjedh me çastin e dorëzimit. Në raste specifike, kur blerësi kupton ose i është dashur të kuptojë se e drejta e personit të tretë, para dorëzimit, kalon një të drejtë në send. Nga formulimi i kësaj, kur flitet se nuk mund të përmbillet kur fillon e rrjedh afati i njoftimit të shitësit.

IV. 9.3.2.2. Zgjatja e afatit

Njoftimin për të metat juridike në të drejtën ndërkombëtare tregtare blerësi nuk duhet ta adresojë menjëherë, por në afat të arsyeshëm. Qëndrimi dominant në teori është që afati i arsyeshëm si edhe njoftimi për dorëzimin e mallit jokonform kontratës nuk duhet të jetë më i gjatë se një muaj. Megjithatë, zgjatja e afatit të arsyeshëm është pyetje faktike dhe varet nga rrethanat e rastit individual (të veçantë). Para njoftimit është e nevojshme që blerësi të hasë në skenën e qartë të pozitës së tij juridike. Nga kjo, blerësi duhet të ketë mundësi, që para lajmërimit, eventualisht të përfshijë edhe një vështrim në një regjistër. Gjithashtu, blerësi sipas mendimit të përgjithshëm duhet të ofrojë kohë të mjaftueshme që të kontaktojë me personin e tretë, si dhe të kërkojë këshillë juridike nga avokati.⁶⁹² Megjithatë, blerësi nuk guxon të parashtrojë ankesën derisa me qartësi të mjaftueshme nuk e ekzaminon kërkesën e personit të tretë.⁶⁹³

Në doktrinë ekziston mendimi që, me rastin e kalimit të afatit të arsyeshëm, duhet të krahasohen, dhe blerësi duhet të paralajmërojë shitësin për ekzistimin real të së drejtës ose

⁶⁹⁰ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 449.

⁶⁹¹ Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2417.

⁶⁹² Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 507; Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2417.

⁶⁹³ Fritz Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2417; Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 449.

pretendimin e personit të tretë. Nëse flitet për ankesën dhe për ekzistimin e afatit të arsyeshëm real duhet të zgjatet dhe ai të jetë sa më i gjatë. Në këtë rast blerësi duhet me precizitet të konstatojë pozitën juridike të personit të tretë, dhe duhet të aprovojë edhe kohën e nevojshme për marrjen e këshillës juridike. Përkundër kësaj, nëse blerësi e njofton shitësin për pretendimet e personit të tretë afati duhet të jetë më i gjatë, sepse njoftimi nuk duhet të përmbajë vlerësimin më të rëndë juridik të personit të tretë.⁶⁹⁴ Sipas mendimit tonë, një qëndrim i tillë nuk është pranuar sepse shkon në ngarkesën e rëndësishme të blerësit.

Afati shkurtohet vetëm atëherë kur njoftimi është i nevojshëm, i shpejtë, dhe kjo për shkak të ndalimit të veprimit të dëmit të pakthyesëm,⁶⁹⁵ gjegjësisht kur shitësi mund të humbasë të drejtat e veta në mall. Para së gjithash, varet nga rasti kur personi i tretë përmbush ose dëshiron të përmbushë posedimin në mall (p.sh. kur personi i tretë merr mallin duke u thirrur në të drejtën e posedimit ose e drejta e premtimit në mall).

Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve nuk parasheh se në cilin afat blerësi është përgjegjës që të lajmërojë shitësin për të metat juridike. E konsiderojmë që në cakun e zbulimit të mungesave mund të bëhet zbatimi analog i nenit 467, i LMD-së, norma të cilat rregullojnë afatin për njoftimin e shitësit për të metat materiale. Sipas kësaj, blerësi do të duhej që pa vonesë të njoftojë shitësin për të drejtat ose kërkesat e personit të tretë.

IV. 9.3.3. Afati i fundit për njoftim

Konventa e Vjenës nuk parasheh afatin absolut për kufizimin e kohës për njoftimin e të metave juridike.⁶⁹⁶ Shkaku qëndron në atë se vendimet për të drejtat e personit të tretë shumë shpesh pasojnë pas një kohe të gjatë. Parashikimi i afatit më të shkurtër për njoftim do të ishte përgjegjësi e shitësit dhe do të jetë aq e kufizuar sa që do të humbiste vlerën praktike. Kjo megjithatë nuk do të thotë që blerësi duhet të lajmërojë shitësin për të metat juridike në çdo kohë. Megjithatë, ankesa nuk mund të parashtrahet sërish sepse ka ardhur deri te vjetërsimi i kërkesës së personit të tretë. Afati i vjetërimit fillon të rrjedhë nga momenti i dorëzimit. Meqë Konventa e Vjenës nuk përmban rregulla për vjetërsimin dhe aplikohen edhe rregullat e Konventës për

⁶⁹⁴ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 2417.

⁶⁹⁵ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 2417.

⁶⁹⁶ Në *Konventën e Vjenës* nuk është pranuar propozimi që dihet edhe për të metat juridike të cilat e fusin afatin prekluziv prej dy vjetësh. Shih më shumë: Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 509.

Vjetërsimin të shitja ndërkombëtare e mallit e vitit 1974.⁶⁹⁷ (më poshtë shënohet Konventa për Vjetërsimin) ose rregullat e zbatueshme të së drejtës vendore. Në të kaluarën shteti ynë ka ratifikuar konventën e përmendur. Kjo domethënë që shitësi duhet të jetë i njoftuar për të metat juridike në afatin prej 4 vitesh nga dorëzimi.⁶⁹⁸

IV. 9.3.4. Forma e njoftimit, adresimi dhe rreziku i transfertës

Konventa e Vjenës nuk parasheh kërkesa të veçanta në vështrim të formës së ankesës. Sipas kësaj, ajo mund të jetë joformale, gjegjësisht shitësi duhet të shprehet me gojë. Sigurisht, për shkak të dëshmisë më të lehtë në rast të konfliktit eventual propozohet që ankesa të jetë në formë të shkruar.

Është e nevojshme të kthehemi në përkthim të konventës. Neni 43, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës parasheh që blerësi humbet mundësinë që të thirret në mungesën juridike nëse shitësit nuk i vendoset lajmërimi (njoftimi). Nga kjo mund të nxirret përfundimi, se është e nevojshme që lajmërimi të jetë në formën e shkruar. Për formën e ankesës, për adresimin dhe rrezikun e bartjes vlen mutatis mutandis krejt çka është e thënë përpara te njoftimi për jokonformitetin e mallit të dorëzuar.

Edhe LMD pranon parimin se joformaliteti parashihet vetëm kur blerësi detyrohet të njoftojë shitësin për të metat juridike, derisa për mënyrën e lajmërimit vendos blerësi. Konsiderojmë që në vështrim të formës së njoftimit duhet të aplikohet ajo çka është vendosur më parë për njoftimin e të metave juridike.

IV. 9.4. Përrjashtimet nga detyrimi i njoftimit

Konventa e Vjenës parasheh rregull të ashpër që blerësi e humbet të drejtën që të thirret në të metat juridike nëse nuk parashtrohet ankesa. Blerësi me mirëbesim ka lajmëruar shitësin, dhe blerësi mund të thirret në të metat juridike. E para, nëse vetë shitësi ka ditur për të drejtat ose

⁶⁹⁷ Kosova e ka ratifikuar Konventën për vjetërsimin të shitja ndërkombëtare e mallit në vitin 1974 dhe ka hyrë në fuqi më 27.04.1992. Kosovae e ka ratifikuar Protokollin e vitit 11.04.1980. Këto janë ratifikuar nga parlamenti i ish -RSFJ-së dhe Kosova ka qenë pjesë përbërëse e ish -Jugosllavisë.

⁶⁹⁸ Shih më shumë nenin 8, Konventa Europiane për Vjetërsimin të Shitja Ndërkombëtare e Mallit.

për kërkesat e personit të tretë dhe natyrën e saj.⁶⁹⁹ E dyta, nëse blerësi ka arsyeshmëri më të arsyeshme që nuk ka dërguar njoftimin e kërkuar.⁷⁰⁰ Për dallim prej shitjes ndërkombëtare i vetmi cak i njoftimit është që të informojë shitësin për të drejtat ose kërkesat e personit të tretë. Megjithatë njoftimi për të metat juridike nuk çon në humbjen e të drejtave të blerësit.

Në bazë të asaj që u tha më lart, ligji parasheh që blerësi nuk ka të drejtë njoftimi nëse shitësi veç e ka pasur të njohur që e drejta në send kalon te personi i tretë.

IV. 9.4.1. Njohuria e shitësit për të drejtat ose kërkesat e personit të tretë

Nëse shitësi ka ditur për të drejtat ose kërkesat e personit të tretë dhe natyrën e tyre ai nuk mund të thirret në rrethanën që blerësi nuk e ka dërguar njoftimin. Ky vendim është i drejtë, sepse në këtë rast të njoftimit të shitësit humbet kuptimin e dorëzimit të ankesës.

Shitësi është i obliguar të njoftojë shitësin vetëm në rast kur shitësi e ka ditur për të metat juridike, respektivisht vetëm te njohja e natyrës pozitive dhe për ekzistimin e së drejtës ose kërkesat e personit të tretë. Neni 43, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës, parasheh se nuk është e mjaftueshme dhe e tejkalon mosnjohjen ose pakujdesinë, nga pakujdesia e rëndë.

Shitësi duhet të dijë jo vetëm që ekziston e drejta ose kërkesa e personit të tretë, por edhe natyrën e të metave juridike. Parashtrahet pyetja, cilat fakte ai duhet t'i dijë që të mund të zbatohet neni 43, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës. Gjithsesi kjo duhet të jetë e dhëna të cilën shitësi do të dinte nga njoftimi i arsyeshëm dhe konkret i blerësit; ai duhet të dijë se cili person përmend kërkesën, si përmbajtje të kërkesës. Nuk është e mjaftueshme për masat të cilat veç i ka marrë në përgjegjësi personi i tretë. Shkaku për këtë qëndrim shtrihet në paralele në mes njohjes së shitësit dhe përmbajtjes së njoftimit. Nëse blerësi shitësin e ka njoftuar për të metat juridike para se të ndërmarrë masa personi i tretë, blerësi sipas nenit 43, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës nuk është i detyruar që për këtë të njoftojë shitësin.⁷⁰¹ Sipas mendimit tonë, blerësi do të duhej që në bazë të detyrimit të përgjithshëm me mirëbesim të vepronte edhe për këtë të lajmërojë shitësin. Lancimi i një njoftimi të tillë, megjithatë nuk do të dërgonte kah humbja e të

⁶⁹⁹ *Konventa e Vjenës*, neni 43, paragrafi 2.

⁷⁰⁰ Po aty, neni 44.

⁷⁰¹ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 544.

gjitha të drejtave të blerësit, por shitësit i jepet e drejta sipas nenit 77 të Konventës së Vjenës, normë e cila ndikon në kërkesën për zvogëlimin e kompensimit e dëmit.⁷⁰²

Neni 43, i Konventës së Vjenës nuk përcakton momentin, kur duhet të ekzistojë njohuria e shitësit. Koha e përmbylljes së kontratës, si dhe koha e dorëzimit nuk mund të jenë relevante sepse natyra e së drejtës ose kërkesat e personit të tretë rrallë janë me njohuri për këtë fazë.⁷⁰³ Shembulli që derivon nga neni 43, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës paraqet shembull të nenit 43, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Për shkak të kësaj çështjeje në teori dominon qëndrimi që, shitësi duhet të ketë njohuri për ekzistimin e natyrës së të drejtave të personit të tretë më së voni deri te kalimi e afatit për njoftim.⁷⁰⁴ Sipas mendimit tjetër, njoftimi për të metat juridike duhet të ekzistojë në kohën e dorëzimit.⁷⁰⁵ Konsiderojmë që shitësi mund potencojë njohuritë për të metat juridike në secilin moment nga shuarja e kontratës deri te kalimi i afatit të arsyeshëm për njoftim. Kjo domethënë që duhet të pranohen qëndrimet e para sepse ky është edhe caku kryesor i njoftimit që shitësi të mbrohet nga kërkesat e personit të tretë, dhe për të drejtat e shitësit me mirëbesim për kohën kur lajmërimi duhet të mbërrijë deri tek ai.

Sipas LMD-së detyrimi i ankesës nuk ekziston kur shitësi veçse e ka pasur të ditur që personi i tretë fiton një të drejtë në send. Sipas kësaj në të drejtën tonë nuk është i detyruar ta lajmërojë shitësin për të metat juridike kur shitësi për to ka njohuri.

IV. 9.4.2. Arsyetimi i arsyeshëm për mospërmbushje të detyrimit të njoftimit

Blerësi nuk e humb të drejtën që të thirret në ndonjë të metë edhe kur nuk e kryen detyrimin e vet që sendin ta kontrollojë pa shtyrje ose detyrimin që brenda afatit të caktuar ta njoftojë shitësin mbi ekzistimin e të metës, si dhe kur e meta është shfaqur vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga dorëzimi i sendit, po qe se për këtë të metë shitësi ka qenë në dijeni apo nuk ka mundur të jetë në dijeni.⁷⁰⁶

⁷⁰² Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 452.

⁷⁰³ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 510.

⁷⁰⁴ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2418; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 510; Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 452; Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 544.

⁷⁰⁵ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 172.

⁷⁰⁶ LMD, neni 468.

Te shitja ndërkombëtare e mallit, blerësi mund të kërkojë kompensimin e dëmit edhe nëse nuk e ka njoftuar shitësin për të metat juridike. Është e nevojshme që ka arsyetim të arsyeshëm që nuk ka dërguar njoftimin e kërkuar nga neni 43, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës.⁷⁰⁷ E gjithë ajo që u potencua më lart është shembull nga detyrimi i njoftimit të dorëzimit të mallit jokonform për shkak të ekzistimit të arsyeshëm për mosdhënien e njoftimit duhet *mutatis mutandis* të aplikohet edhe këtu.

IV. 9.5. Të metat juridike për të cilat shitësi nuk përgjigjet

Shitësi nuk do të përgjigjet për eviksionin edhe përkundër asaj nëse janë përmblusur të gjitha supozimet e tij për përgjegjësinë dhe nëse blerësi përmblidhet që të pranojë mallin me të metat juridike. Neni 41, Konventa e Vjenës përmban të drejtat të cilat çojnë në rezultat të njëjtë, por formulimi është diçka më ndryshe. Është paraparë që shitësi përgjigjet nëse blerësi nuk është njoftuar për të drejtat e personit të tretë, ai as që ka pranuar që të marrë sendin me barrë. Në të kundërt, shitësi nuk do të përgjigjet nëse blerësi pranon që të pranojë mallin me të metat juridike. Për pranimin e mallit është e mjaftueshme, që blerësi të ketë ditur që malli është ngarkuar me të drejtën e personit të tretë.

Për dallim nga përgjegjësia për konformitetin e mallit, gjegjësisht për të metat materiale të tij ku shitësi nuk përgjigjet, nëse blerësi në kohën e shuarjes së kontratës ka ditur për të metat ose ajo nuk ka mundur të jetë e panjohur për të, te përgjegjësia për të metat juridike është e nevojshme edhe pëlqimi i blerësit. Sipas kësaj, nuk është e mjaftueshme që blerësi e di që në mall ekziston një e drejtë e premtuar transportuesit ose magazinierit, sepse në rastet e tilla blerësi do të duhej të priste që shitësi para dorëzimit të lirojë mallin nga barra.

Blerësi vullnetin e vet që të pranojë mallin me barrë me të drejtë të personit të tretë mund ta japë edhe shprehimisht edhe heshturazi. Ai mund ta bëjë këtë në secilin moment, me fjalë të tjera para kohës edhe pas shuarjes së kontratës. Është me rëndësi që blerësi të shpreh dëshirën e tij dhe që të pranojë mallin me të meta. Nga kjo nuk kanë rëndësi deklaratimet e njëanshme të shitësit, që blerësi me pranimin e mallit pranon edhe të metat juridike, sepse aty nuk ekziston dëshira e blerësit, dhe kjo do të paraqiste vetëm vullnetin e njëanshëm.

⁷⁰⁷ Konventa e Vjenës, neni 44.

Sipas doktrinės së shitjes ndërkombëtare të mallit marrja e paarsyeshme e mallit nga ana e blerësit me njohjen e të metave juridike nuk paraqet pranim. Gjithashtu, nuk është e mjaftueshme që njoftimi i përgjithshëm i blerësit për të metat faktike dhe rrethanat juridike të cilat tregojnë për ekzistimin, për shembull të mjeteve të sigurimit të mallit. Deklarimi paraqet më shumë se njoftimi i blerësit. Nga kjo është e nevojshme që ekzistimi i shkëndizave të mëtejshme, të cilat flasin për kontributin dhe miratimin e blerësit, domethënë që blerësi e kupton që malli ka të meta juridike për të cilat shitësi nuk do të përgjigjet.⁷⁰⁸ Një tregues i tillë do të jetë marrja në konsideratë e të drejtave ose kërkesave të personit të tretë me rastin e përcaktimit të çmimit. Ky do të jetë rasti që me rastin e shuarjes së kontratës për shitjen blerësi pranon që të bartë të gjitha shpenzimet e pamatura të magazinimit të mallit të magazinuar. Sipas rregullit kjo situatë do të vijë deri te zvogëlimi i çmimit, dhe supozohet që blerësi ka pranuar të blejë mallin në të cilin ka ekzistuar premtimi i drejtë i magazinuesit.⁷⁰⁹

Gjithashtu, deklarimi i përmbledhur i blerësit supozohet atëherë kur vetë shitësi lajmëron blerësin për të drejtën ose për kërkesat e personit të tretë, dhe në këtë rast blerësi nuk parashtrohet ankesë.⁷¹⁰ Dhe e fundit, kur shitësi lajmëron blerësin që në mall ekziston mjete i sigurimit dhe duhet të llogarisë që çmimin e blerë t'ia paguajë direkt personit të tretë, pranimi pa kusht i mallit nga ana e blerësit dhe nga ana e tij tregon deklarimin e tij për atë mostër.⁷¹¹

IV. 10. Përgjegjësia e shitësit, përgjegjësi kur në mallin e shitur ekziston e drejta ose kërkesa e cila krijohet në pronësinë industriale ose intelektuale

Nëse në mallin e shitur ekziston e drejta e pronësisë industriale dhe intelektuale kjo sipas nenit 41 të Konventës së Vjenës, paraqet të metat juridike. Shitësi duhet të dorëzojë mallra të cilat janë të çliruara nga çdo e drejtë ose pretendim, përveçse kur blerësi ka rënë dakord t'i marrë ato sipas kësaj të drejte apo pretendimi. Megjithatë, në qoftë se kjo e drejtë ose pretendim bazohet në pronësi industriale ose në një pronësi tjetër intelektuale, detyrimi i shitësit rregullohet

⁷⁰⁸ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2407; Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 432; Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 536.

⁷⁰⁹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 490.

⁷¹⁰ Jochen Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 536.

⁷¹¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 490; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2833.

nga neni 42⁷¹² i konventës. Megjithatë përgjegjësia e shitësit në këtë rast është e rregulluar me normën e veçantë (neni 42 i Konventës së Vjenës), e cila për të është më e përshtatshme nga rregullat e përgjithshme nga neni 41, i Konventës së Vjenës. Shitësi duhet të dorëzojë mallra të cilat janë të çliruara nga çdo e drejtë ose pretendim të një pale të tretë, të bazuar në pronësinë industriale ose në një pronësi tjetër intelektuale, për të cilat në kohën e lidhjes së kontratës shitësi kishte dijeni ose nuk mund të mos kishte dijeni, nëse e drejta ose pretendimi bazohej në pronësinë industriale ose në një pronësi tjetër intelektuale: a) sipas ligjit të shtetit ku do të rishiten ose në të kundërt ku do të përdoren mallrat, në qoftë se nga palët ishte parashikuar në kohën e lidhjes së kontratës se mallrat do të rishiteshin ose në të kundërt do të përdoreshin në këtë shtet, ose b) në çdo rast tjetër, sipas ligjit të shtetit ku blerësi ka vendin e tij të biznesit.⁷¹³ Kur në mall ekziston e drejta e pronësisë intelektuale paraqiten të metat juridike. Në të ardhmen kur supozimet e përgjegjësive së shitësit janë ndryshe, janë përcaktuar vetëm që t'i trajtojmë në një pjesë të veçantë.

ULIS-i nuk e ka përmbajtur normën paralele, por në nenin 52, sipas kuptimit të gjerë⁷¹⁴ është përfshirë edhe përgjegjësia e shitësit kur në mall ekziston ndonjë e drejtë e pronësisë intelektuale. Përkundër kësaj, prof Tunc në këtë komentari të ULIS-it analizon nenin 52 të ULIS-it, në kuptimin e pronësisë së personit të tretë, dhe jo në kuptimin e pronësisë intelektuale.⁷¹⁵

Në të drejtat nacionale, dhe në atë shqiptare, LMD-ja detyrimin e shitësit që të garantojë për mallin është i lirë nga e drejta e pronësisë intelektuale të personit të tretë dhe kualifikohet në përgjegjësinë e përgjithshme, përgjegjësia e rëndë e shitësit është e arsyetuar sepse ai nuk mund të ketë në vështrim të drejtën e pronësisë intelektuale në shtetin e vet. Megjithatë, për shkak të natyrës territoriale të këtyre të drejtave, në tregtinë ndërkombëtare nuk mund të kërkohej nga shitësi që të garantojë që malli është i lirë nga e drejta e pronësisë intelektuale në të gjithë vendin. Pikërisht për këtë që u përmend më lart, përgjegjësia e shitësit për dorëzimin e mallit të liruar nga e drejta e të mirave materiale të personit të tretë është, në raport me përgjegjësinë për të metat juridike sipas vendimeve që përmban Konventa e Vjenës, është më e butë. Shitësi

⁷¹² Konventa e Vjenës, neni 41.

⁷¹³ Po aty, neni 42, paragrafi 2.

⁷¹⁴ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 495.

⁷¹⁵ Commentary on the Hague Conventions of the 1st of July 1964 on International Sale of Goods and the Formation of the Contract of Sale, www.cisg.law.pace.edu. Gjithashtu, Honnold, Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention, fq. 293.

përgjigjet për mosekzistimin e të drejtave jomateriale në territorin e kufizuar edhe vetëm në rast të jokonformitetit të tij.

Me rastin e krijimit të Konventës së Vjenës kjo pyetje nuk është trajtuar deri te faza më e vonshme, sepse është konsideruar që për arsye të kompleksitetit të të tërë materies dhe të asaj në përgjithësi, nuk duhet të jetë e rregulluar në Konventën e Vjenës. Megjithatë pas kritikave dhe mbërritjes të qeverive të shumë shteteve, po ashtu edhe te Oda Ndërkombëtare e Tregtisë, është formuluar rregulli i shprehur në të cilin është rregulluar përgjegjësia e shitësit për rastin, pra që në mall ekziston e drejta e pronësisë intelektuale e personit të tretë. Caku ka qenë që përgjegjësia e shitësit, në këtë rast, përmban kornizat e parapara.⁷¹⁶ Neni 42 i Konventës së Vjenës zbatohet vetëm në raport të palëve kontraktuese nga kontrata e shitjes. Përkundër kësaj, çështja kërkon titullarin e së drejtës së pronësisë intelektuale sepse sipas kësaj e drejta e blerësit është e rregulluar me të drejtën nacionale.

Për praninë e përgjegjësisë së shitësit është e nevojshme që të jenë përmbushur kushtet e mëposhtme. E para, për mallin e shitur duhet të ekzistojë e drejta ose kërkimi, i cili nuk bazohet në pronësinë industriale dhe intelektuale. E dyta, e drejta ose kërkimi i bazuar në të drejtën e të mirave jomateriale duhet të ekzistojë në territorin e caktuar. E treta, mungesa juridike duhet të ekzistojë në kohën e dorëzimit. E katërta, shitësi në kohën e shuarjes së kontratës duhet të di për ekzistimin e së drejtës. E pesta, blerësi duhet që në afat të arsyeshëm të njoftojë shitësin për ekzistimin e të metave. Në fund, është e nevojshme që të ekzistojnë rrethanat që çojnë në shuarjen e përgjegjësisë së shitësit.

IV. 10.1. E drejta e personit të tretë për kërkimin e të drejtave të cilat krijohen në pronësinë intelektuale dhe industriale

Shitësi është i detyruar që mallin ta lirojë nga secila e drejtë ose nga çdo kërkesë e personit të tretë që krijohen në pronësinë intelektuale dhe industriale. Në Konventën e Vjenës përdoren nocionet e drejta e pronësisë intelektuale dhe industriale. Nocioni e drejta e pronësisë industriale dhe intelektuale është përfshirë me kuptimin e përgjithshëm si e drejta e pronësisë intelektuale. Pronësia intelektuale është e drejta ligjore mbi krijimtarinë intelektuale në fushën e

⁷¹⁶ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 495 dhe te Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq.439.

industrisë, shkencës, letërsisë dhe arteve.⁷¹⁷ Kjo tejkalon nga teksti i konventës meqë flitet për të drejtën industriale ose e dyta për pronësinë intelektuale. Megjithatë Konventa e Vjenës nuk e përcakton asnjërin nga nocionet e përmendura më lart, dhe nga përmbajtja e tyre duhet të vijmë deri tek interpretimi i saj. Si ndihmë e përcaktimit të nocionit pronësia intelektuale, nga neni 42, Konventa e Vjenës sipas komenetaritit UNICITRAL-it, duhet të përdoret përcaktimi i përsirë në Konventën e krijimit të Organizatës Botërore për pronësinë intelektuale (EİPO) në 14.07.1967.⁷¹⁸ Sipas nenit 2, paragrafi 8, të Konventës së përmendur, shprehja pronësia intelektuale përcakton të drejtat të cilat varen nga veprat letrare, artistike dhe shkencore. Interpretimi i artistëve dhe i interpretuesve nga performanca e autorëve dhe interpretuesve, fonograme dhe emisione të radios, gjetjet në të gjitha fushat e aktivitetit të njeriut, zbulimet shkencore, shkaqet industriale dhe modelet, mostrat e shërbimeve të ndërmarrjeve dhe ato tregtare, si emrat tregtar dhe thirrjet tregtare, mbrojtjen kundër lojës jolojale dhe të gjitha të drejtat e varura nga aktiviteti intelektual në industri, shkencë, letërsi dhe në fushën artistike.⁷¹⁹

E drejta e pronësisë intelektuale, nga neni 42 i Konventës së Vjenës, duhet të kuptohet në kuptimin më të gjerë si nocion i pavarur nga kushtet e mbrojtjes së të drejtës së veçantë të llojit dhe të mbrojtjes së garantuar. Nuk është e rëndësishme sesi është e rregulluar me normat nacionale, por ekziston detyrimi i regjistrimit, se në cilën mënyrë realizohet mbrojtja juridike. Gjithashtu me këtë nocion janë përfshirë jo vetëm të drejtat si një e drejtë kombëtare, që i përfshin ligji, po si e drejtë e pronësisë intelektuale, por edhe ajo e drejtë së cilës i nënshtrohen mbrojtja e përgjithshme deliktore.⁷²⁰

Të përfundojmë, të metat juridike ekzistojnë nëse në mall ekziston e drejta e pronësisë intelektuale të personit të tretë, dhe me kuptimin e drejtë e pronësisë intelektuale janë të përfshira të gjitha të drejtat të cilat shërbejnë për mbrojtjen e krijimeve intelektuale në fushën e shkencës, industrisë dhe artit dhe kanë ndikim në mundësinë e përdorimit ose të shitjes së mëtejshme të mallit.

⁷¹⁷ Fatos Dega, “Pronësia Intelektuale”, Shtëpia Botuese Morena, Tiranë 2012, fq. 20.

⁷¹⁸ UN DOC. A/CONF. 97/5 (Komentari i UNICITRAL-it), Official Records fq. 37, neni. 40/1.

⁷¹⁹ Përcaktimi i kuptimit të pronësisë intelektuale të cilën e përmban neni 2, paragrafi 8, i Konventës për krijimtarinë WIPO, është shumë i gjerë dhe paraqet konsensusin e bashkësisë ndërkombëtare rreth pronësisë intelektuale. Shih më shumë si në konventat relevante të konventave nga kjo fushë. Shih më shumë: *Rauda, Etier, Warranty for Intellectual Property Rights in the International Sale of Goods*, Vindobona Journal of International Commercial Law and Arbitration, Issue 1/2000, fq. 33.

⁷²⁰ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2409; Jochen Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 538.

Në praktikë në tregtinë ndërkombëtare ngarkesa e mallit me patentë, mostër ose me të drejtën e autorit është e rëndësishë së madhe. Sipas nenit 42, të Konventës së Vjenës, ekziston shkelja e së drejtës edhe kur shitësi dorëzon mjetin i cili punon sipas veprimit të patentuar nëse shitësi nuk ka posedim të patentës për këtë veprim. Parashtrohet pyetja se a duhet të aplikohet neni 42, i Konventës së Vjenës, edhe kur në makinën e dorëzuar nuk ekziston patentë, por ajo vepron për prodhimin e prodhimeve të patentuara. Përgjigjja varet nga ajo se në cilën mënyrë mund të përdoret mjeti i dorëzuar. Nëse ekziston mundësia që makina të përdoret në mënyrën në të cilën nuk shkelet patentë e personit të tretë, atëherë blerësi është i detyruar që ta përdorë ashtu si është. Nëse, përkundër kësaj, i vetmi përdorim i menduar i makinës përmbahet në prodhimin e prodhimeve të patentuara, atëherë duhet të aplikohet neni 42, i Konventës së Vjenës, gjegjësisht në këtë rast ekziston shkelja e së drejtës.

Kërkimet (pretendimet) e personit të tretë përshihen në nenin 42, të Konventës së Vjenës, dhe si përfundim ekziston e drejta e pronësisë intelektuale të personit të tretë. Në bazë të kësaj pikëpamjeje të zbatueshme të së drejtës nacionale nuk ka kuptim, a është e vërtetë që kjo e drejtë ekziston. Gjithashtu, shitësi do të përgjigjet edhe kur kërkesa e personit të tretë është krijuar, edhe nëse nuk janë përmbushur të gjitha propozimet e përgjegjësisë së tij. Për përgjegjësinë e blerësit është e mjaftueshme që ajo të jetë e ngadalshme dhe ai të jetë jo i kufizuar për përdorimin e mallit. Shembulli kur malli ka mostër të ngjashme me mostrën e mbrojtur, në vështirësi të së cilit shitësi beson që nuk ekziston rreziku nga përzierja, por pronari i mostrës së tillë potencon kërkesat sipas blerësit.⁷²¹ Me parashikimin që të metat juridike ekzistojnë edhe në rast të kërkimeve të personit të tretë, blerësi është i mbrojtur nga ngarkesa e cila me vete bart konfliktin eventual me poseduesin e përmendur të së drejtës.

IV. 10.2. Kufizimi territorial

Kufizimi territorial i vazhdimet të së drejtës intelektuale ka si shkak pasojën direkte të kufizimit të përgjegjësisë së shitësit vetëm në shtetet e përcaktuara. Siç e kemi thënë edhe më lart do të ishte shumë e ashpër që nga shitësi të kërkohej që të mos t'i garantohet blerësit, se nuk ekziston e drejta e pronësisë intelektuale. Një kërkesë e tillë nuk do të kishte kuptim. Interesi i blerësit është që mallin ta shesë ose ta përdorë edhe më tutje pa pengesa. Blerësi nuk ka interes

⁷²¹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 498.

që malli të jetë i lirë nga e drejta e pronësisë intelektuale jashtë shtetit të përdorimit. Pikërisht për këtë, që është përmendur më lart, shitësi është përgjegjës që të garantojë që malli duhet të jetë i lirë nga e drejta e pronësisë intelektuale ose industriale vetëm në territorin e caktuar, domethënë në shtetin në të cilin blerësi shtesë të vendosë që mallin më tutje ta shesë ose ta përdorë edhe në shtetet e tjera, në të cilat blerësi planifikon më tutje ta shesë mallin. Nëse blerësi me shtesë vendos që mallin ta shesë më tutje ose ta përdorë edhe në shtetet e tjera, në të cilat ekzistojnë të drejtat subjektive të së drejtës së pronësisë intelektuale të personit të tretë, atëherë ai është përgjegjës që të fitojë të drejtat e nevojshme (p.sh. licencën).

E drejta bazë është që malli duhet të jetë i lirë nga e drejta e pronësisë intelektuale, sipas së drejtës së shitjes së mëtejshme ose përdorimit të mallit.⁷²² Nëse palët para shuarjes së kontratës nuk kanë pasur në mendje shtetin e përdorimit vlen pronësia intelektuale sipas së drejtës së shtetit në të cilën blerësi në kohën e shuarjes së kontratës e ka pasur selinë.⁷²³

IV. 10.2.1. Shteti i përdorimit të mallit

Malli nuk guxon të ngarkohet me të drejtën ose kërkimin i cili krijohet në pronësinë intelektuale ose industriale sipas së drejtës në të cilën malli do të shitet më tutje ose do të përdoret në ndonjë mënyrë tjetër, nëse palët në kohën e shuarjes së kontratës kanë pasur parasysh që malli të shitet më tutje ose në një mënyrë tjetër të përdoret në atë shtet.⁷²⁴

Edhe pse neni 42 paragrafi 1, pika a, e Konventës së Vjenës përdoret fjala shtet në njëjës dhe është e mundur që të jetë i zbatueshëm më shumë sipas urdhrave nga shumë shtete.⁷²⁵ Një përfundim i tillë tejkalon si më poshtë. E para, pjesëmarrja që shitësi është përgjegjës për ekzistimin e pronësisë intelektuale vetëm në një shtet do të çojë deri te kufizimi i lirisë së kontraktimit. E dyta, paraqitja e mallit dhe përdorimi i dytë në nenin 42, paragrafi 1, pika a, e Konventës së Vjenës nuk janë kuptuar në mënyrë alternative, por mund të aplikohen më herët kumulativisht.⁷²⁶ Është shumë e qartë që malli do të përdoret në disa shtete dhe do të shitet në një shtet, e pastaj një mënyrë tjetër e përdorimit të mallit në njërin ose në disa shtete. Shitësi

⁷²² *Konventa e Vjenës*, neni 42, paragrafi 1, pika a.

⁷²³ Po aty, neni 42, paragrafi 1, pika b.

⁷²⁴ *Konventa e Vjenës*, neni 42, paragrafi 1, pika a.

⁷²⁵ *Qëndrim të kundërt kanë Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, vepër e cituar, fq. 169.*

⁷²⁶ *Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, vepër e cituar, fq. 500; Rauda, Etier, vepër e cituar, fq. 51.*

përgjigjet për ekzistimin e pronësisë intelektuale në të gjitha ato shtete,⁷²⁷ por vetëm me kushtin që palët në kohën e shuarjes së kontratës kanë pasur të njohur mundësinë e përdorimit të mallit në të gjitha këto shtete. Nëse shitësi nuk dëshiron të përgjigjet për të drejtat e pronësisë intelektuale të personit të tretë në shtete të ndryshme, ai mundet që në kontratë të shuajë përgjegjësinë e tij në atë aspekt. Përkundër kësaj blerësi pas shuarjes së kontratës përcakton shtetet në të cilat pretendon ta përdorë mallin, dhe ai vetë duhet të kujdeset që me këtë të mos dëmtojë të drejtat e pronësisë intelektuale të personave të tretë.

Sipas nenit 42, paragrafi 1, pika (a), e Konventës së Vjenës është supozim që palët në kohën e shuarjes së kontratës për shitjen kanë pasur të njohur mundësinë e shitjes së mëtejshme ose mundësinë e përdorimit të mallit, në njërën ose në disa shtete. Nuk kërkohet që palët të kontraktojnë vendin e përdorimit të mallit, por është e mjaftueshme që me rastin e shuarjes së kontratës ta marrin këtë parasysh. Është shumë e rëndësishme kur të dyja palët kontraktuese e kanë të njohur atë që malli të përdoret në shtetin e caktuar. Parashtrohet pyetja, a mundet shitësi të kuptojë shtetin e përdorimit të mallit nëse sipas kontratës malli duhet të dërgohet në shtetin përkatës? Sipas një qëndrimi, është e nevojshme që edhe rrethanat e tjera të tregojnë për shtetin e përdorimit të mallit dhe të ekzistojnë udhëzime për përdorimin e planifikuar të mallit në vendin e përcaktimit,⁷²⁸ ose për nga natyra e mallit tejkalon atë që ajo të përdoret atje.⁷²⁹ Qëndrimi tjetër është qëndrim i cili përcakton që, është e rëndësishme që në kontratë të përmendet vendi në të cilën malli dërgohet.⁷³⁰ E konsiderojmë që qëndrimi i parë është i drejtë, gjegjësisht shënjimi i vendit të dorëzimit është vetëm aluzion dhe është nevojë për aplikimin e nenit 42, paragrafi b, pika a, e Konventës së Vjenës, që është e nevojshme edhe ekzistimi i rrethanave të tjera që tregojnë shtetin ku do të përdoret malli. Kjo do të jetë shembulli, nëse me rastin e shuarjes së kontratës blerësi ka kërkuar dorëzimin e mallit në shtetin e caktuar ose nëse blerësi e di se në cilat shtete blerësi duhet të tregtojë mallin e shitur.⁷³¹ Dhënia e adresës shtesë të dorëzimit të shitësi nuk është mjaftueshme.⁷³² Sipas mendimit tonë, në interes të të dyja palëve kontraktuese është e qartë se në kontratë të dyja palët kontraktuese duhet të përcaktojnë vendin e përdorimit të mallit.

⁷²⁷ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2411; Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 442.

⁷²⁸ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 2412.

⁷²⁹ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 441.

⁷³⁰ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2412.

⁷³¹ Jochen Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 539.

⁷³² Po aty, *vepër e cituar*, fq. 539.

Nëse shteti i shitësit, për shitjen e mallit e parasheh vendin e përdorimit, atëherë shitësi duhet të garantojë që malli është i lirë nga e drejta e pronësisë intelektuale në atë shtet.

IV. 10.2.2. Shteti i selisë së blerësit

Nëse palët me rastin e shuarjes së kontratës nuk kanë pasur në mendje shtetin në të cilin malli do të përdoret, aplikohet edhe rregulla shpesh. Në këtë rast, malli duhet të jetë i lirë nga secila e drejtë ose nga kërkimi i personit të tretë, të cilat fitohen në të drejtën e pronësisë industriale dhe intelektuale sipas së drejtës së shtetit në të cilin blerësi ka selinë.⁷³³ Në shumicën e rasteve, në shtetin në të cilin blerësi ka selinë, a priori dhe me vetëdije bën përdorimin e mallit. Në këtë rast zbatohet e drejta e shtetit në të cilin blerësi ka pasur selinë në kohën e shuarjes së kontratës. Sipas kësaj, ndryshimi i mëvonshëm i selisë nuk ka rëndësi për përgjegjësinë e shitësit.

Për përcaktimin e nocionit seli aplikohet neni 10, i Konventës së Vjenës. Nëse blerësi ka më shumë seli merret në konsideratë selia e cila ka lidhjen më të ngushtë me kontratën dhe përmbushjen e saj. Nëse blerësi nuk e ka selinë, merret në konsideratë vendbanimi ose vendqëndrimi i tij i rregullt.

IV. 10.3. Koha për ekzekutimin e të drejtave ose kërkesave të personit të tretë të cilat krijohen në pronësinë intelektuale

Përgjegjësia e shitësit do të jetë e pranishme nëse malli nuk është i lirë nga e drejta ose pretendimet e personit të tretë, të cilat krijohen në pronësinë intelektuale të personit të tretë në kohën e dorëzimit të mallit. Gjithashtu neni 42, i Konventës së Vjenës, aplikohet edhe kur kërkesa e personit të tretë bëhet pas dorëzimit. Në këtë rast, me rastin e vlerësimit se a është malli i lirë nga e drejta e pronësisë intelektuale e personit të tretë duhet të vërtetohet se a janë rrethanat e tilla kur edhe është bërë kërkesa para dorëzimit apo pas dorëzimit tij.

Koha e shuarjes së kontratës nuk është e përshtatshme për përcaktimin se a ekziston e meta juridike. Ajo ka rëndësi për përcaktimin e ndërgjegjësimit të palëve kontraktuese dhe për

⁷³³ Konventa e Vjenës, neni 42, paragrafi 1, pika b.

përcaktimin e shtetit në të cilin malli do të përdoret. Në rrethana të tilla që, në kohën e shuarjes së kontratës, ekziston edhe e drejta e pronësisë intelektuale e personit të tretë, kjo nuk dërgon në përgjegjësi të shitësit, sepse ai deri te dorëzimi mund të rregullojë raportin me personin e tretë si, për shembull, me fitimin e licencës.

IV. 10.4. Njohuritë e shitësit

Shitësi sipas nenit 42, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, do të përgjigjet vetëm për ato të drejta ose kërkesa të cilat krijohen në pronësinë intelektuale, nëse në momentin e shuarjes së kontratës ka qenë e njohur ose nuk ka qenë e mundur të jetë e panjohur. Për dallim nga përgjegjësia për të metat juridike nga neni 41, i Konventës së Vjenës, shitësi duhej të përgjigjet sipas nenit 42, të Konventës së Vjenës, vetëm kur ka ekzistuar e drejta e pronësisë intelektuale e personit të tretë dhe kur e ka ditur këtë fakt dhe kur ka qenë e pamundur të jetë e panjohur.

Në njohuritë e shitësit, që malli ka qenë i ngarkuar me të drejtën e pronësisë intelektuale të personit të tretë, kuptohet njohuria reale e shitësit. Nëse shitësi e di që ekziston ndonjë e drejtë ose ndonjë e drejtë e personit të tretë, ai për këtë do të lajmërojë blerësin me shuarjen e kontratës dhe në këtë mënyrë do të tejkalojë përgjegjësinë.

Formulimet nuk kanë mundur të jenë të panjohura dhe përdoren në disa vende në Konventën e Vjenës. Në shqyrtimet e mëhershme kemi parë që fjalët nuk kanë mundur të mbeten të panjohura dhe këto paraqesin pakujdesi të rëndë. Megjithatë, në doktrinë nuk ekziston qëndrimi që formulimi i përmendur do të thotë që është në pyetje përgjegjësia e shitësit për të drejtën e pronësisë intelektuale të personit të tretë. Është konflikt dhe a është shitësi përgjegjës që të kontrollojë dhe të hulumtojë se a ekziston në shtetin përgjegjës e drejta e caktuar, si dhe sa detajisht duhet bërë hulumtimi. Sipas një qëndrimi, shitësi përgjigjet për të gjitha të drejtat e fituara të së drejtës intelektuale në shtetin e përdorimit.⁷³⁴ Duke pasuar më pas, vetëm kur ndonjë e drejtë e pronësisë intelektuale të personit të tretë nuk është e kryer, shitësi nuk do të jetë përgjegjës. Sipas një qëndrimi mbizotërues, shitësi është përgjegjës që të provojë hulumtimet e të

⁷³⁴ UN DOC. A/CONF. 97/5 (Komentar UNCITRAL-a), Official Records, fq. 38, pika 6; Peter Schlechtriem, *Uniform Sales Law*, fq. 74.

drejtave ekzistuese të regjistruara.⁷³⁵ Sipas kësaj dukurie pakujdesia e rëndë ekziston nëse shitësi nuk e ka kontrolluar në regjistrat publikë, në shtetin e shfrytëzimit ose në shtetin në selinë e blerësit, e a ekziston e drejta e personit të tretë.⁷³⁶ Megjithatë, nëse në shtetin e caktuar nuk ekziston regjistri i së drejtës së pronësisë intelektuale, nga shitësi nuk mund të pritët që të dihen të gjitha të drejtat e fituara të pronësisë intelektuale. Në këtë rast, për pakujdesinë e rëndë të shitësit, mund të flitet vetëm nëse flitet për zbatimin e së drejtës për të cilën shitësi e ka pasur më lehtë ta ketë në dispozicion ose të cilën ai nuk ka mundur ta konstatojë lehtë. Me rastin e vlerësimit merret parasysh që edhe blerësi ka lidhje më të afërta me shtetin përdorues, gjegjësisht a është shteti i përdorimit cak në të cilën shitësi rregullisht e dorëzon mallin.⁷³⁷ Gjithashtu, pakujdesia e rëndë e shitësit supozohet kur shitësi rregullisht merr pjesë në prodhimin e mallit ose kur është njoftuar në ekzistimin e së drejtës përgjegjëse.⁷³⁸ Mendimi i tretë, për formulimin kur nuk ka pasur njohuri ose është dashur të mbetet i panjohur, përcakton përgjegjësinë e shitësit në rastet kur me keqbesim ai hesht përpara blerësit për të drejtën e personit të tretë.⁷³⁹

Sipas mendimit tonë, qëndrimi i parë është shumë i ashpër dhe ngarkon rëndë shitësin. Përkundër kësaj, mendimi i tretë, i shpejtë në përgjithësi, liron shitësin nga përgjegjësia, kështu në të ardhmen do të përgjigjet vetëm në rast të veprimit me keqbesim. Nuk është planifikuar sigurisht rezultati nga krijuesit e Konventës së Vjenës. Sipas kësaj ne e konsiderojmë që duhet të pranohet qëndrimi tjetër dhe kjo për disa arsye. E para, obligimi i shitësit që të hulumtojë ekzistimin e së drejtës në mall është e arsyetuar sepse ai më së miri e di në këtë vështrimin se për cilat pjesë të mallit mund të ekzistojë kjo e drejtë. E dyta, nëse shitësi nuk do të ketë të drejtën e hulumtimit të të drejtave të regjistruara, detyrimi i tij do të ishte aq i reduktuar saqë do të humbiste secilin kuptim praktik.⁷⁴⁰ Kur nuk do të ekzistonte detyrimi i shitësit që të njihet me të drejtën në vështrim të të drejtave të pronësisë intelektuale, në shtetin e shfrytëzimit, ai gjithmonë do të kishte mundësi që të konstatonte që nuk ka ditur për ekzistimin e të drejtave edhe në këtë mënyrë do të shmangte përgjegjësinë.

⁷³⁵ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 168; John Honnold, *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, fq. 290; Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2835; Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2412; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 502.

⁷³⁶ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 442.

⁷³⁷ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 442, 443. Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2835.

⁷³⁸ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2412.

⁷³⁹ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 168.

⁷⁴⁰ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 502.

Njohuria duhet të ekzistojë në momentin e shuarjes së kontratës. Me vetë këtë fakt më vonë është arritur njohuria e shitësit për ekzistimin e së drejtës së pronësisë intelektuale të personit të tretë që nuk çon në përgjegjësinë e tij. Në këtë rast, ai sipas parimit të vetëdijësimit është përgjegjës që blerësin ta njoftojë për ekzistimin e së drejtës së personit të tretë dhe në këtë mënyrë ai ndihmon që, për shembull, me mirëbesim të sigurojë licencën përkatëse.

Formulimi që shitësit nuk kanë mundur t'i mbesin të panjohura të drejtat ose kërkimet të cilat krijohen në pronësinë intelektuale në vetvete bart kufizime. Shitësi në kohën e shuarjes së kontratës mund të zbulojë për ekzistimin e të drejtave dhe hulumtimeve. Megjithatë, në këtë rast nuk mund të flitet për jokonformitetin e mallit nga ana e shitësit, sepse në kohën e shuarjes së kontratës ai nuk mund të dijë për pretendimet e personave të tretë, pretendime që eventualisht do të pasojnë pas dorëzimit të mallit.

IV. 10.5.Njoftimi i shitësit për të drejtat ose kërkimet e personit të tretë të cilat krijohen në pronësinë industriale dhe intelektuale

Blerësi sipas nenit 43, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, është përgjegjës të njoftojë shitësin për secilën të metë në afatin e arsyeshëm meqë ka zbuluar ose është dashur të zbulojë për ekzistimin e së drejtës ose kërkimet e personit të tretë. Me vetë faktin nga kjo që u tha sipas konventës së Vjenës, blerësi duhet të lajmërojë shitësin edhe për të drejtat edhe për kërkimet e personit të tretë të cilat krijohen në pronësinë intelektuale dhe industriale. Për njoftimin e mutatis mutandis sa më parë që është thënë për detyrimin e njoftimit për të metat juridike.

Edhe pse në teorinë e shitjes ndërkombëtare të mallit njoftimi për të metat në këtë rast nënkupton që është e obligueshme të trajtohet arsyeshmëria e ekzistimit të detyrimit të shitësit. E kemi parë më herët që shitësi për këtë lloj të të metave juridike do të përgjigjet vetëm nëse në kohën e shuarjes së kontratës ka pasur njohuri për të drejtat e pronësisë intelektuale të personit të tretë. Parashtrohet pyetja kush është atëherë caku i bartjes së ankesës, nëse shitësi ka ditur për ekzistimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të personit të tretë. Nëse shitësi nuk di për ekzistimin e së drejtës së pronësisë intelektuale të personit të tretë atëherë nuk janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 42, paragrafi 1, të Konventës së Vjenës dhe ai gjithsesi nuk do të jetë përgjegjës.

Kushtet e ekzistimit të detyrimit të njoftimit edhe në këtë rast, sipas mendimit tonë kuptohen si më poshtë. Me rastin e krijimit ose të miratimit të Konventës së Vjenës është përcaktuar një regjim i vetëm për pjesëmarrje të përgjegjësive së shitësit për konformitetin e mallit dhe të metat juridike. Sigurisht nuk është ditur që përgjegjësia e shitësit për konformitet të mallit edhe për të drejtat ose kërkimet e personit të tretë e cila me krijimin e pronësisë intelektuale do të jenë përjashtim nga ky regjim.

Ekzistimi i detyrimit për të drejtat e pronësisë intelektuale, të personit të tretë, nuk është logjike as e logjikshme, sepse është propozimi i përgjegjësive së shitësit si e drejtë e tij e njohjes për të metat juridike në kohën e shuarjes së kontratës. Gjithashtu, konsiderojmë se njoftimi i personit të tretë nënkupton që ai e di për natyrën e së drejtës së personit të tretë. Eventualisht me njoftim mund të jetë e dobishme nëse për këtë blerësi shitësin e njofton për masat të cilat personi i tretë i ka ndërmarrë. Megjithatë neni 43, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, nuk parasheh që njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna.

E konsiderojmë që njoftimi i lëshimeve për ekzistimin e natyrës së masave të pronësisë intelektuale të personit të tretë nuk duhet të jetë si në rastin e të metave të tjera juridike dhe të çojë kah humbja e mjeteve juridike të blerësit. Shkaku qëndron në atë se nuk është njoftuar për të metat juridike nëse nuk ka ditur për të drejtën ose kërkesat e personit të tretë dhe natyrën e tyre.

IV. 10.6.Përjashtimi i përgjegjësive së shitësit

Shitësi nuk do të jetë përgjegjës, bile edhe nëse në mall ekziston e drejta e pronësisë intelektuale e personit të tretë dhe nëse janë përmbushur supozimet nga neni 42, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës në dy raste. E para, nëse në momentin e shuarjes së kontratës blerësi ka ditur ose nuk ka mundur që për të jetë i panjohur ekzistimi i së drejtës ose kërkesave, dhe e dyta, nëse kjo e drejtë ose kërkim është pasojë e veprimit të shitësit sipas planeve teknike, vizatimeve, formulave ose specifikave të tjera të ngjashme të cilat ia ka paraqitur blerësi.⁷⁴¹

⁷⁴¹ *Konventa e Vjenës*, neni 42, paragrafi 2.

IV. 10.6.1. Njohuria e blerësit

Përgjegjësia e shitësit sipas nenit 42, paragrafi 2, pika a, e Konventës së Vjenës sqaron se nëse në momentin e shuarjes së kontratës blerësi ka ditur ose nuk ka mundur të mbetet për të e panjohur ekzistimi i së drejtës ose kërkesave të tilla, ky vendim është i kuptueshëm sepse blerësi me shuarjen e kontratës e di që përdorimi i mallit do të jetë i kufizuar në mes të ekzistimit të së drejtës së pronësisë intelektuale të personit të tretë, atëherë ai me vetëdije bart rrezikun që shitësi nuk duhet që për atë gjë të jetë përgjegjës.

Nenit 42, paragrafi 2, pika a, e Konventës së Vjenës i përgjigjet nenit 35, paragrafi 3, i Konventës së Vjenës i cili është analizuar në detaje nga ana jonë më herët, dhe i cili varet nga përmbushja e detyrimit të shitësit të dorëzimi i mallit jokonform kontratës. Në raport me përgjegjësinë e përgjithshme për të metat juridike ku për shuarjen e tij është e nevojshme deklarimi i blerësit, shuarja e detyrimit sipas nenit 42, paragrafi 2, pika a, e Konventës së Vjenës është me e lehtë për të ardhmen dhe është e mjaftueshme për njoftimin e blerësit.

Përgjegjësia e shitësit është shuar nëse blerësi për të metat e ka ditur ose nëse për të nuk ka mundur të mbeten të panjohura. Derisa fjala ka ditur nënkupton njohurinë e blerësit, deri këtu formulimi për të metat e blerësit nuk ka mundur të mbetet i panjohur dhe në teori ka provokuar debate. Pyetja bazë është se në cilën shkallë të kujdesit duhet të pritët nga blerësi. E konsiderojmë që duhet të pranohet qëndrimi i doktrinës që edhe përgjegjësia e shitësit për konformitetin e mallit, shënon formulimin e veprimit të blerësit me pakujdesinë e rëndë.⁷⁴² Pyetja tjetër është se kur ekziston pakujdesia e rëndë e blerësit, domethënë se cilat veprime duhet të ndërmarrë blerësi. Në secilin rast, blerësi nuk vepron me pakujdesinë e rëndë, kur e lëshon që të kontrollohet ekzistimi i të drejtave të pronësisë intelektuale (p.sh. patenta e mostrës) në shtetet e përdorimit ose në shtetin përkatës. Sikurse e kemi parë me herët shitësi është përgjegjës që të kërkojë të dijë se a ekziston në shtetin përkatës e drejta e pronësisë intelektuale, që sjell në pyetje përdorimin e pandërprerë të mallit. Blerësi nuk ka detyrim të tillë sepse ai më së shpeshti nuk do të jetë në pozitë të dijë detajet për kontrollin e mallit, të përmbajtjes dhe ndërtimit të saj. Pakujdesia e rëndë e blerësit do të ekzistojë kur flitet për të drejtat, të cilat në treg nuk mund të

⁷⁴² Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2413. Ky qëndrim i përgjigjet edhe të gjitha atyre të cilat i kemi përmendur në rastin e analizës së përmbushjes së përgjegjësisë së shitësit për dorëzimin e mallit (*Konventa e Vjenës*, neni. 35, paragrafi 3).

parashihi, gjegjësisht me të cilat duhet të planifikohet te përdorimi i paraparë.⁷⁴³ Gjithashtu, nëse blerësi në vete merr si detyrim hulumtimin atëherë pakujdesia e rëndë ekziston te mostrat ndërkombëtare të gjithëpërfshira, në zbulimet e reklamuar ose në të drejtat e pronësisë intelektuale.⁷⁴⁴

Njohja e blerësit për ekzistimin e së drejtës në mall duhet të ekzistojë në kohën e shuarjes së kontratës. Më vonë zbulimi i blerësit nuk ka kuptim për shuarjen e përgjegjësisë së shitësit, por mund të aktivizohet afati për njoftimin e shitësit për të metat juridike nga neni 43, paragrafi 1, Konventa e Vjenës.

IV. 10.6.2. Trajtimi sipas udhëzimeve teknike të blerësit

Sipas nenit 42, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës përgjegjësia e shitësit është përmbushur kur e drejta ose kërkimi është pasojë e veprimit të shitësit sipas planeve teknike, vizatimeve, formulave ose specifikave të tjera të ngjashme të cilat i ka paraqitur blerësi. Në rastin e përmendur shkelja e pronësisë intelektuale të personit të tretë është rezultat i sjelljes së blerësit për të cilin ai duhet të bartë përgjegjësinë. Neni 42, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës paraqet konkretizimin e rregullit të përgjithshëm të nenit 80, të Konventës së Vjenës, që njëra palë nuk mund të thirret në përmbushjen e palës tjetër nëse kjo është mospërmbushje si pasojë e veprimit të tij ose me lëshimin e tij.⁷⁴⁵

Për shuarjen e përgjegjësisë së shitësit është e nevojshme që në mënyrë kumulative të bëhet përmbushja e disa kushteve. E para, shitësi duhet të veprojë sipas të dhënave dhe udhëzimeve të cilat i ka fituar nga blerësi. E dyta, në bazë vijnë vetëm të dhënat teknike, të cilat varen edhe në prodhim, në pamje ose në paketim të mallit. Neni 42, paragrafi 2, pika b, e Konventës së Vjenës nuk përfshin, për shembull, kërkesat e zakonshme të cilat malli do të duhej t'i përmbushë.⁷⁴⁶ E treta të dhënat e fituara duhet të jenë mjaftueshëm precize.⁷⁴⁷ Sipas kësaj, përgjegjësia e shitësit është përmbushur vetëm tek ato udhëzime të cilat shitësi i aplikon direkt dhe të cilat nuk i nënshtrohen ekzaminimit (shqyrtimit) ose ndryshimeve⁷⁴⁸. Në të kundërtën

⁷⁴³ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2413.

⁷⁴⁴ Bamberger, Roth, *vepër e cituar*, fq. 2836; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 503.

⁷⁴⁵ Shih më shumë pjesën e këtij punimi ku flitet për lirimin nga detyrimi i përgjegjësisë.

⁷⁴⁶ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 444.

⁷⁴⁷ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 503; Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 541.

⁷⁴⁸ Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 444.

udhëzimet, të cilat i lënë hapësirë shitësit për diskrecion, për shembull, ajo që ia mundëson që të zgjedhë mënyrën alternative të prodhimit, që nuk do të çonin në shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale, nuk çojnë në shuarje të përgjegjësisë së shitësit.

Për lirimin e shitësit nga përgjegjësia nuk është domosdo që blerësi e ka ditur që do vijë deri te shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale. Supozimi është që blerësi, i cili i jep shitësit udhëzime, di për ekzistimin eventual të të drejtave të personit të tretë.

Shitësi, i cili ka fituar udhëzime nga blerësi, nuk është përgjegjës që të sjellë hulumtimin se a ekziston e drejta e personit të tretë. Megjithatë, nëse shitësi kupton që respektimi i udhëzimeve të dhëna shkel të drejtën e pronësisë intelektuale të të tretit. Ai është i detyruar që në këtë rrethanë të njoftojë blerësin. Detyrimi i përmendur tejkalon nga parimi i ndërgjegjësimit nga neni 7, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Nëse blerësi nuk reagon me lajmërimin, se shitësi nuk krijon shkeljen e kontratës nëse dorëzon mallin në të cilin ekziston e drejta e pronësisë intelektuale të personit të tretë. Nga ana tjetër, lëshimi i njoftimit të blerësit ka për pasojë që shitësi nuk mund të jetë më i liruar nga përgjegjësia për shkak të shkeljes së parimit të ndërgjegjësimit.

IV. 11. Bazat për lirimin e shitësit nga përgjegjësia për dorëzimin e mallit

Bazat e parimit gjithëpërfshirës të së drejtës së detyrimeve *pacta sunt servanda* paraqet që secila palë kontraktuese përgjigjet për përmbushje të kontratës. Ndonjëherë, megjithatë mund të veprojnë ngjarje të tilla, të cilat përmbushjen e detyrimit në masë të madhe e vështirësojnë ose e bëjnë më të vështirë. Sipas parimit *pacta sunt servanda* në këtë situatë do të çonte kah caku i kundërt nga ajo që mbron palët kontraktuese. Pikërisht për shkak të kësaj edhe Konventa e Vjenës edhe LMD-ja përmbajnë rregulla të cilat rregullojnë situatat të tilla. Duhet të kemi parasysh që këtu bëhet fjalë për rastet të cilat paraqesin bazën për devijimin nga parimi kryesor kontraktues, dhe aplikimin e normës që rregullon lirimin nga përgjegjësia i cili është i mundur dhe është i lejuar vetëm në rastet specifike.

Në shqyrtimet e mëhershme kemi parë bazat e ndryshme të përgjegjësisë sipas Konventës së Vjenës dhe LMD-së. Pasojat e saj janë të rregulluara në mënyrë të ndryshme për lirimin e debitorit nga përgjegjësia, e cila ekziston në të drejtën shqiptare, përkatësisht në atë kosovare si edhe në atë ndërkombëtare të shitja ndërkombëtare e mallit. Për të gjitha këto, që janë

përmendur, e konsiderojmë veçmas sesi do të jetë e nevojshme të bëhet shqyrtimi i bazave për lirim nga përgjegjësitë e parapara në Konventën e Vjenës dhe në LMD.

IV. 11.1. Bazat për lirim nga përgjegjësia te shitja ndërkombëtare e mallit

Respektimi pa kusht i parimit të përgjegjësisë si përgjegjësia kauzale, do ta çojë shitësin në pozitë të vështirë, kjo edhe për shkak të zbutjes në Konventën e Vjenës, të parapara me kushtet e lirit që nuk kanë qenë të lidhura me fajësinë. Gjatë analizës së bazës për lirim nga përgjegjësia, varësisht nga gjerësia, mund të japim përgjigje të plotë për natyrën juridike të përgjegjësisë së shitësit për dorëzimin e mallit.

Çështja e lirit nga përgjegjësia ka rëndësi shumë të madhe teorike dhe rëndësi praktike. Të gjitha të drejtat nacionale përmbajnë rregulla për çështjen, që pas shuarjes së kontratës nuk mund të përmbushet aspak detyrimi i tij ose mund të themi se përmbushja e tyre në masë të madhe është rënduar.

Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i dëmit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet. Zotëruesi i sendit lirohet nga përgjegjësia edhe në rast se provohet se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i palës së dëmtuar ose i personit të tretë, gjë të cilën ai nuk ka mundur ta parashihet dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i shmangë ose t'i mënjanojë. Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia pjesërisht në rast se pala e dëmtuar pjesërisht ka kontribuar në shkaktimin e dëmit. Në rast se në shkaktimin e dëmit ka kontribuar pjesërisht personi i tretë, ky person i përgjigjet palës së dëmtuar, solidarisht bashkë me zotëruesin e sendit. Personi që e ndihmon zotëruesin në përdorimin e sendit nuk konsiderohet si person i tretë.⁷⁴⁹

Këtë situatë është dashur ta rregullojnë edhe me rastin e nxjerrjes së Konventës së Vjenës. Pikërisht në këtë fushë kanë ardhur deri te shprehja e një ndryshimi të madh në mes të së drejtës civile dhe sistemit *common law*. Për shkak që është përmendur më lart, për nxjerrjen e rregullit për lirim nga përgjegjësia janë bërë debate të gjata dhe diskutime të shumta, dhe rezultati ka qenë vendim kompromisi dhe krijimi i një konceptit *sui generis*, i cili nuk ekziston askund në botë. Një veprim i tillë ka anët pozitive dhe negative. Krijimi i një koncepti të ri dhe përdorimi i terminologjisë unike mundëson lirim nga aplikimi i rregullit që përmbajnë një

⁷⁴⁹ LMD, neni 158, paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5.

rregull nacionale. Nga ana tjetër, pikërisht terminologjia e re krijon veprimin e këtij rregulli shumë të vështirë.

Lirimi nga përgjegjësia në Konventën e Vjenës është rregulluar në mënyrë të veçantë për të dyja palët kontraktuese (kapitulli V, Rregullat e Përbashkëta për Detyrimet e Shitësit dhe Blerësit, departamenti IV, Lirimi nga përgjegjësia) në nenin 79 dhe 80. Është interesante që në versionin tonë të Konventës së Vjenës departamenti IV bart thirrjen e lirimit nga përgjegjësia, derisa në gjuhën angleze dhe në tekstin gjerman është thirrur vetëm Lirimi. Sipas mendimit tonë është më i mirë përdorimi i shumicës se flitet për dy raste të ndara. Lirimi nga përgjegjësia është i mundur vetëm në këto dy raste. Pala, e cila nuk e ka përmbushur detyrimin, nuk do të jetë përgjegjës nëse nga mospërmbushja ka ardhur në kuadër të pengesës që është shkaktuar jashtë kontrollit të palës, domethënë *vis major* (neni 79, Konventa e Vjenës ose nëse mospërmbushja ka sjellë me veprimin ose lirimin nga përgjegjësia e palës së dytë kontraktuese (neni 80, Konventa e Vjenës).

IV. 11.1.1.Karakteri i normës për lirimin e përgjegjësisë

Neni 79, i Konventës së Vjenës, është i karakterit të kompromisit në mes të vendeve të ndryshme. Gjithashtu, paraqet një nga nenet më të gjata në Konventën e Vjenës, sipas mendimit të shumë interpretuesve dhe një prej neneve më të vështira. Rregulli ka provokuar polemika të shumta që me rastin e miratimit të tij⁷⁵⁰ dhe me rastin e aplikimit të tij. Me rastin e nxjerrjes së nenit 79, ka qenë shumë i rëndësishëm formulimi i tij nga arsye të rasteve të tjera. E para, sepse flitet për një pyetje të ndijshme dhe pikërisht mënyra e përcaktimit të rregullës për lirimin nga përgjegjësia e përcakton përgjegjësinë si bazë reale. Në rastet e formulimit të zgjeruar ose jopreciz, se a ka ekzistuar edhe rreziku që janë “në porta të vogla” në Konventën e Vjenës është futur përgjegjësia subjektive. E dyta, ka qenë e nevojshme mënjanimi i mungesave të gjetura, të cilat kanë ekzistuar në nenin 74 të ULIS-it, dhe që janë parë në mënyrë shumë të lehtë të lirimit të debitorit nga përgjegjësia.

Neni 79, i Konventës së Vjenës është i karakterit dispozitiv dhe flet për Përgjegjësinë për mospërmbushje të detyrimit, ku diskutohet çështja e marrëveshjes në mes palëve kontraktuese.

⁷⁵⁰ Barry Nicholas, *Impracticability and Impossibility in the U.N. Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, *International Sales: The United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, 1984, Ch.5, fq. 5-2.

Ato mund të ndikojnë, që neni 79 i Konventës së Vjenës, me kontratën e tyre do të lirohet, të kufizohet ose të përmbushet.

IV. 11.1.2.Rasti i jashtëzakonshëm (vis major)

Sipas parimit të përgjegjësisë objektive, i cili është pranuar në Konventën e Vjenës, shitësi garanton për përmbushjen e detyrimit të tij. Shitësi është i detyruar që të garantojë për përmbushje të detyrimit të tij. Shitësi është përgjegjës që të garantojë për të metat kur ai ka mundur t'i ndalojë, por përkundër kontrollit që ka pasur si detyrë për përgatitjen, organizimin ose përmbushjen e detyrimit, dhe kjo nuk është kryer. Në këtë kuptim, shitësi “garanton” aftësinë e përmbushjes,⁷⁵¹ gjegjësisht është përgjegjës që të garantojë për të gjitha rreziqet të cilat mund të krijohen në sferën e kontrollit të tij. Sipas rregullit, shitësi duhet të jetë i përgatitur që të garantojë për rrezikun nga i cili mund të sigurohet ose mund të marrim në konsideratë rastin e përcaktimit të çmimit.

Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit, të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut të blerësi, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit. Shitësi përgjigjet edhe për ato të meta materiale të cilat shfaqen pas kalimit të rrezikut të blerësi, në qoftë se janë pasojë e shkakut i cili ka ekzistuar më parë.⁷⁵²

Në të kundërt, ai nuk mund të jetë përgjegjës për veprimin e rrethanave që nuk janë paraparë dhe që janë të paevitueshme, sepse gjenden jashtë sferës së ndikimit të tij. Në të kundërtën të dyja palët kontraktuese kanë duruar pasojat negative, sepse shitësi nga ngjarjet e papritura dhe të pamposhturat është përpjekur që të sigurohet përmes ngritjes së çmimit.

Sipas nenit 79, paragrafi 1, nëse njëra palë nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e saj, ajo nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushje, nëse dëshmon që deri te mospërmbushja nuk ka ardhur për shkak të të metave, të cilat kanë qenë jashtë kontrollit dhe që nuk ka qenë e kuptueshme që të pritët kjo rrethanë që në kohën e shuarjes së kontratës të merren në konsideratë të metat, që tejkalon ose mbizotëron të metat e tilla dhe pasojat e saj. Në mënyrë përmbajtësore formulimin identik e gjejmë në nenin 8:108 paragrafi 1, i PECL-it dhe neni 7.1.7 paragrafi 1, UPC.

⁷⁵¹ Peter Schlechtriem, *Uniform Sales Law*, fq.101.

⁷⁵² *LMD*, neni 461, paragrafët 1 dhe 2.

Nga ajo që u tha më lart ne shohim që arsyeja për lirimin nga përgjegjësia është ngjarja e jashtëzakonshme e cila është vlerësuar mjaftueshëm për sa i përket rëndësisë për lirimin nga përgjegjësia, pra me ndikimin e *vis majorit*. Derisa Konventa e Vjenës dhe PECL nuk përmendin shprehimisht që flitet për vis major por flitet për lirimin deri te neni 7.1.7 UPC ka thirrjen vis major. Shkaku pse Konventa e Vjenës dhe PECL nuk përcaktojnë shprehimisht që flitet për vis major duhet kërkuar, që në mes të sistemit common law dhe sistemit civil law, dhe bile në mes shteteve të cilat i përkasin të njëjtit rreth të së drejtës, ku ekziston dallimi edhe në terminologji dhe në përmbajtje të këtij nocioni. Në bazë të kësaj duhet të theksohet se kuptimi për *vis major*, para së gjithash, është përfshirë për shtetet e sistemit kontinental, ndërsa për të drejtën e shteteve anglosaksone kuptimi karakteristik është frustrimi i kontratës.⁷⁵³

IV. 11.1.2.1.Kushtet për lirim

Kushtet për lirimin nga përgjegjësia janë identike në Konventën e Vjenës, UPC dhe PECL. Sot, të gjitha tekstet përdorin kuptimin bezdisje dhe në mënyrën e njëjtë përshkruajnë ndodhitë të cilat krijojnë vis majorin.

Në nenin 79, paragrafi 1 i Konventës së Vjenës janë paraparë kushtet në të cilat pala nuk është përgjegjëse për mospërbushje të ndonjërit nga detyrimet e tij. Në bazë të kësaj para analizës së kushteve për lirimin nga përgjegjësia është e nevojshme të shqyrtohet se çka nënkupton nocioni mospërbushje.

IV. 11.1.2.2.Mospërbushja e detyrimit të dorëzimit

Mospërbushja e detyrimit është vonesa e përmbushjes së detyrimit ose dorëzimi i mallit jokonform, në këtë rast shitësi nuk do të jetë përgjegjës për dëmet, nëse nuk është përgjegjës për mospërbushje të dorëzimit së sendit. Në kontratat e dyanshme asnjëra palë nuk e ka për detyrë ta përmbushë detyrimin e vet në qoftë se pala tjetër nuk e përmbush, ose nuk është e gatshme që njëkohësisht ta përmbushë detyrimin e saj, me përjashtim kur është kontraktuar diçka tjetër ose është caktuar me ligj apo kur rrjedh diçka tjetër nga vetë natyra e punës.⁷⁵⁴

⁷⁵³ Ivica Jankovec, (1993). *Ugovorna odgovornost*, Beograd, fq. 98-111.

⁷⁵⁴ LMD, neni 104, paragrafi 1.

Sipas nenit 79, të Konventës së Vjenës, nëse ndonjëra nga palët nuk përmbush ndonjë detyrim të tij, ajo në bazë të kushteve të përcaktuara mund të lirohet nga përgjegjësia për to. Shohim se kuptimi i mospërmbushjes së detyrimit është përcaktuar në mënyrë të përgjithshme dhe që përfshinë secilën shkelje të detyrimit. Prandaj, mospërmbushja mund të jetë tërësore, pjesërisht ose shumë pak e përmbushur. Nga këndvështrimi i lirimit nga përgjegjësia karakteri i shkeljes së detyrimit nuk është i rëndësishëm. Dallimi i shkeljes së detyrimit është si pasojë në ndikimin e lirimit, gjegjësisht në mjetet juridike, të cilat do të ndodhen në dispozicionin e palës së dëmtuar.

Duke marrë parasysh që norma varet për shkeljen e secilit detyrim, ajo do të aplikohet edhe në shkeljen e detyrimit të dorëzimit nga ana e shitësit. Megjithatë, në teori kanë ekzistuar qëndrime të kundërta në raport me përmbajtjen e kuptimit të mospërmbushjes së dorëzimit. Padyshim që neni 79, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, aplikohet në rastet kur shitësi fare nuk dorëzon mallin ose kur vonohet me dorëzimin e mallit. Por janë ndjekur diskutime, se a është përfshirë me normën e përmendur edhe detyrimi i mallit jokonform kontratës. Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duhet të nisemi nga vetë kuptimi i dorëzimit të mallit. Detyrimi i shitësit për dorëzim është i karakterit të përgjithshëm dhe nga shitësi kërkohet që të dorëzojë mallin i cili nuk ka të meta, gjegjësisht mallin i cili është konform kontratës. Sipas burimeve të së drejtës të shitja ndërkombëtare e mallit, shitësi nuk ka detyrim të veçantë të garancisë që malli të jetë konform kontratës.⁷⁵⁵ Sipas kësaj edhe dorëzimi i mallit jokonform kontratës kryen mospërmbushje të detyrimit, dhe në këtë rast, lirimi nga përgjegjësia është i mundur nëse janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara.

Të përfundojmë se gjuha e nenit 79, paragrafi 1, të Konventa e Vjenës është e qartë dhe jo e dykuptimtë, shprehimisht çon në të gjitha shkeljet e detyrimeve kontraktuese, dhe me vetë këtë dhe në të gjitha llojet e shkeljeve të detyrimit të dorëzimit. Në bazë të kësaj norma e përmendur është pranuar si kuptim i përgjithshëm i mospërmbushjes (shkeljes së kontratës) i cili ekziston edhe në nenin 45, paragrafi 1, pika b, e Konventës së Vjenës. Për kontributin dhe konstatimin tonë flet edhe praktika gjyqësore, që nga mospërmbushja varet edhe detyrimi i dorëzimit të mallit jokonform kontratës.⁷⁵⁶

⁷⁵⁵ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 810; Peter Schlechtriem, *Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht*, fq. 761.

⁷⁵⁶ FRANCE Tribunal de Commerce (District Court) Besancon 19 January 1998, www.cisg.law.pace.edu

IV. 11.1.2.2.1.Shkelja e kontratës, jashtë kontrollit të shitësit

Shitësi do të jetë i liruar nga përgjegjësia për shkeljen e detyrimit të dorëzimit nëse dëshmon shkakun e mospërbushjes dhe të shkeljes jashtë kontrollit të tij. Nëse nocioni shkelje përdoret në Konventën e Vjenës, ai nuk do të përdoret në asnjërin nga aktet e përmendura si PECL dhe UPC. Për shkak të kësaj është e nevojshme që fillimisht të përcaktojmë çka paraqet shkelje, si dhe ndodhitë të cilat i kanë përbushur kushtet e tjera që mund të sjellin deri te lirimi nga përgjegjësia.

Askund nuk kemi mundur të gjejmë çka paraqet shkelja, por janë shqyrtuar edhe mendime të kundërta të zgjedhja e rastit të këtij nocioni. Me rastin e miratimit të ULIS-it u hap diskutimi në mes nocionit pengesë dhe rrethana të jashtëzakonshme. Mbizotërimin e ka marrë nocioni i rrethanës së jashtëzakonshme. Sipas nenit 74, paragrafi 1, i ULIS-it, pala e cila nuk është përgjegjëse për mospërbushje të detyrimit të saj nëse dëshmon që deri të mospërbushja ka ardhur për shkak të rrethanave të cilat sipas pretendimeve të palëve kontraktuese në kohën e shuarjes së kontratës, ajo nuk ka qenë e obliguar as të marrë në konsideratë, as të tejkalojë ose mbizotërojë atë. Koncepti i rrethanës së jashtëzakonshme, e cila ka sjellë deri te mospërbushja, është i gjerë dhe ka mundësuar lirin nga përgjegjësia edhe të një numri të madh të rasteve.⁷⁵⁷ Për këtë arsye, me rastin e miratimit të Konventës së Vjenës, kjo pyetje prapë është shqyrtuar edhe nga grupi punues i UNICITRAL-it, që në tekstin e Konventës ka vendosur shprehjen pengesë (*impediment*). Me rastin e krijimit të Konventës së Vjenës është marrë vendimi që neni 79, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, duhet të jetë i formuluar ashtu që të jetë siguruar pjesëmarrje e shkurtër dhe objektive.⁷⁵⁸ Ndërrimi në terminologji para së gjithash, do të duhej të fillonte me natyrën objektive të natyrës së pengesës.

Meqë kuptimi shkelje është i karakterit të përgjithshëm ai në vetvete përfshin të gjitha të metat pa marrë parasysh kohën e krijimit të tij. Sipas kësaj, njëkohësisht trajtohen edhe shkeljet paraprake dhe kompensimi, gjegjësisht pamundësia e përbushjes. Kjo dallon nga vendimet që përmban e drejta jonë dhe të drejtat e tjera nacionale. Këto pasoja të pamundësisë së mëparshme duhet gjithmonë të përcaktohen në raport me Konventën e Vjenës. Gjithashtu është e parëndësishme se a është pengesa (shkelja) e vazhdueshme ose e përkohshme. Në fund nuk ka

⁷⁵⁷ Peter Schlechtriem, *Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht*, fq. 761.

⁷⁵⁸ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 812.

kuptim a është shkelja e tillë, përmbushje e dorëzimit dhe krijon të pamundurën objektive ose subjektive. Sipas kësaj, lloji i shkeljes qëndron përkundër përmbushjes së detyrimit të shitësit, për mundësinë e lirimit të shitësit vetëm nga rëndësia indirekte. Është e rëndësishme që flitet për ndodhinë e cila paraqet shkeljen (pengesën) jashtë kontrollit të debitorit.

Pa dyshim që me pengesa në kuptimin e nenit 79, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, mund të konsiderohen vetëm rrethanat objektive të cilat nuk ballafaqohen me përmbushjen e detyrimit. Kjo domethënë që nuk ekziston dëmtimi nëse kjo është shkak i mospërmbushjes dhe kërkesave të shitësit.

Shënjimi i rëndësishëm i pengesës është që ajo duhet të jetë jashtë kontrollit të shitësit, gjegjësisht platforma e saj. Është e nevojshme që flitet për ngjarjen e jashtme dhe të pavarur nga personaliteti i tij. Pjesa e jashtme paraqet një element më shumë të *vis majorit* e cila shprehimisht kërkohet në sistemin e përgjegjësisë objektive.

Duke pasur parasysh atë që është përmendur më lart, shkeljen mund ta prezantojnë si ndodhitë shoqërore, politike dhe natyrore ose si vështirësitë fizike dhe politike. Në mes të tjerash shkeljen ose pengesën në kuptimin e nenit 79, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, e paraqet katastrofa natyrore (vërshimet, tërmetet zjarret, uraganet et.), veprimtaritë të cilat varen nga rrethanat politike ose shoqërore (lufta, revolucioni, etj.) të metat juridike dhe të metat e tjera.⁷⁵⁹

Në bazë të kësaj nuk është e mundur të krijohet lista përfundimtare e ndodhive, të cilat do të mund të konsiderohen si dëmtim, shkelje, por është e nevojshme që vlerësimi të kryhet në *casu*. Shembulli paraqet shkatërrimin e sendit individualisht të përcaktuar në zjarr. A mund të konsiderohet zjarri pengesë varet nga rrethanat e rastit konkret. Nuk do të konsiderohet pengesë jashtë kontrolli zjarri për shitësin, pa marrë parasysh shkakun e tij nëse shitësi nuk ka ndërmarrë të gjitha masat e sigurimit nga zjarri për të cilat edhe ka qenë i detyruar t'i ndërmarrë.

⁷⁵⁹ Shih më shumë: Chengwei Liu, *Remedies for Non-performance: Perspectives from the CISG, UNIDROIT Principles & PECL*, September 2003, www.cisg.law.pace.edu

IV. 11.1.2.2.2.Fusha e kontrollit të shitësit

Formulimi i nenit 79, i Konventës së Vjenës, krijohet në supozimin së shitësi si debitor, në aspektin e dorëzimit, ka sferën tipike të kontrollit për të cilin është përgjegjës.⁷⁶⁰ Kjo do të thotë që shitësi bart rrezikun për përmbushje të detyrimit. Ky rrezik nuk është i pakufizuar, por shpërndahet deri te rreziku i përmbushjes, gjegjësisht deri te rreziku që është jashtë kontrollit të shitësit. Bëhet fjalë për sferën që në bazë të rrethanave objektive mund të pritët nga shitësi që ta dorëzojë mallin pa probleme. Këtu do të pasojë përgatitja dhe përmbushja e dorëzimit përkrah marrjes së të gjitha masave të kontrollit dhe masave të organizuara.

Sfera e kontrollit të shitësit ku është përgjegjës, gjegjësisht bart përgjegjësinë për dorëzimin që është shumë e gjerë. E para, shitësi bart përgjegjësinë për të ashtuquajturin rrezik organizues. Shitësi si subjekt tregtar, në kornizën e veprimtarisë është përgjegjës për drejtuesit e tyre (p.sh. prodhimin dhe përgatitjen për dorëzimin) dhe kështu organizon dhe orienton që ajo të ndahet pa pengesa. Nën kontrollin e shitësit janë të gjithë faktorët, që janë të lidhur me organizimin e prodhimit ose të furnizimit të mallit, si teknikë personale e përgatitjes. Gjithashtu, kontrolli i shitësit përfshin edhe me mirëbesim sigurimin e aksioneve, si t'i krijojë të gjitha dhe të pranojë leje të domosdoshme.⁷⁶¹ Pengesat, të cilat krijohen brenda organizatës së ndërmarrjes si, për shembull, zvogëlimi i vëllimit të prodhimit për shkak të pushimeve vjetore, për shkak të lirimit të punëtorëve të rëndësishëm nga përgjegjësia për mospërmbushje të detyrimit.⁷⁶² Gjithashtu shitësi është i detyruar që të sigurojë hapësirë të përshtatshme për magazinimin e mallit.⁷⁶³ Këtu si shumë interesante përmendet çështja e grevës. A paraqet greva e punëtorëve të shitësit pengesë jashtë kontrollit në kuptimin e Konventës së Vjenës. Te përgjigjja duhet të jemi shumë të kujdesshëm sepse shkak i grevës shumë shpesh gjendet në vetë ndërmarrjen, e me këtë fakt edhe në sferën e kontrollit të shitësit. Sipas mendimit tonë nuk është e mundur marrja e qëndrimit të përgjithshëm, por gjithmonë është e nevojshme të analizohen rrethanat e rastit konkret. Nëse greva është shprehje e konflikt të brendshëm në fabrikën e shitësit, atëherë mund të mos e konsiderojmë pengesë jashtë kontrollit të tij. Nëse nga ana tjetër do të bëhej fjalë për grevë gjenerale, për shembull në të gjithë shtetin, atëherë ai do të mund të konsiderohej me

⁷⁶⁰ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 814.

⁷⁶¹ Po aty, fq. 814.

⁷⁶² Chengwei Liu, *Remedies for Non-performance: Perspectives from the CISG, UNIDROIT Principles & PECL*, September 2003, www.cisg.law.pace.edu; Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *International Sales Law*, fq. 322.

⁷⁶³ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2658.

pengesë edhe përkrah përmbushjes kumulative të kushteve të tjera që të çojnë deri të lirimi nga përgjegjësia. Te vlerësimi i rrezikut organizues duhet të kemi në mendje se Konventa e Vjenës aplikohet vetëm te kontratat e shitjes me rastin e shuarjes së kontratës së shitjes dhe pjesëmarrja e tyre nuk do të çojë te lirimi nga përgjegjësia. Përkundër kësaj, nëse një organizatë vjen deri te çrregullimi, në rast të fatkeqësisë natyrore, kjo do të çojë te lirimi sepse këtu ekzogjeni, ndodhitë e jashtme kanë ndikuar në çrregullim, e jo shitësi me veprimin ose me mosveprimin e vet.

E dyta, shitësi përgjigjet për të ashtuquajturin rrezik personal. Kur shitësit i bije hasë ndonjë sëmundje e rëndë, vdekja, nëse është në vuajtje të dënimit me burg ose nga ndonjë arsye e tij personale nuk përmbush detyrimin, kjo nuk është e mjaftueshme për lirimin e tij nga përgjegjësia. Shembulli është i mundshëm vetëm nëse flitet për kontratën *intuito personae*, gjegjësisht nëse përmbushja e detyrimit varet nga aftësitë personale ose njohuritë e shitësit.

E treta, shitësi përgjigjet edhe për aftësinë e tij financiare të përmbushjes së detyrimit. Pikërisht problemet janë tek aftësitë financiare të shitësit që i janë dedikuar diskutimeve të shumta. Njëra nga pyetjet më të shpeshta është se, a është shitësi përgjegjës për rritje radikale të shpenzimeve të furnizimit ose të prodhimit të mallit. Fakti është se rritja e shpenzimeve “pengon” përmbushjen e kontratës. Rritja e shpenzimeve mund të sjellë deri te pamundësia e shitësit që të krijojë fitimin e pritur nga shuarja e kontratës për shitjen, por kontrata mund të përmbushet. Në këtë rast rritja e shpenzimeve nuk do të shërbejë si bazë për lirim, sipas Konventës së Vjenës.⁷⁶⁴ Shkaku për këtë qëndrim shtrihet si më poshtë. Në mënyrë dramatike rritja e shpenzimeve është rrezik i atillë të cilin shitësi si profesionist është i obliguar ta bartë. Mendimi që shitësi të bartë përgjegjësinë për aftësinë financiare është vërtetuar edhe në vendimet e arbitrazhit.⁷⁶⁵ Gjithashtu, shitësi është përgjegjës edhe për pajisjen me valutën e huaj.⁷⁶⁶ Kufizimi i këtij parimi është megjithatë i mundshëm nëse shitësi ka mbetur pa rezervat e tij financiare; për shembull veprimet e shtetit të cilat nuk ka qenë e mundur të parashihen (lufta, eksporcioni, konfiskimi i pjesës ose të të gjithë pjesëve të tij). Në këtë rast nuk ka arsye që, me intervenimin e shtetit me anë të mjeteve financiare të shitësit, në mënyrë indirekte ndikon në pamundësinë e tij për dorëzimin e mallit dhe trajtimi, në një mënyrë tjetër nga frustrimi direkt i përmbushjes, është ndikuar nga intervenimi shtetëror.⁷⁶⁷ Sipas kësaj, është e mundur që shitësi

⁷⁶⁴ Herbert Bernstein & Joseph Lookofsky, *vepër e cituar*, fq. 108.

⁷⁶⁵ Jens Krüger & Rüdiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2660.

⁷⁶⁶ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 710; Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 815.

⁷⁶⁷ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 815.

të jetë i liruar nga përgjegjësia vetëm me kushtin për financimin e tij; kjo është paaftësi nga e cila pason pengesa edhe jashtë kontrollit të saj, nëse është në pyetje rrethana e jashtëzakonshme.

E katërta, shitësi gjithmonë bart përgjegjësinë për pajisjet që vijnë me mall. Nëse në kontratë nuk përcaktohet ndryshe, sipas rregullit, shitësi i përgjigjet blerësit për pajisje të mallit borxh dhe mallit jokonform kontratës. Në bazë të kësaj, bëhet dallimi i situatës kur lëndë e kontratës për sendin e përcaktuar individualisht, malli gjenerik, duhet që të ndahet nga masa e përcaktuar. Lënda e kontratës në shitjen ndërkombëtare të mallit më së shpeshti është malli gjenerik, dhe shitësi është përgjegjës për furnizim edhe atëherë kur furnizuesi nuk porosit mallin ose malli i porositur rastësisht nuk bie. Pengesat e përmendura për shitësin kanë mbizotëruar derisa shitësi në treg mund të pajiset me mallin e ri, kështu që malli gjenerik nuk vjen (genera non pereunt). Shitësi është përgjegjës që të shkarkohet për secilën mundësi të plotësimit të pajisjes me mall, edhe kur kjo është e lidhur me sasi të konsiderueshme të humbjeve monetare (p.sh. rritja e çmimit të mallit, rritja e shpenzimeve transportuese). Nëse për shkak të pajisjes me mall të ri dorëzimi i mallit ka vonesë, shitësi eventualisht mund të ketë përmbushje me mirëbesim, përmbushje që ka qenë e ndaluar, por në mënyrë jo të kontrolluar si edhe me rastet e paparashikuara me të cilat ai ka atakuar mallin.⁷⁶⁸

Nëse flitet për shitjen e mallit gjenerik, mall që duhet të ndahet nga masa e përcaktuar ose nga sasia e tepërt e mallit të përcaktuar, shitësi përgjigjet për përgjegjësinë nëse e gjithë sasia e lidhur ka shenjë dalluese nga rrethanat e jashtëzakonshme.

Kur sendi i përcaktuar individualisht është lëndë e kontratës, shitësi bart rrezikun e pajisjes me mall vetëm nëse kjo shprehimisht ose heshturazi është e detyruar që të marrë mallin. Në të gjitha rastet e tjera shitësi do të jetë i liruar nga përgjegjësia nëse dorëzimi i sendit, individualisht të përcaktuar, është ndaluar në mes të ngjarjes nga neni 79, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, gjegjësisht nëse pengesa ka ndikuar në sendin individualisht të përcaktuar. Gjithashtu, shitësi, si borxhli në kontrollin e mallit, mund të kufizojë ose të hapë përgjegjësinë e tij.

Në fund, shitësi bart përgjegjësinë për të gjithë të punësuarit e tij. Shitësi nuk përgjigjet vetëm për sjelljet e tij, por edhe për veprimet e njerëzve të tij. Sipas kësaj, sjellja e të punësuarve vjen në sferën e kontrollit të borxhliut, dhe ata nuk paraqesin personat e tretë nga neni 79, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës. Shitësi përgjigjet për punën e personave të tretë dhe nuk

⁷⁶⁸ Po aty, fq. 816.

mund të lirohet nga përgjegjësia me anë të dëshmisë që këta persona kanë vepruar kundër udhëzimeve të tij, dhe që kanë kryer vepra penale ose që nuk kanë qenë aspak të angazhuar në përmbushjen e kontratës.⁷⁶⁹

IV. 11.1.2.2.3. Dorëzimi i mallit jokonform kontratës

Detyrimi i shitësit sipas Konventës së Vjenës ka karakter të përgjithshëm, një aspekt i saj paraqet detyrimin e shitësit që të dorëzojë mallin i cili është konform sferës së kontrollit të shitësit, por meqë për këtë çështje janë iniciuar debate të shumta, ne e konsiderojmë që është e nevojshme që këto nuk rregullohen në detaje.

Kushti i parë, për lirimin e shitësit nga përgjegjësia, është që deri te mospërmbushja ka ardhur jashtë kontrollit të tij. Pyetja qëndron në atë se, a është lirimi i shitësit nga përgjegjësia e mundur, nëse me kontratë është shkëlur përmbushja e detyrimit. Në bazë të kësaj, dëmet që vijnë nga jashtë sipas disa autorëve janë të paparashikuara. Pengesa jashtë kontrollit të shitësit mund të jetë vetëm ngjarje e jashtme në bazë të së cilës shitësi nuk ka kontroll mbi të. Për këtë arsye vështirësitë bazë të dorëzimit i mallit jokonform kontratës bazohen në dëshminë që mungesa në mall mund të shënojë pengesat jashtë kontrollit të shitësit.⁷⁷⁰ Shumë autorë, të cilët i takojnë sistemit anglosakson, kanë potencuar që në Konventën e Vjenës është përfshirë nocioni pengesë me anë të së cilës arrihet të mbyllet çështja e përgjegjësisë së mallit jokonform kontratës. Nga neni 79, paragrafi 1,⁷⁷¹ shitësi në rast të dorëzimit të mallit me të meta nuk mund të lirohet nga përgjegjësia. Për dallim nga këto qëndrime, pjesëtarët e sistemit civil laë, para së gjithash autorët gjermanë, kësaj pengese nuk i japin rëndësi të tillë.⁷⁷²

Qëndrimi i Bordit Këshillimor është që neni 79, Konventa e Vjenës, çon në lirimin nga përgjegjësia dhe gjithmonë pala që e ka shkëlur detyrimin e saj, duke përfshirë detyrimin e shitësit që të dorëzojë mallin konform kontratës.⁷⁷³

⁷⁶⁹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 816 dhe 817.

⁷⁷⁰ Barry Nicholas. (1989). *The Vienna Convention on International Sales Law*, 105 Law Quarterly Review, fq. 235.

⁷⁷¹ Barry Nicholas. (1989). *The Vienna Convention on International Sales Law*, fq. 235; John O. Honnold, *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, fq. 478.

⁷⁷² Ulrich Huber. (1979). *Der UNCITRAL-Entwurf eines Übereinkommens über internationale Warenkaufverträge*, *Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht*, Heft 3, fq. 465-469.

⁷⁷³ CISG – Advisory Council Opinion no. 7, Exemption of Liability for Damages Under Article 79 of the CISG, 12 October 2007.

Rastet në praktike për të cilat do të parashtrohet pyetja e lirimit nga përgjegjësia e shitësit për shkak të dorëzimit të mallit jokonform kontratë janë tepër të rralla.

Në praktikën gjyqësore të shitjes ndërkombëtare të mallit nuk ekziston një qëndrim i vetëm për këtë çështje. Shitësit janë përpjekur që te dorëzimi i mallit jokonform të bazohen në nenin 79, paragrafi 1, Konventa e Vjenës, por me sukses shumë të kufizuar. Megjithatë, nëse disa gjykata me vendimet e tyre kanë pranuar mundësinë teorike që shitësi në rastet e caktuara të lirohet nga përgjegjësia për dorëzimin e mallit jokonform, shumë rrallë ka ndodhur që shitësi vërtetë është i liruar nga përgjegjësia.⁷⁷⁴

Shitësi do të jetë i liruar nga përgjegjësia, edhe pse kjo ndodh shumë rrallë, megjithatë është e mundshme, që të vijën deri në ato situata në të cilat shitësi do të jetë i liruar nga përgjegjësia për shkak të dorëzimit të mallit jokonform kontratës. E para, një rast i tillë do të jetë kur shitësi nuk dorëzon mallin e cilësisë së kontraktuar sepse në kohën e shuarjes së kontratës ka ekzistuar mungesa në mall. Këtu duhet të flitet për faktin të cilin shitësi nuk ka qenë i detyruar të dijë.⁷⁷⁵ E dyta, shitësi mund të lirohet nga përgjegjësia nëse shteti fut pengesat eksportuese të paketimit të mallit në kontejnerë plastikë ashtu siç është kontraktuar.⁷⁷⁶ E treta, deri tek të metat në mall mund të vijnë kur ekzistojnë kushte ekstreme të motit të keq.⁷⁷⁷ E fundit, lirimi nga përgjegjësia është i mundur nëse sendi individualisht i përcaktuar, është lëndë e kontratës dhe pason në kohën e shuarjes së kontratës edhe para se rreziku të ketë kaluar te blerësi, me kushtin që shitësi për këtë nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur të dijë si, dhe njëkohësisht pritet që me shkatërrimin e mallit kjo të merret në konsideratë me rastin e shuarjes së kontratës.⁷⁷⁸

IV. 11.1.2.2.4. Mosparashikimi i pengesës

Lirimi i shitësit nga përgjegjësia për dorëzim është i mundur nëse pengesa ka qenë jashtë kontrollit të tij dhe nëse nga ai nuk ka qenë e kuptueshme që të pritet qysh në kohën e shuarjes së

⁷⁷⁴ CISG – Advisory Council Opinion no. 7, Exemption of Liability for Damages Under Article 79 of the CISG, 12 October 2007, pika 8-13.

⁷⁷⁵ FRANCE Tribunal de Commerce (District Court) Besancon 19 January 1998, www.cisg.law.pace.edu

⁷⁷⁶ Joseph Lookofsky, *Fault and No-Fault in Danish, American and International Sales Law: The Reception of the United Nations Sales Convention*, Scandinavian Studies in Law, 1983, fq. 137.

⁷⁷⁷ Joseph Lookofsky, *Fault and No-Fault in Danish, American and International Sales Law: The Reception of the United Nations Sales Convention*, Scandinavian Studies in Law, 1983, fq. 137.

⁷⁷⁸ CISG – Advisory Council Opinion no. 7, Exemption of Liability for Damages Under Article 79 of the CISG, 12 October 2007, pika 8.

kontratës ta marrin në konsideratë dëmin. Sipas kësaj, dëmi duhet të jetë i paparashikueshëm. Përkundër kësaj, nëse nga mospërbushja e detyrimit ka ardhur për shkak të pengesës jashtë kontrollit të shitësit, pengesë e cila në kohën e shuarjes së kontratës mund të parashihet qartë, ai do të jetë përgjegjës për mospërbushje kontrate. Paparashikueshmëria ose mosparashikimi i pengesës është shënjim i rëndësishëm i kuptimit të rrethanave të jashtëzakonshme.

Sipas nenit 79, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës, pengesa nuk është e paraparë nëse nga palët kontraktuese (në rastin tonë shitësi) nuk ka qenë e njohur, që me rastin e shuarjes së kontratës të merret në konsideratë. Për përcaktimin e parashikimit pengesa është moment i shuarjes së kontratës me mirëbesim. Sipas kësaj, shitësi mund të jetë liruar nga përgjegjësia vetëm nëse në kohën e shuarjes së kontratës, që në mënyrë të paparashikuar të ketë ndodhur pengesa në kohën e shuarjes së kontratës. Në këtë rast është e nevojshme që shitësi për këtë nuk e ka ditur ose nuk është dashur të dijë.⁷⁷⁹ Nëse ngjarja ka mundur të parashikohet, konsiderohet që edhe shitësi në mungesë të normës të supozonte rrezikun që përbushja mund të jetë e vonuar ose e ndaluar me këtë pengesë.⁷⁸⁰

Sipas kësaj, nëse shitësi në kohën e shuarjes së kontratës ka ditur për të metat dhe ka lejuar shuarjen e kontratës, e meta për të nuk ka qenë e paparashikuar, gjegjësisht për të metën e tillë ai bart rrezikun dhe ajo nuk mund të dërgojë drejt lirimit të tij nga përgjegjësia. Kjo është konfirmuar edhe në disa vendime gjyqësore në të cilën shitësi konsiderohet përgjegjës sepse flitej për rrethanat të cilat nuk i ka marrë në konsideratë me rastin e shuarjes së kontratës.⁷⁸¹

E dyta, është e nevojshme që nga shitësi nuk ka mundur të pritet qartë që pengesat të merren në konsideratë. Kjo domethënë se sipas Konventës së Vjenës parashikimi i pengesës nuk vlerësohet *in concreto* sipas standardit të së drejtës së personit të arsyeshëm. Personi i arsyeshëm paraqet mjedisin në mes “pesimistit të papërmirësueshëm i cili parasheh të gjitha llojet e katastrofës dhe optimistit të vendosur që kurrë nuk është i bindur për fatkeqësinë më të keqe”.⁷⁸² Shitësi duhet të veprojë në mënyrë të zakonshme, si dhe duhet të veprojë si person i kuptueshëm, gjegjësisht personi i cilësive të njëjta si shitësi në të njëjtat rrethana.⁷⁸³ Nga kjo që u theksua më

⁷⁷⁹ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 323; FRANCE Tribunal de Commerce (District Court) Besancon 19 January 1998, www.cisg.law.pace.edu Jens Krüger & Rudiger Westermann, *vepër e cituar*, fq. 2658.

⁷⁸⁰ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 817. Chengwei Liu. (2003). Remedies for Nonperformance: *Perspectives from the CISG, UNIDROIT Principles & PECL*, September. www.cisg.law.pace.edu

⁷⁸¹ NETHERLANDS Rechtbank (District Court) ‘s-Hertogenbosch 2 October 1998 www.cisg.law.pace.edu, BULGARIA Arbitration Award case No. 56/1995 of 24. April 1996 www.cisg.law.pace.edu

⁷⁸² Bianca, Bonell, *vepër e cituar*, fq. 580 dhe 581.

⁷⁸³ *Konventa e Vjenës*, neni 8, paragrafi 2.

lartë mundësia e parashikimit vlerëson të kundërtën e kësaj, që të jetë person i kuptueshëm dhe e ka paraparë ndodhinë ose të metën (ngjarjen) në pozitën e njëjtë.

Pyetja e parashikueshmërisë paraqet elementin më të ndërlikuar të nenit 79, paragrafi 1, Konventa e Vjenës, sepse kjo është më e vështira që të dëshmohet. Nga kjo, të gjitha pengesat potenciale, shikuar teorikisht, në masë të caktuar janë të parapara. Të gjitha pengesat (p.sh. luftërat, vërshimet, zjarret, mbyllja e rrugëve të ujit), të cilat një herë kanë ndodhur në të kaluarën mund të ndodhin prapë edhe në të ardhmen dhe mund të bëhen pengesa për përmbushje të detyrimit të dorëzimit të mallit. Problemi me pengesa paraqet edhe atë mënyrë e cila mund të parashohë veprimin e tyre, por edhe kohën kur ajo ngjarje do të veprojë. Me rastin e vlerësimit të pengesave duhet të jetë përgjegjës në rastin konkret dhe mund të presë veprimin që do të shkaktojë pengesa.⁷⁸⁴ Për shembull, shitësi është i detyruar që me rastin e shuarjes së kontratës të merren në konsideratë vërshimet vjetore dhe problemet e transportit, por edhe ngricat për vendet në të cilat kjo dukuri është e zakonshme.⁷⁸⁵ Më pastaj nuk pretendohet që shitësi të merr në konsideratë ndodhitë për të cilat sipas parashikimit të përgjithshëm nuk mund të pritët që të ndodhin para se kontrata të përmbushet ose nëse kjo edhe ndodh, nuk pret që kjo të ndikojë në përmbushjen e kontratës.

Në praktikën gjyqësore dhe në arbitrazh është pranuar kuptimi tjetër i parashikueshmërisë: veprimi i ngjarjes që palët që janë marrë vesh është aq i pabesueshëm saqë nuk e shohin nevojën që shprehimisht të ndajnë rrezikun e veprimit të tyre, edhe pse ndikimi i saj mund të ketë rëndësinë që palët për këtë kanë biseduar, që ndodhitë të kenë qenë më të sigurt.⁷⁸⁶

Në bazë të të gjitha këtyre, që janë shënuar, mund të themi që parashikueshmëria e pengesave paraqet çështje të modelit dhe mostrës. Në bazë të kësaj gjyqtarit ose arbitrit do t'i duhej të kryejë vlerësimin në secilin rast konkret. Gjithashtu, me rastin e vlerësimit të faktorit të parashikueshmërisë merren parasysh rrethana të shumta. Për shembull, është shumë e rëndësishme pyetja sesa zgjat kontrata. Nëse kontrata është përmbyllur në afat më të gjatë kohor zvogëlohet mundësia e parashikimit të pengesës. Më pastaj, dikur lëndë e kontratës është malli i cili në bazë të çmimit të tij ka tendencë të ndryshimit në tregtinë ndërkombëtare.

⁷⁸⁴ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *vepër e cituar*, fq. 155.

⁷⁸⁵ Po aty. fq. 155.

⁷⁸⁶ Pietro Trimarchi, *Commercial Impracticability in Contract Law: An Economic Analysis*, 11 *International Review of Law & Economics*, 1991, fq. 63, 65 prema Chengwey Liu, Remedies for Non-performance: Perspectives from the CISG, UNIDROIT Principles & PECL, September 2003, www.cisg.law.pace.edu

Të përfundojmë, masat me rastin e shpalljes së vendimit duhet të jenë sipas rrethanave të cilat kanë mbizotëruar, në kohën e shuarjes së kontratës dhe të marrin në konsideratë zakonet e profesionit të cilat është dashur që t'i parashohë me ekzistimin e pengesave ose me veprimin e tij të sërishëm.⁷⁸⁷

IV. 11.1.2.2.4. Pathyeshmëria e pengesës dhe pasojat e saj

Nëse shitësi nuk përmbush detyrimin e dorëzimit, ai nuk do jetë përgjegjës për mospërmbushje nëse dëshmon që deri te mospërmbushja ka ardhur për arsye të pengesave, të cilat ka qenë jashtë kontrollit dhe jashtë vullnetit të tij, dhe duke marrë në konsideratë pengesën e mospërmbushjes së kontratës, që ai duhet të tejkalojë ose të mbizotërojë një pengesë të tillë dhe pasojat e saj.⁷⁸⁸ Sipas kësaj, kushti i fundit kumulativ, i cili duhet të përmbushet për lirimin e shitësit nga përgjegjësia, është se nga ai nuk është pritur arsyeshëm që të tejkalojë ose të mbizotërojë pengesat dhe pasojat e tyre.

Norma e përmendur rregullon dy raste. Rasti i parë, varet nga tejkalimi i pengesës. Shitësi duhet të ndërmarrë masat kundër pengesave të tilla të cilat afrohen, por nuk mundet që *a priori* të vendoset në raport me përmbushjen e detyrimit konkret.⁷⁸⁹ Evitimi nënkupton marrjen e të gjitha detyrimeve pozitive.⁷⁹⁰ Mundësia e shiut, paraqet pengesën, e cila, mund të tejkalojë me ndërmarrjen e masave të përcaktuara të cilat përbëhen për zgjedhjen e mjetit të përshtatshëm transportues.

Situata e dytë, përshin mbizotërimin e pengesës dhe të pasojave të tyre. Në këtë rast pengesa vetëm sa ka filluar të veprojë dhe shitësi duhet të ndërmarrë të gjitha masat që të largojë ndikimin e saj, gjegjësisht që të largojë pasojat të cilat i ka shkaktuar pengesa. Për shembull nëse rastësisht vjen deri te stuhia, dhe malli të cilin shitësi duhet t'ia dorëzojë blerësit ndodhet në qiell të hapur, duhet sa më shpejt të mbulohet ose me mbulesë ose duhet zhvendosur malli në magazinë.

⁷⁸⁷ Niklas Lindström, *Changed circumstances and Hardship in the International Sale of Goods*, *Nordic Journal of Commercial Law*, 2006/1, fq. 9. Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 817.

⁷⁸⁸ *Konveta e Vjenës*, neni 79, paragrafi 1.

⁷⁸⁹ Fritz Enderlein & Dietrich Maskow, *International Sales Law*, fq. 324.

⁷⁹⁰ Bruno Zeller, *Damages under the Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, New York, 2005, fq. 182.

Masa e cila përdoret, për tejkalimin e mënjanimin të pengesës, është ajo që edhe është pritur. Shitësi është përgjegjës që të krijojë përpjekje, që të tejkalojë ose të mbizotërojë pengesat dhe pasojat e tyre. Shitësi është përgjegjës të gjejë mënyra alternative të përmbushjes së kontratës dhe të bartë shpenzime shtesë. Pikërisht ai duhet të ketë në mendje, që shumica e pengesave mund të mbizotërojnë, por në shumë raste kjo nuk do jetë ekonomikisht e qëndrueshme, dhe nga shitësi nuk mund të presim mrekulli.⁷⁹¹ Nga shitësi nuk pritet që detyrimin ta kryejë me çfarëdo çmimi sepse rrezikon edhe ekzistimin personal. Gjithashtu, nga shitësi nuk mund të kërkohet që të marrë masa paraprake jashtë fushës së rrezikut, por as që të zbatohen mjete ilegale (p.sh. tregti me mall që të tejkalojë pengesat e eksportit të tij) që të tejkalohet pengesa.⁷⁹² Përmbushja e kushteve për lirimin nga përgjegjësia është çështje faktike dhe vlerësohet në secilin rast konkretisht. Varësisht nga lënda e kontratës vlerësohet edhe si mbizotërim i pengesës. Për shembull, nëse sendi është fundosur dhe mund të nxirret në gjendje të mirë, por krahas shpenzimeve të rëndësishme, vendimi nuk do të jetë ashtu, nëse objekti është eksponat i shtrenjtë artistik ose mjet mekanik.⁷⁹³

Sikur edhe te vlerësimi i paparashikueshmërisë masa është në pikëpyetje dhe kështu nëse shitësi është përgjegjës për dërgimin e mallin gjenerik (thëngjill, mjete ndërtimi) dhe nëse detyrimi i dorëzimit nuk është i kufizuar në një burim të caktuar, i cili është burim i furnizimit, burim që e ka pasur parasysh në rastin e shuarjes së kontratës, që më vonë është shuar. Shitësi në këtë rast nuk do të lirohet nga përgjegjësia sipas nenit 79, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Në këto raste, shitësi mund të tejkalojë pengesën ose mund të mënjanojë sigurimin e burimeve alternative të furnizimit. Rastin tjetër e kemi kur lëndë e kontratës është malli specifik gjenerik.

IV. 11.1.2.2.5.Shkaku

Shkaku i fundit dhe vendimtar është shkaku për lirim nga përgjegjësia. Ekziston shkaku i lidhjes në mes të shkeljes së kontratës dhe mungesave. Që të ndodhë kjo është e nevojshme mospërmbushja e kontratës dhe nga kjo ka ardhur për shkak të tejkalimit të kontrollit të shitësit, dhe ky shkak do të duhej që të ishte i paparashikuar dhe i pamposhtur.

⁷⁹¹ Bruno Zeller, *vepër e cituar*, fq. 182.

⁷⁹² Chengwei Liu, *Remedies for Non-performance: Perspectives from the CISG, UNIDROIT Principles & PECL*, September 2003, www.cisg.law.pace.edu

⁷⁹³ Bianca - Bonell, *vepër e cituar*, fq. 582.

Në teori nuk duhet të jetë pengesa shkaku kryesor i shkeljes së kontratës ose të së metës, por kjo duhet të ndikojë përfundimisht në shkeljen (mospërbushjen) e kontratës. Sipas një mendimi të një grupi teoricienësh, lirimi nga përgjegjësia duhet të jetë shkaku kryesor i mospërbushjes së kontratës.⁷⁹⁴ Një grup tjetër autorësh e konsiderojnë se nuk mund të kërkohej që pengesa të jetë shkak dhe bazë e shkeljes së kontratës. Është i rëndësishëm vetëm dëmi nga i cili varet lirimi nga përgjegjësia. Dëmin të cilin e ka duruar shitësi, kur ka ndodhur shkatërrimi i mallit, nuk ka ekzistuar për faktin që është shkatërruar malli, por ka qenë shkak sepse malli nuk ka qenë i paketuar sipas rregullit të përcaktuar. Sipas këtij mendimi; është e rëndësishme se, a e ka shkaktuar e meta, shkeljen e kontratës? Sipas mendimit tonë, për t'i dhënë përgjigje pyetjes së rëndësishme, të ngritur prej nesh, duhet të nisemi nga parimi bazë që, secila palë kontraktuese është përgjegjëse që kontratën ta përmbushë ashtu si janë marrë vesh në kontratë. Nëse shitësi nuk e përmbushë detyrimin atëherë ai duhet të ndërmarrë këto masa. Nëse shkelja e detyrimit është shkak i mospërbushjes së tij, atëherë shitësi edhe më tej do të jetë përgjegjës. Nëse shitësi nuk siguron paketim e përshtatshëm për mallin dhe si pasojë e kësaj, malli më vonë do të dëmtohet si shkak i veprimit të së metës (nga rastet e jashtëzakonshme) dhe shitësi prapë do të jetë përgjegjës. LMD-ja e përcakton që dërguesi është përgjegjës sepse: dërguesi ka për detyrë t'i paketojë sendet sipas mënyrës së parashikuar ose të praktikuar, kështu që të mos shkatohet ndonjë dëm ose të rrezikohet siguria e njerëzve ose e të mirave.⁷⁹⁵ Nëse malli është paketuar sipas të gjitha karakteristikave, si janë marrë vesh palët kontraktuese, dhe nëse ky detyrim është përmbushur sipas kontratës, dhe nëse ndodh ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme atëherë shitësi lirohet nga përgjegjësia. Shitësi do të lirohet nga përgjegjësia vetëm në rastet kur pengesa apo ngecja është shkak i veçantë (ekskluziv) i shkeljes së kontratës.

IV. 11.1.3. Lirimi për shkak të veprimit ose lëshimit të blerësit

Sipas neni 80 njëra palë nuk mund të thirret sepse pala tjetër nuk e ka përmbushur kontratën nëse ky veprim është pasojë e veprimeve të tij. Shitësi do të përgjigjet për veprimet e veta, domethënë për mospërbushje, nëse shitësi me veprimet e tij ka ndikuar në mospërbushjen e kontratës. Sipas parimit të përgjithshëm asnjë palë kontraktuese nuk mund të

⁷⁹⁴ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 583.

⁷⁹⁵ LMD, neni 672, paragrafi 1.

nxirret nga veprimet e veta, domethënë nga shkeljet e kontratës dhe nga sjellja e tij jokonform kontratës nuk do të nxjerrin dobi. Ky vendim është pranuar nga shumë vende.

IV. 11.1.3.1. Kushtet për lirim nga përgjegjësia

Shitësi lirohet nga përgjegjësia nëse janë përmbushur kushtet si në vijim: a) Duhet të jetë shkelur detyrimi i dorëzimit; b) Duhet të ekzistojë veprimi ose lëshimi i blerësit.

Neni 80, i Konventës së Vjenës, supozon se sjellja e blerësit është shkak i shkeljes së dorëzimit nga ana e shitësit.

IV. 11.1.3.1.1. Mospërmbushja e detyrimit

Nocioni mospërmbushje ka domethënie si në nenin 709, paragrafi 1, i Konventës së Vjenës. Ky është kuptim i përgjithshëm me të cilin janë përfshirë të gjitha shkeljet e kontratës dhe me këtë shkelja e detyrimit të dorëzimit. Nën nocionin mospërmbushje të detyrimit shprehimisht është përmendur në konsultimet e mëhershme dhe kjo nënkupton mospërmbushjen e detyrimit, vonesën e dorëzimit ose dorëzimin e një sasive më të vogël të mallit. Sipas LMD-së, nëse nuk është kontraktuar diçka tjetër, apo nuk rrjedh diçka tjetër nga vetë natyra e punës, shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në gjendje të rregullt së bashku me pjesët aksesore të tij.⁷⁹⁶ Çdo gjë tjetër, që nuk i përkon këtij neni, konsiderohet si mospërmbushje.

IV. 11.1.3.1.2 Veprimi i shitësit

Mospërmbushja e detyrimit duhet të jetë e shkaktuar me veprimin ose me lëshimin e blerësit. Me veprim nënkuptohet çdo aktivitet aktiv i blerësit. Detyrimi i veprimit të blerësit mund të jetë i shprehur nëpërmjet kontratës; për shembull, blerësi mund të ketë detyrim që t'ia dorëzojë shitësit vizatimet për ndërtimin e mjetit teknik, i cili është lëndë e kontratës për shitjen dhe që shtesë të japë specifikën e mallit. Neni 80, i Konventës së Vjenës, e përfshin edhe veprimin e lirë të besimtarit nga motivet e veta. Veprimi i blerësit mund të bazohet edhe në

⁷⁹⁶ LMD neni 451, paragrafi 1.

dhënien e udhëzimeve jokonkrete të transportit të mallit ose përpjekjet e tij që malli të jetë dorëzuar direkt nga prodhuesi duke e tejkaluar shitësin që është në kundërshtim me shuarjen e kontratës së shitjes.⁷⁹⁷ Shitësi nuk do të lirohet nga përgjegjësia edhe nëse blerësi me kalimin e afatit të arsyeshëm nuk e ka dorëzuar mallin dhe kështu ka ardhur deri te vonesa në dorëzim të mallit.

Lëshimi supozon që blerësi është i obliguar të veprojë ose të bashkëpunojë me shitësin, ndërsa blerësi nuk ka vepruar kështu. Shembull tipik i lëshimit ekziston kur blerësi nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për fitimin, për shembull, të lejeve të importit.⁷⁹⁸ Për çka ka qenë edhe i detyruar me anë të detyrimeve të marra me kontratë. Për lirimin e shitësit nga përgjegjësia, sipas nenit 80, Konventa e Vjenës, nuk është e nevojshme që veprimi ose lirimi i blerësit të paraqesë shkelje të kontratës. Megjithatë, nëse sjellja e blerësit paraqet shkelje të kontratës, atëherë shitësi sipas tij ka kërkesa duke u bazuar në nenin 61, të Konventës së Vjenës. Blerësi nuk mund të thirret në bazën për lirimin nga përgjegjësia nga neni 79, nëse veprimi i tij ose lëshimi i tij është pasojë e pengesës e cila është jashtë kontrollit të tij, ky veprim është papapararë dhe kjo është e pakapërcyeshme. Këtë e rregullon neni 80 duke e përfshirë lirimin e shitësit nga përgjegjësia kur ai nuk e ka përmbushur detyrimin, si pasojë e shkakut që ndodhet në lëmin e blerësit, e jo në përgjegjësinë e blerësit. Janë të barabarta veprimi dhe lëshimi i blerësit nga palët për të cilat ai bart përgjegjësinë, dhe kjo është pa lidhje sepse nuk dihet se nga ka ardhur deri te veprimi ose lëshimi nga vetë blerësi ose nga personi i cili është përgjegjës si, për shembull punonjësi i tij.

IV. 11.1.3.1.3 Lidhja shkakësore

Kushti i fundit për aplikimin e nenit 80, të Konventës së Vjenës, është ekzistimi i lidhjes shkakësore në mes veprimit ose lëshimit të blerësit dhe shkeljes së detyrimit të përmbushjes nga ana e shitësit, gjegjësisht është e nevojshme që mospërmbushja e shitësit ka ndikuar me veprimin ose lëshimin e blerësit. Lidhja shkakësore duhet të ekzistojë jo vetëm sipas logjikës, por duhet

⁷⁹⁷ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 839.

⁷⁹⁸ Jochem Schmidt, *vepër e cituar*, fq. 721; Peter Schlechtriem, *Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht*, fq. 789.

objektivisht të jetë pjesë e natyrës së tillë që ndalon përmbyshjen në përgjithësi ose pjesërisht të detyrimit.⁷⁹⁹

Lidhja shkakësore mund të jetë e menjëhershme edhe jo e menjëhershme. E para ekziston kur veprimi ose lëshimi i shitësit sjellin direkt deri te mospërmbyshja e detyrimit. E dyta, ekziston nëse është krijuar rreziku të cilin blerësi me veprimin vet dhe sjelljen e tij e ka krijuar dhe mund t'i takojë fushës së përgjegjësisë së tij.⁸⁰⁰

Është shumë problematik rasti kur të dyja palët kontraktuese me sjelljen e tyre ndikojnë në mospërmbyshjen e detyrimit të dorëzimit.

Ekzistojnë shumë raste në praktikë në bazë të së cilës të dyja palët kontraktuese janë fajtorë për mospërmbyshjen e detyrimit. Por ka raste edhe kur me veprimin e njëres palë ndikohet edhe pala tjetër duke mospërmbyshur detyrimin.

Një qëndrim tjetër është se veprimet e palëve kontraktuese janë aq të lidhura saqë ndikimi i tyre në shkeljen e kontratës nuk mund të kufizohen te njëra ose te pala tjetër.

Ekzistojnë disa teori lidhur me këtë çështje. Teoria e parë është se, palët duhet të kufizohen në rastet kur kreditori ekskluzivisht i shkakton detyrime debitorit.⁸⁰¹

Sipas qëndrimit të dytë, neni 80, të dyja palët mund të kontribuojnë në mospërmbyshjen e detyrimit. Mendimi i teoricienëve të tjerë është kontributi i dyja palëve kontraktuese, por ai që ka pasur ndikim më të madh është kreditori.⁸⁰²

IV. 11.1.3.2. Rregullat për lirimin e shitësit nga përgjegjësia për veprimet ose lëshimet e blerësit

Shitësi nuk mund të thirret për mospërmbyshje të detyrimit nga ana e blerësit, kur ai ka ndikuar me veprimin, sjelljen ose lëshimin e tij. Kjo domethënë që blerësi për shkak të veprimeve të tij humbet mjetet për shkeljen e kontratës në raport me nenin 45, paragrafi 1, të Konventës së Vjenës. Të drejtat që blerësi humbet janë: blerësi humbet të gjitha të drejtat dhe kërkesat të cilat tejkalojnë shkeljen e detyrimit të dorëzimit, blerësit nuk i qëndrojnë në posedim

⁷⁹⁹ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 840.

⁸⁰⁰ Peter Schlechtriem, *Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht*, fq. 790.

⁸⁰¹ Po aty, *vepër e cituar*, fq. 629; Wilhelm Albrecht Achilles, *vepër e cituar*, fq. 244.

⁸⁰² Julius von Staudinger & Ulrich Magnus, *vepër e cituar*, fq. 794.

të drejtat për kompensimin e dëmit, por as të drejtat për shkëputje të kontratës, as për zvogëlimin e çmimit, si dhe kërkesat për përmbushje të kontratës.

IV. 11.2. Baza për lirimin e shitësit nga përgjegjësia për mospërmbushje të detyrimit tek e drejta vendore

Debitori lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nëse dëshmon që nuk ka mundur të përmbushë detyrimin e tij, kur ai është vonuar me përmbushjen e detyrimit për shkak të rrethanave të krijuara pas lidhjes së kontratës, të cilat ai vetë personalisht nuk ka mundur t'i ndalojë, t'i largojë ose t'i tejkalojë.⁸⁰³ Ky është rregull i përgjithshëm për lirimin nga përgjegjësia e mospërmbushjes së kontratës dhe që aplikohet te përgjegjësia e shitësit për mospërmbushje të detyrimit në përgjithësi dhe për mospërmbushje të detyrimit në afatin e përcaktuar. Debitori lirohet nga përgjegjësia për dëmin në qoftë se provon se nuk ka mundur ta përmbushë detyrimin e tij, përkatësisht se është vonuar me përmbushjen e detyrimit për shkak të rrethanave të krijuara pas lidhjes së kontratës të cilat nuk ka mundur t'i parandalojë, t'i evitojë ose t'iu shmanget.⁸⁰⁴

IV. 11.3. Karakteri i normës për lirimin nga përgjegjësia

Dispozita 246, e LMD-së lidhur me këtë problematikë është dispozitive. Blerësi dhe shitësi mundën që me marrëveshje ose në një mënyrë tjetër të përcaktojnë përgjegjësinë e shitësit për dorëzim. Një mundësinë të tillë ligji e parasheh shprehimisht në nenin 246, 267 dhe 288 dhe u pranon palëve kontraktuese që të hapin, të kufizojnë ose tërësisht të përbyllin përgjegjësinë për shkeljen e kontratës dhe të detyrimeve të marra me të.

IV. 11.4. Kushtet për lirim nga përgjegjësia e shitësit për mospërmbushje të kontratës

Për lirim të shitësit nga përgjegjësia për mospërmbushje apo për vonesën e përmbushjes së kontratës duhet të përmbushen këto kushte të posaçme. E para, përmbushja e detyrimit ka

⁸⁰³ *Konventa e Vjenës*, neni 80.

⁸⁰⁴ *LMD*, neni 246.

qenë e pamundur. E dyta, pamundësia duhet të veprojë në kuadër të rrethanave të krijuara pas lidhjes së kontratës. E treta, shitësi këto rrethana nuk ka mundur t'i ndalojë, t'i mënjanojë ose edhe t'i ndalojë. Shitësi, duhet të dëshmojë veprimin e këtyre rrethanave dhe lidhjen shkaksore me pamundësi të përmbushjes.

KAPITULLI V: KOMPENSIMI I DËMIT SI PËRGJEGJËSI KONTRAKTORE E SHITËSIT PËR SHKAK TË SHKELJES SË DETYRIMIT TË DORËZIMIT

V.1. Vështirime të përgjithshme

Kompensimi është pasojë e mospërbushjes së kontratës nga ana e shitësit. Mospërbushja e mallit çon deri te kompensimi i dëmit. Ai ekziston gjithmonë krahas përbushjes së detyrimit ose edhe ndërron detyrimin kontraktues. Me kompensimin e dëmit, blerësi kompenzon humbjet e veta. Kompensimi i dëmit nuk është sanksion, nuk paraqet mjet sigurimi të kontratës siç janë penalet.

Nëse shitësi do të përmbushte detyrimin nuk do të aplikohesh fare kompensimi i dëmit. Me anë të kompensimit të dëmit me një fjalë arrihet një lloj satsifaksioni me anë të së cilës do të kompensoheshin humbjet e blerësit me ndonjë vlerë monetare ose edhe kompensimin e dëmit me ndonjë mall të nivelit dhe cilësisë së njëjtë.

Kompensimi i dëmit njëkohësisht paraqet edhe një lloj shtytjeje për shitësin sepse ajo nxit shitësin që të përmbushë detyrimin.

Edhe në të drejtën tonë edhe në atë ndërkombëtare me anë të kompensimit të dëmit blerësi kompenzon humbjet në përgjithësi për shkak të mospërbushjes së detyrimit të palës tjetër kontraktuese. Blerësi përveç kompensimit të dëmit material mund të kërkojë edhe humbjet e tij morale dhe këtë përmes kompensimit të dëmit moral, që është diçka që pala e inicicion personalisht.

Palës së cilës i është shkaktuar dëmi, në këtë rast blerësit, ka të drejtë gjithmonë të kërkojë kompensimin e tij. Nëse malli ka të meta materiale atëherë blerësi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit. Por, kompensimi i dëmit kërkohet me anë të një kërkesë në gjykatën kompetente vetëm nëse detyrimi kryesor i shitësit për dorëzimin e mallit nuk është përmbushur, ose, është përmbushur, por malli i dorëzuar ka të metat e veta si materiale ashtu edhe juridike. Me anë të kësaj nuk është përmbushur kontrata dhe blerësi krahas kësaj kërkon përmbushjen e kontratës dhe kompensimin e dëmit për shkak të mospërbushjes së kësaj kontrate të lidhur në mes palëve kontraktuese.

V.2. Kërkesa e blerësit për kompensim dëmi

Pacta sunt servanda dhe mospërbushja e kontratës paraqet automatikisht mospërbushje të detyrimit, mospërbushja e detyrimit të palëve kontraktuese dërgon edhe te kërkesa e palës së dëmtuar për kompensimin e dëmit.

Kërkesa e parë e blerësit është përbushja e kontratës, ndërkaq krahas kësaj si kërkesë subsidiare (dytësore) e cila krahas mospërbushjes është kërkesa për kompensimin e dëmit. Konventa e Vjenës në nenin 45, paragrafi 1, pika (b), paraqet kushtet materiale për kompensimin e dëmit. Paragrafët 74 dhe 75 janë rregulluar tërësisht për kompensimin e dëmit. Kushdo mund të kërkojë prej tjetrit që të mënjanojë burimin e rrezikut të dëmit të rëndësishëm që i kanoset atij ose numrit të pacaktuar të njerëzve si dhe përmbahet nga veprimtaritë nga të cilat rezultojnë trazimi ose rreziku i dëmit në qoftë se lindja e trazimit të dëmit nuk mund të parandalohet me masa përkatëse.⁸⁰⁵

Me nocionin shpërblim të dëmit nënkuptojmë detyrën juridike të dëmtuesit që ta zhdëmtojë materialisht dhe moralisht subjektin e dëmtuar.⁸⁰⁶ Qëllimi i shpërblimit të dëmit është që t'i mënjanojë pasojat e dëmshme të dëmit të shkaktuar. Ai ka për qëllim të krijojë gjendjen që ka ekzistuar tek i dëmtuari me shkaktim të dëmit.⁸⁰⁷ Dëmi material ekziston kur dëmtohen sendet e ndonjë subjekti; kur thyhet dera, vetura, kur rrëzohet murri i oborrit të ndonjë pronari, kur cenohet dinjiteti dhe përhapja e fakteve të pavërteta, që pasqyrohen përmes faktit se i dëmtuari nuk ka mundur të punojë; ai ka humbur klientët e vet, ose nuk mund të punësohet.⁸⁰⁸

V.3. Kompensimi i dëmit

Kompensimi i dëmit duhet të bëhet në atë mënyrë duke kompensuar të gjitha dëmet që i janë shkaktuar me jokompensimin e dëmit. Ai ka duruar dëme të cilat i janë shkaktuar me mospërbushjen e kontratës, përbushjen e saj me mall jo të përshtatshëm dhe mospërbushje sipas marrëveshjes. Me mospërbushjen e kontratës shkaktohet dëmi. Me shkaktimin e dëmit do

⁸⁰⁵ LMD, neni 138, paragrafi 1.

⁸⁰⁶ Nerxhivane Dauti.(2001). *E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Veçantë*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq.195.

⁸⁰⁷ Po aty, fq.195.

⁸⁰⁸ Po aty, fq. 195-196.

të shkaktohet edhe dëmtimi i blerësit, dhe me kompensimin e këtij dëmi ai do të zhdëmtohet. Zhdëmtimi duhet të bëhet nga ana e shkaktuesit të dëmit, dhe kompensimi i dëmit nuk dërgon në pasurimin e blerësit në asnjë mënyrë. Kompensimi i dëmit çon vetëm të kompensimi i asaj çka ai ka humbur me mospërbushjen e marrëveshjes.

Kompensimi i dëmit duhet të bëhet tërësisht, pra i gjithë dëmi që i është shkaktuar, pra dëmi material, por edhe dëmet e tjera që i janë shkaktuar atij, me mospërbushjen e kësaj kontrate. Kompensohet dëmi material dhe fitimi i humbur njëkohësisht. Konventa e Vjenës, në nenin 74, e parasheh këtë çështje duke potencuar kompensimin e dëmit dhe fitimin e humbur për blerësin. Shitësi është i detyruar të bëjë kompensimin e dëmit, por edhe fitimin e munguar që do të kishte blerësi po të ishte respektuar kontrata e lidhur. Po ashtu kompensimi i dëmit duhet të bëhet nëse shitësi ka dërguar mall jokonform kontratës. Nëse i është dërguar malli jokonform kontratës, është dashur të respektohet parimi se blerësi është dashur të dërgojë lajmërim (njoftim) për këtë çështje.⁸⁰⁹ Kodi Civil Shqiptar shpërblimin e dëmit e rregullon në kreun III. Dëmi pasuror, është dëmi që shpërblehet dhe që përbëhet nga humbja e pësuar dhe nga fitimi i humbur.⁸¹⁰

V.3.1.Kompensimi i dëmit sipas zgjedhjes së blerësit

Blerësi është i autorizuar dhe në rastin konkret që të zgjedhë se në cilën mënyrë do të kompensohet dëmi; kjo është llogaritje abstrakte e kompensimit të dëmit. Blerësi vetëpërcaktohet për mënyrën e kompensimit të dëmit i cili paraqet kompensimin më të përshtatshëm për të. Zgjedhja e blerësit nuk është përfundimtare, ajo mund të bëhet edhe më pastaj në një mënyrë tjetër, derisa interesi i tij të kompensohet, deri në momentin që ai arrin të jetë i kënaqur me shpërblimin për dëmin që i është shkaktuar.

V.3.2.Kompensimi i dëmit me mjete monetare

Kompensimin e dëmit sipas një rregulli të përgjithshëm, për shkak të mospërbushjes së kontratës, bëhet në mjete monetare. Kompensimi i dëmit gjithmonë duhet të bëhet në para nëse

⁸⁰⁹ *Konventa e Vjenës*, neni 44.

⁸¹⁰ *KCSH*, neni 640, paragrafi 1.

blerësi kërkon nga shitësi që të kryejë atë që është paraparë me kontratë; nuk mund të flitet për përgjegjësinë. Në dëmshpërblimin me para, i dëmtuari në vend të sendit të asgjësuar merr një sasi të caktuar parash për të blerë sendin e llojit të njëjtë.⁸¹¹ Shpërblimi i dëmit me para është pagim i dëmit me të holla si barasvlerë e përgjithshme.⁸¹²

Konventa e Vjenës, kompensimin e dëmit për mospërmbushje të kontratës në mënyrë të thjeshtë e parasheh me kompensimin e dëmit me para. Kompensimi i dëmit paraqet sasi të caktuar parash. Sipas LMD-së, nenit 169, paragrafi 1, secili person, i cili është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, ka për detyrë të rivendosë gjendjen, që ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Për pësimin e dhimbjeve fizike dhe shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor të shëmitmit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatohen rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës si edhe zgjatja e tyre, arsyeton se do të gjykojnë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.⁸¹³

V.4. Mënyrat e kompensimit

Kompensimi i dëmit mund të bëhet në dy mënyra - në mënyrë konkrete dhe abstrakte. E para llogaritet sipas rrethanave konkrete të rastit dhe paraqet humbje reale. Llogaritja abstrakte është llogaritur në atë mënyrë që dëmi nuk është reflektim real i humbjes reale. Në shumicën e teorive flitet për llogaritjen abstrakte. Sipas mendimit tonë kjo nuk është reale sepse llogaritja abstrakte paraqet vështrim monetar të dëmit real konkret. Gjykata duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë ose në para, njëherësh ose me këste.⁸¹⁴

⁸¹¹ Nerxhivane Dauti. (2001). *E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Veçantë*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, fq.195.

⁸¹² Po aty, neni 197.

⁸¹³ LMD, neni 183 paragrafi 1.

⁸¹⁴ Kodi Civil Shqiptar, neni 643, paragrafi 3.

V.5.Mënyra konkrete e kompensimit të dëmit

Mënyra konkrete e kompensimit të dëmit është paraparë në nenin 74, të Konventës së Vjenës. Zvogëlimi i gjendjes reale për secilin blerës veç e veç, në mes të shkaktimit të dëmit, duhet të merrra në konsideratë rrethanat e secilit rast veç e veç. Baza teorike e llogaritjes së kompensimit të dëmit qëndron në kuptimin se, caku i kompensimit të dëmit është që, i dëmtuari të sillet në pozitë të njëjtë ekonomike në të cilin do të ishte, po qe se do të përmbushej kontrata. Kompensimi konkret do të thotë kompensim i dëmit të shkaktuar dhe dëmit të dëshmuar. Blerësi duhet të dëshmojë se cilin dëm e ka duruar (përjetuar). Kompensimi i dëmit duhet të bëhet për dëmin e shkaktuar dhe fitimin e munguar. Krahas dëmit material gjithsesi duhet të jetë edhe dëmi moral.

V.5.1. Dëmi real – dëmi i rëndomtë

Përveç kontratës, si burim i rëndësishëm i detyrimeve, ekziston si burim edhe shkaktimi i dëmit dhe detyrimi që ky dëm të shpërblehet.⁸¹⁵ Qëllimi i përgjegjësisë juridiko-civile është mbrojtja e subjektit dhe e pasurisë së tij nga pasojat që vijnë prej veprimeve të paligjshme dhe të dëmshme të personave që të mbajnë një sjellje të tillë.⁸¹⁶

Dëmi është zvogëlimi apo pakësim i pasurisë së dikujt (dëmi i rëndomtë) apo pengimi i rritjes apo zhvillimit të saj (dëmi i humbur) si dhe kur tjetrit i shkaktohet dhimbje fizike, psikike apo frikë (dëmi jomaterial).⁸¹⁷ Neni 608 i KCSH-së parashikon se: Personi në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkaktonte dëm tjetrit (....) dhe në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Dëmi nuk kompensohet nëse dëshmohet që shitësi nuk është fajtor. KCSH-ja, në nenin 609, parasheh që: Dëmi duhet të jetë si rrjedhojë e drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Konventa e Vjenës nuk përcakton në detaje se cilat dëme paraqesin dëmin e vërtetë. Në teorinë e shitjes ndërkombëtare të gjitha dëmet e pësuar janë dëme për shkak të mospërmbushjes, gjegjësisht për shkak të shkeljes së kontratës dëmet e palëve ose dëmet e rëndësishme.⁸¹⁸

⁸¹⁵ Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). *E Drejta e Detyrimeve*, Tiranë. fq. 94 dhe 95.

⁸¹⁶ Mehdi Hetemi. (1998). *Detyrimet dhe Kontratat*, Tiranë, fq. 76.

⁸¹⁷ Riza Smaka. (2008). *E Drejta Biznesore*, Universiteti Iliria, Prishtinë, fq. 28.

⁸¹⁸ Peter Schlechtriem & Ingeborg Schwenzer, *vepër e cituar*, fq. 753.

V.5.2. Dëmi i shkaktuar për shkak të mospërmbushjes së kontratës

Kur shitësi nuk e dorëzon mallin fare, kur ai vonohet me dorëzimin dhe kur nuk dorëzon mallin sipas kontratës, blerësi është i autorizuar që të ndërmarrë të gjitha masat për kompensimin e dëmit të tij. Ai do të kërkojë nga shitësi që i gjithë dëmi të kompensohet dhe jo vetëm dëmi i vërtetë, por edhe fitimi i humbur. Nëse të metat e mallit të dorëzuar janë aq të mëdha saqë ajo për blerësin është e pavlefshme, dëmi i thjeshtë është i njëjtë sipas vlerës së mallit. Nëse vlera e mallit është zvogëluar, humbjet reale të humbura për blerësin paraqesin dallim në mes vlerës objektive të mallit të dorëzuar në sasi më të vogël. Nëse blerësit i është dorëzuar makina e cila ka të meta, dëmi i blerësit përfshin edhe humbjet të cilat janë pasojë e zvogëlimit të prodhimit për periudhën në të cilën makina nuk është përdorur (fitimi i humbur). Në rast të dorëzimit të mallit në sasi më të vogël, blerësi mund të ndërmarrë masa me cakun që të jetë në pozitë të njëjtë me atë që do të ishte po të përmbushej kontrata. Në rast të vonesës së shitësit dëmi direkt mund ta pasqyrojë këtë si më poshtë: Blerësi mund të jetë i dëmtuar sepse ka pasur shpenzime të caktuara për shkak të pranimit të mallit kanë qenë të kota, dhe duhet prapë t'i bëjë. Nëse shitësi kurrë nuk e ka dorëzuar mallin, blerësi ka të drejtë për kompensim të shpenzimeve.

V.6. Dëmet anësore

Blerësi mund të krijojë shpenzime të caktuara në cakun e tejkalimit të humbjeve shtesë. Dëmet e tilla thirren si dëme anësore. Konventa e Vjenës shprehimisht nuk e përmend që dëmet anësore kanë qenë të kompensueshme, kjo tejkalon edhe kapitullin e kompensimit të përgjithshëm të dëmit. Në rast të vonesës së shitësit blerësi mund të kërkojë që, për shembull, në kompensimin e shpenzimeve të magazinimit të mallit të dorëzuar më vonë. Blerësi ka të drejtë në kompensimin e dëmit për konfirmimin e dëmit ose tejkalimin e tij, por edhe zvogëlimin e tij.⁸¹⁹ Kjo domethënë që në rast të dorëzimit të mallit në sasi më të vogël, dëmi anësor paraqet shpenzimet e konfirmimit se a është malli konform kontratës.

⁸¹⁹ Po aty.fq. 757.

V.7. Pasojat e dëmit

Secila shkelje e kontratës, blerësit mund t'i shkaktojë dëme shtesë për shkak të marrjes së dëmeve sipas palëve të treta dhe humbje të tilla i konsiderojmë si pasojë. Kur shitësi i ka shitur mallin personit të tretë, dhe shitësi nuk përmbush detyrimin ose dërgon sasi më të vogël të mallit, dëmi shihet si përgjegjësi e blerësit sipas konsumatorëve të tij. Si pasojë e kësaj, dëmi prej natyrës së tij është dëm indirekt. Konventa e Vjenës nuk e kufizon kompensimin e dëmit vetëm në dëmet direkte, dëmi është i kompensueshëm varësisht se çfarë dëmi është.

V.8. Lucrum cessans apo fitimi i humbur

Fitimi i munguar (ajo që do të fitohej nga pasuria nëpërmjet përdorimit normal të saj po të mos ishte shkaktuar dëmi jashtëkontraktor). Shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin. Shpenzimet e nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit janë shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin e dëmit në rrugë jashtëgjyqësore⁸²⁰. Nga kjo mund të konkludojmë se fitimi i humbur nuk paraqet vetëm dëm material, domethënë kompensimi për dëmin e mospërmbushjes së kontratës, por edhe atë që do ishte fituar në rast se malli do ishte dorëzuar me kohë.

Fitimi i humbur llogaritet në mënyrë të tillë që krahason gjendjen e pronësisë së blerësit dhe kjo gjendje që vepron, nuk do të jetë e veprimit të dëmshëm. Sipas kësaj, me rastin e matjes së fitimit të munguar në konsideratë merren gjendja faktike, gjegjësisht gjendja hipotetike e cila do të krijohej se shitësi rregullisht ka kryer detyrimin. Te shitja ndërkombëtare e mallit, matja e fitimit të munguar mund të krijojë probleme të përcaktuara. Konventa e Vjenës nuk përcakton më afër në cilën mënyrë duhet të llogaritet fitimi i humbur, si dhe çka nënkuptohet me këtë nocion. Ne mendojmë që blerësi, në secilin rast, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të cilin e ka duruar me rastin e shkaktimit të dëmit, si dhe fitimin e humbur të cilin do ta realizonte në rast të përmbushjes së kontratës, sipas asaj që janë marrë vesh. Dëmi i fituar paraqet mbetje të shtimit të pasurisë. Në një rast të tillë, fitimi nuk është i mjaftueshëm, kemi pritje subjektive të të dëmtuarit, por ekziston mundësia objektive e shtimit të fitimit.

⁸²⁰ Ardian Nuni, Ilir Mustafaj & Asim Vokshi. (2008). *E Drejta e Detyrimeve I*, Tiranë, fq. 100.

Dëmi emergjent dallon nga fitimi i munguar dhe të dy janë dëme, por ne mendojmë se në mes tyre ekziston dallimi qenësor dhe konkretisht se i pari, pra dëmi emergjent është dëm që është shkaktuar ndaj sendit, i cili është në posedim apo më mirë të themi, është send ose mall i cili preket, ndërkas fitimi i munguar është dëm që është shkaktuar, gjegjësisht dëmi që po të ekzistonte sendi ose malli, ashtu si janë marrë vesh, do të kishte përfitime shtesë. Për fitimin e munguar KCSH-ja flet në nenin 640, paragrafi 1. Fitimi i munguar pra mund të llogaritet si dëm që do të shkaktohet në të ardhmen, pra nuk ka ndodhur, por do të ndodhë. Problemi qëndron në atë se Konventa e Vjenës dhe as KCSH-ja, apo LMD-ja nuk e përcakton çështjen ose kohën sesa është blerësi i autorizuar që të kërkojë shpërblimin e fitimit të humbur. Në teori mbizotëron qëndrimi se kërkesa për fitimin e humbur nuk është e afatizuar. Fitimi i humbur është pasojë e shkeljes së kontratës, gjegjësisht shkeljes së obligimit për dorëzimin e mallit. Blerësi nuk mund të jetë pasiv, por është i detyruar që të ndërmarrë masa në cak të zvogëlimit të dëmit. Shkelja e kontratës ose më mirë të themi mospërmbushja e detyrimit të shitësit, ka ardhur se tek të dyja palët ka ekzistuar lidhja shkasore. Konventa e Vjenës, neni 74 në mënyrë të qartë e detyron debitorin, në rastin tonë shitësin, që t'kompensojë dëmin e shkaktuar ndaj blerësit. Blerësi mund të kërkojë kompensimin e dëmit për dëmet të cilat janë pasojë e mospërmbushjes së detyrimit. Kompensimi duhet të bëhet nga ana e shitësit.

Konventa e Vjenës e përcakton, që është e nevojshme se dëmi ka vepruar në mes të shkeljes së detyrimit. Shkelja e detyrimi të dorëzimit paraqet kusht për kompensimin e dëmit dhe ka vlerë të shkakut nëse si pasojë është *conditio sine qua non*. Nuk është me rëndësi nëse shkelja direkte ose indirekte e ka shkaktuar dëmin. Sipas mendimit të përgjithshëm janë të kompensueshme humbjet direkte ose indirekte.

V.9. Mjetet monetare të shpërblimit të dëmit

Është me rëndësi të ceket se me çfarë mjeti të pagesës bëhet shpërblimi i dëmit të shkaktuar te shitja ndërkombëtare. Pyetja se me çfarë mjeti monetar duhet të bëhet kompensimi i dëmit, sipas rregullit nuk është problem, kur të dyja palët kontraktuese janë të një shteti (kur të dyja palët kontraktuese janë të Shqipërisë ose të dyja nga Kosova). Po që se palët kontraktuese janë shtetas të Republikës së Shqipërisë të dyja palët kontraktuese dëmin që i kanë shkaktuar

njëri -tjetrit e bëjnë me valutën shtetërore, pra, me LEK Shqiptar, nëse janë shtetas të Kosovës atëherë shpërblimi i dëmit do të bëhet me valutën që përdoret në Kosovë, gjegjësisht me EURO.

Konventa e Vjenës nuk e rregullon në cilën valutë duhet të paguhet dëmi. Lidhur me këtë çështje kanë ndodhur përplasje të shumta në mes teoricienëve në botë. Ata ndahen në disa grupe. Grupit të parë, i takojnë ata që përcaktohen duke bërë shpërblimin e dëmit të përcaktuar sipas kontratës, po qe se kjo përcaktohet me kontratë. Problemi është më i madh kur kjo nuk është përcaktuar në kontratë, dhe këtë e diskutojnë dhe e përkrahin grupi i dytë i teoricienëve të cilët përcaktojnë valutë të shpërblimit, e cila është valutë e shtetit ku është shkaktuar dëmi.

Teoria e parë është mjaft e përshtatshme, por problemi kryesor është kur valuta për shpërblimin e dëmit nuk është përcaktuar në kontratë. Problemi rritet në teorinë e dytë, sepse teoria e dytë mund të jetë e papërshtatshme për të dyja palët kontraktuese, sepse dëmi mund të jetë shkaktuar në një shtet, ku nuk janë shtetas asnjëri nga palët kontraktuese, e posaçërisht është rrethanë shumë e vështirë në rastet kur shitësi nuk është shtetas i atij vendi. Në raste të tilla, duhet të bëjnë këmbimin e valutës në valutën e shtetit⁸²¹ në të cilën bëhet shpërblimi i dëmit.

⁸²¹ Dëmi duhet të kompensohet me valutën e shtetit në të cilin është shkaktuar dëmi.

KAPITULLI VI: PËRFUNDIMET / KONLUZIONET

Kontrata e shitjes është kontrata më e rëndësishme. Një prej qëllimeve kryesore të kontratës së shitjes është bartja e pronësisë së mallit të caktuar me kompensim të caktuar. Nga kontrata e shitjes lindin detyrime për të dyja palët kontraktuese; shitësi është i detyruar që t'ia dorëzojë mallin blerësit së bashku me dokumentacionin përkatës, por të bartë edhe pronësinë sipas teorisë tradicionale. Nga ana tjetër blerësi është i detyruar që të paguajë çmimin dhe të marrë lëndën e kontratës.

Sipas marrëveshjes së tij, por edhe sipas problemeve juridike, që mund të ndodhin në praktikë, detyrimet e shitësit janë shumë më tepër të ndërlikuara. Këtu, para së gjithash, mendohet për detyrimin e dorëzimit ku nuk është koncentruar pjesa më e rëndësishme e ndikimit detyrimor në kontratën e shitjes.

Shitësi gjithmonë ka detyrim të bartë sendin i cili edhe është lëndë e kontratës.

Në teori ekzistojnë dy kuptime të nocionit dorëzim, koncepti tradicional dhe ai komercial.

Sipas kuptimit tradicional caku i dorëzimit është bartja e pronësisë në lëndën e kontratës, prej shitësit te blerësi, kështu që blerësi mund ta përdorë sendin dhe nga përdorimi i tij të nxjerrë dobi. Në këtë mënyrë dorëzimin e sendit e përcakton edhe LMD edhe KCSH sepse shitësi është i detyruar që blerësit t'ia dorëzojë, por dhe t'i japë udhëzime sipas të cilave sendin mund ta marrë në vendin dhe në kohën e përcaktuar me kontratë. Dorëzimi i sendit është kuptuar në kuptimin e bartjes së pronësisë dhe detyrimi është përmbushur vetëm atëherë kur blerësi merr sendin, gjegjësisht kur sendi do t'i dorëzohet blerësit.

Nga ana tjetër, sipas kuptimit komercial, kuptojmë detyrimin, i cili konsiderohet se kryen të gjitha veprimet të cilat shitësi është i detyruar t'i kryejë, në mënyrë që blerësi të mund të pranojë mallin që dorëzohet. Kjo domethënë se shitësi duhet të krijojë të gjitha mundësitë për blerësit për fitimin e pronësisë në mall.

Cilat janë veprimet që duhet të ndërmarrë ai në rastin konkret, kjo varet edhe nga kontrata, por dhe nga natyra e punës.

Tradicionalisht, kuptimi i dorëzimit, mund të pranohet për disa arsye të tjera. E para, koncepti tradicional nuk i përgjigjet nevojave bashkëkohore të tregtisë së mallrave. Caku i dorëzimit është që blerësi e kap mundësinë reale të pajtueshmërisë së mallit. A do të përshtatet përmbushja e detyrimit me veprimin faktik të dorëzimit të mallit, domethënë me bartjen e

pronësisë, kjo nuk është me rëndësi. E dyta, dorëzimi si kuptim, apo si veprim material me ndikim detyrimor, mundëson shqyrtimin ndaras në shqyrtimin e pyetjeve të bartjes së pronësisë dhe kalimit të rrezikut, që do të thotë se shitësi duhet të krijojë të gjitha mundësitë që blerësit t'i mundësohet fitimi i pronësisë në mall. Cilat veprime duhet të ndërmerren në rastin konkret, kjo varet nga kontrata dhe nga natyra e punës.

Kuptimi tradicional i dorëzimit nuk mund të kuptohet nga shkaqet e mëposhtme. E para, koncepti tradicional nuk u përgjigjet nevojave të tregtisë bashkëkohore. Qëllimi i dorëzimit është që blerësi të fitojë mundësinë reale të posedimit të mallit. A do të përputhet përmbushja e detyrimit me veprimet faktike të dorëzimit të sendit, domethënë me bartjen e pronësisë nuk është e rëndësishme.

E dyta, dorëzimi është kuptuar si veprim material, me ndikim detyrimor, i cili mundëson shqyrtimin e problemit ndaras prej bartjes së pronësisë dhe kalimit të rrezikut. Kjo është kryesisht e rëndësishme për shitjen ndërkombëtare të mallit sepse çështja e fitimit dhe e bartjes së pronësisë në të drejtën vendore, zgjidhet në mënyra të ndryshme, me rastin e krijimit të normave uniforme, nuk ka qenë i mundur rregullimi i njehsuar i këtij problemi.

Për të gjitha këto, në tregtinë ndërkombëtare është përcaktuar se, palët kontraktuese janë pikat qendrore të kontratës së shitjes.

Me nocionin dorëzim, shitësi bart fuqinë e pajtueshmërisë të blerësi, dhe në këtë moment rreziku kalon te blerësi.

Në fund në mes të dorëzimit tradicional dhe komercial ekziston edhe një dallim i thellë. Dorëzimi kuptohet si akt i njëanshëm të dorëzimi komercial, derisa, dorëzimi në kuptimin tradicional është akt i dyanshëm.

Dorëzimi paraqet detyrimin e shitësit, që të kryhen të gjitha veprimet e domosdoshme, në mënyrë që blerësi të ketë mundësi për të fituar pronësinë mbi mallin e kontraktuar. Në bazë kësaj, nëse dorëzimi është kuptuar si akt i dyfishtë, nëse për përmbushjen e tij kanë qenë të nevojshme ndërmarrja e veprimeve të shitësit dhe blerësit, atëherë përmbushja e tij do të jetë e lidhur me kalimin e rrezikut që shpesh varet edhe nga dëshira e blerësit. Në këtë rast shitësi do të ndodhet në pozitë të vështirë.

Dorëzimi, në kuptimin e ngushtë, është ai veprim i vendosjes së mallit në posedim të blerësit, në vendin e caktuar, ose në transportin e përcaktuar, ose dorëzimi i mallit te blerësi ose te shpedicioni. Dorëzimi është veprimi i fundit të cilin e merr shitësi. Qëllimi i dorëzimit nuk

është që blerësi të fitojë pronësinë në mall, por fuqinë e tij reale të posedimit. Në këtë moment, kur shitësi i dorëzon mallin blerësit ose transportuesit ose në rastet kur mallin e vendos në posedim të blerësit, në vendin e caktuar, ai ka përmbushur detyrimin e tij kontraktor.

A do ta pranojë blerësi mallin, dhe a do të transportohet malli deri te blerësi, me qëllim përmbushjen e detyrimit të shitësit, kjo nuk ka rëndësi. Me dorëzim, në kuptimin e ngushtë, lidhet edhe kalimi i rrezikut.

Te dorëzimi distancional edhe kur shitësi duhet t'ia dërgojë mallin blerësit ai është i detyruar që të ndërmarrë edhe veprime të tjera (juridike ose faktike) të cilat përmbushin detyrimin në kuptimin e gjerë. Për shkak të rrezikshmërisë, që bartin në vetvete dhe sepse hapin veprime të caktuara të dorëzimit, përshkruajnë rregullat e dorëzimit, rregulla të cilat përcaktojnë dorëzimin në kuptimin e gjerë.

Dorëzimi në të njëjtën mënyrë përcaktohet edhe në burimet vendore dhe në burimet ndërkombëtare.

Konventat dhe LMD-ja nuk e përcaktojnë shprehimisht kuptimin e dorëzimit, por çojnë në veprime të cilat krijojnë përmbajtjen e saj.

Në Konventën e Vjenës, dorëzimi, është kuptuar si detyrim juridik i shitësit, i cili për të buron nga kontrata e shitjes dhe që është plotësisht e pavarur nga fitimi i pronësisë në mall.

Dorëzimi kuptohet si akt i njëanshëm i shitësit, në mënyrë që t'ia mundësojë blerësit fitimin e pronësisë dhe posedimin e mallit.

Veprimi i dorëzimit është veprim i përmbushjes, derisa suksesi i përmbushjes, që tregon ndikimin e fitimit real të pronësisë, nuk është pjesë përbërëse e detyrimit të dorëzimit. Sipas kësaj, shitësi detyrimin mund ta përmbushë në mënyrë të njëanshme, pa bashkëpunim dhe pjesëmarrje të veprimeve të caktuara nga ana e blerësit. Përkundër kësaj, me një përcaktim të tillë të dorëzimit të mallit detyrimet e palëve kontraktuese, njëra që ta dorëzojë mallin dhe tjetra që do ta marrë mallin ose që do ta pranojë mallin, janë qartësisht të ndara.

Në të drejtën tonë dorëzimi i mallit kuptohet si diçka tradicionale, si veprim me të cilin shitësi bart pronësinë e sendit te blerësi, me anë të të cilit i mundësohet që sendi të përdoret, por dhe të shfrytëzohet.

Detyrimi i dorëzimit të mallit është i përcaktuar si detyrim bilateral (i dyanshëm), për përmbushje të detyrimit bazë të shitësit, dhe kjo përmbushje e detyrimit, në masë të madhe varet edhe nga blerësi.

Kontrata për shitjen, rregullisht përmban rregulla përfundimtare nga të cilat varet edhe përmbushja e saj. Përkundër kësaj, jo rrallë marrëveshjet e palëve, fare, ose në mënyrë të pamjaftueshme rregullojnë problemin e pasojave të mospërmbushjes, ose të përmbushjes së detyrimit në sasi më të vogël.

Për krijimin e përgjegjësisë së shitësit, për dorëzim, është e nevojshme përmbushja e supozimeve të caktuara - duhet të jetë shkelur detyrimi i dorëzimit të mallit dhe duhet të shkaktohet dëmi. Shkaku i ekzistimit të përgjegjësisë kontraktore është shpërblimi i dëmit.

Nëse me shkeljen e kontratës blerësit nuk i është shkaktuar asnjë dëm, nuk ka vend për përgjegjësinë kontraktore.

Sipas rregullave që përmban Konventa e Vjenës, baza e përgjegjësisë kontraktore për dorëzim, është shkelje e detyrimit kontraktor. Për përgjegjësinë e shitësit është e nevojshme edhe shkelja e detyrimit, si një përgjegjësi objektive, e pavarur nga fajësia, e cila, ekziston gjithmonë kur nuk ekzistojnë rrethanat të cilat çojnë kah lirimi i përgjegjësisë.

Tek e drejta jonë për mospërmbushje dhe për vonesën e shitësit për dorëzimin e mallit, shitësi përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë kontraktore në bazë të parimit të përgjegjësisë subjektive me fajësinë e supozuar. Ekzistimi i pakujdesisë së rëndomtë gjithmonë supozohet derisa mënyrat e tjera të fajësisë nuk supozohen, por dëmtuesi duhet t'i dëshmojë ato. Në teorinë tonë, në praktikë, pakujdesia nga neglizhenca, kuptohet në mënyrë objektive, sepse sjellja e shitësit, vlerësohet në mënyrë abstrakte sipas modelit të tregtarit të mirë ose specialistit, por jo konkretisht sipas mundësive të tyre individuale.

Shitësi përgjigjet për të metat materiale, te sendet që ai ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut te blerësi, dhe këtë pa marrë parasysh se a ka qenë i njoftuar më herët. Në këtë rast shitësi përgjigjet njësoj sikurse edhe te shitja ndërkombëtare e mallit, sipas parimeve objektive të përgjegjësisë, pa marrë parasysh fajësinë.

Shitësi është i detyruar që të garantojë blerësit se te malli i blerë nuk ekziston ndonjë e drejtë e personit të tretë që të përmbushë, të zvogëlojë ose të përkufizojë të drejtën e blerësit. Sipas kësaj shitësi përgjigjet, sipas rregullave të përgjegjësisë garantuese, edhe për të metat juridike të mallit të dorëzuar.

Shitësi mund të dëmtojë detyrimin e dorëzimit, nëse në përgjithësi nuk e dorëzon mallin ose nëse me dorëzimin e mallit do të vonohet, ose nëse dorëzon mall i cili ka të meta materiale-juridike.

Vonesa e shitësit në dorëzimin e mallit është shembull tipik i vonesës së debitorit. Konventa e Vjenës, sipas së drejtës anglosaksone, nisët nga shkelja (mosrespektimi) e kontratës. Vonesa konsiderohet lloj i shkeljes së detyrimit të dorëzimit dhe nuk është e rregulluar me rregulla të veçanta.

Shitësi ka gabuar për kohën e rregullt të dorëzimit vetëm atëherë kur nuk është dorëzuar asgjë në afatin e konfirmuar. Nëse shitësi dorëzon çdo gjë blerësit në posedim, ai bartë përgjegjësi për të metat e konformitetit. Në këtë mënyrë, vonesa është e njëjlojtë me vonesën e dorëzimit në tërësi. Sistemi që është pranuar në Konventën e Vjenës është i mirë, sepse i përgjigjet nevojave të tregtisë.

LMD vonesën e shitësit e aplikon si rregull të përgjithshme për vonesën e debitorit, si dhe normat në të cilat është e rregulluar koha e dorëzimit të mallit. Për përgjegjësinë e shitësit për vonesën duhet të krijohen kushte të veçanta, të cilat kushte ne i ndajmë në kushte pozitive dhe negative.

Janë pozitive kushtet, të cilat, duhet të jenë të përmbushura për veprimin e vonesës, derisa ekzistimi i supozimeve ndalon vonesën e shitësit. Edhe sipas së drejtës sonë edhe asaj ndërkombëtare të shitjes ndërkombëtare të mallit, arritja e detyrimit është kusht i vetëm pozitiv për lëshimin e shitësit në vonesë pa marrë parasysh se a është caktuar afati për dorëzim të mallit. Edhe pse nuk është kusht ligjor, dërgimi i lajmërimit të shitësit është i dëshirueshëm, sepse pasiguria në mes të blerësit dhe shitësit në vështrim të arritjes së kohës së dorëzimit, kur afati nuk është përcaktuar, çon në masë më të vogël të shpërblimit të dëmit.

Kushtet negative, ekzistimi i të cilave ndalon veprimin e vonesës së shitësit, janë vonesa e blerësit me pranimin e dorëzimit dhe rasti kur shitësi, sipas blerësit, mund të përmendë ankesën e mospërmbushjes së kontratës.

LMD vonesën e përcakton objektivisht, kështu që për veprimin e tyre është e mjaftueshme që blerësi nuk përmbushë detyrimin e tij që ka arritur. Për rënie në vonesë nuk është me rëndësi shkak për të cilat shitësi nuk ka dorëzuar me mirëbesim mallin. Megjithatë, rregullat ndërkombëtare dhe ato vendore në mënyra të ndryshme përcaktojnë pasojat e veprimit të vonesës.

Konventa, pasojat e veprimit të vonesës i përcakton në mënyrë objektive, kështu që me shuarjen e kontratës shitësi garanton se detyrimet e tij do t'i përmbushë sipas rregullit. Nga ana tjetër, në shitjen ndërkombëtare për përgjegjësinë e shitësit për vonesën, fajësia e shitësit është

juridikisht relevante dhe ai, për vonesën e dorëzimit të mallit, i përgjigjet sipas përgjegjësisë subjektive me fajësinë e supozuar.

Përgjegjësia e shitësit, i cili ka ra në vonesë është e ashpërsuar, sepse përgjigjet edhe për të ashtuquajturin rast i përzier, gjegjësisht për pamundësinë e pafshehur, të pjesshme ose edhe të tërësishme të përmbushjes, nëse ka vepruar pas ardhjes së tij në vonesë, për të cilën ai edhe përgjigjet.

Shitësi është i detyruar që blerësit t'ia dorëzojë mallin në gjendje të rregullt. Ai do t'i përgjigjet blerësit për dorëzimin e mallit jokonform kontratës, gjegjësisht mallit me të metat materiale nëse kumulativisht përmbushen kushtet e mëposhtme.

E para, është e nevojshme që malli të jetë jokonform, që malli të ketë të meta materiale.

E dyta, mungesa duhet të ekzistojë në kohën e kalimit të rrezikut te blerësi.

E treta, blerësi duhet që mallin ta kontrollojë dhe me mirëbesim t'i dërgojë shitësit njoftimin për të metat e tij.

Në fund, nuk guxojnë të ekzistojnë rrethanat të cilat çojnë te lirimi i shitësit nga përgjegjësia.

Në të drejtën vendore dhe atë ndërkombëtare shitësi do të përgjigjet nëse ka dorëzuar sasi më të vogël të mallit.

Sipas Konventës së Vjenës, shitësi përgjigjet për konformitetin e mallit të dorëzuar, ndërkaq LMD-ja dhe Kodi Civil Shqiptar parashohin që malli nuk duhet të ketë të meta materiale, me rastin e dorëzimit të tij dhe se në rast se ato janë të pranishme duhet të njoftohet blerësi.

Krijimi i një koncepti të konformitetit është pasojë e kompromisit, dhe ka qenë e nevojshme për shkak të tejkalimit të dallimeve, të cilat kanë ekzistuar në mes të të drejtave të ndryshme kombëtare.

Megjithatë, sot nocioni i konformitetit është gjerësisht i pranuar në burimet ndërkombëtare dhe janë të nxjerra shkresa në kornizat e Bashkimit Europian, por edhe në të drejtat kombëtare. Konformiteti i mallit përfshin të gjitha karakteristikat fizike të mallit, jo vetëm të metat në cilësi, por edhe dallimet në sasi të mallit, dorëzimi i aliud-it, si dhe, për të metat në paketimin e mallit.

E drejta jonë nuk njeh nocionin e konformitetit, por kuptimin e të metave materiale, kuptim i cili është më i gjerë sesa kuptimi i të metave fizike.

Me kuptimin e meta materiale janë të përfshira fillimisht të metat reale (fizike).

E dyta, nocioni i të metave materiale përfshin edhe dorëzimin e sasisë më të vogël të mallit.

E treta, mungesa e paketimit të rregullt (ambalazhimit) mund të konsiderohet si mungesë materiale.

Në fund, me dorëzimin e aluid-it, në rastet e caktuara, do të duhej të trajtohej si e metë materiale. Duke e pasur parasysh në vështrim të parë që, përdorimi i nocionit konformitetet më mirë do t'i përgjigjej përmbajtjes së tij. Përfshirja e kuptimit konformitetet do të jetë e tërësishme edhe në raport me zhvillimin e së drejtës së shitblerjes. Sipas kësaj, në këtë mënyrë e drejta jonë do të rregullohej me normat juridike norma të cilat janë pjesë e së drejtës komutative, si dhe normave të së drejtës me anë të cilës është e rregulluar shitja ndërkombëtare e mallit.

Me nocionin e përgjithshëm të (jo)konformitetit do të përfshihen të gjitha të metat materiale dhe juridike.

Në fund, përfshirja e nocionit konformitetet do të sjellë deri te veprimi i njëjtë tek të gjitha llojet e të metave, dhe si rrjedhojë siguri të rëndësishme juridike.

Shitësi përgjigjet vetëm për jokonformitetin, që ka ekzistuar në kohën e kalimit të rrezikut te blerësi.

Nëse malli është konform, në kohën e kalimit të rrezikut, blerësi sipas rregullit nuk ka të drejta, e aq më shumë, nëse ajo bie në mes të ndikimeve të jashtme dhe më vonë nuk i përgjigjet dispozitave të kontratës.

Te shitja ndërkombëtare e mallit, nuk mund të lirojmë nga rreziku shitësin- nga përgjegjësia si dhe për shkeljen e disa përgjegjësive të tij.

Shitësi do të përgjigjet për çdo të metë të konformitetit që është lajmëruar pas momentit të kalimit të rrezikut dhe që mund të shënohet si shkelje e secilës përgjegjësi të tij, duke përfshirë shkeljen e garancisë, që malli për një kohë do të mbetet i përshtatshëm për përdorim të zakonshëm ose për përdorim të rregullt dhe do të përmbajë qëllime të caktuara si dhe karakteristika të caktuara.

Për krijimin e së drejtës, e drejta që është krijuar me kontratë (me lidhjen e saj) dhe në bazë të asaj që, malli është dorëzuar jokonform kontratës së lidhur, blerësi duhet që rregullisht ose me mirëbesim të lajmërojë shitësin për të metat në mënyrë që blerësi t'ia dërgojë ankesën (reklamacionin) shitësit.

Ankesa paraqet konstatimin e mospërmbushjes së detyrimit nga ana e shitësit, gjë që varet nga sasia e mallit të dorëzuar, cilësia e mallit, lloji i mallit ose paketimi që i është bërë mallit nga ana e shitësit, dhe në këtë mënyrë blerësi është i detyruar që të veprojë dhe që të mund të përdorë rregullat të cilat i takojnë atij në rastet e posedimit të të metave të mallit.

Parashtrimi e ankesës nuk është detyrim juridik, por është obligim. Moslajmërimi i shitësit për të metat ka pasoja serioze juridike.

Dorëzimi konsiderohet i rregullt, nëse blerësi është i detyruar që të paguajë çmimin. Në bazë të kësaj, ai humbet mundësinë që të përdorë mjete juridike, të cilat do t'i ketë në dispozicion në bazë të dorëzimit të mallit jokonform kontratës, blerësi në këtë mënyrë dhe me çdo kusht duhet të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Edhe në të drejtën ndërkombëtare edhe në atë vendore, blerësi sipas rrethanave të caktuara, nëse nuk dërgon lajmërimin të shitësi, ka të drejta të cilat i takojnë në bazë të të metave që posedon malli.

Shitësi nga blerësi nuk mund të kërkojë dërgimin e lajmërimit për të meta, nëse vetë e ka kuptuar ose nuk do t'i mbetet i panjohur fakti nga i cili varet e meta.

Në shitjen ndërkombëtare, shitësi duhet të jetë përgjegjës edhe atëherë kur blerësi ka arsyetim të arsyeshëm që nuk ka dërguar lajmërimin e kërkuar.

Në rastet e caktuara, kur malli ka të meta, shitësi për këtë nuk do të përgjigjet.

Shitësi nuk është përgjegjës nëse malli ka të meta materiale të parëndësishme.

Ai nuk do të përgjigjet për të metat nëse me rastin e shuarjes së kontratës blerësi ka ditur për të metat ose në këto rrethana ka qenë e mundur që të metat të ishin njohur.

Shitësi poashtu nuk përgjigjet për të metat e mallit të shitur në ofrimin e shitjes për shkak të realizimit të së drejtës ose procedurës së falimentimit.

Shitësi blerësit duhet t'ia dorëzojë mallin e lirë nga e drejta ose nga pretendimet e personit të tretë. Në të kundërtën, ai do të jetë përgjegjës për të metat juridike të mallit të dorëzuar. Kjo nënkupton se edhe vetë shitësi nuk guxon të kufizojë të drejtat e blerësit në mall.

Te shitja ndërkombëtare e mallit bëhet dallimi në mes të përgjegjësisë së përgjithshme për të metat juridike dhe përgjegjësisë kur në mallin e shitur ekziston e drejta ose kërkimi, i cili krijohet në pronësinë industriale ose intelektuale.

E drejta jonë, në një mënyrë të rregullt rregullon përgjegjësinë e shitësit për eviksion, pa marrë parasysh natyrën e së të drejtës të personit të tretë, e cila ekziston në mall.

Për përgjegjësinë e përgjithshme për të metat juridike është e nevojshme përmbushja kumulative e kushteve të mëposhtme.

Në mall duhet të ekzistojë përmbushja ose kërkesa e personit të tretë. E dyta, e meta juridike duhet të ekzistojë në kohën e përmbushjes së detyrimit.

E treta, është e nevojshme që blerësi në afatin e përcaktuar të lajmërojë shitësin për ekzistimin e së drejtës ose kërkimet e personit të tretë. Me këtë, pasojat juridike për mosnjohftimin e shitësit dhe për ekzistimin e të metave juridike, janë të ndryshme, në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore. Sipas Konventës së Vjenës mosparaqitja e ankesës për të metat juridike, çon në mungesën e së drejtës së blerësit që të përdorë mjetet juridike për shkak të ekzistimit të të metave juridike. Blerësi edhe përkundër lëshimit të detyrimit të njohftimit mund të thirret në vese nëse vetë shitësi ka pasur njohuri për të drejtën, për kërkesat e personit të tretë dhe për natyrën e tyre, ose në rastet kur blerësi ka arsyetim të arsyeshëm, që nuk ka dorëzuar lajmërimin e kërkuar për të metat.

Në të drejtën tonë, me anë të lajmërimit, blerësi duhet ta njoftojë shitësin për të metat juridike.

E fundit, është e nevojshme që të mos ekzistojnë rrethanat të cilat çojnë në shuarjen e përgjegjësisë së shitësit për të metat juridike.

Shitësi nuk do të përgjigjet për eviksionin, edhe atëherë kur janë plotësuar të gjitha supozimet e përgjegjësisë së tij nëse blerësi pajtohet që ta pranojë mallin me të metat juridike.

Te shitja ndërkombëtare e mallit shitësi do të përgjigjet nëse në mallin e blerësit ekziston e drejta ose kërkesa që krijohet në të drejtën e pronësisë intelektuale sipas kushteve të mëposhtme.

Në mallin e shitur duhet të ekzistojë e drejta ose hulumtimi i cili krijohet në pronësinë intelektuale dhe industriale.

E drejta ose kërkesa e krijuar në të mirat jomateriale duhet të ekzistojë në teorinë e caktuar.

E meta duhet të ekzistojë në kohën e dorëzimit.

Shitësi në kohën e shuarjes së kontratës duhet të dijë për ekzistimin e së drejtës.

Blerësi duhet që shitësin, në kohën e arsyeshme, ta lajmërojë për ekzistencën e së metës.

Në fund, është e nevojshme që të mos ekzistojnë rrethanat të cilat çojnë te shuarja e përgjegjësisë së shitësit.

Shitësi nuk do të përgjigjet nëse në kohën e shuarjes së kontratës blerësi e ka ditur ose ka qenë e panjohur për të, ekzistimi i asaj të drejte dhe kërkitimi është pasojë e ndikimit të shitësit, sipas planeve teknike, vizatimeve, formulave, ose rasteve të tjera specifike të cilat i ka vendosur blerësi.

Parimi i përgjithshëm i palëve kontraktuese *pacta sunt servanda* përcakton që secila palë kontraktuese është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimit. Ndonjëherë, megjithatë mund të veprojë ajo situatë ose ajo rrethanë, e cila me përmbushjen e kontratës, në masë të madhe, vështirëson ose e bënë të pamundur përmbushjen e kontratës, por edhe jo pak e rëndojnë ose edhe e bëjnë të pamundur këtë përmbushje. Aplikimi i një parimi të tillë në këto situata do të na çonte drejt qëllimit të kundërt me atë që të mbrojë palët kontraktuese. Pikërisht, për këtë edhe Konventa e Vjenës edhe LMD përmbajnë rregulla të cilat i rregullojnë këto situata.

Përgjegjësia e shitësit për dorëzimin e mallit varet edhe nga shpërblimi i dëmit për të cilin është shkelur detyrimi i dorëzimit.

Në kërkesën për shpërblimin e dëmit qëndron garancia, që është më e rëndësishmja për përmbushjen kontraktore. Ajo mund të ekzistojë krahas përmbushjes së detyrimit kontraktues ose mund të ndërrojë detyrimin kontraktues.

Caku kryesor për shpërblimin e dëmit, është, që blerësit t'i kompensohen humbjet e pësuarat, në rastet kur shitësi nuk e ka përmbushur detyrimin e tij.

E drejta e blerësit për shpërblimin e dëmit tejkalon direkt nga parimi *pacta sunt servanda* sepse ndikimi i tij kryesor është që ta detyrojë shitësin me detyrimin monetar, detyrimin e dorëzimit, i cili i është premtuar, por nuk është përmbushur ose është përmbushur në sasi më të vogël. Shpërblimi i dëmit të shitja ndërkombëtare e mallit, por edhe tek ajo kombëtare, që duhet të kompensojë blerësin, nuk ka karakter penal dhe paraqet satisfaksion për blerësin.

Me rastin e matjes së shpërblimit të dëmit aplikohen parime të shpërblimit të plotë, parime të zgjedhjes së lirë të blerësit në shikim të mënyrës së matjes së dëmit dhe parimit të shpërblimit të dëmit.

Shpërblimi i dëmit mund të bëhet në dy mënyra : në mënyrën konkrete dhe në mënyrën abstrakte.

E para është e llogaritur sipas rrethanave konkrete të rastit dhe paraqet humbje reale.

Llogaritja abstrakte (diferenciale) e kompensimit të dëmit paraqet mënyrën e llogaritjes së kompensimit të dëmit në bazë të dallimit në mes të çmimit të kontraktuar dhe çmimit të tregut.

Llogaritja abstrakte e dëmit paraqet dëmin minimal, dëm që mund të jetë llogaritur për blerësin pa dëshmi të caktuara.

LISTA E REFERENCAVE / LITERATURA

a). Burime Parësore

- CISG – Advisory Council Opinion no. 2, Examination of the Goods and Notice of Non-Conformity: Articles 38 and 39, 7 June 2004, www.cisg.law.pace.edu
- CISG – Advisory Council Opinion no. 6, Calculation of Damages under CISC Article 74, 7 May 2005, www.cisg.law.pace.edu
- CISG – Advisory Council Opinion no. 7, Exemption of Liability for Damages Under Article 79 of the CISG, 12 October 2007, www.cisg.law.pace.edu
- Distr.General 23.Pril 2015, <http://www.uncitral.org/uncitral/en/index.html,A/CN.9/849>, qasur me: 2.06.2015.
- Distr.General 5. Maj. 2015, <http://www.uncitral.org/uncitral/en/index.html>, A/CN.9/824, qasur me: 2.06.2015.
- *International Chamber of Commerce, The new Incoterms*, www.icco.org,
- Kodi Civil Austriak,
- Kodi civil Gjerman
- Kodi Civil i Francës
- Kodi Civil i Italisë
- Kodi Civil i Shqipërisë, i vitit 1929 (Kodi i Ahmet Zogut).
- Kodi Civil i Shqipërisë, i vitit 1981
- Kodi Civil i Shqipërisë, i vitit 1994
- Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private 31 Tetor 1951 ndryshuar me 30 qershor 2005
- Konventa për qasje në materie të shitja ndërkombëtare e mallrave nga viti 1983,
- Konventa për të drejtën ndërkombëtare autoritare të shitja ndërkombëtare e mallrave e vitit 1985.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Nderkombetare të Mallrave, Konventa e Vjenës 1980.
- Konventa e OKB-së për shpërndarje dhe qasje në materien e shitjes ndërkombëtare të mallit nga viti 1983.

- Konventa për të drejtën autoritare të shitja ndërkombëtare e mallrave nga viti 1974,
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Lex Mercatoria
- Lex Mercatoria: Intellectual Property
- Lex Mercatoria: Transport, Including carriage of Goods
- Ligji nr: 10 092, i datës 09.03.2009. Për aderrimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave”
- Ligji për tregtinë e Brendshme, Ligji Nr.2004/18
- Ligji për Hipotekat, nr 2002/4.
- Ligji për Mardhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.04/L-077, Nëntor 2012.
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore, i Kosovës, Ligji nr.03/L-154, 25.06.2009
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore, i Kroacisë i vitit 1996 (Zakon o vlasništvu i drugim stvarnim pravima).
- Ligji për shoqëritë tregtare, Ligji nr02/-123
- Ligji për të drejtën ndërkombëtare private, i Republikës së Shqipërisë Nr 10 428 , 02.06.2011.
- Ligji për tregtinë elektronike, i Shqipërisë, Nr 10 128 i datë 11.05.2009,
- Ligji për tregti me jashtë, i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-048
- New Law of Obligations in Germany, 1.01.2002
- Opste uzanse sa promet robom, RSFJ nr.15/54
- Posebne uzanse u prometu robe na malo, SFRJ 12/78
- Principles of European Contract Law, www.cisg.law.pace.edu
- Principles of International Commercial Contracts (UPICC), www.cisg.law.pace.edu
- Resolution of 26 May 1989, OJEC No. C 158/401 of 26 June 1989.
- Resolution of 6 May 1994, OJEC No. C 205 (519) of 25 July 1994.

- Review of the Convention on Contracts for the International Sale of Goods (CISG), Pace International Law Review, The Hague, London, New York, 2004
- The United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods, 1984.
- UNCITRAL Model Law on Electronic Commerce (1996) with additional article 5 bis as adopted in 1998,
http://www.uncitral.org/uncitral/uncitral_texts/electronic_commerce/1996Model.html
- UNCITRAL Model Law on Electronic Signatures (2001),
http://www.uncitral.org/uncitral/uncitral_texts/electronic_commerce/2001Model_signatures.html
- UNICITRAL <http://www.uncitral.org/uncitral/commission>
- UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts 2010, <http://www.unidroit.org/english/principles/contracts/principles2010/integralversionprinciples2010-e.pdf>
- Uniform Law Review,
<http://www.unidroit.org/english/publications/review/contents/2011-3.pdf>
- Uniform Law Review, *The Harmonisation of Contract Law within Ohada*, VOL XIII 2008, <http://www.unidroit.org/english/publications/review/contents/2008-1&2.pdf>
- United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods (Vienna, 1980)(CISG) http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/sale_goods/1980CISG.htm
- United Nations Convention on the Use of Electronic Communications in International Contracts (New York, 2005), ka hyrë në fuqi me datën 1 Mars 2013
http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/electronic_commerce/2005Convention.html
- Zakon o Obligacionim Odnosima Gazeta Zyrtare SFRJ, nr. 29/78, 39/85, 45/89 dhe 57/89

b). Burime Dytësore

- Achilles, Wilhelm Albrecht. “Kommentar zum UN-Kaufrechtsübereinkommen (CISG)”, Luchterhand, 2000.
- Alishani, Alajdin. Odgovornost za materijalne nedostatke stvari, Beograd, 1996.

- Aliu, Abdulla. “E Drejta Civile I”, Pjesa e përgjithshme, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2008.
- Aliu, Abdulla “E Drejta Sendore (Pronësia)”, Prishtinë, 2006
- Aliu, Avdulla. . “E Drejta Civile ”, Universiteti i Prishtinës, “Hasan Prishtina”, Prishtinë 2013.
- Antonijević, Zoran. “Privredno pravo”, Beograd, 1970.
- Atiyah, P.S. An Introduction to the Law of Contract, 5th ed, Oxford, 1995
- Babić, Ilija. “Leksikon obligacionog prava”, 2. Botim plotësues dhe i zgjeruar Beograd, 2001.
- Bamberger, Erbrecht & Georg Roth, Heinz. “Kommentar zum Bürgerlichen Gesetzbuch, Band 3”, München, 2003.
- Bernstein, Herebert & Lookofsky, Joseph. “Understanding the CISG in Europe – A Compact Guide to the 1980 United Nations Convention on the Contracts for the International Sale of Goods”, Dordrecht, 1997.
- Bianca, Cesare Masimo & Bonell, Michael Joachim. “Commentary on the International Sales Law – The 1980 Vienna Sale Convention”, Milan, 1987.
- Bilalli, Asllan & Kuçi, Hajredin. “E Drejta Ndërkombëtare Private, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2009.
- Black, Henry Campbel. “Black's Law Dictionary”, ed. Garner, 8th Edition, St. Paul, 2004.
- Blagojević, Milan. “Novi međunarodni privredni poredak i savremeno međunarodno privredno pravo”, Novi Sad, 1976.
- Bonell, Michael Joachim . “A New Approach to International Commercial Contracts – The UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts”, The Hague, London, Boston, 1999.
- Brandić, Damjan. “Fjalor- Kroatisht-Gjermanisht”, Zagreb, 1996.
- Brestovci, Faik. “E Drejta e Procedurës Civile I”, Prishtinë, 2006.
- Brestovci, Faik. “E Drejta e Procedurës Civile II”, Prishtinë, 2006.
- Bridge, Michael. “The International Sale of Goods – Law and Practice”, New York, 1999.
- Brox, Hans. “Besonderes Schuldrecht”, 19. Auflage, München, 1993.
- Carić, Slavko, Stevan Šogorov & Jelena Vilus, “Međunarodno privredno pravo”, Novi Sad, 1996.

- Ćirić, Aleksandar & Cvetković, Predrag. “Menunarodno trgovinsko pravo – stručni eseji”, Niš, 2001.
- Ćirić, Aleksandar. “Odgovornost prodavca po ugovoru o isporuci izmenu organizacija socijalističkih zemalja”, Dokorate, Niš, 1987.
- Ćirić, Aleksandar. “Odgovornost prodavca za isporuku”, Beograd, 1989.
- Cvetković, Predrag. “Zaključivanje ugovora o menunarodnoj prodaji robe”, Magistarski rad, Niš, 2000.
- Dauti, Nerxhivane, “ E Drejta Kontraktuese”, Praktikum, Prishtinë, 2008.
- Dauti, Nerxhivane. “E Drejta e Detyrimeve pjesa e përgjithshme dhe e veçantë”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2001
- Dauti, Nerxhivane. “Kontratat”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2012
- Day, Griffin. “The Law of International Trade”, 3rd Edition, New York, 2004.
- Dega, Fatos. “*Pronësia Intelektuale*”, Shtëpia Botuese Morena, Tiranë 2012.
- Dixon M., e Drejta ndërkombëtare, Tiranë, 2009
- Draetta, Ugo & Lake, Ralph B. & Nanda, “Breach and Adaptation of International Contracts – An Introduction to Lex Mercatoria”, USA, 1992.
- Draškić, Malden & Stanivuković, Maja. “Ugovorno pravo međunarodne trgovine”, Beograd, 2005.
- Draškić, Mladen. “Međunarodno privredno ugovorno pravo (ugovorni odnosi sa elementom inostranosti)”, 2. izmenjeno i dopunjeno izdanje, Beograd, 1974.
- Draškić, Malden. “Obaveze prodavca prema unifikovanim propisima o međunarodnoj kupoprodaji”, Beograd, 1966.
- Durović, Radomir. “Menunarodno privredno pravo”, Beograd, 2004.
- Enderlein, Fritz, Maskoë, Dietrich & Stargardt, Monika. “Kommentar – Konvention der Vereinten Nationen über Verträge über den internationalen Warenkauf, Konvention über die Verjährung beim internationalen Warenkauf, Protokoll zur Änderung der Konvention über die Verjährung beim internationalen Warenkauf”, Berlin, 1985.
- Folsom, Ralph. Michael Gordon & John Spanogle, Menunarodni trgovački poslovi, Novi Sad, 1997.
- Fritz Enderlein & Dietrich Maskoë, International Sales Law, Oceana Publications, 1992.

- Galgano, Françesko. “E Drejta Private”, Tiranë, 2006.
- Gams, Andrija. “Hyrje në të Drejtën Civile”, Prishtinë, 1986.
- Goldštajn, Aleksadar. “Menunarodno trgovačko pravo – Konvencije- Pravila- Opći uvjeti poslovanja”, Zagreb, 1970.
- Goldštajn, Aleksandar. “Jednoobrazni zakoni o menunarodnoj kupoprodaji i autonomno privredno (trgovačko) pravo”, Beograd, 1966.
- Goldštajn, Aleksandar. “Konvencija Ujedinjenih naroda o ugovorima o menunarodnoj prodaji robe”, Zagreb, 1980.
- Goldštajn, Aleksandar. “Pravo menunarodne kupoprodaje, I”, Zagreb, 1965.
- Goldštajn, Aleksandar. “Pravo menunarodne kupoprodaje, II”, Zagreb, 1965.
- Goldštajn, Aleksandar. “Privredno ugovorno pravo”, Zagreb, 1967.
- Gorenc, Vilim. “Bazat e së Drejtës Tregtare Statusore dhe Kontraktore”, Prishtinë, 2010.
- Gjata, Rustem. “E Drejta Civile Sendet dhe Pronësia”, albPaper, Tiranë, 2011
- Gjata, Rustem. “E Drejta Civile”, pjesa e përgjithshme, Ribotim me ndryshimet përkatëse, viti 2010.
- Hedemann, Wilhelm. “Schuldrecht des Bürgerlichen Gesetzbuches”, Berlin, 1949.
- Hetemi, Mehdi. *Detyrimet dhe Kontratat, Prishtinë*
- Hix. S. & Hiyland B., Sistemi Politik i Bashkimit Evropian” Universum Press Prishtinë, 2013
- Honnold, Ruediger. “Documentary History of the Uniform Laë for the International Sales”, Philadelphia, 1989.
- Honnold, Ruediger. “Unification of the Laë Governing International Sales of Goods”, Paris, 1966.
- Honnold, Ruediger. “Uniform Laë for International Sales under the 1980 United Nations Convention”, 3rd edition, The Hague, 1999.
- Howorth, J. “Politikat e sigurisë dhe e mbrojtjes së Bashkimit Evropian” Universum Press, Prishtinë 2013.
- Jaffe, Die Anknüpfung der Verjährung im deutsch-amerikanischen Rechtsverkehr soëie das Institut der Verjährung beim Handelskauf beëeglicher Sachen im Staate New York, München, 1994.

- Jankovec, Ivica “Privredno pravo”, Beograd, 1999.
- Jankovec, Ivica. “Ugovorna odgovornost”, Beograd, 1993.
- Jankovec, Ivica. “Vidovi i posledice nemogućnosti ispunjenja ugovorne obaveze”, Beograd, 1982.
- Kalia, Ardian. E Drejta Ndërkombetare Private, Botimet Flesh, Tiranë, 2013.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kuvendi, Shkodër, 2001.
- Kapor, Vladimir & Carić, Slavko. “Ugovori robnog prometa”, IX izdanje, Novi Sad, 1996.
- Kapor, Vladimir. “Haški jednoobrazni zakon o zaključivanju ugovora o menunarodnoj kupoprodaji”, Novi Sad, 1974.
- Kapor, Vladimir. “Kupoprodaja robe u spoljnoj trgovini”, Novi Sad, 1972.
- Kapor, Vladimir. “Ugovor o kupovini i prodaji robe – tumač Opštih uzansi za promet robom”, Beograd, 1961.
- Kapor, Vladimir, Vilus Jelena, Trajković, Miodrag. “Nove pojave u unifikaciji međunarodnog privrednog prava”, Novi Sad, 1980.
- Klajn-Tatić, Vesna. Docnja prodavca sa predajom stvari, Beograd, 1983.
- Komentar Zakona o obligacionim odnosima, knjiga i, redaktor Blagojević, Borislav & Krulj, Vrleta, Beograd, 1980.
- Komentar Zakona o obligacionim odnosima, libri II, redaktor Perović, Slobodan. Beograd, 1995.
- Komentar ZOO, Knjiga I, Beograd, 1995.
- Krasniqi, Armand. E Drejta Biznesore Ndërkombëtare, Kolegji Evropian Dukagjini, Pejë, 2015
- Krasniqi, Armand. E Drejta Biznesore, Kolegji Evropian Dukagjini, Pejë, 2014
- Kritzer, Albert H. “Guide to Practical Application of the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods”, Deventer, 1989.
- Krüger, Jens & Westermann Rüdiger, “Münchener Kommentar zum Bürgerlichen Gesetzbuch”, Band 3, 4. Auflage, München, 2004.
- Krulj, Vrleta. “Dejstva ugovora o kupoprodaji – svojina, predaja, rizik i cena”, Beograd, 1972.

- Krulj, Vrleta. “Promenjene okolnosti i ugovorna odgovornost (nemogućnost ispunjenja, viša sila, klauzula rebus sic stantibus)”, Beograd, 1967.
- Lando, Ole & Beale, Hugh. (eds.), “Principles of European Contract Law - Parts I and II - Combined and Revised”, The Hague/London/Boston: Kluwer Law International (2000)
- Lando, Ole & Beale, Hugh. “Principles of European Contract Law – Parts I and II”,
- Larenz, Karl. “Lehrbuch des Schuldrechts, Allgemeiner Teil”, Band I, München, Berlin, 1960.
- Maho, Besnik. “Fitimi i pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, Universiteti Evropian i Tiranës, Tiranë 2009.
- Medicus, Dieter. “Schuldrecht I – Allgemeiner Teil”, 3. Auflage, München, 1986.
- Misita, Nevenka. “O uslovima primjene Bečke konvencije o međunarodnoj prodaji robe”, Sarajevo, 1990.
- Mlikotin-Tomić, Desa. “Pravo međunarodne trgovine”, Zagreb, 1999.
- N. Gavella dhe të tjerë, “Stvarno Pravo”, Zagreb, 1998
- Nourissat, Cyril. “E Drejta e Biznesit e Bashkimit Evropian”, Papirus, 2010, fq. 36.
- Nuni, Ardian & Hasneziri, Luan. “E Drejta Civile II-Pronesia”, Tirane, 2010
- Nuni, Ardian & Mustafaj Ilir, & Vokshi Asim. E Drejta e Detyrimeve I” Tiranë 2008
- Nuni, Ardian & Mustafaj Ilir, & Vokshi Asim. E Drejta e Detyrimeve II” Tiranë 2008
- Nuni, Ardian. “E Drejta Civile”, Pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012.
- Perović Jelena., “Bitna povreda ugovora - Međunarodna prodaja robe”, Beograd, 2004.
- Perović Slobodan., Obligationo pravo – opšta teorija ugovora, Beograd, 1968.
- Perović Slobodan., Predgovor Zakonu o obligacionim odnosima, 14. Beograd, 2002.
- Popović, Vitomir. “Doknja prodavca sa isporukom robe”, Banja Luka, 2000.
- Popović, Vitomir. “Pravni aspekti doknje kupca”, Banja Luka, 1998.
- Posch, Martin. “Neugestaltung des Kaufrechts”, Berlin, 1961.
- Rabel, Ernst. Das Recht des Warenkaufs – eine rechtsvergleichende Darstellung, 1. Band, Berlin, Tübingen, 1958.
- Rabel, Ernst. Das Recht des Warenkaufs – eine rechtsvergleichende Darstellung, 2. Band, Berlin, Tübingen, 1958.

- Rabel, Ernst. Die Haftung des Verkäufers wegen Mangels im Rechte, Berlin, New York, 1973.
- Reich, Dietmar & Schmitz, Peter. “Einführung in das Bürgerliche Recht”, 2. Auflage, Wiesbaden, 1999.
- Schlechtriem, Peter & Shwenzer, Ingeborg. “Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)”, 2nd (English) edition, New York, 2005.
- Schlechtriem, Peter. “Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods (CISG)”, 1st edition, München, New York, 1998.
- Schlechtriem, Peter. “Kommentar zum Einheitlichen UN-Kaufrecht”, 3. Völlig neubearbeitete Auflage, München, 2000.
- Schlechtriem, Peter. “Schuldrecht – Besonderer Teil”, 6. Ëeitgehend neubearbeitete Auflage, Tübingen, 2003.
- Schlechtriem, Peter. “Uniform Sales Law – The UN-Convention on Contracts for the International Sale of Goods”, Vienna, 1986.
- Schmidt, Karsten. “Münchener Kommentar zum Handelsgesetzbuch”, München, 2004.
- Schulze, Reiner. “Bürgerliches Gesetzbuch – Handkommentar”, 2. Auflage, Baden-Baden, 2002.
- Schumann, Hans. “Handelsrecht, Teil III”, Ëiesbaden, 1962.
- Sime Ivanjko, Hilda Marija Pivka & Kresimir Puharič. “Pravo mednarodne trgovine”, Ljubljana, 1989.
- Smaka, Riza. “*E Drejta Biznesore*”, Universiteti Mbretëror ILIRIA, Prishtinë , 2008.
- Spanogle, John & Winship, Peter. “International Sales Laë – A Problem-oriented” Coursebook, St.Paul, 2000.
- Spirović-Jovanović, Lucija & Milenković-Kerković, Tamara. “Poslovi trgovinskog prava”, Niš, 2006.
- Spirović-Jovanović, Lucija. “Garantija za ispravno funkcionisanje stvari”, Beograd, 1975.
- Statovci, Ejup. “E Drejta e Pengut”, Prishtinë, 1998.
- Staub, Herman. “Handelsgesetzbuch – Grosskommentar”, Dritter Band, Berlin, 1968.

- Staub, Herman. “Handelgesetzbuch – Grosskommentar”, Dritter Band, Berlin, New York, 1978.
- Staub, Herman. “Handelgesetzbuch – Grosskommentar”, Vierter Band, Berlin, 1970.
- Staudinger, Julius von. & Magnus, Ulrich. “Wiener UN-Kaufrecht (CISG)”, Berlin, 2005.
- Stojiljković, Vladimir. “Menunarodno privredno pravo”, 2. izdanje, Beograd, 2003.
- Stone, Bradford. “Uniform Commercial Code”, St. Paul, Minnesota, 1984.
- Tratnik, Matijas & Ferčić, Ales. “Mednarodno gospodarsko pravo”, Maribor, 2002.
- Treitel, Guenter. “The Law of Contract”, 11th edition, London, 2003.
- Tunc, Andre. “Commentary on the Hague Conventions of the 1st of July 1964 on International Sale of Goods and the Formation of the Contract of Sale”, www.cisg.law.pace.edu
- Tutulani-Semini, Mariana. “E Drejta E Detyrimeve dhe e Kontratave”, Pjesa e përgjithshme, Skanderbegbooks, Tiranë 2006.
- Tutulani-Semini, Mariana. “E Drejta E Detyrimeve dhe e Kontratave”, Pjesa e posaçme, Skanderbegbooks, Tiranë 2006.
- Van Houtte, Hans. “The Law of International Trade”, 2nd Edition, London, 2002.
- Vasiljević, Mirko. “Poslovno pravo”, Beograd, 2003.
- Vedriš, Martin & Klarić, Petar. “Građansko Pravo”, Zagreb, 1998.
- Veljković, Dragoslav. “Obligaciono pravo kroz Komentar Zakona o obligacionim obligacionim odnosima” – për aplikimin dhe praktikën me shembuj nga kontrata e shitjes, padi dhe praktika gjyqësore, Beograd, 2005.
- Vermelle, Georges, “E Drejta civile, Kontratat –Pjesa e Posaçme”, Papirus, Tirane 2008.
- Vilus, Jelena. “Komentar Konvencije UN o menunarodnoj prodaji robe”, Zagreb, 1981.
- Vilus, Jelena. “Konvencija Ujedinjenih nacija o ugovorima o menunarodnoj prodaji robe – Bečka Konvencija – Šta jugoslovenski izvoznik i uvoznik mora da zna u vezi sa Bečkom konvencijom”, Beograd, 1985.
- Vilus, Jelena. “Odgovornost za kvalitet i kontrola kvaliteta u menunarodnom prometu robe”, Novi Sad, 1976.
- Vilus, Jelena. “Opšti uslovi formularnih ugovora”, Beograd, 1976.

- Vilus, Jelena. “Tipski ugovori o menunarodnoj prodaji”, Beograd, 1963.
- Vizner, Boris & Bukljaš, Ivan. “Komentar Zakona o obveznim (obligacionim) odnosima”, libri 3, Zagreb, 1979.
- Vizner, Boris. “Komentar Zakona o obveznim (obligacionim) odnosima”, libri 1 dhe 2, Zagreb, 1978.
- Vukadinović, Radovan. “Medunarodno poslovno pravo – opšti deo”, Kragujevac, 2005.
- Zakon o Obaveznim Odnosima, Narodne Novine, Zagreb, 2005.
- Zeller, Bruno. “Damages under the Convention on Contracts for the International Sale of Goods”, New York, 2005.
- Zimmermann, R&Wittaker, S. Good Faith in european Contract Law, Cambridge, 2000

c). Artikuj

- Bernard. Audit,. *Vienna Sales Convention and the Lex Mercatoria*, Lex Mercatoria and Arbitration, 1990, 173-194.
- Bartels Jochacim & Motomura, Motomura. *Haftungsprinzip, Haftungsbefreiung und Vertragsbeendigung beim internationalen Kauf*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 4, 1979, 649-707.
- Belegu, Majlinda. “Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese si bazë për funksionimin e ligjit në shtetin e së drejtës”, punim në konferencën me titull Universiteti i Tetovës, 12 Mars 2014
- Blase Friedrich & Höttler, Philipp. *Remarks on the Damages Provisions in the CISG, Principles of European Contract Law (PECL) and UNIDROIT*
- Brand, Brnad. *CISG Article 31: When Substantive Law Rules Affect Jurisdictional Results*, *Journal of Law and Commerce*, 2005/06, 181-202.
- Boghossian, Nayiri. *A Comparative Study of Specific Performance in the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, Pace Review of the Convention on Contracts for the International Sale of Goods, Kluwer 1999-2000, fq. 3-78.

- Bonell, Michael Joachim. *The UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts and the Principles of European Contract Law: Similar Rules for the Same Purposes?*, Uniform Law Review, 1996, 229-246, www.cisg.law.pace.edu
- Bonell, Michael Joachim. *The UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts and CISG – Alternative or Complementary Instruments?*, Uniform Law Review, 1996, 26-39, www.cisg.law.pace.edu
- Bonell, Michael Joachim. *Introduction to the Convention*, Bianca-Bonell: Commentary on the International Sales Law, Milan, 1987, 1-20.
- Bonell, Michael Joachim & Liguori, Fabio. *The U.N. Convention on the International Sale of Goods: a Critical Analysis of Current International Case Law – 1997 (Part II)*, Uniform Law Review, Vol. 2, 1997-3, 583-597.
- Bonell, Michael Joachim & Liguori, Fabio. *The U.N. Convention on the International Sale of Goods: a Critical Analysis of Current International Case Law (Part II)*, Uniform Law Review, Vol. 1, 1996-2, 359-375.
- Borisova, Bozhidara. *Remarks on the manner in which the Principles of European Contract Law may be used to interpret or supplement Article 75 of the CISG*, October 2003, www.cisg.law.pace.edu
- Butler, Allison. *Limitation of Remedies Due to Failure of Performance Caused by Other Party: Comparison Between Provisions of the CISG and Counterpart Provisions of the Principles of European Contract Law*, www.cisg.law.pace.edu
- Bydlinski, Franz. *Vertragliche Qualitätsgarantie im österreichischen Recht*, Recht der Internationalen Wirtschaft, 36:1981, 149-151. Caemmerer, *Das Verschuldensprinzip in rechtsvergleichender Sicht*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 1, 1978, 5-27.
- Cerqueira, *Defective Performance in Contracts for International Sale of Goods - A Comparative Analysis between the Brazilian Law and the 1980 United Nations Convention on Contracts for the International Sales of Goods*, May 2005, www.cisg.law.pace.edu
- Cohen, Kathryn S. *Achieving a Uniform Law Governing International Sales: Conforming the Damages Provisions of the United Nations Convention on Contracts for the*

International Sale of Goods and the Uniform Commercial Code, University of Pennsylvania Journal of International Economic Law, 2005, 601-622.

- Darkey, Joanne J. *A U.S. Court's Interpretation of Damage Provisions under the U.N. Convention on Contracts for the International Sale of Goods: A Preliminary Step towards an International Jurisprudence of CISG or a Missed Opportunity?*, Journal of Law and Commerce, 1995, 139- 152.
- Del Duca Louis F & Del Duca Patrick. *Selected Topics Under the Convention on International Sale of Goods (CISG)*, Dickinson Law Review, 2001, 205-253.
- DiMatteo, Larry A, Dhooge, Lucien & Greene, Stephanie Maurer, Virginia & Pagnattaro, Marisa. *The Interpretive Turn in International Sales Law: An Analysis of Fifteen Years of CISG Jurisprudence*, Northwestern Journal of International Law and Business, 2004, 299-440.
- Di Palma, Maryellen. *Nachfrist under National Law, the CISG, and the UNIDROIT and European Principles: A Comparison*, International Contract Adviser, Vol. 5, No.1, 1999, 28-38.
- Dokter, D. *Interpretation of exclusion-clauses of the Vienna Sales Convention*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 3 (Juli), 2004, 431-443.
- Eiselen, Siegfried. *A Comparison of the Remedies for Breach of Contract under the CISG and South African Law*, Aufbruch nach Europa – 75 Jahre Max-Planck-Institut für Privatrecht, 2001, www.cisg.law.pace.edu
- Enderlein, Fritz. *Rights and Obligations of the Seller under the UN Convention on Contracts for International Sale of Goods*, International Sale of Goods: Dubrovnik Lectures, Oceana, 1996, 133-201, www.cisg.law.pace.edu
- Ergun, Cagdas Evrim. *Comparative Study on the Buyer's Remedies Under the 1980 Vienna Sales Convention and Turkish Sales Law*, www.cisg.law.pace.edu
- Eörsi, Gyula. *The Validity of Clauses Excluding or Limiting Liability*, American Journal of Comparative Law, 1975, 215-235.
- Farnsworth, E. Allan. *An International Restatement: The UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts*, University of Baltimore Law Review, Vol. 26, 1997, 1-7.

- Farnsworth, E. Allan. *Developments in Contract Law during the 1980's: The Top Ten, Case Western Reserve Law Review*, Vol. 41, 1990-1991, 203-230.
- Farnsworth, E. Allan. *On Trying to Keep One's Promises: the Duty of Best Efforts in Contract Law*, University of Pittsburg Law Review, Vol. 46, 1984-1985, 1-20.
- Farnsworth, E. Allan. *The Problems of Nonperformance in Contract*, New England Law Review, Vol. 17, 1981-1982, 249-319.
- Farnsworth, E. Allan. *Damages and Specific Relief*, American Journal of Comparative Law, Vol. 27, 1979, 247-253.
- Farnsworth, E. Allan. *Legal Remedies for Breach of Contract*, Columbia Law Review, Vol. 70, No. 7, November 1970, 1145-1216.
- Felemegas, John. *An Interpretation of Article 74 CISG by the U.S. Circuit Court of Appeals*, 15 Pace International Law Review, Spring 2003, 91-147.
- Ferrari, Franco. *The Interaction between the United Nations Conventions on Contracts for the International Sale of Goods and Domestic Remedies*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 1 (Januar), 2007, 52-80.
- Ferrari, Franco. *Divergences in the application of the CISG's rules on nonconformity of goods*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 3 (Juli), 2004, 471-494.
- Ferrari, Franco. *Comparative Ruminations on the Foreseeability of Damages in Contract Law*, Louisiana Law Review, Vol. 53, 1993, 1257-1269.
- Ferrari, Franco. *Comparative Remarks on Liability for One's Own Acts*, Loyola of Los Angeles International and Comparative Law Journal, 1992-1993, 813-845.
- Ferreri, Silvia. *Remarks Concerning the Implementation of the CISG by the Courts (the Seller's Performance and Article 35)*, Journal of Law and Commerce, 2005-06, 223-239.
- Flambouras, Dionysios. *Comparative Remarks on CISG Article 79 & PECL Articles 6:111, 8:108*, May 2002, www.cisg.law.pace.edu
- Flambouras, Dionysios. *Remarks on the manner in which the PECL may be used to interpret or supplement Article 79 CISG*, May 2002, www.cisg.law.pace.edu
- Flambouras, Dionysios. *The Doctrines of Impossibility of Performance and clausula rebus sic stantibus in the 1980 Vienna Convention on Contracts for the International Sale*

of Goods and the Principles of European Contract Law: A Comparative Analysis, Pace International Law Review, Fall 2001, 261-293.

- Flechtner, Harry M. *Remedies Under the New International Sales Convention: The Perspective from Article 2 of the U.C.C.*, Journal of Law and Commerce, 1988, 53-108.
- Fuller, L.L. & Perdue, William R. *The Reliance Interest in Contract Damages: 1*, Yale Law Journal, 1936, fq. 52-96.
- Garro, Alejandro M. *Comparison between provisions of the CISG regarding exemption of liability for damages (Art.79) and the counterpart provisions of the UNIDROIT Principles (Art.7.1.7)*, 2005, www.cisg.law.pace.edu
- Giuliano, Adam. *Non-conformity in the Sale of Goods between the United States and China: The New Chinese Contract Law, the Uniform Commercial Code, and the Convention for the International Sale of Goods*, 2005, www.cisg.law.pace.edu
- Gordley, James. *Impossibility and Changed and Unforeseen Circumstances* American Journal of Comparative Law, Summer 2004, 513-530.
- Henschel, René Franz. *Conformity of Goods in International Sales Governed by CISG Article 35: Caveat Venditor, Caveat Emptor and Contract Law as Background Law and as a Competing Set of Rules*, Nordic Journal of Commercial Law, 2004/1, 1-21.
- Henschel, René Franz *Interpreting or Supplementing Article 35 of the CISG by using the UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts and the Principles of European Contract Law*, www.cisg.law.pace.edu
- Herber, Rolf. *Das VN-Übereinkommen über internationale Kaufverträge*, Recht der Internationalen Wirtschaft, 9/1980, 601-608.
- Herber, Rolf. *The Rules of the Convention Relating to the Buyer's Remedies in Cases of Breach of Contract*, www.cisg.law.pace.edu
- Herbert, Asam. *UN-Kaufrechtsübereinkommen im deutsch-italienischen Rechtsverkehr*, Recht der Internationalen Wirtschaft, 12/1989, 942-946.
- Huber, Peter. *CISG – The Structure of Remedies*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 1 (Januar), 2007, 13-34.
- Huber, Peter. *Der UNCITRAL-Entwurf eines Übereinkommens über internationale Warenkaufverträge*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 3, 1979, 413-526.

- Hyland, Richard. *Conformity of Goods to the Contract Under the United Nations Sales Convention and the Uniform Commercial Code*, u Schlechtriem, Einheitliches Kaufrecht und nationals Obligationenrecht, Baden-Baden, 1987, fq. 305-341.
- Lando, Ole. *Das neue Schuldrecht des Bürgerlichen Gesetzbuchs und die Grundregeln des europäischen Vertragsrechts*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 2 (April), 2003, 231-245.
- Lando, Ole. *The Rules of the European contract law*, Study of the systems of private law in the EU with regard to the discrimination and the creation of a European Civil Code, European Parliament, Directorate General for Research, Working Paper, Legal Affairs Series, JURI 103 EN, June 1999, Chapter III, 127-136 www.cisg.law.pace.edu
- Lee, Wanki. *Exemptions of Contract Liability Under the 1980 United Nations Convention*, Dickinson Journal of International Law, 1990, 375-394.
- Limbach, Francis & Ahearn, Brendon. *Conformity of goods, derogation from Article 40 by the parties and conditions of Art. 40 CISG*, www.cisg.law.pace.edu
- Lindström, Niklas. *Changed Circumstances and Hardship in the International Sale of Goods*, Nordic Journal of Commercial Law, 2006/1, 1-29.
- Liu, Chengwey. *Additional Period (Nachfrist) for Late Performance: Perspectives from the CISG, UNIDROIT Principles, PECL and Case Law*, 2005, www.cisg.law.pace.edu
- Liu, *Specific Performance: Perspectives form the CISG, UNIDROIT Principles, PECL and Case Law*, 2005, www.cisg.law.pace.edu
- Liu, Chengwey. *Price Reduction for Non-Conformity: Perspectives form the CISG, UNIDROIT Principles, PECL and Case Law*, 2005, www.cisg.law.pace.edu
- Liu, Chengwey. *Force Majeure: Perspectives form the CISG, UNIDROIT Principles, PECL and Case Law*, 2005, www.cisg.law.pace.edu
- Liu, Chengwey. *Place of Performance: Comparative analysis of Articles 31 and 57 of the CISG and counterpart provisions in Article 7:101 of the PECL*, November 2004, www.cisg.law.pace.edu
- Liu, Chengwey. *Comparison of CISG Article 45/61 remedial provisions and counterpart PECL Articles 8:101 and 8:102*, May 2004, www.cisg.law.pace.edu
- Liu, Chengwey. *Remedies for Non-performance: Perspectives form the CISG, UNIDROIT Principles & PECL*, September 2003, www.cisg.law.pace.edu

- Lookofsky, Joseph M. *Fault and No-Fault in Danish, American and International Sales Law: The Reception of the United Nations Sales Convention*, Scandinavian Studies in Law, 1983, 109-138.
- Magnus, Ulrich. *Die allgemeinen Grundsätze im UN-Kaufrecht*, www.cisg.law.pace.edu
- Magnus, Ulrich. *The Remedy of Avoidance of Contract Under CISG – General Remarks and Special Cases*, Journal of Law and Commerce, 2005-06, 423-436.
- Mullis, Alastair. *Twenty-Five Years On – The United Kingdom, Damages and the Vienna Sales Convention*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 1 (Januar), 2007, 35-51.
- Nicholas, Barry. *The Vienna Convention on International Sales Law*, 105 Law Quarterly Review, 1989, 201-243.
- Nicholas, Barry. *Impracticability and Impossibility in the U.N. Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, International Sales:
- Nicholas, Barry. *Force Majeure and Frustration*, 27 American Journal of Comparative Law, 1979, 231-245.
- Oberman, Nail Gary. *Transfer of risk from seller to buyer in international commercial contracts: A comparative analysis of risk allocation under the CISG, UCC and Incoterms*, www.cisg.law.pace.edu
- Perillo, Joseph. *UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts: the Black Letter Text and a Review*, Fordham Law Review, Vol. 63, 1994-1995, 281-344.
- Perović Jelena. *Aliud kao osnov za raskid ugovora o menunarodnoj prodaji robe*, Pravni život, 11/2006, fq. 257-265.
- Perović Jelena. *Izjava o raskidu kao uslov za raskid ugovora zbog neispunjenja obaveze*, Pravni život, 11/2005, fq. 473-499.
- Piliounis, Peter A. *The Remedies of Specific Performance, Price Reduction and Additional Time (Nachfrist) under the CISG: Are these worthwhile changes or additions to English Sales Law?*, Pace International Law Review, Spring 2000, 1-46.
- Piltz, Burghard. *Die Rechtsprechung zum Haager Einheitlichen Kaufrecht*, Recht der Internationalen Wirtschaft, 3/1986, 167-172.
- Poikela, Teija. *Conformity of Goods in the 1980 United Nations Convention of Contracts for the International Sale of Goods*, Nordic Journal of Commercial Law, 2003/1.

- Rauda, Christian & Etier, Guillaume. *Warranty for Intellectual Property Rights in the International Sale of Goods*, Vindobona Journal of International Commercial Law and Arbitration, Issue 1/2000, 30-61.
- Rosett, Arthur. *UNIDROIT Principles and Harmonisation of International Commercial Law: Focus on Chapter Seven*, www.unidroit.org
- Shinn Jr. Allen M. *Liabilities under Article 42 of the U.N. Convention on the International Sale of Goods*, Minnesota Journal of Global Trade, 1993, 115-142.
- Schlechtriem, Peter. *Subsequent Performance and Delivery Deadlines - Avoidance of CISG Sale Contracts Due to Non-conformity of the Goods*, Pace International Law Review, Spring 2006, 83-98.
- Schlechtriem, Peter. *Damages, avoidance of the contract and performance interest under the CISG*, Festschrift Apostolos Georgiades, Athens, 2005.
- Schlechtriem, Peter. *The Seller's Obligations Under the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, www.cisg.law.pace.edu
- Schlechtriem, Peter. *Basic Structures and General Concepts of the CISG as Models for a Harmonisation of the Law of Obligations*, Juridica International, X/2005, 27-34.
- Schlechtriem, Peter. *Conformity of the goods and standards established by public law*, Case commentary, 1999, www.cisg.law.pace.edu
- Schlechtriem, Peter. *Uniform Sales Law – The Experience with Uniform Sales Laws in the Federal Republic of Germany*, Juridisk Tidskrift, 1991/92, 1-28.
- Schlechtriem, Peter. *Uniform Sales Law in the Decisions of the Bundesgerichtshof*, 50 Years of the Bundesgerichtshof, www.cisg.law.pace.edu
- Schwenger, Ingeborg. *Avoidance of the Contract in Case of Non-Conforming Goods (Art. 49(1)(a)CISG)*, Journal of Law and Commerce Vol. 25, 2005-2006, 437-441.
- Schwenger, Ingeborg. *The Danger of Domestic Pre-Conceived Views with Respect to the Uniform Interpretation of the CISG: the Question of Avoidance in the Case of Non-Conforming Goods and Documents*, Victoria University of Wellington Law Review, 36/2005, 795-807.
- Schwenger, Ingeborg. *Specific Performance and Damages According to the 1994 UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts*, European Journal of Law Reform, Vol. 1, No. 3, 1999, 289-303.

- Siehr, Kurt. *Convention on the International Sale of Goods - Summary*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 3 (Juli), 2004, 528-532.
- Southerington, Tom. *Impossibility of Performance and Other Excuses in International Trade*, 2001., www.cisg.law.pace.edu
- Stoffel, Walter. *Ein neues Recht des internationalen Earenkaufs in der Schweiz: C. Grundzüge des Konventionsrechts: Rechte und Pflichten der Parteien*, Schweizerische Juristen-Zeitung, Heft 10/1990, 175-178.
- Sutton, Jeffrey S. *Measuring Damages Under the United Nations Convention on the International Sale of Goods*, Ohio State Law Journal, Vol. 50, 1989, 737-752.
- VanDuzer, Anthony. *Seller's Responsibility for Third Party Intellectual Property Claims: Are the UN Sales Convention Rules Better?*, Canadian International Lawyer, 2001.
- Vilus, Jelena. *UNIDROIT Načela menunarodnih trgovinskih ugovora, 2004. – Preraneno i dopunjeno izdanje*, Pravni život, 11/2005, fq. 459-472.
- Vilus, Jelena. *Načela menunarodnih trgovinskih ugovora, UNIDROIT 1994*, Pravni život II-1998, fq. 413-431.
- Vilus, Jelena. *Provisions Common to the Obligations of the Seller and the Buyer*, International Sale of Goods: Dubrovnik Lectures, Oceana, 986, Ch. 7, 239-264.
- Viscasillas, Pilar Perales. *The Nachfrist Remedy*, Sinagapore International Arbitration Centre, 2005, 89-102, www.cisg.law.pace.edu
- Vukadinović, Slobodan. *Način i mesto isporuke robe prema Konvenciji UN o menunarodnoj prodaji robe*, Pravna riječ –časopis za pravnu teoriju i praksu, 20/2009, 631-643.
- Winship, Peter. *Exemptions under article 79 of the Vienna Sales Convention*, Rabels Zeitschrift für ausländisches und internationales Privatrecht, Heft 3 (Juli), 2004, 495-510.
- Zimmermann, Reinhard. *Breach of Contract and Remedies under the New German Law of Obligations*, Roma, 2002, 1-51.

c). Vendime Gjyqësore

- *ANCE Tribunal de Commerce (District Court) Besancon 19 January 1998,*
www.cisg.law.pace.edu
- BULGARIA Arbitration Award case No. 56/1995 of 24. April 1996
www.cisg.law.pace.edu
- *FR NETHERLANDS Rechtbank (District Court) 's-Hertogenbosch 2 October 1998*
www.cisg.law.pace.edu,
- Germany 29 March 2001 District Court (Landgericht) Trier www.cisg.law.pace.edu;
Switzerland 28 October 1998 Supreme Court www.cisg.law.pace.edu;
- Germany 21 March 1996 Hamburg Arbitration proceeding www.cisg.law.pace.edu
- Gjykata e Arbitrazhit, rasti No.9187 Qershor 1999, www.cisg.law.pace.edu.
- M Oberlandesgericht Koblenz, 14.12.2006., www.unilex.info
- MEXICO, 29. April 1996 Compromes Arbitration (Canned fruit case),
www.cisg.law.pace.edu
- RUSSIA Arbitration Award case No. 054/1999 of 24 January 2000,
www.cisg.law.pace.edu.
- SWEDEN, 5 June 1998 Arbitration Institute of the Stockholm Chamber of Commerce
(4.000 ton rail press case), www.cisg.law.pace.edu

d). Web faqe

- www.cisg.law.pace.edu
- <http://www.uncitral.org>
- www.icco.org,
- <http://www.unidroit.org>
- www.law.com
- http://www.jus.uio.no/pace/en/html/the_rules_of_european_contract_law.ole_lando/toc.html

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.